

# ENVER HOXHA

VEPRA

23



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPËRISE**



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE  
PRANÉ KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VELLIMI

23

JANAR 1962 – TËTOR 1962

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1977



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 23-të

Në vëllimin e 23-të të Veprave të shokut Enver Hoxha përfshihen dokumente që i përkasin periudhës janar-tetor 1962. Këto dokumente, shumica e të cilave botohen për herë të parë, janë shkruar në një periudhë shumë të vështirë, por të lavdishme që kalonte Partia dhe populli ynë, në kushtet e bllokadës së egër ekonomike dhe të presioneve të gjithanshme imperialisto-revizioniste. Revizionistët sovjetikë, pas prerjes në mënyrë të njëanshme të marrëdhënieve diplomatike me vendin tonë, kishin kaluar plotësisht në pozita të hapura armiqësore, antishqiptare e antimarksiste.

Karakteristika kryesore e kësaj periudhe në fushën e politikës së jashtme ishte thellimi dhe vazhdimi pa kompromis i luftës së hapur parimore kundër imperializmit, revizionizmit hrushovian dhe veglave të tyre. Kjo luftë që zhvillonte PPSH kishte për qëllim, përveç të tjerash, t'u çirrte plotësisht maskën revizionistëve modernë sovjetikë, të tregonte me argumente bindëse brenda vendit dhe në opinionin ndërkombëtar tradhtinë e udhëheqësve sovjetikë ndaj marksizëm-leninizmit dhe internacionalizmit proletar.

PPSH vazhdonte të mos ushqente asnjë iluzion për natyrën dhe karakterin agresiv të imperializmit, në ra-

dhë të parë të atij amerikan, për tradhtinë e revizionistëve sovjetikë, jugosllavë etj. Ajo e shihte qartë se revizionistët modernë po shkonin gjithnjë e më thellë në llumin e antikomunizmit. Propozimeve të disa partive për rikrijimin e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, PPSH iu përgjigj nga pozita të drejta e parimore, në interes të marksizëm-leninizmit. Në njaft materiale që përfshihen në këtë vëllim, si në fjalën para zgjedhësve të zonës elektorale Nr. 179 të kryeqytetit, në fjalën e mbylljes në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH etj., del qartë se PPSH luftonte për një unitet të vërtetë mbi parimet e marksizëm-leninizmit e jo për një unitet fals, me lëshime të paprincipita dhe në dëm të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Duke njohur mirë veprimtarinë revizioniste të udhëheqjes sovjetike, PPSH me shoqun Enver Hoxha në krye, parashitroi qartë dhe prerë se uniteti i vërtetë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare mund të arrihej vetëm atëherë kur N. Hrushovi do të pranonte publikisht dëmet e mëdha që i kishte sjellë komunizmit ndërkombëtar. Por një gjë të tillë ky tradhtar s'mund ta bënte, ashtu sikundër nuk e bëri, sepse kjo do të ishte vetëvrasje për të. Në dokumentet e këtij vëllimi pasqyrohen qartë edhe një herë largpamësia e PPSH, vija marksiste-leniniste e saj, drejtësinë e të cilës e vërtetoi koha. Vazhdimi i polemikës, lufta pa kompromis, demaskimi i plotë i revizionistëve hrushovianë ishin të domosdoshme për të siguruar një unitet të shëndoshë në radhët e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Në këto kushte të acarimit të situatës së jashtme, të ashpërsimit të bllokadës, presioneve e shantazheve

kundër vendit tonë, detyra e PPSH në planin e brendshëm ishte intensifikimi i mëtejshëm i punës ideopolitike, për të bërë kurdoherë e më shumë të ndërgjegjshëm gjithë komunistët dhe masat punonjëse në luftë për realizimin e plotë të detyrave të mëdha që shtronte plani i vitit 1962, viti i dytë i pesëvjeçarit të tretë. Vështrësitë ishin të shumta si rezultat i shtimit të presioneve dhe të synimeve armiqësore e antishqiptare të imperialistëve e revizionistëve, por edhe lufta e popullit tonë, nën udhëheqjen e Partisë, për kapërcimin e këtyre vështirësive, ishte e madhe.

Në mjaft materiale që botohen në këtë vëllim, si në fjalën e mbajtur në aktivin e Partisë të rrethit të Fierit, në bisedat e fjalimet në rrethin e Shkodrës, në diskutime në mbledhje të Byrosë Politike të Sekretariatit të KQ të PPSH e të tjera, duket më së miri kujdesi dhe vëmendja që u kushtuan në këtë periudhë KQ i PPSH e shoku Enver Hoxha forcimit të frontit të brendshëm, zhvillimit të pandërprerë të luftës së klasave, zbatimit të parimit të mbështetjes në forcat e veta, forcimit të marrëdhënieve kuadër-masë, përmirësimit të vazhdueshëm të metodës së drejtimit për zbatimin e direktivave të Partisë etj.

Një vend të rëndësishëm në këtë vëllim zë edukimi ideologjik i kuadrove, sidomos i inteligjencës, duke shtruar para tyre çështjen e studimit e të drejtimit shkencor si një domosdoshmëri për të ndërtuar me sukses socializmin, për të zbatuar detyrat që kishte shtruar Kongresi i 4-t i PPSH.

Në kushtet konkrete që gjendej vendi ynë në këtë periudhë, rëndësi të madhe merrete kuptimi politik i

problemeve të ndërtimit socialist në Shqipëri. Komiteti Qendror i Partisë dhe shoku Enver Hoxha porositnin se vetëm duke kuptuar thellë anën politike e ideologjike të problemeve dhe të detyrave që shtronte koha, masat punonjëse do të bëheshin plotësisht të ndërgjegjshme për zgjidhjen me sukses të tyre, për të vënë në shërbim të revolucionit e të socializmit të gjitha aftësitë e tyre mendore e fizike, duke i bërë të pafektshme presionet e shumta e të gjithanshme të revizionistëve sovjetikë dhe bllokadën e egër imperialisto-revizioniste.

Në materialet e këtij vëllimi shprehet qartë vendosmëria e Partisë dhe e popullit tonë për të kryer me nder detyrat në të gjitha fushat. Në këtë kuadër me rëndësi të madhe ishin detyrat në fushën e mbrojtjes së atdheut. PPSH synonte që komunistët dhe punonjësit të kuptonin thellë rrezikun që vinte nga imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik, të mprehej gjithnjë vigjilenca politike e ideologjike ndaj armiqve të jashtëm e të brendshëm, të forcoheshin përgatitjet ushtarake dhe fryma revolucionare në punë, të ngrihej më lart roli udhëheqës i Partisë në të gjitha drejtimet, të gjallëroheshin më tej organet e diktaturës së proletariatit, organizatat e masave etj.

Duke i kuptuar drejt politikisht e ideologjikisht problemet që shtronte situata në atë kohë, klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjenca popullore, mobilizuan të gjitha forcat për të realizuar detyrat e ngarkuara nga Partia, për ndërtimin socialist dhe mbrojtjen e atdheut tonë.

## SHKENÇA DHE TEKNIKA TE NE JANË PRONË E MASAVE

*Nga fjala në mbledhjen solemne me rastin e 15-vjetorit  
të themelimit të politeknikut «7 Nëntori»<sup>1</sup>*

6 janar 1962

Të dashur nxënës dhe mësues të politeknikut,  
Të dashur shokë dhe miq,  
I dashur shoku drejtor, Gjergj Canco,

Jam jashtëzakonisht i gëzuar dhe i prekur që marr pjesë në këtë mbledhje solemne. Me këtë rast dua t'ju them se jam borxhli ndaj jush, sidomos ndaj drejtorit tuaj, shokut tonë të dashur, Gjergj Canco; i cili më ka ftuar disa herë për t'ju vizituar, por këtë nuk e kam bërë dot, sepse nuk kam pasur mundësi. Tani dëshiroj të pohoj se nga mosardhja midis jush kam humbur. Për këtë gjë zgjodha një rast shumë të mirë, ditën e 15-vjetorit të lavdishëm të themelimit të shkollës suaj.

Gëzimi që ju ndieni sot, krenaria juaj e ligjshme dhe e gjithë shokëve tuaj më të vjetër që kanë dalë

---

<sup>1</sup> Sot shkolla e mesme industriale «7 Nëntori».

nga bankat e kësaj shkolle, janë plotësisht të merituar. Por unë ju siguroj se, së bashku me ju, sot gëzohet i gjithë populli shqiptar, se ky institucion është një qendër e madhe mësimore, nga gjiri i tij kanë dalë mijëra kuadro, që tani drejtojnë me sukses shumë sektorë të rëndësishëm të ekonomisë e gjer në degët e ndryshme të Universitetit të Tiranës.

Së bashku me ju gëzohen edhe të gjithë ish-nxënësit e kësaj shkolle, që nuk kanë mundur të vijnë dot në këtë festë, por që me mendje dhe me zemër janë midis jush. Kjo është e vërtetë, të gjithë e kemi provuar se sa më shumë që kalon koha, aq më tepër shtohet malli dhe dashuria për shkollën ku ke mësuar, për arsye se gjatë jetës njeriu e ndien akoma më shumë vlerën e madhe të mësimin, e ndien se ato mësimet që ka përveçësuar në bankat e shkollës, ia lehtësojnë punën dhe njëkohësisht e shtojnë t'i zgjerojë më tej dituritë e tij, e bëjnë të vlefshëm për popullin dhe atdheun, i krijojnë një gëzim të madh në familjen që ka formuar ose që ka për të formuar.

Nuk ka njeri që gjatë jetës së tij të mos kujtojë me dashuri dhe respekt kohën e bukur të shkollës, shokët, mësuesit ose pedagogët e tij. Edhe unë tani shoh këtu midis jush shokë dhe miq të vjetër, disa edhe ish-profesorë të mi dhe ndiej një gëzim të madh. Në sallën e kësaj mbledhjeje solemne është mësuesi i vjetër Hysni Babameto, që më ka mësuar bazat e rëndësishme të shkencës së matematikës qysh në moshën 13-14 vjeç. Tani, sado që i janë zbardhur krejtësisht flokët, e shikoj po aq të ri nga zemra, sa akoma nuk ndien të lodhur, megjithëse që prej gjys-

më shekulli vazhdon të mësojë dhe të edukojë djemtë dhe vajzat e popullit. Midis jush shoh shokë të vjetër si Vangjel Gjikondi, Aqif Selfo etj., me të cilët kam mësuar në bankat e shkollës dhe qysh atëherë edhe ata vazhdojnë t'u mësojnë bijve dhe bijave të popullit bazat e shkencës. Midis nesh ndodhet gjithashtu drejtori i nderuar i shkollës suaj, Gjergj Canco, një nga mësuesit e shquar të vendit tonë, njeri me eksperiencë të madhe në fushën e arsimit, që punon me zjarr prej të riu, të cilit ju, të dashur nxënës, si dhe populli e Partia i detyrohemi për punën që ka bërë dhe vazhdon të bëjë për drejtimin me zotësi dhe me zgjuarsiri të këtij institucioni të rëndësishëm.

Në këtë ditë solemne për shkollën tuaj, më lejoni në emër të Komitetit Qendror të Partisë t'ju falënderoj nga zemra juve, nxënësve dhe mësuesve të kësaj shkolle, për punën e madhe që keni bërë, të cilën do ta kujtojë me mirënjohje të thellë brez pas brezi rinia jonë e lavdishme, që do të ketë rastin të kalojë në bankat e kësaj shkolle ku po mësoni ju, për t'u bërë edhe ata kuadro të vlefshëm të së ardhshmes të atdheut tonë socialist, të Shqipërisë sonë të bukur.

Të gjithë ne mburremi me politeknikumin «7 Nëntori». Këtë e them me plot gojën dhe jo vetëm sa për t'ju bërë qejfin. Pa politeknikumin «7 Nëntori», mund të themi se zhvillimi i industrisë, i minierave dhe i shkencës në përgjithësi në vendin tonë do të çalonte. Por Partia me programin e saj të drejtë të Luftës Nacional-çlirimtare arriti të realizojë çlirimin e atdheut dhe të popullit. Pas Çlirimit, me programin e saj për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta dhe për ndërti-

min e bazave të socializmit, i siguroi popullit tonë çdo vit një jetë më të mirë e më të begatshme. Për këtë qëllim, fill pas Çlirimit Partia mendoi se në vendin tonë duhej të zhvillohej me hapa të shpejta, në radhë të parë, arsimi, të ngriheshin nga të katër anët shkolla fillore, 7-vjeçare e të mesme, ndër të cilat edhe ky politeknikum, se e tillë ishte perspektiva e zhvillimit të Shqipërisë së re. Vendit i duhej një numër i madh kuadrosh të lartë dhe divizione të tëra kuadrosh të mesëm për realizimin e programit madhështor të Partisë. Prandaj që në fillim Partia mendoi se një shkollë e tillë si politeknikumi duhej të bëhej dhe u bë një çerdhe shumë e rëndësishme e kuadrove tanë të mesëm teknikë.

Kur njihesh me historikun e politeknikut tuaj, konstaton se ai është rritur e është zhvilluar, duke arritur shkallën që e shikoni sot. Sigurisht, shkollën tuaj e pret një e ardhshme akoma më e shkëlqyer, kështu, nxënësit që do ta ndjekin atë në vitet që vijnë, do të dalin patjetër më të zotë, jo se do të jenë më të zgjuar se ju, por se në dispozicion të tyre do të vihen mjete dhe laboratorë më të përparuar nga ata që janë tani.

Natyrisht, zhvillimi i mëtejshëm i shkollës suaj do të bëhet krahas me përparimin e gjithë vendit tonë. Shqipëria deri sot ka bërë hapa të mëdha në të gjitha fushat, në industri, miniera, bujqësi, edhe në fushën e shkencave. Kjo u detyrohet, në radhë të parë, heroizmit të klasës sonë punëtore, që zbaton me vendosmëri vijën e drejtë të Partisë, si edhe të gjithë atyre që, pasi kanë mbaruar shkollat, kanë shkuar në prodhim, qoftë si kuadro të mesëm teknikë, ashtu edhe si kuadro të lartë pas mbarimit të universitetit.



Gjatë viteve pas Çlirimit një përparim i madh është arritur në vendin tonë në fushën e industrisë dhe të minierave. Planet në këta sektorë i kemi realizuar me sukses, popullit i dhamë ato që i kishim premtuar, bile edhe më shumë. Por ajo që është më interesante dhe inkurajuese dhe që hap perspektiva të mëdha për zhvillimin e atdheut është se klasa punëtore, teknikët dhe inxhinierët tanë, si dhe kuadrot e mesëm që kanë mbaruar shkollat profesionale dhe kanë shkuar në prodhim, kanë treguar kudo, në çdo sektor, një iniciativë të shkëlqyer në drejtim të shpikjeve dhe të racionalizimeve.

Në vendin tonë socialist shpikjet janë kurdoherë në rendin e ditës. Ne duhet të kuptojmë se ato nuk bëhen vetëm nga një grup shtetesh ose shkencëtarësh. Shpikje mund të bëjë një sovjetik, një francez, një anglez apo një amerikan, por mund të bëjë edhe një shqiptar. Natyrisht shpikjet nuk mund të bëhen nga çdo njeri, ato bëhen nga njerëz me kokë, me tru, si i thonë fjalës. Por duhet kuptuar se shkenca dhe teknika te ne nuk janë pronë vetëm e disave, por janë pronë e masës. Shkenca është një fenomen shoqëror, aspak e izoluar nga qytetërimi njerëzor, pra ajo i ka rrënjët e veta thellësisht në terrenin shoqëror, ekonomik dhe ideologjik, në etapa të ndryshme historike, që janë të lidhura me njëra-tjetrën. Gjithashtu në zhvillimin e shkencës botërore nuk kanë kontribuar vetëm një kategori njerëzish të një kombësie ose një kategori dijetarësh nga një shkollë e caktuar, por me qindra e mijëra njerëz të popujve të ndryshëm, të kategorive të ndryshme dhe të epokave të ndryshme.

Me epokën tonë të ndërtimit të socializmit është e

lidhur shkenca më përparimtare e kohës, që edhe ajo është produkt i rendit socialist, ashtu siç ka qenë në të kaluarën çdo shkencë, produkt i rendit shoqëror në epokat kur ajo është zhvilluar. Për shembull, dituria e filozofëve grekë në kohët e vjetra që nga Talesi e të tjerë nuk mund të kuptohet e shkëputur nga ambienti laik, ashtu si nuk mund të shkëputet më vonë metoda karteziane<sup>1</sup> nga rregullat e shkollës që quhet karteziane. As shekulli i Amperit nuk mund të shkëputet nga romantizmi, ashtu sikurse nuk mund të shkëputet sot astronautika nga rendi aktual i ndërtimit të socializmit.

Zhvillimi i mëtejshëm dhe përparimi i shkencës u përket të gjitha vendeve me radhë. Por nuk duhet të harrojmë aspak se shkenca jonë e përparuar bazohet në shpikjet dhe në mendjen e lartë e të ndritur të shumë dijetarëve të kombësive të ndryshme, që gjatë periudhave historike kanë hedhur bazat e saj dhe e kanë zhvilluar atë më tej. Në kohën e sotme, shkencëtarët e vendeve socialiste po shkojnë edhe më përpara në zhvillimin e mëtejshëm të shkencës.

Kurdoherë duhet pasur parasysh se jo të gjithë njerëzit e shkencës kanë kryer universitete ose akademi. Këtë e vërteton historia e kohës së kaluar, këtë e vërteton edhe epoka e tanishme. Në zhvillimin e shkencës kanë ndihmuar e kanë kontribuar me shpikjet e tyre të mrekullueshme edhe mijëra e mijëra njerëz të thjeshtë,

---

1 Shkolla apo metoda karteziane — janë quajtur sipas emrit të filozofit Kartezi (lat. Cartesura), mbi bazën e të cilave qëndronte teoria filozofike e Dekartit, filozof dhe shkencëtar francez i shekullit XVII.

fare të panjohur. Por sa i kanë përbuzur në të kaluarën njerëzit e shquar të shkencës, të cilët mbylleshin në laboratorët e tyre e punonin me durim dhe besim të madh duke bërë vazhdimisht eksperimente? Kur Radhërfordi<sup>1</sup> bënte eksperimente në laborator, shumë njerëz që hiqeshin të ditur e tallnin, kurse eksperimentet e tij përmbanin bërthamën e zbulimit të madh të atomit. Kush nuk i ka tallur Erstedin<sup>2</sup>, apo më vonë Voltin<sup>3</sup> për shpikjet e tyre të mëdha? Në zbulimet e Voltit, të Erstedit, e të tjerë, bazohet shkenca mbi elektricitetin që ju mësoni këtu, e cila qysh atëherë e deri sot është zhvilluar edhe më tej.

Por historia vërteton se në zhvillimin e shkencës kanë ndihmuar e kanë kontribuar edhe njerëz të thjeshtë, të cilët në saje të eksperiencës, durimit dhe mendjes së ndritur kanë bërë zbulime të mëdha shkencore. Sa njerëz janë tallur me Zenob Gramin, me këtë punëtor të thjeshtë belg që punonte për të përfunduar shpikjen e tij? Kur ai shpiku unazën [dinamon elektrike me rrymë të vazhduar], të gjithë thanë se ajo do të hidhej tej, sepse nuk kishte ç' duhej elektriku, pasi makina e avullit ishte e mjaftueshme. Por shpikjen e tij të madhe e vazhduan shkencëtarë të tjerë, të cilët jo vetëm e çuan përpara veprën e tij, por bënë të mundshëm akumulimin e energjisë elektrike në transformator. Kështu shkenca në të kaluarën ka çarë përpara nëpërmjet vështirësish dhe pengesash të panumërta, ndërsa sot, në vendet socialiste, ata që bëjnë përpjekje për shpikje,

1 Ernest Radhërford — fizikan anglez (1871-1937).

2 Hans Kristian Ersted — fizikan danez (1777-1851).

3 Aleksandër Volta — fizikan italian (1745-1827).

gjejnë përkrahjen e plotë morale dhe materiale nga ana e shtetit dhe e gjithë shoqërisë. Prandaj ajo ecën me hapa të mëdha përpara.

Edhe në vendin tonë, në regjimin tonë socialist, ju, djem dhe vajza, që ndiqni shkollat dhe pajiseni me shkencë dhe dituri, teorike dhe praktike, kur të mbaroni mësimet, e keni për detyrë jo vetëm të vini në lëvizje makinat që do t'ju besojë populli, shteti dhe Partia, por edhe t'i perfeksiononi ato më tej, të shpikni të tjera më të mira që ta lehtësojnë punën dhe të ndihmojnë për të shtuar prodhimin, për ta bërë atë më të lirë.

Gjatë këtij viti janë bërë nga klasa punëtore, teknikët dhe inxhinierët tanë 50-60 propozime, plotësisht të realizueshme, për ndërtim fabrikash me mbeturina materialesh dhe lëndë të parë të vendit, që do t'i japin një impuls të mëtejshëm industrisë sonë. Kjo është jashtëzakonisht e vlefshme për ne. Këto rezultate janë arritur nga përpjekjet e djemve dhe të vajzave të popullit tonë, të klasës sonë punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencës sonë, të cilët, porsa kanë lënë bankat e shkollës dhe me atë pak praktikë që kanë në punë, kanë mundur t'i japin ekonomisë popullore më shumë mjete prodhimi, më shumë artikuj të nevojës së përditshme. Kjo ka një rëndësi shumë të madhe dhe politeknikumi «7 Nëntori», kuadrot e të cilit shpërndahen në të gjitha anët e vendit, luan një rol mjaft të madh në këtë drejtim.

Prandaj Partia jonë i ka kushtuar një kujdes të madh këtij institucioni. Sido që shumë nevoja të shkollës suaj tash janë plotësuar, përsëri ka nevoja të reja,

të cilat me siguri do të plotësohen në të ardhshmen. Partia dhe Qeveria kanë besim të madh jo vetëm në vullnetin e mirë të nxënësve, por edhe në kuadrot mësuës të vjetër dhe të rinj të shkollës suaj, me të cilët ju, nxënës dhe nxënëse, duhet të lidheni ngushtë dhe t'i kuptoni drejt përpjekjet dhe qëllimet e tyre fisnike. Gjatë punës dhe praktikës mësimore ju duhet t'i mbani sytë hapur, të dëgjoni kurdoherë me shumë kujdes dhe gatishmëri mësimet që ata ju japin, në mënyrë që të përpini gjithë diturinë e tyre.

Ju jeni në dijeni se në vendin tonë po bëhen përparime të mëdha. Industria jonë tani prodhon më shumë dhe më mirë, bujqësia ka hyrë në një rrugë të mirë zhvillimi, arsimit dhe kultura janë përhapur në shkallë të gjerë në të gjitha anët e vendit tonë. Gjatë këtij pesëvjeçari do të shtohen edhe më shumë të mirat materiale për popullin. Vetëm të keni mirë parasysh se asgjë nuk bëhet vetvetiu, por vetëm me punë e sakrificë, me lodhje e djersë. S'ka diskutim se gjatë realizimit të pesëvjeçarit të tretë ne do të kemi edhe vështirësi. Ne dimë se socializmi nuk ndërtohet pa luftë dhe pa përpjekje kundër vështirësive, qofshin këto të brendshme apo të jashtme, jo vetëm për Shqipërinë e vogël, po edhe për çdo vend tjetër socialist, si edhe për gjithë ata popuj që akoma pushtetin nuk e kanë në dorë, por që aspirojnë dhe luftojnë për këtë qëllim të madh. Prandaj i madh e i vogël te ne duhet të mobilizohen me të gjitha forcat për të kryer detyrat që na janë ngarkuar, bile për t'i tejkaluar ato.

Për të pasur sukses në punë, detyrat të mos kryhen në mënyrë automatike, shabllone, por me iniciativë

dhe ndërgjegje, se vetëm kështu gjithçka do të realizohet dhe vendi do të përparojë më shpejt. Bashkë me këto kudo duhet të vihet edhe një rregull më i mirë dhe një disiplinë akoma më e fortë. Rregulli dhe disiplina nuk kanë munguar te klasa jonë punëtore, te fshatarësia dhe inteligenca jonë, bile në mjaft qendra pune ato ekzistojnë në një shkallë për t'u lavdëruar, që mund të na i kenë zili edhe vende të tjera, por ne duhet t'i rritim më shumë kërkesat tona. Megjithëkëtë gjendja në vendin tonë është shumë e mirë dhe kjo, në radhë të parë, si rezultat i ndershmërisë së njerëzve tanë, i ndërgjegjes dhe i patriotizmit të tyre të lartë, i vuajtjeve që ata kanë pasur në të kaluarën, si dhe i dëshirës së madhe për të mësuar dhe për të ndërtuar një jetë më të mirë. Populli shqiptar, i zgjuar dhe patriot, nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, e ka të qartë perspektivën dhe punon me të gjitha forcat për t'ia arritur sa më parë objektivit. Ai e kupton vijën e drejtë të Partisë, e kupton se me rregull e disiplinë të fortë dhe me një organizim të shëndoshë në punë mund dhe do t'i kapërcejë të gjitha vështirësitë për të arritur objektivat që i ka vënë përpara Partia.

Ju, shokë të rinj, kur të mbaroni shkollën, atje ku do të caktoheni për të punuar, të bëheni shembull i shkëlqyer në të gjitha drejtimet, të përpiqeni të merrni ndihmën dhe të përfitonit sa më shumë nga eksperiencia e shokëve tuaj më të vjetër dhe me kulturë më të lartë ose me praktikë të madhe, në mënyrë që pas një ose dy vjetësh të bëheni të aftë që të punoni me rendiment të lartë. Gjithashtu të përpiqeni edhe të mësoni më tej, të nxitni edhe te ata që nuk kanë mbaruar

shkollë dëshirën për mësim dhe për një ngritje të mëtejshme të nivelit shkencor, teknik dhe kulturor. Tani, këtu në shkollë, të jeni shembull i një kolektivi të organizuar që mëson dhe punon mirë, të fitoni cilësi të tilla të përparuara që t'i çoni pastaj në fabrikat dhe në kantieret ku do të punoni. Vendi ynë ka nevojë të madhe për një gjë të tillë.

Situata në vendin tonë është e mirë. Kudo ka një entuziazëm të madh me baza të forta. Në asnjë vend populli nuk mund të udhëhiqet për një kohë të gjatë me dhunë ose me disa parulla boshe, ai mund të gënjehet për një kohë të shkurtër, por pastaj fillon të lëvizë. Kur populli sheh se ajo që i thuhet është gënjeshtrë, se premtimet që i jepen nuk mbahen dhe gjendja e tij ekonomike nuk përmirësohet, atëherë fillon të mos besojë. Por në vendin tonë ndodh e kundërta. Populli shqiptar është i gëzuar dhe i lumtur, pavarësisht se ka akoma ndonjë mungesë, ai ka besim në të ardhshmen, se shikon që Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e tij ecin në rrugë të drejtë dhe e udhëheqin atë drejt lumturisë.

Për çdo shqiptar dhe shqiptare çështja e lirisë, e pavarësisë dhe e sovranitetit të atdheut është kryesorja. Për këto kanë luftuar gjyshërit dhe stërgjyshërit në të kaluarën, shoqet dhe shokët tanë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Të gjithë te ne, të mëdhenj ose të vegjël, kanë në zemër lirinë dhe pavarësinë, e duan pushtetin dhe Partinë që u mbrojnë atyre gjërat më të shtrenjta. Këtë e kanë kuptuar jo vetëm njerëzit e ndershëm brenda vendit tonë, por edhe mjaft nga ata që tash ndodhen në emigracion, të cilët gjer tani e kanë luftuar

popullin, Partinë dhe Qeverinë tonë me çdo mjet, qoftë duke ardhur si diversantë ose me mjete propagandistike që u kanë vënë në dorë imperialistët dhe shërbëtorët e tyre. Ata Partinë dhe Qeverinë tonë i kanë quajtur, si të thuash, qole, të shitur, që fare lehtë mund të sakrifikonin lirinë e popullit dhe të atdheut dhe ndërtimin e socializmit për hir të njërit ose të tjetrit. Por jeta dhe lufta e Partisë sonë bënë që edhe këta të kuptojnë se komunistët nuk janë të tillë që mund të shiten. Tani ka edhe armiq, të cilët kanë arritur të thonë se komunistëve duhet t'u heqim kapelen, .se, sado që i kemi armiq, ata e kanë mbrojtur me vendosmëri atdheun dhe lirinë e popullit, sepse në këto situata, po të mos ishte në fuqi Qeveria Shqiptare e udhëhequr prej komunistëve, Shqipëria do të ishte e përcarë dhe e copëtuar.

Sa rreziqe të mëdha, sa vështirësi të shumta kanë kaluar populli dhe Partia gjatë këtyre 20 vjetëve, por të gjitha këto janë kapërcyer me sukses. Sa komplete dhe diversione janë bërë pas Çlirimit kundër Republikës sonë Popullore, por të gjitha janë shpartalluar. Partia i ka mbrojtur me vendosmëri këto çështje kaq të mëdha. Por liria, pavarësia dhe sovraniteti i atdheut nuk mund të mbrohen pa ngritur dhe pa forcuar shpirtin patriotik dhe frymën revolucionare të popullit, pa ngritur, në radhë të parë, një ekonomi të fortë, pa krijuar për popullin, çdo vit e çdo muaj, një jetë më të mirë dhe më të begatshme. Në rast se ëndrrat, dëshirat dhe qëllimet e popullit nuk do të realizoheshin gradualisht, nuk do të ekzistonte sot një unitet kaq i shëndoshë midis popullit dhe Partisë.



Gjatë kësaj periudhe ndryshime të mëdha janë bërë në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të popullit tonë. Këto ndryshime dhe përparime asnjëri nuk mund t'i mohojë, sepse gjithkush në vendin tonë i prek ato me dorë, i sheh me sy, i gëzon vetë. Por jashtë vendit ka njerëz që i mohojnë këto realizime madhështore, disa nga shpirtligësia e tyre, disa sepse nuk i kanë parë, prandaj edhe nuk i besojnë. Ka njerëz jashtë që mendojnë se gjithë puna jonë konsiston vetëm në një propagandë të zbrazët. Të tillë mentalitet kanë ata që nuk na e duan të mirën ose që nuk e njohin realitetin shqiptar. Këto janë arsyet që këta njerëz nuk u besojnë përparimeve tona. Natyrisht kjo s'na prish asnjë punë se pavarësisht nga kjo, ne çdo vit realizojmë planet, ecim përpara dhe populli gëzon të mira më shumë. Ku ka pasur Shqipëria kaq shumë fabrika, hidrocentrale, uzina, hekurudha, kombinatë? Ku ka parë populli ynë punime të tilla kolosale për tharjen e kënetave dhe ujitjen e fushave tona, rreth 50 për qind të të cilave gjer në fund të këtij pesëvjeçari do të arrijmë t'i ujitim, që të punojnë mijëra traktorë dhe të tjerë që do të sjellim? Ku kishte parë populli ynë në të kaluarën një rrjet kaq të dendur shkollash fillore, 7-vjeçare e të mesme, gjithë këto institute të larta dhe universitetin? Këto nuk janë për propagandë, por realitet i pamohueshëm i vendit tonë.

Viti 1961 ka qenë një vit i vështirë, por njëkohësisht një vit kur populli ka qenë i lidhur jashtëzakonisht ngushtë me Partinë e pushtetin e tij popullor dhe është mobilizuar si kurrë ndonjëherë për realizimin e të gjitha detyrave, në çdo sektor. Një gjendje e tillë

flet qartë për besimin e madh që ka populli te Partia dhe shteti ynë, që kanë mbrojtur e mbrojnë me vendosmëri lirinë dhe pavarësinë e atdheut, jetën e popullit tonë dhe marksizëm-leninizmin, nga çdo kërcënim, kurdo dhe ngado që i ka ardhur. Këto kërcënime kanë genë të mëdha dhe të rrezikshme edhe më përpara, por tash së fundi ato janë bërë akoma më të mëdha për shkak se armiqtë tanë u shtuan edhe më tepër. Në këto situata të vështira populli, si kurdoherë, Partinë nuk e la vetëm, po u lidh akoma më ngushtë me të dhe u tregoi armiqve, që donin t'i bënë varrin atdheut, Partisë dhe udhëheqjes së saj, se ne vërtet jemi një vend i vogël, por të bashkuar si një trup i vetëm dhe të pampostur, sepse Partia jonë ndjek një rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Populli e pa edhe një herë se, po të mos ishte udhëheqja e drejtë e Partisë, atdheu ynë do të copëtohej nga armiqtë. Lidhjet e ngushta të Partisë me popullin u treguan armiqve tanë se ne nuk jemi dogmatikë si thonë revizionistët, të cilët bëjnë përpjekje për të na përçarë. Partia jonë është e lidhur aq ngushtë me popullin saqë rreziqeve të mëdha ajo u bëri dhe kësh-tu do t'u bëjë ballë me sukses edhe në të ardhshmen.

Grupi i Titos vite me radhë lufton me tërbim kundër atdheut dhe Partisë sonë. Ky grup është një klikë renegatësh, revizionistësh, nacionalistësh dhe shovinistësh të tërbuar që e ka halë në sy Shqipërinë, por asgjë nuk i ka bërë dhe nuk i bën dot asaj. Përkundrazi, qëndrimet e Partisë dhe të popullit tonë ndaj kësaj kli-ke janë një kontribut i madh për socializmin dhe komunizmin. Partia jonë, qysh në fillim së bashku e në unitet të plotë me Partinë Komuniste të Bashkimit So-

vjetik të udhëhequr nga Stalini i pavdekshëm, nga ky luftëtar i papërkulur dhe marksist i shquar që shpëtoi komunizmin nga rreziku i grupit titist, së bashku edhe me të gjitha partitë e tjera komuniste e punëtoare, ka luftuar me vendosmëri për demaskimin e këtij grupi tradhtarësh dhe kështu do të vazhdojë gjer në shkatërrimin e tij përfundimtar.

Rreziqe të reja iu kanosën marksizëm-leninizmit nga ana e grupit revizionist të Nikita Hrushovit. Ky grup përbën një rrezik akoma më të madh se ai i revizionistëve të Beogradit, sepse për fat të keq ka lindur në krye të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të shtetit sovjetik dhe për veprimtarinë e tij tradhtarë shfrytëzon autoritetin e vendit të parë socialist në botë. Për këto arsye ky grup revizionistësh është akoma më i rrezikshëm nga ai i Titos. Por marksizmi është shumë më i fortë nga këto rryma armiçësore, që janë të destinuara të falimentojnë dhe të shkatërrohen.

Shokë, revizionistët po i bëjnë Shqipërisë një luftë të tmerrshme. Në të kaluarën nuk mund të imagjinohej që një vend i vogël si Shqipëria t'u rezistonte me sukses presioneve dhe goditjeve kaq të forta dhe nga të katër anët, siç i bëhen tani vendit tonë dhe në këto kushte të rënda rrethimi. Të gjithë po e sulmojnë Shqipërinë, por ajo reziston dhe përparon, ajo nuk mund të mposhtet, sepse jeton në shekullin e triumfit të marksizëm-leninizmit. Ne jetojmë, luftojmë dhe fitojmë kurdoherë jo vetëm për faktin se situata jonë e brendshme është e fortë, por edhe për arsye se në botë ka vende socialiste, ka parti komuniste dhe punëtoare, njerëz e popuj përparimtarë që janë vënë në mbrojtje të Repu-

blikës Popullore të Shqipërisë, janë me Partinë e Punës të Shqipërisë dhe jo me klikat revizioniste që kanë ardhur në fuqi në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavi, në disa vende të demokracisë popullore të Evropës dhe në disa parti komuniste e punëtoresh të vendeve kapitaliste. Këto janë arsyt që Shqipëria qëndron në këmbë, përparon dhe askush nuk guxon ta prekë.

Megjithatë nuk ka ditë që propaganda e Hrushovit të mos drejtohet kundër Shqipërisë. Përse ai na lufton ne? Ç'rrezik paraqit Shqipëria për të? Po, Shqipëria është një rrezik i madh për Nikita Hrushovin e grupin e tij, sepse ajo është në pararojë të një lufte të vendosur edhe kundër kësaj rryme të re revizioniste dhe e demaskon atë në sytë e gjithë komunizmit ndërkombëtar. Prandaj Hrushovi dhe organet e tij të propagandës përpiqen t'i mbushin mendjen opinionit publik botëror se shqiptarët janë «antimarksistë» dhe «nacionalistë». Mos vallë Shqipëria «nacionaliste» ka pretenduar të aneksojë apo të gllabërojë ndonjë vend tjetër? Jo, asnjëherë! Njerëzit që mendojnë, vijnë në konkluzionin e drejtë se RP e Shqipërisë dhe Partia e Punës nuk janë bërë kurrë rrezik për të aneksuar ndonjë vend, por për grupin e Hrushovit po, përbëjnë vërtet një rrezik, sepse nuk lejojnë që ai të shkelë parimet e marksizëm-leninizmit. Njerëzit e ndershëm e kuptojnë shumë mirë se Partia jonë nuk është as dogmatike, as nacionaliste, por marksiste-leniniste. Prandaj, rruga që ndjek ajo, admirohet dhe përkrahet nga gjithë marksistë-leninistët e vërtetë, në radhë të parë, si edhe nga gjithë njerëzit e ndershëm në botë.

Ju keni dëgjuar se një numër i madh partish, që

morën pjesë në Kongresin e 22-të të PK të BS, nuk folën kundër nesh, pasi e dinin si qëndronte çështja, kishin marrë vesh për veprimtarinë antimarksiste të Hrushovit kundër Partisë dhe vendit tonë, dinin se veprime të tilla, në një shkallë më të madhe ose më të vogël, Hrushovi i ka bërë edhe kundër vendeve të tjera. Kush ka qenë më vigjilent i ka kuptuar aktet antimarksiste të Hrushovit, kush nuk i ka kuptuar akoma do t'i kuptojë me siguri nesër, dhe kush është i trashë dhe nuk do t'i kuptojë, aq më keq për të.

Nikita Hrushovi me veprimet e tij antimarksiste shkaktoi përçarjen, ai ndau më dysh kampin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe shkeli kësh-tu Deklaratën e Moskës. Por pas Kongresit të 22-të të PK të BS, duke mos u kënaqur me qëndrimin e shumë partive që nuk e sulmuan Partinë tonë, ai filloi t'u bëjë presion për t'i detyruar që të vihen publikisht kundër nesh. Kështu ai ka arritur që nga disa parti të tërheqë deklarata dhe t'i botojë menjëherë në shtypin sovjetik. Nikita Hrushovi mendon se kjo i shërben atij. Përkundrazi një veprimtari e tillë e demaskon edhe më shumë dhe sjell si pasojë që jo vetëm shumë parti, që tani nuk janë me të, të mos i afrohen, por edhe ato udhëheqje partish që aktualisht janë të lidhura ngushtë me të, kanë filluar ta lënë në mes të rrugës.

Nikita Hrushovi preu marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, akt ky që vetëm armiqtë mund ta bënin. Bile edhe ata, para se të marrin një masë të tillë, do ta mendojnë njëzet herë, pastaj të presin një herë. Me këtë veprim Nikita Hrushovi kërkon të na frikësojë ne, synon të frikësojë edhe të tjerët, miqtë e tij të tani-

shëm, se mos e lënë në baltë. Por në fakt Hrushovi trembet për vete. Ajo që e tremb më shumë atë është se një numër partish komuniste dhe punëtorë e kanë kuptuar se Nikita Hrushovi, qëkur sulmoi publikisht Partinë tonë, është futur në një rrugë qorre, nga e cila e ka të vështirë të dalë.

Nikita Hrushovi dhe grupi i tij na akuzojnë se gjoja jemi kundër paqes. Ky është një absurditet i madh që nuk e beson njeri. Si është e mundur që ne, një popull i vogël, të jemi kundër paqes? Prandaj kjo akuzë s'ka zënë dhe s'do të zërë kurrë vend.

Ata na akuzojnë ne se jemi kundër bashkekzistencës paqësore. Edhe ky është një absurditet tjetër i madh. Por bashkekzistencën paqësore ne nuk e kuptojmë ashtu siç e kupton Hrushovi dhe ata që e pasojnë, si vijën e vetme të përgjithshme të politikës së jashtme të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste. Ne mendojmë se bashkekzistenca paqësore duhet të jetë vetëm një nga aspektet e politikës së jashtme të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve socialiste, kurse dy aspektet e tjera janë: bashkëpunimi dhe ndihma vëllazërore midis vendeve socialiste me njëri-tjetrin dhe ndihma popujve të shtypur e të varur për të fituar lirinë dhe pavarësinë e tyre, kundër kolonialistëve të vjetër dhe të rinj, ndihma proletariatit të vendeve kapitaliste për fitoren e revolucionit.

*Më poshtë, shoku Enver Hoxha, pasi foli për tezat revizioniste të Hrushovit mbi çarmatimin, për pikëpamjet e tij pacifiste e oportuniste, për lëshimet e paprincipa të revizionistëve sovjetikë ndaj imperializmit, për çështjen e traktatit të paqes me Gjermaninë, për qën-*

*drimet revolucionare marksiste-leniniste të Partisë sonë, për gjendjen në lëvizjen komuniste e punëtoare ndërkombëtare, tha:*

Këto janë çështjet që na ndajnë ne nga Nikita Hrushovi dhe pasuesit e tij. Këto janë çështje shumë të rëndësishme parimore, prandaj jemi në luftë të papajtueshme me ta. Ne nuk i bëjmë asnjë lëshim imperiaлизmit, sepse e dimë se çdo lëshim është një fitore për të. Por Nikita Hrushovi është mësuar të bëjë lëshime dhe jemi të bindur se edhe në të ardhshmen, duke ndjekur rrugën antimarksiste, ai do të bëjë lëshime të tjera. Lufta e vendosur që i bëjmë ne imperializmit dhe revizionizmit, do të ndihmojë që të demaskohet veprimtaria e Nikita Hrushovit dhe e grupit të tij. Lëshimet që ai i bën imperializmit në lëmin ndërkombëtar, do të kenë vazhdimisht pasoja të rënda, jo vetëm për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe kampin socialist, por edhe për ndërtimin e komunizmit brenda në Bashkimin Sovjetik.

Sot Bashkimi Sovjetik, duke pasur në krye një udhëheqje antimarksiste, pengohet në rrugën e tij për ndërtimin e komunizmit dhe kjo është një fatkeqësi për të e për gjithë lëvizjen komuniste punëtoare ndërkombëtare. Prandaj kjo e keqe nuk duhet fshehur, ashtu sikurse nuk mund të fshihet tradhtia që i bënë marksizëm-leninizmit Titoja me shokët e tij. Ju lexuat artikullin<sup>1</sup> e botuar sot në gazetën «Zëri i popullit» se në ç'gjendje ka arritur industria dhe e gjithë ekonomia jugosllave, e cila është vënë nën kontrollin e kapitalit ame-

---

<sup>1</sup> Industria jugosllave përballë vështirësish serioze.

rikan, e kapitaleve të monopoleve të tjera kapitaliste, të trusteve ndërkombëtare. Dhe megjithatë Hrushovi vazhdon ta mbrojë grupin revizionist të Titos. Hrushovi është nacionalist dhe pansllavist, tendenca këto që nuk pajtohen me marksizëm-leninizmin. Porsa preu marrëdhëniet diplomatike me ne, Hrushovi forcoi edhe më tepër marrëdhëniet me Titon, i cili po futet dalngadalë në të tëra poret e jetës së vendeve socialiste të Evropës, me qëllim që të minojë në to ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Nga të gjitha këto kuptohet se Hrushovi është puçur politikisht dhe ideologjikisht me Titon. Ai është gati ta futë Jugosllavinë, e udhëhequr nga grupi revizionist i Beogradit, edhe në kampin socialist, edhe në Traktatin e Varshavës, edhe në Këshillin e Ndhmës Ekonomike Reciproke, veçse në nuk dashtë Titoja. Prandaj do të ishte një krim i madh, po të mos luftohej e gjithë kjo veprimtari e madhe armiqësore kundër marksizëm-leninizmit dhe socializmit.

Këto tregojnë se rruga jonë nuk është e lehtë, se puna jonë politike, ideologjike dhe ndërtimi i socializmit në Shqipëri nuk do të bëhen pa vështirësi. Por ne ato do t'i kapërcejmë me sukses, dhe në luftën tonë kundër armiqve do të fitojmë me siguri, se jemi në rrugë të drejtë, se na udhëheq Partia jonë marksiste-leniniste, e vuajtur, por e regjur në luftëra, e cila gjatë këtyre 20 vjetëve ka fituar një eksperiencë shumë të madhe revolucionare, jo vetëm nga librat, por edhe nga jeta dhe përpjekjet e saj. Pse Partia jonë ndjek një rrugë të drejtë marksiste-leniniste, prandaj në radhët e saj ka një unitet të çeliktë mendimi dhe veprimi.

Uniteti i Partisë ka kurdoherë rëndësi jashtëza-



konisht të madhe, veçanërisht në situatat e vështira që kalojmë. Ky unitet i çeliktë i masës së Partisë me udhëheqjen e saj vjen se njerëzit e udhëheqjes mendojnë dhe veprojnë në rrugën marksiste-leniniste. Të gjithë në vendin tonë e dinë se ata që janë në udhëheqje të Partisë kanë ardhur në saje të luftës, të punës dhe të qëndrimeve të tyre të vazhdueshme dhe konsekuente në shërbim të popullit dhe të atdheut. Po edhe në qoftë se ndokush në udhëheqje gabon, ai çohet menjëherë në vendin që meriton. Të tilla janë te ne Partia dhe udhëheqja e saj, prandaj ekziston ky unitet i çeliktë. Uniteti i kalbur në baza familjare nuk mund të ekzistojë as në Partinë tonë dhe në asnjë parti tjetër marksiste-leniniste. Propaganda e revizionistëve ka për qëllim të përçajë Partinë tonë nga udhëheqja, por Parti-udhëheqje dhe Parti-popull te ne janë një dhe të pandarë. Revizionistët përpiqen të na futin spica, por te ne këto nuk do të zënë vend. Prandaj ta ruajmë dhe ta forcojmë me luftë dhe me punë unitetin tonë të pathyeshëm. Çdo njeri, në mënyrë komuniste, bolshevike, kur sheh se bëhet ndonjë gabim, të flasë pa druajtje, të kritikojë cilindo që gabon. Ndaj atij që bën gabime, që shkel vijën e Partisë, qoftë i madh apo i vogël, të merren menjëherë masa. Çdo njeri duhet ta kuptojë drejt rëndësinë që ka kritika. Ajo është ilaçi më i mirë për njerëzit, qofshin ata komunistë ose pa parti. Prandaj në qoftë se ne nuk e mprehim dhe nuk e zhvillojmë kritikën, atëherë kemi dobësuar Partinë dhe pushtetin tonë socialist. Këtë ta kemi kurdoherë parasysh.

Si këtë vit ashtu edhe në vitet që do të vijnë popullit nuk do t'i mungojë asgjë. Janë marrë dhe do të

merren të gjitha masat që industria dhe bujqësia jonë të punojnë pa ndërprerje dhe me ritme kurdoherë në ngritje. Vetëm çdo gjë varet nga ne, nga punonjësit tanë, klasa punëtore, fshatarësia dhe inteligjenca jonë që punojnë në fabrika dhe uzina, në kooperativa dhe ferma, në shkolla dhe institucione të ndryshme. Ne kemi bindjen e plotë se planin e tretë pesëvjeçar do ta realizojmë me sukses dhe popullit do t'i japim çdo vit e më shumë të mira materiale dhe gradualisht më të lira.

Me investimet që do të bëjmë gjatë viteve të pesëvjeçarit të tretë, jo vetëm do të zgjerohet më tej industria me vepra të reja me rëndësi të madhe ekonomike, por edhe bujqësia do të marrë një hov më të madh, sidomos pas përfundimit të ndërtimit të uzinave të plehrave kimike. Ne jemi të bindur se edhe sikur kushtet atmosferike të jenë të disfavorshme, në vitet e ardhshme nuk do të jemi më keq nga sa kemi qenë këtë vit, megjithëse këtë vit, në krahasim me çdo vit tjetër pas Çlirimit, nuk kemi qenë aspak keq, përkundrazi shumë më mirë. Prandaj, në vitet që vijnë, do të vazhdojmë të kemi kushte materiale, gjithnjë më të mira, sepse jeta provoi se qysh këtë vit kuadrot tanë, sado të rinj, duke kapërcyer çdo vështirësi, drejtuan me sukses industrinë, realizuan dhe tejkaluan planet. Gjithashtu edhe bujqësia do të ecë kurdoherë përpara, ajo do të fuqizohet me më shumë traktorë dhe vegla të tjera bujqësore. Kështu çdo vit në të ardhshmen do të kemi përparime më të mëdha.

Në masat e popullit tonë ndihet kudo kënaqësi, sepse dyqanet janë plot me prodhime ushqimore dhe industriale. Mirë, mund të thotë ndonjë, ishte Viti i Ri

dhe vërtet ai kaloi shumë i gëzuar, sepse tregu me këtë rast ishte plot me mallra. Por ne i themi popullit se tregu do të vazhdojë të jetë gjithnjë plot, sepse shteti ka siguruar rezervat e nevojshme, duke filluar që nga buka e gjer te frutat. Në treg nuk do të mungojnë as mallrat ushqimore, produktet blegtorale, perimet e të tjera, as ato industriale. Një situatë e tillë si te ne, nuk ekziston në mjaft vende të demokracisë popullore, bile as në ato ku industria dhe bujqësia janë më të përparuara se në vendin tonë. Kjo ndodh se masat punonjëse janë në këmbë dhe se Qeveria jonë trajton me nikoqirllëk ekonominë popullore.

Edhe në bujqësi, megjithëse na akuzojnë se jemi «dogmatikë», nuk kemi bërë gabime, kurse udhëheqësit bullgarë, që e heqin veten «marksistë-leninistë të kulluar», në të vërtetë kanë bërë gabime serioze dhe tani në Bullgari shihet se në treg ka mungesa edhe për mish; edhe në Bashkimin Sovjetik, ka mjaft vështirësi për furnizimin e popullit, kurse në tregjet tona gjen plot shpendë, pula, rosa, pula deti dhe lloje të tjera mishi. Pse ndodh një situatë e tillë në këto vende? Këtë ta shpjegojë Nikita Hrushovi dhe pauesit e tij, që ndjekin një vijë «marksiste-leniniste» dhe kanë deklaruar kaq herë se shpejt do t'ia kalojnë edhe Amerikës. Hrushovi ka trumbetuar se qysh në vitin 1960 do të kalonte Shtetet e Bashkuara të Amerikës në shumë gjëra. Ai jo vetëm nuk i mbajti premtimet që dha, por ka bërë hapa prapa. Një Shqipëri e vogël, me kapacitet ekonomik dhe teknik të kufizuar, ka arritur të ketë gjithë këto përparime, saqë në treg të mos mungojë asgjë dhe populli të furnizohet pa ndër-

prerje me bukë, mish, yndyrna, fruta, zarzavate dhe me gjithfarë mallrash industriale, kurse në Bashkimin Sovjetik, që ka një potencial të madh ekonomik, gjendja është keqësuar në vend që të ishte më përpara nga sa ka qenë. Kjo situatë jo e mirë që është krijuar atje, rrjedh nga vija e shtrembër e grupit të Nikita Hrushovit, e cila ka sjellë si pasojë që popullit të mos i sigurohen ato që i janë premtuar dhe për të cilat ai ka nevojë.

Prandaj me besim të patundur në forcat tona dhe duke u mbështetur fort në vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, të ecim kurdoherë përpara dhe të mos kemi frikë nga vështirësitë. Të armatosemi me këtë vijë të drejtë, me guximin e patriotizmin e zjarrtë që vlon në zemrat e popullit tonë dhe të mobilizohemi me të gjitha forcat për realizimin e planeve, t'i japim popullit prodhime sa më të shumta dhe më të lira. Kështu do të kryejmë detyrën tonë ndaj popullit, do të ndihmojmë për garantimin e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut, do t'i sjellim një shërbim të madh çështjes së madhe të socializmit dhe do të bëjmë që edhe ata që nuk kanë dashur të lidhin gjer më sot marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë socialiste, të na lutën për një gjë të tillë. Pozitat e vendit tonë do të vijin vazhdimisht duke u forcuar dhe shpifjet e revizionistëve modernë do të demaskohen. Ne jemi të ndërgjegjshëm se, duke vepruar kështu, luftojmë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të socializmit. Ne kemi një detyrë të madhe patriotike dhe komuniste, të brendshme, ndaj popullit dhe atdheut, por kemi gjithashtu edhe një detyrë të madhe internacionaliste ndaj vendeve socialiste, miqve tanë dhe proletariatit ndërkom-

bëtar. Prandaj e theksoj edhe një herë që, të frymëzuar nga vija e drejtë e Partisë, të mobilizohemi të tërë për realizimin e këtyre detyrave, sepse pa luftë dhe pa përpjekje asgjë nuk arrihet dhe të jemi të bindur se do t'i kapërcejmë vështirësitë.

Ju, shokë dhe shoqe, nxënës dhe nxënëse të politeknikut, të dëgjoni me kujdes këshillat e mësuesve tuaj, të përvetësoni sa më thellë mësimet që ju japin ata. Në çështjen e mësimit mos mendoni ashtu si mendonim ne kur ishim nxënës. Për mësimin dhe shkollën ju keni mendime më të përparuara nga ato që kishim ne kur ishim si ju. Mentaliteti ynë i asaj kohe ndaj mësimi dhe shkollës ishte shumë larg atij që keni ju tani, pra ju, në këtë drejtim, jeni më përpara. Nuk mund të krahasohemi ne, ish-nxënësit e brezit të vjetër, me ju që keni të gjitha mundësitë që i kuptoni shkencën, artin, politikën, ideologjinë, më drejt e më thellë se ne, qoftë edhe kur ishim në klasat e fundit të shkollës së mesme, apo në bankat e universitetit. Ju tani keni vënë të gjitha forcat për të mësuar; sepse jeni të ndërgjegjshëm dhe kjo i detyrohet punës së palodhur të Partisë, për detyrën që ju është ngarkuar, që të bëheni kuadro të aftë, me horizont të gjerë shkencor, me zotësi praktike, gati për t'i shërbyer popullit tonë të mrekullueshëm, atdheut tonë të shtrenjtë, kudo që ta dojë nevoja, për të shkrirë të gjitha energjitë tuaja në përparimin dhe në lulëzimin me ritme të shpejta të Shqipërisë së re socialiste.

Ju duhet të jeni të lumtur që ju japin mësim mësues të vjetër, edhe nga ata që kanë mbaruar shkollat e pushtetit popullor. Edhe mësuesit tuaj, të vjetër e të

rinj, duhet të jenë të lumtur e të gëzuar që kanë të bëjnë me një rini kaq të pastër, të shëndoshë dhe të gatshme për të thithur diturinë dhe shkencën dhe për ta vënë atë në shërbim të popullit ashtu siç jeni ju.

Të dashur nxënës dhe mësues,

Partia dhe Qeveria janë të sigurt se ju e doni popullin, atdheun dhe Partinë dhe u qëndroni atyre besnikë. Këtë dashuri e besnikëri ju po e tregoni çdo ditë me punën tuaj të palodhur për përvetësimin e mësimëve teorike dhe praktike, atë e tregoni me entuziazmin tuaj revolucionar ndaj vijës së drejtë të Partisë sonë. Prandaj ju uroj nga zemra punë të mbarë dhe suksese sa më të mëdha në kryerjen e detyrave, për të mirën tuaj, të popullit dhe të Partisë sonë të dashur të Punës!

*Botohet për herë të parë, me shkurtime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TË JEMI VIGJILENTË, TË QARTË POLITIKISHT DHE TË ARMATOSUR KUNDËR ARMIQVE TË JASITËM DHE TË BRENDSHËM

*Diskutim në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë  
të Rrethit të Shkodrës<sup>1</sup>*

**15 janar 1962**

Është më se e vërtetë ajo që thanë shokët në diskutime, se ne nuk duhet të mendojmë që njerëzit i dinë në detaje të gjitha çështjet politike. Mundet që për asnjë njeri të mos jenë të huaja problemet e mëdha politike të kohës, megjithatë të gjithë kanë nevojë të sqarohen herë pas here. Të kemi parasysh se niveli politik i njerëzve nuk është i njëjlojtë. Ata që janë më të ngritur politikisht, e kanë për detyrë të ndihmojnë edhe në ngritjen politike të njerëzve të tjerë, pa pasur frikë se problemet që do të shtrojnë dihen dhe të kujtojnë se po bëjnë «përsëritje».

Kur ndonjëri zhvillon një konferencë ose bisedë politike në një kohë që nuk ka ngjarje të reja politi-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u punua letra e KQ të PPSH «Mbi punën politike me masat».

ke, mund të kujtojë se të tjerët që dëgjojnë, do të thonë se ky që po flet, nuk po na thotë ndonjë gjë të re. Mirëpo një konferencë ose një bisedë e tillë politike i sqaron mjaft mirë njerëzit, veçanërisht kur konferencieri është i lidhur me masat, njeh pikëpamjet, boshllëqet dhe kërkesat e tyre. Biseda ka rëndësi kur lidhet mirë me terrenin, kur flet jo vetëm mbi disa çështje sensacionale ose të përgjithshme, po sidomos kur ngjarjet interpretohen drejt dhe, ato që thua, i lidh mirë me problemet që preokupojnë e interesojnë njerëzit. Por ka raste që, dashur padashur, ndonjë çështje kuptohet shtrembër, prandaj, kur në këto mbledhje shokët shkojnë të pregatitur mirë dhe i sqarojnë konkretisht çështjet, njerëzit armatosen në luftën kundër armiqve, gjë që ndihmon në forcimin e situatës politike të vendit, në realizimin e detyrave ekonomike ose të çdo sektori tjetër.

Është fakt se në rrethin e Shkodrës situata politike është e mirë. Populli patriot është i lidhur me Partinë dhe lufton në pararojë kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm. Në kufi me rrethin tuaj janë revizionistët jugosllavë. Ata vite të tëra kanë punuar dhe punojnë me të gjitha mënyrat kundër vendit tonë. Për këtë qëllim ata kanë pasur dhe kanë baza të fshehta dhe të hapëta në elementët e klasave të përmbysura e të tjerë dhe luftojnë kështu në të gjitha fushat kundër Partisë dhe pushtetit tonë.

Por në këto situata të vështira populli i rrethit të Shkodrës jo vetëm që qëndron mirë politikisht, por ai, si kurdoherë, është i mobilizuar dhe po realizon planet me sukses. Kjo u detyrohet punës së palodhur po-



litike dhe ideologjike të Partisë për sqarimin e vazhdueshëm të masave si edhe luftës këmbëngulëse që bëjnë Partia dhe populli për ngritjen ekonomike të rrethit. Të gjitha këto çështje janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Në rast se ne kemi një gjendje të mirë ekonomike, do të thotë se kjo është rezultat i punës sonë të gjithanshme politike, organizative, ekonomike dhe parullat e armikut do të dështojnë e nuk do të kenë sukses, ashtu sikurse kanë dështuar edhe më parë.

Kudo në Shqipëri, kështu si në rrethin tuaj, situata e brendshme është e fortë, e shëndoshë. Kjo na jep forca dhe na inkurajon shumë. Sa më tepër shtohen përpjekjet e armikut kundër vendit tonë, aq më shumë tregohet forca dhe patriotizmi i anëtarëve të Partisë dhe i punonjësve. Në kohët e vështira duken akoma më mirë lidhjet e Partisë me popullin dhe po të mos ishin këto lidhje në rrugë të drejtë, në baza të shëndosha, atëherë në situata të tilla të vështira ato do të dobësoheshin dhe Partia natyrisht do të kishte vështirësi shumë më të mëdha. Por në vendin tonë ndodh e kundërta dhe ky është një inkurajim i madh për Partinë, është një tregues që dëshmon se Partia ka ecur dhe ecën në rrugë të drejtë dhe kështu do të ecë kurdoherë. Te ne çdo gjë ecën në rrugë normale, komunistët qëndrojnë fort dhe të sigurt në vijën e Partisë. Ngjarjet e këtyre kohëve të vështira ata nuk i kanë çorientuar aspak; shumë të rrallë mund të jenë ata persona që janë hutuar nga situatat, të cilat nuk janë të lehta. Të tilla situata, të shkaktuara nga veprimtaria armiqësore e revizionistëve modernë, megjithëse janë shumë të vështira, ne, komunistët shqiptarë, do t'i ka-

përcejmë, sepse Partia jonë është e fortë, prandaj ecën ballëlart e papërkulur në vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste.

Jeta ka provuar dhe po e vërteton se ka periudha që lufta e klasave ashpësohet, armiqtë e shohin që u vjen vdekja dhe s'lenë gjë pa bërë kundër nesh. Këtë e vërteton edhe situata e krijuar. Ku ka armiqtësi më të madhe se fakti që në Bashkimin Sovjetik erdhi në fuqi një grup i egër revizionistësh? Puna e N. Hrushovit është një punë armiqtësore, antimarksiste që ka për qëllim të shkatërrojë PK të BS. Jo vetëm kaq, por veprimtaria reaksionare e këtij grupi trockist i sjell dëme të mëdha edhe gjithë klasës punëtore në shkallë ndërkombëtare.

Fakti që imperializmi vazhdimisht dobësohet, nuk do të thotë se ai hodhi armët. Përkundrazi, imperializmi përpiket të sulmojë dhe sulmon për të dobësuar socializmin dhe, për t'ia arritur këtij qëllimi, përdor një nga armët e tij më të preferuara, revizionizmin. Vija e N. Hrushovit çon drejt shuarjes së vigjilencës së partive komuniste e punëtore përpara rrezikut që kërcënon socializmin dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Prandaj revizionizmin, që ka ngritur krye në BS, ne do ta luftojmë që të zhduket, sepse është një sëmundje e rrezikshme, dhe jemi të sigurt se marksizëm-leninizmi do të fitojë në BS.

Grupin e N. Hrushovit e pasojnë në radhë të parë udhëheqësit e partive komuniste dhe punëtore të Polonisë, Bullgarisë, Hungarisë, Çekoslovakisë, Rumanisë, RD Gjermane, si dhe të partive komuniste të Francës e të Italisë. Ata tani po përpiqen t'i shpëtoj-

në luftës së drejtë parimore që u bëhet atyre dhe vijës së tyre revizioniste nga Partia jonë si dhe nga partitë e tjera marksiste-leniniste.

Vija dhe qëndrimet e Partisë sonë dhe të partive të tjera marksiste-leniniste godasin hapur deviacionet e mëdha revizioniste të këtyre grupeve, të cilat gjithashtu përpiqen, si me anën e demagogjisë, ashtu edhe me masa të shumta policore, të luftojnë rezistencën që po rritet brenda në partitë dhe në vendet e tyre. Kështu ata janë të detyruar ta zhvillojnë luftën në dy fronte: në frontin e brendshëm dhe në atë të jashtëm. Tani mund të themi pa e ekzagjeruar se ata kanë shteruar në luftën që po u bëjnë Shqipërisë dhe partive të tjera marksiste-leniniste, se në luftën që kanë ndërmarrë kundër nesh, nuk kanë fakte dhe, sado që të mundohen, nuk kanë për të gjetur kurrë veprime të shtrembra në Partinë tonë dhe në vijën e saj. Propaganda e tyre është ndërtuar në një mënyrë të tillë për të gënjyer njerëzit, ajo është e maskuar nga qëllimet e saj të vërteta. Kështu ata na akuzojnë si dogmatikë në pikëpamje ideologjike. Mirëpo edhe kjo mbetet një formulë e thatë, sepse nuk mund ta argumentojnë që të sqarojnë opinionin. Një «argument» që po përdorin është se gjoja Shqipëria nuk dëshiron të bashkëjetojë me Greqinë, po ky është një argument fals, sepse politika e Partisë dhe e Qeverisë sonë ka qenë kurdoherë për marrëdhënie diplomatike me Greqinë, këtë e di fare mirë edhe N. Hrushovi. Por atij i duhet që ta përpunojë opinionin publik sipas gustos së tij, dhe me disa formula mundohet për të fshehur fytyrën e vet prej revizionisti, por jeta, praktika, vija që ndjek dhe ve-

primtaria që zhvillon ai, ia heq maskën. Me qëndrimet e tij revizioniste ai po lë në heshtje ndihmën që vendet tona duhet t'i japin luftës nacionalçlirimtare të popujve të shtypur, si dhe luftës së proletariatit të vendeve kapitaliste. Kursi që ndjek tani BS jo vetëm që nuk e mbron lëvizjen nacionalçlirimtare të popujve të vendeve koloniale, por bile merr në mbrojtje udhëheqësit reaksionarë të vendeve që janë në kundërshtim me vendet socialiste. Kjo pikëpamje pacifiste borgjeze zbut luftën kundër imperializmit duke i bërë atij lëshime të njëpasnjëshme.

Sipas pikëpamjes së tij, propaganda kundër imperializmit amerikan duhet të shuhet. Shtypi sovjetik nuk po e godet në thelb politikën agresive të imperializmit amerikan dhe të presidentit Kenedi. Sipas tij duhet të mos bëhet propagandë kundër imperializmit dhe në fakt vetë Hrushovi gati e ka shuar propagandën kundër imperializmit amerikan. Në shtypin sovjetik mund të gjendet ndonjë fjalë kundër ndonjë gjenerali amerikan, po që të goditet në thelb politika e imperializmit amerikan, politika dhe veprimtaria e Xhon Kenedit, ajo nuk bëhet nga organet zyrtare sovjetike. Pra këtu i bëhen koncesione imperializmit. Është e natyrshme se gjersa BS ndjek një kurs të tillë, ai druhet shumë të mbrojtë luftën nacionalçlirimtare të popujve të skllavëruar dhe kjo e ka diskredituar me gjithë kuptimin e fjalës Bashkimin Sovjetik.

N. Hrushovi dhe grupi i tij nuk u jep asnjë ndihmë materiale popujve të angazhuar në luftën nacionalçlirimtare, si Algjerisë, Kongos, Laosit etj. Jo vetëm nuk u jep ndihmë materiale, por edhe përkrahja politike është

e zbetë, për të mos thënë se mungon krejtësisht, e kjo është në kundërshtim me parimet e internacionalizmit proletar. Në OKB Zorin<sup>1</sup> thotë ndonjë fjalë të mirë, po zëdhënësi kryesor i politikës shtetërore, shtypi zyrtar sovjetik, nuk flet për të tilla probleme me atë forcë dhe në atë shkallë që duhet ta bëjë shtypi i një vendi socialist, për t'u ardhur në ndihmë atyre vendeve që luftojnë për të hedhur poshtë zgjedhën koloniale. N. Hrushovi ishte ai që votoi për t'u futur ushtritë e OKB-së në Kongo, domethënë ushtritë e SHBA-së. Tani në fakt në Kongo mbretëron kaosi. Imperializmi amerikan po shfrytëzon të gjitha mjetet për t'u zënë vendin kolonialistëve të vjetër anglo-belgo-francezë dhe N. Hrushovi nuk bën asgjë. Bile as në shtypin sovjetik nuk thuhet të paktën një fjalë e mirë për Kongon, përveç ndonjë komunikate të shkurtër që bën fjalë vetëm për zhvillimin e ngjarjeve. Tani atje amerikanët po veprojnë lirisht nën maskën e OKB-së.

Politika e revizionistëve, me veprimet që kanë ndërmarrë, është që të mos prishen me imperializmin, të mos ndihmojnë luftën e popujve të shtypur dhe të proletariatit të vendeve kapitaliste. Puna e tyre qëndron vetëm në hedhjen e ndonjë parulle në rrugë revizioniste dhe asgjë tjetër.

Për N. Hrushovin, pra, bashkekzistenca paqësore nuk do të thotë të ndihmojë luftën nacionalçlirimtare të popujve të robëruar, sepse kjo do të binte në kundër-

---

<sup>1</sup> Valerian Zorin — në vitin 1960-1963 ka qenë përfaqësues i përhershëm i Bashkimit Sovjetik në Komitetin Politik të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

shtim me rrugën e tij të pajtimit me imperializmin për një paqe me kompromis. Kjo rrugë e tij i pengon vendet socialiste për të ndihmuar proletariatin e vendeve kapitaliste. Prandaj në fakt në këto vende nuk ekziston më ajo situatë revolucionare që ekzistonte përpara. Kjo nuk do të thotë se në vendet kapitaliste tani nuk bëhen greva e demonstrata. Të tilla aksione bëhen nga proletariati i këtyre vendeve, por ato nuk udhëhiqen nga një patos i fortë revolucionar, sepse në udhëheqje të partive komuniste të tyre kanë ardhur elementë revizionistë.

Presidenti i sindikatave italiane u thotë punëtorëve se viti i ri do t'u sjellë të mira, ata do të kenë shtëpi më të mira dhe do të bëhen përpjekje që t'u gjendet edhe punë. Kjo do të thotë se orientimi i sindikatave italiane drejtohet vetëm në fushën ekonomike. Ky orientim përfaqëson vijën e PK të Italisë, që është krejtësisht në kundërshtim me marksizëm-leninizmin.

Në Itali dhe në Francë, nga ana e partive komuniste, çështja e marrjes së pushtetit nga proletariati është shtruar të realizohet vetëm në rrugën paqësore, nëpërmjet reformave e rrugëve parlamentare, gjë që do të thotë shuarje e luftës ideologjike ndaj imperializmit. Sipas tyre rruga paqësore do të çojë në fitoren e socializmit.

Edhe problemin e çarmatimit ne e kemi të qartë. Imperializmi nuk i hedh armët ashtu si mendon N. Hrushovi, i cili e di këtë, po lufton vetëm për të na çarmatosur. Faktet kanë treguar dhe po tregojnë vazhdimisht se imperializmi nuk vjen vetë në rrugën e çarmatimit. Ne themi se janë popujt ata që mund ta detyrojnë

imperializmin të çarmatoset. Që të realizohet çarmatimi, nuk mjafton vetëm të bisedojmë, po duhet edhe të ndihmojmë luftën nacionalçlirimtare të popujve kolonialë, luftërat e drejta mbrojtëse që bëjnë ish-popujt kolonialë, që tani janë çliruar, si edhe luftën revolucionare të proletariatit, në mënyrë që të arrijmë atë që popujt të ngrihen në këmbë kundër imperializmit, për t'i ndalur këtij dorën gjakatare dhe luftënxitëse. Prandaj, puna që bën Hrushovi për çarmatimin e popujve, nuk është e drejtë, ajo është një punë që errëson luftën e madhe për paqe që duhet të bëjnë popujt në rrugë marksiste-leniniste revolucionare. Puna ka arritur gjer atje sa, në mbledhjen e Këshillit Botëror të Paqes në Stokholm, përfaqësuesit e Kinës dhe të vendeve afrikane u përleshën me delegatët sovjetikë për shkak të kursit reaksionar që ndjekin këta të fundit në zgjidhjen e çështjes së madhe të paqes. Përfaqësuesi i Guinesë u tha haptazi sovjetikëve: Si na këshilloni ne të lëshojmë armët, në një kohë kur imperialistët amerikanë dhe të tjerë po na qëndrojnë mbi kokë, si mund të hedhim poshtë ne edhe ato pak armë që kemi, kur imperialistët po gjakosin popujt e Afrikës? Kjo nuk është logjike.

Por vija e Hrushovit me shokë synon të demoralizojë popujt. Të çarmatosësh popujt që porsa kanë fituar lirinë, do të thotë të shuash luftërat e tyre nacionalçlirimtare, t'i çmobilizosh ata.

Udhëheqësit e PK të Francës sulmuan PPSH, duke shpifur sikur ne jemi gjoja kundër paqes, por kjo ka të bëjë me atë ofensivë të madhe në aspekte të ndryshme, që zhvillohet kundër nesh nga Hrushovi dhe pasu-

esit e tij, me qëllim që të asgjësojë kampin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Ndigni me kujdes se si e sheh N. Hrushovi çështjen e bashkekzistencës. Qëllimi i tij është të dobësojë pozitën e marksizëm-leninizmit dhe rezistencën e popujve kundër imperializmit amerikan. Tani nuk është çështja që ai të bëjë lëshime të mëdha, megjithëse edhe kjo kohë do të vijë, po tani për tani Hrushovi punon për të shuar hovin revolucionar dhe për t'i ardhur në ndihmë imperializmit amerikan.

Është një fitore e madhe për imperializmin kur sheh se udhëheqja e Partisë Socialiste e Bashkuar e Gjermanisë është diskredituar në opinionin publik, sepse 3-4 herë e ka ngrënë fjalën paturpësisht mbi çështjen gjermane dhe të Berlinit. Këto veprime nuk i gëlltitin as komunistët e vërtetë gjermanë as masat liridashëse të popullit gjerman, që luftojnë për bashkimin demokratik të vendit. Kështu V. Ulbrihti, i cili nuk qëndron jashtë valles që heq N. Hrushovi, po diskreditohet. Në një intervistë që Ulbrihti i dha korrespondentit të televizionit amerikan i tha se brenda vitit 1962 do të nënshkruhet traktati i paqes me Gjermaninë!

Dihet se imperializmi amerikan është armiku ynë kryesor dhe revanshistët e Bonit përbëjnë forcën e tij ndihmëse në Evropë, që të dy armiq të egër të paqes dhe të socializmit. Por tani propaganda e Hrushovit dhe e pasuesve të tij nuk thotë asnjë fjalë kundër imperializmit amerikan, po thekson vetëm se rreziku kryesor në Evropë vjen nga revanshistët e Bonit. Dhe pas kësaj fushate, N. Hrushovi i dërgon një memorandum Adenauerit, të cilit i zgjat dorën në rrugën e tij të bashkek-



zistencës, me fjalë të tjera arrin t'i thotë pak a shumë: «ju jeni njerëz të zotë, kurdoherë gjermanët kanë qenë të fuqishëm në industri, kampi socialist është një oqean i madh ku mallrat gjermane do të gjejnë një treg të gjerë, prandaj të bëjmë tregti. Ne nuk kemi kundërshtim të qëndroni në NATO, po kini parasysh se Franca ka qenë kurdoherë armike e Gjermanisë, Amerika kërkon t'ju përdorë si vegël për luftë, Anglia ka bërë kurdoherë një politikë dredharake kundër Gjermanisë. Prandaj, që ju të arrini bashkimin e Gjermanisë në një shtet, ju propozojmë të nënshkruajmë traktatin e paqes» etj. Me një fjalë Hrushovi u hap një perspektivë krerëve të imperializmit gjerman. Kjo perspektivë ndjell shumë gjëra, edhe lëshime, edhe kërcënime, ashtu siç e ka zakon N. Hrushovi, pastaj përsëri i ul pendët.

Krerët e borgjezisë reaksionare gjermane me manovrat e tyre po bëjnë të gjitha përpjekjet për të fituar koncesione. Por, duke pasur për bazë memorandumun, N. Hrushovi thotë të bëjmë tani disa lëshime për Berlinin, gjersa të bëhet bashkimi, ë pastaj e bëjmë tonën të gjithë Gjermaninë. Kjo, sipas tij, është politika «e madhe», një politikë «e urtë» e jo politikë «aventureske» si e shqiptarëve. Për këtë duhen bërë disa lëshime. Nuk është ndonjë punë e madhe, mund të mendojë Hrushovi, pse lëmë edhe për disa vjet akoma garnizonet anglo-franko-amerikane në Berlin. Po, për të justifikuar këtë, ne mund të marrim ndonjë koncesion të vogël që, për të ardhur në Berlinin Perëndimor anglezët, francezët dhe amerikanët, të marrin leje ose autorizim nga komanda sovjetike.

Kjo natyrisht është një politikë adventureske. Ma-

rëveshja Molotov-Ribentrop<sup>1</sup> ishte e favorshme për BS. Stalini atëherë nuk kishte si vepronte ndryshe, dhe ajo ishte një masë e domosdoshme që vonoi sulmin kundër BS nga Gjermania e Hitlerit. Mirëpo tani situatat janë ndryshe, Gjermania Perëndimore është e lidhur ngushtë me SHBA-në dhe NATO-n, prandaj përpjekjet për ta shkëputur atë nga blloku perëndimor nuk bëjnë gjë tjetër veçse e diskreditojnë politikën e Hrushovit.

Jo vetëm armiqtë, por edhe miqtë e Hrushovit, si ata të udhëheqjes polake, e kanë kuptuar se kjo politikë e revizionistëve sovjetikë është aventureske, e lëkundshme dhe e rrezikshme. Sidoqoftë, politika revizioniste e N. Hrushovit akoma nuk ka arritur të demaskohet si duhet në gjithë opinionin publik botëror dhe as në atë komunist. Por, megjithatë, lufta që Partia jonë ka zhvilluar kundër politikës së N. Hrushovit ka bërë një efekt mjaft të mirë në të gjitha vendet socialiste. Në disa nga vendet e demokracisë popullore ka njerëz që na bëjnë thirrje t'i ndërpresim këto kritika kundër N. Hrushovit, se kjo «e ul autoritetin e BS». Natyrisht, ata që na japin të tilla këshilla, janë oportunistë, revizionistë. Autoritetin e BS ata nuk e kuptojnë si duhet, por në rrugë të gabuar. Ata nuk e kuptojnë se Bashkimi Sovjetik nuk mbrohet duke përkrahur një grup të tillë armik, që nuk e forcon po e diskrediton atë, përkundrazi ky grup duhet luftuar që të mbrohet Bashkimi Sovjetik. Grupi i N. Hrushovit e ka diskredituar Bashkimin

<sup>1</sup> Është fjala për traktatin e mossulmimit midis BS e Gjermanisë të nënshkruar nga ministrat e jashtëm të të dy shteteve, Molotov e Ribentrop, më 23 gusht 1939.

Sovjetik përpara komunizmit ndërkombëtar dhe përpara gjithë popujve të botës.

Ne duhet të vëmë re me kujdes atë fenomen që u duk në Kongresin e 22-të të PK të BS. Zjarri prej kashite, që N. Hrushovi ndezi në këtë kongres kundër PPSH, tani ka filluar të shuhet. Nga propaganda sovjetike janë bërë përpjekje të mëdha që të gjitha partitë e botës të thonë diçka kundër Shqipërisë, dhe shumica e bëri këtë gjë, bile këtu ka lëvizur shumë me siguri edhe rubla sovjetike. Kështu edhe disa nga ato parti që nuk na sulmuan në Kongresin e 22-të të PK të BS, nën presionin e udhëheqjes sovjetike, tani kanë filluar të thonë diçka, po kanë mbetur gjer këtu.

Më aktive nga këto ka qenë PK e Francës, sidomos në ditët e para pas kongresit. Udhëheqësit komunistë francezë kanë bërë disa artikuj në forma të përgjithshme, po tani ka ca kohë që edhe ata kanë pushuar sulmet, jo se kanë ndryshuar pikëpamjen kundër nesh, por për arsye se edhe në PK të Francës në bazë ka reagime kundër udhëheqjes, sepse shumë punonjës e komunistë shfaqin një respekt të veçantë për Partinë tonë, kjo duket edhe nëpërmjet letrave që na dërgohen, ku mbështetin qëndrimin e drejtë marksist-leninist të Partisë sonë dhe na inkurajojnë se kudo në Francë Shqipëria ka miq të shumtë.

Një gjë e tillë ndodh edhe në vende të tjera, si në Çekosllovakia, në Bullgari, në Poloni etj. Në Poloni fjalimin e mbajtur nga ana jonë, me rastin e 7-8 Nëntorit të vitit që kaloi, e shtypën në dhjetëra mijëra kopje vetë marksistë-leninistët polakë, të cilët luftojnë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Atyre, kur u bie në dorë

ndonjë nga materialet tona, e shtypin edhe e shpërndajnë vetë.

N. Hrushovi me shokë mendonin se, për të shkatërruar PPSH, nuk do t'u duhej ndonjë punë e madhe, por ata u gabuan në llogaritë e tyre. Ata kanë menduar që Shqipëria është një vend, populli i së cilës është mik besnik i popujve të Bashkimit Sovjetik, dhe këtu nuk janë gabuar, po u gabuan rëndë kur menduan se do të ndiqej rruga e Hrushovit. Duke parë çdo problem me syrin revizionist, udhëheqësit sovjetikë menduan se çdo gjë te ne është bërë vetëm në saje të tyre, prandaj ata thanë: mjafton t'u presim kreditë dhe furnizimin, shqiptarët nuk do të jetojnë dot. Dhe të gjitha planet e presionet ekonomike që kishin menduar, i zbatuan.

Edhe në fushën ushtarake ata prenë çdo ndihmë. Duke u mbështetur në këto plane, ata kishin llogaritur dhe shpresuar se brenda një kohe të shkurtër çdo pengesë kundër tyre këtu në Shqipëri do të likuidohej.

Mikojani i tha shokut Mehmet se tani që e prishët me BS, do të shihni ç'do t'ju ngjasë. Por po ngjan e kundërta. Meqenëse Shqipëria është në rrugë të drejtë, jo vetëm s'pësoi asgjë, po u forcua më shumë. Blofet, gënjeshttrat, kërcënimet dhe poshtërsitë e N. Hrushovit, që drejtohen kundër nesh, do të bëhen të qarta për të gjithë. Koha do t'i sqarojë të gjitha këto, do të zbulojë shpifjet dhe intrigat që ka ndërmarrë grupi i N. Hrushovit kundër PPSH.

Hrushovi dhe ata që e pasojnë na thanë se ne qenkemi «të lidhur me imperializmin», se qenkemi «të shitur për 30 aspra» dhe «agjentë të imperializmit». Mirëpo koha dhe faktet do të vërtetojnë të kundërtën.

Në rrugën tonë ne do të hasim edhe vështirësi të tjera. Por sidoqoftë ne jemi në luftë të papajtueshme me revizionistët, veprimtaria e të cilëve, qoftë në planin tonë kombëtar, qoftë në planin ndërkombëtar, vazhdimisht po demaskohet. Ato që po bën Hrushovi, s'mund t'i quajmë gabime, por tradhti. Politika që ndjek ai do të bëjë që popujt dhe komunistët, kudo që janë, të shohin gjithnjë e më qartë tradhtinë e grupit të tij. Është e pamundur që kjo rrugë të mos demaskohet, kësaj ai me shokë nuk kanë si i shpëtojnë.

Për shkak të vijës revizioniste që ndjek, N. Hrushovi me siguri do të dështojë edhe në politikën e brendshme të BS. Është e pamundur të ketë fitore kjo vijë, qoftë edhe brendapërbrenda Bashkimit Sovjetik. Në sipërfaqe Hrushovi mundohet ta paraqitë situatën të balancuar, por e vërteta duhet të jetë ndryshe. Kjo duket edhe nga rezultatet që ka.

Shumë ka folur N. Hrushovi për përparimet në bujqësi dhe përmirësimin e gjendjes së furnizimit të popullit, por në BS janë krijuar situata aspak të mira. Për disfatat në ekonomi nuk e ka fajin tjetërkush, por e tillë është politika e brendshme e Hrushovit, i tillë është i gjithë organizimi i ri që ai ka ndër marrë. Mjafton të përmendim që shteti SMT-të i prishi dhe traktorët ua shpërndau kolkozeve, duke u thënë se do t'i kenë pronë të tyre, prandaj, sipas tij, do t'i mbajnë si jo më mirë e do t'i shfrytëzojnë në maksimum. Tani ky parashikim i tij «i bukur» nuk u vërtetua, prandaj u detyrua të nxjerrë vendimin për dënimin e traktoristëve. Por ne jemi të sigurt se me këtë mënyrë ky organizim do të çojë drejt shkatërrimit, sepse traktorët që vjetrohën

në kolkoz, zëvendësohen me vështirësi, pasi një traktor kushton shtrenjtë dhe rëndon ekonominë kolkoziane. Përveç kësaj pengohet kështu edhe përparimi teknik që BS ka nevojë ta çojë gjithnjë sa më përpara për shumë arsye. Pra, me politikën që bën, N. Hrushovi do të pësojë me siguri disfatë. N. Hrushovi, për të dalë nga situata ku është zhytur, do të përpiqet të manovrojë. Por ne jemi të bindur se ashtu siç ndodhi me Titon, ka për të ndodhur edhe me N. Hrushovin, sepse politika antimarksiste që ai ndjek, do ta demaskojë çdo ditë më shumë përpara popujve dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Në këto situata, pra, të jemi vigjilentë, ta mbajmë popullin të qartë për situatën, të forcojmë unitetin e tij me Partinë dhe me pushtetin dhe kurdoherë të jemi në gatishmëri kundër armiqve, të cilët nuk flenë. Në këto situata është e natyrshme që do të dalin disa njerëz të këqij, me plot mbeturina të së kaluarës dhe të hedhin parulla armiqësore, sepse momente më të përshtatshme se këto, për të tillë njerëz, nuk ka. Ata gjërat i matin me metrin e tyre, se tani që na u krijuan këto situata, mendojnë ata, mbaroi Shqipëria, se është nga të katër anët e rrethuar, prandaj edhe ne të bëjmë diçka. Po njerëz të tillë janë të paktë, se populli është vigjilent. Pastaj njerëzit e shohin se këtë Parti dhe këtë pushtet nuk i luan as topi. Ata shohin forcën e madhe të Partisë sonë dhe gjendjen ekonomike që përmirësohet çdo vit. Prandaj të gjithë këta faktorë, sqarimi i masave, forcimi i vigjilencës, goditja e çdo veprimtarie të armikut, forcimi i ekonomisë, do t'i çarmatosin ata që hedhin parulla.

Por në këto situata ne duhet të vëmë të gjitha forcat tona për realizimin e planit, se kjo është një detyrë me rëndësi shumë të madhe. Situatat e krijuara kanë ndihmuar shumë për një mobilizim më të madh të masave në realizimin e planeve, si dhe për sigurimin e produkteve të nevojshme ushqimore për popullin. Kjo është një kënaqësi e madhe për masat që e kuplojnë se patriotizmi i tyre bëri që jeta e popullit të përmirësohej dhe sulmet e armiqve të asgjësoheshin. Këtë mobilizim të përpiqemi ta shtojmë akoma më shumë. Edhe këtë vit asgjë s'mungon dhe nuk do t'i mungojë popullit. Detyra jonë është të mobilizohemi për të realizuar çdo detyrë politike dhe ekonomike, në industri dhe në bujqësi.

Duke i parë çështjet në këtë frymë, jemi të sigurt se çështja jonë e drejtë marksiste-leniniste do të triumfojë. Viti i ri do të na sjellë patjetër situata shumë më të favorshme në demaskimin e revizionizmit, por duhet punuar në këtë drejtim. Artikujt që boton gazeta «Zëri i popullit» duhet t'i studjoni vetë në radhë të parë, pastaj t'i punoni në popull, të cilin ta sqaroni; në bazë të tyre të përpunohen leksionet e të organizohen mbledhjet, duke i lidhur mirë edhe me situatën konkrete të fabrikës, lagjes, fshatit, ndërmarrjes bujqësore ose kooperativës bujqësore.

Të forcojmë pareshtur vigjilencën. Kjo detyrë është veçanërisht për ju, shokë të organizatës së Partisë të rrethit të Shkodrës, që keni në kufi revizionistët jugosllavë. Ata me siguri do ta shtojnë veprimtarinë diversioniste dhe agjenturale kundër nesh, dhe tani për tani revizionistët jugosllavë kënaqen me sa thotë

N. Hrushovi, ose sa shkruan gazeta «Pravda». Të tilla materiale i botojnë gazetat dhe i transmetojnë radiot jugosllave.

Prandaj, në këto situata, të forcojmë vigjilencën, të mobilizohemi për të realizuar plotësisht planet ekonomike, se kështu armiqtë s'kanë ç'të na bëjnë. Ne jemi të bindur se situata e jashtme do të zhvillohet çdo vit në favorin tonë, nuk ka si të jetë ndryshe.

Ne i kemi të gjitha mundësitë për të realizuar detyrat tona, sepse Partinë e kemi të fortë, në radhët e saj nuk ka asnjë çarje, asnjë lëkundje. Kjo tregon se Partia jonë është e shëndoshë dhe në rrugë të drejtë.

Pra, të mobilizohemi për realizimin e detyrave, ashtu siç kemi vendosur, u jepni rëndësi gjithashtu edhe formave të punës politike me masat, u jepni rëndësi edhe lektorëve, edhe propagandistëve, edhe instruktorëve të Partisë. Punonjësit e frontit të propagandës e njëkohësisht edhe sekretarët e organizatave-bazë t'i mbani kurdoherë në korent të situatës.

*Botohet për herë të parë, me  
disa shkurtime, sipas origjinalit  
që gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*



## GJYKATËSI PËRFAQËSON DHE MBRON INTERESAT E KLASËS NË FUQI

*Diskutim në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë  
të rrethit të Shkodrës<sup>1</sup>*

15 janar 1962

Partia duhet të bëjë shumë kujdes në zgjedhjen e ndihmësgjyqtarëve. Kjo është një çështje që ka dhe do të ketë kurdoherë një rëndësi të madhe, sepse përfaqëson zbatimin e drejtë të vijës së Partisë. Prandaj, njerëzit që zgjidhen, duhet të kenë disa cilësi: Ata duhet të njihen nga populli si njerëz të ndershëm, duke zbatuar drejt ligjshmërinë socialiste, të jenë shumë të pastër politikisht e moralisht që zgjedhësit të kenë bindje për votën që do t'u japin dhe të jenë të qartë se, po të shkojnë ndonjëherë në gjyq, çështja do t'u zgjidhet me drejtësinë më të madhe, sepse atje punojnë njerëz që e kuptojnë mirë qëllimin e drejtësisë sonë socialiste, që nuk konsiston në marrjen e masave dhe në dhënien e dënimit, po në edu-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua raporti «Mbi lëvizjen dhe përbërjen e kuadrove të organeve të drejtësisë».

kimin e njerëzve për zbatimin e drejtë të vijës së Partisë.

Bindjen se në organet e drejtësisë ka njerëz pa njolla, të pakorruptueshëm, që e njohin dhe e zbatojnë drejt vijën e Partisë, duhet ta kenë jo vetëm ata që janë të pafajshëm dhe u qëllon të venë në gjyq, por edhe ata që janë fajtorë dhe luftojnë e bëjnë shumë dredhira dhe simulime. Punonjësit e drejtësisë duhet të kuptojnë dhe të përvetësojnë mirë vijën e Partisë në të gjitha drejtimet. Ata janë njerëz politikë, vija e Partisë nuk është një vijë e ngurtë, po e drejtë dhe elastike, e rreptë kundër armiqve, por edhe e mëshirshme për atë që rrethanat e detyruan të futej në një rrugë të gabuar e të shtrembër kundër pushtetit, ose në drejtimin ekonomik, ose kundër rregullave të shoqërisë sonë socialiste, pra gjyqtari duhet të jetë kurdoherë një aktivist, njeri politik.

Duhet gjithashtu të mbahet parasysh që ndihmësgjyqtari të jetë mundësisht edhe me një moshë të pjekur, se kështu do t'i zbatojë më mirë ato që theksova më lart. Fajet që bëhen kundër shtetit, ekonomisë etj., nuk janë të thjeshta, po çështje të komplikuar dhe njerëzit e pjekur dhe me një eksperiencë më të pasur dinë t'i gjykojnë më drejt. Gjykatësi mbështetet në ligjet e shtetit, të cilat njerëzit duhet t'i dinë, por gjyqtari duhet gjithashtu të jetë edhe ca i rrahur me jetën. Kjo presupozon që të mos jetë shumë i ri, sepse duke mos pasur eksperiencë në jetë, megjithëse ligjet mund t'i dijë, nuk do t'i zbatojë gjithnjë drejt në praktikë. Kjo duhet pasur parasysh edhe për gjykatësit që mbarojnë shkollat, të cilët, po të mos fitojnë një eksperiencë të madhe, mund

të bëjnë edhe gabime në punë. Të kesh mbaruar vetëm shkollë, të njohësh mirë ligjet dhe normat juridike, nuk do të thotë se mund të zgjidhësh çdo gjë drejt, se ka momente dhe rrethana që ligji të lejon ose të bësh lehtësira, ose të godasësh rëndë, po kjo varet nga gjyqtari si do ta interpretojë ligjin dhe interpretues i mirë i ligjit është ai që ka një eksperiencë të madhe, që di të bëjë mirë diferencimin e çështjeve.

Një mjek që është i ndershëm, tre vjet pas mbarimit të shkollës nuk lëshon recetë nga mendja, po mbështetet në kodekset. Po edhe këto nuk janë të gjitha. Ai, kur të viziton, të pyet për babanë, nënën, për sëmundjet e tyre dhe si kanë vdekur etj., etj., me qëllim që të njohë terrenin me kë ka të bëjë dhe pastaj t'i vërë gishtin plagës. Kështu duhet të bëjë edhe një gjyqtar i mirë me fajtorin që do të gjykojë. Ai duhet të interesohet për origjinën, për pakënaqësinë e për rrethin shoqëror të tij. Këto çështje sidomos kanë rëndësi të madhe për ndihmësgjyqtarët, që nuk janë edhe të përhershëm, sepse ndryshe është puna me ata që janë profesionistë, ata merren vazhdimisht me këtë punë dhe kanë mundësi të orientohen. Prandaj në zgjedhjen e ndihmësgjyqtarëve të kemi kujdes që të jenë njerëz politikisht e moralisht të pastër, sepse vetëm kështu ata do të ndihmojnë më mirë në marrjen e vendimeve.

Çështja e moshës ka rëndësi të madhe edhe për gjyqtarët profesionistë. Natyrisht, kjo që thashë është në përgjithësi, se ka edhe gjyqtarë të vjetër që bëjnë gabime dhe lëshime, nxjerrin të pafajshëm ose dënojnë lehtë njerëz të vërtetuar si armiq, sepse disa gjëra i kuptojnë gabim, dhe nuk i interpretojnë ligjet në

frymë të drejtë revolucionare. Ka nga këta gjykatës që kanë disa koncepte në lidhje me faktet dhe provat, dhe, duke u nisur nga disa çështje formale, u humbet nganjëherë sensi revolucionar i Partisë dhe bien në gabime. Në gjykimin e fajtorëve, në gjyq dhe në interpretimin e ligjeve duhet qëndruar kurdoherë në frymën revolucionare, ndryshe ligji nuk zbatohet si duhet në një vend socialist.

Ka momente të rrezikshme, ka momente revolucionare, por asnjëherë nuk duhen shkelur normat në fuqi, nuk duhen bërë lëshime. Kur vjedhjet në një rreth thuajse janë zhdukur, atëherë përse të dënosh rëndë një vjedhës që s'ka bërë ndonjë dëm të madh, por kur sheh se vjedhja në një rreth ose në një organizatë ekonomike është bërë një sëmundje e rrezikshme dhe po përhapet, atëherë duhet të bëhet goditje e fortë që të shkunden njerëzit që kanë prirje për veprime të tilla. Ose në një moment të vështirë, kur të tëra agjencitë e armiqve punojnë në mënyrë të shfrenuar kundër pushtetit, të mos e dënosh me vdekje një agjent kundër të cilit ke fakte, por t'i japësh pafajësi, nuk është e drejtë, se ligji ka dhënë marzhe të gjera që nga dënimi ekstrem e gjer në dënimin më të vogël, prandaj duhet gjykuar drejt sipas ligjit. Çdo qëndrim tjetër është në kundërshtim me faktet, edhe me frymën e ligjeve. Kjo është e palejueshme për një gjyqtar.

Ka ndonjë që mendon se gjykata është e pavarur. Por këtë pavarësi duhet ta kuptojmë drejt. Gjykatësi ka pavarësi nga pikëpamja që në punët e tij nuk duhet të ndërhyjnë të tjerët, por ai s'është i pavarur nga klasa, interesat e së cilës shpreh dhe mbron. Gjykatësi e merr

në pyetje të pandehurin, dëgjon mendimin e prokurorit dhe të avokatit dhe vendos vetë në mënyrë të pavarur, por ai në dhënien e vendimit duhet të dijë se përfaqëson dhe mbron interesat e klasës në fuqi. Te ne nuk mund të ketë pavarësi nga politika e Partisë dhe nga populli. Gjykatësi ynë një pavarësi të tillë nuk mund ta ketë se ai është i lidhur ngushtë me jetën shoqërore, politike dhe ekonomike të pushtetit tonë, se dënimet që japin gjykatat kanë karakter edukativ. E gjithë puna që bën Partia jonë ka karakter edukativ, ka për qëllim të pastrojë e të ngrejë ndërgjegjen e njerëzve nga pikëpamja politike dhe ideologjike. Prandaj bëhen konferenca politike, kulturore, ekonomike, ku demaskohen bashkë me imperialistët e revizionistët, edhe vjedhësit, keqbërësit etj., me qëllim që të kalitim njeriun e ri dhe të largojmë disa njerëz nga rruga e keqe. Prandaj edhe në gjyq, gjyqtari ynë duhet të ketë kurdoherë parasysh vijën e Partisë, frymën e saj revolucionare.

Natyrisht, gjykatësi është i lirë të japë mendimin e tij, po ka njerëz që këtë parim e kuptojnë në mënyrë automatike dhe thonë: Mirë gjykatësi e jep vendimin, po unë që jam sekretar i komitetit të Partisë nuk kam të drejtë që, përpara se trupi gjykues të marrë vendim, ta këshilloj dhe t'i them ç'mendoj për këtë çështje? Edhe drejtorët e ndërmarrjeve bëjnë konsulta me njëri-tjetrin, sepse e ndiejnë nevojën e ndihmës, po në zgjidhjen e çështjeve të drejtësisë, që janë më të vështira, a nuk ka nevojë për konsultime? Sigurisht, konsultime mund të bëhen edhe në gjykatë, që vendimi të jetë kurdoherë i drejtë, por tjetër është të konsulto-

hesh, tjetër është të ndërhysh, të influencosh, që vendimi të jetë më i rreptë ose më i butë. Qëndrime të tilla nuk janë të drejta. Sigurisht ty nuk të ndalon njeri të vendosësh sipas pikëpamjes tënde, por, kur vendimi nuk është i drejtë, ka të tjerë që e prishin ose e ndryshojnë se ka organe më të larta gjyqësore. Prandaj, që të mos ta prishin një vendim nga lart, ti i ke të gjitha mundësitë në rreth që të konsultohesh me shokët e kë-tushëm dhe të vendosësh si mendon, të vendosësh me ndërgjegjen tënde. Por, gjykatësin duhet ta vrasë ndërgjegjja, kur s'vendos në rrugë të drejtë.

Pra çështja e gjyqtarëve ka rëndësi të veçantë. Kjo nuk do të thotë që të gjithë të jenë anëtarë partie, gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët mund të jenë edhe njerëz pa parti. Prandaj edhe këtë ta keni parasysh.

Edhe ju, shokë gjyqtarë, që jeni profesionistë, duhet t'i keni parasysh mësimet e Partisë. Është gjë e madhe për Partinë dhe për ju që e keni kryer shkollën e lartë përkatëse, po mos harroni se ne kemi edhe gjyqtarë me eksperiencë, që janë aktivistë të dalluar të Partisë e kanë edhe funksione të tjera. Tani ne kemi një bazë të shëndoshë kuadrosh në organet e drejtësisë, po nga ato të meta që përmenda, duhet ruajtur, dhe këtë nuk e them vetëm për ju gjyqtarët, po për çdo kuadër. Të mos na rritet mendja se kemi fituar një diplomë dhe mund të zgjidhim lehtë çdo çështje. Natyrisht, të mbarosh shkollën është një punë shumë e vlefshme dhe me rëndësi të madhe dhe Partia lufton që njerëzit të marrin sa më shumë kulturë, po kjo të shfrytëzohet mirë dhe të bazohet në vijën e Partisë e të kombinohet me eksperiencën e popullit.

Gjyqtari, qoftë burrë ose grua, duhet të jetë njeri që të gëzojë besimin e masës, që, kur tjetri ka një hall, edhe në familjen e tij të shkojë dhe të flasë lirisht. Kjo do të lehtësojë edhe punën e gjyqtarit për të marrë një vendim të drejtë ndaj fajtorit dhe ta interpretojë drejt ligjin se, një vendim i dhënë drejt, bën një efekt të madh pozitiv jo vetëm te fajtori, po edhe te të tjerët, kurse një vendim i dhënë me hatër, me gjaknxehësi etj., do të bëjë efektin e kundërt.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**KOMUNISTËT JANË KURDOHERË SË BASHKU  
ME POPULLIN SI NË KOHË TË MIRA  
DHE NË KOHË TË VËSHTIRA**

*Nga fjala me punonjësit e Fabrikës së Cigareve dhe të  
Uzinës së Fermentimit të Duhanit në Shkodër*

**15 janar 1962**

Ju dëgjuat se, përpara se të flasë, drejtori iu drejtua shoqeve, pastaj shokëve. Shikoni si kanë ndryshuar kohët! Në të kaluarën gratë nuk i përfillte njeri, kurse tani ato vlerësohen lart. Prandaj edhe drejtori nuk i zuri ato në gojë në fillim për t'u bërë qejfin, po se tani gruaja ka dalë në një radhë me burrin. Veçanërisht drejtori bëri mirë që zuri më parë në gojë shoqet se zotër në këtë fabrikë dhe në uzinën e fermentimit jeni ju, gratë. Me këtë rast dëshiroj t'ju përshëndes nga zemra për punën e mirë që keni bërë e jeni duke bërë me një vrull të madh patriotik, për të mirën e atdheut, për të mirën tuaj personale dhe të fëmijëve tuaj!

Të gjithë ne, shokët e udhëheqjes, kur vijmë këtu në Shkodër ndiejmë një kënaqësi të veçantë dhe një gëzim të madh, sepse midis jush gjejmë një ambient



shumë të ngrohtë dhe të dashur. Kjo vjen se populli i rrethit dhe i qytetit të Shkodrës, ashtu si i gjithë populli shqiptar, është i dashur, patriot, përparimtar dhe i lidhur me Partinë. Shkodra është një ndër qytetet më të rëndësishme, më të përparuara e më të kulturuara të vendit tonë. Në Shkodër Partia ka zhvilluar vazhdimisht industrinë, sepse te ju njerëzit kanë qenë zanatçinj përparimtarë, nga duart e të cilëve prodhoheshin artikuj të çmueshëm. Në Shkodër ka pasur tradita të larta në fushën e kulturës, në të gjitha aspektet. Prandaj pushteti popullor i zhvilloi ato më tej me një lehtësi të madhe, se vetë populli është i etshëm për kulturë e arsim dhe e përqafoi shpejt vijën e Partisë.

Në Shkodër ka institucione të ndryshme kulturore. Ju, shkodranët, përsa u përket artit, muzikës, teatrit etj., u bëni një konkurrencë të fortë, jo vetëm qyteteve të tjera po edhe Tiranës. Edhe ndërtesën e teatrit e keni të bukur, keni aktorë dhe muzikantë me talent, si edhe njerëz të zotë në frontet e tjera të kulturës. Përveç këtyre tani Shkodra është mbushur me shkolla fillore, me 7-vjeçare, ka gjimnaze, pedagogjike dhe një institut pedagogjik dyvjeçar që nxjerr çdo vit mësues.

Unë personalisht kam ardhur vazhdimisht në Shkodër dhe fytyrat e njerëzve i shoh çdo herë më të qeshura. Kjo vjen nga përmirësimi i gjendjes suaj dhe siguria që keni për të ardhshmen, se shihni që Partia e Punës qëndron e fortë si çeliku dhe udhëheq popullin drejt lumturisë dhe begatisë, jo me fjalë po me vepra. Këto vepra ju i shijoni çdo ditë, si në përmirësimin e jetës ekonomike, ashtu edhe në zhvillimin

e arsimit e të kulturës. Pikërisht për këto qëllime luftuam dhe derdhëm gjak, për këto qëllime sot derdhim djersën dhe mbrojmë atdheun nga çdo rrezik.

Detyra kryesore e Partisë ka qenë dhe është të ruajë pavarësinë, sovranitetin dhe paprekshmërinë e kufijve të atdheut dhe në këto toka që na lanë të parët, të vaditura në shekuj me gjak dhe me djersë, të ngrihet një jetë e lumtur, e begatshme dhe paqësore, për popullin tonë trim, punëtor e paqedashës, sepse ai e meriton një gjë të tillë. Ky ka qenë, është dhe do të jetë qëllimi i Partisë. Për të gjitha përparimet që ka arritur vendi ynë, duhet të themi se populli i qytetit dhe i gjithë rrethit të Shkodrës ka dhënë e po jep një kontribut të shquar.

Ju zini një vend të rëndësishëm në ekonominë e Shqipërisë dhe në zhvillimin e kulturës në vendin tonë dhe, me gjithë vështirësitë që kanë pasur fabrikat tua-ja, që rrjedhin nga kushtet jo të mira atmosferike, sidomos nga shirat e përmbytjet e mëdha, ju keni bërë mjaft punë. Por do të vijë dita që edhe pengesat e kohës do të evitohen, sepse me miliarda ka investuar shteti në këtë drejtim. Ja gjer tani janë bërë punime të mëdha për sistemimin e Myzeqesë. Punimet në këtë zonë do të mbarojnë për disa vjet, pastaj forcat do të hidhen këtej nga Veriu, sidomos nga Shkodra, e cila më në fund ka për të shpëtuar nga përmbytjet e lumenjve e do të bëhet një vend i lulëzuar.

Sidoqoftë, me gjithë vështirësitë e natyrës, rrethi i Shkodrës i ka realizuar me nder detyrat e planit si në industri, ashtu edhe në bujqësi. Natyrisht gjatë punës janë dukur edhe të meta po këtu flas në përgjithësi.

Në sektorin e industrisë, ku bën pjesë edhe artizanati, mund të themi me kënaqësi se ju keni ecur mirë.

Edhe në sektorin e bujqësisë rrethi i Shkodrës ka punuar shumë mirë dhe nga sa e kam parë këtë e nga sa më kanë raportuar shokët, që kanë ardhur e kanë kontrolluar rrethin tuaj, mund të them se punimet që janë bërë në Shkodër në sektorët e bujqësisë, qëndrojnë në një nivel të mirë. Në Byronë Politike të Komitetit Qendror na kanë informuar se Shkodra ka bërë një punë jashtëzakonisht të madhe, gjë që provon se fshatarësia kooperativiste e rrethit tuaj ka ecur dhe po ecën përpara.

Vetëm vitin që shkoi kemi pasur një fatkeqësi që ju ka prekur ju, punëtorët e duhanit, si dhe financat e shtetit tonë. Duhanin e goditi sëmundja e vrugut, nga e cila u dëmtua ekonomikisht fshatarësia dhe vetë shteti. Po s'kemi ç'bëjmë, edhe këtë vështirësi do ta kapërcejmë si shumë të tjera. Humbjen në radhë të parë e patën kooperativistët, po ata nuk u dëshpëruan. Ata kishin punuar mirë për duhanin, por njëkohësisht kishin punuar edhe për zhvillimin e sektorëve të tjerë. Kjo bëri që të mos mbeteshin pa të ardhura, megjithatë, arritën të merrnin nga 80-100 e gjer në 120 lekë për ditë-punë. Ky nuk është një rezultat i keq, duke marrë parasysh se kemi edhe kooperativa të tjera që, megjithëse nuk kanë pësuar gjë nga kjo fatkeqësi, nuk kanë mundur të sigurojnë dot kaq të ardhura. Sidoqoftë gjendja ekonomike e kooperativistëve të Shkodrës për këtë vit u vështirësua, po shteti ua lehtësoi këtë duke u ardhur në ndihmë me kredi.

Natyrisht nga kjo fatkeqësi pësuan edhe xhepat

tuaj. Pyeta shokët e këtushëm se si e pritën gratë punëtoresh të duhanit uljen e orëve të punës, po ata më thanë se gratë punëtoresh e kanë kuptuar drejt këtë situatë dhe ato kanë shprehur me këtë rast një patriotizëm të lartë dhe unitet të madh e të shëndoshë ndaj Partisë dhe Qeverisë ashtu si edhe kooperativistët. Shokët drejtues të Partisë dhe të pushtetit në rrethin e Shkodrës, të cilët i preokupon çështja e jetës së popullit, kanë marrë masa që vështirësitë e shkaktuara nga forca madhore të natyrës të kapërcehen dhe punëtorët e duhanit të mos rëndohen shumë.

Por gjëra të papritura ngjasin në jetën e njerëzve dhe në atë të shtetit. Ndodh një fatkeqësi në familje ose një dasmë dhe detyrohesh të bësh shpenzime, prandaj familja detyrohet të bëjë ekonomi gjersa të normalizojë situatën. Kështu ngjau edhe në jetën e vendit tonë vitin e kaluar me sëmundjen e vrugut që na dëmtoi mjaft, po jemi të sigurt se këtë vit kjo sëmundje nuk do të na dëmtojë, sepse Partia po merr masa kundër saj. Sot na thanë shokët se kooperativa e Grizhës, që vjet pati disa milion lekë humbje, ka marrë masa të plota kundër sëmundjes së vrugut. Por kjo eksperiencë duhet të përgjithësohet në të gjitha kooperativat bujqësore që kultivojnë duhanin, gjë që ju intereson edhe juve, shokë punëtorë të kësaj fabrike e uzine. Prandaj kërkoni nga propagandistët dhe agjitorët e Partisë që të punojnë për zbatimin e vendimeve që janë marrë. Por edhe ju vetë në çdo takim që keni me prodhuesit e duhanit u rriini atyre mbi kokë, kërkoni të bëjnë pastrimin e tokës duhanore, bërjen e saj qilizmë, djegien e kallamishteve të duhanit etj. Ju të jeni nga

propagandistët dhe agjitorët më të mirë të këtyre masave, sepse jeta juaj është lidhur me prodhuesit e duhanit.

Përveç punës që do të bëni ju, dhe në radhë të parë vetë kooperativistët, shteti ka marrë masa për të sjellë pesticide për luftimin e sëmundjeve të duhanit, porsa të diktohen. Prandaj për këtë vit shpresat janë të mëdha, se, me masat e marra dhe me punën që do të bëhet, sëmundjet e duhanit do të evitohen.

Po të mos i kishte rënë vrugu duhanit, plani edhe në Shkodër do të ishte tejkaluar, pra do të ishin realizuar zotimet e marra. Sidoqoftë plani i përgjithshëm në rrethin e Shkodrës është tejkaluar, prandaj Komiteti Qendror përgëzon klasën punëtore dhe gjithë punonjësit e rrethit të Shkodrës për përparimet që kanë arritur, të cilat kanë kontribuar që të përmirësohet jeta e popullit tonë.

Në vendin tonë punët shkojnë mirë. Situata e brendshme është e fortë si çeliku. Kjo ka rëndësi të madhe. Partia jonë e ka zakon ta thotë realitetin ashtu siç është. Edhe kur ka vështirësi, ajo ia thotë popullit. Vështirësitë i fsheh vetëm ai që ka frikë, kurse komunistët nuk kanë frikë. Të mirat dhe hidhërimet komunistët i ndajnë me popullin dhe çështja e situatës nuk është një çështje që u përket vetëm disave, po është një çështje jetike e gjithë popullit.

Të gjithë për të mirën luftojmë dhe punojmë, po kur vjen një fatkeqësi, atëherë i duhet qëndruar ballë për ballë për ta kapërcyer. Pra situata në vendin tonë është e mirë dhe e fortë. Kjo vjen se në krye qëndron

Partia jonë marksiste-leniniste, që punon ditë e natë për popullin, për të mirën dhe lumturinë e tij. Por ka në botë edhe nga ata komunistë që përsëritin se punojnë për popullin, por që në fakt asgjë nuk bëjnë për të. Po fjalët i merr era, në qoftë se ato nuk shoqërohen me vepra. Vënia në zbatim e atyre që thua është prova më e mirë për të treguar se një komunist ose një parti është marksiste-leniniste. Në qoftë se vija ose politika e Partisë është marksiste-leniniste, kjo duhet provuar në jetë. Dhe Partia jonë këto prova i ka dhënë dje në luftë dhe sot pas Çlirimit. Nuk ka njeri që të thotë se ato që ka premtuar Partia, nuk janë vënë në jetë, çdo gjë që ka thënë ajo, është realizuar. Natyrisht veprat e mëdha të socializmit janë ndërtuar me djersën e popullit, me përpjekje dhe me luftë. Kështu na mëson marksizëm-leninizmi, asgjë nuk bie nga qielli, çdo gjë bëhet me mendjen dhe krahun e punëtorit dhe të fshatarit. Dhe kur puna e tyre udhëhiqet në rrugë të drejtë nga një Parti si jona, atëherë sukseset dhe përparimet janë të mëdha.

Kështu ka ndodhur edhe në vendin tonë. Tani fabrikat dhe uzinat, ndërmarrjet ekonomike, minierat etj., janë shtuar shumë, fushat janë zbukuruar, mocalet janë tharë e janë ndërtuar vepra e kanale ujitëse, u hapën me mijëra shkolla gjer te institutet e larta dhe universiteti. Kjo ka bërë që ne tani të kemi jo vetëm kuadro të mesëm me shumicë, po dhe me mijëra kuadro të lartë. Dhe të gjitha këto Partia i ka bërë që jeta e popullit të përmirësohet dhe ajo është përmirësuar.

Të mos shikojmë vetëm ç'është bërë 3-4 vjet më parë

te ne, po t'ë shohim ç'u bë vitin që kaloi. Viti 1961 nuk ishte një vit i mbarë për bujqësinë, për arsye se nga thatësira drithërat nuk u realizuan sipas parashikimit. Pra, me gjithë vështirësitë politike dhe ekonomike që na u shkaktuan nga grupi i N. Hrushovit, me gjithë kushtet e vështira të rrethimit imperialisto-revizionist, u pa fare qartë se jeta e popullit tonë në vitin 1961 ishte më e mirë se në vitin 1960. Dyqanet ishin dhe janë plot. Askujt nuk i mungoi buka, jo vetëm qytetarëve, po as malësorëve që nuk prodhojnë sasi drithi të mjaftueshme. Populli e ka të siguruar bukën dhe në treg nuk mungojnë mishi, gjalpi, sheqeri, vezët, frutat apo zarzavatet. Tregu është gjithashtu plot me mallra industriale të prodhuara në vend dhe të ardhura nga jashtë. Kjo ndodh se Qeveria jonë është një qeveri e popullit, që udhëhiqet nga Partia dhe që di të ekonomizojë si duhet pasurinë e popullit, që di ta ruajë dhe ta shfrytëzojë si duhet vetëm për interesat e tij.

Një situatë e tillë e mirë ekonomike nuk mund të ndodhë në vende ku s'është populli në fuqi. Kështu jo vetëm në vendet kapitaliste, ku ka miliona të papunë, që nuk dinë si do ta ngrysin ditën, po edhe në vendet revizioniste të Evropës Lindore popullit i kanë munguar shumë gjëra.

Në çështjet politike ju e dini se vija politike e Partisë sonë ka qenë dhe është e drejtë, një vijë marksiste-leniniste. Vendi ynë është një shtet socialist. Te ne në fuqi është klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste, të drejtuar nga Partia. Socializmit i përket e ardhshmja. Kapitalizmi do të varroset edhe në ato vende ku ai sundon akoma. Klasa punëtore, me flamur-

rin e marksizëm-leninizmit, lufton për përmbysjen e kapitalizmit. Ne duhet të ndihmojmë popujt dhe proletariatin e atyre vendeve që akoma vuajnë nën zgjedhën e shtypjes e të shfrytëzimit për shkatërrimin e imperializmit. Në botë ekziston një luftë e papajtueshme midis proletariatit e kapitalizmit, për të cilën Marks i dhe Lenini na kanë mësuar që ta bëjmë pa u trembur, duke u interesuar dhe për çlirimin e popujve të tjerë, që vuajnë nën shtypjen kapitaliste.

Tani të gjithë popujt e botës duan të rrojnë të lirë dhe në paqe. I tillë është edhe populli ynë, i cili e urren luftën grabitqare, sepse e di që kjo asgjë të mirë nuk u sjell njerëzve. Ne duam që luftë të mos ketë, por për ta bërë realitet këtë dëshirë, njerëzit, grupet, klasat dhe shtetet që duan luftë kundër popujve duhet t'i vëmë në pamundësi që ta shpërthejnë.

Po paqja nuk vjen me fjalë. Partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe komunistët e të gjitha vendeve duhet të jenë ata që të luftojnë konkretisht për paqe, për ta fituar atë, të luftojnë që popujt të mos e presin paqen nga askush, po ta sigurojnë me luftën dhe vendosmërinë e tyre, që popujt të luftojnë për paqen ashtu si shumë të tjerë që fituan lirinë. Ashtu sikurse lirinë neve nuk na e dha njeri, ashtu edhe paqen nuk ta fal kush. Luftën e duan kapitalistët, se e shohin që po u afron vdekja. Vetëm me anë të luftës ata shpresojnë të shpëtojnë pasurinë e tyre.

Në botën kapitaliste borgjezia pasurohet duke shfrytëzuar proletariatin. Prandaj punëtorët kanë plotësisht të drejtë të luftojnë dhe t'u rrëmbejnë pasurinë nga duart atyre që s'punojnë, por vetëm shfrytëzojnë.



Kjo i bën kapitalistët të kenë shumë frikë prej punëtorëve, të kenë frikë marksizëm-leninizmin, se popujt, me klasën punëtore në krye, luftojnë dhe po i përgatitin dita-ditës varrin imperializmit, prandaj edhe ky lufton të bëjë të padëmshëm valën revolucionare që ngrihet vazhdimisht. Përpara kësaj vale imperializmi po armatohet që t'u kundërvihet klasës punëtore të vendeve të tyre, si edhe socializmit, që është armiku kryesor i tij.

Në këto kushte, kur imperialistët përgatiten për të luftuar kundër vendeve socialiste dhe klasës punëtore, duhet luftuar që imperialistëve t'u lidhen duart. Popujt nuk duhen gënjer me llafe, nuk duhen vënë në gjumë, atyre u duhet thënë nga vjen rreziku, që të jenë të përgatitur ta përballojnë atë, të jenë vigjilentë dhe të punojnë për ta evituar këtë rrezik. Ndryshe në rrugën tonë mbijnë barëra të egra, në radhët tona futet revizionizmi dhe bën diversione për të na hedhur në erë, për të na përçarë e për të na dobësuar, kështu që imperializmi të na futë lehtë thikën.

Rruga që ndjek Shqipëria nën udhëheqjen e Partisë është marksiste. Por ka vende që nuk ndodh kështu. Të marrim Jugosllavinë. Dihet se në këtë vend në fuqi është klika revizioniste e Titos, e cila është vënë në shërbim të plotë të imperializmit amerikan dhe i shërben atij, në kundërshtim me interesat e popujve të Jugosllavisë dhe të çështjes së madhe të komunizmit. Po të mos e demaskosh këtë klikë, nuk duhet ta quash veten marksist-leninist. Revizionistët jugosllavë ne duhet t'i demaskojmë vazhdimisht, ashtu siç bëjmë edhe për imperializmin.

*Pasi foli për disa probleme të zhvillimit botëror,*

*si problemi i çarmatimit, i bashkëkzistencës paqësore etj., për veprimet revizioniste të Hrushovit në Mbledhjen e Bukureshtit e të Moskës të vitit 1960, për sulmet e tij nga tribuna e Kongresit 22 të PK të BS kundër Shqipërisë dhe vijës së drejtë të Partisë sonë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, shoku Enver Hoxha tha:*

Veprimtarinë armiqësore kundër vendit tonë N. Hrushovi e zhvillonte për të vështirësuar gjendjen ekonomike dhe për të rrëzuar udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit tonë, për të sjellë në vend të saj një udhëheqje të re në shërbim të tij.

N. Hrushovi u përpoq të krijonte një front unik kundër PPSH, sepse ajo u bë një rrezik i madh për të, prandaj lëshoi zjarrin nga të katër anët kundër Shqipërisë. Po Shqipëria qëndron e patundur. Qëndrimi i drejtë dhe burrëror i PPSH ka bërë që edhe miqtë e ngushtë të N. Hrushovit të përçahen.

Duke gjykuar drejt nga pozitat marksiste-leniniste, shumë komunistë dhe njerëz të ndershëm në botë tani thonë se në këtë rast drejtësia qëndron në anën e PPSH. Ata mendojnë se shqiptarët kanë të drejtë që kanë mbajtur këtë qëndrim, duke dalë në kundërshtim të hapur me rrugën e N. Hrushovit. Nuk është e drejtë të thuhet që, meqenëse N. Hrushovi është udhëheqës i shtetit të madh sovjetik dhe i PK të BS, me domos duhet t'i shkojmë pas qorrazi edhe kur ai nuk vepron mirë, siç thonë udhëheqësit bullgarë. Ne dimë dhe dallojmë se N. Hrushovi nuk është Bashkimi Sovjetik dhe jemi të bindur se atje ka rezistencë kundër rrugës së tij. Populli ynë e sheh me besim të ardhsh-

men e tij dhe lufton me vendosmëri, sipas porosisë së Partisë, kundër revizionizmit dhe është i sigurt se ky do të shkatërrohet, sepse jemi në rrugë të drejtë.

Armiqtë e popullit shqiptar e kuptojnë mirë se, kështu si është zhvilluar situata, Shqipëria nuk është e vetme dhe po të cenohet pavarësia e saj jo vetëm që vetë populli shqiptar është i fortë dhe i vendosur për mbrojtjen e atdheut të tij, po në një rast të tillë çështja shqiptare do të bëhej një problem i madh ndërkomëtar. Kjo do të shkaktonte një katastrofë të madhe për ta dhe për miqtë e tyre të hapët ose të fshehtë.

Situata e vendit tonë është e mirë, se kemi një popull të guximshëm dhe një Parti heroike, se Republika jonë Popullore është e fortë, se me ne janë shumica e komunistëve dhe popujt. Të gjithë këta faktorë na bëjnë të fortë. Prandaj punët tona shkojnë mirë dhe gjendja e brendshme dhe e jashtme e Shqipërisë është shumë e mirë. Ata që na sulmojnë ne, janë demaskuar dhe nesër do të demaskohen edhe më shumë. Kjo do të ndihmojë që të bëhemi edhe më të çeliktë, kështu që akoma më shumë do të gëzojmë respektin dhe simpatinë e gjithë komunistëve dhe popujve të botës.

Partia jonë, me vijën e drejtë të saj, ka bërë që ta duan e ta respektojnë të gjitha masat punonjëse. Anëtarët e PPSH, pavarësisht se janë në ballë të luftës, janë dhe do të jenë kurdoherë të thjeshtë, organizatorë të zgjuar e të vendosur të punës. Sa më shumë që ata të japin për çështjen e socializmit dhe të popullit, aq më tepër duhet ta mbajnë kokën ulur. Të gjitha këto suksese që u arritën në vendin tonë nuk duhet

t'ua kushtojmë një, dy, pesë ose njëqind njerëzve, ato u arritën nga përpjekjet e popullit dhe e të gjithë anëtarëve të Partisë sonë. Sado të zotë e të mësuar të jenë dy-tre vetë, ata s'mund të bëjnë dot shumë punë. Le të jetë i zoti dhe i mësuar sa të dojë drejtori, nuk e bën vetëm ai punën. Ju që bëni këtu gjithë këto punë të bukura, jepni pjesën më të madhe të kontributit. Prandaj komunistët do të jenë kurdoherë së bashku me popullin si në kohë të mira ashtu edhe në kohë të vështira dhe kështu të bashkuar kurdoherë do të fitojnë. Komunistët kurdoherë të jenë kokulur, sepse modestia është një nga karakteristikat e Partisë sonë.

Prandaj, me besim të patundur te Partia dhe në vijën e saj të drejtë, të forcojmë unitetin rreth Partisë, të forcojmë vigjilencën revolucionare aq të nevojshme në këto momente, kur çdo njeri duhet të mbajë sytë hapur, po jo të shihet çdo gjë si armiqësore. Vigjilenca të mprehet dhe të drejtohet atje ku është armiku. Njerëzit gabojnë, mund të thonë edhe ndonjë fjalë, prandaj ata që janë të ndershëm dhe patriotë duhet ta kuptojnë drejt këtë gjë dhe të përpiqen ta ndreqin atë që ka gabuar. Armiku përpiqet si e si t'i komprometojë njerëzit dhe t'i futë në rrugën e tij, kurse ne çdo njeri duhet ta lidhim fort me rrugën e Partisë që ndjek i gjithë populli. Momentet për punën e Partisë dhe për veprimtarinë e çdo patrioti janë shumë të favorshme që armikut të mos i lëmë asnjë njeri, qoftë edhe të lëkundur, të shkojë me të. Edhe një njeri i tillë e do atdheun, po është ca i çoroditur. Atëherë është detyra jonë ta sjellim në rrugë të drejtë. Po ta mbushë kupën, atëherë fajin nuk ia ka njeri, sepse Partia nuk

mund të sakrifikojë interesat e popullit dhe të sajat për hatrin e njërit dhe të tjetrit.

Veçanërisht ju punonjësit e Shkodrës që keni tre-guar kurdoherë një frymë të lartë patriotike, keni meritën e madhe që planin e keni realizuar, me gjithë vështirësitë që keni pasur, megjithëse fare afër keni revizionistët jugosllavë, që nuk i kanë hedhur armët në luftën e tyre kundër Shqipërisë. Por populli i qytetit të Shkodrës dhe i malësisë, nën udhëheqjen e organizatave-bazë të Partisë dhe në bashkëpunim me organet e Sigurimit të Shtetit, kanë punuar që situata politike në rrethin tuaj të jetë e shëndoshë. Te ju ka qetësi, pavarësisht se revizionistët jugosllavë kanë dërguar me dhjetëra spiunë e diversantë, të cilët janë kapur nga populli i rrethit tuaj dhe nga forcat e Sigurimit të Shtetit, që kanë qëndruar kurdoherë vigjilente në luftën kundër armiqve.

Situatat që na janë krijuar nga armiqtë, ne do t'i kapërcejmë. Planin ne do ta realizojmë, sepse për këtë qëllim është siguruar çdo gjë. Këtë pesëvjeçar do të ngremë dy uzina të mëdha për prodhimin e plehrave kimike, por pavarësisht nga kjo edhe në sektorin e bujqësisë ne do të ecim përpara nga viti në vit, dhe jemi të bindur se viti 1962 do të jetë më i mirë se viti 1961 dhe viti 1963 më i mirë se viti 1962. Me siguri, kur të fillojnë nga prodhimi uzinat e plehrave kimike, bujqësia jonë do të ecë më përpara dhe atëherë ajo do t'i dyfishojë prodhimet, sepse fushat tona do të ngopen me sasirat e nevojshme të plehut dhe jo si tani. Gjer atëherë ato gjithashtu do të jenë më të sistemuara, sipërfaqe më të mëdha toke do të ujiten, shpresojmë afër

50 për qind të të gjithë sipërfaqes së punueshme në vendin tonë. Atëherë ne do të kemi edhe mundësi të tjera, minierat tona do të na japin minerale dhe të ardhura më të shumta, industria do të prodhojë edhe më tepër se tani, kështu që krijohen mundësi për t'i dhënë një ndihmë më të madhe edhe bujqësisë.

Çdo gjë ne do ta ndërtojmë me duart tona. Në këtë luftë ne kemi dhe ndihmën vëllazërore të vendeve mike, në radhë të parë të RP të Kinës. Po faktori vendimtar i jetës së lumtur të popullit tonë janë dhe do të jenë Partia e Punës dhe populli shqiptar. Këta do të bëjnë, me zotësinë dhe eksperiencën e tyre, që planet tona të realizohen me sukses.

Ju uroj shëndet juve, fëmijëve, nënave, vëllezërve dhe motrave tuaja dhe suksese në punë!

Të rrojë populli patriot i rrethit të Shkodrës!  
Rrofshin punëtorët dhe punëtorët tanë!  
Rroftë Partia jonë heroike e Punës!

*Botohet për herë të parë, me  
disa shkurtime, sipas origjinalit  
që gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## PA ÇIMENTO NDËRTIMET TONA S'KANË «BUKË»

*Nga fjala me punëtorët e Fabrikës së Çimentos  
në Shkodër*

16 janar 1962

Të dashur shokë punëtorë të Fabrikës së Çimentos,

Ju falënderoj shumë për dashurinë dhe besnikërinë që ushqeni ndaj Partisë sonë të shtrenjtë! Partia jonë, duke pasur rreth saj një klasë punëtore të tillë heroike, të ndërgjegjshme dhe të vendosur për të ecur përpara, nuk ka asnjë dyshim që, ashtu sikurse i ka kryer gjer më sot detyrat e veta ndaj popullit, atdheut dhe socializmit, ashtu do t'i kryejë me nder edhe në të ardhshmen, sado të rënda dhe të vështira që të jenë ato.

Planet që ka realizuar populli ynë, klasa jonë punëtore, ju, shokë punëtorë, me duart, zotësinë dhe forcat tuaja të mendjes dhe të krahut, tani kanë filluar të japin frytet e tyre që sot i gëzon mbarë populli ynë.

Edhe ju, kolektivi i Fabrikës së Çimentos të qytetit të Shkodrës, që mban emrin e Heroit të Popullit tonë, komunistit Vaso Kadija, jeni pionierë të ndërti-

mit të socializmit në vendin tonë. Ju keni prodhuar qysh në ditët e para pas Çlirimit tonët e parë të çimentos, aq e nevojshme për rindërtimin e atdheut. Unë nuk dua të flas këtu për periudhën para Çlirimit, kur punëtorët e kësaj fabrike shfrytëzoheshin nga pronari i saj. Por pas Çlirimit ju e bëtë këtë fabrikë pronë të të gjithë popullit, iu përveshët punës pa u kursyer dhe i dhatë popullit dhe atdheut çimento. Ju ishit të vetmit dhe të parët që prodhoni nga ky lloj artikulli. Pushteti i ri popullor atëherë priste shumë nga ju, sepse të ardhurat shtetërore në fillim ishin thuajse zero, financat ishin bosh, ndërsa vendi, i shkatërruar nga pushtuesit dhe tradhtarët shqiptarë, duhej rindërtuar. Duke kuptuar mirë gjendjen, me punën tuaj të lavdërueshme, menjëherë pas Çlirimit, ju u dhatë ndërmarrjeve të ndërtimit «bukën», për të cilën kishin aq shumë nevojë, pra i dhatë çimenton. Ashtu siç ka njeriu nevojë të përditshme për bukë, ashtu edhe shoqëria socialiste ka dhe kurdoherë do të ketë nevojë për lëndë ndërtimi, e në radhë të parë për çimento. Pa çimento ndërtimet tona s'kanë «bukë».

Çimentoja që keni prodhuar ju gjatë këtyre 16-17 vjetëve, ka hyrë thuajse në të gjitha veprat, të vogla e të mëdha, që janë ngritur pas Çlirimit kudo në Shqipëri. Që nga fabrikat e hidrocentralet e gjer te shkollat e ambulancat e fshatrave është derdhur çimentoja që keni prodhuar ju, atje, pra, është derdhur zotësia, energjia dhe vendosmëria juaj. Ju keni të drejtë të mburreni për këtë gjë, gjithashtu edhe ne jemi kryelartë për Fabrikën tuaj të Çimentos, e cila në krahasim me atë të Vlorës është më e vogël, kurse në



të ardhshmen, kur do të ngremë të tjera më të mëdha, do të na duket akoma më e vogël. Sidoqoftë vlera e kësaj fabrike, ku ju punoni, është dhe do të mbetet e madhe për kontributin e vlefshëm që ka dhënë atëherë kur ekonomia popullore kishte nevojë të madhe për çimento.

Është gjithashtu e qartë se ashtu si i gjithë populli ynë edhe ju jeni të gëzuar kur morët vesh se do të ngrihen fabrika të tjera çimentoje në vendin tonë. Po përveç fabrikave të mëdha që do të ngrihen, sipas planit, me iniciativën e punonjësve, sidomos të punëtorëve, të teknikëve e të inxhinierëve të fabrikës suaj dhe asaj të Vlorës, në Tiranë tani është duke u ndërtuar një fabrikë e vogël që besojmë të përfundojë këtë tremujor. Të tilla fabrika të vogla ne mendojmë të ngremë edhe disa të tjera shpejt e shpejt, sepse forcat dhe mundësitë tani i kemi, kurse më parë një gjë e tillë ishte e vështirë.

Por, edhe pasi t'i ngremë këto fabrika, përsëri ne do të themi se prodhimi i çimentos te ne nuk mjafton. Objektet e mëdha e të shumta të pesëvjeçarit kërkojnë në sasira të shumta çimentoje e të cilësisë së mirë. Më të rëndësishmet e këtyre objekteve do të jenë uzinat për prodhimin e plehrave kimike, fabrikat e çimentos, uzina e përpunimit të hekurit, si edhe një sërë veprash të tjera.

Kohët e fundit u përfunduan me RP të Kinës të gjitha marrëveshjet dhe tani po punohet për hartimin e projekteve të të gjitha objekteve që do të ndërtojmë, në mënyrë që çdo objekt të përfundojë në kohën e parashikuar. Tani varet nga ne që të marrim të gj-

tha masat për ndërtimin e veprave në kohë. Kjo kërkon që të sigurojmë çdo gjë që varet nga ne, që nga përgatitja e kuadrove dhe gjer në gjërat më të vogla, në mënyrë që pesëvjeçarin e tretë ta realizojmë me sukses.

Por gjatë këtij pesëvjeçari, përveç objekteve të mëdha industriale që do të ngremë, Partia do ta çojë akoma më përpara edhe bujqësinë, sepse ky është sektori më i rëndësishëm pas industrisë. Dihet se industria nuk mund të ecë përpara pa përparimin e bujqësisë. Shikoni sa të favorizuar jemi ne tani në ecjen përpara të ekonomisë sonë, sa shumë është zhvilluar ajo çdo vit në Shqipëri! Kjo ka ardhur nga kujdesi i madh që kanë treguar Partia dhe Qeveria për ngritjen e fabrikave të mëdha e të vogla, të cilat të punojnë në radhë të parë dhe kryesisht me lëndën e parë të vendit, me qëllim që të mos jemi orë e çast të varur nga importi dhe nga ana tjetër të shfrytëzojmë në maksimum pasuritë e vendit tonë.

Të gjitha fabrikat e uzinat e ngritura në vend, tani punojnë me materialet tona. Me të tilla materiale do të punojnë edhe ato që do të ngrihen gjatë pesëvjeçarit të tretë. Perspektiva e vendit është e tillë që për një kohë jo shumë të gjatë ne të arrijmë të përpunojmë në vend edhe mineralet tona, si edhe ato lëndë të para të vendit që tani në pjesën më të madhe i eksportojmë për mungesë fabrikash e uzinash. Kështu, jo shumë larg, pjesën më të madhe të mineraleve që nxjerrim dhe që do të nxjerrim, synojmë që t'i përpunojmë në vend. Kjo politikë do të ndihmojë që të ngrihet më shumë mirëqenia e puno-

njësve të vendit, do t'i sigurojë shtetit të ardhura më të mëdha, të cilat do t'i disponojë për të mirën e mëtejshme të punonjësve të vendit tonë.

Industria ka rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të një vendi, po rëndësi ka gjithashtu edhe bujqësia, e cila prodhon artikuj ushqimorë për popullin dhe lëndë të parë për industrinë. Ne mund të themi që në fund të pesëvjeçarit një pjesë e madhe e fushave tona do të bonifikohet, do të sistemohet e do të ujitet gjer në 46 për qind. Ky është një tregues shumë i lartë dhe për pesëvjeçarët e ardhshëm do t'u mbetet radha fushave të Shkodrës, që vuajnë nga përmbytjet. Por në të ardhshmen, me hidrocentralet që do të ndërtohen, Drini do të frenohet, pastaj edhe në fushat e rrethit tuaj do të ndërmerren punime të tjera që do të bëjnë të mundur zhdukjen e rrezikut të ujërave të ju. Atëherë mund të themi se do të kemi krijuar në të gjithë Shqipërinë një bujqësi me të vërtetë të përparuar, sepse fushat do t'i kemi bonifikuar krejtësisht, ujitja do të sigurohet në sipërfaqe të mëdha. Në fund të pesëvjeçarit do të kemi siguruar edhe plehra kimike në sasira të mëdha, kuadro bujqësorë, teknikë punimi dhe farëra të zgjedhura. Duke krijuar të gjitha këto kushte të favorshme, ju mund ta merrni me mend se si do të shtohen atëherë prodhimet bujqësore e blegtorale, drithërat, pambuku, panxhari, duhani etj. Atëherë ne do të jemi në gjendje të plehërojmë edhe ullinjët, të cilëve nuk u kemi hedhur kurrë pleh e megjithatë «nuk harrojnë» të na japin prodhim. Por, kur t'u hedhim edhe pleh, t'u bëjmë në rregull edhe shërbimet kulturore, do të sigurojmë një prodhim stabil ulliri, pra, dhe re-

ndimenti i tyre do të jetë shumë më i madh se tani. Gjatë pesëvjeçarit do të shtohet edhe mekanizimi i bujqësisë, sepse do të sjellim çdo vit me mijëra traktorë sipas parashikimeve të planit.

Me mobilizimin e masave tona punonjëse, në radhë të parë të klasës punëtore, ne do t'i realizojmë detyrat e pesëvjeçarit të tretë. Kini parasysh se në të gjitha anët e Shqipërisë po ndërtohen shtëpi banimi për popullin. Prandaj kudo ka kërkesa të mëdha për çimento dhe lëndë druri. Po të kenë mundësi të gjithë duan të ndërtojnë shtëpi, prandaj nga të katër anët kërkohet lëndë ndërtimi, sidomos çimento. Këtë duhet ta kini kurdoherë parasysh ju, punëtorët e Fabrikës së Çimentos. Shteti ynë preokupohet shumë për ndërtimin e banesave për popullin dhe çdo vit plani për ndërtim shtëpish banimi tejkalohet. Po shteti ka vësh-tirësi të mëdha për sigurimin e lëndës së drurit, të çimentos dhe të hekurit që kërkohen. Pra, midis të tjerave, edhe çimentoja është një artikull shumë i nevojshëm për ndërtimin e socializmit dhe për rritjen e vazhdueshme të mirëqenies së popullit tonë, dhe këtë artikull e prodhojnë punëtorët e palodhur të fabrikës të Shkodrës dhe të Vlorës.

Ju përpiqeni që cilësia e çimentos që prodhoni të jetë e mirë, sepse edhe ndërtimet që do të bëhen me të, do të jenë të cilësisë së mirë. Prandaj të jeni më shumë të kujdesshëm gjatë procesit të punës. Sic më kanë thënë shokët, çimentoja që prodhon kolektivi juaj është e një cilësie të mirë. Ju jeni një kolektiv shumë i mirë, i shëndoshë, i lidhur ngushtë me fabrikën. Midis jush unë shoh edhe punëtorë të kaluar nga mosha.

Këta shokë janë një fond shumë i çmueshëm në fabrikë, sepse kur ka punëtorë me eksperiencë në një ndërmarrje prodhimi, atëherë artikujt do të dalin të cilësisë së parë.

Për të ndriçuar mendjen e njerëzve dhe për t'u dhënë punonjësve armë të fuqishme për të krijuar sa më shumë për veten e tyre dhe për popullin, një rëndësi shumë të madhe ka vazhdimi i shkollës nga punonjësit. Ndërsa në regjimet borgjeze dituria shërben për shfrytëzimin e punëtorëve dhe fshatarëve, te ne ajo bëhet një mjet për të mirën e gjithë punonjësve. Natyrisht shkolla ka rëndësi të madhe, por, po të kombinohet dituria edhe me eksperiencën e masave, bëhet më e plotë dhe e dobishme. Midis jush ka njerëz me shkollë, ka edhe të tjerë me eksperiencë të madhe. Duke kombinuar mirë të dy këta faktorë, fabrika juaj ka plotësuar patjetër planet që i ka caktuar shteti. Te ne ka pasur edhe ndërmarrje që kanë çaluar në këtë drejtim dhe që nuk i kanë realizuar planet. Në disa kjo është shkaktuar edhe nga mungesa e eksperiencës ose e kuadrove. Po, kur planet realizohen kështu si te ju, neve na bëhet zemra mal.

Shumica juaj janë njerëz të pjekur dhe me eksperiencë të madhe. Si të tillë, kur të ndërtojmë fabrikat e tjera të çimentos, disave, megjithëse mund t'u vijë keq, do t'u takojë të largohen këtej. Po ata duhet të shkojnë për të punuar ose për të drejtuar në fabrikat e reja, ndryshe ato do të na mbeten si peshku pa ujë. Shqipëria është atdheu ynë, prandaj shkodrani shkon punon me gjithë qejf në Gjirokastër dhe gjirokastriti në Vlorë ose në Peshkopi, sepse vendi është yni. Pra, në fabrikat e reja do të duhen mësues të

vjetër, mjeshtër të prodhimit të çimentos, që t'u mësojnë zanatin punëtorëve të rinj.

Kështu qëndron puna e ndërtimeve në vendin tonë, këto janë kolosale. Nuk di nëse ju organizoni ekskursionë për të shkuar në kohën e pushimeve në disa vende të atdheut tonë që të shikoni me sy, se ç'po bëhet. Një punë e tillë duhet organizuar mirë, se kështu do të keni një ide të qartë për ato që po bëhen në të katër anët e Shqipërisë dhe do të ndieni kënaqësi, se gjatë ndërtimit të objekteve do të shikoni edhe çimenton e prodhuar nga duart tuaja.

Situata në vendin tonë në përgjithësi është e mirë, e shëndoshë, si nga ana politike, ekonomike, kulturore e arsimore, ashtu edhe nga ana e gatishmërisë ushtarake. Partia dhe Qeveria janë gjithë kujdesin e tyre e kanë vënë në drejtim të forcimit të atdheut tonë socialist, për ruajtjen e pavarësisë së tij, për ndërtimin me sukses të socializmit, domethënë për jetën e mirë të punonjësve. Kjo tregon se Partia jonë është në rrugë të drejtë, ajo interesohet për fatet dhe mirëqenien e popullit. Në saje të kujdesit të Partisë ju shihni se jeta e popullit vazhdimisht përmirësohet, megjithëse na dalin vështirësi dhe halle të reja. Hallet e popullit tonë nuk kanë mbaruar, po ato nuk na kanë thyer, përkundrazi na kanë forcuar dhe na kanë kalitur, gjë që na ka ndihmuar të kapërcejmë vështirësitë dhe të korrim suksese në rrugën tonë.

Armiqtë janë përpjekur vazhdimisht ta rrëzojnë pushtetin tonë dhe sidomos të dobësojnë Partinë. Në radhë të parë imperialistët, me ata amerikanë në krye, qysh nga fillimi dhe gjer sa të zhduken nuk kanë

pushuar e nuk do të pushojnë nga veprimtaria e tyre kundër socializmit, sidomos kundër lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë, por nuk kanë pasur dhe kurrë nuk do të kenë sukses te ne. Këtu e 17 vjet më parë ne ishim të dobët, ndërsa tani jemi forcuar shumë. Çdo vit që kalon, ne bëhemi më të fortë. Prandaj çdo vit që kalon përpjekjet e tyre do të dështojnë me turp.

Imperialistët kanë kurdisur shumë herë komplete kundër Shqipërisë, brenda dhe jashtë, në bashkëpunim me revizionistët jugosllavë, të cilët kanë bërë dhe bëjnë çmos për ta dëmtuar vendin tonë. Përveç atyre, edhe monarko-fashistët grekë, edhe imperialistët italianë janë përpjekur dhe përpiqen ta dëmtojnë Shqipërinë tonë socialiste, po kurrë nuk kanë pasur dhe nuk do të kenë sukses dhe gjithnjë do të dështojnë edhe në orvatjet e ardhshme, për arsye të situatës së fortë që ekziston në vendin tonë. Kusari, para se të vijë të të vjedhë shtëpinë, bën plane dhe merr parasysh çdo gjë, ai kujdeset nga ç'anë do të hyjë dhe përpiket që të zotin e shtëpisë ta gjejë në gjumë, se ka frikë prej tij. Kështu edhe armiqët e popullit tonë, përpara se të veprojnë, i bëjnë mirë llogaritë. Është e vështirë për armiqët tanë të sulmojnë Shqipërinë sot në shekullin e triumfit të leninizmit, kur e gjithë bota përparimtare, me proletariatin në krye, lufton për zhdukjen e zgjedhës kapitaliste dhe ushqen një simpati të madhe për vendet socialiste dhe veçanërisht për vendin tonë.

Faktori kryesor për mbrojtjen e atdheut është populli ynë që është lidhur ngushtë me Partinë, që është i fortë si kurrë ndonjëherë ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht. Shqipëria në këto kushte s'preket dot

lehtë, prandaj armiqtë imperialistë, për t'ia filluar një aventure, duhet të maten shumë herë dhe të presin një herë. Kohët kanë ndryshuar, tani armiqve tanë ua kanë prerë dhe ua presin duart Partia jonë dhe pushteti popullor. Pra vendimtare në këtë drejtim është forca jonë dhe këtë e krijoi vetë populli me Partinë në krye.

Partia me popullin tonë janë në unitet të çeliktë. Në Shqipëri populli është i lidhur ngushtë me Partinë dhe përgjon me vigjilencë çdo veprimtari të armiqve të brendshëm ose të jashtëm, sepse sheh që Partia është e tij, se ajo ndjek një rrugë të drejtë dhe lufton që jeta e popullit të përmirësohet, se sheh që në shumë vende, ku partia nuk ecën drejt, ka shumë mungesa, kurse te ne dyqanet janë plot, megjithëse bujqësia jonë vitin e kaluar pësoi dëme nga thatësira. Malësorët që përpara në vite të këtilla vuanin për bukë, tani e urojnë Partinë se nuk detyrohen të zbresin në qytete për të blerë 5 kg misër, mbasi depon e kanë afër fshatit, me bukë, sheqer, oriz, kripë e çdo gjë tjetër.

*Pastaj shoku Enver Hoxha, pasi foli mbi punën armiqësore që zhvillon grupi i N. Hrushovit për të përçarë lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe pasi theksoi qëndrimin parimor revolucionar të Partisë sonë, tha:*

Në këto situata të rënda ne jemi të armatosur mirë me çdo gjë për të përballuar çdo vështirësi nën udhëheqjen e sprovuar të Partisë sonë. Ne kemi një popull të tërë ushtar, kemi një ushtri të fortë, të organizuar e të pajisur më së miri me ç'duhet për mbrojtjen e fitoreve historike të popullit tonë. Masat punonjëse i janë përveshur punës për realizimin e planeve



dhe jemi të bindur se do të vëmë të gjitha forcat, do të vëmë të gjitha energjitë tona për të ecur përpara për realizimin e planeve dhe kapërcimin e vështirësive që mund dhe do të na dalin përpara. Do të gaboheshim, në qoftë se do të mendonim se çdo gjë te ne është shesh me lule. Vështirësi vazhdimisht kemi pasur, prandaj edhe në të ardhshmen të mos mendojmë se nuk do të kemi të tilla. Ja edhe vitin e kaluar ne hasëm në disa vështirësi shumë të mëdha, po i kaluam në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë, të patriotizmit të flaktë, të mobilizimit të gjithanshëm të popullit tonë dhe të ndihmës së madhe internacionaliste që na u dha nga Republika Popullore e Kinës. Kështu planin e vitit 1961 jo vetëm e realizuam, po edhe e tejkaluam. Prandaj jemi plotësisht të bindur se edhe në të ardhshmen do të kapërcejmë çdo vështirësi në saje të heroizmit dhe të vijës së drejtë të Partisë, në saje të vendosmërisë së popullit tonë si dhe të ndihmës që na kanë dhënë dhe do të na japin miqtë tanë.

Me këtë besim te Partia ta fillojmë edhe punën për realizimin e planit të këtij viti dhe ju, punëtorët e çimentos, e keni filluar mbarë punën, sepse e keni realizuar me sukses planin e 15-ditorit të parë të muajit janar. Kështu duhet të ecim gjer në fund për të mirën dhe lumturinë e popullit tonë, për të mirën e Partisë sonë, të socializmit, të revolucionit.

Prandaj ju uroj nga zemra juve, punonjësve të Fabrikës së Çimentos të qytetit të Shkodrës, në radhë të parë, shëndet të mirë! E them këtë në radhë të parë për të tërhequr vëmendjen e drejtorisë dhe të organizatës-bazë të Partisë të ndërmarrjes që të kujdesen

shumë për t'ju mbrojtur nga pluhuri, se ju që punoni këtu, në mënyrë që të mos dëmtoheni, duhet të përdorni maskat për ruajtjen e organeve të brendshme të trupit. Shëndetin juve, punëtorëve, Partia jua uron me gjithë zemër. Në emër të Komitetit Qendror unë ju uroj gjithashtu edhe punë të mbarë për realizimin e tejkalimit e planit të fabrikës!

Rroftë Partia jonë heroike e Punës!

Rroftë klasa e lavdishme punëtore e Shqipërisë!

Rrofshin punëtorët e Fabrikës së Çimentos të Shkodrës!

*Botohet për herë të parë, me shkurtime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# KOOPERATIVAT BUJQËSORE T'I NDIHMOJMË ME KREDI NË BAZË TË KRITEREVE TË CAKTUARA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

19 janar 1962

Vitin që kaloi kooperativat bujqësore u dëmtuan shumë. Ky dëm u shkaktua nga fatkeqësitë e natyrës. Megjithatë ne duhet të mendojmë si t'u vijmë atyre në ndihmë.

Edhe në familje, kur ndodh një fatkeqësi, hartohet një buxhet familjar, sipas mundësive, për të përballuar vështirësitë. Aq më tepër kjo do bërë kur është fjala për shumë familje. Disa nga kooperativat bujqësore të lokalitetit të Koplikut mund të kenë marrë edhe nga 200 lekë për ditë-punë, por sivjet, megjithëse shlyerja e kredive ndaj shtetit u shty, ato e kanë vështirë të marrin edhe 50 lekë për ditë-punë. Bile ka kooperativa që do të ndajnë vetëm nga 25 lekë për ditë-punë. Kooperativa të tilla natyrisht duhen ndihmuar

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi detyrimet e kreditit në kooperativat bujqësore.

në bazë të kriterëve të menduara mirë. Kjo ndihmë duhet dhënë e diferencuar, sipas dëmeve që kanë pësuar kooperativat. Por ndihma është gjithnjë ndihmë. Kryesorja është që vetë kooperativat të bëjnë përpjekje për të zgjidhur vështirësitë ekonomike që u paraqiten, të mos presin çdo gjë nga shteti. Kjo ka rëndësi të madhe. Konkretisht, për të ndihmuar në situatën e tanishme, mendoj që të caktohet një komision në çdo rreth me kryetarin e komitetit ekzekutiv të kp në krye. Kriteri për ndihmë të jetë situata ekonomike konkrete aktuale e çdo kooperative dhe jo të nisemi nga fakti se meqë vitin e kaluar ndonjë kooperative ka realizuar të ardhura të mëdha, ta ndihmojmë që edhe këtë vit të sigurojë po aq të ardhura. Kjo nuk është e drejtë. Dëmet që shkaktohen nga kushtet e këqija atmosferike duhet të përballohen në pjesën më të madhe nga vetë kooperativistët. Natyrisht edhe shteti do të ndihmojë për të lehtësuar disi vështirësitë.

Kooperativat bujqësore ne duhet t'i ndihmojmë me kredi, për të ecur përpara dhe për të kapërcyer vështirësitë, por kurdoherë të jemi shumë të matur dhe të kursyer në dhënie të tyre, sepse mund të krijohen dy rreziqe:

Së pari, krijohet rreziku që shteti të nxjerrë më shumë nga sa duhet të holla në qarkullim, gjë që do të dëmtonte monedhën tonë.

Së dyti, është rreziku që mund të krijohet te kooperativistët pikëpamja, se me kreditë e shtetit, mund të përballojnë fatkeqësitë, duke justifikuar mungesën e organizimit të punës, dembellëkun etj.

Ne kemi kooperative bujqësore që, megjithëse kanë kushte të njëllota, rezultatet i kanë të ndryshme:

njëra merr më pak të ardhura, tjetra arrin suksese të mëdha në saje të punës dhe të një organizimi më të mirë. Prandaj, ato kooperativa që nuk ecin përpara për shkak të organizimit të dobët dhe të mungesës së mobilizimit në punë, nuk duhet të ndihmohen me kredi. Pra, në qoftë se kreditë nuk jepen me kriter, atëherë kryesitë e kooperativave bujqësore nuk do të vrasin shumë mendjen për të përmirësuar organizimin dhe drejtimin e punës.

Në Shkodër më thanë se për kooperativat bujqësore që nuk kanë dalë me rezultate të mira, Banka e Shtetit do të japë kredi dhe kështu kooperativistët do të kenë mundësi të sigurojnë çdo muaj paradhënie. Kjo është një gjë e mirë, nuk është eksperiment, por në rast se ata nuk arrijnë t'i shlyejnë kreditë që u jepen me të ardhurat e tyre, atëherë shteti nuk mund të vazhdojë më duke dhënë kredi. Të mos realizojë kooperativa të ardhurat dhe kooperativisti të marrë çdo muaj paradhënie, kjo nuk do të ishte e drejtë. Është një lloj sikur një grup punëtorësh të kërkojë që secilit, nga të ardhurat e tij të ardhshme, t'i jepet, ta zëmë, 10 mijë lekë paradhënie, por ne nuk e bëjmë një gjë të tillë dhe nuk kemi përse ta bëjmë. Prandaj këto çështje duhet t'i shikojmë mirë.

Këtë masë, pra, le ta marrim për një vit, por shokëve të rretheve t'u bëhet mirë e qartë kjo çështje.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **PUNA ORGANIZATIVE E PARTISË NUK DUHET SHKËPUTUR NGA DETYRAT E TJERA**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**19 janar 1962**

Jam dakord me këshillat që u dhanë në këtë mbledhje nga të gjithë shokët e Byrosë Politike dhe mendoj se ato janë shumë të vlefshme, por dua edhe unë të them se puna organizative e Partisë nuk duhet të shkëputet nga të gjitha detyrat e tjera. Ajo ka për qëllim që Partia, duke qenë një repart i organizuar, të jetë vazhdimisht në këmbë e organizuar, e mobilizuar, e disiplinuar dhe komunistët të qëndrojnë kurdoherë në ballë të luftës, të vendosur, të drejtë dhe të ndershëm. Puna organizative ka për qëllim ta mbajë këtë ushtri në lartësinë e duhur, në kompaktësi, si një grusht i fuqishëm, për të kryer si duhet me sukses në çdo situatë detyrat e shumta që ka.

---

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i paraqitur nga ekipi i KQ të PPSH «Mbi disa çështje të metodës së punës në organizatat e Partisë të rrethit të Durrësit, të Krujës dhe të Korçës».

Detyra kryesore e Partisë sonë është ndërtimi i socializmit, pra, zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës së vendit tonë. Prandaj shtimi i radhëve të Partisë me elementë të rinj, pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e organizatave-bazë, ruajtja si sytë e ballit e tësërisë së Partisë etj., të gjitha këto duhet të shërbejnë për kryerjen e detyrave që na janë vënë përpara. Për këtë arsye, format organizative nuk duhen lënë pas dore, ndryshe thyhet disiplina, prishet rregulli, shkelet Statuti i Partisë dhe si pasojë lufta e Partisë nuk bëhet si duhet në të gjitha frontet.

Forcimi organizativ i Partisë dhe zbatimi me përpikëri i të gjitha detyrave janë të lidhura ngushtë me edukimin e komunistëve, të cilët t'i bëjmë të kuptojnë mirë domosdoshmërinë e rregullave organizative dhe rëndësinë e zbatimit të tyre; për këtë qëllim duhen bërë përpjekje për edukimin ideologjik të komunistëve. Ky është një problem i rëndësishëm dhe i vazhdueshëm. Ne duhet të përfitojmë shumë nga situata aktuale për ngritjen ideologjike të anëtarëve të Partisë. Kjo ngritje ideologjike është shoqëruar kurdoherë me eksperiencën e madhe të Partisë dhe kemi pasur rezultate të kënaqshme. Po të mos e lidhim teorinë revolucionare me praktikën e Partisë, anëtarët e Partisë sonë do të ishin në një nivel shumë të ulët. Këtë ne do të vazhdojmë ta bëjmë edhe në të ardhshmen, ashtu siç e kemi bërë deri tani. Vepra e Partisë sonë tregon zbatimin me sukses në jetë të teorisë marksiste-leniniste.

Lidhja e teorisë marksiste-leniniste me jetën, me praktikën revolucionare të vendit tonë, ka bërë që Par-

tia jonë të korrë gjithë këto suksese të mëdha. Ja tanë Partia jonë e ka më lehtë të zhvillojë luftën e saj parimore kundër grupit të N. Hrushovit, sepse ajo ka një eksperiencë shumë të madhe në luftën e gjatë kundër revizionistëve jugosllavë. Edhe në të ardhshmen, anëtarët e Partisë sonë do ta kuptojnë më thellë çdo problem në rast se Drejtoria e Propagandës dhe e Agjitacionit pranë aparatit të Komitetit Qendror dhe komitetet e Partisë në rrethe do të luftojnë akoma më mirë për të lidhur mësimet e Partisë sonë me teorinë e përgjithshme marksiste-leniniste.

Ne duhet të përfitojmë shumë nga entuziazmi i madh dhe kuptimi i drejtë i çështjeve që vihen re aktualisht në radhët e Partisë e në masën e popullit tonë dhe të marrim masa për edukimin dhe për kalitjen e mëtejshme ideopolitike të tyre. Të flasim konkretisht: Të gjithë artikujt me rëndësi të gazetës «Zëri i popullit» komunistët dhe masat punonjëse i lexojnë, përfitojnë, kënaqen dhe armatosen me mësimet e Partisë. Por komitetet e Partisë nuk duhet të kënaqen vetëm me një të lexuar. Këto materiale të vlefshme duhet të jenë një bazë e fortë për t'i gërshetuar me teorinë që komunistët kanë mësuar ose mësojnë në shkolla, në kurse apo në format e ndryshme të arsimit të Partisë. Pra, teoria që mësohet në rrjetin e arsimit të Partisë, do të bëhet e pakuptueshme po të mos lidhet me direktivat, letrat dhe vendimet e Komitetit Qendror, me artikujt që botohen në shtypin e Partisë, që përfaqësojnë vijën e Partisë sonë. Është e domosdoshme që të gjitha këto të përdoren si materiale për edukimin e komunistëve. Me to dhe me mësimet e



Leninit e të Stalinit anëtarët e Partisë do të pasurohen me eksperiencë për luftën e tyre kundër revizionizmit apo armiqve të tjerë të marksizëm-leninizmit dhe për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Partia jonë ka 20 vjet që e zhvillon këtë luftë, prandaj, kur të flitet në format e arsimit për luftën e Leninit kundër oportunitizmit, pjesëmarrësit në këto forma do ta kuptojnë menjëherë thelbin e çështjes. Kurse po ta mësojmë teorinë të palidhur me praktikën tonë, atëherë do të bëhet vetëm një punë skolastike.

Detyra e Partisë është që jo vetëm në format e arsimit, por edhe në tërë punën politike e ideologjike me masat e popullit të ketë një program të veçantë të ndërtuar mbi bazën e direktivave të Partisë, vendimeve e letrave të Komitetit Qendror, si dhe të artikujve që botohen në shtypin e Partisë, duke i lidhur ato edhe me teorinë që mësohet në shkolla. Këto materiale të mos lexohen si çdo gjë tjetër në gazetë, po të studjohen e të lidhen edhe me problemet teorike.

Ajo që ngriti Ramizi [Alia] për përmirësimin e metodës dhe të stilit në punë është shumë e drejtë. Ne duhet të punojmë për forcimin organizativ të Partisë me qëllim që Partia të jetë një repart i armatosur mirë dhe i edukuar ideologjikisht e politikisht. Kjo duhet të pasqyrohet në të gjitha frontet e punës dhe në radhë të parë në frontin ekonomik. Punonjësit e rrethit të Korçës janë të ngritur politikisht dhe të lidhur ngushtë me Partinë, po ka shumë rëndësi ajo që shtroi në diskutimin e vet shoku Hysni [Kapo], që në këtë rreth 90 traktoristë nuk e kanë realizuar planin. Kjo do të thotë se këta punonjës nuk i kanë kuptuar si

duhet detyrat që u vihen përpara në këto situata. Ose mosrealizimi i planit nga një sërë ndërmarrjesh po të rrethit të Korçës tregon se këta punonjës nuk i kanë kuptuar si duhet momentet e rëndësishme politike që po kalojmë.

Ne shohim vetëm se, në përgjithësi, kemi rezultate të mira dhe kënaqemi, po Partia duhet t'u futet më thellë dhe t'i shikojë një nga një planet dhe do të zbulojë me siguri se atje ku planet nuk janë realizuar, me njerëzit nuk punohet si duhet politikisht dhe organizata-bazë e Partisë nuk është mobilizuar mirë për luftën kundër të metave e dobësive dhe nuk e ka organizuar punën mirë. Ne duhet të kemi kudo sa më pak deficite në realizimin e planeve e sa më pak dëmtime në pronën shoqërore. Mos harrojmë se jemi të rrethuar nga të katër anët dhe në luftë me armiq të mëdhenj e të fuqishëm, siç janë imperialistët e revizionistët.

Ne jemi dakord me sa thanë shokët se situata në vendin tonë është e mirë, se Partia jonë është e fortë, planet tona në përgjithësi realizohen më mirë se çdo herë tjetër, po duhet të mos harrojmë edhe të metat tona, prandaj ta vazhdojmë punën me një organizim më të mirë dhe të jemi të sigurt se do të kemi sukses.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## PAK FJALË PËR MASAT NDËSHKIMORE DHE SHLYERJEN E TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

20 janar 1962:

Për komunistët që kanë masa ndëshkimore, qofshin këto të vjetra ose të reja, rëndësi edukative ka çështja që ata, pas një periudhe të caktuar, të kërkojnë vetë shlyerjen e këtyre masave. Shlyerja e masave ndëshkimore nuk mund të bëhet nga lart. Kjo do të ishte një gjë fare e lehtë, por puna është që anëtari i Partisë ta ndiejë vetë se ka ardhur koha të kërkojë shlyerjen e masës dhe që komiteti i Partisë t'i studjojë se për ç'arsye janë marrë këto masa, sa kohë kanë dhe të nxjerrë konkluzionet e veta.

Nuk është i drejtë mendimi që u shfaq këtu se byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës gabon që nga 8 propozime për përjashtime, të bëra

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi masat ndëshkimore dhe përjashtimet nga Partia.

nga organizatat-bazë, aprovoi vetëm dy. Një punë e tillë bën shumë herë një efekt edukativ më të madh. Mund të ndodhë që masa e organit më të lartë të jetë më e vogël ose më e madhe. Kur isha nxënës në fillore, kishim një drejtor me shumë autoritet. Një ditë, një shok i klasës ishte rrahur me një tjetër dhe i qe këputur kopsa e palltos e s'dinte ta qepte. Kur e pa mësuesi ashtu të çrregullt, e përjashtoi nga klasa, mirëpo drejtori, përkundrazi, nuk e përjashtoi, por e thirri në drejtori dhe, duke i folur me ngadalë e «vrau» nxënësin më keq se ç'mund ta kishte rrahur dikush. Ai të vriste me pambuk. Pikërisht për këtë arsye neve na vinte shumë rëndë të shkonim te drejtori.

Kur japin dënime, natyrisht komitetet e Partisë gjykojnë thellë mbi çështjet dhe, kur është e arsyeshme, mund të mos pranohen vendimet e organizatave-bazë, sepse një qëndrim i matur bën shumë efekt. Sekretari i komitetit të Partisë mund të thotë dhe të theksojë bile se komunisti është ndëshkuar me të drejtë, sepse të tilla janë edhe gabimet e tij, por byroja mendon t'i jepet edhe një herë dora, t'i falet gabimi dhe ta këshillojë, por të ketë parasysh që të mos vijë më këtu për qëndrime të tilla, sepse e ka tepruar shumë. Në këtë mënyrë ai të kuptojë se faljen ia bënë duke marrë parasysh se mund të ndreqet, mbasi është punëtor i mirë, komunist që përpiqet, po që në këtë rast ka gabuar rëndë. Kështu, fajtori duhet të kuptojë drejt si qëndrimin dhe masën që i ka dhënë organizata-bazë, ashtu edhe lehtësimin që i bën udhëheqja e rrethit dhe të veprojë me shumë kujdes në të ardhshmen.

Ndikimi i Partisë duhet të shtrihet edhe te të për-

jashtuarit nga Partia. Ata që nuk kanë aktivitet armiqësor, nuk do të jetë keq t'i thërrasë sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit, të bëjë me ta një takim të ngrohtë, t'u vërë në dukje karakteristikat kryesore, t'u theksojë se për ç'shkaqë janë përjashtuar dhe t'u thotë se Partia i ka ata afër dhe t'u bëjë thirrje që të mobilizohen më mirë në punë. Ai t'u flasë atyre për çështjet politike dhe ekonomike dhe t'u thotë se Partia do t'i ndihmojë në punë, por duhet që edhe ata vetë të aktivizohen, të jenë vigjilentë dhe të bëjnë të gjitha përpjekjet që të dallohen sa më shumë atje ku punojnë. T'u theksojë se Partia është afër tyre, se ajo do të ndjekë çështjen e secilit veçanërisht dhe për ata që tregohen revolucionarë me vepra, me punë dhe aksione, kjo do të jetë një provë se i kanë kuptuar gabimet dhe mund të arrijnë edhe të rifuten përsëri në Parti.

Të përjashtuarit e kategorive të tjera që janë më pak pozitivë, mund të thirren në komitetin e Partisë një nga një, t'u vihen në dukje gabimet, por edhe përparimet që eventualisht mund të kenë bërë dhe t'u thuhet se Partia do t'i ndihmojë, do t'i afrojë, prandaj edhe ata të mobilizohen më shumë në punë dhe në aksionet e ndryshme të vendit.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## PAK FJALË MBI PRANIMET NË PARTI NGA RADHËT E USHTRISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

20 janar 1962

Në ushtri ka shumë rëndësi që të pranohen në Parti kuadro, prandaj jam dakord me Hysniun [Kapo] që atje të ndryshojmë përqindjet e pranimi punëtorë-nëpunës dhe të pranohen më shumë oficerë dhe punëtorë stabil të ndërmarrjeve ushtarake e më pak nga ushtarët, të cilët qëndrojnë në shërbim vetëm dy-tre vjet. Natyrisht, të kemi parasysh që edhe ushtarëve të mos ua mbyllim perspektivën, sepse vërtet që ushtari qëndron në repart dy ose tre vjet, por ai mund të pranohet në Parti edhe në terren, pas çmobilizimit, mjafton të ketë dokument mbi punën dhe qëndrimin e mirë që ka mbajtur në ushtri. Nga ana tjetër, ushtarët janë djem të rinj, ata militojnë, punojnë dhe edukohen në radhët e organizatës së rinisë dhe, disa që dallohen,

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi pranimet në Parti në organizatat-bazë të Partisë të Ushtrisë Popullore.

mund të pranohen edhe në Parti. Në fakt, ushtarit që pranohet në Parti, i takon të qëndrojë në organizatën-bazë 4-5 ose 6 muaj, sepse çmobilizohet, pra nuk i mbetet kohë të punojë për forcimin e organizatës. Efektivisht pranimi i tij nuk sjell ndonjë ndryshim të dukshëm në organizatën e Partisë në ushtri. Kështu është më mirë që ky të mos i zërë vendin një oficeri ose punëtori të ofiçinës që është stabil.

Duke pranuar në Parti kuadro nga ushtria, ka rrezik që të na ulet përçindja e pranimet të punëtorëve si Republikë, prandaj, që të mos ndodhë kjo, të pranojmë më shumë punëtorë nga terreni. Kështu, përçindjen më të madhe të pranimeve në ushtri duhet ta zënë oficerët që kanë mbi 5 vjet shërbim, natyrisht, kur e meritojnë, në bazë të kërkesave të Statutit. Për pranimet në Parti nga radhët e ushtrisë ne duhet të shikojmë kryesisht cilësinë.

Këto masa t'i marrim duke u nisur nga interesi i forcimit të organizatave-bazë të Partisë në ushtri, pavarësisht se do të prishet ca raporti i pranimeve punëtorë-nëpunës. Për Partinë është vendimtare që në organizatën-bazë të repartit të kemi një kuadër të fortë partie. Është më mirë për Partinë të pranohet një kuadër oficer, edhe pse quhet nëpunës, sepse ai është efektiv në ushtri, sesa një punëtor i ri që është ushtar, i cili, në mos u pranofte sot në ushtri, mund të pranohet nesër në qendrën e punës ku do të punojë. Elementët e klasës punëtore ne nuk i kalitim në ushtri ku shërbejnë përkohësisht, ata i kalitim në miniera, në uzina, në fabrika, në kantiere ndërtimi etj. Atje të synojmë të pranojmë punëtorë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto, mendoj që të bëhen korrigjimet e nevojshme dhe kjo çështje të ndiqet konkretisht në jetë.

*Botuar për herë të parë në:  
Enver Hoxha «Në ndihmë  
të Ushtrisë Popullore»,  
vëll. II, f. 437.  
Tiranë, 1975*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë  
nga procesverbali i mbledhjes  
së Sekretariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## ARSIMI ËSHTE NJË NGA SEKTORET MË TË RËNDËSISHËM TË PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**20 janar 1962**

Një problem me rëndësi që duhet parë nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës është që lëvizjet e arsimtarëve, transferimet e tyre nga një vend në tjetrin të kufizohen. Në këtë drejtim është e domosdoshme të bëhet një propagandë e gjerë shoqërore, që arsimtarët të stabilizohen atje ku janë caktuar të punojnë, gjë që është në interes të shtetit, të arsimit dhe të vetë arsimtarëve. Me arsimtarët që punojnë në fshat duhet të punohet që të mos e kenë mendjen në qytet, sepse fshati ynë është një nga qendrat më të bukura e më të rëndësishme të punës sonë. Misioni i lartë i arsimtarit është të edukojë fëmijët e popullit, prandaj atë duhet ta lidhim me shkollën dhe fshatin ku punon. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të bëjë ç'është e

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi gjendjen e kuadrit të arsimit dhe puna për përgatitjen, edukimin, aktivizimin dhe trajtimin e tij».

mundur që shkollat të ndërtohen të bukura, të mbahen të pastra, të ketë në to rregull e disiplinë, që tekstet t'u sigurohen të gjithëve etj.

Për arsimtarin e fshatit rëndësi të veçantë ka sigurimi i banesës. Ne duhet të përpiqemi t'u lehtësojmë jetën arsimtarëve në fshat, sidomos për strehimin e atyre që janë nga qyteti, natyrisht brenda mundësive tona. Për këtë çështje të theksohet në vendim që komitetet e Partisë dhe kryesitë e kooperativave bujqësore të interesohen më shumë për strehimin dhe për furnizimin e arsimtarëve, që atyre t'u jepet mundësia të ushqehen në mensat e kooperativave ose të SMT-ve etj. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të studjojë dhe të hartojë një plan me perspektivë të gjerë, në mënyrë që arsimtarëve të fshatit t'u sigurohet strehimi i nevojshëm dhe të mos mbeten si të ardhur, por të kenë mundësi të krijojnë edhe familje, natyrisht kjo kurdoherë me dëshirë. Partia, nga ana e saj, të punojë që arsimtarët beqarë të martohen në fshat, ku ka djem dhe vajza po aq të mira, të bukura, të zgjuara dhe punëtore sa edhe në qytet, sepse kështu ata do të lidhen më ngushtë me fshatin, me fëmijët, me shkollën, me ekonominë fshatare. Pra arsimtarët duhet të binden të qëndrojnë në fshat. Natyrisht kjo është çështje e një perspektive të gjatë, po propagandë e tillë duhet bërë vazhdimisht.

Në vendim duhet të theksohet edhe çështja e mësuesve të shkollave 7-vjeçare, ku ne kemi më shumë vështirësi. Komitetet e Partisë të kenë kujdes t'i plotësojnë kontingjentet që parashikohen për shkollat dhe institutet pedagogjike. Një kujdes i veçantë duhet të tregohet edhe për marrjen e arsimit përkatës me ko-

rrespondencë nga ana e arsimtarëve, sidomos nga ata që janë caktuar të punojnë në shkollat 7-vjeçare. Kjo të vihet si një detyrë e domosdoshme për komitetet e Partisë, për të plotësuar kërkesat e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës, jo vetëm për të siguruar kontingjentet e shkollave, por edhe të kontrollojnë arsimtarët që duhet të ndjekin shkollat me korrespondencë dhe t'u kërkohet atyre llogari, si nga ana e Partisë, ashtu edhe nga ana e organizatës së rinisë dhe e bashkimeve profesionale, të cilat duhet të përcaktojnë edhe metodën se si t'i kontrollojnë dhe t'i ndihmojnë këta arsimtarë që të ndjekin mësimet dhe të japin provimet rregullisht. Nga ana e tyre, gjithashtu, të kontrollohet qëndrimi i arsimtarëve në shkolla, që ata të edukohen me ndjenjën e disiplinës në detyrë, ashtu siç u përket këtyre njerëzve, që kanë një mision shumë të lartë për të kryer.

Ne kemi mjaft përparime në arsim. Partia për këtë sektor tregon një interesim të gjithanshëm. Në krye të këtij dikasteri kemi shokun Manush, i cili interesohet shumë për problemet e arsimit, që janë kaq të mëdha, vetëm duhet që Partia të ndihmojë akoma më shumë në të gjitha këto drejtime. Ta bëjmë arsimin një nga problemet më të rëndësishme të Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbalit i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## VITI 1962 TË JETË NJË TJETËR VIT LUFTE PËR REALIZIMIN E PLANIT

*Nga fjala e mbajtur në Plenumin e 6-të  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

25 janar 1962

Edhe unë mendoj se kjo mbledhje e Plenumit ka qenë shumë e frytshme. Këtu u shtrua realizimi i planit për vitin 1961 dhe detyrat për vitin 1962. Organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe të ekonomisë kanë tani në dorë planin e vitit 1962, po punohet në bazë të tij dhe shenjat janë shumë të mira. Pra për planin e këtij viti ju të gjithë jeni në korent. Shokët e Byrosë Politike, dhe veçanërisht shoku Mehmet, dhënë këtu shumë orientime të vlefshme, të cilat duhet t'u shërbejnë Partisë dhe pushtetit në rreth e në bazë si plotësuese të detyrave që janë caktuar për realizimin e planit të vitit 1962.

---

<sup>1</sup> Plenumi i 6-të i KQ të PPSH, që u mbajt më 24-25 janar 1962, diskutoi rreth raportit «Mbi rezultatet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1961 dhe mbi masat që duhen marrë për plotësimin e detyrave të planit të vitit 1962».

Me gjithë vështirësitë e mëdha që janë hasur, Partia dhe pushteti kanë arritur shumë suksese në realizimin e planit të vitit 1961. Këto suksese duhet të vlerësohen drejt, sepse u arritën në situata shumë të vështira politike dhe ekonomike që na u krijuan nga revizionistët, nga grupi tradhtar i N. Hrushovit. Prandaj është e drejtë që të gjithë punonjësit ndiejnë në zemër një kënaqësi të madhe dhe krenohen për punën e mirë që është bërë. Të gjithë ne jemi të bindur se sukseset dhe kënaqësia që ndiejmë, nuk na bëjnë të na rritet mendja dhe të flemë mbi dafina, ose të mendojmë se sukseset e tjera në të ardhshmen do të vijnë vetë, pa përpjekje.

E vërteta është se viti 1961 ka qenë një vit i madh prove për të gjithë Partinë dhe punonjësit e vendit tonë. Kjo tregon jo vetëm hovin e madh revolucionar patriotik të masave me parti dhe pa parti, por edhe se vija e Partisë sonë, në të gjitha aspektet, ka qenë dhe është e drejtë. Për këtë arsye masat e gjera të popullit tonë e përqafojnë me kaq heroizëm dhe luftojnë si duhet për zbatimin e kësaj vije. Interesante është se e tërë Partia jonë ka qenë si një bllok i bashkuar rreth Komitetit Qendror dhe i gjithë populli gjithashtu i bashkuar si një trup i vetëm rreth Partisë. Ai ka përvetësuar vijën dhe vendimet e drejta të Partisë, ka kuptuar kundërpërgjigjen e guximshme dhe të menjëhershme që ndërmoi Komiteti Qendror ndaj veprimtarisë armiqësore të grupit të Hrushovit dhe udhëheqësve revizionistë të vendeve të demokracisë popullore të Evropës, sepse ka qenë plotësisht e drejtë dhe e bazuar në rrugën marksiste-leniniste, në interes

të atdheut, të lirisë, të sovranitetit dhe të pavarësisë së tij, si edhe në interes të vendeve socialiste e të marksizëm-leninizmit. Këtë qëndrim të drejtë të Komitetit Qendror e kuptuan menjëherë Partia dhe populli dhe u vunë gjoksin vështirësive të mëdha që u krijuan, i përballuan dhe po i kapërcejnë me sukses.

Është edhe një faktor tjetër që u kapërcyen këto vështirësi të mëdha: zotësia e kuadrove tanë. Ky faktor nuk u krijua menjëherë, po gjatë gjithë jetës së lirë e të pavarur të popullit tonë nën udhëheqjen e Partisë. Njerëzit tanë me punën e palodhur të përditshme për ndërtimin e socializmit, të rrahur në vaj e në uthull, të ngrënë e të pangrënë, me gjumë e pa gjumë dhe me pak dituri, gjatë kësaj periudhe 18-vjeçare, nën drejtimin, kujdesin dhe këmbënguljen e Partisë, e rritën eksperiencën e tyre, mësuan dhe u bënë të aftë për detyrat që janë duke i kryer me zotësi. Kur bëjmë analizën dhe shohim si janë rritur dhe shumëfishuar kuadrot tanë në të gjithë sektorët, atëherë na bëhet zemra mal për rrugën e drejtë që ka ndjekur Partia.

Po të marrim dinamikën e gjithë zhvillimit ekonomik, kulturor dhe arsimor gjatë çdo viti pas Çlirimit, do të shohim jo vetëm sa vështirësi të shumta kemi kapërcyer, por edhe sa e kanë perfeksionuar kuadrot tanë metodën e punës, të organizimit dhe të kërkimit të llogarisë për arritjen e qëllimeve që ka caktuar Partia në planet e veta. Këtë e tregon edhe madhështia e planeve tona që janë realizuar çdo vit. Edhe plani i vitit 1961 me kënaqësi mund të themi se është realizuar si asnjëherë, veçanërisht në industri.

Po duhet të pranojmë, shokë, se në punën tonë

ne kemi edhe të meta. Shumë vështirësi kemi kaluar, shumë suksese e fitore kemi korrur, po kemi edhe mjaft gabime në punë. Është pozitive se te ne rrallë gjen kuadro që të mos i vrasë ndërgjegjja përpara gabimeve. Ata janë edukuar politikisht nga Partia, prandaj u dhemb zemra kur shohin se ndodhin prishje, avari, shpërdorime dhe veprojnë menjëherë e marrin masa për ndreqjen e situatës. Kjo është shumë pozitive. Natyrisht nuk mund të themi se kjo ka arritur përsosmërinë, as nuk jemi në një stad, ku nuk do të ndodhin më të tilla fenomene negative. Ne jemi akoma prapa në këtë drejtim, veç përparime kemi bërë dhe ato duhet të na shërbejnë për të ecur edhe më përpara në të ardhshmen. Të kemi parasysh gabimet që vërtetohen në punë dhe të marrim të gjitha masat politike, ideologjike dhe organizative për të forcuar më tej punën. Kjo ka mundësi të arrihet, sepse njerëzit tanë janë tani ideologjikisht më të ngritur, prandaj t'i nxitim ata që të ngrenë kurdoherë probleme në një platformë ideologjike më të lartë. Lufta e përditshme do të çojë në atë që gabimet e bëra të mos përsëriten më.

Pastaj gabimet dhe të metat të mos i shohim si diçka të thjeshta në vetvete, e të mendohet se fundi i fundit ato që ndodhin në një repart ose në një ndërmarrje nuk mund të dëmtojnë vendin, po t'i shohim në kuadrin e përgjithshëm të ekonomisë dhe të intereseve të atdheut, të mirëqenies së popullit dhe të mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë së vendit. Prandaj ky vit të na shërbejë si një vit tjetër lufte në drejtim të realizimit të planit.

Ne konstatojmë se çështja jonë fiton çdo ditë, kurse armiqtë tanë, imperialistët, titistët, hrushovianët humbasin dhe do të humbasin kurdoherë. Por situatat nuk zhvillohen dhe nuk do të ecin si në gjalpë, pa luftë, pa përpjekje e pa vështirësi, pa kërcënime të gjithfarëlloji nga armiqtë, veprimtarinë e të cilëve ne duhet ta përballojmë si gjer tani, bile edhe më mirë akoma. Për këtë ne jemi të bindur. Por është e qartë se sa më të kalitur e më të ngritur të jemi politikisht e ideologjikisht, sa më të fortë të jemi ekonomikisht, aq më pak rreziqe do të ketë për çështjen e madhe të atdheut, aq më të sigurta do të jenë fitoret tona në rrugën e marksizëm-leninizmit. Prandaj ky vit të na shërbejë për të ecur edhe më përpara në rrugën tonë drejt sukseseve të reja.

Siç u tha në raport dhe siç e theksuan edhe shoku Mehmet e shokët e tjerë, plani i vitit 1962 është një plan mjaft i rëndë dhe i ngarkuar, që kërkon mobilizimin e përgjithshëm të forcave fizike e mendore të të gjithë punonjësve tanë, kudo që janë, në fabrika, në ara, apo në shkolla. Të kemi parasysh që në këto situata, jo vetëm të mos e ulim ritmin, po t'i tejkalojmë caqet e planit për të mirën e popullit tonë. Kjo do të jetë një disfatë e madhe për N. Hrushovin, Titon, imperialistët amerikanë, ata italianë, monarko-fashistët grekë etj., të cilëve do t'u tregojmë se shqipoja ka sedër të madhe marksiste, revolucionare dhe jo sedër borgjeze. Të punosh për të realizuar planet, do të thotë të veprosh për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit në shkallën që ka caktuar Partia, kurse po të bëhen



përpjekje për ta tejkaluar planin, i sjell edhe një plus çështjes së marksizëm-leninizmit, sepse kjo u tregon atyre që janë të lëkundshëm, brenda ose jashtë vendit tonë, se ç'mund të bëjë një popull si populli shqiptar, në unitet të plotë me Partinë e tij, që nuk u lëkundën në këtë furtunë kaq të madhe, po morën parasysh çdo gjë, pse ishin të sigurt në vijën e tyre të drejtë dhe se do të fitonin. Kështu, të gjitha orvatjet e antimark-sistëve dhe të imperialistëve ndaj vendit dhe Partisë sonë dështuan. Prandaj në këtë rrugë të luftojmë për t'i siguruar popullit mirëqenien. Në këtë mënyrë ne do t'i kemi demaskuar armiqtë dhe do t'i sjellim një kontribut të madh vendit tonë dhe marksizëm-leninizmit. Prandaj asnjë të mos fërkojë duart, se, duke ndenjtur, asgjë nuk vjen vetë. Armiqtë tanë nuk fërkojnë duart, po kanë thurur e thurin plane e komplete kundër nesh. Por siç kanë dështuar gjer tani, ata edhe këtej e tutje do të dështojnë. Ata duan dhe luftojnë që planet tona të mos realizohen, me qëllim që ne të mos jemi në gjendje t'i japim popullit çfarë i kemi premtuar, të mos e ngremë nivelin e tij të jetesës. Këtë ta kemi kurdoherë parasysh jo vetëm ne, komunistët, por të gjithë punonjësit.

Që të realizojmë planet në këto kushte të vështira, duhet të bëjmë përpjekje të mëdha për të shfrytëzuar në maksimum rezervat e brendshme të çdo lloji, për të cilat folën këtu shumë nga shokët që diskutuan. Jo vetëm komunistët e drejtuesit, po edhe punonjësit më të thjeshtë duhet ta kuptojnë thellë se çështja e rezervave të brendshme është një çështje jetike. Partia kurdoherë ka theksuar që në çdo rast të bëhet sa më

shumë ekonomi. Në këtë fushë ajo ka luftuar, lufton dhe do të luftojë, sepse kursimet do t'i kthehen përsëri popullit. Po tani në situatat që po kalojmë, ato marrin një kuptim akoma më të madh. Të kursejmë çdo gjë, edhe lekun, se edhe një lek ka në vetvete një vlerë materiale.

Në radhë të parë, siç theksoi shoku Mehmet, të kursejmë vlerat materiale, sidomos nga ato që importojmë. Ardhja e mallrave nga importi për realizimin e planit është siguruar, por, në këtë luftë të egër që i bëjnë Shqipërisë heroike të gjithë armiqtë, mund të na sillen pengesa të reja në sigurimin e materialeve të importit. Ne këto pengesa duhet t'i parashikojmë e të marrim edhe masat përkatëse. Dhe udhëheqja masa ka marrë. Gatishmëria dhe qëndrimi internacionalist i shokëve kinezë, për të na siguruar anën materiale të planit tonë në një nivel të mirë, të domosdoshëm për të mos penguar ritmikën e planit, për të mos pësuar ulje mirëqenia e popullit, ka një rëndësi shumë të madhe. Ka mundësi për të lidhur marrëveshje tregtare dhe po i lidhim me disa vende të Evropës Lindore, po ato mund të mos u përmbahen kontratave dhe, për të dëmtuar ekonominë tonë, më vonë mund të bëjnë presione duke mos na furnizuar. Prandaj, masat që janë marrë nga Partia jonë, nuk do të lejojnë të dëmtohet plani edhe sikur këto vende t'i prishin kontratat.

Vija jonë, shokë, është e drejtë, atë e ka vërtetuar dhe po e vërteton jeta, kurse revizionistët po demaskohen dita-ditës; ata janë në këmbë, ne jemi kaluar. Ata shkelin marrëdhëniet tregtare të vendosura midis

shteteve, i tillë është botëkuptimi i tyre. Por ne, duke qëndruar në sferën e marrëdhënieve tregtare, jemi gati të bëjmë bisedime dhe të përpiqemi të realizojmë të gjithë kleringun me ta.

Siç e dini Byroja Politike dhe Qeveria kanë menduar dhe kanë siguruar një farë rezerve drithërash e prodhimesh të tjera ushqimore si dhe lëndë të parë industriale për t'i përdorur në një kohë të keqe. Prandaj, po të duan çekët, polakët dhe shokët e tyre, le ta marrin vesh se pa bukë dhe pa mish ne nuk jemi, të gjitha të nevojshmet i kemi në rezervat e shtetit. Në qoftë se, siç thonë, ata dëshirojnë të bëjnë tregti me ne, pavarësisht se miku i tyre N. Hrushovi i ka shkelur të gjitha marrëveshjet me Shqipërinë, ne do të nënshkruajmë me ta kontratat, njëkohësisht do të përpiqemi t'i realizojmë ato. Për këtë duhet të bëhet një luftë e madhe nga ana e organeve tona të tregtisë së jashtme. Ministrinë e Tregtisë nuk duhet ta zërë gjumi për këto çështje. Jo vetëm ajo, po e gjithë Partia duhet të punojë që të jemi sa më korrektë në realizimin e eksporteve tona, sidomos me vendet e Evropës Lindore, me të cilat kemi kontraktuar, sepse udhëheqja në ato vende është në kundërshtim të hapur politik dhe ideologjik me Partinë dhe vendin tonë. Prandaj me to të zhvillojmë tregti me korrektësi reciproke. Mallrat tona të eksportit nga sektori i minierave, i industrisë, i bujqësisë dhe i artizanatit të realizohen në kohën e duhur, me cilësitë e kërkuara dhe të parashikuara në kontratat. Ndryshe një difekt i vogël dhe të jeni të sigurt se ata do të na nxjerrin pengesa. Ne nuk duhet t'u japim atyre asnjë armë për të na pen-

guar. Prandaj në këtë drejtim duhen bërë përpjekje të mëdha.

Kursimi i lëndëve të para deficitare ka një rëndësi shumë të madhe për ne. Shoku Mehmet e shtroi drejt çështjen që të krijohen jo vetëm rezerva shtetërore për këto lëndë, por edhe rezervat dikasteriale, bile rezerva të krijohen edhe në çdo ndërmarrje. Ajo që u shtrua këtu, për të mos luftuar që të tejkalohet plani, duhet të kuptohet drejt. Tejkalimi i planit nuk duhet lakmuar në disa zëra, po edhe për këto gjersa të kemi siguruar rezerva, dhe kur ato t'i krijojmë në çdo ndërmarrje, atëherë kudo të bëjmë të gjitha përpjekjet e mundshme që plani jo vetëm të realizohet, po edhe të tejkalohet, ndryshe sistemi ynë nuk mund të mbahet në këmbë, se kemi norma, emulacion dhe nevoja të mëdha për mallra. Po ç'i do të gjitha këto, kur nuk ke rezerva? Duhet pasur kujdes në cilësinë e mallrave, ato që janë stoqe në depo tregtia duhet t'i vërë në shitje dhe t'i blejë kush të dojë. Kurse në sektorin e minierave, të bujqësisë e të blegtorisë ai që tejkalon planin, të përfitojë edhe stimuj moralë në format që janë caktuar. Këtë duhet ta kemi parasysh gjatë punës për realizimin e planeve tona.

Byroja Politike mendon se shokët janë në pozita të tilla që t'i vënë në jetë këto mësimë. Populli, Partia dhe shteti ynë i kuptojnë mirë situatat që kalojnë, e kanë të qartë vijën tonë. Me zotësinë dhe energjinë e punonjësve tanë ne jemi të bindur se çdo gjë do të shkojë mirë dhe nuk ka përse të mos shkojë mirë.

Dëshiroj të insistoj në disa gjëra, sido që shumë

prej tyre u theksuan mirë nga shokët që diskutuan. Përsa i përket prodhimit në miniera u theksua në raport, edhe shoku Todo Manço<sup>1</sup> foli, po dua të theksoj se shokët e minierave, veçanërisht ata të kromit duhet ta organizojnë më mirë punën, t'i ngrenë kuadrot në lartësinë e kuptimit politik dhe ekonomik të problemeve, në mënyrë që kromi ynë të jetë sa më i pastër dhe i pasur, sepse ka mjaft të meta, prandaj na bëhen edhe reklamime nga ana e blerësve.

Pastaj të mbahet mirë parasysh çështja e prodhimit të naftës nga të gjithë shokët, duke filluar që nga ministria. Çdo detyrë që ka të bëjë me naftën, të realizohet. Realizimi i planit të naftës është një çështje shumë e rëndësishme, po realizimi duhet të bëhet me ritmin e caktuar dhe me kursime. Pastaj rëndësi ka edhe çështja e fushave të reja të naftës. Shokët e naftës të punojnë që t'i japin ekonomisë sonë fusha të reja naftë dhe të kenë mirë parasysh se nxjerrja e naftës është një çështje shumë e koklavitur. Në këtë çështje ata kanë bërë shumë përparime dhe siç thanë edhe vetë kanë marrë shumë iniciativa të mira, siç është ajo për zgjerimin e Rafinerisë në Qytetin «Stalin» ose në Cërrrik, përpjekja për të siguruar vajra lubrifikantë etj. Por në të ardhshmen duhet luftuar më me këmbëngulje, zgjuarsi dhe zotësi. Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë të marrë të gjitha masat për të çuar më përpara sektorët e rëndësishëm të naftës.

Zhvillimi i mëtejshëm i naftës kërkon kuadro dhe

---

<sup>1</sup> Në atë kohë kryeinxhinier në Minierën e Kromit në Bulqizë.

njerëz të zotë, të cilët ne do t'i përgatitim vetë. Për këtë tani janë mundësitë, sepse në naftë kemi si shkollat që duhen për këtë sektor, ashtu edhe punëtorë e specialistë të zotë të kësaj dege të rëndësishme.

Shkolla, si kudo, edhe në naftë është fidanishtja, baza e ardhshme për nxjerrjen e kuadrove. Prandaj interesimi për shkollën nga ana e komitetit të Partisë, e drejtorisë së kombinatit dhe e Ministrisë së Minierave dhe të Gjeologjisë duhet të jetë i madh. Por ata të interesohen edhe për punëtorët e specialistët e kategorive të ndryshme të naftës që punojnë në fushat e naftës, të tregojnë gjithashtu kujdes të madh për çdo sondë, kantier, automobil e shofer, çdo gjë të jetë nën kujdesin e veçantë të Partisë dhe të pushtetit, që punonjësit të punojnë dhe të mësojnë sa më mirë se dhe puna duhet të bëhet për punonjësit një shkollë e madhe.

Hapja e një pusi ka rëndësi të madhe, se për shpimin e tij harxhohen deri 60-70 milion lekë, prandaj këtë çështje punëtorët dhe specialistët e naftës duhet ta kuptojnë politikisht edhe ekonomikisht se këto miliona shteti ose i humbet, ose siguron miliona lekë të ardhura. Po nuk mjafton vetëm ta kuptojnë, ne duhet t'i mësojmë njerëzit edhe me eksperiencën e fituar, dhe në sektorin e naftës kemi mjaft njerëz të zotë, siç janë punëtorët me eksperiencë të gjatë, inxhinierët e shumtë dhe një numër i madh kuadrosh të mesëm. Të gjithë këta kanë mundësi të ndihmojnë për edukimin e punonjësve të naftës.

Kujdes i madh të tregohet për ruajtjen dhe për shfrytëzimin e mirë të sondave, sepse ato jo vetëm

kanë rëndësi të madhe ekonomike, por edhe duhen siguruar. Sondat, traktorët, automobilat e çdo makinë tjetër si kudo edhe në naftë të shfrytëzohen në maksimum, plani i tyre të realizohet në njësi, domethënë të luftohet e të arrihet që çdo mjet të realizojë planin e vet. Për këtë qëllim duhet kujdes që nga mirëmbajtja e profilaksia e mjeteve, ndryshe ato nuk do të punojnë aq sa duhet. Atyre sektorëve dhe rrethëve që mund të kenë teprica makinerie t'u hiqen, në qoftë se nuk realizojnë planin si njësi. Në qoftë se, për shembull, Korça ka 180 traktorë, nga të cilët 80 prej tyre nuk e realizojnë planin, atëherë të hiqen këta të fundit dhe të dërgohen në ato rrethe ku ka më pak makina të tilla. Kështu, duke forcuar llogarinë, rrethet do t'i kontrollojnë më mirë makineritë dhe do të luftojnë që ta shtojnë shfrytëzimin e tyre. Iniciativa e Rako Pinës është shumë e mirë, mirëpo ajo nuk po përqafohet nga të katër anët; ka njerëz që marrin traktorë të rinj dhe lënë të vjetrit. Ne edhe traktorë të rinj do të sjellim, po duhen shfrytëzuar mirë ata që kemi, se kjo ka interes të madh ekonomik. Një kujdes i tillë, për t'i shfrytëzuar në maksimum, duhet treguar edhe për sondat dhe po të ketë teprica, të bëhet ekonomi, se ato janë makineri që na kushtojnë shumë.

Rëndësi shumë të madhe ka për vendin tonë industria ushqimore. Kjo degë e industrisë e ka tejkaluar planin dhe për këtë punonjësit e këtij sektori janë për t'u lavdëruar. Pjesa më e madhe e makinerisë së kësaj industrie është e re. Prandaj ato në radhë të parë duhen mbajtur vazhdimisht në gatishmëri, sidomos në ato degë që kanë të bëjnë me punë sezonale:

Është e drejtë ajo që u tha në raport për zgjerimin e asortimenteve dhe që për nevojat e popullit të prodhojmë vetëm mallra të mira e të vlefshme dhe jo të prodhojmë për të prodhuar e pastaj të na mbeten stoqe ose të prodhojmë artikuj ndryshe nga ata që paraqiten nëpër reklama. Një gjëje të tillë i duhet dhënë fund. Ne jo vetëm duhet të plotësojmë planin, por të kemi parasysh që të kënaqim kërkesat e popullit.

Ne nuk jemi në atë stad që ishim 10-12 vjet më parë, kur, për çdo gjë që prodhohim, i thoshim popullit ta merrte. Po të krahasohen mallrat që prodhoheshin atëherë te ne me këto që prodhohen tani, ato do të na duken si gjëra pa vlerë. Po edhe kushtet atëherë ishin të tilla dhe populli nuk ishte aq kërkues si tani. Mirëpo niveli i masave është ngritur, ato tani kërkojnë mallra me cilësi të mirë. Prandaj, gjersa ka mundësi që ato t'i sigurojmë, popullit t'i japim produkte sipas dëshirës dhe gustos së tij. Lufta e Partisë tani duhet të përqendrohet në këtë detyrë të rëndësishme, në përmirësimin e cilësisë së prodhimeve, sepse kjo do të shtojë kënaqësinë e konsumatorëve tanë që do të shikojnë se në vend kultura e prodhimit është duke u ngritur vazhdimisht dhe do t'i urojnë me gjithë zemër punonjësit e ndërmarrjeve prodhuese.

Për bujqësinë nuk do të zgjatem, por dëshiroj të flas vetëm për frutikulturën. Ky sektor nuk është më në atë stad si kuptohet përpara nga fshatarësia. Gjer në një farë shkalle tani fshatarët kanë kuptuar se frutat u sjellin së pari përfitime të mëdha ekonomike dhe ushqimore. Prandaj fshatarët tanë nuk kënaqen më me ato që u kanë mbjellë gjyshërit, tani frutat kanë



marrë kuptimin e vërtetë, si përta i përket ushqimit me to të punonjësve tanë, ashtu edhe për eksport. Kush nuk u kënaq në Vitin e Ri kur pa dyqanet të mbushura plot me fruta? Nuk mbeti njeri, i madh ose i vogël, që të mos ndiente kënaqësi e të uronte push-tetin popullor që i mbushi dyqanet plot e përplot. Mirëpo, që të vjelim, duhet më parë të mbjellim. Në këtë drejtim është bërë një punë e madhe, janë caktuar drejtimet dhe është bërë punë konkrete. Unë jam dakord me kritikën që u bë këtu në lidhje me këtë çështje, për të cilën duhet treguar nga të gjithë kujdes më i madh, sidomos nga Partia dhe pushteti në bazë. Nuk jam dakord me mendimin e shfaqur këtu që plani duhet të quhet i tillë vetëm kur zë pema. Edhe kur mbjellim, themi se kemi realizuar planin e mbjelljeve dhe përpigemi të korrin ato rendimente që kemi planifikuar. Përta i përket frutikulturës gjer tani ne nuk i kemi arritur rendimentet e parashikuara, sepse nuk bëhet një punë e mirë në këtë drejtim, nuk organizohet si duhet puna, por ka edhe shumë faktorë të tjerë që ndikojnë, midis të cilëve edhe ata klimaterikë.

Natyrisht të tëra pemët që mbillen, nuk ka mundësi të zënë. Që të kemi fruta, duhet më parë të mbjellim shumë pemë, por edhe kjo s'mjafton. Të mos tregojmë kujdes vetëm për të mbjellë pemë, po edhe që ato të zënë, bile kujdesi të vazhdojë edhe kur çdo pemë të rritet, të marrë forcë e të japë fruta. Po, edhe pasi të prodhojë, duhet të kujdesemi për pemën, ta krasitim, ta mbrojmë nga sëmundjet etj. Me një fjalë të tregojmë një kujdes më të madh e të vazhdueshëm për frutikulturën dhe vreshtat, që janë një pasuri shu-

më e madhe për vendin tonë, që kanë të bëjnë me ushqimin e popullit dhe me shtimin e eksporteve tona. Ne kemi ndërtuar mjaft fabrika për përpunimin e frutave e të konservave, të tjera do të ngremë në të ardhshmen, po furnizimi i tyre me lëndë të parë dhe funksionimi i mirë i tyre varet vetëm nga puna që do të bëjmë për zhvillimin e frutikulturës.

Për shtimin e frutikulturës kemi ngritur shumë fidanishte shtetërore, tani kanë filluar të krijojnë fidanishte edhe shumë kooperativa bujqësore. Në këto fidanishte kooperativat bujqësore duhet të rritin fidana të shëndoshë dhe të tregojnë kujdes për të gjitha pemët frutore e veçanërisht për ullinjtë. Në këtë drejtim një kujdes më i madh se gjer tani duhet të tregohet nga rinia, e cila, s'ka dyshim, se do të tregohet e papërtuar dhe do ta çojë përpara gjer në fund këtë çështje. Jo vetëm rinia, por për frutikulturën të kujdesen të gjithë, e në radhë të parë Partia dhe organet drejtuese ekonomike e shtetërore.

Mbi të gjitha, shokë, duhet të na preokupojë buka, sepse importojmë dhe do të vazhdojmë akoma të importojmë sasira të mëdha drithi. Tani si asnjëherë kemi rezerva të mira drithi, megjithatë edhe përpara populli nuk ka mbetur dhe as do të mbetet kurrë pa bukë, po duhen bërë përpjekje shumë të mëdha për të arritur rendimentet e planifikuara në kulturat e arave. Edhe në qoftë se do të bëjë thatësi e madhe, po të punohet me mend dhe të marrim masat e duhura me kohë, sidomos për drithërat e bukës, me siguri do ta evitojmë një pjesë të dëmeve të natyrës. Por këtu duhen bërë përpjekje të mëdha nga të gjithë.

Ka kooperativa bujqësore që janë afër njëra-tjetrës, me të njëjtat kushte të tokës, që marrin rendimente të ndryshme, njëra i realizon ose i tejkalon rendimentet, kurse tjetra as që u afrohet. Kjo tregon se ne duhet të luftojmë seriozisht të metat dhe dobësitë tona dhe të bëjmë një luftë të vendosur për shtimin e sasisë së drithërave të bukës në vend. Të jemi të ndërgjegjshëm për t'u bërë të gjitha shërbimet e nevojshme drithërave, sepse kjo mbetet sot detyra jonë kryesore në sektorin e bujqësisë.

Shokët e tregtisë dhe të gjithë shokët e tjerë të kenë kujdes për kërkesat nga importi. Këto të jenë të matura me kandar, asnjë fije më shumë. Ju, shokë të tregtisë, mos u përpiqni të sillni nga jashtë vetëm mallra të lira, të cilat prishen shpejt, por të merrni artikuj e makineri sa më të durueshme dhe më pak të kushtueshme. Në këtë drejtim duhet luftuar shumë dhe, po të bëhen përpjekje, të tillë artikuj gjenden. Në shumë sektorë të ekonomisë ne mund të bëjmë më tepër kursime, kjo duhet pasur mirë parasysh.

Ministria e Tregtisë të zhvillojë një luftë të madhe përsa u përket çmimeve të artikujve që eksportojmë në vendet ku sundojnë zotërinjtë revizionistë. Gjer dje ne ishim shumë më pak kërkues ndaj tyre. Ndhimën me kredi që na jepnin ata, ne e kuptonim drejt si një ndihmë internacionaliste, jo si një mjet presioni e dallaveresh. Kur ata na paraqitnin nga ana e tyre ndonjë vështirësi, ne e kuptonim, e pranonim dhe kur na i paraqitnin mallrat me çmimet që na caktonin kishim besim të plotë te ata, duke pasur mendimin se kishim të bënim me një tregti socialiste, me vëllezër

dhe shokë të vërtetë. Jo vetëm tani, po edhe gjatë kohës së marrëdhënieve të mira me ta ne konstatojmë se shumë nga këta të quajtur shokë na kanë grabitur në çmime. Këtë ia pohoi haptazi shokut Mehmet Viliam Shiroki, i cili, përpara specialistëve të Çekosllovakisë, tha: «këta janë kusarë», prandaj në vitin 1954, u hoqën 6-7 milion rubla, sepse na ishin falsifikuar çmimet.

Meqenëse tani ata kanë vendosur të bëjnë tregti me Shqipërinë, le të urdhërojnë, edhe ne duam të bëjmë tregti me ta. Çekët kanë nevojë për mineral hekuri, mirë, le ta blejnë në ato kushte që janë në tregun ndërkombëtar. Edhe ne kemi nevojë për disa nga mallrat e tyre, prandaj jemi dakord të bëjmë me ta tregti me leverdi reciproke. Për mallrat tona të eksportit, edhe ne jemi kërkues, se lëndët e para që eksportojmë ne, nuk janë të pakërkueshme, bile janë shumë të kërkueshme në tregjet e jashtme. E dimë se çekët kanë shumë nevojë për hekurin tonë, i cili është shumë i mirë, përmban edhe nikel dhe për arsye se vendi ynë është afër tyre në pikëpamje të transportit dhe, më së fundi, se çekët, duke u bazuar në burimet tona, kanë ndërtuar dy fabrika në Çekosllovakia. Me hekurin tonë ata kujtuan se gjetën koloni në Shqipëri dhe nuk na ndihmonin të ngrinin industrinë e përpunimit të hekurit. Por të jemi shumë më kërkues nga sa kemi qenë, të dimë edhe ne të bëjmë tregti dhe kthesën e tregtisë sonë ta bëjmë gradualisht. Këto çështje t'i keni parasysh dhe ju, shokë të rretheve, se nuk zgjidhen me sustë. Gjersa të stabilizohet gjendja e tregtisë sonë të jashtme, në qoftë se disa mallra nuk na i ma-

rrin çekët, atëherë t'u drejtohem tregjeve të tjera. Prandaj edhe ju, drejtuesit e ekonomisë, t'i keni parasysh vështirësitë e përkohshme që do të kemi në këtë sektor, se shumë gjëra nga vendet e Evropës do të na vonohen dhe mund të mos na dërgohen. Kështu ju duhet t'i adaptoheni kësaj situate anormale, gjersa kjo të stabilizohet.

Nuk ka dyshim se çështjet ekonomike janë kryesorët, po unë prisja që jo vetëm ndonjë, po disa diskutantë të ngrinin përpara Plenumit edhe çështje të arsimit dhe të kulturës. Një gjë e tillë nuk u bë. Kjo ndodh jo se shokët nuk interesohen edhe për këto çështje, po fakti është se problemet ekonomike tërheqin më shumë. Kjo është një gjë e mirë, po duhet të kishte edhe diskutime për problemet e arsimit e të kulturës. Ndonjë i jashtëm që do të na dëgjonte, do të thoshte se gjersa këta kanë gjithë këto suksese, edhe në fushën e arsimit e të kulturës janë në rregull. Dhe nuk jemi keq edhe në këtë fushë. Të gjitha këto suksese janë arritur, sepse Partia interesohet edhe për këta sektorë, veçse çështja është që akoma më shumë duhet të interesohej.

Unë thashë se të gjithë sektorët kanë rëndësi për realizimin e planeve tona, por faktori mësim ka luajtur dhe do të luajë një rol të madh në ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë. Lidhur me këto probleme dua të theksoj një çështje me karakter shoqëror, atë të ekonomisë shtëpiake.

Partia duhet të interesohet edhe për këtë çështje, sepse kjo nuk i takon vetëm organizatës së gruas. Është e domosdoshme që Partia të kujdeset për çdo pu-

nonjës dhe familje, në qytet ose në fshat, që të mësohen si të rregullojnë jetën e brendshme ekonomike të familjes. Kjo çështje ka një rëndësi të madhe. Ne kemi krahina që dinë të bëjnë ekonomi, domethënë dinë të kullandrisen me pak. Po tani ne e dimë se nuk është më situata e dikurshme, punonjësit tanë kanë të ardhura më shumë se përpara. Por përsa i përket anës ekonomike shumica e familjeve nuk dinë të ekonomizojnë pasurinë e familjes, nuk dinë të bëjnë si duhet buxhetin familjar për përdorimin e drejtë të të ardhurave, për të blerë bukë, mish, ushqime të ndryshme, veshmbathje etj., etj. Është e vërtetë se te ne janë marrë disa masa për zhdukjen e paragjykimeve fetare, si edhe për disa zakone në dasma, në vdekje, në festa etj., që shkaktojnë harxhime të mëdha. Por kjo nuk mjafton. Çështja është që kur fshatari ther delen, të mos e hajë menjëherë brenda ditës, duke thirrur njërin a tjetrin, dhe pastaj të hajë përsëri një thelë mish pas dy muajsh, po ta racionojë mishin si duhet që të hajë për një kohë më të gjatë. Kështu edhe në drejtime të tjera. Kjo gjë në radhë të parë u takon grave, po edhe te burrat duhet të futim dëshirën për të bërë ekonomi, edhe ata duhet të kontribuojnë në këtë çështje dhe të mos i mbajnë vetë paratë. Me këtë duhet kuptuar jo vetëm ajo që të mos shkojnë e të shpenzojnë kot në kafene, po edhe gjer në gjënë më të vogël, gjer në ngrënien në një kohë nga të gjithë pjesëtarët e familjes, që të mos shtrohen dy sofrat në shtëpi, se kur të jenë të gjithë rreth sofrës, do të hanë së bashku dhe proporcionalisht. Kjo ka rëndësi të madhe edhe për një ngrënie të rregullt dhe me masë. Kur njëri ha një

gjë pa masë, qoftë edhe ushqimin më të shëndetshëm, nuk i bën mirë. Po kur rregullohet si duhet ushqimi, edhe fizikisht, edhe ekonomikisht është më mirë, sepse familja ka mundësi të vërë ndonjë rezervë për ta përdorur për një kohë të vështirë.

Kohët e vështira në familje secili duhet t'i parashikojë vetë, se, po të të ndodhë një fatkeqësi, nuk do të vijë Qeveria të të rregullojë shtëpinë. Pra secili t'i vërë gishtin kokës për t'i parashikuar ditët e vështira dhe gëzimet, se njeriu që punon, ka nevojë edhe të dëfrejë.

Rëndësi të madhe t'i japim higjienës, pastërtisë e shëndetit. Partia interesohet shumë për këto probleme. Kush nuk ndien kënaqësi kur konstaton se te ne përqindja e vdekjeve vjen duke u ulur nga viti në vit? Por që të ulet akoma më tej kjo përqindje, duhet që çështjen e higjienës njerëzit tanë ta futin në gjak.

Papastërtia është armiku më i madh i shëndetit. Ki sa të duash bukë, ushqime, mish, pemë e zarzavate, po nuk pate pastërti, do të të shkatërrohet shëndeti. Çështjes së higjienës, pastërtisë dhe shëndetit t'u kushtohet kujdes më i madh, sidomos në fshat. Higjiena në familje, si dhe higjiena personale janë të domosdoshme. Po kjo çështje nuk zgjidhet me një ditë, ajo ka të bëjë me një edukatë të vazhdueshme dhe nuk i takon vetëm organizatës së gruas. Por në qoftë se ka pastërti në shtëpi, kjo u detyrohet vetëm grave, ndërsa burrat dhe fëmijët janë më pak të kujdesshëm në këtë çështje. Prandaj organizatat e Partisë ta marrin seriozisht këtë problem, të ndihmojnë vazhdimisht or-

ganizatën e gruas dhe ashtu sikurse kujdesen për të gjitha problemet e tjera që kanë të bëjnë me përhapjen e arsimit dhe të kulturës në fshat, të kujdesen edhe për çështjen e higjienës, të pastërtisë dhe të shëndetit.

Edhe disa fjalë për çështjen e kulturës së përgjithshme, për teatrin, muzikën etj. Kudo edhe në fshatra ne kemi ngritur shtëpi e vatra kulture, mjaft fshatra kanë edhe kinemanë e tyre. Por aktivizimi i këtyre institucioneve të rëndësishme në fshat më duket se bëhet në mënyrë shabllone. Për këto ka disa tipa pune, ka edhe instruktorë. Edhe mësuesit bëjnë përpjekje për t'i gjallëruar ato, po akoma nuk shfrytëzohen sa duhet të gjitha mundësitë që ekzistojnë në fshat, dhe këto mundësi duhen kthyer në realitet. Nëpër fshatra ne kemi poetë, bejtexhinj ose ndonjë shkrimtar të nivelit të fshatit. Jo vetëm që këta duhen aktivizuar, po edhe shkrimtarët tanë mund të bëjnë më shumë për fshatin, mirëpo mungon interesimi i duhur nga ana e organizatave-bazë të Partisë, çdo gjë kufizohet brenda fondeve dhe nuk dilet jashtë tyre. Unë mendoj se ka shumë mundësi për të përkrahur iniciativat e shumta që dalin për zhvillimin e artit, muzikës, valleve, recitimit të vjershave të poetëve e të bejtexhinjve fshatarë që kanë një iniciativë të madhe krijuese dhe që dëshirojnë të punojnë bile pa asnjë shpërblim. Në qytete ne kemi estrada, po për fshatin nuk bëhet shumë nga ana e tyre. Mendoj se rreth artistëve profesionistë dhe njerëzve me talent nëpër qytete të krijojmë grupe të mëdha njerëzish me prirje për punë të tilla, që t'i përdorim për të përgatitur e për të shfaqur estrada, jo vetëm nëpër kinema e tea-



tro po edhe në konferenca, e gjer në familje, ku rastësisht me ndonjë rast të gëzuar mblidhen njerëzit për të uruar. Këta njerëz me prirje, në këto raste mund të këndojnë ose të recitojnë diçka dhe ta kthejnë këtë vizitë në një mbrëmje të gëzuar. Për gjëra të tilla, që duken të vogla po që janë shumë të frytshme, kemi shumë mundësi dhe mendoj se duhen bërë, sepse njerëzit ngrihen vazhdimisht, ata kanë kërkesa. Tani me shumicë po shpërndahen edhe në fshatra gjithfarëlloj kuadrosh që kanë mbaruar universitetin, institutet ose teknikumet, njerëz që kanë jetuar dhe i kanë familjet nëpër qytete. Këta njerëz patjetër i tërheq më shumë qyteti, sepse në fshat nuk është krijuar akoma një ambient i tillë kulturor, ku ata të kënaqin shijet e veta dhe të ngrenë në nivelin e tyre gjithë banorët e fshatit. Në këtë drejtim Partia ka mundësi të mëdha për të bërë dhe duhet t'i ndihmojë këta, sidomos njerëzit e artit dhe të kulturës, për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet e tyre.

Nuk duhet menduar se kemi abuzuar kur përkrahim një piktor, kompozitor ose artist të talentuar dhe të kemi frikë mos thonë gjë të tjerët kur plotësojmë disa nevoja të tij. Në qoftë se dikush pëshpërit pse iu dha më parë apartament një artisti ose shkrimtari, e sqaroni mirë dhe e bindni se ky do të na e shpërblejë këtë ndihmë duke krijuar vepra që do të kënaqin kërkesat shpirtërore të punonjësve dhe do t'i shërbejnë edukimit të tyre.

Nëpër ndërmarrjet ngrihet me të madhe çështja e kursimeve, po të jeni të sigurt se asnjëri nuk do të qortojë në qoftë se artistëve diletantë të kombinatit të

tekstileve do t'u bëhen 2-3 kostume të bukura për të dalë në skenë. Një gjë e tillë do t'i kënaqë punëtorët, kur të shohin se artistët e tyre dalin në skenë të veshur sipas pjesës që interpretojnë. Ose një poeti të ri që bën një vjershë të bukur, ç'i koston organizatës-bazë të Partisë t'i japë një ditë leje që ai pas punës të recitojë dhe të ndihmojë që të kalohet një mbrëmje me recitime dhe me këngë? Partinë, pra, duhet ta preokupojnë të gjitha këto probleme, që kanë një rëndësi të madhe shoqërore, por midis tyre, në radhë të parë duhet ta preokupojnë çështjet e arsimit.

Partia kujdeset për këto probleme dhe organizatat-bazë kërkojnë llogari për zgjidhjen e tyre, po ky interesim më tepër duhet të shtohet jo vetëm nga anëtarët e Partisë, ndaj të cilëve duhet të jemi më shumë kërkuar, po edhe ndaj mësuesve e pedagogëve. Partia t'i afrojë këta, t'i pyesë si shkojnë nxënësit. Shokët e organizatave-bazë të bisedojnë me arsimtarët në mënyrë që ata të shikojnë ngrohtësinë e Partisë dhe interesimin e saj për përparimin dhe për edukimin e nxënësve.

Partia të interesohet veçanërisht për ndjekjen e shkollave me korrespondencë nga ana e punonjësve, që ata t'i përfundojnë sa më mirë mësimet dhe të mos punojnë për nota dhe për diplomë, po për të marrë sa më shumë dituri. Kjo ka rëndësi të madhe. Një punonjës nëse mëson sa për diplomë, nuk ka për të ecur mirë, sepse puna e tij e dobët do të duket shpejt. Prandaj kushdo që merr përsipër këtë barrë, sidomos ata që shkollën nuk e ndjekin as mbrëmjeve, po me ko-

rrespondencë, ta dinë se kjo është një punë e vështirë, prandaj duhet të bëjnë përpjekje të mëdha për të mësuar.

Partia kujdeset shumë për arsimtarët, për ngritjen e tyre profesionale e kulturore në nivelin e shkollës ku punojnë. Rëndësi të madhe ka dërgimi i kontingjenteve të caktuara në institutet dyvjeçare që përgatitin arsimtarë për shkollat 7-vjeçare. Në vitet që vijnë shkolla 7-vjeçare do të bëhet e detyrueshme, prandaj qysh tani ne duhet të sigurojmë një numër sa më të madh arsimtarësh për këto shkolla. Në këtë fushë ne kemi bërë mjaft, po kemi akoma shumë për të bërë, sepse deficitet janë të mëdha në plotësimin e kontingjenteve të parashikuara, për shkak se nuk ka sa duhet interesim nga ana e Partisë për dërgimin e numrit të nxënësve të parashikuar në plan për shkollat pedagogjike dhe institutet pedagogjike.

Përsa u përket shkollave e kurseve me korrespondencë Partia t'i kushtojë kësaj çështjeje kujdesin më të madh. Ne kemi nevoja të mëdha për kuadro të lartë e të mesëm në të gjithë sektorët, prandaj të luftojmë që të realizojmë plotësisht detyrat e Kongresit të 4-t në këtë fushë.

Përsa i përket fushatës së mbjelljeve të pranverës mos prisni vendimin që merret si zakonisht dhe shpalljen që botohet në shtyp, po përvishuni punës që tani, të përfitojmë nga koha e mirë, të kemi traktorët në gatishmëri dhe të punohet me të gjitha forcat, në radhë të parë, për sigurimin e bukës si problemin tonë më kryesor.

*Më poshtë, shoku Enver Hoxha foli për disa çështje të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Pasi theksoi qëllimet revizioniste e tradhtare të N. Hrushovit dhe të pasuesve të tij ndaj marksizëm-leninizmit, veprimtarinë e tij armiqësore ndaj Shqipërisë, pajtimin me imperializmin dhe kontradiktat që duken në kampin e revizionistëve, shoku Enver Hoxha tha:*

Ne jemi të sigurt se kauza e madhe e komunizmit do të triumfojë, se vendet socialiste do të shpëtojnë nga sëmundja e revizionizmit, po ky është një proces që kërkon kohë. Partia jonë qëndron dhe do të qëndrojë fort në pozitat e veta, sepse rruga e saj është e drejtë dhe e lavdishme. Rruga e Partisë sonë është për-qafuar nga komunistët revolucionarë dhe nga masat punonjëse kudo. Për rrugën e saj të drejtë dhe vendosmërinë që e karakterizon, Partia jonë gëzon simpatinë e të gjithë marksistëve të vërtetë në botë dhe mbrojtjen e fuqishme, në radhë të parë, të PK të Kinës, si dhe të shumë partive të tjera komuniste e punëtore që janë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste.

Rruga që ndjek Hrushovi nuk e ka jetën të gjatë, për arsye të qëndrimit që mbajnë partitë marksiste-leniniste, si edhe të disfatave që pëson e do të pësojë ai, qoftë në çështjet ideologjike, qoftë në politikën ndërkombëtare. Ne jemi të sigurt se N. Hrushovi patjetër do të dështojë në rrugën e tij, ose do të kalojë në kompromise të hapëta dhe në lëshime skandaloze ndaj imperializmit, gjë që do të shpejtojë tatëpjetën e tij, sepse ai, gjatë këtyre 7 vjetëve që ka ardhur në fuqi, ka pësuar vazhdimisht disfata të mëdha. Bolshevikët e vjetër i shohin veprimet e shëmtuara të N. Hrushovit,

që vazhdon të dërgojë dhëndrin e tij, Axhubejin, me letra te Kenedi. Kështu si bën Hrushovi, nuk zgjidhet fati i botës. Këto veprime i shohin edhe komunistët sovjetikë, prandaj rezistenca e tyre vjen e do të vijë vazhdimisht duke u shtuar.

Rruga jonë, pra, është e drejtë, prandaj të vazhdojmë ta zhvillojmë atë dhe të realizojmë detyrat. Të punojmë për ta ngritur sa më lart politikisht popullin, sepse kjo ka rëndësi shumë të madhe për ne, se do të na ndihmojë të kapërcejmë vështirësitë aktuale ashtu si kemi kapërcyer çdo vështirësi tjetër gjer tani.

Problemi i ngritjes politike të punonjësve tanë në këto situata është vendimtar. Partia menjëherë pas mbledhjeve të Bukureshtit e të Moskës informoi hap-tazi komunistët dhe popullin për të mirat që kishte qëndrimi i mbajtur në këto mbledhje, si edhe për rreziqet e vështirësitë që do të na dilnin përpara. Prandaj populli u bë grusht me Partinë. Kjo tregon, pra, ç'rëndësi vendimtare ka sqarimi politik i popullit. Këtë metodë pune ne s'duhet ta lëmë pas dore. Prandaj artikujt që boton «Zëri i popullit» e që kanë rëndësi shumë të madhe jo vetëm të lexohen nga komunistët, po edhe të punohen nga organizatat-bazë dhe nëpërmjet tyre të bëhen krahasime me luftën që kanë zhvilluar Lenini e Stalini kundër oportunitizmit dhe revizionizmit. Këta artikuj, pra, të lidhen me çështjet teorike. Atëherë anëtarët e Partisë, qofshin edhe ata më të thjeshët e të rinjtë që u vihen për herë të parë çështjeve teorike, do të kuptojnë fare mirë ç'është oportunitizmi i Bernshtajnit ose i Kautskit dhe lufta e Leninit kundër tyre dhe ç'është lufta që i bëjnë sot marksistët e shë-

ndoshë Kautskëve të rinj, siç janë N. Hrushovi me shokë, të cilët, për të luftuar marksizmin, ndjekin po ato metoda siç janë presionet, shantazhet, blofet, kërcënimet etj. dhe veprojnë njëloj si edhe ata.

Lufta e Partisë sonë kundër këtyre armiqve të marksizëm-leninizmit është një luftë që bazohet në mësimet dhe në praktikën e Leninit dhe të Stalinit, prandaj të studjohet thellë kjo nga ata që kanë bërë kurset ose shkollat e Partisë ose edhe nga të tjerët që mësojnë vetë marksizëm-leninizmin, t'i krahasojnë këto mësimet me luftën dhe qëndrimet revolucionare të Partisë sonë. Kështu do të bëhen më të gjalla mësimet teorike. Edhe popullit t'i themi haptazi çdo gjë dhe ta armatosim, se kështu fitorja është e sigurt dhe vështirësitë aktuale do t'i kapërcejmë më me sukses.

Por në këtë drejtim ne duhet të dimë edhe si të punojmë, sepse momentet janë shumë të rënda. Ne, komunistët shqiptarë, jemi realistë, prandaj nuk themi kot se kohët janë shumë të vështira. Por uniteti i radhëve tona është i fortë. Disa parulla të hedhura nga elementë armiq të Partisë humbën, sepse qëndrimet e drejta dhe të vendosura të Partisë kanë ngjallur një entuziazëm dhe patriotizëm të madh në masat e popullit. Këtë situatë të shëndoshë që ka krijuar Partia, ta ruajmë dhe ta forcojmë. Të jemi të durueshëm se mund të ketë njerëz që në këto situata të vështira të çoroditen, të thyhen ose të lëkunden. Prandaj Partia të jetë si mëmë në këto raste, me tërë kuptimin e fjalës dhe t'i sqarojë njerëzit.

Është lehtë ta dënosh ose ta përjashtosh nga Partia një komunist që ka bërë një gabim, po Partia

duhet të punojë për t'i edukuar njerëzit me durim, dhe këtë ajo e ka bërë kurdoherë e do ta bëjë edhe në situatën e sotme të rëndë, se ka njerëz që thyhen. Interesi i Partisë, i popullit dhe i marksizëm-leninizmit është që t'i gjallërojmë këta njerëz dhe t'i futim në rrugë. Kjo nuk do të thotë të mbajmë qëndrime oportuniste ndaj tyre, nga oportunizmi ne duhet të ruhem. Kështu njeriut që gabon, nuk duhet t'i bëjmë lajka, po ta kritikojmë dhe ta bëjmë të kuptojë se dora e hekurt e Partisë është dora shpëtimtare, që synon të mirën e tij dhe të mirën e përgjithshme. Këtë mund ta bëjnë vetëm komunistët, këtë mund ta bëjnë anëtarët e Partisë sonë se ata kanë një eksperiencë të madhe lufte, kurse në partitë e tjera ka lëkundje kolosale, atje ka edhe terror, gjë që nuk ndodh te ne, siç shpifin armiqtë tanë revizionistë. Ne burgosim dhe pushkatojmë tradhtarë të tillë si Teme Sejkon me shokë dhe nuk na prishet puna se hrushovianët e titistët bërtasin për terror në Shqipëri. Terror ka në partitë e tyre. Shumë vetë janë futur në burg në Hungari, kontingjente të tëra komunistësh janë shkarkuar nga detyra me përgjegjësi në RD Gjermane. Kështu ndodh edhe në Bullgari. Ky është terror. Gjersa udhëheqësit në këto vende e heqin veten marksistë, demokratë etj., përse nuk i lejojnë njerëzit të thonë pikëpamjen e tyre?

Me këtë dua të them se Partia jonë di të sillet me njerëzit dhe këtë ajo e ka bërë gjithnjë dhe kështu do të veprojë edhe në të ardhshmen. Të përpiqemi t'i shpëtojmë njerëzit, se armiqtë janë të shumtë. Prandaj duhet të jemi shumë vigjilentë ndaj tyre. Partia të

ketë kujdes për njerëzit kudo që janë, në punë, në shoqëri, në familje, që asnjëri të mos i lëmë armikut dhe ndaj atyre që bëjnë gabime të sillcimi në mënyrë të tillë që t'i vrasë ndërgjegjja dhe t'ia thonë hapur Partisë ato që kanë bërë, të kuptojnë se Partia u do të mirën, në mënyrë që të hyjnë në një jetë të re.

Partia, pra, të luftojë për edukimin e njerëzve me pjekurinë dhe zgjuarsinë e saj, por në këto situata të jetë edhe shumë vigjilente ndaj armiqve. Kjo detyrë të mos u lihet përsipër vetëm organeve të punëve të brendshme po të jetë detyrë e gjithë Partisë, për gjithë komunistët. Në organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme ne kemi shokë nga më besnikët, njerëz me partishmëri të lartë, që nuk i kanë shkelur kurrë direktivat e Partisë. Ata janë të lidhur shumë ngushtë me Partinë në terren dhe me masat e popullit. Ata s'kanë vepruar dhe nuk veprojnë kurrë jashtë direktivave të saj. Partia duhet të bëjë një punë të vazhdueshme në ndihmë të organeve të punëve të brendshme. Kështu njerëzit që lëkunden, ose hedhin ndonjë parullë, Partia t'i thërrasë, t'i këshillojë që të ndreqen, t'i mbajë afër dhe të mos i lërë sa të mbushin kupën, se pastaj s'kemi ç'bëjmë, duam s'duam, do të marrim masa për ata që bëjnë faje. Pra, midis Partisë dhe punonjësve të organeve të punëve të brendshme, të vendoset një bashkëpunim i ngushtë dhe kompakt.

Situata e brendshme dhe e jashtme e vendit tonë është shumë e fortë, siç e thashë, dhe ajo do të vijë duke u forcuar kurdoherë, sepse edhe miqtë tanë janë të fortë dhe të mëdhenj, se me ne janë të gjithë komunistët e botës, kurse revizionistët demaskohen dhe izo-



lohen çdo ditë e më shumë. Kështu do të ndodhë dhe kjo i detyrohet e do t'i detyrohet në radhë të parë punës dhe mobilizimit për realizimin e çdo detyre të anëtarëve të Partisë sonë.

Të rrojë Partia jonë heroike dhe populli shqiptar!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**DISA PIKËPAMJE MBI KRYENGRITJEN E  
FSHATARËSISË SË SHQIPËRISË SË MESME  
(1914-1915), TË UDHËHEQUR NGA HAXHI QAMILI<sup>1</sup>**

**31 janar 1962**

Në «imbroglio»<sup>2</sup> e «çështjes së Orientit», dhe të luftërave të popujve të Ballkanit, çështja e luftës së popullit tonë zë një vend të rëndësishëm, jo vetëm nga pikëpamja thjesht shqiptare, por se lufta e popullit shqiptar për liri kontribuoi, herë direkt, herë indirekt,

---

1 Ky shkrim përbën një studim mbi Kryengritjen e Fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme të udhëhequr nga Haxhi Qamili në vitet 1914-1915, në përgjigje të pikëpamjeve të gabuara që u shfaqën për këtë çështje nga disa historianë dhe studjues të tjerë gjatë diskutimit të maketit të vëllimit të dytë të Historisë së Shqipërisë. Varianti fillestar i studimit mban datën 4 janar 1959. Më vonë shoku Enver e zhvilloi dhe e thelloi më tej këtë studim. Tezat themelore të tij i parashtroi në mbledhjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të 31 janarit 1962, ku u shqyrtua maketi.

Studimi jep vlerësimin marksist-leninist të kësaj ngjarjeje në historinë e popullit shqiptar, njëkohësisht është një shembull se si mund të bëhet analiza dhe vlerësimi i ngjarjeve historike nga pozitat e materializmit dialektik dhe historik.

2 «Imbrogio» (italisht) — rrëmujë.

edhe në luftën për çlirim të popujve fqinjë ballkanas. Fuqitë e mëdha imperialiste të Evropës edhe në këtë periudhë për të cilën po shkruaj, por edhe në periudhat e tjera, kanë pasur synime grabitqare dhe kanë intriguar në kurriz të popujve. Luftën e popullit shqiptar, qëllimin e kësaj luftime, jo vetëm e përçmonin dhe e bastardonin, por e fshihnin, e errësonin, ose e shfrytëzonin për interesat e tyre. Shqipëria dhe populli shqiptar për ta nuk ekzistonte. Shtetet shoviniste të porsalindura në Ballkan, si Greqia e Serbia, luftonin për copëtimin e Shqipërisë. Italia, Austro-Hungaria kishin qëllimet e tyre aneksioniste-imperialiste ndaj Shqipërisë. Turqia, megjithëse me shpirt në dhëmbë, përpiquej të ruante ç'të ruante nga kusëritë e saj. Anglia dhe Franca bënin çdo përpjekje si të kënaqnin, herë Rusinë, herë Gjermaninë, herë Austro-Hungarinë, herë Turqinë, sipas interesave që u diktonin koha, momentet, aleancat. Mund të thuhet se në këtë kohë populli shqiptar nuk kishte asnjë mik që ta mbështeste. Ai duhej të luftonte vetë, me armë, me diplomaci dhe me çdo mjet në këtë situatë të vështirë. Duhet të njohim ne tash, pas 50 vjetëve, se baballarët tanë nuk e kishin punën të lehtë. Patriotët tanë të kësaj periudhe të vështirë dhe të ndërlikuar kanë meritën e madhe se luftuan heroikisht, korrën suksese, patën dhe disfata, vepruan drejt, bënë dhe gabime, por kryesorja është se lufta e tyre, që ishte luftë për ekzistencë e për të mos u asimiluar nga të tjerët, ishte e drejtë dhe e lavdishme.

Është duke u diskutuar maketi i Historisë së Shqipërisë, i përpiluar nga historianët tanë me talent, të vjetër e të rinj, si Aleks Buda, Stefanaq Pollo etj. Dis-

kutimet janë kurdoherë shumë të mira, shumë të nevojshme, shumë të frytshme. Vetëm shokët duhet të kenë kujdes dhe të mos influencohen ose «intimidohen» nga pseudohistorianët demagogë, që përpiqen të mbrojnë të vjetrën, duke veshur gënjeshttrat me petka ultranacionaliste, dhe këtë e bëjnë për të ruajtur «tabutë» e vjetra të pabaza.

Sipas mendimit tim, historianët tanë që kanë përpiluar maketin e Historisë së Shqipërisë, kanë bërë një punë shumë të madhe, shumë të mirë e të lavdërueshme. Ju lumtë atyre! Është e vetmja dhe e para Histori serioze e Shqipërisë. Këta historianë premtojnë shumë dhe me veprat e tyre na nderojnë.

Ne duhet të mbajmë parasysh se periudha e luftërave ballkanike konsiderohet, ashtu siç është në të vërtetë, një periudhë mjaft e ndërlikuar nga pikëpamja e forcave lëvizëse, e drejtimit të tyre, si edhe e orientimit politik të këtyre forcave nga shtetet e mëdha që ndikonin në këto luftëra dhe lëvizje popujsh, veçanërisht në Ballkan. Lufta Ballkanike konsiderohet, pra, në histori si një nga çështjet më të koklavitura.

Por akoma më e ndërlikuar bëhet çështja shqiptare për historianët, sepse fuqitë e mëdha, që kanë ndikuar shumë nëpërmjet diplomacisë dhe ndërhyrjeve direkte, kanë lënë pas dore faktorët popull shqiptar, dhe Shqipërinë si një shtet më vete. Për përfaqësuesit e shteteve të mëdha, duke filluar që nga Bismarku, Shqipëria ka qenë vetëm një shprehje gjeografike, një vend barinjsh i pazhvilluar fare. Qëllimi kryesor i tyre ishte që Shqipëria të copëtohej në mes shteteve të tjera.

Ata nuk kishin asnjë konsideratë për vendin tonë, për luftën që zhvillonte populli shqiptar për liri dhe pavarësi, asgjë nuk i lëvizte dot këta përfaqësues nga pozita dhe pikëpamjet e tyre për ndarjen e Shqipërisë në favor të shteteve të tjera.

Populli shqiptar nuk ka pasur një organizim në atë formë që e kishin edhe shtetet e tjera të Ballkanit, për koordinimin e luftës të tij të përgjithshme drejt qëllimeve të caktuara. Lëvizjet e popullit tonë kanë pasur qëllim të caktuar dhe të drejtë, por në Shqipëri ka munguar një udhëheqje qendrore, një lërësi e organizuar, siç ka qenë te grekët, te serbët, te bullgarët. Por lëvizja për liri dhe pavarësi në këto vende nuk ka qenë aspak më e fortë se ajo e popullit shqiptar, bile ka momente kur lëvizja e popullit tonë mund të konsiderohet shumë më e fortë nga shumë lëvizje të shteteve fqinje.

Veçanërisht për momentet e ndërlikuara historike, siç ka qenë periudha që po analizoj, historianët tanë të mirënjohur, si dhe ata të rinjtë, në qoftë se duan të jenë objektivë, të drejtë dhe në rrugë shkencore për studimin e historisë sonë, duhet të kapërcejnë me guxim disa dogma të vendosura nga historianët e huaj borgjezë, dhe nga historianë shqiptarë borgjezë, të cilët jo vetëm i kanë zhdukur faktet, por edhe ato që janë i kanë shtrembëruar, i kanë interpretuar siç u ka dashur qejfi, duke krijuar një rutinë ose një botëkuptim krejt të rremë e absurd për shumë çështje mbi vendin tonë. Këto interpretime të gabuara të fakteve historike të vendit tonë duhet të jenë të papranueshme për historianët tanë, të cilët duhet t'i interpretojnë faktet në dritën marksiste-leniniste, pavarësisht se do të rrë-

zohen disa «norma» e do të habiten disa njerëz, që historinë e kanë mësuar si papagallë, ose të tjerë që e konsiderojnë atë të dhënë një herë e përgjithmonë e se mbi këto «norma» historike na paskan vendosur «autoritetin» e tyre «shkencëtarë», «historianë» ose «letrarë»! Historia nuk mund dhe nuk duhet të shkruhet sipas qejfit të njërit ose të tjetrit, por në bazë të ngjarjeve, të fakteve, të dokumenteve, si dhe të gojëdhënave e të folklorit. Këto të dhëna duhet të interpretohen drejt. Interpretimet ndryshojnë nga njëri-tjetri, por ai që bazohet në materializmin historik është i vetmi interpretim i drejtë. Historianët borgjezë na akuzojnë se ky interpretim është tendencioz dhe thonë se ata gjithë s' bëjnë kurrë interpretime me tendencë. Ky është «avazi i mukës» i tyre. Le t'i lëmë ta këndojnë me zë të ngjirur këtë avaz, aq na bën neve, tymi të na shkojë drejt.

E keqja është se dokumente të brendshme shqiptare për këtë çështje e të kësaj periudhe nuk ka shumë<sup>1</sup>, gojëdhëna ka, por duhet orientuar drejt, se edhe janë deformuar shumë, duke kaluar gojë më gojë gjatë kohëve e sipas dëshirës e tendencave të njerëzve, pra, sipas interesave të klasave që kanë përfaqësuar këta, sipas pozitive që kanë zënë në kohë të ndryshme, i kanë interpretuar edhe këto çështje. Dokumentet e

---

<sup>1</sup> Gjurmimet e mëvonshme të historianëve shqiptarë kanë nxjerrë në dritë një varg dokumentesh të reja për Kryengritjen e Fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme të viteve 1914-1915, që vërtetojnë tezat shkencore të shokut Enver Hoxha në këtë studim.

shkruara që ekzistojnë, duhet të riletshen e të studjohen me shumë kujdes, dhe në asnjë mënyrë nuk duhet qëndruar në vlerësimet e gabuara që u janë bërë këtyre fakteve nga njerëz qoftë «të mirë», qoftë «jo të mirë» dhe që kanë krijuar në opinion, me dashje ose pa dashje, ato «norma» për të cilat fola më lart. Me një fjalë asnjë dokument çfarëdo qoftë, i brendshëm ose i jashtëm, nuk duhet neglizhuar, nuk duhet skartuar si i pavlefshëm, pa e gjykuar. Faktet që japin historianët borgjezë, jo vetëm në manuale historike të përgjithshme, por edhe në monografi të veçanta, faktet dhe dokumentet diplomatike, të gjitha duhen marrë, duhen studjuar e duhen interpretuar drejt.

**Historianët tanë duhet të kenë parasysh dy gjëra me rëndësi në interpretimet e fakteve historike të kësaj periudhe: shkrimet e Leninit dhe programin madhështor të rilindasve të Shqipërisë, me epiqendër Sami dhe Naim Frashërin. Për të studjuar këtë periudhë me rëndësi të madhe, shokët tanë historianë, që janë marksistë, duhet t'i kenë më mirë parasysh disa gjëra. Studimet e manualeve të thjeshta historike e të monografive nuk duhen marrë ashtu siç i ka shtruar borgjezia, por ngjarjet e kësaj periudhe të koklavitur t'i analizoni me hollësi në dritën e marksizëm-leninizmit. Analiza marksiste e dokumenteve të kësaj epoke është e domosdoshme. Shkrime, raporte ose botime të ndryshme monografike nuk mungojnë. Përveç marksistëve, me Leninin në krye, ka edhe shkrimtarë përparimtarë që mund të studjohen. Për këtë periudhë, për luftën e popujve të tjerë ballkanikë si edhe për imperialistët austro-hungarezë, për Turqinë etj. ka shkruar**

edhe vetë Lenini. Ai nuk ka munguar të flasë edhe për çështjen shqiptare. Shqipërinë Lenini e ka përmendur në fjalime e raste të tjera. Nga këto studime, në bazë të gjykimeve të Leninit dhe të shkrimtarëve e historianëve përparimtarë, mund të sqarohet *imbroglioja* e historianëve dhe e politikanëve borgjezë që kanë folur e që kanë shkruar për këtë periudhë në interes të klasave që përfaqësonin.

Që të mos gabohemi për vlerësimin e ngjarjeve të kësaj periudhe, sipas mendimit tim, një bazë për orientim janë pikëpamjet filozofike, teorike, moralo-politike dhe organizative të Samiut e të Naimit, të cilët në përgjithësi ishin revolucionarë, progresistë, patriotë, demokratë-borgjezë, liberalë, të përshtatshëm për kohën. Duke mbajtur gjithmonë si barometër shkrimet e Leninit dhe të këtyre njerëzve të mëdhenj të popullit tonë, siç ishin rilindasit, e në radhë të parë Naimi dhe Samiu, ne nuk do të gabohemi, ose do të gabohemi shumë pak në studimin dhe në përshkrimin e saktë e në mënyrë korrekte të kësaj periudhe të historisë së popullit tonë. Çështjen e Shqipërisë ata e kishin si pikën kryesore dhe fener ndriçues në gjithë veprimtarinë e vet. Në veprat e tyre letrare, historike e filozofike ata kanë dhënë orientimin e luftës që duhet të bënte populli shqiptar për liri e pavarësi në ato etapa të koklavitura. Këtë ata e kishin parë nga të katër anët dhe në përgjithësi e kanë pasur të qartë se si duhet ta fitonte Shqipëria pavarësinë e vet, taktikën dhe politikën që ajo duhet të ndiqte për këtë qëllim në atë kohë.

Këto të dhëna shokët tanë historianë gjer në një



farë shkalle i kanë pasur parasysh, por duhet t'i kishin dhe më mirë, t'u futeshin më thellë për t'i analizuar dhe për të parë se si u orientuan patriotët tanë të Rilindjes, nga ç'pikëpamje politike e filozofike u nisën ata, si i zbatuan këto pikëpamje në jetë në rrethanat e situatat e Shqipërisë, lidhur me gjendjen revolucionare të vendit, me prapambetjen e popullit, sidomos me intrigat e imperialistëve ndaj popullit tonë dhe popujve të tjerë të Ballkanit.

Sipas mendimit tim, kush ka ndjekur vijën e rilindasve në këtë periudhë, nuk ka gabuar ose ka gabuar më pak, kush nuk e ka ndjekur ka gabuar shumë, kush e ka luftuar dhe shqelmuar ka pasë tradhtuar çështjen shqiptare.

Periudhën e historisë, për të cilën po shkruaj këto radhë, historianët tanë nuk e kanë trajtuar keq, por dua të them se ajo është mjaft skematike. Faktet diplomatike, që zënë vendin kryesor në këtë trajtim, janë paraqitur jo shumë në frymë kritike, dhe disa herë mendoj unë, dilet me konkluzione jo të drejta e të gabuara, përsa i përket karakterit të Kryengritjes së Fshatarëve të Shqipërisë së Mesme ose «Rebelizmit». Këta shokë «rutina» historike, «normat» e vendosura nuk i kanë lënë të lëvizin, por kanë bërë përpjekje që t'i japin kësaj ngjarjeje një ngjyrë «progresiste» dhe disa herë atyre evenimenteve, të cilat në bazë të «normave» të vendosura janë konsideruar «të zeza», t'u ngjitin nga një epitet zbutës, gjoja për «oportunitet». Sipas mendimit tim, kjo pjesë dhe kjo periudhë duhet të rishikohet, pa parti pris me gjakftohtësi, me drejtësi. Këtu është çështja të përcaktohet drejt karakteri i një:

momenti të rëndësishëm shqiptar, në një periudhë të rëndësishme të historisë së Shqipërisë, e që do të ketë reperkusione në luftën e mëvonshme të popullit tonë, në rezistencën e popullit kundër regjimit të feudalëve me Zogun në krye, në Luftën Nacionalçlirimtare të popullit tonë kundër fashizmit italian, nazizmit gjerman dhe tradhtarëve të vendit.

A janë të bindur historianët tanë për formulimin dhe konkluzionet e tyre për këtë periudhë të historisë? Nga informatat që kam, ata janë të lëkundur, i kanë ndryshuar disa herë konkluzionet, por mendoj se «rutina» e historisë dhe demagogjia e disave në diskutime, i ka bërë hezitantë. Duhet ndihmuar që t'i kuptojnë drejt këto çështje.

Të vijmë konkretisht në çështjen: cilët ishin miqtë e Shqipërisë në këtë periudhë që luftohej për çlirimin dhe për pavarësinë e saj? Kjo kishte një rëndësi të madhe. Në atë kohë populli shqiptar nuk kishte miq. Nuk flas për lëvizjen punëtore revolucionare, po e kam çështjen për ata që udhëhiqnin dhe drejtonin qeveritë në interes të vendeve të tyre, pra, për pushtetet që ishin në fuqi. Ato ishin qeveri shoviniste, borgjeze, feudale ose klerikale që çështjen e Shqipërisë e konsideronin si një çështje tregtie. Sipas tyre, Shqipëria duhej të copëtohej. Shqipëria, pra, nuk ka pasur asnjë mik në atë kohë. Ata që i janë bërë «miq» Shqipërisë kanë dalë si të tillë në disa momente politike që kishin të bënin me interesat e tyre. Këto momente patriotët tanë të Rilindjes, që janë shquar në përpjekjet për pavarësinë e atdheut, kanë ditur t'i shfrytëzojnë dhe të orientohen prej tyre. Kjo ka qenë një anë pozitive.

Mik i vërtetë i pavarësisë së Shqipërisë atëherë ishte vetëm populli shqiptar me luftën dhe përpjekjet e tij për t'u çliruar me armë në dorë. Kjo luftë, këto përpjekje ishin faktori kryesor. Gjatë veprimtarisë së vet shumë prej këtyre njerëzve kanë qëndruar konsekuentë, ka pasur prej tyre që janë lëkundur, ose që kanë shkuar edhe më tej, në tradhti ndaj interesave të lëvizjes kombëtare. Kjo ishte e paevitueshme.

Prandaj në këto çështje konkrete mendoj se historianët dhe shkrimtarët tanë duhet të ndiqnin një metodë kritike, në radhë të parë në lidhje me aleancat, të shikuara këto në prizmin e përpjekjeve të popullit shqiptar për liri e pavarësi. Në këto aleanca duhen nxjerrë anët pozitive dhe negative të tyre në momente të caktuara, jo sipas rutinës së caktuar nga borgjezia ose reaksioni i jashtëm, as nga konkluzionet e formulimet e bëra sipas traditës nga elementë që kanë marrë pjesë në këto lëvizje e që kanë mbrojtur pikëpamjet e veta, as nga pasardhësit e tyre, qofshin ata përparimtarë ose reaksionarë. Nga formulimet e bëra përpara, ju, historianët tanë, duhet të shkëputeshit. Ato që ishin formuluar drejt, natyrisht, të mbaheshin, të tjerat ju duhet t'i hidhnit poshtë. Ne rrëzuar një pushtet të tërë, feudalizmin e kapitalizmin dhe vendosëm pushtetin popullor, prandaj asgjë nuk na tremb të rrëzojmë e të hedhim poshtë si gjëra pa vlerë edhe disa pikëpamje e teza historike që s'janë të drejta.

Feudalët dhe borgjezia reaksionare e brendshme si dhe imperialistët dhe historianët e huaj borgjezë (me përjashtim të ndonjë historiani, si historiani francez Simonar, i cili në librin e tij «Essai sur l'Indépendance

albanaise», «rebelizmin» e përcakton më drejt se të tjerët, sido që jo në mënyrë të shumanshme, por vetëm karakterin klasor dhe ekonomik të tij) janë përpjekur, pse kanë pasur interes që Kryengritjen në fjalë të Fshatarëve të Shqipërisë së Mesme ta paraqitin nën prizmin e interesave të tyre, t'ia fshehin karakterin e saj të vërtetë, ta cilësojnë atë si «reaksionare, antishqiptare, antikombëtare, proturke» etj. Në këtë gabim, për fat të keq, kanë rënë edhe historianët tanë që kanë përpiluar maketin e Historisë së Shqipërisë. Borgjezia dhe historianët e saj, si brenda dhe jashtë vendit, janë përpjekur dhe përpiqen «të vërtetojnë» se kjo kryengritje lindi si reaksion dhe kundër «konsolidimit të shtetit shqiptar të porsalindur dhe që merrte formë nën kurorën e mbretit gjerman, Princ Vidit» e të tjerë. Disa intelektualë vazhdojnë t'i zhvillojnë dhe t'i mbrojnë me forcë këto teza reaksionare borgjeze, të kaluara, si «tabu», në lidhje me Kryengritjen Fshatare të Shqipërisë së Mesme dhe këtë e bëjnë me argumente joreale dhe antishkencore e antimarksiste, megjithëse përpiqen gjoja ta studjojnë historinë e popullit tonë në mënyrë shkencore, realiste, marksiste. Jo vetëm kaq, por ata përpiqen të mashtrojnë disa intelektualë të rinj, duke u paraqitur si «zemërgjerë» ndaj qëndrimit jo «të drejtë» që ka mbajtur në parim Partia jonë mbi këtë çështje dhe këshillojnë që «të ndreqet ky gabim i tmerrshëm» pse «ofendon kujtimin e patriotëve» dhe veçanërisht «të kolonelit të huaj holandez Tomson, që u vra si hero kundër rebelëve, për Shqipërinë» etj. Deri këtu venë këta njerëz, të cilët ekzaltohen vetë e duan të ekzaltojnë edhe të tjerët për këtë

mercenar dhe agjent të huaj, kurse, ai, më parë se të udhëhiqte ekspeditën ndëshkimore kundër fshatarëve kryengritës shqiptarë, në interes të agjentit gjerman, Princ Vidit, si i dërguar i qeverisë së këtij princi, së cilës i shërbente, ra në ujdi me përfaqësuesin e «vorio-epirotëve» për të vendosur «autonominë» e krahinave jugore të Shqipërisë, në kundërshtim me interesat e popullit shqiptar.

Por le të hyjmë më në thelb të çështjes. Kryengritësit fshatarë i quajtën aso kohe «rebelë» dhe jo esadistë. Në fakt ky emër u ka mbetur në histori. Ndonjë intelektual dhe shokët e tij mund të pretendojnë se gjoja ata quheshin «esadistë», por ata ishin kundër Esat Pashës<sup>1</sup>, ata e luftuan atë, dhe ky fakt s'ka si fshihet. «Rebel» është një titull i urrejtshëm, i tmerrshëm për feudalët, për imperialistët, për borgjezinë reaksionare të asaj kohe, dhe të çdo kohe, pse këta «rebelë» ishin armiqtë e tyre, pse këta «rebelë» i urrenin ata për vdekje, pse këta «rebelë» fshatarë ngritën krye me armë kundër tyre, kundër kompleteve dhe planeve që bënin mbi kurriz të popullit shqiptar, siç do ta shohim më poshtë.

**Pra përcaktimi që u kanë bërë imperialistët, feudalët dhe borgjezia reaksionare, e brendshme dhe e jashtme, fshatarëve të Shqipërisë së Mesme që ngritën krye si «rebelë», s'ka qenë një përcaktim i keq, por shumë ekzakt.**

---

<sup>1</sup> Esat pashë Toptani — një ndër feudalët e Shqipërisë së Mesme, agjent i serbëve, i grekëve etj., kryetar i «qeverisë së përkohshme» në vitet 1914-1915. U vra nga patrioti revolucionar Avni Rustemi, më 13 qershor 1920, në Paris për tradhti ndaj atdheut.

Vetëm këtu ata s'kanë gabuar. Ata e kanë gjykuar drejt karakterin e kryengritjes fshatare, qëllimet, synimet e saj politike, ekonomike, klasore. Pra, këtu ne jemi plotësisht dakord me ta. S'ka se si përcaktimi të mos jetë rrjedhim logjik i qëllimit klasor të problemit. «Rebelizmi» mund të mos jetë kurdoherë një kryengritje me kuptimin marksist-revolucionar, por në rastin e Kryengritjes së Fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme, ajo ishte me të vërtetë një kryengritje me kuptim revolucionar dhe kryengritësit fshatarë të Shqipërisë së Mesme, sipas bindjes sime, ishin me të vërtetë revolucionarë. Pse është kështu? Po jap arsyet:

Asnjëherë, me sa di unë, në historinë shekullore të popullit tonë nuk është vërtetuar që grupe të mëdha fshatarësh ose lëvizje fshatarësh të kenë pasur karakter «antikombëtar», «antishqiptar», «proturk» etj. Udhëheqës ka pasur që kanë tradhtuar çështjen e atdheut dhe të fshatarësisë sonë, ka pasur udhëheqës mercenarë që gënjenin për një kohë grupe fshatarësh, por që të arrinin të përdornin fshatarësinë kundër interesave të atdheut, asnjëherë dhe në asnjë periudhë të historisë ata nuk i ka lejuar fshatari ynë patriot dhe revolucionar. Tash, sipas zotërinjve historianë dhe «të mësuar» borgjezë, na qenka vërtetuar një lëvizje e madhe fshatare, e cila paska rrokur armët dhe paska luftuar kundër interesave të kombit dhe të atdheut! Ky është një bluf i turpshëm, historikisht është një përcaktim antishqiptar, antikombëtar.

Një klasë me tradita revolucionare dhe patriotike të pamohueshme, fshatarësia e varfër dhe e mesme e Shqipërisë së Mesme, në momentet kritike dhe ven-

dimtare që po kalonte atdheu, e kur do të përcaktohe-  
shin fatet e atdheut dhe të popullit, ngre krye me ar-  
më në dorë. Çështja nuk vihet, siç pretendon S.L. dhe  
shokët e tij, se kush ua dha ose ku i gjetën ata armët,  
por rëndësi ka kundër kujt i ngritën dhe i përdorën  
fshatarët këto armë. Pra duhet shtruar drejt pyetja:  
kundër kujt ngriti krye kjo klasë dhe cilat ishin arsytet  
që e shtynë në kryengritje, cilat ishin objektivat krye-  
sorë të kësaj kryengritjeje? Përsa u përket lëkundjeve,  
taktikave, gabimeve këto janë të tjera gjëra, që zor t'u  
shpëtojë një kryengritje dhe sidomos një kryengritje  
fshatare. Të mos na pengojnë gjethet për të parë pyllin.  
Por edhe këto do t'i analizoj, se pikërisht në çështjet  
sekondare mbështeten historianët borgjezë për të he-  
dhur baltë mbi shpirtin dhe hovin revolucionar të kë-  
saj kryengritjeje fshatarësh shqiptarë.

Faktet tregojnë se fshatarët e Shqipërisë së Mesme  
ngritën krye ose u «rebeluan» kundër feudalëve, kundër  
bejlerëve, kundër pronarëve të mëdhenj të tokave,  
kundër taksave, grabitjeve etj., me armë në dorë dhe  
me violencë, rrëmbyen tokat e feudalëve dhe të bejle-  
rëve, dogjën tapitë e tyre, kullat dhe sarajet e pasha-  
llarëve, vranë bejlerët, qehajallarët dhe agjentët e tyre,  
dhe prandaj në mënyrë të pashmangshme dhe me të  
drejtë u cilësuan si «rebelë». Ata zgjodhën si udhëheqës  
shokët e tyre fshatarë, zgjodhën për komandant të  
përgjithshëm njeriun më të besuar, më trimin, më të  
vendosurin, më të thjeshtin, fshatarin Haxhi Qamili.  
Përse doli në krye të kësaj lëvizjeje Haxhi Qamili, pse  
u shqua ky? Përse nuk doli në krye të saj si koman-  
dant i përgjithshëm i forcave kryengritëse një ideolog

xhonturk, po doli një fshatar i varfër ose i mesëm? Dokumentet dhe faktet luajnë një rol të madh në histori, por Lëvizjen Fshatare të Shqipërisë së Mesme ne nuk duhet ta shohim me syrin e tanishëm, por të kohës së Haxhi Qamilit. Po të gjykojmë ndryshe, nuk jemi konsekuentë. Në atë kohë, që nga Haxhi Qamili e gjer te fshatarët e varfër dhe të mesëm, të gjithë u ngritën me armë në dorë dhe, me kurajë, u vunë në pararojë. Lëvizja Fshatare e Haxhi Qamilit nuk kishte vetëm fshatarë të mesëm në radhët e saj, në këtë lëvizje kishte kryesisht fshatarë të varfër. Kryengritësit vendosën një formë origjinale dhe njëkohësisht tradicionale të qeverisjes së vendeve që pushtonin: këshillat e fshatrave, të cilat vendosnin ligjin, dënimet, mobilizimin ushtarë (ose vullnetarë) etj.

Pra jemi përpara një kryengritjeje klasore fshatare, që ka qëllimet politike, ekonomike dhe organizative shtetërore e ushtarake të saj. Një klasë e shtypur, fshatarësia, ngrihet kundër një klase tjetër shtypëse, feudalëve. Në bazë, pra, qëndron lufta e klasës, lufta për pushtetin politik e ekonomik. Lëvizja fshatare e udhëhequr nga Haxhi Qamili ishte një lëvizje përparimtare dhe i tregonte popullit se rruga e fitores së tij që lufta me armë në dorë, kurse intrigat diplomatike të çojnë dhe në fakt çuan në greminë. Asnjë arsyetim sofistik dhe i fabrikuar, me fraza pompoze dhe plot «barut nationalist», nuk mund ta errësojë qëllimin e madh të Kryengritjes së Fshatarëve të Haxhi Qamilit. Arsyet e vërteta të «rebelizmit» i tregojnë qartë veprimet e kryengritësve. «Rebelët» u rrëmbenin me vullnet me forcë tokat feudalëve e bejlerëve dhe pushkatonin të



gjithë ata që i pengonin në qëllimet e tyre, dhe kjo do të thotë se në radhë të parë mbizotëronin arsyet ekonomike, arsyet agrare, që ishin çështje jetike të fshatarësisë dhe një problem i madh nacional. Zgjidhja e çështjes së tokës ishte e lidhur me fatet e Shqipërisë, me fatin e fshatarësisë. Kush nuk i ka parasysh këto, s'mund të gjykojë drejt mbi këtë problem të rëndësishëm.

Armiqtë e «rebelizmit», vendosën «normat»: «rebelët janë vrasës», vrasin «patriotët». Po pse i vrasin «patriotët»? Pse këta luftojnë për Shqipërinë, përgjigjen ata. Po «rebelët» për kë luftojnë? Për Turqinë, është përgjigjja. Po vrasin njeri tjetër «rebelët»? A i vrasin bejlerët dhe pashallarët? Aspak, përgjigjen ata. Atëherë, sipas tyre dhe sipas «normave», «rebelizmi» është një «kaos», vrit të vrasim, pa qëllim, pa arsye, e kështu, sipas tyre, kemi përpara një kope fanatikësh antishqiptarë (për herë të parë dalin në skenën e historisë së Shqipërisë dhe për herë të parë dëgjohet në historinë e fshatarësisë shqiptare, që fshatarët të jenë kaq të fanatizuar për Turqinë sa t'i vënë zjarrin atdheut të tyre, dhe të shkojnë në litar si pa gjë të keq për baba dovetin). Të arsyetosh kështu siç bëjnë këta, do të thotë të jesh antishkencor, antishqiptar, të mos e njohësh fare karakterin e popullit tënd dhe të mos kesh asnjë fije respekti për ndjenjat e tij liridashëse, për të cilat është shquar shekuj me radhë.

Vihet pyetja: Kush e kishte pjesën dërrmuese të tokës? Feudalët, bejlerët, agallarët. Ku e kishin gjetur ata tokën? E kishin grabitur me forcë, ose ua kishte dhënë sulltani. A nuk ishte i interesuar fshatari ynë për tokën, a nuk e lakmonte atë, a nuk ëndërronte të

kishte ai *de facto* dhe *de jure* tapitë që ndodheshin në sëndyqet e bejlerëve? Sigurisht, përgjigjen «të zgjuarit», por fshatarëve tanë të Shqipërisë së Mesme as u binte ndër mend kjo gjë. Domethënë, sipas këtyre historianëve, fshatari ynë që rronte në baltë, që vdiste nga uria dhe nga sëmundjet, që shihte se çdo ditë djer-sën dhe gjakun ia grabitnin Turqia dhe beu, as që mund të mendonte kurrë të ngrinte krye kundër kësaj gjendjeje. Kjo është absurde. Këta zotërinj «të zgjuar» dhe «të mësuar» mohojnë të gjitha luftërat dhe kryengritjet e fshatarëve tanë, të po këtyre fshatarëve ose të baballarëve dhe gjyshërve e stërgjyshërve tanë kundër osmanllinjve, kundër shërbëtorëve të tyre, kundër sistemit të taksave etj., etj.

Bile trillimet e këtyre antirebelëve arrijnë deri në arsyetime absurde dhe ilogjike. Sipas tyre, «rebelët» u ngritën për Turqinë, që e mbronin bejlerët dhe pashallarët, pra u ngritën pse paskan dashur të rronin në varfëri, në mjerim, në uri, qenkan ngritur për të mbrojtur xhelatët e tyre, bejlerët dhe feudalët (meqenëse S.L. dhe Q.Ç. pretendojnë se «rebelët» nuk e ngritën kurrë dorën kundër një beu, ose feudali) që këta t'i shtypnin, t'i rripnin, t'i turpëronin më mirë! Me të vërtetë kjo do të thotë «të të kenë lënë fare trutë». I marrshin të keqen fshatarit tonë, ai e ka pasur kurdoherë kokën plot dhe zemrën të zjarrtë!

«Rebelizmi» s'ishte as «kaos» dhe as «bjeri t'i biem». «Rebelët», armiqtë e «rebelizmit» i kanë quajtur «inJORANTË» ose «XHAHILË», «fanatikë» e se «hiqeshin» prej hunde, «s'merrnin erë nga politika» etj., gjë që s'është aspak e vërtetë. E kundërta vërtetohet po të interpre-

tohen drejt dhe shkencërisht faktet. «Rebelët» kishin një objektiv politik të caktuar dhe që konsistonte në marrjen me violencë të pushtetit politik nga duart e pashallarëve, feudalëve, bejlerëve dhe vendosjen e pushtetit të tyre, të fshatarëve, domethënë, pushtetin popullor. Veprimet e tyre, pra, në këtë drejtim ishin revolucionare dhe joreaksionare, siç e kanë përcaktuar «normat» e borgjezisë. «Rebelët» nuk luftuan as për Esat Pashën, as për pashallarët e tjerë, por për një pushtet ku të sundonte populli; ata nuk luftuan që t'i ruanin tokat dhe çifligjet për Esatin e për feudalët e tjerë, por u rrëmbyen këtyre shumë toka për t'ua shpërndarë fshatarëve të varfër e të mesëm; ata nuk mblodhën taksa t'ia çonin Esatit dhe Perandorisë Turke, por i fshinë borxhet, tapitë e taksat. Lufta me armë dhe zhdukja e mbeturinave shtypëse të Perandorisë Otomane dhe e bejlerëve, a nuk tregon se «rebelët» kishin objektiva të qartë, pavarësisht se bënë gabime gjatë rrugës? Ata filluan të shkallmonin pushtetin e vjetër dhe mbeturinat e pushtetit otoman, krijuan këshillat e kryengritësve, pavarësisht se në një pjesë të tyre vunë dorë disa krerë turkomanë, dhe ishin të vendosur të mos njihnin asnjë pushtet tjetër që do t'u grabiste fitoret e tyre të fituara me gjak. Dua të them se një ndjenjë e tillë popullore nuk mund të kërkohet nga njerëz që udhëhiqnin një lëvizje për ta çuar popullin në kasaphanë. Unë mendoj se kjo çështje ka një rëndësi të madhe jo vetëm për Lëvizjen e Fshatarëve të Shqipërisë së Mesme, te të cilët shohim një konsekuencë edhe më vonë. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare Shqipëria e Mesme ka qëndruar dhe ka luftuar mirë, kurse mjaft nga ata që

ndiqeshin e persekutoheshin nga Haxhi Qamili vazhduan politikën antishqiptare të bazuar te imperialistët, si Lef Nosi, Cakranjtë e të tjerë. Pra instinktin popullor të kësaj lëvizjeje ne nuk mund ta marrim nëpër këmbë. Këtu qëndron madhështia e «rebelizmit», ndjenjat e zjarrta revolucionare të «rebelëve», patriotizmi dhe instinkti i drejtë politik i tyre, pavarësisht nga gabimet e paevitueshme që janë karakteristike për çdo kryengritje fshatare.

Këtë kryengritje fshatare e kanë akuzuar si «antishqiptare», «antikombëtare», «proturke», «xhonturke» etj., etj., pra e kanë ngarkuar me të gjitha mëkatet. Këto janë shpifje, siç do ta vërtetoj më poshtë.

Kur plasi Kryengritja e Fshatarëve të Shqipërisë së Mesme, e Haxhi Qamilit ose «Rebelizmi»? Ajo shpërtheu, në qoftë se jam fare ekzakt, një vit e gjysmë, afër dy vjet pas datës historike të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë më 28 Nëntor 1912. Kryengritja plasi pas dështimit të përpjekjeve të Qeverisë përparimtare të Vlorës, të kryesuar nga Ismail Qemali, e cila u sabotua dhe u hodh në erë nga intrigat e mëdha të imperialistëve dhe të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe nga shërbëtorët e tyre, bejlerët e pashallarët, që ndihmuan agjentin e tyre Esat pashë Toptanin dhe pashallarët e tjerë reaksionarë; ajo plasi pas organizimit dhe vendosjes në «fronin» e Shqipërisë të agjentit të imperializmit gjerman, Princ Vidit; ajo plasi në pragun e Luftës së Parë Botërore imperialiste, kur Shqipëria po përgatitej nga imperialistët të bëhej plasdarm për qëllimet e tyre, kur fqinjët grabitqarë serbë,

grekë, italianë, po thurnin aleancat për të sulmuar dhe për të copëtuar Shqipërinë, kur Turqia e raskapitur e xhonturqve po përgatitej të futej në luftë përkrah Gjermanisë së kajzer Vilhelmit të dytë. Në këto momente politike të rëndësishme dhe të koklavitura, «rebelizmi» shpërtheu si rrufe, në formën e një lufte të ashpër klasash kundër feudalëve, pashallarëve dhe kundër gjithë imperialistëve e satelitëve të tyre, fqinjëve tanë grabitqarë. Këto janë periudha shumë të rëndësishme, të cilat, po u kuptuan drejt, të bëjnë të kuptosh drejt edhe karakterin e «rebelizmit» dhe kështu rrezohet kalaja prej karte, rrezohen «normat» dhe «parullat» e fabrikuara nga pashallarët e imperialistët kundër Kryengritjes së Haxhi Qamilit.

Tash problemi shtrohet kështu: «Rebelët» bënë mirë që ngritën krye kundër feudalëve, kundër pashës, kundër të gjithë imperialistëve, kundër qeverisë së Durrësit dhe kukullës, Princ Vedit, apo tradhtuan kauzën e Shqipërisë? Kush tradhtoi në këtë mes: «rebelët» apo Pasha, pashallarët me imperialistët, me fqinjët grabitqarë dhe me mbretin Vid? Kush mbronte çështjen e Shqipërisë dhe të popullit, «rebelët» apo të dytët? Cila ishte rruga e drejtë, rruga revolucionare, rruga që të çonte në pavarësinë e Shqipërisë, e para, rruga e «rebelëve» të Haxhi Qamilit apo ajo e imperialistëve, e Esat Pashës dhe e Princ Vedit? Kush mendoi dhe u orientua drejt në këto momente delikate, të koklavitura dhe të rrezikshme, «rebelët» apo politikanët patriotë «pa thonjëza» që e mbështetën Vidin dhe politikën e imperialistëve? Këto pyetje janë të vështira për S.L. me shokët e tij, por tash po u japim përgjigjen dhe

po i sqarojmë. Pika kulminante pas gjithë përpjekjeve të popullit dhe të patriotëve tanë është ngritja e flamurit në Vlorë.

Dita e ngritjes së Flamurit në Vlorë më 1912 ishte nga më të rëndësishmet në historinë e Shqipërisë, ishte një ngjarje historike me një kuptim të jashtëzakonshëm. Sigurimi i një Shqipërie të lirë e të pavarur ishte objektivi, për realizimin e të cilit qe drejtuar gjer atëherë e gjithë lëvizja e Rilindjes sonë Kombëtare, të gjitha luftërat dhe përpjekjet e popullit shqiptar. Këtë e realizoi grupi i Ismail Qemalit, i cili, në ato forma që e lejonin kushtet e atëhershme, grumbulloi në një farë shkalle përfaqësuesit e popullit në Vlorë dhe shpalli pavarësinë e Shqipërisë. Ky ishte një akt heroik kundër të gjithë armiqve të deklaruar të Shqipërisë, të hapët ose politikanë të momentit, që nuk e donin vendin tonë ose e donin vetëm për interesat e tyre. Ngritja e flamurit në Vlorë më 1912 ishte një grusht kundër gjithë këtyre elementëve dhe një çështje e madhe pozitive kombëtare. Kur flamuri u ngrit në Vlorë, Shqipëria shpalli pavarësinë e saj dhe Qeveria e Vlorës hyri në rrugën e konsolidimit të pushtetit që do të siguronte pavarësinë e atdheut e që do të arrinte sigurisht edhe në vendosjen e formës së regjimit në Shqipëri. Ismail Qemali me shokët e tij vepruan me guxim, në mënyrë revolucionare, nuk u përkulën e nuk u frikësuan kur erdhën në Vlorë dhe shpallën pavarësinë e Shqipërisë. Populli ynë e priti kudo me entuziazëm të papërshkruar këtë ngjarje të madhe historike. Populli shqiptar i dha grushtin e fundit ushtarako-politik Perandorisë Otomane, duke kurorëzuar ëndrrat dhe as-

piratat mijëravjeçare dhe revolucionare të tij. Flamuri, simboli i gjakut të derdhur në shekuj, u ngrit, Shqipëria u shpall sovrane, e pavarur, jo vetëm ndaj zgjedhës otomane, por edhe ndaj çdo zgjedhe e zinxhirëve të rinj që farkëtoheshin për ne në kudhrat e imperialistëve e të fqinjëve. Ismail Qemali u tregua patriot i shquar dhe politikan i mençur. Ai dhe shokët e tij studjuan mirë rrethanat dhe vendosën drejt. Ata studjuan mirë situatat politike, u orientuan shpejt, sipas mendimit tim, dhe me diplomaci u mbështetën në ato fuqi të mëdha të cilat shpresonin se do të gjenin përkrahje për t'u njohur në arenën ndërkombëtare pavarësia e Shqipërisë dhe sovraniteti i saj.

Pavarësia e Shqipërisë ishte, në radhë të parë, një grusht i rëndë kundër Turqisë. Deklaroheshim të pavarur kundër kujt? Natyrisht kundër Turqisë. Atëherë vihet pyetja: Ata që ishin pro Turqisë, a duhej të ishin kundër pavarësisë së Shqipërisë, kundër evenimentit historik të Vlorës? Kjo s'ka asnjë dyshim. Atëherë sipas historianëve «të zgjuar» dhe «të mësuar», fshatarët e Shqipërisë së Mesme ose «rebelët» duhej të kishin rrokur armët dhe të ngriheshin kundër ngritjes së flamurit në Vlorë, kundër Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, por përkundrazi, ata i kthyen armët kundër pushtesve të tjerë të rinj, serbëve. Pikërisht ashtu duhej të bënin, po të arsyetosh me logjikën e këtyre zotërinjve sipas të cilëve «rebelëve u digjte zemra për baba dovetin, ishin për Turqinë, ishin antishqiptarë». Për fat të keq të këtyre falsifikatorëve të fakteve historike, asnjë kryengritje e fshatarëve të Shqipërisë së Mesme nuk u vërtetua menjëherë pas ngritjes së flamurit në

Vlorë më 1912. «Rebelët» nuk u ngritën kundër Qeverisë së Vlorës dhe flamurit që simbolizonte pavarësinë. Ky fakt flet qartë për shpifjet e këtyre zotërinjve dhe vërteton nga ana tjetër se fshatarët e Shqipërisë së Mesme, si të gjithë fshatarët e Shqipërisë, ishin për sovranitetin dhe pavarësinë e atdheut, e aprovonin ngjarjen historike të Vlorës dhe shpresonin shumë në të. Dhe s'kishte si të ishte ndryshe. Pse nuk vepruan ndryshe «rebelët», mundësitë i kishin të vepronin: «ideologjinë antishqiptare», «urrejtjen kundër flamurit», «fanatizmin në kulm», «dashurinë e zjarrtë për sulltanin», armë po kishin, edhe kurajua dhe guximi atyre s'u mungonte se i provuan, siç pretendojnë ata që na hiqen si mbrojtësit e çështjes kombëtare. Këta zotërinj, përdorin gjoja argumentin e thënë dhe të stërthënë, derisa është bërë «dogmë» se «Babë Qamili luftonte me flamurin e Turqisë». Këto argumente janë për «gogotë», po më poshtë do t'i analizoj si dhe ç'rëndësi kanë këto «fakte» përpara vijës së përgjithshme të «rebelizmit», sa reale e sa të vërteta mund të jenë përpara faktit të pamohueshëm që fshatarët e Shqipërisë së Mesme nuk u ngritën kundër Ismail Qemalit, as kundër Qeverisë së tij, as kundër Ditës së Flamurit, as kundër flamurit, por gati dy vjet më vonë. «Rebelizmi» pra plasi në momente, që mund t'i quajmë të menduara mirë nga udhëheqësit e kryengritjes.

Ose duhej pranuar zgjedha e huaj dhe të varej fati i atdheut te tradhtari Esat Pasha dhe te agjenti gjerman Vid, që së bashku shkatërruan shpresat që lindën në Vlorë, ose duhej ngritur me armë në dorë siç bënë «rebelët». E vetmja rrugëdalje nga kaosi, nga



tradhtia ishte revolucioni popullor, ishte kryengritja e armatosur. Këtë moment politiko-ushtarak e kuptuan vetëm «rebelët» dhe prandaj kryengritjen e bënë ata. «Rebelët» ishin në rrugën e drejtë, në rrugën revolucionare, në rrugën shqiptare. Një pjesë e krerëve patriotë «pa thonjëza» që ishin shquar në atë kohë në çështjen shqiptare, për fat të keq, këtë moment nuk e kuptuan drejt, nuk e kuptuan dot, nuk u shkëputën nga besimi i tepruar ndaj politikës bizantine të imperialistëve, ata ishin të shkëputur nga faktori vendimtar popull, ata qëndruan pas, kurse «rebelët» dhe Haxhi Qamili ishin në pararojë. Instinkti i drejtë popullor, traditat luftarake dhe revolucionare i shtynin përpara «rebelët» dhe jo «fanatizmi» ose «dashuria për sulltanin ose për flamurin gjysmëhënë të Stambollit». «Rebelizmi» nuk ishte as në interes të Turqisë, as të Gjermanisë, as të Austro-Hungarisë, as të Italisë, as të Serbisë, as të Greqisë, as të bejlerëve dhe as të pashallarëve, por në interes të popullit shqiptar, të sovranitetit dhe të pavarësisë kombëtare, dhe pikërisht pse ishte kështu prandaj të gjitha forcat reaksionare u lidhën kundër «rebelizmit» dhe e shtypën. E shtypën se nuk u leverdiste, jo pse fitorja e «rebelizmit» në Shqipëri do t'i jepte shpirt të vëdekurit e të pakallurit të Bosforit, po se prishte të gjitha planet e koalicionit të egër antishqiptar. Kjo është e qartë.

Tash, për të mbrojtur atë që s'mbrohet, por për të cilën jemi ne pas 50 vjetëve në gjendje të gjykojmë drejt e me gjakftohtësi, koalicioni antishqiptar dhe me të shumë njerëz të ndershëm të asaj kohe, të gënjyer prej tij, krijuan «historinë» mbi «rebelizmin», përdorën

dhe shfrytëzuan gabimet që ata bënë dhe që ishin të paevitueshme, idealizuan veprimet e veta, çdo gjë të tyren e paraqitën «të pagabueshme», «të drejtë», «patriotike», «proshqiptare» etj. T'i analizojmë pakëz më me kujdes këto gjëra. Në qoftë se qëndrojmë, ose gozhdohemi në idealizimet e bëra, dhe të «konsakruara» për disa patriotë dhe udhëheqës, të periudhave të kaluara, në qoftë se kemi frikë se mos dalim nga «vija e caktuar» dhe bëjmë gjynahe, atëherë historinë do ta shkruajmë gabim, gjërat do të vihen shtrembër dhe në vend që t'i vëmë vetullat, do t'i nxjerrim sytë historisë që kemi ndër mend të botojmë. Natyrisht masa, sa e si do t'i nxjerrim këto çështje, është një problem tjetër, por që në analizën e fakteve dhe në interpretimin shkencor të tyre t'i neglizhosh gabimet, lëshimet dhe të shkosh me ëndrra dhe me përralla, ose me mendimin se mos lëndohet njëri ose tjetri, mos bjerë nga «piedestali» ose mos i ulet «rutbeja» njërit ose tjetrit, kështu nuk mund të veprohet.

Qeveria e Vlorës dhe kryetari i saj Ismail Qemali, përveç veprës së madhe patriotike që kryen, në punën e tyre shumë herë nuk janë treguar konsekuentë, të fortë, organizatorë të shkathët dhe të shpejtë në marrjen e vendimeve etj. Ata kanë bërë lëshime, gabime, kanë qenë të lëkundshëm qoftë në politikën e brendshme, qoftë dhe në çështjen e alcancave në shumë raste, në momente decizive. Ne që e gjykojmë me gjakftohtësi dhe pas kaq kohësh Qeverinë e Vlorës, mund të themi, duke studjuar përbërjen e saj, se ajo kishte në gjirin e vet elementë të borgjezisë së mesme dhe intelektuale, kishte dhe feudalë e bejlerë të pakontro-

lluar, sidomos nga këta të fundit, të tillë që s'kishin treguar as shenja patriotizmi. Ismail Qemali është gjeundur në situata të vështira, ka dashur të bëjë kompromise për të përfituar nga influenca që mund të gëzonin e që gëzonin në fakt këta elementë feudalë në shtresat e mesme e të pasura të vendit, e që kishin fituar një autoritet politik gjatë sundimit të Perandorisë Otomane. Pra Qeveria e Vlorës do të haste në vështirësi të panumërta, sikundër që hasi, dhe Ismail Qemalit do t'i viheshin gurë në rrota në veprën e tij të lavdërueshme. Ismail Qemali, në vija të përgjithshme, në punën e tij politike, morale dhe organizative, duhej të inspirohej, të udhëhiqej, sipas mendimit tim, nga pikëpamjet progresiste, demokratike revolucionare të Naimit dhe të Sami Frashërit, në kushtet e brendshme dhe të jashtme reale të asaj kohe. Këtë ai, mendoj unë, nuk e pati kurdoherë parasysh. Qeverisë së tij, Ismail Qemali u përpoq t'i jepte një formë më shumë «representative» për jashtë, në fushën e diplomacisë, dhe më pak «representative» dhe të lidhur me forcat popullore të brendshme. Mund të gjente njerëz patriotë në vend, të lidhur me masat e aty duhej të mbështetej, në radhë të parë dhe fuqimisht, Qeveria e Vlorës. Ky faktor vendimtar, lidhjet e ngushta me masat, puna konkrete me to, mbështetja e fuqishme dhe konkrete që do të forconte pushtetin politik, organizativ, ushtarak dhe ekonomik të Qeverisë së Vlorës e që do të siguronte pavarësinë, u nënvleftësua. Ismail Qemali ishte një politikan idealist, ai kishte më shumë besim në kombinacionet politike të jashtme, prandaj edhe i vuri rëndësi gati kryesisht kësaj ane.

Kombinacionet diplomatike kishin rëndësi të madhe sidomos në atë kohë, duhej siguruar një përkrahje nga jashtë, nga fuqitë e mëdha, duheshin studjuar koniunkturat politike. Mund të themi se Ismail Qemali në këtë drejtim nuk manovroi keq. Ai pa se Austro-Hungaria, për interesat e veta të atyre momenteve, ishte për mbështetjen e një «Shqipërie independente». Asnjë shtet tjetër i madh, ose nga fqinjët nuk ishte në këto pozita të Austro-Hungarisë, përkundrazi ata Shqipërinë donin ta copëtonin dhe vepronin për këtë qëllim. Më vonë koniunkturat politike u ndërlikuan. Ismail Qemali ishte shqiptar, patriot i ndershëm dhe bëri mirë që nuk hyri në kombinacione të dyshimta me fuqitë imperialiste. Por dobësitë e politikës së tij qëndrojnë në faktin se politikës së jashtme Ismail Qemali i vuri rëndësinë më të madhe, shpresoi shumë dhe neglizhoi forcimin e pushtetit brenda. Duhet të njohim se armiqtë e Shqipërisë dhe të Qeverisë së Vlorës në rrugën e tyre të tradhtisë manovronin me shkathtësi. Këta peshkonin në dëm të pavarësisë së Shqipërisë, futeshin në kombinacionet e imperialistëve, vendosën tok me ta formën e regjimit, sollën mbret të huaj, organizuan forcën e xhandarmërisë, likuiduan Qeverinë e Vlorës dhe krijuan qeveri të re.

Përse Qeveria e Vlorës nuk pati jetë të gjatë dhe nuk mundi të konsolidonte pushtetin demokratik borgjez? Në radhë të parë, Qeveria e Vlorës nuk pati parasysh në përbërjen e saj mbledhjen e përfaqësuesve të popullit që u bë në Vlorë dhe vendosi Shpalljen e Pavarësisë. Qeveria e Vlorës u rrethua nga shumë njerëz të klasave të pasura; ajo nuk diti t'i rrethonte

këta me elementë patriotë dhe luftëtarë për të kundërbalancuar veprimtarinë e saj. Kështu drejtimin e ekonomisë ia ngarkoi Myfit Libohovës<sup>1</sup>. Po kështu edhe forcat e armatosura i kishte Esat pashë Toptani, i cili mendoj se, për të marrë në dorë fuqinë, duheshin krijuar forcat e armatosura, prandaj krijoi xhandarmërinë dhe punoi me masat fshatare për interesat e tij tradhtarë. Shpresat e Ismail Qemalit të Evropa dështuan. Fuqitë e mëdha i vunë mbi kokë Qeverisë së Vlorës dhe asaj të Durrësit Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit. Të gjitha këto janë disa faktorë që çuan në rënien e Qeverisë së Vlorës. Pra Qeveria nuk u zgjerua me njerëz më të lidhur me masat dhe njerëz të tillë nuk mungonin.

Në radhë të dytë, Qeveria e Vlorës nuk doli me një program më të gjerë dhe më të qartë ekonomik. Natyrisht, ky program nuk do të ishte siç mendojmë ne sot, as me parullat e tanishme, po një program i cili do të kishte të bënte me çështjen e pavarësisë. Pra, nuk u hodhën disa parulla ekonomike në radhë të parë në lidhje me problemin fshatar, se dihet që atëherë Shqipëria nuk kishte industri, prandaj në atë kohë çështja fshatare ishte i vetmi problem me rëndësi për t'u zgjidhur (çështja e tokës të paktën me një perspektivë jo të afërme dhe jo një reformë agrare siç e kuptojmë sot) me një reformë organizative të vendit jo vetëm në letër, por me detyra konkrete për krahinat

---

<sup>1</sup> Myfit bej Libohova, një ndër feudalët e Shqipërisë së Jugut, agjent i imperialistëve italianë, ish-anëtar i qeverisë proitaliane të Durrësit (1918-1920) dhe ministër i Financave në qeverinë e Zogut më 1925.

dhe pleqësitë, me organizimin e forcës ushtarake popullore (këtu do të gjente vështirësi në lëmin diplomatik, por duhej kapërcyer), por kjo ishte nga më të rëndësishmet. Në këtë terren Qeveria e Vlorës do të kishte sukses të madh në popull, do të përkrahej dhe s'do të gjente vështirësi në organizimin në formë çetash. Ajo nuk u bazua në forcat dhe në mundësitë që kishte brenda Shqipërisë për të krijuar në vend forcat e armatosura dhe kjo mundësi nuk mungonte për të krijuar një mbështetje popullore. Armatosja e kësaj force mund të bëhej shumë lehtë, me një vendosmëri më të madhe, duke çarmatosur repartet turke që ndodheshin të izoluara dhe të raskapitura. Kjo gjë nuk u bë. Natyrisht populli priste, ishte i gatshëm, ishte entuziast, por Qeveria s'veproi aktivisht në këtë drejtim. Esat Toptani veproi për hesap të tij, ai kërcënoi me «ngritjen e popullit», dhespoti i Durrësit intrigoi, kjo ishte puna e tij dhe këtë punë ai do ta bënte, por puna e Qeverisë së Vlorës nuk ishte «të varte mëlçinë» në qafën e një tradhtari, siç ishte Esat Pasha dhe as të priste një kolonel holandez, agjent gjerman, që të organizonte xhandarmërinë e rregullt shqiptare për ta lëshuar më vonë kundër «rebelëve» ashtu siç bëri nipi i Esat Pashës më vonë, Ahmet Zogu, që ngarkoi kolonelë anglezë të organizonin xhandarmërinë, për ta lëshuar si qen të tërbuar mbi popullin shqiptar.

Ç'formë do t'i jepte Qeveria e Vlorës regjimit në Shqipëri? Do të ishte një republikë, apo një monarki? Në qoftë se do të shpallej monarki, mbreti do të ishte vendës, apo i huaj? Në qoftë se do të ishte i huaj, nga ç'kombësi do të ishte? Të gjitha këto janë pikëpyetje,

të cilat duhen sqaruar. Qeveria e Vlorës nuk na i shpjegon, por as «historianët» s'na i bëjnë të qarta. Kjo s'është e qartë për ne, por dimë një përpjekje të Ismail Qemalit për t'i dhënë formë monarkike Shqipërisë, me një mbret me nënshtetësi turke, ose princ turk. Këtu lidhet çështja e arrestimit të Beqir Grebenesë etj. Ismail Qemali as e la të zgjatej kjo tentativë. Imperialistët kishin plane të tjera mbi Shqipërinë, kishin zgjedhur mbret tjetër, gjerman. Kjo të lë të mendosh se Ismail Qemali nuk ishte dakord plotësisht me zgjedhjen e një mbreti gjerman. Por është shumë interesante kjo ide që i dështoi që në embrion Ismail Qemalit për një princ turk, në fronin e Shqipërisë. Borgjezia s'flet fare për këtë mendim të Ismail Qemalit, historianët borgjezë mund dhe do të dëshironin që Ismail Qemalin ta diskreditonin dhe ta quanin dhe atë proturk, por këtë s'e bënë dhe s'e bëjnë se nuk i lejon personaliteti i Ismail Qemalit dhe patriotizmi i tij i paatakueshëm. Ne, komunistët shqiptarë, nipërit e Ismail Qemalit dhe të fshatarëve të Haxhi Qamilit, s'mund të na akuzojnë dot për «proturq» siç i akuzonin ata; tani jemi në pozita të tjera nga ato në të cilat u gjend Plaku patriot dhe diplomat i hollë, Ismail Qemali. Vihet pyetja: kot vallë i shkoi ndër mend Plakut antiturk, që bëri punën e madhe të Vlorës, të mendojë për një princ turk në fronin e Shqipërisë së pavarur? A mos vallë ky u lëkund në veprën e madhe patriotike që bëri? Jo, sipas mendimit tim, Plaku i Vlorës pati një shkëndijë mendimi të drejtë, prej shqiptari dhe prej diplomati, por u tërhoq shpejt, pse pati frikë, sipas mendimit tim, se mos akuzohej, për proturk, që ai nuk ishte dhe kishte

dhënë prova për këtë. Po të insistonte dhe të vepronte për realizimin e këtij mendimi, me siguri Ismail Qemali do të akuzohej proturk dhe ç'nuk do të thoshin për të. Progjermanët, proaustriakët, proitalianët, ata që ishin pro fqinjëve grabitqarë do ta quanin Plakun patriot «tradhtar», «xhonturk», «proturk», ashtu siç bënë për «rebelët», për Haxhi Qamilin. Ismail Qemali i mblodhi shpejt këmbët dhe iu vu kapaku kësaj çështjeje.

Duhet të dimë se për Ismail Qemalin të insistonte në mendimin e tij në ato kohë ka qenë e vështirë, por ideja e tij s'mund të hidhej poshtë si e gabuar. Kurse «rebelët», në qoftë se pranojmë tezën se «kërkonin mbret turk» etj., kanë treguar më kurajë dhe me armë në dorë tentuan të zbatonin mendimin e Ismail Qemalit. Këta u shtypën me armë nga kundërshtarët imperialistë të të gjitha ngjyrave. A ka pasur lidhje konkrete për këtë ide në mes Ismail Qemalit dhe disa krerëve të «rebelizmit», që historianët borgjezë i dënojnë *en bloc* si «xhonturq», «antishqiptarë», «antikombëtarë»? Kjo ca më pak, nuk mund të dihet.

Nga i lindi ky mendim i «princit turk» Ismail Qemalit dhe a ishte me vend? Ky mendim i ka lindur atij, sipas gjykimit tim, nga situata reale. Ismail Qemali, pas ngritjes së flamurit, bën përpjekje të mëdha për të konsoliduar pavarësinë e Shqipërisë, derisa bëri edhe tratativat me italianët për krijimin e bankës, gjë që nuk u prit mirë në popull. Por në një moment ai pa më qartë qëllimet grabitqare të atyre që ai mendonte, si «idealist», se do ta mbronin Shqipërinë. Ai i gjykoj drejt si një sukses vendimet e Konferencës së Londrës të vitit 1913, ai i gjykoj më drejt qëllimet gjermane



dhe austro-hungareze, gjykoj qëllimet grabitqare të Italisë dhe të fqinjëve serbë dhe grekë. Ai po e shihte se Evropa po shkonte drejt luftës. Ismail Qemali si politikan dhe njeri i mësuar po e shihte edhe më mirë ndarjen e fuqive të mëdha dhe prirjet e tyre. Në këtë kaos të madh botëror që po përgatitej, Ismail Qemali, siç e gjykoj unë, mendoi të mos e linte Shqipërinë e porsalindur në mes të zjarreve, por në këtë rrebesh t'i krijonte edhe miq të tjerë direktë që s'kishin synime të drejtpërdrejta mbi Shqipërinë, siç ishin bullgarët dhe miq të tjerë të mundshëm nga fuqitë e mëdha, që përkrahnin rivendikimet greke e serbe, por që mund të mbronin eventualisht edhe të «sëmurin e Bosforit». Shqipëria, pra, mund t'i siguronte këta miq, duhet të ketë menduar Ismail Qemali, nëpërmjet gjestit simbolik të vendosjes së një «princi turk» në fronin e Shqipërisë. Pra Ismail Qemali kërkonte të çante frontin, të çante rrethimin kundër grekëve e serbëve, ai me këtë mendim deshë të afrohej me bullgarët. Mendoj se Ismail Qemali kishte gjykuar drejt. Kjo ishte një politikë e zgjuar e tij, sepse ai konkretisht pa se Turqia në atë kohë nuk përbënte ndonjë rrezik për Shqipërinë. Rrezik për vendin tonë ishin në atë kohë krali i Serbisë, perandori i Austrisë, i Gjermanisë etj. Prandaj për vendin tonë nuk prishej ndonjë punë në qoftë se vinte këtu ndonjë princ turk. Pse e mbulojnë ata këtë gjest të Ismail Qemalit dhe vënë në dukje atë që Haxhi Qamili ka thënë se duam një mbret të Turqisë? Pra në momentin kur Turqia bëhej e parrezikshme për ne, Ismail Qemali ngrihet dhe bën një gjest të zgjuar politik dhe këtë në marrëveshje edhe me

bullgarët. Me këtë hap të tij ai synonte të përcante frontin e atyre që në Ballkan ishin kundër Shqipërisë. Por ai nuk shkoi më tej nga mendimi. Po t'u referohemi datave ekzakto, që unë tash nuk i kam parasysh, del se fill pas këtij mendimi, marrëveshja që pat bërë ai u muar vesh nga imperialistët. Në Vlorë Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit arrestoi dhe dënoi me burgim të përjetshëm Grebenenë, u arrestuan një numër oficerësh shqiptarë, që shërbenin në ushtrinë turke etj. Kështu u dogj për ta karta e Qeverisë së Vlorës dhe e Ismail Qemalit. Ai u flak prej tyre.

Qeveria e Durrësit me Esat pashë Toptanin në krye e me bejlerë e agallarë zëvendësoi atë të Vlorës, imperialistët caktuan edhe formën e regjimit në Shqipëri, që do të ishte regjimi i Princ Vidit. Pikëpamja se rreth qeverisë së Vidit u grumbullua vegjëlia, se ajo ishte e vetmja formë shtetërore që duhej mbrojtur, është një pikëpamje e historianëve gjermanë. Po të analizojmë drejtimet dhe qëllimet e austro-hungarezëve del se ata nuk ishin për një Shqipëri të pavarur, ata pranonin të krijohej shteti shqiptar vetëm për eventualitetet politike. Ju e dini në ç'gjendje të këputur ishte në atë kohë Perandoria e Habsburgëve, atë e kishte mbuluar arterioskleroza, te ajo zotëronin pikëpamjet gjermane, ajo vepronte sipas interesave gjermane dhe në atë kohë kishte filluar të lëkundej, sidomos në Hungari e pastaj në Serbi.

Pra ardhja e Vidit në Shqipëri nuk duhet konsideruar si një akt pozitiv, po si një koniunkturë e shteteve të fuqishme të Antantës dhe të shteteve të Evropës Qendrore për përgatitjen e luftës së madhe botërore.

Në një kohë kur po përgatitej kjo luftë, duhet të ishte naiv që të thoje se qeveria e Vidit që me të vërtetë një qeveri pozitive. Dihet dhe është fakt se sa kohë që ishte Vidi në fuqi, në Shqipëri vepronte Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, ku lëvrinin të gjitha intrigat.

Në goftë se disa nga historianët tanë pranojnë se qeveria e Vidit është pozitive dhe e argumentojnë këtë me faktin se në atë qeveri morën pjesë patriotët Luigj Gurakuqi e Bajram Curri, bashkëpunëtorë të Ismail Qemalit, kjo nuk është me baza. Roli i Luigj Gurakuqit ishte shumë i madh në Qeverinë e Vlorës, po ajo u likuidua për shkaqet që u thanë më sipër. Në vend të saj lindi qeveria e Durrësit. Esat pashë Top-tani mori fuqinë në dorë, erdhi Princ Vidi dhe Esati u vu nën drejtimin e tij dhe më në fund u dorëzua të italianët, që ishin në kundërshtim me Perandorinë e Habsburgëve. Prandaj nuk duhet cilësuar pozitive qeveria e Vidit duke u nisur nga prezenca e Luigj Gurakuqit dhe e Bajram Currit. Pjesëmarrja e këtyre dy patriotëve që një orvatje, në përshtatje me situatën e asaj kohe, për t'i dalë në krye kësaj shtate, por kjo nuk do të thotë aspak se qeveria e Vidit ishte në interes të vendit. Sillet edhe fakti që Vidi vrau pashallarët, po këtë ai e bëri për të mobilizuar masat në favor të qeverisë së Durrësit dhe ky akt tregon karakterin tranzitor të qeverisë së Vidit. Në këtë periudhë plasi «rebelizmi» dhe u zhvillua me furi.

Ideologëve të vjetër, të shqiptarizmit të pastër, duhet t'u vëmë në dukje meritat e tyre, patriotizmin e tyre, por t'i konsiderosh këta të pagabueshëm kjo

s'është aspak e drejtë dhe ca më keq fajet e tyre t'ua hedhësh të tjerëve. Populli shqiptar me të drejtë në ato kohë kishte nevojë për udhëheqje, pse ishte prapa, pra dhe fshatarët e Shqipërisë së Mesme kishin nevojë për udhëheqje. A pamë ndonjë nga ideologët e shqiptarizmit të pastër të dilnin në krye të «rebelëve»? Jo s'pamë. Pse? pyesim. S'ka përgjigje tjetër, veçse ata kanë gabuar, ata ishin larg masave popullore. Esat Toptani është më aktiv në rrugën e tij të tradhtisë, ai bënte ç'bënte influenconte me rrenat e tij, ai i kërcënonte kundërshtarët me «rebelët», por megjithatë, «rebelët» u ngritën kundër tij. Kush i udhëhoqi «rebelët»? Ky është një problem tjetër shumë interesant që duhet sqaruar drejt. Sipas historianëve borgjezë, sipas «normave» të vendosura, sipas logjikës së «pagabueshme» dhe «të ndritur» të S.L. e ndonjë tjetri, ishin xhonturq shqiptarë, ose të ardhur fshehtazi nga Turqia, ishin anti-shqiptarë, antikombëtarë. Pra këta ishin të tillë, kurse Vidi, kolonel Tomsoni, Turhan Pasha dhe qeveria e Durrësit, ishin «proshqiptarë» ishin «kombëtarë» etj. Të parët «luftonin kundër Shqipërisë», të dytët «për Shqipërinë». Kjo «normë» është false, johistorike, është me të vërtetë antishqiptare, e kundërta është e vërtetë. Tashti ta gjykojmë.

Cilët ishin ideologët «xhonturkistë» që udhëhiqnin «rebelizmin», cila ishte prejardhja e tyre, botëkuptimi, edukata e kaluar e tyre, lidhjet shpirtërore, politike, organizative me xhonturqit e vërtetë etj., ky është mister. Flitet vetëm se këta ishin «xhonturq», «donin Turqinë dhe urrenin Shqipërinë, urrenin flamurin, ishin fanatikë». Njëri prej tyre, bile, «kishte ar-

dhur me qëllim nga Turqia, si agjent organizator». Kjo është e tërë historia e tyre. Kështu është shkruar dhe vazhdon të shkruhet kjo histori. Vetëm fakti që këta u gjendën ose u vunë në krye të «rebelizmit» duhet të na shtyjë t'i njohim këta njerëz. Këta kishin disa qëllime në kokë, ishin politikanë dhe që i zbatuan pikëpamjet e tyre në jetë, mirë ose keq, edhe pse nuk është gërmuar çështja e tyre, por vazhdon të rrijë e mbuluar me vellon e zezë të tradhtisë që i kanë hedhur. Vazhdohet me një logjikë të çuditshme, pa e vrarë aspak mendjen, dhe me një inkoshiencë të çuditshme të ecet në gjurmët e atyre kundër të cilëve luftuan «rebelët». Prej tyre largohemi si djalli nga thimjami, ndërsa kur bëhet fjalë për ata që ishin proitalianë, progjermanë e proanglezë, atëherë po, historia-nët tanë s'kanë druajtje t'i studjojnë nga të katër anët, dhëmbët e dhëmballët «t'u gjejnë» bile edhe ndonjë anë të vogël pozitive atyre që janë shumë të nxirë. Kjo situatë dhe këto gjykime kundrejt të ashtuquajturve krerë «xhonturkistë» të «rebelizmit», për mendimin tim, janë të papranueshme dhe duhen hedhur poshtë si antihistorike.

Sipas mendimit tim, ata ishin shqiptarë në radhë të parë dhe jo xhonturq. Por të supozojmë se ata ideologjikisht dhe politikisht ishin «xhonturkistë», por të çfarë periudhe të xhonturkizmit ishin, të fillimit apo të mbarimit? Heshtje e madhe. Në qoftë se pranojmë se ishin nga xhonturqit e orës së parë, atëherë pse këta të jenë antishqiptarë, kur ka pasur dhe shumë të tjerë patriotë të shquar shqiptarë që i përkrahën, bile kontribuan drejtpërdrejt në triumfin e xhonturq-

ve, të cilët paraqiteshin në fillim progresistë me vep-  
rimtarinë e tyre për përmbysjen e regjimit absolutist  
të sulltanit «të kuq», Abdyl Hamitit, për «reformat» e tij.  
Në qoftë se pranojmë tezën që këta udhëheqës «xhon-  
turkistë» të «rebelizmit», nuk i prenë lidhjet me xhon-  
turqit, ashtu siç bënë patriotët e tjerë, kur këta ho-  
dhën tej maskën, atëherë duhet të jemi konsekuentë  
deri në fund. Pra, po të arsyetosh sipas kësaj teze  
del se këta udhëheqës «xhonturkistë» të «rebelizmit»,  
duhej të ndiqnin, e sidomos në lidhjet e jashtme, poli-  
tikën e Enver Pashës, të Talatit etj., të cilët u lidhën  
ngushtë me kaiser Vilhelmin e dytë, domethënë shku-  
an pas qerres gjermane. Bile gjenerali Liman von  
Sanders, në krye të një misioni të madh oficerësh jo  
vetëm shkoi pranë Enver Pashës, por u bë dhe koman-  
dant i forcave turke të Stambollit, gjë që alarmoi të  
gjitha kanceleritë e Evropës. Por si shpjegohet atëherë  
që «rebelizmi» dhe udhëheqësit «xhonturkistë» të «rebe-  
lizmit», në mes të të cilëve na paskësh ardhur dhe një  
oficer i lartë turk nga Stambolli, pra të gjithë këta që  
«digjeshin» për Turqinë, vajtën krejt në kundërshtim  
me politikën turke duke sulmuar qeverinë e Durrësit  
dhe mbretërinë e Vidit, së cilës s'po i mbaheshin më  
këmbët. Ky është një fakt kryesor dhe rreth këtij vër-  
titet gjithë çështja. Problemi shtrohet: «Kush ishte me  
qeverinë e Durrësit, me mbretin Vid» ata ishin «patrio-  
të» të vërtetë, kush luftonte kundër qeverisë së Du-  
rrësit, kundër Vidit dhe xhelatit Tomson ai ishte tra-  
dhtar, proturk. Esat Pasha, tradhtar, agjent i serbëve,  
i francezëve e i italianëve, ia ktheu pushkën politikës  
gjermane dhe Vidit për një kohë. Nga ana tjetër, ne

shohim se «rebelët antikombëtarë» i ngritën pushkët dhe i zbrazën deri në fund kundër Vidit gjerman, kundër Esat Pashës (domethënë ata shkuan në kundërshtim flagrant me politikën e xhonturqve, për të cilën i akuzojnë), zbrazën pushkën kundër serbit etj.

Pra, përse «rebelët» luftonin kundër qeverisë së Durrësit dhe Esatit në një kohë kur politika e shteteve të Evropës Qendrore, e në radhë të parë e Perandorisë Gjermane dhe e asaj Austro-Hungareze, ishte për një lidhje të ngushtë me Turqinë? Këta njerëz që «digjeshin» për Turqinë, atëherë duhet të ishin pro qeverisë së Vidit, mikut të tyre. Mirëpo lëvizja e pa se as Vidi, as Esat Pasha nuk mbronin interesat e Shqipërisë, këtë gjë e shprehte dufi dhe lufta e tyre. Kryengritësit duhet të ndiqnin ose Vidin, ose Esat Pashën. Por ata nuk e ndoqën Esatin se e panë që ishte çifligar dhe i lidhur me serbët dhe italianët. Instinktivisht fshatarët e Shqipërisë së Mesme e ndienë se nga ana e Esatit bëhej tradhti. Ne duhet të analizojmë jo shfaqjet, por ndjenjat e luftëtarëve kryengritës, ata luftonin edhe kundër Vidit se ky nuk përfaqësonte interesat kombëtare të Shqipërisë.

Atëherë është e natyrshme të bëhet pyetja: pse këta krerë të «rebelizmit» «xhonturkist», të shkojnë në kundërshtim me politikën e xhonturqve? Logjika e thjeshtë ta do që «rebelizmi» duhej të mbështeste dhe të mbronte qeverinë e Vidit dhe jo të luftonte. Atëherë zotërinjtë «e mësuar» e «patriotë të flaktë» kthehen e thonë se «rebelët» dhe krerët e tyre ishin «xhahilë», injorantë, fanatikë. Arsye e shëndoshë!! Por për budallenjtë. Kur u intereson i nxjerrin «xhahilë», kur u inte-

reson thonë «ata bënë kthesë», kur s'u intereson thonë «janë antikombëtarë» etj.

Sipas mendimit tim, historianët tanë duhet të bëjnë një studim të hollësishëm e shkencor për të pasqyruar qartë e me vërtetësi udhëheqjen e kryengritjes së «rebelëve» dhe jo të bazuar në përralla të kurdisura. Unë mendoj se krerët e «rebelizmit» pa dyshim kanë bërë gabime, gjë që nuk mund të evitohej. Kishte ndër ta që mund të mendonin se xhonturqit do të ishin për një Shqipëri të lirë e të pavarur dhe do ta mbrojnë (këtu ishte çështja e besimit në aleancat), por ata, sipas mendimit tim, s'kanë qenë as antikombëtarë, as antishqiptarë, as xhahilë, ata luftuan për një Shqipëri të lirë e të pavarur, ata luftuan kundër të gjithë atyre që intrigonin dhe përpiqeshin t'i bënë varrin Shqipërisë. Ata nuk luftuan as kundër popullit as kundër Qeverisë së Vlorës, as kundër Ismail Qemalit. Kjo ka rëndësi të dorës së parë, ky është i vetmi barometër që duhet të shërbejë për të gjykuar Kryengritjen e Shqipërisë së Mesme të asaj kohe. Kishte mjaft gjëra që «rebelët» nuk i kuptuan, por edhe të tjerët (e kam fjalën për patriotët) nuk i kuptuan «rebelët», nuk u futën te «rebelët» që të lidheshin me ta e me influencën e tyre të mos lejonin ato gabime që u vërtetuan. Në qoftë se ata në fillim u nxitën nga intrigat e Esat Toptanit, nuk duhet t'ua hedhim fajin njerëzve që morën armët, por dobësive të krerëve demokratë borgjezë dhe patriotëve të asaj kohe, që, pas Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, nuk ditën si duhet që të kapeshin pas shtresave kryesore, pas masës së fshatarësisë, si Skënderbeu 25 vjet me radhë.



Po parullat «antikombëtare» të «rebelëve» e «sharja e flamurit të Shqipërisë» prej tyre etj., thonë «njerëzit e zgjuar», që pretendojnë se kanë në duar «argumente të shëndosha», ç't'i bëjmë? Ku t'i fusim? Ato nuk fshihen! Po vrasjet e «patriotëve» nga ana e «rebelëve» si shpjegohen? thonë ata. Këto në përgjithësi s'kanë asnjë bazë të shëndoshë, por janë të kurdisura dhe të ekzagjeruara dhe u bënë «norma» sharjesh e diskreditimesh. Që mund të ketë pasur parulla të gabuara e jo të pëlqyera, kjo mund të ketë ngjarë, por këto janë fryrë në një shkallë të atillë sa t'i përshkatoj qëllimit imperialisto-feudal. Që mund të jenë vrarë edhe njerëz të pafajshëm, kjo as që mund të përjashtohet, revolucion ishte «me të njomin kalonte dhe nga një i thatë», por pamë më vonë shumë «nga ata patriotë» që i ndiqte Haxhi Qamili se sa patriotë ishin. Pikërisht këta pseudopatriotë e shitën Shqipërinë te italianët e te gjermanët dhe 30 vjet më vonë u ngritën kundër Luftës Antifashiste të popullit tonë, por populli i kapi, i gjykoi dhe i pushkatoi duke realizuar kështu atë ideal që u vlonte në shpirt gjithë patriotëve të vërtetë të vendit tonë, të cilët në kohën e tyre s'i patën kushtet për ta realizuar këtë ëndërr shekullore.

Por çfarë tha fashizmi italian për ne që na pushtoi më 1939 dhe që formoi një qeveri kuislinge si atë të Durrësit, ç'tha reaksioni zogist e ballist, çfarë thanë nazistët gjermanë që pushtuan Shqipërinë dhe krijuan regjencën në shembullin e qeverisë së Durrësit, pra çfarë thanë të gjithë këta kundër partizanëve, kundër Partisë? Ata na quajtën «antishqiptarë», «antikombëtarë», «të shitur te serbi», «agjentë të rusëve e të ser-

bëve», na akuzuan se çorrëm flamurin, na akuzuan si «terroristë». E çfarë nuk thanë për ne!

Të bëjmë tash një analogji. Sikur lufta e popullit të mos kishte triumfuar dhe të kishin fituar fashizmi, ballistët, zogistët dhe për 40-50 vjet me radhë sikur të vazhdonte sundimi i tyre, të mos kishte dokumente të shkruara, e merrni me mend ç'do të thuhej për Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare, ç'do të thuhej për Partinë, ç'do të thuhej për lavdinë e partizanëve. Do të thuheshin edhe më shumë e me epitete ndoshta më të ekzagjeruara se ato që janë thënë për fshatarët revolucionarë të Shqipërisë së Mesme, për «rebelët» e që vazhdojnë, për fat të keq, të thuhën e të mbrohen edhe sot me paturpësi.

Pa bërë analogjinë që bëra më sipër, le të qëndrojmë tash, në kohën e sotme. Revizionizmi titist e tradhtari Hrushov ç'nuk po thonë për Partinë tonë, na quajnë agjentë të imperialistëve që e shitëm vendin të të huajtë. Absurditetin e këtij epiteti s'ka nevojë ta zbulojmë se është lakuriq. Imperializmi vazhdon luftën me tërbim kundër Shqipërisë së re. Ai ka ndryshuar metodën, por jo qëllimet. Ne tash jemi të rrethuar gjeografikisht si «rebelët» dikur, nga armiq të tërbuar, po ata armiq, por Shqipëria s'është më si në kohën e Haxhi Qamilit. Ajo është një vend socialist i fuqishëm që udhëhiqet nga Partia e lavdishme e Punës, populli shqiptar tani ka miq të mëdhenj, të shumtë, sot rrojmë në shekullin e leninizmit. Shqipëria e re e popullit, e Partisë heroike të Punës, ecën përpara kryelartë, në rrugën e lavdishme të historisë së saj. Për arritjen e kësaj rruge kanë kontribuar edhe fshatarët revolucio-

narë të Shqipërisë së Mesme me Haxhi Qamilin në krye, në kohën e «rebelizmit». Prandaj neve nuk na falet që, pas kaq kohësh, pas kaq luftërash dhe përpjekjesh, pas kaq eksperience të fituar nga populli e Partia, me gjak e me djersë, të vazhdojë dhe të njolloset një nga faqet e mira të kryengritjeve fshatare të vendit tonë, të vazhdohet të errësohet nga demagogët dhe injorantët «rebelizmi».

Kjo padrejtësi patjetër duhet të vihet në vend, është detyra jonë si komunistë, si patriotë, si njerëz të shkencës së drejtë e realiste.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

*Me rastin e botimit të këtij vëllimi, shoku Enver Hoxha bëri edhe këtë shtojcë:*

Kryengritja e Fshatarësisë së varfër të Shqipërisë së Mesme ose «Rebelizmi», siç u karakterizua aso kohe, ishte një luftë klase, lufta e klasës fshatare të varfër e të shtypur kundër klasës feudale të dalë nga Mesjeta dhe të konsoliduar nga Perandoria Turke.

Pa u futur në analizën e zhvillimit dhe të evolucionit klasor, ne mund të afirmojmë se në shoqërinë tonë të viteve të para të shekullit të 20-të klasa e feudalëve, me komponentët e saj, bejlerët, bajraktarët, por edhe agallarët, ishte klasa dominuese. Përbri kësaj klase, dhe

e dalë nga gjiri i saj, ekzistonte shtresa «zyrtare», që mund të konsiderohej si elementi i saj më i avancuar në drejtimin dhe në administrimin e çifligjeve, në vënien e nxjerrjen e taksave, në dhënien e gjyqeve, në lidhjen e tratativave diplomatike me Stambollin, e më vonë me përfaqësues të fuqive të tjera evropiane që interesohehin për Shqipërinë. Elementë të kësaj shtrese të feudalizmit, duke qenë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të zhvillimit shoqëror të vendeve të tjera, disa edhe me kulturë, filluan të evoluonin në drejtimin progresist e patriotik për krijimin e një Shqipërie të pavarur dhe të një shteti shqiptar të centralizuar. Përpjekjet për krijimin e një shteti shqiptar të centralizuar ushqeheshin nga ideja e mbrojtjes së unitetit tokësor dhe kombëtar, në kundërshtim me synimet e ndarjes së Shqipërisë nga të huajtë.

Këto përpjekje luftarake revolucionare të popullit tonë, të fshatarësisë, në radhë të parë, dhe të një plejade patriotësh, u kurorëzuan me sukses me ngritjen e flamurit në Vlorë nga patrioti i madh Ismail Qemali, që e shpalli Shqipërinë të pavarur.

Përpjekjet dhe luftërat progresiste të Qeverisë së Vlorës u pasuan me një periudhë të trubullt, dhe u takon historianëve tanë të hedhin dritë mbi të e ta sqarrojnë, duke u bazuar në materializmin historik.

Ka mjaft njerëz, dhe intelektualë veçanërisht, që, për disa ngjarje dhe periudha të caktuara të historisë sonë, vazhdojnë të ruajnë pikëpamje të formuluar dhe të interpretuara gabim. Të tilla interpretime nuk kanë qenë reale, ishin subjektive, idealiste dhe jomaterialiste, sepse nuk janë bazuar në arsyet dhe në shkaqet

e vërteta që qëndronin në bazë të këtyre ngjarjeve e periudhave.

Një gjë e tillë ndodh me Kryengritjen e Fshatarëve të Shqipërisë së Mesme, me «rebelët e Haxhi Qamilit», siç i përcaktonin.

Opinionet e formuara mbi këtë kryengritje ishin: «rebelizmi ishte pro Turqisë dhe kundër një Shqipërie të pavarur e sovranë; rebelët luftonin me flamurin e Turqisë dhe ishin kundër flamurit të ngritur në Vlorë; rebelët ishin esadistë (me Esat pashë Toptanin), pro serbëve e pro grekëve, që kërkonin të copëtonin Shqipërinë; rebelët ishin kundër Princ Vidit dhe qeverisë së tij, pra dhe kundër atyre patriotëve demokratë që mbështetnin qeverinë e Vidit». Dhe kaq. Pra «rebelizmi ishte antishqiptar, shkatërrimtar». Edhe tash akoma ruhet kjo pikëpamje e errët dhe antishkencore. Vihen në dukje vetëm «gabimet» dhe zigzagjet politike e fetare të Kryengritjes Fshatare të Shqipërisë së Mesme dhe errësohet krejt kryesorja, karakteri klasor i kësaj kryengritjeje.

«Rebelizmi», i udhëhequr nga Haxhi Qamili, ishte një luftë klase e fshatarësisë së varfër dhe të mesme, kundër klasës së feudalëve, pashallarëve, bejlerëve dhe agallarëve, pronarë tokash e privilegjesh në përgjithësi. Kjo është kryesorja dhe pikërisht kryesorja fshihej në ato kohë.

Nga feudalët dhe nga elementët progresistë të kësaj klase, si dhe të asaj borgjezie të vogël të qyteteve, elementët e së cilës sapo kishin filluar të dukeshin dhe të zinin vende si «memurë» dhe zyrtarë, klasa fshatare nuk llogaritej. Në planet e tyre dhe në kombinacionet

e politikanëve ajo nuk përfillej fare. Ajo përdorej prej tyre, por nuk llogaritej si klasë e së ardhshmes që përbënte një potencial të madh ekonomik dhe njerëzor. Klasa fshatare ishte Shqipëria, ajo prodhonte, por ajo vuante dhe harrohej nga të tjerët.

Patriotët shqiptarë demokratë dhe progresistë, që luftuan për pavarësinë e Shqipërisë dhe për një shtet shqiptar të centralizuar, nuk e patën parasysh sa duhej, për të mos thënë aspak, fshatarësinë që përbënte shumicën dërrmuese, të vetmen prodhuese, e cila ishte e etur dhe e interesuar, në radhë të parë, për lirinë dhe pavarësinë e atdheut.

Vetëm kur vinte puna për të treguar «influcencën» që kishin njerëzit e shtresave të pasura mbi fshatarësinë, atëherë llogaritej kjo, pa se ku konsistonte kjo influencë dhe si ishte krijuar, domethënë marrëdhëniet shoqërore në mes klasave, as shikoheshin dhe as llogariteshin. Pra llogaritej vetëm në lidhje me njerëzit «me influencë» dhe aspak me masat e gjera të popullit. Patriotët shqiptarë që luftuan për pavarësinë e Shqipërisë, ishin idealistë dhe shumica, në mos të gjithë, anonin nga diplomacia e fuqive të mëdha, që, me fjalë të tjera, do të thoshte «Shqipëria dhe qenia e saj e pavarur varej nga fuqitë e huaja imperialiste».

Prandaj mbizotëronte mendimi i mbrojtjes nga jashtë, sesa i organizimit nga brenda. Nga brenda duhej dhënë forma, pak a shumë, e një qeverie përfaqësuese, prandaj sa më shumë të bënin pjesë në të, bejlerë dhe pashallarë, miq të njerit ose të tjetrit shtet, aq më mirë do të ishte për të siguruar përkrahjen nga jashtë.

Më 1912, kur u ngrit flamuri në Vlorë, Shqipëria

dhe shqiptarët dilnin nga luftëra të pareshtura për liri dhe pavarësi, por dilnin po ashtu me një varfëri të madhe ekonomike dhe kulturore.

Fshatarësia ishte e shtypur në kulm, e varfër në kulm, në injorancë të thellë. Mbi popull dominonin ligjet e kanunit, të sheriatit, paragjykimet fetare dhe xhamitë e kishat tok me kamxhikun e turqve, feudallëve, bejlerëve, agallarëve dhe të sejmenëve të tyre.

Pra, kur flasim për «rebelimin» e fshatarëve të Shqipërisë së Mesme, duhet ta kemi kurdoherë parasysh këtë gjendje shoqërore, marrëdhëniet në mes klasave, të cilat pas Shpalljes së Pavarësisë hynin në një fazë të re.

Idealistët menduan se do ta qeverisnin vendin sipas pikëpamjeve e veprimeve të tyre. Por këto pikëpamje e veprime nuk puqeshin në të gjitha çështjet me ato të masës së madhe të fshatarësisë, që priste të pyetej, sepse kishte luftuar, por nuk u pyet, që priste të shihte shkëndijën e parë të disa reformave fillestare që do ta lehtësonin mjerimin e saj ekonomik dhe shpirtëror, por që nuk i pa. Atëherë ngriti krye dhe ky është një gjest revolucionar nga ana e saj. Këtë fakt elementët progresistë dhe patriotë jo vetëm nuk e kuptuan, por edhe e shtrembëruan, duke e quajtur një akt antipatriotik dhe e dënuan.

Kjo kryengritje fshatare u akuzua si «esadiste», pro serbëve e pro grekëve, agjent i të cilëve ishte Esat pashë Toptani. Ishte ky Esat Pashë, të cilin princi Vid e kishte ministër dhe të luftës bile. Mos harrojmë po ashtu «influencën» e pashait toptanas në Shqipërinë e Mesme, «influencë» që e përmenda më lart e që aktivizohej në

ato kohë të trubullta. Të tilla «influenca» i pamë edhe më vonë, në Luftën Nacionalçlirimtare, te krerët e «Ballit Kombëtar» dhe te bajraktarët e Veriut.

Kryengritja fshatare, për të cilën bëhet fjalë, u akuzua proturke dhe antishqiptare, sepse në të morën pjesë një farë Musa Qazimi e Mustafa Ndroqi, turkomanë, fanatikë dhe intrigantë, që e përdorën çështjen fetare dhe flamurin e Turqisë jo për t'ia këthyer Shqipërinë Perandorisë Turke, e cila kishte vdekur e s'ngjallej më, por për të frenuar qëllimet e kryengritjes fshatare dhe për të minuar zhvillimin e saj. Këto ishin tentativa të feudalëve dhe të elementëve të borgjezisë konservatore, të «memurëve», që fshatarësinë ta nbanin nën sundim dhe ta kishin rezervë të tyre.

Edhe pse në këtë kryengritje fshatare ishin futur elementë të tillë, ose spikaste elementi fetar, kjo nuk ndërron asgjë mbi këtë çështje. Të gjitha e gjejnë shpjegimin në kushtet e atëhershme, kur u zhvillua kjo kryengritje.

**Pra, nuk ishte as çështje feje, as çështje e mbrojtjes së qëllimeve tradhtarë të Esat Toptanit, as çështje e mbrojtjes së një farë Perandorie Turke, por ishte një luftë klase, lufta e fshatarëve kundër feudalëve dhe bejlerëve, natyrisht për tokën dhe kur flitet për tokën, flitet për atdheun. Këtë nuk e tund asgjë.**

Fshatarët u ngritën dhe dogjën kullat e atyre që i shtypnin, që u merrnin prodhimet, që i mbulonin me taksa dhe i rripnin me fajde. Kjo klasë e feudalëve, kundër së cilës u ngrit fshatarësia, ishte pjella e Perandorisë Turke. Pra nuk ka logjikë që fshatarësia të ngrinte krye kundër feudalëve dhe të mbronte Peran-



dorinë Turke që i kishte pjellë ata. Jo. Logjika anon nga fshatarësia kryengritëse dhe jo nga ata që, me dashje ose pa dashje, kanë shtrembëruar logjikën e hekurt të materializmit historik, e cila analizon drejt zhvillimin shoqëror dhe historik të periudhave e të ngjarjeve dhe vë në dukje arsyet dhe shkaqet e vërteta që qëndrojnë në bazë të historisë.

Nuk mund të bëjmë fajtorë një pjesë fshatarësh të Shqipërisë së Mesme pse për një moment Esat pashë Toptani tentoi dhe e ngriti për interesat e tij të mbrapshta. Faktet historike tregojnë se ajo kryengritje e kapërceu atë fazë dhe e dogji pashën, siç dogji dhe xhonturqit.

Por kur vëmë në dukje këto zigzage të natyrshme në një kryengritje fshatare, duhet të vëmë në dukje edhe gabimet e borgjezisë liberale, e cila sapo kishte filluar të lindte, dhe elementëve të saj patriotë që as e kuptuan dhe as luftuan për ta bërë me vete këtë element revolucionar të të gjitha kohëve të historisë sonë, dhe të luftonin në krye të saj për të konsoliduar pavarësinë dhe sovranitetin e Shqipërisë. Është fakt se këta elementë progresistë u grumbulluan rreth princit gjerman Vid, te i cili ushqenin shpresa pa baza dhe iluzione për kombinacione diplomatike joreale, jo të qëndrueshme dhe të pafrytshme.

10 shkurt 1977

*Botohet për herë të parë sipas dorëshkrimit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **FIERI — NJË NGA HAMBARËT E MËDHENJ PËR DRITHËRAT E BUKËS**

*Nga fjala në konferencën e 12-të të Partisë  
të rrethit të Fierit*

**18 shkurt 1962**

Të dashur shokë,

Në radhë të parë dëshiroj t'ju sjell juve, delegatëve të konferencës së 12-të të organizatës së Partisë të rrethit dhe nëpërmjet jush gjithë komunistëve dhe popullit të rrethit të Fierit, përshëndetjet e Komitetit Qendror dhe t'ju uroj për sukseset e shumta që keni arritur në punën tuaj gjatë vitit të kaluar!

Partia dhe Qeveria kanë një konsideratë të veçantë për rrethin e Fierit, i cili është një nga rrethet më të rëndësishme të vendit tonë si nga ana politike, ashtu dhe nga ana ekonomike. Rrethi i Fierit është një nga më të pasurit në lëmin e bujqësisë, kurse në një të ardhshme të afërt ai do të bëhet një nga më të rëndësishmit edhe në lëmin industrial.

Zhvillim të mëtejshëm do të marrë te ju veçanë-

risht industria e naftës. Objekte shumë të rëndësishme do të jenë uzina e plehrave azotike si edhe termocentrali i madh që do të ndërtohen gjatë këtij pesëvjeçari si dhe objekte të tjera industriale, të cilat do ta kthejnë rrethin tuaj në një zonë të rëndësishme industrialo-bujqësore.

Megjithatë qysh tani njeriu këtu në Fier sheh ndryshime të mëdha, në radhë të parë, te njerëzit, te vetë komunistët. Pasqyra më e mirë që e tregon këtë, është kjo konferencë. Më bënë sidomos përshtypje diskutimet e shokëve delegatë që ishin të një niveli mjaft të mirë nga ana politike, ideologjike dhe ekonomike dhe që tregojnë se shokët e organizatës suaj preokupohen shumë për çështjet e drejtimit dhe të zbatimit sa më të mirë të detyrave që ata kanë mbi supe. Diskutimet rrihnin problemet aktuale që preokupojnë rrethin. Ato në përgjithësi karakterizoheshin nga një frymë e shëndoshë kritike dhe kishin parasysh perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë, të forcimit të Partisë dhe të Republikës sonë Popullore. Këto ishin, natyrisht, fryma dhe pikëpamjet e organizatave-bazë, që delegatët sollën në këtë konferencë.

Në këtë prizëm ne shohim edhe ngritjen e nivelit arsimor e kulturor të punonjësve të rrethit të Fierit. Më parë në konferenca partie raportohej përbërja e delegatëve, jepeshin të dhëna shumë të mira për qëndrimin heroik të tyre gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, vendosmëria e tyre për mbrojtjen e Partisë, faktorë këta që janë me rëndësi të madhe, po, kur raportohej për gjendjen arsimoro-kulturore të delegatëve, shifrat

atëherë ishin jo të kënaqshme. Ne e kuptojmë nga rridhte kjo anë negative, kurse tani konstatojmë me kënaqësi të madhe se midis të gjithë delegatëve vetëm një është që di vetëm shkrim e këndim, të gjithë të tjerët kanë mbaruar shkolla fillore, shumica janë me 7-vjeçare, ka mjaft me të mesme, bile edhe me të larta. Kjo është një pasqyrë e përparimit që ka bërë organizata e Partisë në këtë rreth.

Përsa i përket zhvillimit politik e ideologjik, edhe në rrethin tuaj ka gjithashtu përparime të shumta. Të gjithë anëtarët e Partisë të organizatës së Fierit kanë mbajtur dhe mbajnë qëndrime të drejta politike, janë të kalitur ideologjikisht, i kuptojnë të gjitha problemet në frymë të shëndoshë për zbatimin e vijës së Partisë.

Edhe në masat e popullit të Fierit ka entuziazëm, njerëzit janë të gëzuar dhe të lumtur. Ata rrojnë më mirë, të gjithë kanë kënaqësi se atdheu po lulëzon dhe se atë po e udhëheq me pjekuri Partia në rrugën e ndërtimit të socializmit. Populli ynë sheh se rruga që ndjek Partia është e drejtë, dhe në këtë rrugë ecin me vendosmëri komunistët. Populli shikon një siguri në punën e Partisë, të pushtetit popullor, të komunistëve dhe të kuadrove që drejtojnë. Prandaj, pavarësisht se në jetën e përditshme ka vështirësi, masat punonjëse kanë besim të madh në të ardhshmen dhe e kanë të qartë rrugën ku po na çon Partia.

Si gjithë Shqipëria edhe Fieri po bëhet një qytet i bukur. Po ngrihen shtëpi banimi dhe institucione arsimore, kulturore e sociale, në të ardhshmen do të ngrihen edhe më shumë. Jemi të sigurt se nga fundi i pesëvjeçarit Fieri nuk ka për t'u njohur fare.

Me ndërtimin e uzinës së madhe të plehrave azotike dhe të TEC-it, këtu do të vijnë shumë punëtorë nga fshati, prandaj për ta do të duhet të ndërtohen shtëpi banimi, kopshte, çerdhe, ambulanca, kinema, shtëpi kulture etj. Njëra pastaj sjell tjetrën. Kishte të drejtë artistja që këndoi parmbremë «Këngën e Fierit» se Fieri është vërtet i bukur nga natyra, në një vend pjellor, po dora e Partisë tani po e bën atë edhe më të bukur.

Po nuk ka vetëm rëndësi zhvillimi i qytetit të Fierit, po edhe zhvillimi i fshatit. Shumë vjersha të poetëve tanë flasin për vuajtjet e rënda të bujkut tonë në të kaluarën, sidomos për bujkun e Myzeqesë që ka parë sundimin e feudalëve, injorancën dhe malarjen, e cila prekte shumicën dërrmuese të fshatarësisë së këtyre krahinave. Lufta dhe puna e drejtë e Partisë dhe e popullit zhdukën një herë e përgjithmonë shfrytëzimin dhe malarjen, përmirësuan jetesën, i hapën perspektiva popullit shqiptar që ai të rrojë më mirë. Përparimet e kooperativave bujqësore të rrethit të Fierit, në shumë drejtime janë të mëdha dhe po kapërcejnë kooperativat e ndonjë rrethi që më parë ka qenë më i përparuar.

Organizatën e Partisë të rrethit tuaj e kanë preokupuar mjaft problemet ekonomike. Kjo është e drejtë dhe nga kjo anë në përgjithësi ju keni pasur rezultate të mira, sidomos në prodhimin e përgjithshëm industrial, të cilin e keni realizuar 114 për qind, ju keni tejkaluar planin gjithashtu edhe në ndërtime e në artizanat. Kjo nuk do të thotë se rezultatet e arritura janë plotësisht të kënaqshme, sepse mundësitë kanë qenë

për më shumë, në qoftë se do të ishin marrë masa më të forta.

Nga ana juaj janë bërë përpjekje në vijën e përgjithshme që ka dhënë Komiteti Qendror në lidhje me shfrytëzimin e rezervave të brendshme, që i kemi të shumta në çdo sektor, të cilat patjetër duhet t'i nxjerrim në dritë, sidomos për situatat që po kalojmë. Në kushtet e rrethimit armiqësor të vendit tonë dhe të një shtate ndërkombëtare mjaft të trubullt nuk na lejohet të mos i shfrytëzojmë në maksimum këto rezerva. Në këtë drejtim ju keni bërë diçka. Në ofiçinat e SMT-së dhe të uzinës së zhveshjes së pambukut nga ju janë bërë përpjekje për të prodhuar në vend pjesë këmbimi, me të cilat sigurohen kursime të mëdha në valutë dhe që furnitorët e jashtëm, për të na vënë në pozita të vështira, nuk po na i japin. Ju jo vetëm që keni bërë përpjekje për të zëvendësuar materiale të importit, po punëtorët e rrethit tuaj kanë bërë përpjekje edhe për shpikje e racionalizime në të gjithë sektorët e ekonomisë.

Ky patriotizëm i madh i punëtorëve të rrethit tuaj dhe i të gjithë Shqipërisë ka sjellë rezultate të mrekullueshme, sepse, nga shpikjet që bëhen prej punëtorëve, teknikëve dhe inxhinierëve tanë, ekonomia ka përfituar shumë. Dy vjet më parë kujtonim se gjëra të tilla nuk mund të bëheshin te ne, kurse tani bëhen nga duart e arta të punëtorëve tanë.

Me gjithë këto suksese duhet të kemi parasysh se disa nga ndërmarrjet që më 1961 nuk kanë dalë mirë, duhet të bëjnë më shumë përpjekje që të mos përsëriten të metat e vërtetuara vitin e kaluar. Kështu, për

shembull, ndërmarrja e veshmbathjes, megjithëse planin vjetor në përgjithësi e ka realizuar, ka disa sektorë, si ai i riparimeve, që s'kanë shkuar mirë. Prandaj atje të organizohet puna që t'i shërbehet popullit më mirë.

Edhe në prodhimet bujqësore, si në drithëra, pambuk dhe kultura të tjera, në rrethin tuaj është fakt se ka rezultate më të larta se në vitin 1960. Të mos flasim për ullinj të që janë bërë më shumë se çdo vit tjetër. Këto rezultate kanë sjellë rritjen e nivelit të jetesës së popullit. Me gjithë vështirësitë klimaterike, për shkak të të cilave plani i drithërave nuk u realizua, gjendja ekonomike e kooperativistëve është shumë e kënaqshme. Ata kanë ndarë nga 150-170 dhe 200 lekë për ditë-punë, që nuk është gjë e vogël. Kjo do të thotë se tani kooperativistët disponojnë mjaft të ardhura, prandaj edhe jeta e tyre është përmirësuar.

Po sigurisht rëndësinë më të madhe t'ia kushtoni realizimit të planit të drithërave. Rrethi juaj ka krijuar rreth 10 mijë tonë deficit drithëra, gjë që na vështirëson shumë. Ky deficit rrjedh për shkak të disa të metave e dobësive në organizim si dhe të vështirësive të kohës. Për të plotësuar këtë deficit jemi detyruar të sjellim drithëra nga jashtë, me devizë. Ne duhet të bëjmë përpjekje që në të ardhshmen të sigurojmë drithërat e bukës në vend, sepse sa më pak drithëra të sjellim nga jashtë, aq më mirë do të jetë për ekonominë tonë.

Për prodhimin e drithërave të bukës rrethin e Fierit duhet ta konsiderojmë një nga hambarët më të mëdhenj të vendit tonë. Këtu shteti ka bërë investime

të mëdha për sistemime tokash, mekanizime e kanalizime. Vetëm për tharjen e kënetave janë shpenzuar 1,6 miliard lekë. Tani fushat e Fierit janë bërë më të bukura e më pjellore. Prandaj të mobilizojmë të gjitha forcat tona për të shfrytëzuar si duhet mundësitë e krijuara që Fieri të bëhet me të vërtetë hambar i Shqipërisë. Do të ishte me plot kuptimin e fjalës krim po të mos shfrytëzoheshin si duhet të gjitha këto toka nga komunistët dhe populli i rrethit tuaj me gjithë këto kanalizime të mëdha e sistemime tokash që janë bërë, me mekanizimin e gjerë të bujqësisë, me kuadrot e shumtë që u janë vënë në dispozicion nga Partia e Qeveria.

Ju keni në dispozicion një fuqi të madhe motorike. Gëzohet njeriu kur dëgjon se këtu ka kooperativa bujqësore që i kanë mekanizuar punimet në një shkallë shumë të lartë. Të gjitha kooperativat duhet të përpiqen të arrijnë një nivel të tillë, sepse ju mbillni shumë kultura prashitëse që kërkojnë krahë pune të lirë. Prandaj punimet e tokës dhe disa të tjera i zëvendësoni me mjete të mekanizuara, për të pasur forca për prashitjet dhe shërbimet e domosdoshme që u duhen bërë pambukut, duhanit dhe misrit. Pastaj kini parasysh se në Fier do të ndërtohen edhe objekte industriale të rëndësishme. Partia do të bëjë përpjekje që fshatarët t'i lidhë ngushtë me kooperativat, me problemet e bujqësisë, po kjo është e pamundur për të gjithë, sepse një pjesë e të rinjve dhe e të rejave fshatare do të shkojnë të punojnë edhe në uzinën e plehrave kimike ose në objektet e tjera ekonomike që do të ndërtohen në qytet. Edhe kjo është e domosdoshme. Prandaj mje-



tet e mekanizuara t'i shfrytëzoni në maksimum dhe t'i mbani mirë.

Shfrytëzimi i SMT-së te ju mund të themi se është i kënaqshëm. Kjo nuk do të thotë se atje nuk ka të meta e gabime, ndonëse plani është realizuar. Po ne nuk duam që SMT-të ta realizojnë dhe ta tejkalojnë në përgjithësi planin, puna është që të luftojmë që plani të realizohet e të tejkalohet nga çdo traktor. Në këtë drejtim jemi shumë prapa, kemi mjaft të meta që duhet t'i evitojmë. Traktoristët tanë duhet të punojnë në bazë të metodës së Budo Isufit dhe të Shyqri Kanaparit. Ne nuk pretendojmë që të gjithë traktoristët të bëhen si ata, po duhet të ecin në shembullin e tyre që plani të realizohet e të tejkalohet jo vetëm në përgjithësi, por nga çdo traktorist.

Iniciativa e marrë nga Rako Pina është shumë e mirë. Ju keni shumë traktoristë, të cilët i shfrytëzojnë traktorët që u besohen dhe që e kuptojnë këtë problem politikisht dhe ekonomikisht, sepse e dinë që traktorët na vijnë nga larg, pra shteti bën shumë shpenzime për t'i siguruar. Fakti që rreth 26 traktorë në rrethin tuaj nuk e kanë plotësuar ngarkesën, duhet të shqetësojë organizatën-bazë të Partisë të SMT-së, e cila të ndihmojë çdo traktorist, sidomos traktoristët e rinj, që traktorët të mos vjetrohen para kohe, por që edhe traktorët e rinj të përdoren me masë.

Kini parasysh se toka për ne është flori, prandaj ta ruani mirë fondin e saj, duke evituar rrugët e gjera e duke zhdukur mezhdat etj. Të shfrytëzohet mirë toka, duke mbjellë dhe hamullore sipas planit, kur kushtet atmosferike e lejojnë.

Duhet të organizohet mirë puna që të ketë sa më pak firo dhe të rritet rendimenti. Për këtë midis kooperativeve dhe brigadave të ngjallet emulacioni. Nuk duhet të lejoni gjithashtu që brenda një kooperative, ose midis dy kooperativave fqinje me të njëjtat kushte të merren rendimente të ndryshme etj.

Lufta për bukën përbëhet nga të gjithë këta faktorë që thashë. Prandaj, gjersa gruri të ketë shkuar në hambar, të merret çdo masë që të kemi sa më pak humbje dhe të sigurohen rendimente sa më të larta, që të arrihen këto, natyrisht duhet shumë punë, përpjekje e mundime. Në këtë drejtim komunistët duhet të jenë në ballë të punës, të marrin shembull nga ata kuadro e komunistë që, kur fillojnë shira të mëdha, nuk ngrohin këmbët në zjarr, po hedhin gunën në kokë, marrin shatin në dorë dhe shkojnë në krye të detyrës. Natyrisht këta mundohen shumë, po politikisht mendojnë thellë për interesat e kooperativës dhe të atdheut. Pra në çdo drejtim duhet bërë një luftë më e madhe për sigurimin e bukës.

Të përpiqemi të shfrytëzojmë në maksimum kapacitetet ujtitëse. Me gjithë përparimet edhe këtu kemi të meta që u përmendën. Duke marrë parasysh investimet e mëdha që janë bërë për ujitjen, ta keni për nder që këto vepra të shfrytëzohen gjer në fund. Natyrisht puna e ujitjes është një shkencë e tërë, që duhet ta mësojnë mirë, agronomët në radhë të parë, e nga ata pastaj ta mësojnë fshatarët. Dhe për këtë çështje ne kemi edhe specialistë nga zotësia e të cilëve të përfitojmë. Pra u vini rëndësi mirëmbajtjes së veprave ujtitëse, hapjes së vijave kulluese, merrni masa dhe shfry-

tëzoni çdo ditë të mirë se mund të fillojnë edhe shira që na pengojnë.

Mbjellja e shpejtë dhe në kushte të mira është një fitore për të siguruar prodhime të larta. Prandaj, për të luftuar fatkeqësitë e kohës, sidomos shirat e vazhdueshme, jo vetëm të përfitojmë nga çdo ditë me kohë të mirë, po më parë të kemi në gatishmëri të plotë traktorët, të merren masa për të kulluar arat nga ujërat, pra kanalet kulluese të mbahen në gatishmëri.

Fshatarësia kooperativiste e rrethit tuaj është për t'u lavdëruar për rritjen e ditëve të punës në kooperativat bujqësore, megjithëse edhe këtu ka akoma kooperativistë që nuk kanë bërë minimumin. Sidoqoftë burrat kanë bërë mesatarisht 315 ditë-punë dhe gratë — 214. Në këtë drejtim të vazhdohet edhe më mirë akoma. Kryesia e kooperativës dhe organizata-bazë e Partisë të kenë kujdes që këto ditë-punë të jenë të frytshme, të jenë të tilla që t'i sjellin të ardhura kooperativës, sepse kështu ditët e punës do të kenë vlerë të madhe, ndryshe do të kesh shumë ditë-punë, po të ardhura më të pakta.

Edhe gratë kooperativiste më duket se kanë punuar mirë. Ato mund të kishin bërë edhe më shumë, po masat e pakta që janë marrë për t'i lehtësuar, kanë qenë pengesë që ato të bëjnë ditë-punë më tepër. Prandaj organizatat-bazë të Partisë dhe kryesitë e kooperativave kanë shumë për të bërë për ta lehtësuar gruan e për ta çliruar atë nga disa punë të shtëpisë dhe për ta hedhur më shumë në prodhim. Po të llogaritet mirë, gruaja kooperativiste përveç 214 ditë-punë që ka bërë mesatarisht jashtë në fushë, ajo bën edhe shumë punë të

tjera në shtëpi, si kujdesi për fëmijët, gatimi, pastrimi i shtëpisë etj. Të gjitha këto tregojnë se ajo punon më shumë se burri. Prandaj të veprohet më mirë që gruaja të lehtësohet, kjo është në interes të familjes, të ekonomisë së kooperativës dhe të të gjithë shoqërisë.

Shumë vërejtje u bënë këtu në drejtim të ndërmarrjeve bujqësore. Ato nuk kanë punuar mirë vitin që kaloi, si ajo e Levanit, po sidomos ndërmarrja bujqësore «Çlirimi». Është interesant se sivjet mjaft ndërmarrje bujqësore janë bërë shembull i keq për kooperativat bujqësore dhe jo për arsye të kohës, sepse rreth tyre kooperativat kanë dalë shumë më mirë. Një gjë e tillë nuk duhet lejuar as nga Partia, as nga Ministria e Bujqësisë, as nga udhëheqja e këtyre ndërmarrjeve.

Le të marrim ndërmarrjen bujqësore «Çlirimi», që në raport u kritikua me të drejtë. Sekretari i komitetit të Partisë i kësaj ndërmarrjeje në diskutimin që bëri deshi t'i kalonte në heshtje gabimet dhe të metat e vërtetuara në këtë qendër pune, sidomos në drejtim të mosrealizimit të planit të drithërave. Në të ardhshmen kjo ndërmarrje do të jetë nga më të mëdhatë e vendit tonë. Tokat e saj shumë pjellore ujiten të tëra qysh tani, atje ka shumë mekanizma, lopët dhe bagëtitë janë të racave më të mira. Prandaj drejtori i ndërmarrjes dhe të tjerët t'i vënë gishtin kokës se kanë një përgjegjësi të madhe përpara Partisë, shtetit dhe popullit për mbarrëvajtjen e saj. Ata duhet të punojnë që planet në të gjitha drejtimet të realizohen e të tejkalohen, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që kanë vënë në dispozicion Partia dhe shteti, përndryshe do të merrën masa,

sepse nuk mund të lejojmë që një nga ndërmarrjet bujqësore më të mira të dalë me humbje.

Me blegtorinë ju nuk keni shkuar keq. U gëzova sidomos kur mësova se planin e qumshtit e keni tejkaluar. Vetëm duhet të keni parasysh shtimin numerik të bagëtive se me këtë nuk jemi mirë, bile kemi shkuar në rënie. Me çengjat e rinj të këtij viti mundohuni të mbushni deficitet që keni pësuar. Ju duhet të kujdese-ni sidomos për sigurimin e plotë të ushqimit të bagëtisë, sepse i keni të gjitha mundësitë për ta plotësuar këtë detyrë. Në Fier vinin blegtorë të krahinave të tjera për të dimëruar bagëtinë, kurse tani ka njerëz te ju që kërkojnë t'i çojnë ato në kullota jashtë rrethit. Kjo është për të justifikuar ngordhjet. Mirëpo përse nuk ka pasur humbje, të themi, edhe kooperativa e Zharrëzës? Përkundrazi kjo kooperativë i nxori mirë e pa humbje bagëtitë, planin e qumshtit, të mishit e të leshit e tejkaloj. Kooperativat e tjera, megjithëse nuk kanë më pak krerë, nuk i realizuan planet. Sekretet qëndron në çështjen se Zharrëza siguroi ushqimin. Prandaj bëni përpjekje për zbatimin e udhëzimeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe të organeve të pushtetit në rreth për sigurimin e plotë të ushqimit të blegtorisë, në mënyrë që kafshët të qëndrojnë brenda, sidomos gjatë gjithë dimrit.

Ju duhet t'ju preokupojë sidomos çështja e bagëtisë së oborreve kooperativiste. Kooperativa të mos tregohet e huaj për fatin e bagëtisë së oborreve, sepse edhe kjo është pronë e anëtarëve të saj, dhe se e mbledhur së bashku është një pasuri më e madhe nga blegtoria e kolektivizuar. Drejtuesit e kooperativës duhet

të mendojnë seriozisht për këtë çështje, jo për t'ua marrë, po për t'i edukuar anëtarët dhe për t'i ndihmuar ata që t'u sigurojnë sa më shumë ushqim bagëtime, natyrisht jo në dëm të bagëtive të kolektivizuara, përkundrazi në interes të kooperativës. Ligji themelor i socializmit, pra edhe i kooperativës bujqësore është t'ua bëjë jetën sa më të lumtur kooperativistëve, në rradhë të parë nga puna e përbashkët. Po edhe bagëtia e oborreve të mos lihet pas dore, sepse oborri kooperativist është për t'u ardhur në ndihmë anëtarëve, por me kusht që kjo të mos dobësojë ndjenjën e fuqishme të punës dhe të pronës kolektive. Kooperativa të edukojë te anëtarët dashurinë për punën kolektive, duke e kuptuar këtë si një mjet që do ta ndihmojë kooperativistin të prodhojë më mirë dhe të forcohet ekonomikisht, ndërsa përsa i përket pronës individuale, të kuptojë që ndihma e kooperativës në këtë drejtim nuk është për të shtuar dhe për të nxitur ndjenjën e pronës së vogël vetjake, po për t'i dhënë atij mundësinë që të plotësojë një pjesë të nevojave të tij, kurse nevojat më të mëdha dhe më të mira t'i plotësojë nga pasuria e përbashkët. Në këtë drejtim ka shumë kooperativa që nuk interesohen për bagëtitë personale të anëtarëve, të cilët detyrohen pastaj t'i kullosin fshehtazi në pronën e përbashkët. Kooperativa me këtë gjë nxit, padashur, që anëtarit t'i shtohet më tepër interesi për pronën personale. Prandaj organizatat-bazë dhe kryesitë e kooperativave duhet të mendojnë edhe për këtë sektor.

Së shpejti Komiteti Qendror ka menduar të thërrasë plenumin e vet për problemin e madh të inten-

sifikimit të bujqësisë. Një nga problemet që do të diskutohet mendohet të jetë edhe çështja e bagëtive të oborrit kooperativist. Për këtë problem duhet menduar seriozisht, kështu të shihet nëse mund të gjendet ndonjë formë organizimi, një farë kooperimi i bagëtive personale pa e çenuar këtë si pronë, të paktën për të siguruar ruajtjen dhe kullotjen e tyre. Ju mbani mend si kemi menduar në fillim për të pasur tri lloj kooperativash. Jeta në vendin tonë i skartoi dy forma dhe u zhvilluan kooperativat bujqësore që kemi sot. Tani mund të gjejmë ndonjë formë që edhe kjo pasuri e oborreve të vazhdojë të ndihmohet dhe përsëri të mbetet pronë e oborrit kooperativist, por t'i ndihmojë anëtarët dhe t'i lehtësojë ata nga puna që duhet të bëjnë për t'u kujdesur për to dhe në këtë mënyrë t'u japë atyre mundësi për t'u hedhur më shumë në punët e kooperativës.

Rëndësi të madhe duhet t'i kushtoni zhvillimit të sektorit të frutikulturës. Ka kooperativa bujqësore që e kanë marrë mirë në dorë punën e këtij sektori, si ajo e Cakranit, e Romësit ose ajo e Hekalit dhe janë interesuar mirë për zhvillimin e frutikulturës dhe të ullinjve. Tani të gjithë interesohen dhe e kuptojnë rëndësinë ekonomike dhe ushqimore të frutave. Ne tashmë nuk jemi në atë stad kur mungonte interesimi për këtë sektor. Më parë, fshatari ynë pemën e shikonte vetëm nga pikëpamja e interesit për të siguruar ndonjë të ardhur të vogël, ose për të ngrënë frutat. Po kjo fazë tani ka kaluar. Politika e drejtë e Partisë dhe e Qeverisë e bëri fshatarin tonë të kuptojë se sektori i frutikulturës i sjell të ardhura të konsiderueshme vendit, ai

siguron ushqimë të një cilësie të lartë dhe shumë të shëndetshme për popullin, si edhe valutë. Prandaj kooperativat tona bujqësore i kanë dhënë një hov të madh zhvillimit të frutikulturës dhe e kanë kuptuar drejt rëndësinë e mbjelljes së pemëve frutore në blloqe.

Për të pasur prodhime të sigurt, vazhdoni t'i mbillni në blloqe pemët, sepse në këtë mënyrë atyre mund t'u bëhen shërbimet më mirë. Kur frutikultura, vreshtat dhe ullinjët bëhen një sektor i rëndësishëm për kooperativën, atëherë për këtë sektor e vlen të krijohen brigada të veçanta.

Duke bërë bilancin e mbjelljes së pemëve frutore në pesëvjeçarin e kaluar, del se nuk jemi mirë me zënie e tyre, bile dhe ato që kanë zënë, nuk janë ruajtur. Kjo duhet të na bëjë t'i vëmë gishtin kokës. Ne duhet të kujdesemi që pemët e mbjella të zihen dhe pastaj të ruhen dhe të arrijnë të rriten 80-85 për qind e jo si gjer tani 30-40 për qind, ndryshe venë dëm investimet, ikin kot munda e djersa e rinisë dhe arrihet që të merren më pak të ardhura për ditë-punë. Në qoftë se do të vazhdojmë të bëjmë të tilla investime dhe të mos tregojmë kujdes për pemët e mbjella, me këtë ne i kemi sjellë një dëm të madh gjithë ekonomisë sonë.

Kujdes i posaçëm duhet treguar sidomos për ullinjët dhe ullastrat që duhet t'i shartoni; gjithashtu nëpër kooperativa duhet të krijohen medoemos fidanishte, pavarësisht se të tilla ka dhe shteti.

Përsa i përket organizatës së Partisë të rrethit tuaj Komiteti Qendror i Partisë ka përshtypjen se si baza, ashtu edhe udhëheqja e rrethit punojnë mirë. Partia



forcohet çdo ditë te ju, në organizatën e Partisë të rrethit të Fierit nuk ka sëmundje politike ose ideologjike dhe kjo është një nga karakteristikat e shëndosha të Partisë kudo në Shqipëri. Me gjithë vështirësitë e mëdha që na kanë dalë përpara, Partia jonë është rritur e është forcuar, jeta e saj e brendshme është gjallëruar. Është e vërtetë që në disa organizata-bazë ka pasur ndonjë grindje, për shembull, kryetari i kooperativës bujqësore të Zharrëzës në diskutimin e vet tha se në organizatën-bazë, ku ai bën pjesë, ka pasur grindje, mosmarrëveshje, ambicie etj. Shfaqje të tilla ka pasur dhe ka, por ato janë zbutur, sepse jo vetëm komunistët, po edhe masat punonjëse, përpara situatave të krijuara dhe veprimtarisë armiqësore të revizionistëve sovjetikë e të tjerëve kundër Partisë dhe vendit tonë, si rezultat i punës edukuese të Partisë sonë, i kanë lënë mënjanë grindjet e mosmarrëveshjet, se e kuptojnë që ato vetëm të këqija sjellin. Komunistët shfaqjet e tilla i kanë kritikuar si të dëmshme, ndërsa ata që kanë qenë ngatërruar me to kanë bërë autokritikë dhe gjendja është përmirësuar. Për ne mbi të gjitha është interesi i Partisë dhe i atdheut, prandaj shfaqje të tilla duhen flakur tej, dhe ky problem duhet mbajtur kurdoherë parasysh.

Të gjithë jemi vëllezër dhe shokë luftime, punojmë për të njëjtin ideal, tjetrin e konsiderojmë shok, me të kemi luftuar dhe luftojmë për ta bërë më të lumtur jetën e popullit dhe për ta mbrojtur nga armiqtë që duan t'ia rrëmbejnë këtë lumturi. Atëherë pse njëri tha një fjalë, ose pse tjetri e kritikoi me të drejtë, për këtë arsye u dashka që disa njerëz të grinden? Pra-

ndaj në organizatat-bazë të Partisë, në radhë të parë, duhet të ketë një dashuri të sinqertë. Atje ku një çështje nuk ecën drejt, të kritikohet hapur, shoqërisht, ndërshtërisht dhe ai që kritikohet ta pranojë gjithashtu sinqërisht, shoqërisht, ndërshtërisht kritikën, kështu forcohet uniteti politik, ideologjik dhe organizativ i Partisë.

Në këtë drejtim jeta e brendshme e organizatës së Partisë në rrethin e Fierit është forcuar. Edhe vendimet që janë marrë, qoftë nga komiteti i Partisë, ashtu edhe nga organizatat-bazë në përgjithësi, janë të drejta. Udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në rreth e ka ndjekur mirë zbatimin e këtyre vendimeve, është përpjekur dhe është interesuar për to. Por nuk përjashtohet që të ketë lëshime, gabime dhe pakujdesi. Mbi këto të kemi kujdes që të mos përsëriten dhe të punohet që të zhduken. Niveli i komunistëve të organizatës së Partisë të rrethit të Fierit në përgjithësi është ngritur, po duhen bërë përpjekje edhe më të mëdha që anëtarët e Partisë ta ngrenë më tej nivelin e tyre kulturor e arsimor. Shkollat të ndiqen rregullisht si nga komunistët e qytetit, ashtu edhe nga ata të fshatit. Shokët e fshatit duhet të kenë parasysh se s'janë më pak përgjegjës nga ata të qytetit. Ata të kenë kurdoherë parasysh perspektivën që duhet dhe do të arrijë që fshati të jetë në nivelin e qytetit. Nuk do të jetë e largët dita kur në fshat nuk do të mbetet njëri pa mbaruar shkollën 7-vjeçare, dhe do të ketë edhe nga ata që do të kenë mbaruar shkolla të mesme e të larta. Mirëpo njerëz të tillë me kulturë të gjerë do të kenë nevoja të reja, që nuk do t'i plotësojë qyteti, por këto do t'i

plotësoni vetë ju këtu në fshat, qyteti vetëm do t'ju japë drejtimin, kurse jetën do ta organizoni ju, në mënyrë që këta kuadro dhe anëtarë të kooperativave bujqësore të gjejnë në fshat kushte pune, jete dhe dëfrim: të ngjashme me ato të qytetit. Vetvetiu agronomi ose zootekniku, mamia ose mësuesi etj., për shembull, në Cakran ose në Libofshë do të kërkojnë që atje jo vetëm të ketë shtëpi kulture që të organizojë shfaqje me program të mirë e të zgjedhur, po në shtëpitë, në rrugët e kudo në fshat të kryhen edhe shërbime komunale, të mbillen pemë e lule, të krijohen parqe, biblioteka dhe kinema, grupe sportive dhe artistike, për të argëtuar kooperativistët pas punës. Kështu këta të mos kenë më prikje për t'u shpërngulur në Fier, atje ata të shkojnë për të parë ndonjë ndeshje futbollit, ose për të dhënë shfaqjen e fshatit të tyre dhe të konkurrojnë me grupet e qytetit. Këto do të bëhen patjetër dhe duhet të bëhen në të ardhshmen, se niveli i njerëzve dhe i kuadrove në kooperativat bujqësore vazhdimisht vjen duke u rritur.

Rininë tonë e kemi shumë luftarake. Partia ka respekt dhe dashuri për punën e madhe që ka bërë dhe bën rinia. Ajo është e dalluar, entuziaste, revolucionare dhe shumë e hedhur për çdo detyrë. Tani shumë të rinj e të reja në fshatra zënë vende me përgjegjësi. Ja këtu u takova me një vajzë të re që është nënkryetare e kooperativës bujqësore të Frakullës, ajo ka kryer shkollën 7-vjeçare dhe tani mban një vend drejtues shumë të rëndësishëm. Kjo vajzë, po të mos kishte disa cilësi të mira që e dallojnë nga të tjerët, nuk mund t'u imponohej anëtarëve të kooperativës, të cilët

nuk e kanë zgjedhur në krye për sytë e saj të bukur, po sepse është e zonja, energjike, e mirë dhe e ndershme. Tani ajo me punën e saj do të dijë si të sillet me anëtarët dhe si t'i aktivizojë sa më mirë ata. T'i jepet asaj sa më shumë iniciativë edhe të ndihmohet në punë. Ajo di dhe duhet të dijë se, për zbatimin e vendimeve të asamblesë së kooperativës, duhet të jetë e palëkundshme. Me njerëzit e moshës së saj të jetë e rreptë, t'u kërkojë llogari, kurse me ata që janë më të mëdhenj se ajo, që janë baballarët ose gjyshërit e saj nga mosha dhe njerëz me eksperiencë të madhe në jetë, pa lëvizur nga kërkesat, t'u flasë me respekt me gojë të ëmbël, po edhe me vendosmëri, t'u tregojë vijën që duhet ndjekur dhe të jetë e sigurt se kështu do ta duan edhe më shumë.

Si kjo që thashë ka shumë të reja të tjera. Këtu në presidiumin e konferencës kemi një brigadiere që ka edhe kjo shkollën 7-vjeçare, por diskutoi para nesh me një lehtësi sikur të kishte bërë një shkollë të lartë politike. Këtë shkollë e ka bërë pranë kooperativës së vet me shokët dhe me shoqet e fshatit, të cilat, duke i parë aftësitë, e kanë zgjedhur brigadiere. Dhe, nga ç'mësuam, në kooperativën ku kjo drejton, punët shkojnë mirë. Prandaj kudo me guxim e kurajë t'i shtyjmë njerëzit të ecin përpara.

Të kemi parasysh se disa janë të rinj, disa të kaluar nga mosha, prandaj të mos harrojmë të përgatitim kuadro zëvendësues. Është detyrë e lartë që çdo njeri të përgatitë zëvendësin e tij nga ata që Partia i ka vënë afër. Prandaj të ketë kujdes jo t'i mënjanojë ata, po t'i ngrejë, se nga ata mund të ketë njerëz të

zotë që ta kapërcejnë. Në këtë rast, ai që e ka pregatitur zëvendësin, ta përshëndesë dhe ta urojë të ecë akoma më përpara. Njerëzit e rinj të periudhës së ndërtimit të socializmit duhet të ecin përpara, ata do të na e kalojnë neve dhe ne do të jemi të lumtur se për këtë lufton Partia. Për partitë komuniste thuhet se kurdoherë janë të reja, sepse në radhët e tyre vjen vazhdimisht gjak i ri, që zëvendëson të vjetrin për të përjetësuar veprën e madhe të komunistëve. Pra edhe një herë theksoj që Partia të tregojë kujdes të veçantë për brezin e ri.

Mbi të gjitha të forcojmë vigjilencën në Parti dhe në popull për mbrojtjen e Partisë, të atdhut, të pronës socialiste. Duhet vënë në dukje se në rrethin tuaj në disa njerëz janë dukur disa shfaqje jo të pëlqyeshme, si vjedhje, akraballëqe etj. Tani ato nuk shfaqen në atë shkallë si përpara, sepse Partia ka bërë një punë të mirë edukuese, kujdeset për mbrojtjen e pasurisë së përbashkët, megjithëse ka akoma njerëz jo të mirë që përpiqen të vjedhin e të dëmtojnë pasurinë socialiste.

Viti i kaluar ishte një vit i pasur me shumë ngjarje të brendshme dhe ndërkombëtare, që u karakterizua nga një mobilizim i jashtëzakonshëm si asnjëherë tjetër i Partisë dhe i masave punonjëse të vendit tonë. Populli shqiptar, për të realizuar me sukses vendimet historike që shtroi Kongresi i 4-t i Partisë sonë, u mobilizua me të gjitha forcat për të realizuar shtomoplanin e vitit 1961. Por Partia dhe i gjithë populli, si një trup i vetëm, u mobilizuan totalisht gjatë vitit të kaluar për të përballuar punën armiqësore të revizio-

nistit N. Hrushov dhe të grupit të tij, siç janë udhëheqësit e partive komuniste dhe punëtorë të vendeve të demokracisë popullore të Evropës, të cilët, të bashkuar rreth N. Hrushovit, u përpoqën ta dëmtonin Partinë tonë, pushtetin popullor dhe çështjen e madhe të komunizmit.

Kongresi i 4-t i Partisë ka një rëndësi të madhe historike për vendin tonë. Duhet thënë se ky Kongres ka pasur një jehonë të favorshme edhe në arenën ndërkombëtare për lëvizjen komuniste botërore. Kongresi i 4-t i PPSH ishte një thirrje për luftë parimore ideologjike kundër revizionizmit modern, që jo vetëm ka ngritur krye, por që po legalizohet në Bashkimin Sovjetik. Për këtë çështje, nga partitë komuniste dhe punëtorë të botës, nga marksistët e vërtetë, Kongresi i 4-t i Partisë sonë është vlerësuar si një Kongres luftarak për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Shumë nga ju kanë qenë delegatë ose të ftuar në këtë Kongres. Vendimet e këtij Kongresi tashmë janë punuar në Parti dhe në masat e popullit. Nëpërmjet tyre zhvillohet e gjithë puna dhe lufta e Partisë dhe e popullit tonë në të gjithë sektorët. Por Kongresi i 4-t i PPSH ka edhe një rëndësi tjetër, sepse ai jo vetëm bëri bilancin e punës për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, por arriti edhe në konkluzionin, në baza reale dhe konkrete, se në vendin tonë është ndërtuar baza ekonomike e socializmit dhe është zhdukur shfrytëzimi i njeriut prej njeriut.

Kongresi i 4-t i Partisë përcaktoi se tani vendi ynë hyri në një etapë të re, në atë të ndërtimit të plotë të socializmit. Detyra themelore e kësaj periudhe është

ndërtimi dhe forcimi i mëtejshëm i bazës materialo-  
-teknike të socializmit, shndërrimi i vendit tonë nga  
një vend agraro-industrial në një vend industrialo-  
-agrar.

Por ne duhet të kemi parasysh se Kongresi i 4-t i  
Partisë dhe vendimet e tij qysh në fillim ndeshën në  
vështirësi të mëdha të jashtme politike, ideologjike dhe  
ekonomike. Përpara se të zhvillonte punimet Kongresi  
i 4-t, me Bashkimin Sovjetik dhe me të gjitha vendet  
socialiste të Evropës dhe të Azisë ne kishim lidhur  
marrëveshje të rregullta tregtare, për të siguruar mjet-  
tet dhe makineritë e nevojshme që duheshin për të rea-  
lizuar planin e tretë pesëvjeçar. Por ne ishim plotësisht  
të bindur se N. Hrushovi dhe grupi i tij, të pasuar edhe  
nga miqtë e tyre revizionistë që kishin nxjerrë krye,  
do të bënin përpjekje me të gjitha forcat dhe mundë-  
sitë për të sabotuar planet tona ekonomike dhe ndër-  
timin e socializmit në Shqipëri. Komiteti Qendror i  
Partisë parashikonte se nga ana e grupeve revizioniste  
do të na bëhej një bllokadë e plotë ekonomike.

Ju e dini se lufta e paprincipitë e grupit revizionist  
të N. Hrushovit nuk filloi pas Kongresit të 4-t të Par-  
tisë sonë, ajo kishte filluar shumë kohë më parë. Por  
N. Hrushovi me shokë menduan që Kongresin tonë ta  
shfrytëzonin për të shpartalluar Partinë tonë dhe  
udhëheqjen e saj, ta vinin udhëheqjen në pamundësi  
për të dalë me një plan të drejtë ekonomik përpara po-  
pullit. Komiteti Qendror e shikonte që synimet e  
N. Hrushovit dhe të pasuesve të tij kundër Partisë sonë  
po vinin në ngritje. Po Partia nuk u frikësua. Kjo  
nuk ishte një përgatitje e luftës vetëm me fjalë nga ana

e grupit të N. Hrushovit, po çdo ditë ajo shoqërohej edhe me masa konkrete, siç ishin prerja e kredive, prerja e furnizimeve ushtarake, ekonomike, heqja e specialistëve etj., për t'i thënë Partisë ose t'i gjunjëzohej Hrushovit, ose të ekspozohej përpara rrezikut të fqinjëve dhe të imperialistëve. Prandaj N. Hrushovi preu edhe furnizimet ushtarake, me qëllim që të dobësohej aftësia mbrojtëse e vendit tonë, dhe nga ky presion të tronditej udhëheqja e Partisë dhe e shtetit tonë.

Të gjitha këto veprime ishin parashikuar nga Partia, kështu ne shkuam në Kongres duke qenë të përgatitur mirë. Dhe viti 1961, që ishte viti i parë i pesëvjeçarit të tretë, i cili u hartua në kushte shumë të vështira politike, ideologjike dhe ekonomike, në kushtet e rrethimit dhe porsa ishte zbuluar komploti armiqësor për sulmin nga jashtë, vërtetoi se çështja e socializmit në Shqipëri është e pamposhtur, se e pamposhtur është Partia jonë, e cila me vendosmërinë marksiste që e karakterizon edhe në rrethana shumë të vështira, i ka realizuar mirë detyrat që kishin para popullit.

Plani i vitit 1961 u realizua e u tejkalua në industri, miniera, ndërtim e kudo. Sigurisht ka pasur edhe ndërmarrje që nuk e kanë realizuar planin. Këto janë të njohura, puna e tyre është analizuar dhe janë marrë masa për ta përmirësuar gjendjen. Po mobilizimi i klasës punëtore në çdo sektor ka qenë kudo i madh, i lavdërueshëm me një frymë të lartë patriotike, gjë që bëri që plani të realizohej si asnjëherë tjetër. Ju vetë, shokë, keni luftuar me vështirësitë e panumërta, siç kanë



qenë mungesa e lëndës së parë, e pjesëve të këmbimit, mosardhja e makinerisë, e çimentos etj., pa llogaritur këtu luftën e madhe politike dhe ideologjike që u është bërë Partisë dhe atdheut tonë. Por zotësia, zgjuarsia dhe vendosmëria e kuadrove tanë bëri që plani jo vetëm të realizohej kudo, po edhe të tejkalohet.

Edhe në bujqësi patëm realizime të kënaqshme. Viti 1961 nuk mund të themi se ishte një vit i mbarë bujqësor, ai ishte një vit mesatar, megjithëse në bujqësi u dëmtuam nga kushtet e vështira atmosferike. Pavarësisht nga të metat dhe dobësitë në sektorin e bujqësisë, në krahasim me vitin 1960, viti 1961 ishte një vit më i mirë bujqësor, sidomos për pambukun, ku patëm rezultate të mira edhe në sasi edhe në cilësi. Vitin e kaluar na u dëmtua veçanërisht duhani. Humbjet nga duhani si Republikë janë rreth 50 milion rubla të vjetra. Humbje të mëdha pësoi sidomos kra-hina e Shkodrës, e Elbasanit etj., po në një farë shka-lle edhe rrethi juaj. Kjo humbje nuk u shkaktua për mungesë të mobilizimit në punë nga ana e kooperati-vistëve, po nga sëmundja e vrugut, kundër të cilit këtë vit duhet të merren masa të forta dhe shumë të rrepta.

Viti 1961 ka qenë gjithashtu një vit mobilizimi e me rezultate shumë të mira edhe në fushën e arsimit e të kulturës, si edhe në ngritjen e nivelit të jetesës së punonjësve të vendit tonë. Kurrë ndonjëherë popu-lli ynë nuk ka qenë në kushte kaq të mira furnizimi sa sivjet. Kënaqësia e popullit ka qenë e dukshme. Në çdo kohë në treg nuk kanë munguar as prodhimet in-dustriale, as ato bujqësore, çdo gjë ka qenë në rregull.

Për arsye të mosorganizimit të mirë të punës ndonjë njësie aty-këtu mund t'i ketë munguar ndonjë mall, po në përgjithësi populli është furnizuar me gjithçka. Kjo gjendje ka rritur besimin e madh në popull dhe në Parti, ai është i sigurt se megjithëse rreth e rrotull kemi shumë armiq, ata nuk kanë ç'të na bëjnë.

Vija e Partisë sonë është e drejtë, mobilizuese dhe se kur zbatohet gjer në fund, jo vetëm mund të kapërcehet çdo vështirësi, po dhe standardi i jetesës së masave punonjëse ngrihet vazhdimisht. Këtë e sheh dhe e ndjek vetë populli. Ky është një grusht i madh për N. Hrushovin dhe miqtë e tij. Kjo situatë u arrit në saje të unitetit, të vendosmërisë dhe të besimit të popullit ndaj Partisë, në saje të frymës dhe të patriotizmit të lartë luftarak të popullit dhe të Partisë për kapërcimin e të gjitha vështirësive të krijuara nga imperialistët, nga Titoja dhe nga Hrushovi. Kjo u arrit në saje të kompaktësisë së popullit dhe të Partisë si dhe të vijës së drejtë marksiste-leniniste, ndryshe kjo situatë nuk mund të krijohej. Nga një kalitje e fortë morale, politike e ideologjike që Partia i ka bërë popullit, nga kujdesi për të ngritur edhe më tej virtytet e larta të popullit tonë, shikoni sa i fortë e kompakt e sa shumë është lidhur ai rreth Partisë, ç'siguri ka në të për të ardhshmen, sa është forcuar atdheu.

Kalitja dhe forcimi politik dhe ideologjik i popullit solli si rezultat edhe fuqizimin ekonomik të vendit tonë. Ekonomia jonë shkoi edhe më përpara, pasi ne shfrytëzuam si duhet të gjitha veprat, makineritë e fabrikat që kemi ndërtuar, si pasojë e zotësisë dhe e pje-

kurisë së kuadrove tanë jo vetëm politikë dhe mendo-rë, po edhe tekniko-ekonomikë. Pa këta kuadro që edukoi dhe edukon me kujdes Partia për vite e vite me radhë, do të ishte shumë e vështirë të kryeshin me sukses të gjitha këto detyra të mëdha, sidomos pas vështirësive të shumta që na u krijuan.

N. Hrushovi me shokët e tij kishin një plan të madh kundër vendit tonë, që synonte të sabotohej ekonomia, të krijohet pakënaqësia në popull dhe në Parti, në mënyrë që të përfitonin njerëzit e tyre për të rrëzuar udhëheqjen se nuk iu bind diktatit të tij. Ata menduan se, me tërheqjen e specialistëve, industria jonë do të dorëzohej, çdo uzine e fabrike do t'i vihej kyçi, çdo ndërmarrje e rëndësishme në vendin tonë do të pushonte së prodhuari.

Specialistët sovjetikë na kanë sabotuar në naftë. Për disa vjet me radhë kemi harxhuar me qindra milion lekë për hapje pusesh të reja dhe, megjithëse udhëheqja sovjetike na kishte dërguar specialistë «të shquar», asgjë me rëndësi nuk doli. Njerëzit tanë kishin besim të plotë te gjeologët sovjetikë, sido që disa prej tyre, nga puna që bënin, i shikonim me një sy të dyshimtë. Kështu vazhdoi puna gjer në një farë shkalle sa u mbush kupa. Ne vinim re se grupet e gjeologëve sovjetikë në raportet që jepnin ç'thoshte njëri nuk thoshte tjetri, një palë thoshin ka naftë në Shqipëri, të tjerë kundërshtonin, një palë thoshin shtresat janë të ngatërruara, të tjerë të shpojme drejt bregut të detit, apo drejt Tomorit. Atëherë njoftuam qeverinë sovjetike se ne nuk mund të pranohim gjithë këtë konfuzion mendimesh rreth problemit të naftës, prandaj

t'i gjendej një zgjidhje këtij problemi. Ndërkohë qeveria sovjetike dërgoi një nga specialistët «më të mëdhenj», po ai nuk ishte specialist po një hrushovian, që na komunikoi se ishte e drejtë vërejtja që bënim ne, duhej vendosur të shpohej në disa pika për të mos u larguar shumë, dhe pandehu se me këto fjalë do të kënaqeshim e do të binim në gjumë. Po planet e N. Hrushovit ranë në ujë, sepse kuadrot tanë u treguan në lartësinë e duhur, bile përpara këtyre vështirësive ata treguan aftësi dhe zgjuarsia të madhe.

Tani që nga inxhinierët e gjeologët e gjer te punëtorët më të thjeshtë ecin më të sigurt, të bazuar në pjekurinë, eksperiencën dhe diturinë e tyre, ata ecin më të matur në çdo veprim se u dhimbset pasuria e popullit, pasuria e tyre. Kështu shumë iniciativa të mëdha janë marrë gjatë këtij viti nga punëtorët dhe teknikët tanë, duke prodhuar pjesë këmbimi, të cilat më parë i importonim. Specialistët sovjetikë na thoshin të mos bënim në vend as pjesët e këmbimit, se «ju kushtojnë shumë, ato mund t'i merrni në Moskë ose në Pragë». Po ishte vetë politika e Hrushovit që i orientonte ashtu ata, ai na këshillonte ne, sa herë takoheshim, të mos preokupoheshim për bukë dhe na thoshte se «aq sa u duhet juve, neve na e hanë minjtë, prandaj mbillni limona e portokalla, vreshta e ullinj». Domenthënë ne ta orientonim ekonominë tonë sipas qëllimeve të tij, që pastaj, kur të vinin këto situata të vështira, për të cilat ai punonte, të na zinte për gryke dhe të na mbyste. Po qëllimit nuk ia arriti dot.

Përkundrazi, tani industria dhe minierat tona, të gjithë sektorët e ekonomisë, ecin edhe më mirë, punë-

torët dhe specialistët tanë jo vetëm drejtojnë më mirë uzinat, fabrikat, ndërmarrjet, po atyre u është hapur edhe horizonti për zhvillimin e iniciativave në të gjitha drejtimet. Pra, për arritjen e të gjitha këtyre suksesëve të vërtetuara gjatë vitit 1960, kanë luajtur rol të gjithë faktorët e brendshëm që përmenda, por një faktor i madh i jashtëm ka qenë edhe ndihma ekonomike internacionaliste që na u dha nga Republika Popullore e Kinës.

Perspektiva të reja i hapen vendit tonë gjatë vitit 1962. Plani i këtij viti është akoma më i ngjeshur nga ai i vitit të kaluar, si në industri, miniera e bujqësi, po veçanërisht në ndërtime. Prandaj për realizimin e tij jo vetëm duhet ngritur më lart fryma e patriotizmit dhe e vendosmërisë së masave punonjëse, po duhet të përmirësohet edhe puna për forcimin e organizimit, për rritjen e mëtejshme të iniciativave dhe të mobilizimit të punonjësve, hovi në punë të shtohet akoma, dhe me siguri ne jo vetëm do të realizojmë me sukses planin e këtij viti, po edhe do ta tejkalojmë, me qëllim që të mbulojmë dhe një pjesë të deficiteve të krijuara gjatë vitit të kaluar, veçanërisht në bujqësi, si në grurë, duhan, sheqer, pambuk. Të kemi parasysh se vitet e ardhshme të këtij pesëvjeçari do të jenë akoma më të ngjeshura, mbasi do të bëhen ndërtime të mëdha, prandaj fundi i vitit 1962 duhet të na gjejë me plan të realizuar dhe me rezerva të mjaftueshme për të përballuar planet e ardhshme. Dhe ne jemi të bindur se do ta realizojmë me sukses planin e vitit 1962, sepse vështirësitë që na u krijuan tani i kemi kapërcyer me sukses, dhe kemi besim se do të kapërcejmë edhe çdo

vështirësi tjetër që armiqtë e socializmit do të na nxjerrin në rrugën tonë.

Ne kemi besim të plotë në këtë çështje, sepse potenciali i ekonomisë sonë socialiste nuk është ai që ka qenë para 10 vjetëve. Tani ekonomia jonë ka një bazë shumë më të fuqishme. Kjo tregon se në Shqipëri ka triumfuar sistemi socialist, është rritur niveli i forcave prodhuese. Në këto forca ka rezerva të mëdha, të cilat duhen shfrytëzuar plotësisht, në radhë të parë kuadrot tanë të shumtë, që tashmë kanë një eksperiencë të madhe. Vetëm në sektorin e gjeologjisë punojnë 360 kuadro të lartë dhe rreth 1 500 kuadro të mesëm, kurse në industri 330 kuadro të lartë dhe rreth 1 200 të mesëm. Gjithsejt në të gjithë sektorët e ekonomisë sot kemi rreth 2 000 kuadro të lartë dhe 5 200 të mesëm. Kjo është një forcë e madhe. Prandaj kemi besim se punët tona në çdo sektor do të na ecin gjithnjë mirë e më mirë. Tani kemi një ekonomi të fuqishme, në radhë të parë kemi një industri moderne, kemi kuadrot tanë të artë, të pajisur me një shpirt të lartë patriotizmi dhe mbi të gjitha kemi popullin tonë të mrekullueshëm, që kurrë nuk e ka bërë dy fjalën e Partisë; ai çdo hap dhe masë të Partisë e ka quajtur të drejtë. Prandaj, me gjithë vështirësitë dhe pengesat e mëdha që na kanë dalë, populli është bashkuar edhe më fort rreth Partisë, duke e mbështetur fuqimisht vijën e saj. Për ndërtimin socialist të vendit përveç forcave tona të brendshme kemi dhe ndihmën e madhe internacionaliste të Republikës Popullore të Kinës. Kohët e fundit ishte atje delegacioni ynë ekonomik qeveritar, i cili konkretizoi marrëveshjen zyrtare që ishte për-

funduar vitin e kaluar, veçanërisht për vitin 1962. Të gjitha ato që kërkuam, na u siguruan nga ana e RP të Kinës.

Por në planet tona janë bërë edhe disa ndryshime që nuk luajnë ndonjë rol në zhvillimin e ekonomisë sonë në pesëvjeçarin e tretë. Këto na u imponuan nga vështirësitë që na krijoi grupi i N. Hrushovit dhe kanë sjellë si pasojë disa boshllëqe e deficite në plan me një vleftë rreth një miliard lekë. Por këto deficite ne do t'i plotësojmë gjatë pesëvjeçarit me tejkalimet që do të bëhen në planin e sektorëve të ndryshëm nga kursimet si dhe nga shpikjet e racionalizimet që mund të bëhen në industrinë kombëtare apo lokale; nga zbatimi në jetë i iniciativave për një prodhueshmëri më të lartë, siç janë: iniciativa për të prodhuar në vend vajrat lubrifikante, iniciativa për ndërtimin e një fabrike çimentoje me kapacitet 40 mijë tonë në vit me forcat e brendshme etj., të cilat do të na japin mundësi të kursejmë miliona dollarë në vit dhe të shfrytëzojmë lëndën e parë të vendit në një shkallë të gjerë.

Të tilla iniciativa shumë të çmueshme punëtorët dhe inxhinierët tanë më parë nuk i merrnin në një shkallë të tillë dhe duhet thënë se kuadrot tanë përpara ishin të ndrydhur për arsye se sovjetikët na këshillonin që, për çdo gjë që na nevojitej, t'i dërgonim lista Qeverisë për të na i sjellë nga jashtë, pa parë një herë nëse kishte mundësi apo jo t'i bënim shumë nga ato në vend. Kurse tani është ndryshe dhe kanë filluar të bëhen jo gjëra të vogla, po gjëra shumë të mëdha. Ja pardje na erdhi propozimi nga punëtorët e Fabrikës së Çimentos në Shkodër për të ndërtuar me mundësitë tona një fabrikë të re çimentoje me kapacitet 40

mijë tonë çimento në vit<sup>1</sup>, domethënë sa ishte kapaciteti i fabrikës së Vlorës para rikonstruksionit. Punëtorët e Shkodrës kanë gati materialet dhe mjetet e fabrikës së re, ata duan të dinë tani vetëm vendin ku do të ngrihet kjo fabrikë. Dhe kjo fabrikë është jashtë planit, jashtë atyre dy fabrikave të mëdha që do të ndërtojmë për prodhimin e çimentos me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës.

Në Shkodër tani po fabrikojnë edhe mullinjtë e blojes, punë kjo me leverdi të madhe ekonomike, mbasi çdo nulli ne e importojmë me 180 mijë rubla, përveç asaj nëse ta jep apo nuk ta jep tjetri. Tani këto i bëjnë punëtorët dhe specialistët tanë dhe na kushtojnë shumë më lirë.

Kështu pra janë të gjitha mundësitë që deficitet, të cilat na u shkaktuan nga veprimtaria minuese antimarksiste e grupit të N. Hrushovit, ne do t'i plotësojmë, bile janë mundësitë që planet t'i tejkalojmë me anën e këtyre iniciativave që shtohen dita-ditës në të gjithë sektorët. Kjo u detyrohet vendosmërisë dhe aftësive të mëdha krijuese të kuadrove tanë dhe udhëheqjes e vijës së drejtë të Partisë sonë.

*Në vazhdim të fjalës së vet shoku Enver Hoxha foli për zhvillimin e situatës ndërkombëtare dhe për mosmarrëveshjet kryesore politike dhe ideologjike që ekzistojnë në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore botërore, për shkak të pikëpamjeve dhe të veprimtarisë revizioniste e antimarksiste të grupit tradhtar të N. Hrushovit. Në përfundim ai tha:*

---

1 Kjo fabrikë u ndërtua në Tiranë pranë kombinatit të materialeve të ndërtimit «Josif Pashko».



Gjendja politike e vendit tonë në përgjithësi është e fortë, e shëndoshë. Patriotizmi i lartë dhe uniteti i çeliktë rreth Partisë janë karakteristika të masave tona punonjëse.

Ne i kemi shpjeguar e do t'i shpjegojmë Partisë sonë gjithmonë drejt, në rrugë marksiste-leniniste, të gjitha problemet e mëdha politike dhe organizative, dhe nuk do të biem në gjumë në asnjë rast në çështjen e luftës kundër imperializmit, këtë luftë nuk do ta këputim nga lufta që i bëjmë revizionizmit jugosllav titist dhe hrushovian.

Në këtë prizëm duhet t'i analizojmë këto çështje, të cilat nuk janë personale, po kanë të bëjnë me politikën e madhe ndërkombëtare dhe me triumfin e ideve të komunizmit. Prandaj në këto situata të vështira, po edhe revolucionare, çdo marksist duhet ta kuptojë drejt situatën dhe të veprojë. Çështja nuk shtrohet që për të vepruar duhet të jesh parti e vogël apo e madhe, kështu e shtron çështjen vetëm N. Hrushovi, kështu e shtrojnë çështjen ata që nuk janë marksistë. Kur N. Hrushovi sheh se një parti e vogël ngrihet dhe bën një vërejtje apo një kritikë, ai i kundërvihet asaj duke u nisur nga pozitat antimarksiste të të fortit, nuk gjykon si marksist.

Prandaj t'u sqarojmë masave tona punonjëse ku çon politika e N. Hrushovit, që gjen mbështetjen e plotë të Titos dhe të imperialistëve, të luftojmë veprimtarinë antimarksiste të tij që diskrediton politikën e jashtme të BS. Qysh tani, Hrushovi e ka diskredituar Bashkimin Sovjetik përpara popujve të porsaçliruar të Afrikës, të cilët nuk kanë besimin e mëparshëm. N. Hru-

shovi e ul prestigjin e BS në çdo drejtim, ai u përulet imperialistëve amerikanë. Përse ky njeri ulet kaq shumë ndaj imperialistëve amerikanë? Në kohën e Stalinit shtabi amerikan i aviacionit ishte shqetësuar jashtëzakonisht shumë nga pengesat që iu vunë, me urdhër të Stalinit, avioneve të aleatëve më 1952, nga Ushtria Sovjetike në korridoret që çonin në Berlin. Stalini nuk lejoi kalimin e këtyre avioneve, gjersa aleatët u detyruan të pranonin atë që kishte thënë ai të bëhej, ndërsa Hrushovi vetëm rreh ujët në havan dhe diskrediton autoritetin e madh ndërkombëtar që gëzonte në kohën e Stalinit Bashkimi Sovjetik, përçan unitetin e kampit socialist.

Në këto situata, që janë luftarake dhe të favorshme për ne, të kemi vazhdimisht parasysh për të zbatuar si duhet detyrat kryesore politike, ideologjike, ekonomike dhe organizative, se lufta kundër revizionizmit modern, Titos, Hrushovit dhe pasuesve të tyre, do të jetë e gjatë. Por asgjë nuk i tund Partinë dhe Republikën tonë Popullore nga rruga e lavdishme që kanë nisur. Ne do të ecim përpara me besim të patundur në këtë rrugë dhe do të fitojmë.

Prandaj të luftojmë për zbatimin e detyrave që na ngarkon Kongresi i 4-t i Partisë, të vazhdojmë pa u ndalur punën për demaskimin e pareshtur të imperializmit, veçanërisht të imperializmit amerikan, si koka udhëheqëse e reaksionit botëror, të cilit N. Hrushovi me veprimtarinë e tij armiqësore po i hap vazhdimisht rrugën.

Ne duhet të punojmë pa u lodhur me masat për të sqaruar qëndrimin marksist-leninist të Partisë sonë ndaj lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe luftës na-

cionalçlirimtare të popujve të shtypur e kolonialë, për të luftuar njëkohësisht edhe tezat e revizionistëve, si domos për problemin e çarmatimit që ata e paraqitin sot si një çështje kryesore. Propaganda e Partisë duhet të sqarojë mirë kontradiktat politike, ideologjike dhe ekonomike në gjirin e imperialistëve, të cilat vijnë vazhdimisht duke u ashpërsuar. Të sqarohet qëndrimi marksist-leninist i Partisë sonë në përkrahje të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe të masave të gjera punonjëse të botës. Kjo përkrahje tregon internacionalizmin e lartë të Partisë sonë. Kudo që klasa punëtore lufton për interesat e saj politike, ideologjike dhe ekonomike, Partia jonë ka qenë dhe do të jetë kurdoherë në pararojë për përkrahjen e kësaj lufte.

Lufta dhe përpjekjet e Partisë sonë kanë për qëllim të forcojnë unitetin në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, mbi bazat e marksizëm-leninizmit. Uniteti ynë duhet të vendoset vetëm në rrugën e marksizëm-leninizmit. Të tillë unitet kishte vetëm në kohën e Stalinit. Mua më ka qëlluar shumë herë, si Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë sonë, të takohesha me Stalinin, kam vënë re se ai, në asnjë rast, nuk e ngriti zërin për të na imponuar pikëpamjen e tij. Në kohën e Stalinit kishte unitet në mes partive, sepse nga të gjithë ndiqej vija e drejtë për çështjet ndërkombëtare edhe në lidhje me rrugën e ndërtimit të socializmit në vendet e demokracisë popullore. Por ne shikojmë ç'orvatje të dëshpëruara bën N. Hrushovi për të rrëzuar veprën e Stalinit dhe për të diskredituar personin e tij. Nuk është aspak e vërtetë se Stalini mudohej t'u impononte të tjerëve pikëpamjet e tij, po

rruga e drejtë që ndiqte ai, respektimi i normave leniniste në çdo drejtim, politika e drejtë në çdo rast, bënin që në kohën e tij të kishte besim të plotë, pra edhe një unitet të fortë, si brenda në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në kampin socialist dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Komiteti i Partisë të shqyrtojë më shumë probleme të punës politike dhe ideologjike në organizatat-bazë, të cilat të bëhen qendrat e punës politike me masat. Organizatat-bazë të jenë akoma më luftarake, t'i kuptojnë më mirë situatat dhe të veprojnë në mënyrë krijuese. Një fjalë në çdo mbledhje ka një rëndësi të madhe, prandaj komunistët ta thonë atë, sepse edhe një sqarim, sado i vogël, ka rëndësi të jashtëzakonshme për forcimin e Partisë.

Të punojmë për forcimin e mëtejshëm të unitetit të Partisë me popullin dhe të kalitet vazhdimisht vigjilenca e madhe revolucionare e masave dhe e Partisë në radhë të parë.

Rëndësi e madhe t'i kushtohet forcimit të mbrojtjes së atdheut, se jemi një vend i vogël e i rrethuar dhe rreziku kundër atdheut tonë ekziston kurdoherë. Por Partia jonë vigjilon dhe vazhdimisht forcon situatën dhe kjo situatë zhvillohet kurdoherë në favorin tonë.

Prandaj të punojmë në bazë të vendimeve të Kongresit të 4-t të Partisë, sidomos për forcimin e unitetit të radhëve të saj që ka rëndësi të dorës së parë. Të përfitojmë nga këto situata të favorshme dhe t'i flasim popullit për fushatat e mëdha politike të këtij viti, siç janë zgjedhjet për deputetët e Kuvendit Popullor dhe 50-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare.

Dita e Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, 28 Nëntori 1912, është një datë e madhe historike që na kujton ngritjen e flamurit nga Ismail Qemali. Prandaj 50-vjetori i saj këtë vit do të përkujtohet në mënyrë madhështore në gjithë vendin tonë, do të përmenden aktet e patriotëve të mëdhenj shqiptarë, me këtë rast mund të botohet edhe pjesa e dytë e Historisë së Shqipërisë. Prandaj për nder të kësaj ngjarjeje të madhe të mobilizojmë të gjitha forcat për realizimin e planit dhe për forcimin e pozitave ndërkombëtare të atdheut tonë.

Të punojmë pareshtur për forcimin e Partisë dhe për kalitjen e mëtejshme të unitetit të radhëve të saj. Për këtë qëllim të shtohet roli i organizatave-bazë të Partisë, të bëhen këto vetëvepruese dhe me iniciativë, duke pasur kurdoherë parasysh vijën e Partisë. Komunistët të mos presin që për çdo gjë t'u venë udhëzime nga lart, ata të punojnë e të veprojnë edhe me iniciativën e tyre, dhe në qoftë se bëjnë ndonjë gabim, kjo nuk prish punë, sidomos kur gabimi bëhet pa qëllim dhe nuk është i rëndë. Në qoftë se një çështje e ke rrahur me vaj e me uthull qysh më parë, atëherë puno që ta zgjidhësh, mos ki frikë çfarë do të thotë komiteti i Partisë. Në qoftë se komiteti thotë «sikur ta kishe bërë ndryshe do të ishte më mirë» «dakord, thuaj, e bëjmë edhe ashtu», po pa vepruar e me duar lidhur nuk duhet ndenjtur.

Kujdes duhet të tregohet edhe për forcimin e përbërjes së Partisë, për përmirësimin e metodës së punës së saj, për edukimin dhe për ngritjen e kuadrove të rinj që edhe këta të përfitojnë sa më shumë nga eksperiencia e madhe e punonjësve të vjetër.

Përpjekje të bëhen nga të gjithë për realizimin e planeve në të gjithë sektorët. Të merren masa gjithashtu edhe për krijimin e rezervave të lëndëve të para, jo vetëm për rezervat shtetërore, se për këtë kujdesen Qeveria dhe Komiteti Qendror, po të krijohen rezerva nga çdo ndërmarrje e dikaster. Të sigurohen kudo rezerva operative, bile edhe më tepër nga sa parashikohet, nëpërmjet kursimeve, shfrytëzimit më me ekonomi të lëndëve të para. Secila ndërmarrje të krijojë rezervën e vet për çdo moment të keq që mund të na ngjasë. Ne këtë vit kemi nënshkruar marrëveshje me disa nga vendet e demokracisë popullore të Evropës. Po kush na siguron se, mallrat që na nevojiten e që do t'i kontraktojmë me këto, do të na i dërgojnë në kohën e duhur? Ato mund të na i justifikojnë vonesat me vështirësitë e transportit, me mosrealizimin e prodhimit etj., etj., me qëllim që të na vonojnë furnizimet. Pikërisht për të përballuar këto raste na duhen rezervat. Kur ne t'i kemi krijuar rezervat, atëherë ato s'kanë ç'të na bëjnë.

Në fushën e prodhimit kini kurdoherë parasysh cilësinë, koston dhe dorëzimin e objekteve në kohën e parashikuar. Bëni përpjekje sidomos për shtimin e prodhimeve të destinuara për eksport. Në këtë drejtim të jemi shumë të rreptë edhe për sasinë, edhe për cilësinë. Jashtë ne duhet t'i eksportojmë mallrat sipas standardeve të kontraktuara. Në qoftë se nuk bëjmë përpjekje për shtimin e prodhimeve për eksport dhe për përmirësimin e cilësisë së tyre, atëherë tregtia jonë e jashtme do të gjendet përpara vështirësive të mëdha, prandaj të shtojmë prodhimet dhe të rritim cilësinë e tyre.

Të kemi vazhdimisht parasysh problemin e kursimeve në interes të forcimit të ekonomisë popullore dhe për rritjen e mëtejshme të investimeve.

Bujqësia është një sektor me rëndësi shumë të madhe për ekonominë tonë. Në radhë të parë t'u kushtohet shumë kujdes prodhimit të bukës, realizimit të planit të drithërave. Për këtë qëllim të zbatohen plotësisht detyrat për plehërimin dhe kullimin e tokave, për punimin e mirë dhe të thellë të tyre, për shërbimet kulturore dhe vaditjen etj., por të mos harrojmë bimët industriale, sidomos duhanin, pambukun e panxharin, t'i kushtohet kujdes zhvillimit të frutikulturës, vreshtave e agrumeve.

Blegtoria të jetë vazhdimisht në qendër të vëmendjes të organizatave-bazë. Të realizohet plani i krerëve, po edhe zërat e tjerë të planit të prodhimit si i mishit, i leshit dhe sidomos i qumshtit.

Suksese të mëdha kemi arritur në kooperativat bujqësore, po sidoqoftë duhen shtuar përpjekjet për forcimin e tyre organizativ, për përgatitjen dhe për ngritjen e kuadrove kooperativistë.

Duhet të përmirësojmë akoma më shumë furnizimin e popullit. Ju vutë re sa u kënaqën masat punonjëse të fshatit dhe të qytetit kur gjatë periudhës së Vitit të Ri gjetën gjithçka që u nevojitej. Ky lloj furnizimi sa të jetë e mundur të jetë i vazhdueshëm. Në qoftë se ne arrijmë t'i japim popullit ato për të cilat ka nevojë, kemi korrur një sukses shumë të madh.

Ndjekja e shkollave dhe përvetësimi i programeve nga pionierët, nxënësit dhe studentët tanë, si dhe nga

ata të shkollave të mbrëmjes dhe me korrespondencë, nga ana e punonjësve, është një nga problemet më të rëndësishme për të cilin duhet të preokupohet shumë Partia.

Të kujdesemi shumë edhe për organizimin e aksioneve kulturore masive, në qytet dhe në fshat, për përhapjen e zhvillimin e muzikës, këngëve, valleve, estradës, teatrit etj., etj., se bëjnë efekt të madh në ngritjen e nivelit kulturor dhe në rritjen e gjendjes revolucionare të popullit, prandaj asnjë prej këtyre të mos lihet pas dore e të nënvleftësohet. Në masat gjen talente të mrekullueshme. Të zbulohen e të përhapen këto talente, të ecin përpara se populli që i sheh e i dëgjon ka nevojë për veprimtarinë e tyre, edukohet me to. Në këtë drejtim mos u kufizoni vetëm në ato që jep shteti. Vetë komiteti i Partisë, komiteti ekzekutiv, kryesitë e kooperativave bujqësore, po ta kenë të qartë këtë çështje, gjejnë mjetet dhe mënyrat për të ndihmuar artistët amatorë dhe ata profesionistë për t'u zhvilluar vetë dhe për të kënaqur popullin.

Kujdes të veçantë e të madh duhet të tregoni për intelektualët. Punoni me ta për t'i lidhur sa më ngushtë me vijën e Partisë sonë. Tani ne kemi një brez të madh intelektualësh të rinj, shumë më tepër se të vjetrit, të cilët janë fare të paktë, por që të gjithë rrojnë në harmoni, sepse të gjithë kanë besim në vijën e Partisë. Në qoftë se mbahen afër, në qoftë se u shpjegohen mirë çështjet aktuale për të cilat kanë nevojë dhe janë të paqartë, ata kaliten me vijën e Partisë.

Detyra kryesore është të punojmë për të realizuar



planet, për forcimin e Partisë, të atdheut dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të luftojmë pa u përkulur për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Ne këtë e bëjmë duke qenë të ndërgjegjshëm dhe se e çmojmë që është një detyrë e lartë që duhet ta bëjmë. Partia jonë e mbron këtë rrugë të drejtë dhe po e kryen me nder këtë detyrë të madhe fisnike po shumë të vështirë. Me qindra janë letrat që i vijnë Komitetit Qendror të Partisë nga shumë vende të botës, nga komunistë dhe jo komunistë, disa të nënshkruara edhe me 40-50 firma, me të cilat jo vetëm autorët solidarizohen me Partinë tonë dhe na përkrahin, po na kërkojnë materiale që marrin përsipër t'i shtypin dhe t'i shpërndajnë në vendet e tyre. Kjo tregon besimin e njerëzve të ndershëm në botë ndaj Partisë sonë dhe vijës së saj dhe me bindje ne themi se shpresat e tyre të mëdha ndaj Partisë sonë nuk do të shkojnë kot. Partia e Punës e Shqipërisë do të luftojë me vendosmërinë më të madhe gjer në fitoren e plotë të ideve të mëdha të marksizëm-leninizmit për shkatërrimin definitiv të imperializmit dhe të revizionizmit.

Ju uroj, shokë, suksese sa më të mëdha në punën tuaj! Komiteti Qendror i Partisë është i bindur se komunistët e organizatës suaj, në krye të të gjitha masave punonjëse të rrethit të Fierit, do të vënë të gjitha forcat për të realizuar me sukses të gjitha detyrat që u ka vënë Partia përpara dhe do të bëjnë të mundur që Fieri të jetë në ballë të rretheve më të mira. Ne kemi bindjen se me punën tuaj dhe të popullit të këtij rrethi, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, Fieri do të bëhet akoma më i bukur, se është një rreth me perspek-

tivë të madhe, me pasuri të shumta, me organizatë partie të fortë dhe me një popull punëtor.

Rroftë Partia dhe populli ynë!

Punë të mbarë e suksese organizatës së Partisë dhe gjithë komunistëve e punonjësve të Fierit në shërbim të popullit, të atdheut e të socializmit!

*Botohet për herë të parë, me shkurtime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TË KUJDESEMI VAZHDIMISHT PËR GRATË DIE TË REJAT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

1 mars 1962

Të keni parasysh vazhdimisht dhe të kujdeseni që shkollën ta ndjekin një numër kurdoherë më i madh të rejash<sup>2</sup>. Partia, organizata e rinisë dhe shkollat të përpiqen që të rejtat të rriten me një frymë të lartë morale dhe politike. Është e domosdoshme të punojë veçanërisht shkolla që të rejtat të edukohen politikisht, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të marrin pjesë aktive si edhe djemtë në problemet politike. Edhe organizata e rinisë të ndikojë në këtë drejtim që të rinjtë e të rejtat të jenë aktive në këto çështje.

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua për zbatimin e vendimit të KQ të PPSH «Mbi masat për edukimin arsimor, tekniko-profesional dhe ngritjen e gruas në punë me përgjegjësi».

2 U drejtohet sekretarëve të komiteteve të Partisë të rretheve Berat e Pogradec, që merrnin pjesë në këtë mbledhje.

Organizatat e Partisë duhet të punojnë sistematikisht për zëvendësimin e punës së burrit me gruan në ata sektorë ku ka mundësi. Në këtë drejtim është bërë mjaft punë në qytete, po edhe këtu ka akoma shumë vende ku burrat mund të zëvendësohen me gra. Sigurisht për këtë ka edhe vështirësi, por këto duhen kapërcyer. Mund të bëhej një kontroll i fortë nga ana e komiteteve të Partisë dhe e komiteteve ekzekutive për emërimet në vendet e reja që hapen. Për shembull, Berati duhet të mendojë që tani për të mos emëruar burra në kombinatin e ri të tekstileve që do të ndërtohet. Ka shumë vende ku fare mirë mund të punojnë gra, si në dyqane, restorante dhe në ndërmarrjet që do të jenë rreth kombinatit. Kjo duhet pasur mirë parasysh, se po u fut burri të punojë 2-3 vjet, pastaj është vështirë ta heqësh. Ose në Pogradec, tani që vjen behari, në hotele, restorante, mensa, shtëpi pushimi, kampe etj., të mos vendosen burra. Në fshatra të tregohet kujdes për të vendosur më tepër gra brigadiere, skuadërkomandante etj. Pra të përpiqemi t'i vëmë gratë në punë e prej andej, më të mirat, t'i pranojmë edhe në Parti.

Duhet t'i theksohet edhe një herë organizatës së gruas çështja e ekonomisë shtëpiake, jo vetëm në atë drejtim që gruaja të mbajë shtëpinë të pastër dhe në rregull, po të mësohet që të administrojë mirë edhe të ardhurat në familje. Po të arrihet kjo, do të jetë një tjetër fitore e madhe për përparimin e familjes në qytet dhe në fshat. Kjo çështje ka rëndësi të madhe, prandaj, për ta vënë në rrugë si duhet, është e domosdoshme të

mendojnë si Partia, ashtu edhe organizata e gruas. Të arrihet që shpenzimet e familjes të bëhen me ekonomi dhe në mënyrë të kulturuar.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## FIZKULTURA DHE SPORTET NDIHMOJNË SHUMË PËR SHËNDETIN E MASAVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

1 mars 1962

Duhet të përpiqemi që çështja e kulturës fizike dhe e sporteve të mos nënvleftësohet nëpër shkolla ashtu siç ndodhte në të kaluarën. Disa kërkesa të shkollës tani mund të na duken si të tepërta, por këto janë të nevojshme. Çështjen duhet ta shohim nga pikëpamja e shëndetit të brezit të ri. Në qoftë se nuk bëjmë pranë shkollave një sallë, nuk sigurojmë një bazë minimale materiale për gjimnastikën dhe për lodra, në të ardhshmen nuk mund të kemi njerëz aq të shëndetshëm për t'u bërë ballë me më pak vështirësi sëmundjeve dhe të papriturave që mund t'i dalin njeriut në jetë. Ndërtimi i

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi zbatimin e vendimit të Sekretariatit të Komitetit Qendror «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të fizkulturës e sporteve».

një salle për mësimin e fizkulturës në shkollë, realizimi i programit të fizkulturës dhe të sporteve do të bëjnë që të ngrihet rendimenti në punë i punëtorëve e në ushtri do të venë të rinj të fortë, rezistentë.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës çështjen e kursimeve të mos e neglizhojë, por këtë të mos e shikojë vetëm te sallat për kulturën fizike, sepse ka drejtime të tjera ku mund të bëhen shkurtime. Kjo ministri të ketë më shumë iniciativë për të pajisur shkollat sipas nevojave që kanë dhe të jetë ajo në radhë të parë që t'i kuptojë më mirë këto nevoja. Mund të ndodhë që ne të vlerësojmë më shumë disa nevoja të tjera, kurse Ministria e Arsimit dhe e Kulturës ka për detyrë të na sinjalizojë e të na propozojë se çfarë duhet bërë për kalitjen e shëndetit të nxënësve. Prandaj çdo shkollë nuk duhet të mbetet pa paralele, unaza, disk, shtizë, gjyle etj. Është e domosdoshme që këto nevoja të plotësohen për ta bërë më dobiprurëse mësimin e fizkulturës. Gjersa shoku Spiro Koleka dhe shoku Manush Myftiu janë dakord që këto gjëra të bëhen, edhe ne nuk kemi kundërshtim.

Mendoj të pregatitet një letër nga ana e Sekretariatit të Komitetit Qendror për çështjen e edukatës fizike dhe të sporteve, duke theksuar nevojën e zhvillimit të tyre që nga kopshtet e shkollat fillore e gjer në shkollat 11-vjeçare. Pastaj të flitet për rëndësinë e sportit në përgjithësi, veçanërisht për punëtorët e nëpunësit që nuk merren dhe që duhet të merren më shumë me gjimnastikë dhe me sport. Në këtë letër të flitet për rëndësinë e sporteve masive, ekskursioneve, turizmit etj.

Letra të mos jetë e thatë dhe me karakter teknik, po të ketë formën e një thirrjeje për forcimin e shëndetit, edukimin dhe dëfrimin e fëmijëve, të rinisë dhe të masave të gjera punonjëse të vendit tonë. Nëpërmjet kësaj letre mund t'i bëhen edhe disa rekomandime Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës për të marrë masa që gjimnastikës t'i vihet një rëndësi më e madhe në kopshte e në shkolla, t'u bëhet thirrje mësuesve e pedagogëve, drejtorëve të shkollave dhe gjithë kuadrove të arsimit që të kujdesen më shumë për këtë problem. Gjithashtu t'u rekomandohet qendrave të punës për të bërë përpjekje që të rregullojnë sheshet sportive, ku të tërheqin e të aktivizojnë sa më shumë punonjës.

Letra, pra, të bëhet në një frymë që njerëzit të kuptojnë se Partinë e preokupon shumë çështja e shëndetit të fëmijëve, të rinisë, të punëtorëve e të nëpunësve dhe se një nga faktorët për forcimin e shëndetit të masave është fizkultura, janë sportet. Kudo të tërhiqet vëmendja që t'u bëhet një luftë e vazhdueshme dhe sistematike mbeturinave që pengojnë zhvillimin e fizkulturës e sportit si edhe çdo veprim që çon në nënvleftësimin e kalitjes fizike. Kështu të rinjtë nuk do të tërhiqen nga ëndërrimet e kota dhe të sëmura, por kohën e lirë do ta përdorin më mirë për edukimin e tyre dhe për të zhvilluar sportin e fizkulturën.

Kjo letër të punohet jo vetëm me arsimtarët, në qendrat e punës etj., por të nxirren pjesë nga ajo në formë citatesh dhe të vendosen nëpër korniza në mure, që njerëzit t'i lexojnë çdo mëngjes. Këto citate të nxi-



rren sipas karakterit të punës së kolektivit, në mënyrë që të jenë si bazë e programit që duhet të bëhet atje për kulturën fizike dhe sportet.

Disa rekomandime, lidhur me forcimin e bazës materiale për zhvillimin e kulturës fizike e të sporteve në shkolla, t'i bëhen edhe Këshillit të Ministrave. Këtë problem ta shikojmë të gjithë më seriozisht lidhur edhe me investimet që bëjmë. Këto investime t'i bëjmë të menduara mirë. Ne ndërtojmë në qytete parqe, për të cilat qytetet kanë nevojë, sepse zbukurohen, shtohet sipërfaqja e gjelbëruar dhe rregullohet urbanistika e qytetit. Po mua më duket se po të marrim nga parku një terren të vogël afër stadiumit për lodra sportive, nuk i prishim ndonjë punë urbanistikës, sepse parkun ne mund ta zgjerojmë më tej dhe afër qytetit ndërtojmë një terren sportiv. Mendoj se edhe urbanistika nuk e shikon drejt këtë çështje. Ndërtimi i lulishteve në qytet është një gjë shumë e mirë, po atje ulen vetëm disa të rinj ose pensionistë, kurse po të kishte një terren sportiv e lodrash mund të përfitonin me dhjetëra e dhjetëra grupe fëmijësh. Prandaj, sipas rastit, këto vende duhet të shfrytëzohen në mënyrë më racionale, sepse fëmijët nuk kanë ku të luajnë. Kjo çështje duhet të bisedohet më seriozisht me shokët e urbanistikës. Rrugëve të Tiranës ka disa rripa të vegjël gjelbërimesh, por në ta asnjëri nuk qëndron, kurse po të ndërtoheshin terrene për lodra, fare lehtë atje mund të grumbulloheshin fëmijët e lagjeve e të luanin.

Po kështu, kudo ku ka mundësi, si në Durrës, në Vlorë, në Sarandë etj., fëmijët në vend që të bredhin rrugëve, të organizohet puna me ta që, në një orë të

caktuar, të zhvillohet noti. Nuk është mirë që në këto qytete plazhet të mos shfrytëzohen, veçanërisht nga rinia.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## MENDJEMADHËSIA SHFAQET NË FORMA TË NDRYSHME .

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

31 mars 1962:

Mendoj se kritikak që bënë të gjithë shokët e Byrosë Politike janë një e tërë me shumë rëndësi. Çdo diskutim që u zhvillua këtu plotëson tjetrin dhe të gjitha kanë qëllime të mira për të ndrequr në radhë të parë punën e Partisë në rrethin e Korçës, pastaj për të të ndrequr edhe ty, Ramadan [Xhangolli], që je sekretar i parë i Komitetit të Partisë në atë rreth. Mua më duket se kritika që po të bëhet është një kompleks i tërë. Natyrisht, ti duhet të reflektosh thellë për këto gjëra, sepse deri tani nuk ke reflektuar fare, prandaj edhe vazhdon të mos i kuptosh gabimet.

Në rrugën që ke ecur për kryerjen e detyrave të ngarkuara nga Partia, është e vështirë që ti të kuptosh.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi disa probleme të punës së Partisë në rrethin e Korçës.

menjëherë gabimet dhe nuk përjashtohet që përsëri edhe kritikant e sotme t'i kuptosh përciptazi.

Në radhë të parë ti duhet të kuptosh mirë një gjë, që puna jote në Korçë ka qenë shumë e dobët. Kjo duhet të të fiksohet mirë në kokë. Është fakt që ti në Korçë nuk ke punuar mirë, prandaj edhe rezultatet e punës tënde kanë qenë të dobëta. Këtë duhet ta fillosh gjykimin e kësaj çështjeje që të kuptosh se te ti ka mendjemadhësi, pastaj të reflektosh edhe të kuptosh përse ka ecur dobët puna në atë rreth. Në qoftë se ti del jashtë këtyre konsideratave dhe kritikave të drejta që të bënë shokët e Byrosë Politike, nuk ke për të gjetur dot shkaqet e dobësive të tua në punë.

Këtë çështje ti duhet ta analizosh në frymë partie, pa kërkuar të shfajësohesh për asnjë nga gabimet e tua. Mendimi im është se asnjë nga kritikant që të bënë këtu shokët, nuk ka qenë e ekzagjeruar, lëre pastaj të mendohet se ato nuk janë bërë në frymë partie, përkundrazi ato kanë qenë kritika të shëndosha. Prandaj po u përpoqe të gjesh disa «arsye» dhe të justifikosh dobësitë, do të dëmtohesh, nuk do të shërohesh, kurse kritika që të bëri me të drejtë Byroja Politike ka të vetmin qëllim: të të sjellë në rrugë të drejtë, pse je një shok i vjetër, por që gjatë jetës tënde, e veçanërisht tani që problemi bëhet konkret, nuk ke treguar zotësi drejtimi, nuk ke përparuar.

Partia edhe autoritetin tënd e ka pasur parasysh dhe jo vetëm që të ka ndihmuar në punë, po të ka vënë sekretar të parë në një nga rrethet më të rëndësishme të Shqipërisë. Mirëpo ti nuk e ke justifikuar besimin që të ka dhënë Byroja Politike. Puna jote jo vetëm

nuk ka shkëlqyer, po i ka sjellë edhe dëme Partisë. Nga të metat e tua të rëndësishme organizatës së Partisë të rrethit të Korçës i janë shkaktuar vështirësi ekonomike dhe disa vështirësi politike. Ti nuk ke bërë ndonjë faj politik, por një njeri që ka të meta serioze në punën e tij, që nuk shkundet prej tyre dhe nuk përparon, ai krijon edhe pa dashje disa situata të vështira, nga të cilat përfitojnë njerëzit e lëkundshëm ose armiqtë e Partisë. Në këtë mënyrë ti ke dëmtuar punën. Prandaj mos u përpiq të lehtësosh veten nga gabimet që ke bërë.

Meqenëse ti qëndron shumë në çështjen e mendjemadhësisë, duke mos pranuar se je i tillë, unë them se te ti ka mendjemadhësi. Mendjemadhësia shfaqet në forma të ndryshme. Ka njerëz që këtë e tregojnë me paraqitjen e tyre të jashtme. Këta, po t'i shikosh kur ecin rrugës, duken sikur mbajnë globin mbi supet e tyre, kurse brenda mund të jenë bosh. Ka edhe njerëz që në pamjen e jashtme të lënë përshtypjen se janë mendjemëdhenj, arrogantë, këta, kur ecin rrugës, duken sikur e vrasin lart, por në të vërtetë s'janë të tillë, për ta nuk ankohet njeri, sepse në punë e në marrëdhënie me të tjerë janë modestë, janë korrektë.

Ka pastaj njerëz të tjerë që janë fodullë, po janë edhe të zotë në punë. Këta mburren në mënyrë të sëmurë, dhe për këtë duhen kritikuar, sepse thjeshtësia është kurdoherë e mirë. Duke kritikuar te njerëz të tillë mendjemadhësinë, ne nuk hedhim poshtë zotësinë dhe energjinë e tyre në punë, por këta ndihmohen që të luftojnë te vetja fodullëkun dhe të ecin përpara.

Ka edhe njerëz si ti, Ramadan, që nga pamja

e jashtme dhe nga jeta duken të thjeshtë, por në realitet janë mendjemëdhenj. Ndonjëri mund të mendojë se si mund t'i vësh Xhakos epitetin e njeriut mendjemadh, shikojeni si është: i thjeshtë, i parruar, kur ecën shkon kurdoherë qosheve, këpucët herë i ka me lidhësa e herë pa lidhësa etj.! Po nuk duhet harruar se edhe në njerëz të tillë ka fodullëk. Ajo që është e rrezikshme te fodullët e këtij tipi është se, kur nuk kanë rezultate në punë, përpiqen të fshehin dobësitë me anën e autoritetit dhe me të kaluarën e tyre.

Ti, shoku Ramadan, nuk je nga ata fodullë që kërkojnë të kenë një shtëpi të mirë ose një automobil luksoz, por ti je një fodull në pikëpamjet e tua jo të shëndosha, në metodën e punës tënde që lë shumë për të dëshiruar, në trajtimin që i bën kuadrit jo sipas mësimëve të Partisë. Ti ke disa pikëpamje që tregojnë se je fodull dhe një fodullëk i tillë është jashtëzakonisht i rrezikshëm, shumë më i rrezikshëm nga ai fodull që, megjithëse hundën e mban lart, punën e bën mirë. Ky fodull çan malet, por nga rezultatet e mira të punës së tij dehet, mburret, i rritet mendja, natyrisht kjo nuk është e mirë dhe njerëz të tillë duhen kritikuar, po të paktën këta fodullë punojnë, japin, kurse ti, Ramadan, nuk ke dhënë, përkundrazi me drejtimin e dobët dhe me disa nga këto pikëpamje të sëmura, ti ke dëmtuar punën e Partisë, armiku ka përfituar nga kjo situatë, e cila, po të lihej kështu, mund të bëhej e rrezikshme. Në këtë mënyrë duhet ta analizosh ti të gjithë punën tënde. Kritikat që të janë bërë, janë konkrete dhe kanë lidhje me punën tënde në shumë sektorë e drejtime.

Por gabimet e tua që u bënë objekt i kritikës kanë një burim: ti ke mbetur në vend, nuk lidhe mirë me jetën dhe me vështirësitë, ke disa koncepte krejtësisht të gabuara, të cilat, duke i mbajtur në kokë, mund të bëhen të rrezikshme.

Si të mos e kuptosh mendjemadhësinë tënde kur orientimet që dëgjove në Byronë Politike të Komitetit Qendror, ti nuk ia shtrove byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit. Ato që t'u thanë në Byronë Politike, para së gjithash, ishin direktiva të udhëheqjes së Partisë, prandaj medoemos duheshin çuar menjëherë në rreth. Kjo ka rëndësi parimore për mbarëvajtjen e punës së Partisë. Të gjithë shokët i zbatuan orientimet, kurse Korça, ku drejton ti, nuk i ka zbatuar dhe shkaktar për këtë je vetë ti, Ramadan Xhangolli. Përse nuk i zbatove këto orientime të Komitetit Qendror? Këtë nuk e bërë se, duke gjykuar me mendjen tënde, e gjeje më të përshtatshme atë metodë të mëparshme, me të meta e dobësi serioze në punën drejtuese të komitetit të Partisë, duke filluar që nga ti, si sekretar i parë. Kjo tregon qartë se te ti ka mendjemadhësi dhe në qoftë se nuk e kupton këtë, atëherë ku po shkon?

Ç'të keqe ka që në një mbledhje të Byrosë Politike, ku analizuam një problem, të ftuam midis shokëve të tjerë edhe ty? Çfarë do të mendojnë shokët e byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës, kur ata e dinë se ti u ftove për të marrë pjesë në mbledhjen e Byrosë Politike, po kur u ktheve nuk u the asgjë? Natyrisht ata do të mendojnë se Ramadani është një hiçgjë, sepse shkoj dhe nuk na pruri asnjë këshillë e porosi. Këto që bën ti, nuk janë aspak të mira as për

Partinë, as për sekretarët e komitetit të Partisë, as për udhëheqjen. Kur një shok vjen nga rrethi në Komitetin Qendror, ai diçka do të marrë, sikur edhe një përsëritje e çështjeve të bëhet në Komitetin Qendror prapë ajo e ka një qëllim.

Ti, Ramadan, nuk lufton të zbatohen drejt edhe vendimet e Komitetit Qendror mbi bujqësinë. Kjo është shumë serioze. Ti jo vetëm nuk lufton që shokët të mobilizohen plotësisht për zbatimin deri në fund të vendimeve të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror, por nga lëshimet ose pikëpamjet e tua që të pëlqejnë ose ngaqë nuk mendohe thellë, në kooperativat bujqësore të rrethit të Korçës janë krijuar disa situata të vështira, nga të cilat mund të dalin hyçkëla të mëdha.

Në qoftë se vija e Partisë nuk zbatohet drejt e me kujdes edhe në Korçë, ku kolektivizimi është bërë më shpejt dhe në fshat ka një nivel kulturor e agroteknik më të lartë e kuadro më të shumtë etj., atëherë krijohen situata të vështira. Edhe ti që je sekretar i parë, nuk të vjen mirë po të të bëhen padrejtësi dhe, në këto raste, nuk lejon të të merren nëpër këmbë arbitrarisht të drejtat e tua. Por këto të drejta duhen respektuar edhe te të tjerët. Mirëpo ti i zhvillon direktivat e Partisë sipas pikëpamjeve të tua. Ç'e pengonte Byronë Politike të thoshte që pensionet në kooperativat bujqësore të vendosen në të gjithë rrethin e Korçës? Po në këtë çështje duhet ecur me kujdes, me hapa të matura.

Në çështjen e pensioneve për kooperativistët duhej vepruar në bazë të udhëzimeve e të kriterëve që janë dhënë se kujt do t'i jepen dhe sa do t'i jepen dhe jo njërit 1 për qind e tjetrit 4 për qind. Në qytete ka



pensionistë që marrin pension të pjesshëm që arrin masën 1 200 lekë në muaj. Me këto ata paguajnë qiranë, ujin, dritën, drutë etj., kurse fshatari këto i ka pothuajse pa para, pastaj ai ka kopshtin, nga i cili siguron ca të ardhura, e me gjithë këto ti i jep atij 2 000 lekë pension! Pastaj, kur e shihni se e keni gabim, mund të thoni të tërhiqemi. Mirëpo tërheqja në raste të tilla është shumë e rrezikshme. Prandaj duhet të ecim me shumë kujdes dhe gradualisht edhe në dhënien e pensioneve. Edhe çështja e furrave ka qenë objekt i disa studimeve në Byronë Politike, dhe më parë në Kryesinë e Këshillit të Ministrave, ku është diskutuar gjatë si duhej vepruar. Kurse ti, Ramadan, na del me pikëpamje të tjera dhe pastaj të ndodhin situata të vështira, si ato që vërtetohen tani në disa kooperativa. Kjo vjen se ti nuk je i rreptë në zbatimin e vendimeve dhe të udhëzimeve të Komitetit Qendror, të cilat nuk janë marrë në erë, po në bazë të eksperiencës së Partisë, prandaj edhe duheshin zbatuar në jetë me kujdes.

Përse je kaq i shturur në këto çështje ti, shoku Ramadan? Je i shturur sepse nuk e ke në dorë situatën, nuk je organizator i zoti, se të pëlqejnë disa pikëpamje të tua që nuk përputhen aspak me orientimin e përgjithshëm të Partisë, me direktivat e saj.

Iniciativë shokët duhet të kenë, po kurdoherë brenda normave. Në qoftë se ti ke një pikëpamje për një çështje, të vish ta diskutojmë, dhe jo ta zbatosh pa vënë në dijeni Partinë, të vish ta shtrosh në Byronë Politike ose në Sekretariat dhe jo të shkelësh normat dhe direktivat. Kur fillon ta vësh në zbatim diçka që mendon, në fillim të duket e lehtë, sepse situata në disa koope-

rativa bujqësore paraqitet e mirë. Mirëpo tani përse kërkon fonde ose një sasi bereqeti? Përse nuk i realizuat planet, ose përse nuk mobilizuat fshatarët të mbli-dhnin më shumë bimë industriale dhe tani të kishin para në xhep për të blerë bukë, po i kërkonit shtetit? Sigurisht, në këtë gjendje të krijuar, shteti nuk do t'i lërë të vuajnë fshatarët, po të na kërkojnë bukë dhe të holla kooperativistët e fushës së Korçës, kjo duhet të të bëjë të skuqesh, këto që ke bërë ti, nuk janë as-pak veprime të drejta.

Partisë i vjen keq që Korça ka rënë në fund të klasifikimit. Sidomos vitet e fundit ti nuk ke menduar jo vetëm për të ecur përpara, që rrethi i Korçës të pak-tën të ishte në një nivel të qëndrueshëm, përkundrazi je shkaktar që ky rreth po shkon në fund. Kjo duhet të të shqetësonte shumë edhe kur u bënë analizat, edhe tani para se të vije në Byronë Politike.

Çështjet ekonomike kanë rëndësi të madhe për or-ganizatën e Partisë të një rrethi. Por në këtë drejtim ti nuk ke pasur rezultate. Edhe çështjet organizative të Partisë janë me shumë rëndësi. Por drejtimi i organi-zatës së Partisë të rrethit të Korçës nga ana jote ka qenë shumë i dobët. Nuk mund të pranohen arsyetimet që jep ti. Ai që bën një gabim ose faj, duhet të ta dijë për të mirë në qoftë se e kritikon dhe të reflektojë e të korrigjohet. Kush gabon ose bën faje, duhet ndih-muar duke e kritikuar dhe jo t'i fërkohen krahët.

Ti je mjaft liberal, nuk i kritikon të tjerët, sepse, po ta bëje këtë, të tjerët do të t'i nxirrnin lakrat në shesh. Po mos harro se kështu do të të kishin ndih-muar. Po të kritikohen shokët nga ti, do të të kritikojnë

edhe ata, pra ndihma do të jetë reciproke. Mirëpo, ti, me drejtimin tënd të dobët, ke krijuar një gjendje plog-shtie në organizatën e Partisë të Korçës.

Mos kujto se punën në një rreth e bën vetëm sekretari i parë i komitetit të Partisë ose kryetari i komitetit ekzekutiv. Jo, punën e Partisë e bëjnë të gjithë komunistët. Edhe në Korçë vepron organizata e Partisë, e cila është e shëndoshë, është një organizatë me tradita patriotike dhe besnike e Partisë. Por lëshimet që janë lejuar në radhë të parë nga ti, mungesat tuaja të drejtimit janë reflektuar edhe në disa sektorë, ku puna e Partisë ka rënë shumë. Megjithatë në organizatën e Partisë të Korçës komunistët kanë një vullnet të madh dhe jam i sigurt se, kur atje të analizohen këto dobësi, ajo menjëherë do të gjallërohet dhe puna e Partisë do të forcohet më tepër, sepse komunistët dhe populli i këtij rrethi kanë qenë kurdoherë në ballë të emulacionit.

Faji kryesor për dëmet e punës në rrethin e Korçës qëndron në radhë të parë te ti, se po të ishte ti në krye të detyrës, po të kuptoje mirë këto çështje pas gjithë ndihmave që të janë dhënë, gjendja në organizatën e këtij rrethi nuk do të ishte kështu, siç paraqitet sot. Ndhimja ty nuk të ka munguar, shokët nga qendra të kanë ndihmuar edhe ty personalisht nëpërmjet ekipeve dhe me të gjitha format e tjera. Këtë ta kesh të qartë. Masa që po marrim për të të larguar nga Korça është e drejtë. Në qoftë se ne do të të lëmë përsëri në Korçë, as gjendja e organizatës së Partisë nuk do të ndreqet, as ti nuk do të ndreqesh.

Ti duhet ta kuptosh drejt se atje ku do të të dër-

gojë Byroja Politike, me gjithë të metat e dobësitë që janë vënë re në punën tënde, prapë Byroja Politike ka shpresë se do të ndreqesh dhe për këtë ndihma nuk do të mungojë. Por këto gjëra duhet t'i realizosh mirë, se nuk janë të thjeshta, të mos lëkundesh, ndryshe detyrat nuk ke për t'i kryer si duhet. Natyrisht, po të mos e kryesh edhe detyrën që të caktohet tani, Partia do të të vërë në një vend tjetër, po kjo do ta dëmtonte punën e saj.

Partia na shikon edhe të mirat, edhe të metat. Tani ne kemi nga 21 vjet në Parti. Ti punën nuk e kryen mirë dhe kështu e dëmton Partinë. Këtë gjë duhet ta kuptosh mirë. Për ato që nuk kupton, kërko ndihmë. Mos kujto se di gjithçka.

Siç u tha, ti, Ramadan, je përgjegjës kryesor për dobësitë që vërtetohen në Korçë, po përgjegjësi kanë gjithashtu edhe shokët e tjerë të byrosë, të cilët ne i kritikojmë që të ndreqen. Është e domosdoshme që vetë shokët e udhëheqjes së Partisë të këtij rrethi të reflektojnë në shkaqet e dobësive dhe të mobilizohen për forcimin e punës. Ne kemi bindje se ata do ta bëjnë këtë, sepse kjo është në interes të Partisë. Mendoj që edhe aparati i Komitetit Qendror, sidomos Drejtoria e Bujqësisë, të ndihmojë më mirë për zhdukjen e gabimeve që janë vërtetuar në sektorin e bujqësisë në rrethin e Korçës.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## KUNDËR FESË DHE ZAKONEVE PRAPANIKE KËRKOHEM NJË PUNË MË E ORGANIZUAR

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

3 prill 1962

Ne duhet të vazhdojmë luftën kundër fesë dhe zakoneve prapanike. Përshtypja ime është se në këtë drejtim Shkodra bën një punë të organizuar dhe ka një eksperiencë të mirë. Nuk është fjala se rrethet e tjera nuk luftojnë kundër fesë dhe zakoneve prapanike, po çështja është se kërkohet një punë më e organizuar.

Është e drejtë që lufta kundër zakoneve prapanike e paragjytimeve fetare të bëhet e organizuar me rininë, sidomos në shkollë, por kjo duhet bërë edhe me gratë, që t'i bindim ato për kotësinë e fesë dhe të zakoneve prapanike. Natyrisht, në këtë fushë ka shumë përparime, janë arritur mjaft rezultate, po feja dhe

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi luftën kundër zakoneve prapanike e paragjytimeve fetare, mbi përhapjen e njohurive ateiste-shkencore me masat.

zakonet e këqija kanë rrënjë më të thella sidomos te gratë. Megjithatë tani në shumicën dërrmuese gratë punojnë, pra nuk qëndrojnë mbyllur në shtëpi dhe të kultivojnë besimet e kota ose të qëndrojnë nën skllavërinë e burrit. Por, duke marrë parasysh prapambetjen e gruas, duhet që me masat e grave, si dhe të rinisë në radhë të parë, të bëhet një punë e organizuar mirë në luftë kundër fesë dhe zakoneve prapanike. Këtë punë duhet ta bëjnë në radhë të parë komunistët dhe elementët përparimtarë, por kurdoherë në mënyrë të organizuar.

Për këtë qëllim Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe Drejtoria e Arsimit dhe e Kulturës pranë aparatit të Komitetit Qendror të studjojnë çështjen që në shkolla jo vetëm të bëhet një punë e mirë për të zhveshur nxënësit nga këto mbeturina, por këta të punojnë e të veprojnë sidomos në familjet e tyre kundër besimeve fetare dhe zakoneve të këqija. Të gjenden gjithashtu edhe forma e metoda të tjera pune për edukimin ateist, sidomos në fshat. Këtu është pak të mjaftohesh me një konferencë kundër fesë ose zakoneve të këqija, prandaj duhet të përdoren më shumë forma të propagandës së Partisë, për shembull, botime të thjeshta e të kuptueshme, me qëllim që fshatarët t'i lexojnë vetë, pa pritur të bëhet ndonjë konferencë. Megjithatë edhe konferencat të mos lihen pas dore, po bashkë me to të përdoren edhe forma të tjera.

Në luftë kundër zakoneve prapanike ne kemi zbatuar disa forma pune, duke i lidhur ato me patriotizmin dhe me probleme ekonomike. Por me kaq nuk mjafton. Çështjen duhet ta shohim të lidhur ngushtë edhe me

ligjet e shtetit, me dispozitat përkatëse, që ndalojnë disa praktika të dëmshme, të cilat janë refleksi i zakonave prapanike. Ka ndonjë komunist që i lejon vetes t'i bëhet synet djali dhe, kur i kërkohet llogari, këtë faj ai ia hedh gruas. Por logjika ta do që edhe sikur të veprojë ndonjë grua, ajo nuk e bën këtë pa dijeninë e të shoqit. Ka burra që janë liberalë, por ndaj grave sillen si tiranë. Në këtë rast jo vetëm të punohet në rrugën e Partisë, me anën e bindjes dhe të edukimit, por kur kjo punë nuk bën efektin e duhur, atëherë duhet të veprohet edhe në bazë të ligjit.

Edhe kur ka raste që fejohet një vajzë e vogël, menjëherë të thërriten babai i saj dhe babai i djalit, të cilëve t'u flitet për këtë akt dhe, po të jetë nevoja, të shtrohet në mbledhje të popullit të fshatit, ku të diskutohet, të nxirren mësimë në bazë të moralit tonë socialist, dhe të veprohet sipas ligjeve në fuqi. Nuk duhet dhe nuk lejohet të bëhen fejesa në djep ose nën moshën ligjore, dhe asnjëherë pa pyetur djalin dhe vajzën që do të fejohen, pa pëlqimin e njëri-tjetrit. Po nuk u përdor bashkë me punën sqaruese edhe forca e ligjit, nuk luftohen si duhet zakonet prapanike, në mënyrë që shkelësve të ligjit t'u skuqet faqja dhe të tjerët të nxjerrin mësimin se «nuk duhet të shkelim ligjin, se nesër e pësojmë edhe ne». Tani edhe shumica e popullit ka arritur në një nivel të tillë që përkrah qëndrimin revolucionar dhe dënon fajtorët, ata që shkelin ligjet.

Thuajse të gjitha zakonet prapanike e kanë buri-min te feja, por gjatë shekujve ato janë përpunuar në një mënyrë të tillë saqë shumë prej tyre duken sikur

nuk kanë të bëjnë fare me fenë, për shembull, çitjanet e grave ose rrobat e zeza duken sikur nuk kanë të bëjnë as me fenë, as me turqit, prandaj shumë plaka qëndrojnë veshur gjithnjë me të zeza, kjo u është bërë zakon, ose gruas kurveleshase çitjanet i duken se e mbajnë më ngrohtë. Shumë gra edhe i kanë hequr ato dhe në vend të tyre kanë veshur fustanin, po ka akoma që mbajnë çitjane. Pra shumë gjëra të këqija e kanë burimin te feja dhe me kohë janë kthyer në zakone. Por ka çështje të tjera, si besimi te zoti, kishat e xhamitë, faljet, tyrbet, shenjtorët, ramazani ose kreshmët, kurbanet, pagëzimet etj., që janë të lidhura konkretisht me doktrinat fetare.

Megjithëse çështja e fesë te ne nuk është ndonjë problem aq i madh e akut, si në shumë vende të tjera, ne duhet të luftojmë sistematikisht kundër shfaqjeve të saj kudo që manifestohen, duke përdorur kundër tyre edhe disa masa të arsyeshme për edukimin ateist të punonjësve, dhe të përdoren mënyra të ndryshme, për të penguar aktivitetin e komuniteteve fetare, por pa i ofenduar besimtarët.

Veç këtyre, mund të flitet në mënyrë të veçuar dhe të organizuar me hoxhallarët dhe me priftërinjtë. Ndonjë hoxhe ose prifti që është i mirë, t'i flitet haptazi që të mos tregohet i zellshëm në punën e tij. Me të gjithë po bëhen mbledhje, vetëm me hoxhallarët e priftërinjtë nuk po bëhet ndonjë punë. Edhe këta duhen mbledhur, sepse disa prej tyre janë patriotë, shumë të tjerë nuk e kuptojnë fenë. Fëmijët e tyre janë të lidhur me kooperativën bujqësore, nga e cila sigurojnë të ardhura. Mund të bisedohet me këta njerëz, t'u bë-



het edhe atyre propagandë antifetare, të sqarohen në mënyrë shoqërore, patriotike. Prandaj të mblidhen ose bashkërisht, ose në grupe, ose veç e veç, e të punohet me ta. Çështja është që të neutralizohet sa më shumë puna e tyre.

Leksione do të dërgohen edhe nga lart, po të tilla duhet të përgatitin edhe vetë rrethet, veçse jo me stërhollime, se materiale të tilla fshatarëve nga një vesh u hyjnë dhe nga tjetri u dalin. Çështjen e ramazanit nuk është e domosdoshme t'ia shpjegosh fshatarit në mënyrë filozofike dhe kronologjike se si ka vepruar Muhameti, po mund t'ia shpjegosh nga ana ekonomike e shkencore. Të shpjegohet thjesht se, duke mbajtur ramazan, nuk do të kesh fuqi të punosh tokën dhe kjo do të të lërë pa bukë, do të sëmuresh, do të dobësohesh etj. Me këtë shpjegim në qoftë se nuk arrin të bindet sot, do të bindet nesër. Në qoftë se në një fshat mbajnë ramazan shumë, pak ose hiç fare, kjo varet nga propaganda e Partisë. Atje ku mbahet ramazan, do të thotë se puna e organizatës-bazë të Partisë është e dobët.

Komitetet e Partisë duhet t'i marrin herë pas here në shqyrtim këto çështje dhe të veprojnë me masa konkrete kundër fesë dhe zakoneve të këqija. Masat të mos jenë të njëjlojta kudo, por të diferencuara. Në fshatra ose në kolektive puna e Partisë të ndërtohet për ato probleme që preokupojnë organizatën-bazë të Partisë. Po të ndodhë një krim, për të mund të hartohet e të zhvillohet leksioni përkatës, pra të rrahë çekani në vendin e ngjarjes. Kur sheh, për shembull, se në një fshat është shitur një grua ose një vajzë, pse ta bësh

problem në të gjithë rrethin? Kjo çështje të bëhet problem atje ku ka ndodhur, pa qenë nevoja të bëhet fushatë në të katër anët e rrethit. Një çështje nuk duhet bërë problem atje ku nuk ekziston.

E përsëris edhe një herë, kundër fesë dhe zakoneve prapanike duhet luftuar në mënyrë të organizuar, duke punuar në radhë të parë me rininë dhe gratë. Mund të punohet edhe me pleqtë, po hallin e kemi më shumë te rinia, sidomos te ajo e shkollës. Ne duhet të bëjmë që nxënësit, kur mbarojnë shkollat 8-vjeçare e të mesme, të jenë të pjekur, të kenë një botëkuptim të qartë materialist mbi botën, mbi fenomenet e natyrës dhe ato shoqërore. Kjo nuk është një punë e lehtë.

Populli ynë ka një të kaluar të lavdishme, me zakone të përparuara, me virtyte të larta. Por ne jemi realistë, shohim edhe zakonet prapanike e besimet fetare, të cilat me luftën e Partisë po zhduken gradualisht. Shfaqjet që vihen re akoma në ndërgjegjen e njerëzve nuk duhet të na bëjnë pesimistë. Sigurisht, në radhët e popullit ka edhe njerëz të tillë që bëhen kriminelë, kundër të cilëve ne duhet të marrim masa të rrepta. Na ka ngjarë edhe tani ndonjë vrasje e shëmtuar, por sot jemi shumë larg nga zakoni i keq i hakmarrjes, me të cilin në disa krahina ushqeheshin fëmijët qysh në djep, që, kur të rriteshin, të zhduknin vrasësin e babait. Por zhvillimi i jetës socialiste te ne po i likuidon këto zakone të dëmshme. Sidoqoftë, mbeturinat mikroborgjeze ruhen akoma te njerëzit, ato shumë herë i pengojnë këta në punë dhe i shtyjnë të kryejnë veprime të dënueshme nga ligji e të papranueshme nga shoqëria. Ky është një problem i rëndësi-

shëm që duhet ta kemi vazhdimisht parasysh, prandaj ta organizojmë punën më mirë dhe kështu sukseset tona do të jenë akoma më të mëdha.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## MONUMENTET E KULTURËS — THESAR I MADH I POPULLIT TONË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

3 prill 1962

Çështja e traditave të popullit tonë ka një rëndësi shumë të madhe. Ne kemi marrë vendim për këtë problem dhe është punuar për zbatimin e tij, sidomos në lidhje me traditat historike të popullit. Ndërsa për monumentet e kulturës, megjithëse është bërë më shumë në krahasim me të kaluarën, jemi akoma prapa me përpunimin e sistemimin e tyre. Është punuar veçanërisht në drejtim të monumenteve të kohës sonë, por përse u përket traditave të lashta të popullit shqiptar dhe monumenteve të kulturës së lashtë, qoftë në drejtim të atyre që janë zbuluar, dhe që janë të pakta, dhe sidomos në drejtim të monumenteve akoma të pazbu-

---

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua zbatimi i vendimit të Byrosë Politike «Mbi traditat patriotike revolucionare të popullit tonë».

luara, është bërë akoma pak. Arsyet për këtë, i dimë të gjithë, kanë qenë vështirësitë ekonomike, pra mungesa e fondeve të mjaftueshme, por sidomos mungesa e kuadrut të specializuar për këtë sektor. Natyrisht, në momentet aktuale duhet të tregohet kujdes shumë i madh për të ruajtur e për të konservuar monumentet e kulturës, për t'u bërë atyre «biografite», për të shkruar për to dhe për t'i fotografuar. Kjo është një shkencë e tërë.

Rëndësinë e madhe të këtij problemi duhet ta kuptojmë mirë, në radhë të parë ne dhe Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, e cila ka detyra jashtëzakonisht të mëdha, që nuk i ka kryer si duhet. Tani ministria dhe të gjithë kuadrot e saj duhet të mendojnë thellë për këto probleme të rëndësishme që dalin në fushën e kulturës.

Studimi i traditave historike, gjuhësore, arkeologjike etj. të popullit tonë nuk sjell ndonjë të ardhur në të holla, por përfitim të madh nga ana historike. Tani ne nuk dimë shumë sa kanë qenë të zhvilluara në Shqipëri kultura ilire ose ajo më e hershmja, pellazgjike, kultura romake apo bizantine. Nuk dimë shumë gjithashtu sa gjurmë kanë lënë te ne këto kultura, vlerat e tyre të mëdha historike që fshihen në vendin tonë të vogël. Studimi i këtyre çështjeve nuk është një punë e vogël. Edhe për të tjerët që kanë qenë më të mëdhenj e më të pasur se populli ynë, kjo nuk ka qenë një punë e lehtë, po ka kërkuar një veprimtari shekullore nga ana e tyre. Kultura në vendet e tyre ka pasë qenë zhvilluar prej shekujsh dhe tani na duket si çudi që ka libra të tërë ku përshkruhen hollësisht historike.

Kurse ne, jo që nuk dimë hollësisht, por dimë pak për kulturën tonë të shekujve 15-të, 16-të, 17-të. Kjo ka shkaqet e veta, të cilat janë të qarta.

Ne duhet të nisemi nga parimi se në fushën e monumenteve të kulturës gjer tani kemi bërë pak. Shokët që punojnë në këta sektorë, sa kanë mundur, janë përpjekur dhe kanë zhvilluar një punë të madhe, por kjo nuk ka qenë e lehtë. Ata nuk kanë qenë të pregatitur për këto profile. Të marrim, për shembull, shokun Gani Strazimiri, ai është pregatitur për inxhinier, po tani është pasionuar shumë pas monumenteve të vjetra të kulturës. Mirëpo këtu kemi të bëjmë me sektorë që janë shkenca më vete, prandaj edhe Ganiu nuk mund ta kryejë si duhet detyrën për restaurimin e monumenteve që janë zbuluar, pa ditur ose pa pasur përkrah tij shokë të tjerë specialistë, që të punojnë së bashku me të dhe të kenë mësuar e të jenë specializuar për këto shkenca të veçanta. Po t'i kishim më përpara këto mundësi, atëherë mund të ishte bërë një punë sistematike për zbulimin e traditave të kulturës së vendit tonë. Kështu, një monument që ndoshta është restauruar gjer tani tri herë, specialistë të pregatitur do të arrinin të bënë më mirë dhe më shpejt zbulimin dhe restaurimin e tij, jo vetëm për shekullin e 19-të, po edhe për shekujt 17-të e 18-të, do të bënë dhe argumentimin e tyre jo vetëm për monumentet e kulturës së lashtë të vendit tonë, por edhe të popujve të tjerë rreth e rrotull Shqipërisë. Specialistë të tillë, pra, do të ndihmonin shumë për restaurimin dhe për ruajtjen e këtyre monumenteve, që janë një thesar i madh për popullin dhe për vendin tonë.

Për këto çështje ne nuk kemi mundur të përgatim kuadro, mirëpo më tej nuk duhet të ecim si gjer tani, vetëm me një plan ekspeditiv, pa një plan të gjerë e perspektiv. Në sektorin e arkeologjisë ne mund të mos kemi aq njerëz sa na duhen që të kenë studjuar për kulturën romake, por në qoftë se do t'i përvishemi punës në këtë sektor për zbulimin në vendin tonë të monumenteve të kulturës përpara 20 shekujsh, domethënë të kohës së okupacionit romak në Shqipëri, atëherë rezultatet do të jenë më të mëdha. Një njeri që nuk është marrë me historinë dhe artin romak, pavarësisht se mund të dijë edhe ca latinisht, nuk mund të japë atë që kërkohet në këtë drejtim.

Vendi ynë është i pasur në fushën e monumenteve të kulturës. Të marrim si shembull vetëm Durrësin, i cili është qytet i vjetër, me tradita. Do të ishte mirë që të ngarkoheshin njerëz për të studjuar historinë e këtij qyteti të lashtë, që lidhet ngushtë me historinë botërore. Nga ky studim mbi Durrësin mund të zbulohet një shtresë monumentesh të lashta, por nën të mund të jenë edhe 3-4 shtresa të tjera. Për çështje të tilla ka ligje edhe norma se deri ku do të zbulojmë dhe deri ku do të shkojmë. Tani, për shembull, ne zhvillimin e Durrësit nuk mund ta ndalojmë. Në Durrës jemi duke ndërtuar dhe do të ndërtojmë, por me ndërtimet që bëjmë nuk mund të ecim në tym, pa ruajtur e pa mirëmbajtur objektet e duhura monumentale.

Ose të marrim Apolloninë. Këtu arkeologët tanë kanë përcaktuar shumë herë konturet e monumenteve, duke u bazuar në shenjat e monumenteve që janë gje-

tur në Nise<sup>1</sup>. Dhe me të vërtetë më pas ka dalë një figurë ose një monument që i përngjet asaj të Nises. Apollonia është një qytet i lashtë i kohës së romakëve me tradita, stil dhe gusto të ndryshme nga ato heleniket. Arti romak ishte më i rëndë nga ai i helenëve. Por vijat e kulturës romake janë gati njëlloj kudo. Njëlloj janë gati edhe dispozitat e pozicionet e tyre. Një njeri që i ka studjuar mirë monumentet romake të zbuluara, do ta organizonte më me lehtësi zbulimin e veprave akoma të pazbuluara në Apolloni.

Në Apolloni ne mund të gjejmë shumë monumente, të cilat figurojnë në listën e monumenteve të Romës, por që kanë humbur. Përse të mos jenë këto monumente në Apolloni, që ka qenë një qendër e madhe kulture, që ka pasur një pozitë të mirë strategjike, e cila është bërë edhe qendër luftimesh e Cezarit, Oktavianit etj.? Kjo ka një rëndësi të madhe edhe nga pikëpamja e kulturës sonë edhe e kulturës së përgjithshme botërore.

Por zbulimet nuk mund të realizohen pa pasur kuadro dhe specialistë të ndryshëm të historisë së lashtë, me të cilët të formohej një bërthamë e shëndoshë. Kështu do të mund të krijoheshin traditat e universitetit tonë për përgatitjen e kuadrove të nevojshëm, të cilët do të merreshin më mirë edhe me monumentet e kulturës. Në vendin tonë ekzistojnë monumente të shumta, që janë të mbuluara, po ka metoda shkencore si bëhet zbulimi i tyre. Kjo punë bëhet me dokumente historike. Për shembull, me anën e helikopterëve sot janë zbuluar

---

1 Nise — qytet antik në Azinë e Vogël



qytete të tëra. Zbulimi i monumenteve të vjetra është një shkencë e tërë, të cilën ka ardhur koha që njerëzit tanë ta zotërojnë. Nuk mund të ecet më qorrazi, duke filluar kërkimet, për shembull, atje ku duket një tumë, një veprim i tillë mund të të çojë në zbulim, po mund edhe të mos të çojë.

Në vende të tjera kanë pasur mundësi më të mëdha që shkencëtarët të veprojnë, ata kanë mbushur muzeumet e botës, si të Stambollit, Parisit, Londrës etj., me monumente antike, siç janë tabelat e shumerëve, që janë libra të shkruar të këtyre popujve para asirianëve, ku shohim që nga mësimi që u jep nxënësve mësuesi e gjer te menyja e gjellëve etj. Ne kemi qenë në kushte të tjera zhvillimi, por tani kemi më shumë mundësi, që edhe ne të kemi specialistë, të cilët të jenë njohës të thellë të historisë dhe të artit romak, sepse në vendin tonë ka monumente të kulturës romake. Ne duhet të kemi gjithashtu njerëz edhe në drejtim të artit bizantin dhe jo vetëm për monumente, po edhe për tabelat, ikonat etj.

Monumentet që kemi duhet t'i klasifikojmë, t'i vlerësojmë dhe t'i riparojmë. Se si do të bëhet kjo punë, duhet menduar gjerë dhe thellë. Për këtë çështje mundet të kemi jo një plan një dhe dyvjeçar, po një plan me periudha të gjata. Në radhë të parë, ne duhet të kemi të qartë rëndësinë e problemit dhe vështirësitë e vënies në dukje të nxjerrjes në sipërfaqe, ruajtjes së monumenteve dhe vënies së tyre në dispozicion të popullit. Kjo nuk është një punë e lehtë.

Restaurimi i një monumenti ka rëndësi të madhe dhe kërkon shumë punë, për kryerjen e së cilës ne du-

het të dërgojmë jashtë shtetit njerëz që të specializohen jo vetëm për të restauruar objekte të kulturës së lashtë, po edhe për t'i kuptuar ato. Këta kuadro t'i dërgojmë për t'u përgatitur në ato vende ku ka shkolla për studime antike greke, romake, bizantine etj. Përveç kësaj, ne duhet të interesohemi për të marrë sa më shumë materiale nga vendet që i kanë ato dhe të reflektojmë mbi to, t'i futemi mirë kësaj pune dhe të krijojmë edhe kuadrot përkatës. Ne nuk e kemi parë kështu problemin, në këtë shkallë, në këtë platformë. Kërkesat që na u bënë nga shokët e këtij sektori, që kemi ftuar në këtë mbledhje, nuk janë pa baza. Ata i dinë këto çështje më mirë se unë, por nuk kanë guximin t'i shtrojnë ashtu siç i mendojnë dhe i ndiejnë si shkencëtarë, kanë druajtje, sepse e dinë që vendi ynë ka shumë nevoja e në shumë drejtime.

Në qoftë se ne do ta kuptojmë dhe duhet ta kuptojmë madhësinë e këtij problemi, interesin e madh për historinë e popullit tonë dhe jo vetëm të popullit tonë, këtë çështje duhet ta studjojmë me seriozitet të madh gjer në marrjen e masave konkrete sipas kushteve tona. Pra Ministria e Arsimit dhe e Kulturës t'i shohë pak më gjerë këto çështje dhe, në qoftë se është ngushtë në drejtim të fondeve, të bëjë kërkesat e duhura, natyrisht të matura. Është e vërtetë që kjo punë materialisht nuk na jep gjë, por moralisht kemi një fitim të madh. Kur ne të ekspozojmë monumente arkeologjike ose të pikturës që kanë një vlerë botërore, sa lart do ta ngrinte kjo në arenën ndërkombëtare emrin e popullit shqiptar! Dhe kur vendit tonë i ngrihet vlera në pikëpamje historike, kulturore, artistike, kjo gjë

ndihmon që të forcohet Republika jonë, shtohen dashamirësit në mbrojtje të atdheut tonë nga rreziqet që mund ta kërcënojnë.

Borgjezia shoviniste e vendeve rreth e rrotull dhe armiqtë imperialistë e kishin lënë Shqipërinë në ditë të hallit; e kanë propaganduar si vend me një popull të egër, barbar, pa kulturë, me zakone të rënda, prandaj kushdo mund të bënte si të donte me këtë vend dhe i prisnin një copë andej dhe një copë këtej. Por Lufta Nacionalçlirimtare bëri që zëri dhe prestigji i Shqipërisë të ngrihen dhe tani, kur të vëmë në dukje edhe traditat e mira dhe historinë e gjatë luftarake të popullit tonë që në kohët e lashta, emri dhe autoriteti i Shqipërisë do të ngrihen akoma më shumë. Çështja, pra, duhet të shihet në kompleks.

Edhe monumentet aktuale kanë një rëndësi shumë të madhe, prandaj duhen ruajtur me kujdes. Të shfrytëzojmë eksperiencën e vendeve të tjera që kanë trashëguar monumente kulturore historike etj. dhe kanë ditur të bëjnë mirë seleksionimin e vlerave të zbuluara. Po të shihej, për shembull, rikonstruksioni i Romës së Cezarit, në fillim ai kishte më shumë monumente, por më vonë janë mbajtur vetëm kryesoret, të tjerat janë fotografuar, ose kanë mbetur vetëm skicat dhe planet e tyre. Kjo është bërë se tani Roma është transformuar dhe janë mbajtur vetëm monumentet me vlerë më të madhe.

Disa nga ju kanë qenë në Romë dhe kanë parë Harkun e Titusit, ose monumente të tjera që gjenden përbri pallateve dhe monumenteve moderne, po sa monumente të tjera më të vogla nuk ekzistojnë atje!

Ne duhet të bëjmë seleksionimin dhe të mos mbajmë, për shembull, ndonjë tyrbe, pa kurrfarë vlere, sepse do të ishte një gjë e ekzagjeruar që një tyrbe e tillë të qëndronte si çiban në një qytet të ri. Po kështu edhe ndonjë urë që nuk ka ndonjë vlerë të madhe. E them këtë, sepse ju, shokë, që merreni me monumentet, nga pasioni që keni për këtë sektor, tregoheni ndonjëherë edhe të ngurtë dhe s'lejoni të cenohet asnjë gjë e vogël. Interesi ynë të përqendrohet në monumente të rëndësishme arkitekturale, artistike dhe historike. Po të jemi në gjendje t'i mbajmë të gjitha, është mirë, po të tëra dhe për gjithë jetën nuk është e mundur të mbahen, prandaj të ruhen ato që janë më karakteristike. Një shtëpi e banuar nuk priset, ajo që nuk banohet priset lehtë. Prandaj ato shtëpi që kanë vlerë historike ose arkitekturale, të restaurohen dhe brenda tyre të futen njerëz për të banuar, ose të përdoren për nevoja të tjera, ndryshe, po të mos përdoren, do të shkatërrohen. Është e pamundur për ne të kemi nga një njeri roje për çdo shtëpi, kjo do të kërkonte shpenzime të mëdha që nuk i përballojmë dot.

Zbulimet e monumenteve që janë bërë në botë, kanë kërkuar miliarda, sepse janë krijuar ekipe me shkencëtarë të mëdhenj e personel të shumtë ndihmës, me mjete e materiale që janë dërguar në vendet e Lindjes dhe në Afrikë, kudo që ka pasur të dhëna për zbulime monumentesh. Ne nuk kemi fonde të mëdha, prandaj «do të shtrijmë këmbët sa kemi jorganin», po edhe për të ardhshmen duhet të mendojmë. Një shok tha këtu se vendi ynë ka nevoja të mëdha për agrono-

më, kjo është e vërtetë, po do të bëjmë edhe me 5 agronomë më pak, çështja është që të krijojmë edhe për monumentet një bërthamë me kuadro që të merren me këtë punë. Pastaj të punohet me shokët e universitetit për ngritjen e katedrës dhe të përgatitim kuadro nga burimet tona.

Monumentet që kemi zbuluar gjer tani, t'i ruajmë, të mos na prishen. Të marrim masa për t'i konservuar ato, gjersa të krijojmë mundësi që me kuadrot tanë t'i restaurojmë. Të japim udhëzime që komunistët dhe populli të dëgjojnë me vëmendje të madhe këshillat dhe udhëzimet e punonjësve të universitetit që merren me zbulimin dhe me ruajtjen e monumenteve historike, të diskutojnë me këta punonjës dhe brenda mundësive të tyre materiale të marrin masa për t'i nxjerrë sa të jetë e mundur të padëmtuara dhe për t'i ruajtur sa më mirë këto vlera.

Të gjitha këto kërkojnë që forcat e pakta që kemi në lëmin e historisë dhe sidomos të arkeologjisë, të mos i shpërndajmë shumë. Me këto forca që disponojmë, të studjohen mirë objektet që do të hapen. Të caktohen për një periudhë jo më shumë se 2-3 objekte, në të cilat të punohet gjer në zbulimin e tyre të plotë. Më duket se kështu është më mirë sesa duke u shpërndarë në shumë anë, pa u përqendruar. Ashtu siç është vepruar gjer tani, është bërë një punë paraprake, por në qoftë se vendet janë të qarta, do të jetë mirë që zbulimi i objekteve të bëhet me radhë, sepse menjëherë dhe të gjitha frontalisht është më vështirë. Vërtet po punohet në Apolloni, por punime po bëhen edhe në disa objekte në Veri, në Plloçë etj. Në këtë

mënyrë forcat nuk na mjaftojnë. Prandaj, theksoj edhe një herë, sikur të përqendroheshin punimet. Kjo nuk përjashton atë që studimet të vazhdojnë edhe në objektet e tjera për të ardhshmen, po jo punimet. Gjatë kësaj kohe të studjohen mirë materialet historike për objektin që do të hapet dhe në këtë drejtim të ecet me plan.

Deri tani janë bërë shumë gjëra, janë vënë në dukje shumë monumente të zbuluara. Kjo është meritë e shokëve që punojnë në këtë sektor, të cilët e kanë me pasion. Një punë e tillë nuk mund të bëhet pa pasion. Kjo na jep një siguri të madhe se, me masat që do të merren paskëtaj dhe me ndihmat që do t'i jepen këtij sektori, do të arrijmë t'i vëmë në dukje thesaret e pazbuluara, të cilat do t'i vëmë në duart e popullit.

Kisha dhe një çështje. Rëndësi të madhe ka për ne sot edhe ngritja e lapidarëve se kështu si punohet te ne për ndërtimin e tyre, ata nuk kanë ndonjë vlerë të madhe artistike. Nuk është çështja të ngrihen lapidarë duke vënë pesë gurë një mbi një. Jo, lapidarët që ngrihen në kujtim të heronjve e të dëshmorëve, që kanë luftuar për çlirimin e Shqipërisë, duhet të mbeten edhe për të ardhshmen monumente që të përfaqësojnë patriotizmin e lartë të njerëzve tanë, po njëkohësisht të jenë edhe monumente kulture. Prandaj interesimi në këtë drejtim nuk duhet të jetë vetëm që të bëhen lapidarë, por këta lapidarë të kenë nivelin e duhur artistik. Natyrisht kjo kërkon orientime të qarta për kërkesat artistike në ngritjen e këtyre monumenteve.

Këto çështje që u ngritën, i shikoni më me hollësi veçanërisht ju, shokët e Ministrisë së Arsimit e të Kulturës dhe të universitetit, dhe, për pengesat që do t'ju dalin, drejtohuni Byrosë Politike të Komitetit Qendror.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## RADIOJA — NJË NGA MJETET MË TË RËNDËSISHME TË PROPAGANDËS SË PARTISE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**3 prill 1962**

Jam dakord me mendimin e shfaqur se në Radio Tirana ka përparime, sidomos që kur ka shkuar atje Thanasi [Nano], i cili është një kuadër i vjetër i Partisë, është shok me eksperiencë në këta sektorë. Në radio duhet të bëhen përpjekje sidomos në drejtimin e ngritjes së nivelit kulturor të kuadrove që punojnë atje. Radioja është një nga mjetet më të rëndësishme të propagandës së Partisë për edukimin e masave të popullit me frymë revolucionare dhe me njohuri të gjera e të shumanshme. Kjo punë do të bëhet kryesisht me kuadrot e radios, po edhe nëpërmjet korrespondentëve të saj. Prandaj duhen bërë përpjekje për të tërhequr në punën e radios edhe kuadro të tjerë, duke i angazhuar ata në mënyrë patriotike, profesionale,

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e Radiodifuzionit.



me qëllim që emisionet e radios të dalin në një nivel të lartë dhe të ndihmojnë konkretisht për edukimin e njerëzve. Kjo do të arrihet në rast se punonjësit e radios do të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për ngritjen e tyre kulturore e jo vetëm profesionale. Duke u përpjekur për ngritjen e nivelit të tyre kulturor, punonjësit e këtij institucioni do të punojnë më mirë, do të kenë horizont pune më të gjerë, do të gjejnë më shumë njerëz për bashkëpunim dhe do të jenë në gjendje të rekomandojnë edhe tema interesante, të panjohura, për të zgjidhur edhe problemin e larmisë së programit, i cili do të jetë tërheqës e me njohuri të shumanshme dhe të ndryshme. Po të bëhet mirë një punë e tillë nga ana juaj dhe e gjithë punonjësve të radios, atëherë do të kemi me siguri emisione shumë interesante.

Çështja e bashkëpunësorëve të zotë që duhet të ketë radioja, siç tha Nexhmija, mund të shihet, sepse kjo ka rëndësi. Një njeri që nuk ka haber nga kjo punë, po të vejë, për shembull, të marrë një intervistë për çështjen e monumenteve arkeologjike, ai nuk do të dijë si të bëjë edhe pyetjet. Një bashkëpunësor, që të pregatitë një intervistë interesante për një çështje si kjo, duhet të jetë i diplomuar për historinë e lashtë dhe të ketë dijeni për arkeologjinë. Një njeri i tillë i pregatitur shkon ballëhapur te ai që do të marrë intervistën dhe ia bën si duhet pyetjet. Njerëzit tanë jashtë radios, nga të cilët dëshironi të merrni një intervistë, kur u drejtohen me kohë disa pyetje për një temë të caktuar që ata janë kompetentë, besoj se nuk do të refuzojnë ta bëjnë këtë punë, sepse kjo shërben

për edukimin e popullit. Prandaj edhe këtë formë ju duhet ta shfrytëzoni për t'i përdorur këta njerëz si bashkëpunëtorë të radios. Ne mund të japim një orientim për t'u thënë të gjithë punonjësve të arsimit, të kulturës, ekonomisë, ndërtimit etj., që t'i vijnë në ndihmë Radio Tiranës; t'u themi atyre se, duke ndihmuar Radio Tiranën, kenë ndihmuar zhvillimin e kulturës popullore, prandaj mos kurseni një ose dy orë për një incizim, ose për të bërë që një pjesë e emisionit të radios të dalë për sektorin tuaj, por çështja është që vetë drejtuesit dhe punonjësit e radios të tërheqin sa më shumë bashkëpunëtorë. Ndihma që i jepet radios është një vepër patriotike e njerëzve tanë.

Të gjitha materialet e radios duhen përpunuar në një nivel të lartë, me një cilësi të mirë. Në qoftë se radioja nuk ka njerëz të zotë, atëherë të aktivizohen sa më shumë bashkëpunëtorë të jashtëm dhe të hidhen sytë në njerëz të përshtatshëm që ju, shokë të radios, mendoni se ju bëjnë. Kuadro në radio mund të kenë, po ndoshta ka prej tyre që s'kanë prirje për atë punë, të tillë mund të dërgohen atje ku mund të japin dhe, në vend të tyre, propozoni të tjerë. Kërkesa për të shtuar kuadro në radio, të shikohet nga Qeveria.

Edhe për emisionet e muzikës duhen marrë disa masa. Jam dakord që të bëhen konkurse brenda vendit në lidhje me muzikën dhe të ketë gjëra të reja, sepse shpeshherë emisionet e muzikës bëhen të mërzitshme për shkak të monotonisë së tyre.

Letrat që i vijnë Radio Tiranës nga masat tona punonjëse dhe nga persona jashtë shtetit të lexohen me vërejtje, të nxirren konkluzione prej tyre dhe në

bazë të kërkesave që bëhen, të hartohen programe për emisione të ndryshme. Po të transmetohen lajme të parëndësishme, siç ka ndodhur në disa raste, atëherë nuk do ta dëgjojë njeri me interesim radion tonë. Prandaj këto lajme duhet të përpunohen mirë si për në radio, ashtu dhe për në shtyp.

Për të huajtë duhen bërë emisione të përgatitura mirë. Në qoftë se ti, për shembull, i bën një përmbledhje të historisë së naftës në Shqipëri, duke u nisur nga ana historike, teknike etj., atëherë të huajit që do ta dëgjojë këtë emision, do t'i mbetet në mendje diçka, kurse asgjë nuk do të mbajë mend, bile as që ka për ta dëgjuar fare, po t'i thuash se nafta te ne u realizua kaq apo aq etj. Prandaj për problemet tona duhet që informacionet të punohen me kujdes. Ka në botë njerëz që interesohen për të tanishmen e popullit tonë, po ka dhe të tjerë që dëshirojnë të mësojnë më shumë për historinë e tij të lashtë. Për të arritur këtë është e domosdoshme që të forcohet emisioni i historisë së popullit tonë, për të njohur të kaluarën e tij të lashtë, historinë e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të ndërtimit të socializmit. Kur ti i thua të huajit se në filan fshat te ne ka 100 radio, natyrisht për ne kjo është një gjë e madhe, po për atë që është i huaj, kjo nuk ngjall asnjë interesim.

Mua më duket se mund të bëjmë një studim kompleks për rindarjen e forcave, ose si të thuash, për koordinimin e ndihmës reciproke midis institucioneve kulturore e propagandistike. Le të marrim çështjen e përkthyesve. Radio Tirana ka nevojë qysh tani për përkthyes që të plotësojë nevojat e saj të përditshme.

Ata që mësojnë tani në shkolla për gjuhë të huaja jo vetëm që janë të paktë, por, pasi të mbarojnë studimet, do t'u duhet disa vjet që të futen në përkthime. Ata që dinë gjuhë të huaja dhe nuk kanë eksperiencë në këtë drejtim, e kanë vështirë të përkthejnë. Prandaj mendoj që të shikohet kjo çështje me kujdes dhe të bëhet një farë rishpërndarjeje më e mirë e tyre.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **TË MIRËBAJMË DHE TË SHFRYTËZOJMË SI DUHET VEPRAT E BONIFIKIMIT**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**3 maj 1962**

Unë nuk jam dhe aq i kënaqur nga ky raport. Mendoj se duhet të flitej pak më qartë për problemin e bonifikimit, për fazën e përparuar që kemi arritur, për përfitimet që kemi pasur, për detyrat që na dalin. Ky raport më duket se nuk pasqyron si duhet këto çështje. Këtu flitet fare në përgjithësi. Mirëpo, të flasësh në përgjithësi, nuk është mirë, sepse mbulohen shumë gjëra.

Çdo gjë që bëhet në vendin tonë, duhet të japë edhe rezultatet e veta. Shteti ynë ka bërë shpenzime kolosale për bonifikimet. Prandaj siç ndiqet çdo ve-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi bonifikimet e kryera në vendin tonë dhe përfitimet prej tyre, gjendja në punimet e bonifikimit në vazhdim dhe mbi zbatimin e vendimit të Komitetit Qendror për zgjerimin e sipërfaqes së ujtitshme».

ndim tjetër që është marrë nga KQ i Partisë dhe Qeveria, ashtu duhet të kontrollohet edhe realizimi i vendimeve për bonifikimet. Në këtë drejtim nuk mjafton të paraqiten veprat e mëdha bonifikuese, siç bëhet fjalë në raport, por duhet të tregohet se ç'rezultate kanë dhënë këto vepra, në bazë të vendimeve që janë marrë.

Ne duhet t'u shohim dobinë investimeve prej 6 miliard lekësh që kemi shpenzuar për bonifikimet. Por nga diskutimet e shokëve del se shumë vepra kanë mbetur në mes të rrugës, sepse nuk janë planifikuar mirë, nuk janë parashikuar drejt. Në këtë drejtim më bëri mjaft përshtypje diskutimi i sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Lushnjës, që, sipas mendimit tim, ishte shumë i mirë dhe tregon se ky problem e ka preokupuar mjaft Partinë. Çështja e bonifikimeve në Lushnjë nuk është parë vetëm në vija të përgjithshme, që janë bërë kaq kanale ujitëse, kaq vepra kulluese etj., por është parë më thellë. Shokët e Partisë atje i ka preokupuar problemi se ç'po bëhet në Tërbuf. Në qoftë se projekti i kësaj vepre nuk ka parashikuar ku do të shkarkohen ujërat, ky është një gabim shumë i rëndë nga ana e projektuesve. Prandaj duhet t'i vëmë detyrë Ministrisë së Ndërtimit që të gjejë zgjidhjen e drejtë të këtij problemi dhe të çështjeve të tjera të këtij karakteri, ndryshe bonifikimi i Tërbufit do të bëhet një problem shumë i koklavitur.

Ose projektet e disa kanaleve mund të bëhen me gabime, kjo mund të ndodhë edhe në veprat e mëdha që po ndërtojmë, sepse reshjet dhe mjaft çështje të tjera nuk mund të parashikohen në detaje. Por në

rast se, për shembull, torfa ulet në Tërbuf 50-60 milimetra më shumë nga parashikimi, atëherë duhen pregatitur projekte të tjera për të marrë masa që të zgjidhet edhe ky problem i vështirë. Duke e parë kështu çështjen e tharjes së Tërbufit dhe të Myzeqesë, ku ka parashikime joserioze, atëherë duhet të themi se kjo vepër nuk ka mbaruar. Prandaj mendoj që rezultatet e bonifikimeve të merren më seriozisht në dorë nga ana e Qeverisë dhe veçanërisht nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, të kontrollohen ato një nga një e të realizohen gjer në fund. Për të evituar gabimet dhe të metat që janë vërtetuar në projektet, të merren masa që të bëhen sa më parë shtojcat përkatëse.

Pavarësisht nga të metat që ekzistojnë akoma nga ana e Ministrisë së Ndërtimit, duhet thënë se çështja e bonifikimeve është organizuar më mirë nga ajo e shfrytëzimit dhe e mirëmbajtjes së tyre. Kjo është një punë shumë serioze që duhet rishikuar më në hollësi, sepse mund të kënaqemi me punimet bonifikuese, po në rast se nuk i shfrytëzojmë ato, nuk arrijmë qëllimin.

Çdo vit do të na duhen rreth 200 milion lekë për mirëmbajtjen e veprave të bonifikimit, që do të thotë rreth një miliard gjatë pesëvjeçarit. Ky është një fond shumë i madh, por në qoftë se e organizojmë më mirë mirëmbajtjen e veprave të bonifikimit, atëherë edhe shpenzimet do të jenë më pak.

Shumë argjinaura e pjesë kanalesh mund të na prishen, po kjo nuk duhet të na frikësojë, sepse gjëra të tilla do të ndodhin për shkak të reshjeve të mëdha dhe të dheut, që akoma është i pastabilizuar mirë. Kujdes duhet të tregojnë edhe vetë kooperativat buj-

qësore ku kalojnë këto kanale, të cilat üshtë e domosdoshme të punojnë në mënyrë sistematike për mirëmbajtjen e kanaleve dhe të mos presin që çdo gjë ta bëjnë ndërmarrjet shtetërore. Të luftojmë kundër pikëpamjes që ekziston në disa njerëz se veprat e bonifikimit do të mirëmbahen nga ana e shtetit dhe jo nga kooperativat bujqësore. Natyrisht ndërmarrjet shtetërore do të kujdesen për mirëmbajtjen e këtyre veprave, por shteti ndërton vepra bonifikimi për fshatarësinë, prandaj tri të katërtat e punës për mirëmbajtjen e tyre duhet ta bëjnë vetë kooperativat bujqësore ku kalojnë këto kanale, qofshin nacionale apo lokale.

Çështja që u shtrua këtu se si duhen punuar tokat, më duket se është serioze. Unë nuk jam specialist, por mendoj se kjo çështje duhet studjuar. Ndoshta kjo metodë do zbatuar sipas vendit. Mund të ketë toka që duhen bërë kurriz peshku, po mund të ketë të tjera që s'është nevoja të bëhen të tilla. Nuk mund të veprojmë si përpara që na thoshin duhet t'u jepen udhëzimet përkatëse traktoristëve, të ndërtohen edhe kanalet e dyta e të treta.

Edhe çështja e mirëmbajtjes së makinerisë ka një rëndësi shumë të madhe, prandaj ndërmarrjet për riparime, t'i shfrytëzojnë si duhet. Zotësia e njerëzve tanë është që ndërmarrjet e riparimeve të Ministrisë së Ndërtimit, të Ministrisë së Bujqësisë etj., t'i shfrytëzojnë në maksimum me tri turne.

Ministria e Ndërtimit duhet të tregojë kujdes edhe për ekskavatorët, të cilët nuk duhen përdorur në ato vende ku puna mund të bëhet me krahë. Mund të bëhet përjashtim në punimet e hekurudhës, ku ekskava-



torët duhet të përdoren në shkallë të gjerë, sepse zëvendësojnë shumë krahun e punës. Të gjitha makineritë që Ministria e Ndërtimit i ka shpërndarë andej-këtej, i shikoni me kujdes.

Projektvendimin që na është paraqitur mund ta pranojmë, të shënojmë edhe disa çështje që u ngritën në diskutimet e shokëve. Çështja është ta organizojmë punën më mirë dhe të ushtrojmë një kontroll më të fortë. Me këto probleme, sidomos në drejtim të shfrytëzimit maksimal dhe të mirëmbajtjes së veprave të mëdha të bonifikimit, të merreni seriozisht si ju, shokët e Ministrisë së Ndërtimit, të Ministrisë së Bujqësisë, edhe ju, shokë të komiteteve të Partisë të rretheve.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **ZGJEDHJA DHE TRAJTIMI I FARËRAVE BUJQËSORE ËSHTË NJË PUNË SHKENCORE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**3 maj 1962**

Çështja e farës ka rëndësi të dorës së parë për bujqësinë. Për këtë problem të gjithë ne jemi të preokupuar, prandaj kërkua të na paraqitej edhe një raport. Unë e lexova me vërejtje materialin që na është paraqitur, por mendoj se ky nuk është i plotë, nuk ka karakter shkencor, ka më tepër një karakter praktikovo-organizativ.

Duke diskutuar këtu, shoku Mehmet tregoi se në fushat tona duhet të mbillen disa lloje farërash etj. Ky konkluzion del nga eksperiencia e gjertanishme, e cila për ne, Byronë Politike të Komitetit Qendror, ka rë-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi gjendjen e furnizimit të bujqësisë me farëra të nevojshme, mbi organizimin e prodhimit dhe të shpërndarjes së farërave dhe masat që duhen marrë për të siguruar nevojat e bujqësisë me farëra të zgjedhura».

ndësi të veçantë. Kemi 17 vjet që po luftojmë në këtë drejtim si me farërat e vendit, ashtu edhe me ato që importojmë. Mirëpo, në raportin që na është dhënë, mungojnë konkluzionet shkencore se mbi ç'farëra duhet të mbështetemi dhe për ç'arsye ne duhet të mbështetemi pikërisht në këto farëra. Të mos dalim me konkluzion si në raport se «te ne ndryshimi i klimës është shumë i madh» dhe me këtë të justifikojmë mungesat tona subjektive në lidhje me farërat.

Gruri dhe misri te ne janë dy kulturat kryesore, për realizimin e të cilave ne kemi vënë të gjitha forcat. Vetëm për këto dy kultura në vendin tonë numërohen shumë lloje farërash. Sikur raporti i paraqitur të kishte karakter shkencor, këto çështje duhet të përcaktoheshin me të dhëna statistikore e me konkluzione se cilat lloje farërash japin rendimente të larta dhe cilat jo, cilat duhen mbajtur e përmirësuar më tej dhe cilat duhen eliminuar e skartuar.

Zgjedhjen e farërave, riprodhimin, përmirësimin dhe mospërzierjen e tyre nuk duhet t'ia lëmë në asnjë mënyrë spontaneitetit. Spontaneiteti është shumë i dëmshëm për zhvillimin e bujqësisë sonë. Prandaj është e domosdoshme që kjo punë të organizohet mirë. Të na paraqiten tablo të veçanta të rajoneve sipas klimave të ndryshme dhe farërat më të përshtatshme për to. Bile një pasqyrë e tillë duhet të na ishte paraqitur, por Ministria e Bujqësisë këtë çështje me rëndësi të madhe nuk e ka plotësisht në dorë dhe nuk bën përpjekjet e duhura për ta organizuar si duhet e në mënyrë shkencore. Është e qartë se Ministrinë e Bujqësisë nuk e preokupojnë sa duhet studimet shkencore.

Kam përshtypjen se i vihet rëndësi vetëm punës praktike dhe nuk nxirren prej saj konkluzione shkencore, të cilat t'i shërbejnë prodhimit.

Në sektorin e bujqësisë ne kemi mundësi të mëdha të bëjmë një punë më të kulturuar dhe frytdhënëse për shtimin e prodhimit të drithërave. Në këtë kuadër nga ana e Ministrisë së Bujqësisë duhet të kërkohet një disiplinë më e madhe shkencore edhe në lidhje me sigurimin e farërave. Kjo është e domosdoshme aq më tepër po të mbajmë parasysh natyrën e punës rutinë të fshatarëve, traditat dhe zakonet e vjetra, mosnjohjen si duhet të agroteknikës, dëmet e agjentëve atmosferikë etj., që pengojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara në lëmin e prodhimit mbi baza shkencore.

Megjithëse drithëra mbillen në të gjithë Shqipërinë, ne duhet të nisemi nga parimi dhe praktika se në disa rrethe kjo kulturë është kryesorja. Për prodhimin e drithërave këto rrethe janë hambari i Shqipërisë, janë vendimtare, ashtu siç janë vendimtare disa rrethe të tjera, ku mbillen bimë industriale, si pambuk, panxhar ose duhan. Pikërisht në rrethe të tilla duhet të zhdukim patjetër anomalitë në çështjen e farërave dhe të stabilizohet prodhimi. Vetë rrethet duhet të sigurojnë farën që u nevojitet.

Për një kohë, gjersa të krijohen kushtet e domosdoshme objektive dhe subjektive, është e nevojshme të vendosen kufij të rreptë për disiplinimin e çështjes së farërave. Kjo do të thotë që deri atëherë nuk duhet lejuar që fshatari të blejë ku të dojë farë ose këtë vit të mbjellim këtë farë dhe vitin e ardhshëm të mbjellim një farë tjetër. Në këtë drejtim ne duhet të vendosim

rregulla dhe të kërkojmë zbatimin e rreptë të tyre. Po kështu duhet organizuar kontrolli që drithërat, të cilat shteti ua shet fshatarëve për konsum, të mos përdoren për farë. Ky kontroll duhet të vendoset sidomos në rrethet që janë prodhuesit kryesorë të drithërave. Çdo kontroll mbi farën e prodhuar e të transportuar nga një fermë ose kooperativë bujqësore në një tjetër, nga një rreth në tjetrin, duhet të bëhet për një kohë të gjatë nën kujdesin e shtetit.

Jam dakord me sa u tha këtu për misrin hibrid. Por duhet thënë se kjo çështje nuk del qartë në raportin që na është paraqitur. Kam dëgjuar se misri hibrid, i mbjellë në kushte të mira për disa vjet me radhë, jep rendimente të larta. Prandaj të mos tërhiqemi përpara vështirësive për studimin dhe mbjelljen e misrit hibrid. Në vende të tjera kanë një eksperiencë të gjatë në këtë drejtim, atje janë bërë prova të nevojshme, të cilat kanë dhënë rezultate, kurse te ne akoma s'po bëhet një gjë e tillë.

Ne duhet të përfitojmë nga eksperiencia e të tjerëve dhe të inkurajohemi prej saj. Natyrisht në këtë drejtim të ecim me kujdes, por pa ngurrim. Prodhimi i keq i ndonjë viti nuk duhet të na dekurajojë. Për shembull, në një rreth, megjithëse fara që u mboll që e mirë, mund të ndodhë që bima e mbirë të krimbet për shkak të lagështirës së madhe. Nga kjo nuk duhet të dalim me konkluzionin se fara e mbjellë nuk bën. Një gjë e tillë nuk do të ishte aspak serioze. Rezultatet e mira arrihen në disa kushte të përshtatshme dhe pas shumë vjet pune të kujdesshme shkencore. Natyrisht, në vende të tjera kanë në dispozicion edhe më shumë

mjete, por të mos harrojmë se ne kemi tokë dhe klimë shumë të mirë dhe këto janë kryesoret.

Ju, shokët e Ministrisë së Bujqësisë, më duket se nuk keni treguar kujdesin e duhur për trajtimin e farës. Këtë pakujdesi duhet ta njihni si në importimin ashtu dhe në trajtimin e në mbjelljen e saj. Ne kemi importuar me tonelata farë dhe ju nuk jeni në gjendje të na thoni konkretisht ç'është bërë me të. Kjo është e palejueshme. Prandaj të tregohet kujdes i madh për farën që importojmë, ta trajtojmë mirë atë dhe të ndjekim agroteknikën. Kështu të veprohet edhe për farën e importuar të misrit hibrid ose jo hibrid.

Edhe një herë dëshiroj të theksoj se për farërat, sidomos për ato të drithërave, në radhë të parë të grurit dhe të misrit, ne duhet të tregojmë kujdes të madh. Mendoj të vazhdojmë importimin e farërave nga jashtë, por kjo të bëhet vetëm me pakicë, aq sa është me të vërtetë e domosdoshme. Duke vepruar kështu, të mos e varim të gjithë shpresën te fara e importuar. Detyra jonë është që, me farërat që importojmë, të krijojmë mundësitë dhe të punojmë për të prodhuar vetë sasinë e farës që na nevojitet, bile farë të cilësisë së mirë, që t'u përshtatet klimës dhe tokës sonë. Në këtë drejtim të luftohet tendenca që ishte futur në disa punonjës të Ministrisë së Bujqësisë për të importuar sasira të mëdha fare, pa bërë përpjekje që ta sigurojmë atë në vend.

Në raport bëhen kërkesa për kuadro të bujqësisë. Kjo nuk është aspak e rregullt. Të tërë e dinë se kuadrot që përgatiten për bujqësinë i jepen të gjitha bujqësisë, ndërsa nga sektorët e tjerë merren kuadro për

plotësimin e nevojave të ndonjë institucioni, ndërmarrjeje ose organizate. Prandaj detyra është që kuadrot e bujqësisë të përdoren mirë, të edukohen, të mësohen si të punojnë gjithnjë e më mirë. Në qoftë se baza ka nevojë për më shumë kuadro të bujqësisë, propozoj që të shikohet mundësia e sigurimit të tyre duke i shkurtuar nga Ministria e Bujqësisë. Punët e bujqësisë janë në terren, atje zhvillohet lufta për prodhimet, pra edhe kuadrot në shumicën dërrmuese duhet të jenë atje. Në ministri të qëndrojnë vetëm kuadrot e nevojshëm, sa për të dhënë ndihmë, për të kontrolluar bazën dhe për të bërë konkluzione e përgjithësime. Natyrisht kuadrot e qendrës duhet të jenë të një niveli të lartë dhe nuk është nevoja të shkojnë në terren si era, të mjaftohen duke marrë disa statistika e duke dhënë ca këshilla në këmbë.

Si përfundim, mendoj që orientimet e dhëna nga mbledhja e sotme e Byrosë Politike të luftojmë për t'i vënë në zbatim nga fillimi i vitit që vjen, gjatë të cilit të ecim më me kujdes dhe më në rregull në zgjidhjen e këtyre çështjeve kaq të rëndësishme.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstilit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## MARRJA E ARSIMIT KËRKON VULLNET, KËMBËNGULJE, KONTROLL

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

4 maj 1962

Marrja e arsimit me korrespondencë nga ana e arsimtarëve të rinj, kërkon masa organizative, sepse çështja nuk mund të ecë në mënyrë spontane dhe se vetëm me të shtruar problemin nuk zgjidhet. Këto çështje i ka shqyrtuar edhe Partia, por ajo që kërkohet është të merren masa për të ndjekur shkollën. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe organizatat e masave duhet të thellohen sidomos në aspektin e vendimit që arsimtarët të vazhdojnë shkollën. Aktivitetet me arsimtarët mund të zhvillohen dhe atje të gjithë janë në gjendje të flasën, po, kur vjen puna për të mësuar dhe për të ndjekur shkollat, për këtë ka ngurrime. Prandaj masat organizative dhe kontrolli sistematik janë ato që

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e organizatës së rinisë dhe të bashkimeve profesionale me arsimtarët e rinj për vazhdimin e shkollës me korrespondencë.



nxitin sedrën e njerëzve, sepse në këtë proces bëhen edhe kritika. Vetëm shtrimi i problemit, siç është vepruar gjer tani, nuk e zgjidh punën, kësaj i thonë të shkosh radhën. Kryesorja është të ndiqet efektivisht detyra deri në zbatimin e plotë. Për këtë duhet organizuar më mirë ndihma e kontrolli që arsimtarët të ndjekin më mirë shkollën. Në parim ka njerëz që janë dakord të venë në shkollë, por në praktikë nuk e mbajnë fjalën. Marrja e arsimit kërkon vullnet të hekurt, këmbëngulje të fortë, kontroll sistematik.

Çdo problemi t'i gjejmë jo vetëm mënyrën si të shtrohet, por edhe mënyrat si të kontrollohet kryerja e detyrës. Kështu të veprohet edhe për shkollën. Njerëzit të venë të mësojnë dhe të nxiten vazhdimisht që ta mbarojnë atë. Pra shtrimi i problemit dhe zgjidhja e tij përbëjnë një të tërë. Ju, shokë të Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale, duhet të përpunoni masa të nxitjes dhe të kontrollit për ata që mësojnë me korrespondencë, duke u bazuar në të gjitha ato kushte të përshtatshme që ka siguruar Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Ndërsa bashkimet profesionale ta ndjekin këtë çështje në qytet, Bashkimi i Rinisë ta ndjekë në fshat. Vështirësitë materiale për arsimtarët që ndjekin shkollën me korrespondencë, siç janë, për shembull, mungesa e disa teksteve, të kapërcëhen.

Ju, shokë sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve, duhet ta kuptoni mirë se çështja e edukimit të arsimtarëve është nga më të rëndësishmet, sepse ata punojnë për edukimin e brezit të ri. Në qoftë se organizatat-bazë të Partisë nuk do t'i kushtojnë kujdes këtij problemi, ne do të kemi një humbje të madhe.

Shifrat që na jepen në materialin e paraqitur tregojnë se gjendjen nuk e kemi të mirë, sepse deficitet janë të shumta, ka mjaft arsimtarë që nuk e vazhdojnë shkollën për të marrë arsimin përkatës. Për arsimtarët në moshë të kaluar ndjekja e shkollës me korrespondencë është mjaft e vështirë, kurse për të rinjtë që janë në gjendje të mësojnë, që kanë vullnet, duhet të tregohet kujdes i madh nga Partia. Është krim i madh të mos i kushtojmë kujdes çështjes së vazhdimit të shkollës nga njerëzit tanë.

Bashkimet profesionale dhe organizatat e Bashkimit të Rinisë duhet të luftojnë më shumë dhe ta marrin si duhet në dorë këtë problem. E vlen që sekretari i parë ose sekretarët e tjerë të komitetit të Partisë të rrethit të shkojnë në mbledhje të arsimtarëve, të flasin dhe t'i inkurajojnë ata edhe për të vazhduar shkollën, pastaj t'u flasin atyre edhe për gjendjen e jashtme e të brendshme të vendit tonë. Një gjë e tillë Partisë i vlen shumë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **TË BEJMË NJË PUNË MË TË STUDJUAR PËR FORCIMIN E PËRBËRJES DHE TË SHTRIRJES SË PARTISË**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**4 maj 1962:**

Gjatë diskutimit të këtij problemi në mbledhjen e Sekretariatit u ngritën disa çështje që vlejné të studjohen dhe të përgjithësohen. Një nga këto çështje është përqindja e të pranuarve të atyre që kanë shkollën 7-vjeçare. Kriteri për të pranuar në Parti një njeri, që po të jetë qytetar duhet të ketë 7-vjeçaren dhe po të jetë fshatar të ketë filloren, është i drejtë. Mirëpo ka edhe disa raste të veçanta, kur njëri nuk e plotëson kërkesën për shkollë, por mund të ketë kushte të tjera shumë të mira, atëherë çështja duhet parë me vëmendje. Për shembull, në kushtet që jemi sot, mund të ketë raste që të preferojmë për të pranuar në

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi përbërjen dhe mbi shtrirjen e forcave të Partisë.

Parti më mirë një punëtor që ka 20 vjet stazh pune, megjithëse mund të mos e ketë shkollën 7-vjeçare, sesa një tjetër që vërtet e plotëson kushtin e shkollës, por ka vetëm 3-4 vjet si punëtor e është i ri në moshë dhe që, për t'u pranuar në Parti, duhet të punojë dhe të luftojë akoma. Ai që është i vjetër në moshë, 40 vjeç e më tepër, e ka të vështirë ta kryejë shkollën, po ka një stazh të gjatë si punëtor në disa sektorë të vështirë dhe cilësitë i ka shumë të mira, prandaj do të ishte gabim të mos e pranoni në Parti. Kur kemi të bëjmë me njerëz shumë të mirë, atëherë komitetet e Partisë nuk duhet të lidhin duart, po mund të bëjnë edhe ndonjë lëshim, që të mos u pritët rruga shokëve.

Komitetet e Partisë dhe aparatet e tyre duhet t'i shohin më mirë problemet. Për shembull, sekretari i Komitetit të Partisë i Rrethit të Lushnjës ngriti çështjen që të gjithë brigadierët, anëtarë partie, në kooperativën bujqësore të Bubullimës konsiderohen si funksionarë ose njerëz të administratës, gjë që duhet parë. Ne duhet t'i klasifikojmë punonjësit në baza reale, sepse mund të ndodhë që disa gjëra më parë janë gjukuar drejt, por me ndryshimin e kushteve, korrigjohen e ndryshohen edhe përcaktimet. Kështu, pa u qëndruar strikt vendimeve që kemi marrë, kur dalin probleme të veçanta, shokët duhet t'i ndjekin ato dhe të propozojnë që të bëjmë korrigjimet e nevojshme. Në këtë prizëm do parë a mund t'i klasifikojmë brigadierët si punonjës të prodhimit? Kriteret dhe nomenklaturën ne mund t'i ndryshojmë për disa gjëra që i ka nxjerrë vetë jeta.

Organizatat-bazë në fshat dhe komitetet e Partisë

duhet të studjojnë me vëmendje problemin e pranimave në Parti, lidhur kjo me detyrat aktuale dhe të perspektivës. Aktualisht ne mund të kemi një kooperativë bujqësore që ka një farë perspektive. Por Partia parashikon që perspektivat e saj do të jenë më të gjera, sepse do të hapen toka të reja, do të punohet për intensifikimin e bujqësisë, për zgjerimin e sektorit të frutikulturës, për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të olivikulturës atje ku ka ullinj, të blegtorisë etj. Në një kooperativë tani mund të jenë dy llogaritarë, por nesër, me zgjerimin e aktivitetit ekonomik të saj do të na duhen edhe dy të tjerë. Natyrisht punonjës të këtij specialiteti është e mirë të vijnë nga radhët e njerëzve pa parti të fshatit, sepse një ose dy anëtarë partie na duhet t'i kemi në sektorin e olivikulturës ose në atë të frutikulturës. Pra, në bazë të perspektivës që ka kooperativa duhet të punojmë edhe për të shtuar radhët e Partisë, të pranojmë anëtarë partie të rinj, bile nga ata sektorë ku ne kemi nevojë më të madhe. Kjo do të thotë që të kemi një farë perspektive për pranimet në Parti. Po ta bëjë këtë studim çdo organizatë-bazë, atëherë do të dalë edhe perspektiva e shtimit të radhëve të Partisë në rreth.

Shtimin e radhëve të organizatave-bazë të Partisë në rreth ne duhet ta llogaritim edhe në raport me popullsinë. Këtu ne mund të bëjmë vërejtje dhe të diskutojmë në Komitetin Qendror me sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve se si janë parë këto çështje dhe në këtë mënyrë të caktojmë kriteret për pranimin e grave, të punëtorëve, të punëtorëve të fermave, të kooperativave etj. Në ndërmarrjet bujqësore mund të

ketë një fond të madh toke, mirëpo atje mund të mos ketë shumë njerëz që të plotësojnë kushtet për të hyrë në Parti. Në një rast të tillë ne mund të shkojmë në kooperativën bujqësore më të afërt dhe të shikojmë se cilët mund të pranohen në Parti. Më vonë, këtyre komunistëve të rinj mund t'u themi të shkojnë në ndërmarrjet bujqësore dhe kështu të forcojmë organizatën-bazë të Partisë të këtij sektori.

Kur një punëtor anëtar partie për natyrën e punës punon 6 muaj në fabrikë dhe 6 muaj detyrohet të kthehet në fshat, dokumentet e tij si komunist nuk duhen lëvizur, por gjatë kohës që ai është në ndërmarrje jetën e Partisë duhet ta bëjë aty, ndërsa kur shkon përkohësisht në fshat, t'i jepet lidhje provizore që jetën e Partisë ta bëjë në fshat. Anëtar i Partisë duhet ta bëjë jetën e organizatës atje ku punon. Prandaj në qoftë se për një kohë kthehet në fshat, që është brenda rrethit, atëherë përkohësisht mund të bëhet efektiv i organizatës-bazë të fshatit. Sa për ata që janë definitivë në ndërmarrje, jetën e Partisë duhet ta bëjnë aty ku punojnë e jo në fshat. Në qoftë se fshati nuk ka komunistë, duhet të punohet me fshatarët më të mirë, të cilët të edukohen e të pregatiten për të hyrë në Parti. Në këtë drejtim të veprojnë sidomos ata anëtarë partie që punojnë në ndërmarrje, por që në darkë kthehen në fshat. Këta komunistë mund të marrin në kujdesin e tyre elementë dhe me ta të punojnë për pranimin e tyre në Parti. Duke vepruar kështu, do të arrihet në krijimin e një grupi njerëzish nga më të mirët, gjersa në fshat të formohet organizata-bazë e Partisë.

Për të gjitha këto çështje mendoj të bëjmë një punë më të studjuar për forcimin e përbërjes dhe të shtrirjes së organizatave-bazë me një perspektivë 5-6-vjeçare, duke e parë këtë çështje edhe në lidhje me origjinën dhe me përbërjen e elementëve të pranuar. Këto probleme që na dalin tani, komitetet e Partisë duhet të na i kishin raportuar me kohë. Megjithatë, le t'u hyjmë tani akoma më mirë. Prandaj, shokët e drejtorisë së organeve të Partisë pranë Komitetit Qendror, të hartojnë një plan pune dhe studimi për çështjet që u ngritën në këtë mbledhje, sidomos për klasifikimin e disa kategorive punonjësish si punëtorë prodhimi apo si njerëz të administratës. Kjo të na paraqitet me shembuj konkretë dhe me statistika, sepse do ta shqyrtojmë në Sekretariat ose në Byronë Politike të Komitetit Qendror për të ndryshuar disa kritere. Problemi i pranimeve të studjohet në mënyrë shkencore dhe jo nga ana sentimentale, me qëllim që elementët më të përgatitur dhe më me perspektivë të pranohen në Parti e të mos pengohen. Prandaj drejtorja e organeve të bashkëpunojë me komitetet e Partisë të rrethëve dhe disa probleme që kanë dalë është mirë t'i bëjë objekt diskutimesh e studimesh komplekse.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## TË FORCOHET PUNA MËSIMORE, EDUKATIVE DHE PEDAGOGJIKE NË SHKOLLAT USHTARAKE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

4 maj 1962

Edhe unë kisha po ato vërejtje që bëri shoku Hysni, prandaj nuk po zgjatem. Ju, shokë të Drejtorisë Politike, duhet t'u vini kujdesin më të madh këtyre dy shkollave<sup>2</sup>, sepse ato janë fidanishtet bazë për përgatitjen e oficerëve tanë të ardhshëm, të cilët duhet të pajisen me shkencë, me kulturë dhe me arsim, të brumosen me ndërgjegje të lartë patriotike dhe me partishmëri të madhe. Në këto shkolla ne duhet të edukojmë oficerët e rinj dhe të arrijmë që të metat tona e të oficerëve tanë të vjetër të mos zënë vend në brezin e ri të oficerëve, domethënë të metat tona të shërbejnë për mësimin dhe edukimin e oficerëve të rinj.

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua «Mbi gjendjen dhe punën mësimore në shkollën e bashkuar «Enver Hoxha», «Skënderbej» dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme».

2 Shkollave «Enver Hoxha» dhe «Skënderbej».



Ju i keni shumë të mira kushtet në shkolla, prandaj ka mundësi që të zhvillohet në nivel të lartë puna mësimore-edukative. Të kihet parasysh orientimi që në shkollat ushtarake të venë më shumë djem të punëtorëve dhe të patriotëve, sidomos djem oficerësh. Them djem oficerësh, sepse ka të bëjë shumë çështja e edukatës në familje, e dashurisë për profesionin ushtarak dhe e kuptimit të rolit të rëndësishëm që duhet të luajë oficeri në ushtri. Prandaj, mendoj se në të ardhshmen, nuk duhet të ngjasë që ndonjë skënderbegas, që mëson në shkollë dhe që përgatitet për ushtarak, të mendojë për të ndjekur universitetin me qëllim që të punojë në sektorë civilë. Këtë gjë e keni në dorë më shumë ju, sesa familja. Nuk është çështja do apo nuk do familja t'i bëhet djali oficer, por çështja varet nga puna që do të bëni ju me të.

Ju duhet të ngjallni te të rinjtë dashurinë e madhe për ushtrinë. Kështu veprojnë shumë prindër, por ka edhe nga ata prindër që bëjnë çmos për ta dërguar djalin e tyre në shkolla të tjera, ose që e nxitin me ndërgjegje për të kryer ndonjë akt indisiplinimi vitin e fundit, me qëllim që të largohet nga shkolla ushtarake e të hidhet në sektorin civil. Një veprim i tillë është shumë i shtrembër.

Në ushtri ne përgatitim, veç oficerëve, edhe kadrotë tjerë, si inxhinierë, mjekë etj., për të shërbyer në ushtri. Prandaj në shkollat ushtarake duhet t'u kushtohet rëndësi e dorës së parë jo vetëm mësimëve ushtarake, por edhe atyre të profesioneve të tilla. Instruktorët duhet t'i japin rëndësi të madhe programit ushtarak, sepse në qoftë se mësimet ushtarake lihen në:

radhë të dytë, vetvetiu kjo do të influencojë mbi prindërit e nxënësve, të cilët nuk do të kenë dëshirë që djali i tyre të bëhet ushtarak dhe kështu do të ketë pengesa në të ardhshmen. Mbarëvajtja në këtë drejtim varet jo vetëm nga rëndësia që i jepet edukatës ushtarake sipas programit, por edhe nga jeta që bën nxënësi në shkollë. Kjo ka rëndësi, sepse mundet që në disa klasa të shkollës «Skënderbej» programi ushtarak të mos jetë aq i ngjeshur, po një jetë e vërtetë tërheqëse ushtarake, që ka të bëjë me sjelljen dhe qëndrimet serioze ushtarake, me pastërtinë, me fjetjen, me disiplinën, me ambientet e kulturuar dhe me shoqërinë ushtarake etj. Duke qenë këto në mënyrë shembullore, atëherë me siguri te nxënësit do të ngjallet shpirti ushtarak, disiplina e vetëdijshme, fryma e patriotizmit dhe ndërgjegjja e lartë për funksionin që do të kryejnë në të ardhshmen në radhët e ushtrisë. Prandaj në këto çështje ju duhet të bëni kujdesin më të madh, sidomos në shkollën «Skënderbej».

Ndëshkimet në shkollat ushtarake nuk janë të drejta, sidomos në atë shkallë që jepen. Kjo tregon se pedagogët nuk bëjnë sa duhet punë edukative, por e kanë zëvendësuar këtë me masa ndëshkimore. Nxënësit e këtyre shkollave janë filiza të rinj, prandaj nuk duhet të konsiderohen nga pedagogët njëloj si ata oficerë që janë më të rritur dhe kanë disa vjet në shërbim ushtarak. Natyrisht, për ata nxënës që bëjnë faje, duhet të jepen edhe disa dënime, po sa të jetë e mundur të lehta dhe të mos jenë ndëshkime fizike dhe diskriminuese. Në këto shkolla dënimet duhet të jenë të tilla që të prekin sedrën e nxënësve dhe t'i përshta-

ten jetës ushtarake. Burgime nuk duhet të jepen në klasat fillestare. Prandaj për këto dobësi t'u tërhiqet vëmendja organizatave të Partisë dhe këshillave pedagogjike. Por këtu ka neglizhenca edhe nga shokët e Drejtorisë Politike, ka nënvleftësim dhe mendjemadhësi nga ana e pedagogëve anëtarë partie. Në rast se pedagogët në asnjë mbledhje të tyre nuk analizojnë si shkon puna edukative me nxënësit, natyrisht rezultatet e tyre nuk ka si të jenë të mira. Prandaj në shkollat ushtarake duhet të forcohet më shumë puna mësimore, edukative dhe pedagogjike.

*Botuar për herë të parë në:  
Enver Hoxha «Në ndihmë  
të Ushtrisë Popullore»,  
vëll. II, f. 439.  
Tiranë, 1975*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë  
nga procesverbali i mbledhjes  
së Sekretariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# VIJA E PARTISË SONË ËSHTE NJË VIJË E DREJTË, REVOLUCIONARE DHE NË PËRPTHJE ME MËSIMET E MARKSIZËM-LENINIZMIT

*Letër dërguar të gjitha organizatave-bazë të Partisë*

9 maj 1962

Kanë kaluar vetëm 6 muaj nga sulmi i hapur që N. Hrushovi bëri në Kongresin e 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik kundër Partisë sonë, kundër unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Por këta 6 muaj mjaftuan për të vërtetuar para gjithë botës falsitetin e akuzave dhe të shpifjeve të N. Hrushovit kundër Partisë sonë, për të provuar drejtësinë e vijës dhe të qëndrimit parimor marksist-leninist të Partisë sonë në luftën kundër revizionizmit modern.

Lufta e drejtë parimore e Partisë sonë kundër grupit të N. Hrushovit, qëndrimi i saj burrëror dhe i vendosur përpara presioneve dhe provokacioneve më të egra të N. Hrushovit e të grupit të tij, gjakftohtësia dhe urtësia e Partisë dhe e popullit tonë heroik kanë bërë që Partisë sonë t'i rritet autoriteti në sytë e opi-

nionit të komunistëve të mbarë botës, në sytë e popujve të ndryshëm dhe të njerëzve përparimtarë. Kjo shihet më së miri nga qindra letra solidariteti që ka marrë e vazhdon të marrë Komiteti Qendror i Partisë sonë nga komunistë të vendeve të ndryshme. Komunistët e botës dhe opinioni publik ndërkombëtar gjithnjë e më qartë shohin se Partia e Punës e Shqipërisë mbron pozitat parimore të marksizëm-leninizmit, kurse N. Hrushovi, me politikën e tij oportuniste dhe me veprimet e tij antimarksiste, dëmton interesat e lëvizjes komuniste, dëmton luftën e popujve për liri, demokraci e socializëm.

Zhvillimi i gjendjes ndërkombëtare deri tani ka dhënë shumë prova për të treguar se në vlerësimin e saj kanë të drejtë Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste që qëndrojnë në pozita parimore, e jo revizionistët modernë, grupi i N. Hrushovit e pasuesit e tij. Komunistët e popujt e botës po e shohin qartë se si po rrëzohen iluzionet e N. Hrushovit për «dëshirat e Kenedit për paqe», shpresat e tij për ndryshimin e natyrës agresive të imperializmit. Përherë e më shumë bëhet e qartë se politika oportuniste e N. Hrushovit, politika e lëshimeve dhe e lajkave ndaj imperialistëve, e paqëndrueshmërisë dhe e lëkundjeve të vazhdueshme, jo vetëm nuk zgjidh asgjë, por përkundrazi është në dobi të imperializmit. Në fakt ç'rezultate janë arritur gjer tani? Asnjë rezultat. Çështja e traktatit të paqes me Gjermaninë dhe çështja e Berlinit Perëndimor kanë mbetur atje ku ishin. Çështja e çarmatimit gjithashtu. Bile, ndërsa në Gjenevë bisedohet për çarmatimin, qeveria e Kenedit rifilloi

provat e armëve bërthamore në atmosferë. Lëvizja nacionalçlirimtare e popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine ka marrë një hov të ri. Krejt në kundërshtim me iluzionet, që përpiqet të krijojë N. Hrushovi në popujt e shtypur, për të pritur çlirimin e tyre nga një rezolutë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ose nga çarmatimi i plotë e i përgjithshëm, popujt kanë rrokur armët. Me luftë e me gjak mbas 7 vjet sakrificash populli algjerian i imponoi armëpushimin imperializmit francez dhe fitoi të drejtën e parvarësisë; me armë në dorë po lufton populli i Kongos, i Laosit, apo i Vietnamit të Jugut. Kudo, në të gjitha çështjet themelore të zhvillimit të gjendjes ndërkombëtare, po duket sheshit se ka të drejtë Partia jonë, se vija e saj është në përputhje me mësimet e leninizmit, pra një vijë revolucionare, ndërsa nuk ka të drejtë N. Hrushovi, vija e të cilit është revizioniste, anti-marksiste, në dëm të interesave të popujve.

Lufta e drejtë parimore e Partisë sonë kundër grupit të N. Hrushovit, rezistenca e saj heroike përpara sulmeve e presioneve të tij, si dhe zhvillimi i ngjarjeve ndërkombëtare, jo në drejtimin që duan revizionistët, por në të kundërtën, kanë forcuar edhe më tej pozitën e marksizëm-leninizmit revolucionar në radhët e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Pozitat e drejta marksiste-leniniste i mbrojnë me vendosmëri jo vetëm Partia e Punës e Shqipërisë dhe Partia Komuniste e Kinës, por edhe shumë parti të tjera. Vija e N. Hrushovit kundër Partisë sonë u kritikua botërisht edhe nga Partia Komuniste e Zelandës së Re e shumë parti të tjera.

N. Hrushovi nuk po gjen mbështetjen e duhur as në aleatët e tij besnikë, në radhët e partive të vendeve socialiste të Evropës. Kjo duket qartë në qëndrimin që këta mbajnë ndaj Partisë e vendit tonë.

Si shpjegohet kjo?

Së pari, kjo ka lidhje me taktikën e urtë që ka ndjekur Partia jonë e Punës. Partia jonë ka qenë dhe është e bindur se udhëheqjet e partive të vendeve socialiste të Evropës janë në pozitat e N. Hrushovit. Por siç dihet, lufta jonë është përqendruar në demaskimin e N. Hrushovit e të pasuesve të tij. Ky diferencim i drejtë taktik i vuri në pozita të vështira udhëheqjet e partive të vendeve socialiste të Evropës, të cilat nuk gjetën ndonjë argument formal për të ndër marrë kundër vendit tonë veprime të ngjashme me ato të N. Hrushovit. Duhet thënë se, për të fituar ndonjë argument të tillë, ata kanë bërë shumë provokime ndaj Partisë sonë, sidomos duke folur e duke shkruar në organet e tyre zyrtare në mënyrë intensive. Por Partia jonë kurdoherë ka manovruar me gjakftohtësi e urtësi.

Së dyti, fakti që udhëheqjet e vendeve socialiste të Evropës nuk e ndoqën N. Hrushovin në të gjitha masat kundër Partisë e vendit tonë, shpreh edhe ekzistencën e kontradiktave që ato kanë në mes tyre, gjë që është shumë logjike, sepse midis oportunistëve e revizionistëve nuk mund të ketë kurrë unitet e mirëbesim reciprok.

Si konkluzion mund të themi se lufta e drejtë pa-rimore e Partisë sonë kundër grupit të N. Hrushovit, qëndrimi konsekuent marksist-leninist i Partisë Komuniste të Kinës dhe i partive të tjera, si dhe zhvillimi

i ngjarjeve në botë në kundërshtim me dëshirat e revizionistëve, i kanë vënë në pozita të vështira N. Hrushovin e pasuesit e tij, të cilët e shohin se toka po u rrëshqet nën këmbë, se fytyra e tyre antimarksiste po demaskohet. Por është e qartë se N. Hrushovi nuk heq dorë nga rruga e tij oportuniste dhe nga qëllimet e tij kundër unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Prandaj ai kërkon të manovrojë, të ndryshojë taktika, për të arritur të njëjtat qëllime me rrugë të tjera.

Ndryshimi i taktikave të N. Hrushovit ka lidhje edhe me presionin e fortë që po bëjnë disa parti komuniste e punëtore motra të vendeve të ndryshme, të cilat kërkojnë që të gjenden rrugët për rivendosjen e unitetit marksist-leninist në radhët e lëvizjes komuniste ndërkombëtare e të kampit socialist.

Kohët e fundit disa parti komuniste e punëtore i kanë dërguar letra KQ të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, KQ të Partisë Komuniste të Kinës dhe Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Në këto letra theksohet preokupacioni i tyre i madh për gjendjen e padëshirueshme të krijuar në kampin socialist e në lëvizjen komuniste e ndërkombëtare pas nxjerrjes në shesh të mosmarrëveshjeve tona nga N. Hrushovi në Kongresin e 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe bëjnë thirrje që të gjenden rrugët për rivendosjen e unitetit, mbi bazën e parimeve të përcaktuara në Deklaratën e Moskës të vitit 1960. Ato propozojnë që për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ekzistuese të thirret mbledhja e përfaqësuesve të tri partive: të Partisë Komuniste të Bashkimit



Sovjetik, të Partisë Komuniste të Kinës dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë, ose mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste, ose, më në fund mbledhja e përfaqësuesve të të gjitha partive komuniste e punëtore të botës.

Komiteti Qendror i Partisë sonë u ka dërguar përgjigjet përkatëse udhëheqjeve të këtyre partive. Në përgjigjet e veta Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ka theksuar se e kupton drejt preokupacionin e këtyre partive për gjendjen e krijuar në marrëdhëniet midis Partisë e vendit tonë dhe grupit të N. Hrushovit dhe se i vlerëson shumë përpjekjet e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe forcimin e unitetit të vendeve socialiste e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Komiteti Qendror i Partisë sonë ka vënë në dukje gjithashtu se ai është përpjekur e ka propozuar vazhdimisht që mosmarrëveshjet me udhëheqjen sovjetike të zgjidhen në baza marksiste-leniniste, në kushtet e barazisë e të pavarësisë së plotë, në frymën e konsultimeve shoqërore. Për këtë dëshmon qartë e në mënyrë të hollësishme korrespondenca e shkëmbyer midis Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por, për fat të keq, grupi i N. Hrushovit nuk ua vuri veshin propozimeve tona. Ai vazhdoi gjithnjë e më brutalisht veprimtarinë e tij antimarksiste për të keqësuar deri në maksimum marrëdhëniet midis dy partive e dy vendeve tona. Puna arriti deri atje sa ai të sulmojë botërisht Partinë tonë nga tribuna e Kongresit të 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sov-

jetik, të presë në fakt marrëdhëniet diplomatike me vendin tonë dhe të shpërthejë një fushatë të tërbuar antimarksiste kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, duke përdorur si «argumente» edhe shpifjet më të ulëta të shtypit reaksionar borgjez.

N. Hrushovi iniciativën e këtyre partive u përpoq ta shfrytëzojë për qëllimet e veta armiqësore. Në shkurt të këtij viti KQ i PK të BS i dërgoi një letër KQ të PK të Kinës. Në letrën e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, përveç fjalëve fund e krye plot hipokrizi për unitet, bëhet orvatja për të futur pyka midis partive motra që qëndrojnë të vendosura në pozitat e marksizëm-leninizmit, konkretisht midis Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, për të mënjanuar e për të izoluar Partinë tonë, sikur çështja e marrëdhënieve me Partinë e Punës të Shqipërisë dhe me Republikën Popullore të Shqipërisë është një problem i veçantë që gjoja nuk ka lidhje me çështjen e unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Është për të shënuar se në letrën e udhëheqjes sovjetike përdoren terma të tillë, si «të shohim përpara e jo prapa», «të shohim ç'na bashkon e jo ç'na ndan» etj., etj. Shokëve do t'u kujtohet se terma të tillë N. Hrushovi ka përdorur e përdor sa herë kërkon marrëveshje e afrim me imperialistët amerikanë apo me klikën revizioniste të Titos. Nga kjo kuptohet se N. Hrushovi nuk merakoset aspak për unitetin marksist-leninist të kampit socialist, por vetëm bën demagogji.

I tillë është thelbi i tërë letrës së lartpërmendur të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit

Sovjetik. Në prill të këtij viti Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës i dërgoi përgjigjen përkatëse Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi u njoh me përmbajtjen e letrave të KQ të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Kinës, e gjeti të arsyeshme që edhe një herë të shprehë mendimin e vet mbi mosmarrëveshjet në gjirin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste dhe gjendjen e marrëdhënieve midis Partisë e vendit tonë dhe udhëheqjes së sotme sovjetike. Për këtë qëllim, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë në prill të këtij viti i është drejtuar me një letër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, ku shpreh pikëpamjen e Partisë sonë lidhur me këto çështje.

Në letrën e vet Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë konstaton me kënaqësi se si Partia jonë, ashtu dhe Partia Komuniste e Kinës, në përcaktimin e vijës e të pikëpamjeve të tyre për të gjitha çështjet që qëndrojnë para lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare nisen nga e njëjta bazë parimore, nga mësimet e marksizëm-leninizmit. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë në letrën e tij midis të tjerave thekson:

«Uniteti i kampit socialist dhe i lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare është dëmtuar e po dëmtohet rëndë nga pikëpamjet dhe veprimtaria antimarksisiste e grupit të N. Hrushovit, i cili është larguar nga mësimet themelore të marksizëm-leninizmit dhe ka shkelur e po shkel brutalisht deklaratat e Moskës të

viteve 1957 dhe 1960, si përsa u përket çështjeve kryesore të zhvillimit të sotëm botëror, ashtu edhe përsa u përket marrëdhënieve që duhet të ekzistojnë midis vendeve socialiste dhe midis partive marksiste-leniniste, gjë që është vetëm në dobi të armikut tonë të përbashkët, imperializmit».

Në letër sillen fakte e argumente të shumta që vërtetojnë pikëpamjet oportuniste e revizioniste të N. Hrushovit e të grupit të tij, si dhe veprimet e tij përçarëse antimarksiste.

«Veprimet e N. Hrushovit e të grupit të tij, thuhet në letër, janë veprime të ndërgjegjshme prej revizionisti, i cili, në vijën dhe në qëndrimin e drejtë e parimor të partive që qëndrojnë fort në pozitë revolucionare marksiste-leniniste sheh rrezikun e demaskimit të tij dhe prandaj përpiqet me çdo mjet t'i nënshtrojë ato, t'u imponojë atyre vijën e vet antimarksiste, t'i diskreditojë e t'i izolojë ato».

Qëndrimi antimarksist e armiqësor i grupit të N. Hrushovit ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, vë në dukje letra e Komitetit Qendror të Partisë sonë, «nuk është një veprim i veçuar e as i rastit, por është pasojë logjike e tërë vijës antimarksiste të tij, është njëra nga hallkat në kuadrin e veprimtarisë së tij, për të përçarë e për të nënshtuar kampin socialist dhe tërë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, për t'u imponuar atyre vijën e tij revizioniste, është një shprehje e qartë e metodave që përdor ai për t'ua arritur qëllimeve të veta. N. Hrushovi mendonte se Partia e Punës e Shqipërisë, si Parti e një vendi të vogël socialist, ishte hall-

ka që mund të cenohej më lehtë, hallka më e përshtatshme që, duke e goditur e duke e nënshtruar atë, do të mund të godiste, frikësonte e nënshtronte të tjerët, t'u impononte atyre vijën e tij revizioniste».

Në letrën e vet Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë thekson se është plotësisht dakord me mendimin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës se, për të arritur në një marrëveshje mbi unitetin, para së gjithash, duhet të likuidohet gjendja e rëndë, e krijuar me iniciativën e N. Hrushovit, në marrëdhëniet sovjeto-shqiptare. Në letër thuhet: «Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë është i mendimit se kusht i domosdoshëm për arritjen e unitetit marksist-leninist në lëvizjen tonë dhe për forcimin e tij të mëtejshëm është zbatimi me rreptësi i parimeve të pavarësisë, barazisë dhe konsultimeve shoqërore në marrëdhëniet midis partive komuniste e punëtore motra. Për këtë është krejt e domosdoshme t'i pritët vendosmërisht rruga shkeljes së këtyre parimeve nga ana e grupit të N. Hrushovit, të dënohen në mënyrë parimore e të vendosur veprimet dhe metodat antimarksiste që përdor ai për t'ia imponuar vijën e vet revizioniste gjithë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, të cilat çojnë drejt thellimit të mëtejshëm të përçarjes së forcave të socializmit. Hapi i parë dhe guri i provës që do të tregonte se grupi i N. Hrushovit heq dorë me të vërtetë nga këto metoda e veprime antimarksiste, do të ishte pranimi nga ana e tij i gabimeve të rënda ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, të cilat u bënë objekt i sulmeve më të egra publike të N. Hru-

shovit. Në goftë se N. Hrushovi nuk pranon ndershmërisht dhe publikisht gabimet e veta të rënda ndaj Partisë dhe ndaj vendit tonë, si dhe ndaj partive të tjera motra, kjo do të thotë se ai nuk është sinqerisht për unitetin, por vetëm manovron me fjalët për unitet, kërkon të fitojë kohë, kërkon të arrijë një pauzë, të diktuar nga dështimet që pëson politika e tij, dhe të përgatitë fshehtazi goditje të reja kundër unitetit, kjo do të thotë se ai ka ndër mend të vazhdojë me këmbëngulje rrugën antimarksiste të shkeljes së parimeve të pavarësisë e të barazisë në marrëdhëniet midis partive komuniste e punëtore dhe vendeve socialiste, duke bërë kështu të pamundur çdo konsultim shoqëror e të barabartë midis partive motra.

Veç kësaj, me presionet e shantazhet ekonomike e politike dhe veçanërisht me sulmet e tij të egra shpifëse kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj, me prerjen e marrëdhënieve diplomatike e me thirrjet e hapura për përmbysjen e udhëheqjes në Shqipëri, N. Hrushovi në fakt ka vënë kushte paraprake të papranueshme për bisedime me Partinë tonë, e ka vënë këtë në kushtet e pabarazisë. Pa i hequr këto kushte paraprake, nuk mund të ketë kurrfarë konsultimesh shoqërore, të bazuara në parimet e pavarësisë e të barazisë së plotë që janë përcaktuar qartë në Deklaratën e partive komuniste e punëtore të vitit 1960, kurse pa konsultime shoqërore, pa respektimin me rreptësi të parimeve të pavarësisë e të barazisë së partive motra kurrfarë uniteti nuk është i mundur».

Komiteti Qendror i Partisë sonë në letrën e vet thekson se është plotësisht i bindur se dhe partitë e

tjera motra do ta kuptojnë drejt atë, edhe ato parti që akoma nuk e kanë të qartë. «Duke bërë fjalë për rrugën që duhet ndjekur si hap për përgatitjen e terrenit për zhdukjen e mosmarrëveshjeve që ekzistojnë në gjirin e kampit socialist dhe për normalizimin e marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike, nuk është fjala për të kënaqur «sedrën tonë nacionale», por për të vënë në vend e për të mbrojtur parimet leniniste të marrëdhënieve midis partive motra dhe midis vendeve socialiste. Mosdënimi i metodave e i veprimeve antimarksiste të N. Hrushovit, të cilat në mënyrën më të hapur e më brutale u shfaqën në qëndrimin e tij ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, jo vetëm nuk jep asnjë garanci se ato nuk do të përsëriten në të ardhshmen kundër ndonjë partie motër apo vendi socialist, por përkundrazi e inkurajon atë për të ecur më tej në rrugën e tij të rrezikshme, për t'i sjellë dëme akoma më të mëdha unitetit tonë».

Kjo është në vija të përgjithshme përmbajtja e letrës që Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë i dërgoi në muajin prill të këtij viti Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, ku shprehet qartë pozita e Partisë sonë lidhur me çështjen e unitetit.

Të dashur shokë,

Partia jonë ka qenë dhe është gjithnjë për unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, ajo ka luftuar e lufton me vendosmëri e në mënyrë parimore për forcimin e këtij uniteti mbi bazën e shëndoshë të marksizëm-leninizmit. Duke u nisur nga kjo pozitë

parimore, Partia jonë i ka qëndruar e i qëndron kurdoherë besnike vijës së përbashkët të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe e ka zbatuar në jetë me vendosmëri këtë vijë. Në marrëdhëniet e saj me partitë motra dhe me vendet socialiste vëllezër Partia jonë u është përmbajtur e u përmbahet me rigorozitet parimeve të internacionalizmit proletar, të barazisë dhe të pavarësisë, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëritjetrit dhe të ndihmës e të përkrahjes reciproke vëllazërore, të arritjes së unitetit me anën e konsultimeve shoqërore.

Si luftëtare e vendosur për unitetin, Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë, është dhe do të jetë kurdoherë për ruajtjen dhe forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Partia jonë ka luftuar e lufton jo për çdo lloj uniteti në kampin socialist e në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, por për një unitet të shëndoshë, të bazuar në parimet e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, për një unitet në luftë kundër imperializmit dhe renegatëve të marksizëm-leninizmit, revizionistëve modernë. Lufta për unitet dhe lufta kundër përçarësve të unitetit, revizionistëve modernë, nuk mund të shkëputen njëra nga tjetra. Vetëm një unitet i tillë marksist-leninist mund të jetë një unitet me të vërtetë efektiv e i qëndrueshëm, për të cilin ka nevojë lëvizja komuniste ndërkombëtare. Pikërisht sepse Partia jonë ka mbajtur dhe mban një qëndrim të tillë parimor në çështjen e unitetit, ajo u sulmua egërsisht nga armiqtë e marksizëm-leninizmit e të unitetit tonë, nga N. Hrushovi dhe përkrahësit e tij.



N. Hrushovit dhe grupit të tij po i shket toka nën këmbë, ai po sheh rrezikun e demaskimit të tij të plotë, prandaj po përpiqet të dalë me flamurin e «unitetit», të manovrojë me fjalët për «unitet», me qëllim që të fitojë kohë, të arrijë një farë pushimi, të mashtrojë partitë komuniste e punëtores dhe të përgatitë goditje të reja kundër unitetit. Kjo taktikë e N. Hrushovit është sidomos e rrezikshme tani që problemi i unitetit preokupon seriozisht partitë dhe komunistët në të gjitha vendet. Në këto kushte është aq më tepër e domosdoshme që partitë, të cilat qëndrojnë me vendosmëri në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, të marrin në duart e veta flamurin e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të kenë iniciativë në këtë drejtim dhe të demaskojnë kështu manovrat taktike të N. Hrushovit. Duhet mbajtur parasysh se në lëvizjen komuniste N. Hrushovi nuk është demaskuar akoma plotësisht si përçarës i kampit socialist e i lëvizjes komuniste dhe si antimarksist.

Natyrisht, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë mendon se grupi i N. Hrushovit nuk do t'i pranojë gabimet, se ai nuk do të bëjë autokritikë. Ne tashmë i njohim mirë revizionistët. Kemi njohur klikën e Titos dhe dimë se ajo kurrë ndonjëherë, në asnjë rrethanë nuk bëri autokritikë, nuk hoqi dorë nga rruga antimarksiste. E njohim edhe grupin e N. Hrushovit dhe jemi të bindur se ai do të përpiqet të përfitojë nga rasti për ta bërë veprimtarinë e tij revizioniste më të rafinuar, për të shtuar përpjekjet e tij si kundër Partisë sonë, ashtu edhe kundër kampit socialist e lëvizjes komuniste ndërkombëtare në forma të tjera.

Komiteti Qendror i Partisë kërkon nga organizatat e Partisë dhe nga të gjithë komunistët që të kuptojnë drejt qëndrimin e Partisë sonë lidhur me çështjen e unitetit në situatën e sotme, të luftojnë kundër iluzioneve që mund të shkaktohen nga fakti se shtypi ynë nuk do të flasë përkohësisht kundër N. Hrushovit etj. Organizatat e Partisë, nga ana tjetër, duhet të forcojnë edhe më shumë propagandën me gojë, me konferenca, leksione e biseda me masat e popullit për demaskimin e pikëpamjeve e të veprimtarisë revizioniste të grupit të N. Hrushovit. Duhet të kuptohet drejt se vija e Partisë mbetet e pandryshuar, mbetet ajo që ka qenë, prandaj ajo duhet propaganduar mirë në masat. Për këtë çështje do t'u vijë në ndihmë edhe shtypi ynë, i cili do të shkruajë edhe më tepër për probleme të ndryshme, duke ekspozuar vijën tonë në të gjitha aspektet.

Komiteti Qendror, si kurdoherë, po i vë në dijeni të gjithë anëtarët e Partisë sonë mbi gjendjen që është krijuar kohët e fundit në lëvizjen komuniste e punëtorë ndërkombëtare. Prandaj kjo letër të punohet në të gjitha organizatat-bazë të Partisë deri më 30 maj 1962.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë, me  
disa shkurtime, sipas origjinalit  
që gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## ZGJEDHJET TE NE KANË QENË KURDOHERË SHPREHJE E LARTË E UNITETIT TË POPULLIT RRETH PARTISË

*Fjala para zgjedhësve të zonës elektorale Nr. 179<sup>1</sup>*

30 maj 1962

Të dashur shokë dhe shoqe,

Para së gjithash, më lejoni t'ju falënderoj nga zemra për besimin që treguat dhe për nderin e madh që më bëtë, duke më propozuar si kandidat për deputet në Kuvendin Popullor. Unë e çmoj këtë si një shprehje të besimit e të dashurisë së pakufishme që ju, zgjedhësit e zonës elektorale numër 179, ashtu si i tërë populli ynë, keni për Partinë e Punës të Shqipërisë, organiza-

---

<sup>1</sup> Ky fjalim u botua në gazetën «Zëri i popullit» të datës 31 maj 1962, por jo i plotë. KQ i PPSH, duke marrë parasysht dëshirën e disa partive komuniste, pranoi të ndërpriste për një kohë kritikën publike në shtyp e në radio ndaj N. Hrushovit dhe grupit të tij revizionist. Megjithëkëtë, PPSH e vazhdoi demaskimin në popull të këtij grupi antimarksist, sepse ishte plotësisht e bindur se ai ishte futur thellë në rrugën e tradhtisë dhe se në këtë rrugë do të ecte edhe në të ardhshmen.

toren dhe udhëheqësen e sprovuar të të gjitha fitoreve të popullit tonë në luftën për çlirimin e atdheut përgjithmonë nga robëria e fashistëve dhe e feudoborgjezisë për vendosjen e pushtetit popullor dhe ndërtimin e socializmit. Ju siguroj, të dashur shokë, se nuk do të kursej forcat e mia për ta merituar plotësisht besimin tuaj, dhe jetën time do t'ia kushtoj deri në fund punës dhe shërbimit me besnikëri për popullin dhe Partinë që më rritën.

Zgjedhjet për Kuvendin Popullor janë një ngjarje shumë e rëndësishme politike në jetën e vendit tonë. Më 3 qershor populli ynë do të zgjedhë përfaqësuesit e tij në organin më të lartë të pushtetit tonë shtetëror. Këto zgjedhje do të jenë edhe një herë një shprehje e lartë e unitetit të pathyeshëm të popullit tonë rreth Partisë së tij të lavdishme dhe pushtetit popullor, e bashkimit të tij në Frontin Demokratik, të udhëhequr nga Partia. Duke votuar të gjithë pa përjashtim për kandidatët e Frontit Demokratik, populli ynë do të votojë për ndërtimin e plotë të socializmit, për lirinë dhe për pavarësinë e atdheut tonë, për begatinë e lulëzimin e tij, për politikën e paqes e të miqësisë midis popujve, për vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë.

E drejta e qytetarëve të vendit tonë për të zgjedhur lirisht përfaqësuesit e vet në organet e pushtetit, që nga më të ulëtat e deri te më të lartat, që nga këshillat e fshatrave e deri në Kuvendin Popullor, dëshmon për karakterin thellësisht demokratik të rendit tonë shoqëror e shtetëror. Sistemi ynë i zgjedhjeve është nga më demokratikët në botë. E drejta e votimit

të përgjithshëm, të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë nuk është një e drejtë formale, siç ndodh në botën kapitaliste, por një e drejtë reale, e cila zbatohet rigorozisht në jetë pa kurrfarë kufizimesh. Në vendin tonë nuk ka tani klasa shfrytëzuese në fuqi që ta kërcënojnë, ta gënjejnë e ta shfrytëzojnë; në pushtet është vetë populli, prandaj nuk ka se kush të bëjë presion mbi popullin dhe të marrë nëpër këmbë vullnetin e zgjedhësve.

Pushteti ynë është pushtet me të vërtetë popullor. Te ne në fuqi janë vetë masat e gjera punonjëse, me klasën punëtore në krye. Mjetet e prodhimit, fabrikat, kombinatet, centralet elektrike, minierat etj. janë në duart e popullit dhe punojnë e prodhojnë vetëm për popullin; gjithë veprimtaria e harmonizuar e shtetit zhvillohet në interesin e për të mirën e popullit. Pikërisht këtu qëndron karakteri demokratik i rendit tonë shoqëror e shtetëror. Këtu qëndron edhe dallimi rrënjësor i demokracisë sonë socialiste nga e ashtuquajtura demokraci borgjeze, e cila është një diktaturë e egër e pakicës shfrytëzuese kundër shumicës dërrmuese të popullit, ku shteti, ashtu si edhe mjetet kryesore të prodhimit, janë në duart e kapitalistëve e të çifligarëve dhe ku gjithë politika dhe veprimtaria e shtetit u shërben interesave të këtyre klasave. Në vendet kapitaliste ekzistojnë kufizime të shumta, si rezultat i të cilave miliona zgjedhës, në një mënyrë ose në një tjetër, përjashtohen nga pjesëmarrja në votime. Mbi zgjedhësit ushtrohet presion i gjithanshëm, zgjedhjet zhvillohen në kushtet e terrorit, mashtrimit, korrumpimit, falsifikimit e të makinacioneve të shumëllojshme. Borgjezia

imperialiste, për të ruajtur sundimin e saj, është hedhur sot në një sulm të përgjithshëm edhe kundër atyre lirive e të drejtave të cinguar që punonjësit kanë fituar me luftë në vendet e kapitalit. Çdo ditë e më tepër në këto vende forcohen aparatet burokratike ushtarako-policore, përherë e më shumë rriten tendencat për kufizimin e të drejtave të organeve të zgjedhura dhe shtimin e kompetencave të organeve ekzekutive për fashistizimin e jetës së vendit. Bile edhe në rastet kur punonjësit dhe shtresat përparimtare të popullit arrijnë me vështirësi të mëdha të sigurojnë ndonjë fitore në zgjedhjet, borgjezia reaksionare, e mbështetur sidomos nga qarqet ushtarake, i likuidon pa ngurrim rezultatet e zgjedhjeve. E për çfarë demokracie mund të bëhet fjalë në këto kushte, kur sundojnë shfrytëzimi e shtypja më e egër e shumicës së njerëzve nga një grusht kapitalistësh, të cilët kanë në duart e tyre pushtetin? Atje ka «liri dhe demokraci» për kapitalistët, te ne ka liri dhe demokraci të vërtetë për mbarë popullin. Këtu e ka burimin entuziazmi i madh i papërshkrueshëm i masave të gjera të popullit në ndërtimin e socializmit në vendin tonë, këtu e ka burimin besnikëria e madhe që tregon populli ndaj Partisë dhe pushtetit të tij popullor, duke përqafuar dhe duke zbatuar me entuziazëm vijën e drejtë që është përcaktuar nga Partia për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë. Zgjedhjet për Kuvendin Popullor te ne zhvillohen në një atmosferë gëzimi e feste dhe besimi të patundur për të ardhshmen, në një atmosferë pune të frytshme e me rezultate të mëdha që kënaqin të madh e të vogël, në fabri-

ka e në arat e lulëzuara, në çerdhe e në shkolla, që i kënaqin zemrën dhe e bëjnë krenar ushtarin, kufitarin, punonjësin e armës së sigurimit, që vigjilojnë si shqiponja mali ditë e natë që atdheu ynë të jetë i paprekshëm, që populli të jetë i gëzuar dhe të punojë e të krijojë në paqe, që fitoret e tij të mos guxojë dot t'ia prekë armiku, qoftë ky i jashtëm apo i brendshëm.

**NË UNITETIN E POPULLIT TONË, NË BASHKIMIN E TIJ  
MONOLIT RRETH PARTISË SË PUNËS QËNDRON  
BURIMI I TË GJITHA FITOREVE TONA**

Të dashur shokë,

Zgjedhjet e reja të 3 qershorit do ta forcojnë edhe më shumë pushtetin tonë popullor, demokracinë tonë socialiste, që është fitorja më e madhe e historisë, e arritur nga populli ynë nën udhëheqjen e Partisë.

Partia jonë e Punës e ka konsideruar dhe e konsideron pushtetin tonë popullor si armën më të rëndësishme në duart e punonjësve për ndërtimin me sukses të socializmit dhe për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut tonë socialist. Marksizëm-leninizmi na mëson dhe eksperiencia jonë 18-vjeçare ka treguar se, kur populli ka në dorë pushtetin, atëherë ai është i pathyeshëm dhe në gjendje të bëjë mrekullira. Prandaj Partia i ka dhënë kurdoherë një rëndësi të madhe forcimit të gjithanshëm të pushtetit. Ajo ka hedhur dhe hedh poshtë me vendosmëri predikimet e revizionistëve jugosllavë për dobësimin dhe për likuidimin e

shtetit socialist të diktaturës së proletariatit, qysh në kohën e tanishme. Të tilla predikime janë vetëm në dobi të imperialistëve dhe të elementëve të ndryshëm reaksionarë, të cilët nuk i kanë pushuar kurrë orvatjet për minimin dhe përmbysjen e rendit socialist në vendet tona. Sigurisht, këtu nuk është vendi për të bërë teorinë e shuarjes së shtetit, por teoritë që predikojnë dhe vënë në zbatim revizionistët modernë në lidhje me këtë problem kapital, s'kanë asgjë të ngjashme me atë që na mësojnë Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini.

Revizionistët modernë falsifikojnë dhe gënjejnë kur thonë se gjoja, me masat që marrin, ata zgjerojnë demokracinë. Përkundrazi «zgjerimi i demokracisë» do të thotë për ta shtypja e egër e marksistë-leninistëve, besnikë e të palëkundshëm, shtimi i aparateve shtypëse policore dhe ushtarake, korruptimi i rinisë dhe pregatitja e saj për vepra të këqija, krijimi i një shtrese të tërë elementësh të korruptuar si mbështetje të klikave revizioniste, për të degjeneruar pushtetin e partinë, për ta çuar vendin në një kaos ekonomik e politik, për ta vënë nën vartësinë direkte të grupeve të gjera të të privilegjuarve të aristokratizuar dhe, më në fund, nën vartësinë direkte dhe nën kontrollin direkt të monopoleve kapitaliste. Pasqyra e të gjitha këtyre të këqijave të degjenerimit revizionist është Jugosllavia titiste, degjenerim në ideologji, degjenerim në politikë, degjenerim në ekonomi, degjenerim në jetën shoqërore dhe kulturore. Ky është kursi i revizionizmit modern, që në agoninë e imperializmit ka ngritur krye dhe godet muret e çelikta të marksizëm-leninizmit, kërkon të hyjë brenda në çdo vend socialist, kërkon të integrohet



me dredhi, me gënjeshtër, me «rrugë paqësore». Por revizionizmin modern, mashën e imperializmit, agjenturën e tij, nën çdo maskë që do të fshihet, e pret vdekja e sigurt. Marksizëm-leninizmi do të triumfojë mbi çdo armik, siç ka fituar kurdoherë.

Në Kongresin e saj të 4-t Partia theksoi se zhvillimi i shtetit tonë do të bëhet kryesisht në drejtim të forcimit e të zgjerimit të mëtejshëm të demokracisë sonë socialiste. Në kushtet e sotme, kur janë bërë ndryshime të mëdha në strukturën socialo-ekonomike të vendit, kur, pasi ndërtuam bazën ekonomike të socializmit, kemi hyrë në një etapë të re, në atë të ndërtimit të plotë të socializmit dhe kur është ngritur niveli arsimor-kulturor dhe ndërgjegjja socialiste e punonjësve, kërkohet dhe është e mundur një pjesëmarrje akoma më e gjerë e më aktive e masave në tërë veprimtarinë shtetërore e shoqërore për zgjidhjen e detyrave të mëdha të ndërtimit të plotë të socializmit. Për këtë qëllim Partia ngre me forcë që të rriten përgjegjësia, roli dhe kompetencat e organeve të pushtetit shtetëror, e këshillave popullore të të gjitha instancave dhe të perfeksionohet gjithnjë e më shumë aparati shtetëror, të lidhet sa më ngushtë me bazën dhe me masat dhe të luftohet pa mëshirë çfarëdo shfaqje e burokratizmit, duke forcuar disiplinën në punë në të gjitha hallkat e aparatit shtetëror.

Forcimi i pushtetit popullor dhe zgjerimi i demokracisë socialiste janë të lidhura ngushtë me respektimin rigoroz të ligjshmërisë socialiste. Ligjet tona socialiste shprehin vullnetin e popullit, mbrojnë interesat e tij, prandaj ato janë të shenjta e të paprekshme.

Respektimi rigoroz i ligjeve tona nga çdo qytetar dhe nga të gjitha organet e pushtetit tonë popullor është një detyrë e lartë, për zbatimin e së cilës duhet zhvilluar një punë e gjerë edukative dhe duhet ushtruar një kontroll i rreptë nga populli, nga organizatat e Partisë, nga organizatat e masave dhe nga organet përkatëse të shtetit.

Si rezultat i ndryshimeve të mëdha që janë bërë në strukturën socialo-ekonomike të vendit tonë, është forcuar dhe është zgjeruar më tej baza shoqërore e pushtetit tonë popullor, e demokracisë sonë socialiste. Tani te ne nuk ka më klasa shfrytëzuese e shfrytëzim të njeriut prej njeriut. Shoqëria jonë përbëhet tani nga dy klasa mike në aleancë vëllazërore me njëra-tjetrën, nga klasa punëtore dhe nga fshatarësia kooperativiste, si dhe nga shtesa e inteligjencës sonë socialiste, e dalë nga gjiri i popullit, e brumosur me ideologjinë marksiste-leniniste, e cila të gjitha dijet dhe aftësitë e veta i ka vënë në shërbim të popullit e të çështjes së socializmit. Klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste janë sot dy klasa të reja, që ndryshojnë si dita me natën me të kaluarën. Ato jo vetëm janë klasa në fuqi dhe kanë në duart e tyre drejtimin dhe mjetet e prodhimit, por kanë bërë përparime të mëdha edhe në ngritjen e ndër-gjegjes së tyre socialiste, të nivelit arsimor, kulturor e teknik.

Mbi bazën e këtyre ndryshimeve dhe të punës së gjithanshme të Partisë ka lindur uniteti i çeliktë moralopolitik i shoqërisë sonë socialiste, të cilin duhet ta ruajmë si sytë e ballit dhe ta forcojmë dita-ditës. Në unitetin e popullit tonë, në bashkimin e tij monolit e të

pathyeshëm rreth Partisë së Punës, qëndron burimi i të gjitha sukseseve e fitoreve tona, qëndron garancia e ecjes sonë të pandalshme përpara, drejt fitores së plotë të socializmit, dhe më vonë të komunizmit.

Armiqtë tanë janë përpjekur gjithmonë të futin pyka për ta përçarë e për ta minuar unitetin tonë, bashkimin e popullit tonë rreth Partisë së tij të Punës. Por ata kurdoherë kanë dështuar e do të dështojnë me turp. Uniteti ynë është i pathyeshëm, ai ka kaluar nëpër prova të mëdha historike, ai është kalitur në luftë me vështirësitë e pengesat që janë përpjekur të na krijojnë armiqtë. Ky unitet është i pathyeshëm, sepse mbështetet në interesat dhe në qëllimet e përbashkëta të popullit e të Partisë sonë, në bindjen e thellë të masave tona punonjëse, në drejtësinë e vijës së Partisë e të udhëheqjes së saj, në drejtësinë e çështjes për të cilën lufton e punon Partia jonë.

Uniteti i çeliktë i popullit tonë, bashkimi i tij monolit rreth Partisë, si dhe gjithë rendi ynë shoqëror e shtetëror socialist, mbi të cilin është ngritur ky unitet, hedhin poshtë shpifjet e propagandës reaksionare borgjeze dhe të revizionistëve modernë, që i mbajnë ison asaj, se gjoja në Shqipëri nuk ka demokraci, se gjoja të ne mbretëron «regjimi i terrorit», «shkelja e ligjshmërisë socialiste» e të tjera përralla si këto.

Por ne i kuptojmë pse i bëjnë këta armiq të vendit tonë këto shpifje, ata me gënjeshtër duan të mbulojnë krimet dhe terrorin që ushtrojnë në vendin e tyre kundër njerëzve të ndershëm që kundërshtojnë me vendosmëri degjenerimin e fitoreve të popullit, që i kushuan këtij aq gjak e djersë, të fshehin terrorin që ata

ushtrojnë në vendin e tyre ndaj patriotëve që kërkojnë t'i thonë ndal kursit drejt greminës ku sundimtarët e çojnë atdheun e tyre. Ata çirren për të fshehur shkeljet flagrante të ligjshmërisë së tyre në kurriz të mijëra e mijëra qytetarëve të pafajshëm, që vuajnë në burgje, në kampe internimi dhe tortura. Armiqtë e vendit tonë ëndërrojnë me sy hapur dhe predikojnë që ne, siç bëjnë ata në vendin e tyre, nën maskën gjoja të «demokracisë», t'u hapim derën krimeve, vjedhjeve, korrumpimit dhe degjenerimit, t'u hapim dyert e atdheut tonë të shenjtë bandave të spiunazhit dhe të diversioinit të huaj. Ata kërkojnë që ne të mos zhvillojmë dhe të mos kalitim virtytet e larta të popullit tonë, si patriotizmin e zjarritë, burrërinë, ndershmërinë dhe besën tradicionale të shqiptarëve, që të mos kalitim dashurinë e shqiptarëve për njëri-tjetrin, solidaritetin në mes tyre, që të mos forcojmë dashurinë në familje, dashurinë për punë, që të mos e rritim dhe të mos e edukojmë rininë tonë të lavdishme me traditat dhe me virtytet e larta të popullit tonë, të mos e rritim të pastër, të mos e mbajmë larg nga ndyrësitë dekadente të moralit të degjeneruar borgjez, që të mos e edukojmë me ndershmërinë, kulturën socialiste, guximin, besnikërinë dhe frymën internacionaliste. Por më kot e kanë: qentë që lehin nuk na kafshojnë dot. Ata demaskohen në të dyja tablotë, qoftë në atë ndërkombëtare, qoftë në atë kombëtare. Armiqtë mendojnë se, duke lehur nga radiot e tyre jashtë, do ta kthejnë dhe do ta gënjejnë popullin tonë kundër Partisë dhe pushtetit popullor. Por e kundërta ngjet: sa më ndyrë flasin ata nga radiot, aq më tepër egërsohet po-

pulli ynë kundër tyre dhe aq më shumë e forcon ai unitetin, dashurinë dhe besnikërinë ndaj Partisë së tij të shtrenjtë. Dhe kjo s'është as e rastit, as thjesht sentimentale, por është fort e bazuar. Kjo është pjella logjike e vijës kurdoherë të drejtë të Partisë.

Vija e drejtë e Partisë sonë marksiste-leniniste shkëlqen me vepra në të katër anët e Shqipërisë dhe frytet e saj i gëzon i gjithë populli. Politika e drejtë dhe njerëzore e Partisë dhe e pushtetit tonë, drejtësia e thellë dhe zbatimi i drejtë dhe edukues i ligjeve tona, kanë bërë që edhe shumë nga ata që kanë pasë bërë faje ndaj popullit, qofshin këto politike ose shoqërore, tani janë më të kthjellët, fajet u janë bërë mësim, ata kanë ardhur në rrugë të drejtë, në rrugën e ndershmërisë politiko-morale, kanë rilindur dhe tani punojnë e prodhojnë. Ata u bindën, duke parë drejtësinë e Partisë, drejtësinë e popullit, forcën e tij të madhe krijuese; ata panë që Partia nuk i neveriti djemtë dhe bijat e tyre, por u dha dorën, i rriti, i edukoi, i mësoi të duan popullin, të punojnë për mirëqenien e popullit. Tetëmbëdhjetë vjet në regjimin popullor edhe të verbërit iu hapën sytë përpara mrekullive që u bënë në një kohë kaq të shkurtër. Çdo qytetar dhe qytetare e Shqipërisë u lidh, si çeliku me çimenton, me atdheun, me Partinë, me pushtetin, me hallet dhe me të mirat, me brengat e me gëzimet, u mbrujtën njerëzit, u kalitën në punë e në luftë, u arrit ky unitet i pashembullt që ekziston te ne.

Për Shqipërinë tonë të dashur, të vaditur me gjak dhe të lulëzuar me punë e djersë, për Partinë tonë, zemrën e atdheut, është grusht i gjithë populli. Këtë e

tregon jeta, këtë e treguan votimet për Kuvendin Popullor katër vjet më parë, këtë do ta tregojnë votimet e tanishme unanime, zëri i vetëm i të gjithë popullit, për Shqipërinë tonë të re, të popullit, socialiste, të pavdekshme në shekuj. T'u tregojmë armiqve grushtin, të bëjmë pluhur e hi çdo tentativë të tyre kundër vendit tonë. Bashkimin e çeliktë të popullit tonë rreth Partisë ata e quajnë «shovinizëm», «nacionalizëm», mungesë demokracie. Por neve aq na bën, tymi të shkojë drejt. Ç'kuptojnë këta njerëz me «demokraci»? Mos duan vallë ata që, me pretekstin e «demokratizimit», ne të dobësojmë pushtetin popullor, diktaturën e proletariatit dhe të ndodhë ashtu si në Jugosllavi, si mund të ndodhë kudo në qoftë se u lihet fushë e lirë veprimi teorive oportuniste që përhapin sot revizionistët modernë? Mos duan vallë që ne të jemi syleshë ndaj armiqve imperialistë e agjentëve të tyre, që ne të mos luftojmë kundër armiqve e tradhtarëve të popullit, por t'i rehabilitojmë edhe ata që i ka dënuar populli e t'i quajmë «njerëz të mirë» e «patriotë»? Jo, ne nuk harrojmë për asnjë moment se në botë ekziston imperializmi, për të cilin nuk kemi pasur, nuk kemi e nuk do të kemi asnjë iluzion se ai e ka ndryshuar natyrën e tij. Vendi ynë është i rrethuar gjeografikisht nga shtete kapitaliste dhe nga revizionistët jugosllavë, prandaj ne do ta mbajmë gjithmonë lart vigjilencën revolucionare për të mbrojtur lirinë e pavarësinë tonë kombëtare, fitoret historike të popullit tonë, çështjen e socializmit në brigjet e Adriatikut tonë të kaltër. Për të gjitha këto ne do ta forcojmë pareshtur pushtetin popullor, këtë armë të mprehtë të popullit në fuqi.

## SUKSESET TONA JANË TË MËDHA DHE PERSPEKTIVAT QË I HAPEN VENDIT TONË JANË TË SHKËLQYERA

Të dashur shokë dhe shoqe,

Populli ynë shkon në zgjedhjet e 3 qershorit me suksese të mëdha në të gjitha fushat e jetës, i mobilizuar si kurrë ndonjëherë për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 4-t të Partisë dhe detyrat e planit të tretë pesëvjeçar plot besim dhe optimizëm për të ardhshmen e tij.

Periudha e legjislacionit të katërt të Kuvendit Popullor, që është duke përfunduar, mund të quhet një periudhë me të vërtetë historike, gjatë së cilës janë zhvilluar e janë kryer procese të rëndësishme të transformimit e të ndërtimit socialist të vendit tonë.

Rezultati kryesor që kemi arritur, është ndërtimi me sukses i bazës ekonomike të socializmit, vendosja kudo, si në fshat ashtu edhe në qytet, e marrëdhënieve të reja socialiste në prodhim. Tani në vendin tonë është krijuar sistemi i vetëm i ekonomisë socialiste. Një fitore e madhe ka qenë kolektivizimi i bujqësisë para afatit të caktuar nga Kongresi i 3-të i Partisë. Gjatë kësaj etape të parë të ndërtimit tonë socialist është bërë shumë për zhvillimin e forcave prodhuese të vendit, për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit. Rezultati kryesor në këtë drejtim është ngritja e një industrie krejt të re, e cila jep tani gjysmën e prodhimit të përgjithshëm të vendit dhe siguron një pjesë të konsiderueshme të nevojave të zhvillimit të

ekonomisë dhe të popullsisë. Në më pak se 15 ditë ajo prodhon aq sa prodhohej gjatë tërë vitit më 1938. Në goftë se në planin e parë pesëvjeçar u ngritën 150 vepra të rëndësishme kryesisht industriale, në planin e dytë pesëvjeçar u ngritën 250 të tilla.

Dy vitet e fundit, dhe sidomos vitin që kaloi, vendit tonë iu krijuan vështirësi e pengesa të mëdha në realizimin e planeve të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës kombëtare. Ju të gjithë i njihni mirë këto vështirësi e pengesa, i dini sa serioze e të mëdha ishin, i njihni sa të padrejta dhe antisocialiste ishin. Por ju e dini fort mirë se të gjitha ato u kapërcyen e po kapërcen me sukses, se ekonomia jonë nuk ngeci në vend, siç ëndërronin dhe shpresonin ata që na i krijuan këto vështirësi, por përkundrazi, plani i vitit 1961 u realizua më mirë se çdo vit tjetër, ne vazhduam të ecim përpara në rrugën e ndërtimit socialist, nuk i shtrimë dorën asnjëri, aq më pak imperialistëve. Partia dhe populli ynë nuk janë përkulur kurrë, ata kurrë nuk u kanë kërkuar dhe nuk do t'u kërkojnë lëmshë imperialistëve, as nuk do të përkulen përpara vështirësive e pengesave, ata janë kalitur me to dhe kanë dalë gjithnjë fitimtarë. Kjo do të ndodhë edhe në të ardhshmen.

Të frymëzuar nga qëndrimi i vendosur, i drejtë e parimor i Partisë sonë, klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjenca popullore, i gjithë populli ynë trim e i talentuar, iu përgjigj me heroizëm thirrjes së Partisë, u mobilizua si kurrë ndonjëherë tjetër, tregoi vendosmëri e patriotizëm të flaktë dhe çau përpara nën flamurin e Partisë. Në valën e këtij



mobilizimi e entuziazmi lindën shumë iniciativa të mrekullueshme të inxhinierëve, teknikëve e punëtorëve tanë për të prodhuar në vend makineri e pajisje, vegla këmbimi dhe shumë materiale të tjera të rëndësishme importi, bile edhe reparte e fabrika të tëra industriale, siç janë fabrika e pllakave të zdrukthit në Elbasan, reparti për prodhimin e karbitit në Maliq dhe i gazit sulfurik në Durrës, projektimi dhe ndërtimi në vend i një fabrike çimentoje, studimi dhe projektimi i impiantit të parë për prodhimin e sodës kaustike dhe hipokloritit të kalciumit, ndërtimi i motorit të parë diezel «Shqiponja», prodhimi në vend i makinave shirëse, projektimi i fabrikës së pasurimit të bakrit në Kukës etj. Partia dhe Qeveria e përkrahën me të gjitha forcat këtë lëvizje të madhe patriotike. Për këtë qëllim u organizua një konsultim i gjerë popullor, ku u bënë rreth 10 500 propozime të ndryshme, nga të cilat 7 000 janë aprovuar në mënyrë paraprake nga ana e dikastereve qendrore dhe arrijnë një vleftë prej rreth 500 milion lekësh. Vetëm për ngritjen e fabrikave, reparteve e punishteve të reja janë bërë mbi 150 propozime, ndërsa më tepër se gjysma e të gjitha propozimeve janë për prodhimin në vend të shumë makinerive, pajisjeve e pjesëve të këmbimit. Mbi 1 000 propozime janë bërë për prodhimin e mallrave të reja të konsumit të gjerë. Kjo është me të vërtetë diçka që na gëzon, që gëzon të gjithë popullin, dhe na mbush me besim se njerëzit tanë, me duart e tyre të arta dhe mendjet e ndritura, mund të bëjnë me të vërtetë çudira.

Për çfarë dëshmojnë të gjitha këto propozime,

shumë prej të cilave kanë filluar të vihen qysh tani në jetë? Ato dëshmojnë jo vetëm për mobilizimin dhe entuziazmin e punonjësve tanë, jo vetëm për patriotizmin e tyre të flaktë socialist, për vendosmërinë e tyre për ta çuar përpara çështjen e ndërtimit tonë socialist, por edhe për diçka tjetër, gjithashtu shumë të rëndësishme: ato dëshmojnë se ne kemi sot një ekonomi të fortë, një bazë të fuqishme industriale, që është në gjendje të zgjidhë me sukses mjaft detyra të mëdha e të ndërlikuara për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore. Vendi ynë ka sot një industri të zhvilluar dhe të pajisur me një teknikë moderne. Dhe ajo që e karakterizon sot industrinë tonë, ashtu si edhe shumë sektorë të tjerë të ekonomisë, është kalimi nga realizimi i planit kryesisht në sasi, në realizimin e tij edhe në treguesit cilësorë e tekniko-ekonomikë. Krahas me zhvillimin në gjerësi të industrisë, me ndërtimin e veprave të reja industriale tani ka filluar dhe po ecën përpara puna për një shfrytëzim intensiv e në thellësi të industrisë, të kapaciteteve të saj prodhuese, për të zbuluar dhe për të përdorur të gjitha rezervat e saj, që rriten bashkë me rritjen dhe zhvillimin e industrisë e të ekonomisë përgjithësisht.

Kjo lëvizje, që ka marrë me të vërtetë një karakter masiv, dëshmon, gjithashtu, se në vendin tonë janë përgatitur me mijëra punëtorë e kuadro teknikë shumë të kualifikuar, të aftë të zgjidhin probleme të vështira të prodhimit dhe të drejtojnë vepra të mëdha. Mjaf-ton të përmendim këtu projektimet dhe drejtimin e punimeve kryesore nga inxhinierët tanë të hidrocentraleve të Shkopetit e të Bisticës, zbulimin e vend-

burimit dhe projektimin e uzinës së bakrit në Gjegjan të Kukësit, studimet e rëndësishme dhe drejtimin e punimeve në industrinë e naftës e shumë të tjera. Në sektorët kryesorë të ekonomisë sonë punojnë tani 1 840 kuadro të lartë dhe 5 270 kuadro të mesëm. Kjo është një forcë e madhe që i ka dhënë dhe po i jep shumë të mira ekonomisë sonë, i jep siguri në zhvillimin me vrull përpara në vitet e ardhshme.

Jeta ka vërtetuar plotësisht e po vërteton çdo ditë drejtësinë e vijës së Partisë sonë për zhvillimin e ekonomisë, për industrializimin socialist të vendit, si dhe të rrugëve e të metodave që ka ndjekur ajo për zhvillimin e industrisë. Partia dhe Qeveria do t'i kushtojnë edhe në të ardhshmen një kujdes të veçantë zhvillimit të industrisë. Industria është hallka kryesore për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit që është detyra jonë themelore për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Investimet e mëdha në industrinë dhe në minierat tona janë bërë të studjuara mirë nga çdo pikëpamje, ashtu siç bën një nikoqire e mirë. Asgjë s'është ndërtuar kot dhe pa leverdi të madhe ekonomike, s'është ndërtuar ku nuk duhej, larg lëndës së parë dhe pa e siguruar atë kryesisht në vend. Është evituar në maksimum grumbullimi i industrisë vetëm në disa pika, kështu që s'ka mbetur gati asnjë rreth i vendit tonë pa pasur fabrika dhe industri në territorin e tij. Të gjitha rrethet janë gjallëruar dhe gjallërohen çdo ditë e më shumë, po shfrytëzohen nga çdo anë pasuritë e vendit, kudo shumëzohet klasa punëtore, po shumëzohen në çdo rreth e me kritere të drejta e të pandër-

prera inxhinierët, teknikët, specialistët; çdo fabrikë, çdo kombinat, çdo minierë e vendit tonë është e lidhur me transport të rregullt, po modernizohet dhe bëhet rentabël çdo ditë e më shumë. Industria jonë punon me leverdi çdo ditë e më të madhe, rendimenti në punë çdo ditë e më shumë po shtohet, po zhduken çdo ditë gabimet e rritjes, po forcohet drejtimi, organizimi, kursumi. Kujdesi i vazhdueshëm i Partisë e i Qeverisë, bën që industria jonë të mos njohë kriza, qoftë edhe të pënkohshme, të mos njohë anomali të theksuara në prodhim dhe paralelizma të dëmshme. Kjo u detyrohet në radhë të parë punëtorëve, specialistëve dhe inxhinierëve tanë të zotë, të zgjuar, të talentuar dhe patriotë.

Në vitin 1965, në krahasim me vitin 1960, prodhimi industrial do të rritet 52 për qind më shumë. Pesha specifike e prodhimit industrial në prodhimin e përgjithshëm të vendit tonë të arrijë 54 për qind. Gjysmën e prodhimit industrial do ta zërë prodhimi i mjeteve të prodhimit. Një zhvillim të madh në pesëvjeçarin e tretë do të marrë sidomos industria e minierave dhe ajo e përpunimit, me qëllim që të shfrytëzohen më mirë pasuritë minerale të vendit tonë. Do të ngrihen degë të reja të industrisë. Do të ndërtohen 400 vepra të reja, si uzina e metalurgjisë së bakrit në Kukës dhe uzinat e plehrave azotike dhe fosfatike, kombinati i tekstileve të pambukta në Berat, 2 fabrika çimentoje, 3 fabrika letre, do të fillojë puna për ngritjen e metalurgjisë së zezë, si dhe shumë vepra të tjera të mëdha. Të gjitha këto ne i jetojmë, i ndërtojmë, i gëzojmë. Ju të gjithë e keni kurdoherë parasysh planin

e pesëvjeçarit të tretë që vendosi Kongresi i 4-t i Partisë. Një program i tërë madhështor që do të realizohet patjetër me sukses. Te ne do të shtohen burimet e naftës, zhvillimi i hekur-nikelit do të marrë një hov të madh; zona e Kukësit, ku tani së fundi ne vendosëm të ndërtojmë qytetin e ri, është e pasur në bakër, hekur, nikel, krom dhe ndoshta në minerale të tjera të çmueshme. Kjo do të jetë në një të ardhshme të afërt një bazë e rëndësishme minerale e vendit tonë, që e zbuluan dhe do ta ndërtojnë e do ta shfrytëzojnë bijtë e popullit tonë që i rriti e i mësoi Partia. Minierat e kromit e të qymyrit po shtohen e po modernizohen. Një numër i madh gjeologësh, të dalë nga universiteti ynë, u janë qepur maleve dhe gërxheve, për të zbuluar thesare të tjera për popullin, thesare që nuk mungojnë, siç ndodh me zbulimet e para të boksiteve, alumineve në shkrepat e malësive të Veriut, atje ku kërciste në shekuj pushka e malësorëve heroikë, ku gjëmonin krismat e Luanit të Dragobisë, që luftoi për lirinë e shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë, tani rreh çekiçi i gjeologut. Dhe kështu në shumë vende të tjera gjeologët tanë zbulojnë, kimistët tanë manipulojnë, kombinuojnë prodhimet, shtojnë asortimentet. Një e ardhshme e madhe e pret ekonominë tonë edhe në këtë drejtim, për zhvillimin e së cilës po përgatiten në shkollat profesionale e në universitet me mijëra kadro të rinj.

Siç e keni konstatuar edhe vetë, industrisë ushqimore i është vënë gjithashtu një rëndësi e madhe dhe ky kujdes do të shtohet edhe më shumë. Populli ynë jo vetëm që në kohën e sezonit furnizohet me çfarëdolloj

zarzavatesh, frutash si dhe me mish, qumësht, vezë etj. (prodhime këto që nuk i kanë munguar kurrë, as në verë, as në dimër), por, me shumëzimin e fabrikave tona të ndryshme ushqimore, populli do të ketë edhe më me bollëk nga çdo gjë, do t'i ketë të freskëta, të pastra, të ushqyeshme, të shijshme në çdo stinë të vitit. Klima e mrekullueshme e vendit tonë dhe puna e mirë e kooperativistëve na lejojnë dhe na ndihmojnë të furnizojmë me bollëk tregun tonë me zarzavate dhe fruta të hershme, edhe të eksportojmë në vende të tjera.

Krahas me zhvillimin e industrisë, suksese të mëdha janë arritur edhe në sektorin tjetër shumë të rëndësishëm të ekonomisë sonë, në zhvillimin e bujqësisë. Partia dhe Qeveria kanë bërë një punë të madhe për ta nxjerrë bujqësinë nga prapambetja dhe për ta futur atë në rrugën e përparimit. Një kthesë historike në zhvillimin e bujqësisë dhe në gjithë jetën e fshatit tonë ishte kolektivizimi. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në pesëvjeçarin e dytë ishte 25,5 për qind më i lartë se në pesëvjeçarin e parë. Gjatë pesëvjeçarit të dytë u hapën mbi 71 mijë hektarë toka të reja, u mbollën me miliona rrënjë pemë frutore dhe mijëra hektarë vreshta. Sot në fushat tona punojnë me mijëra traktorë e makina të tjera bujqësore. Janë bërë punime të mëdha, sidomos në fushën e bonifikimeve, duke filluar nga Vurgu i Delvinës, Roskovci e Tërbufi e deri në Thumanë e në Zadrinë. Kolektivizimi i bujqësisë dhe sukseset e arritura në shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale dëshmojnë qartë për drejtësinë e rrugës së përcaktuar nga Partia për zhvillimin e bujqësisë. Tani në fshatin tonë janë krijuar kushte të favorshme për

një zhvillim të mëtejshëm të prodhimit bujqësor. Kolektivizimi, veprat e mëdha të bonifikimit, mekanizimi i bujqësisë, ndihmat e shumta të shtetit në kredi, farëra të zgjedhura, plehra kimike e kuadro të kualifikuar, kanë krijuar kushte për të kaluar, në një të ardhshme të afërt, nga një bujqësi ekstensive në një bujqësi intensive, ku rritja e rendimenteve të kulturave bujqësore do të bëhet me ritme më të shpejta se rritja e sipërfaqeve të mbjella. Ky do të jetë një hap i madh revolucionar në zhvillimin e bujqësisë, për të cilin duhet bërë një punë e madhe dhe e gjithanshme nga Partia dhe shteti ynë. Çështja është që të likuadohet disproporcioni që ekziston sot ndërmjet zhvillimit të industrisë dhe të bujqësisë dhe që ekonomia jonë të ecë duke u mbështetur mirë në të dyja këmbët, si mbi industrinë ashtu edhe mbi bujqësinë, pa çaluar asnjëra prej tyre.

Për këtë qëllim është parashikuar që në planin e tretë pesëvjeçar bujqësia të zhvillohet me një ritëm më të shpejtë. Prodhimi bujqësor i pesëvjeçarit të tretë do të jetë 48 për qind më i madh sesa ai i të gjitha viteve të pesëvjeçarit të dytë të marra së bashku. Në vitin 1965 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor do të jetë 72 për qind më i madh se në vitin 1960. Detyra kryesore edhe në pesëvjeçarin e tretë për bujqësinë do të jetë shtimi i prodhimit të drithërave për të siguruar bukën në vend. Krahas me këtë, do të rriten edhe prodhimet e tjera bujqësore e blegtorale. Një zhvillim të madh do të marrë frutikultura.

Për realizimin e detyrave të mëdha e të vështira që kanë përpara punonjësit e bujqësisë, kërkohet që

ata vetë, si edhe organizatat e Partisë dhe organet e shtetit, të luftojnë për të shfrytëzuar dhe administruar drejt, në mënyrë sa më racionale, fondin e tokës, që është mjeti kryesor i prodhimit bujqësor, të përqendrojnë vëmendjen e tyre në prodhimin e drithërave të bukës, të duhanit dhe të kulturave të tjera industriale, si dhe të frutikulturës, e në mënyrë të veçantë të ullirit, të zbatojnë me përpikëri kodin agroteknik, si kusht vendimtar për rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore, dhe të tregojnë kujdes të veçantë për zhvillimin e blegtorisë, duke ngritur, duke zgjeruar dhe duke forcuar fermat blegtorale në kooperativat bujqësore, duke përmirësuar masat zooveterinare dhe duke forcuar bazën ushqimore për bagëtitë.

Politika e drejtë leniniste e Partisë në bujqësi ka korrur suksese të mëdha. Tok me kolektivizimin u përfunduan një numër i madh veprash të bonifikimit dhe të ujitjes dhe janë në përfundim edhe një sërë veprash të tjera të mëdha me karakter kombëtar. Vepra të shumta ujitjeje me karakter rajonal dhe kooperativist janë kryer dhe vazhdojnë e do të vazhdojnë të kryhen edhe në të ardhshmen. Kështu që shpejt do të vijë dita që çdo gjë në këtë drejtim në vendin tonë do të ketë marrë fund. Që tani fushat tona, kodrinat e vendit, lulëzojnë për bukuri, lulëzon bujqësia. Atë e bënë të lulëzojë vija e drejtë e Partisë, krahu dhe mendja e kooperativistëve, e zbukuroi puna e mekanizuar, asaj do t'i japin dorën e fundit fabrikat e plehrave kimike që do të ndërtohen. Qëllimi i Partisë është që bujqësia jonë të kthet në një bujqësi moderne, që t'i japë, dhe do t'i japë me siguri çdo vit e më me bo-



llëk ushqime popullit që nga buka, mishi dhe yndyrnat, deri te domatet dhe frutat e shumëllojshme, që t'i japë dhe do t'i japë me siguri jo vetëm industrisë sonë materialet e para, por edhe të eksportojmë dhe t'i sigurojmë vendit të ardhura nga shitja e tyre jashtë. Njerëzit e bujqësisë, pa përjashtim, duhet t'i qepen bujqësisë, me mish e me shpirt, me dashuri të madhe të mësojnë, të mësojnë agroteknikën moderne dhe ta zbatojnë këtë në kushtet kaq të favorshme që kanë krijuar Partia dhe Qeveria në këtë sektor. Shkolla bujqësore janë hapur në të katër anët e vendit, institute bujqësore, kurse të ndryshme; agronomë, veterinerë, zooteknikë, teknikë të çdo lloji kanë shkuar me shumicë dhe çdo vit do të shtohen nëpër fushat tona. Gjithë ky kolektiv i madh, që punon në këtë «industri të madhe pa çati», të bëjë që këtu të punohet dhe të prodhohet me ritmet, me frymëzimin, me pjekurinë e klasës punëtore. Bujqësia me drithërat e saj dhe bimët industriale, blegtoria, perimet dhe frutikultura të zhvillohen në një bashkësi të harmonishme, të orientohet zhvillimi dhe prodhimi i tyre sipas konditave të çdo rrethi dhe sipas nevojave e leverdisë rajonale dhe nacionale, në mënyrë të tillë që populli të ketë nga çdo anë e vendit tonë çdo gjë që ka nevojë dhe në sasi të mjaftueshme. Kushtet ne i kemi të gjitha dhe do t'ia arrijmë këtij qëllimi plotësisht, pasi ne na ka udhëhequr, na udhëheq dhe na mëson çdo ditë e drejt Partia jonë e lavdishme e Punës. Vetëm duke punuar, ne kemi arritur këto rezultate të mëdha, vetëm me punë do të arrijmë të korrim edhe rezultate akoma më të mëdha se në të kaluarën.

Qëllimi më i lartë dhe detyra më e shenjtë e Partisë dhe e shtetit tonë është ngritja sistematike dhe me ritme të shpejta e mirëqenies së popullit. Këtij qëllimi e kësaj detyre u nënshtrohen te ne gjithë zhvillimi i ekonomisë dhe gjithë veprimtaria e Partisë dhe e shtetit tonë, të cilët nuk kanë interesa më të larta se interesat e popullit. Çdo gjë në vendin tonë bëhet vetëm në interes të popullit e për të mirën e tij. Epërsia e rendit socialist nuk qëndron aq në faktin se ai siguron ritme shumë të larta të zhvillimit të forcave prodhuese, sesa në faktin që ritmet e larta të zhvillimit të forcave prodhuese shoqërohen njëkohësisht me ngritjen sistematike të mirëqenies, jo vetëm të një klase apo të një pjese të vogël të popullsisë, por të të gjithë punonjësve të qytetit e të fshatit.

Si rezultat i zhvillimit të ekonomisë, rritjes së prodhimit industrial e bujqësor, niveli i jetesës së popullit tonë ka ndryshuar shumë në krahasim me të kaluarën. Çdo njeri i moshës së rritur është në gjendje të bëjë fare mirë krahasimin e së sotmes me të djeshmen. Tani janë zhdukur një herë e përgjithmonë nga vatrata tona mjerimi, uria dhe papunësia, pasiguria për ditën e nesërme dhe puna e rëndë prej skllavi për një copë bukë, fëmijët gjysmëlakuriq e kasollet prej kashete dhe shumë të këqija të tjera që shoqëronin dje jetën e njeriut tonë punonjës dhe që ishin pasojë e drejtpërdrejtë e sundimit të bejlerëve e të kapitalistëve dhe e grabitjes së vendit nga imperialistët e huaj. Njerëzit tanë sot rrojnë më mirë, jeta e tyre është bërë e po bëhet dita-ditës më e gëzuar e më e pasur, si nga pikëpamja materiale, ashtu edhe nga ajo shpirtërore.

Të ardhurat kombëtare janë rritur nga viti në vit, është rritur gjithashtu paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve, janë rritur edhe të ardhurat e fshatarësisë. Shpenzimet e shtetit për masat socialkulturore kanë qenë çdo vit më të mëdha. Herë pas here janë bërë uljetë çmimeve të mallrave të konsumit të gjerë, nga të cilat popullsia ka përfituar miliarda lekë në vit. Njëpunë e madhe është bërë sidomos për ndërtimin e banesave. Kudo, në të katër anët e atdheut tonë, në fshatra e në qytete, çdo vit ndërtohen me mijëra shtëpi të reja e apartamente banimi.

Me gjithë sukseset e mëdha që janë arritur në përmirësimin e nivelit të jetesës së popullit, ne jemi plotësisht të ndërgjegjshëm se në këtë drejtim na mbetet akoma shumë për të bërë. Ne nuk mund dhe nuk duhet të kënaqemi me atë që kemi arritur, por duhet të shikojmë gjithnjë përpara. Tani kemi krijuar një bazë ekonomike të tillë, e cila na jep mundësi të shkojmë përpara me ritme më të shpejta. Dhe ne do të arrijmë suksese të reja, do të ecim edhe më shpejt përpara, të bindur se e ardhshmeja do të jetë edhe më e lumtur, edhe më e gëzuar. Për këtë duhet të kryejmë me nder detyrat e mëdha që kemi për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit, për shtimin e prodhimit industrial e bujqësor, për rritjen e rendimentit të punës dhe uljen e kostos së prodhimit.

Mbi këtë bazë, gjatë planit të tretë pesëvjeçar, do të ngrihet edhe më lart niveli i jetesës së popullit tonë. Kështu të ardhurat kombëtare, tri të katërtat e të cilave shkojnë drejtpërdrejt në dobi të punonjësve, do të rriten 56 për qind, paga reale e punëtorëve dhe e:

nëpunësve —30 për qind dhe të ardhurat e fshatarësisë —35 për qind. Rritja e pagës reale do të bëhet si me anë të ngritjes së pagës nominale, sidomos të atyre kategorive të punonjësve që kanë paga të ulëta ashtu edhe nëpërmjet uljes së çmimeve të mallrave të konsumit të gjerë. Do të përmirësohen edhe më shumë kushtet e banimit, për të cilat do të shpenzohen 75 për qind më shumë mjete se në pesëvjeçarin e kaluar. Sipërfaqja e banimit që do të shtohet gjatë pesëvjeçarit të tretë do të jetë sa për 5 qytete të reja si Vlora e sotme. Do të zgjerohen më tej rrjeti i tregtisë e i komunikacioneve, shërbimet komunale, elektrifikimi i qyteteve e sidomos i fshatrave. Kujdes i veçantë do të tregohet për ruajtjen dhe për forcimin e shëndetit të popullit, për zgjatjen e jetës së njerëzve tanë etj.

Një revolucion i vërtetë është kryer në fushën e arsimit e të kulturës. Shqipëria është bërë një shkollë e madhe edukimi e mësimi. Arsimi e kultura janë përhapur në të katër anët e atdheut tonë, deri në skajet më të largëta, duke shpërndarë errësirën e padijen që trashëguam nga e kaluara e duke çuar kudo dritën e diturisë. S'ka dyshim se zhvillimi i arsimit e i kulturës, nga pikëpamja e gjerësisë dhe e përhapjes së tyre në masat më të gjera punonjëse, është një fitore e madhe. Por një rëndësi të veçantë ka fakti që arsimi, kultura, shkenca dhe arti në vendin tonë janë zhvilluar e zhvillohen në rrugë të drejtë, që ata kanë një përmbajtje të shëndoshë socialiste, përshkohen fund e krye nga idetë e marksizëm-leninizmit, janë vënë plotësisht në shërbim të popullit e të ndërtimit socialist. Ata janë ngritur tani në një nivel më të lartë. Në qendrat tona

arsimore, shkencore e kulturore-artistike bëhet tani një punë më e kualifikuar. Kurse nga shkollat tona dalin kuadro më të përgatitur. Sukseset madhështore të popullit tonë në zhvillimin e ekonomisë dhe në gjithë sektorët e tjerë të jetës së vendit janë të pandara nga zhvillimi i arsimit e i kulturës dhe nga cilësia e punës së institucioneve të tyre përkatëse, sepse pa arsim, pa kulturë, as që mund të mendohet ndërtimi i veprave të mëdha të socializmit.

Shprehja më e qartë e revolucionit, që është kryer e po kryhet në fushën e kulturës e të ideologjisë, është lindja dhe formimi i njeriut të ri, i njeriut të shoqërisë sonë të re socialiste, në ndërgjegjen e të cilit po rrënjosen çdo ditë e më thellë botëkuptimi marksist-leninist, normat e moralit komunist, idealet e larta të socializmit e të komunizmit. Socializmi i çliron njerëzit nga shtypja shpirtërore e ideologjisë borgjeze, nga normat e moralit borgjez, sipas të cilit «njeriu për njeriun është ujë», nga psikologjia individualiste e egoiste borgjeze. Figura e lartë morale e njeriut tonë të ri, ndërtues i socializmit, shprehet në qëndrimin e tij socialist ndaj punës dhe jetës, ndaj shoqërisë dhe shtetit, ndaj popullit dhe atdheut. Pikërisht ky qëndrim është bërë tani kriteri bazë për të gjykuar mbi njerëzit në shoqërinë tonë të re.

Tiparet e reja morale të njeriut tonë të ri duken tani në çdo hap të jetës sonë, ato janë mishëruar sidomos në njerëzit tanë të pararojës, në heronjtë e punës socialiste, në novatorët e racionalizatorët e prodhimit, në iniciatorët e lëvizjeve të ndryshme patriotike. Shprehjen më të koncentruar figura e re morale e nje-

rëzve tanë ndërtues të socializmit e ka gjetur në lëvizjen e brigadave të punës socialiste, në flamurin e të cilave është shkruar parulla me një kuptim shumë të thellë: «Të punojmë, të mësojmë dhe të jetojmë në mënyrë socialiste».

Ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste kërkon njerëz me ndërgjegje të lartë socialiste, njerëz të zotë, me kulturë e dije të thella, kërkon njerëz që të zotërojnë shkencën e teknikën. Për këtë qëllim Kongresi i 4-t i Partisë shtroi detyra të mëdha për forcimin e punës ideologjike të Partisë, për përgatitjen e kuadrove për zhvillimin e arsimit e të shkencës, të artit dhe të kulturës. Kryerja me sukses e këtyre detyrave ka një rëndësi të madhe për kryerjen e revolucionit kulturor. Në vitin 1965 ne do të kemi 9 700 kuadro të lartë, nga rreth 5 500 që kemi sot, dhe 35 100 kuadro të mesëm, nga 20 000 që kemi sot. Një zhvillim të madh do të marrë arsimiti popullor, sidomos ai 7-vjeçar e më vonë 8-vjeçar, i cili në dhjetë vjetët e ardhshëm do të bëhet i përgjithshëm e i detyrueshëm. Më 1965 gati një e katërta e popullsisë së vendit do të ndjekë shkollat e kategorive të ndryshme. Vetëm në shkollat e larta numri i studentëve më 1965 do të arrijë në 7 000, pa përfshirë këtu studentët e natës e me korrespondencë. Në këtë mënyrë vendi ynë do të bëhet në të ardhshmen jo vetëm një vend i zhvilluar nga pikëpamja ekonomike, me industri moderne e bujqësi të mekanizuar, por edhe një vend i përparuar nga pikëpamja kulturore, me arsim, shkencë e art të zhvilluar, me një jetë kulturore të pasur.

Ndryshimet e mëdha që janë bërë në jetën e ve-

ndit dhe të popullit tonë, sukseset madhështore që janë arritur në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës sonë kombëtare, reflektohen si në pasqyrë në jetën e kryeqytetit tonë dhe të banorëve të tij. Tirana jonë është bërë sot një qendër e madhe industriale, ekonomike e kulturore. Vendin e prodhimit të vogël zejtar dhe të disa punishteve e fabrikave të vogla e primitive që ekzistonin më parë, e kanë zënë prodhimi i madh industrial, kombinatet, uzinat e fabrikat moderne. Në Tiranë shtrihet një rrjet i gjerë shkollash dhe institucionesh kulturore-artistike. Gati në çdo 3-4 vetë njëri mëson në shkollë. Vetëm studentë të rregullt të ditës të shkollave të larta ka gati aq sa kishte nxënës në të gjitha shkollat e Tiranës më 1938. Qyteti i Tiranës ka sot 60 për qind më shumë mjekë nga sa kishte gjithë Shqipëria më 1938 dhe një numër të konsiderueshëm institucionesh shëndetësore. Tirana është rregulluar e është zbukuruar me kopshte e parqe, me rrugë të reja e të asfaltuara, me ndërtesa e pallate madhështore.

Perspektiva të shkëlqyera i hapen kryeqytetit tonë. Prodhimi industrial i qytetit të Tiranës më 1965 do të rritet 62 për qind kundrejt vitit 1960, ose 34 herë më shumë në krahasim me atë të vitit 1938. Gjatë pesëvjeçarit të tretë në Tiranë do të ndërtohen mjaft objekte të reja industriale e socialkulturore. Madhështor do të ngrihet pallati i kulturës. Do të ndërtohen 5 200 apartamente banimi, në të cilat do të strehohen 30 000 vetë, gati aq banorë sa kishte Tirana disa vjet para luftës. Në bazë të planit rregullues të aprovuar nga Qeveria për një periudhë 15-vjeçare, Tirana jonë do të bëhet me të vërtetë një qytet modern, me rrugë

të bukura e pallate madhështore, me kopshte e lulishte të shumta, me një jetë kulturore të zhvilluar. Një perspektivë e tillë është hapur me kohë kudo në vendin tonë në qytete e në fshatra. Kudo po ndërtohet me ritme të shpejta. Me dhjetëra mijëra shtëpi krejt të reja kanë ndërtuar kooperativistët, ata kanë mercuruar dhe kanë zbukuruar të vjetrat, e kudo me shumicë po ndërtojnë të reja, ndërtojnë shkolla, shtëpi kulture, klube, çerdhe e kopshte, po ndërtojnë jetën e kulturuar në fshatin tonë socialist. S'ka qendër pune ku të mos ndërtohen shtëpi banimi, s'ka qytet të madh ose të vogël, ku të mos ndërtohen shkolla, klube, spitale, çerdhe, kinema, teatro, stadiume. Ky ritëm ndërtimi çdo vit po shtohet. Qëllimi i Partisë dhe i Qeverisë është që qendrat e rretheve të bëhen qytete të socializmit ku punonjësit të kenë apartamentet e tyre, të kenë vendet e dëfrimit e të çlodhjes, të kenë shkollat, konviktet, kinematë e teatrot, t'i kenë rrugët të asfaltuara, parqet të sistemuara, që të pushojnë në mënyrë të kulturuar. Kush shikon tani Durrësin, Fierin, Lushnjën, Korçën, Shkodrën, Vlorën, Gjirokastrën, Elbasanin, Peshkopinë, për të mos i përmendur të gjitha, çdo gjë te ato ka ndryshuar aq sa nuk i njeh, janë zbukuruar. Duhet të arrijmë që njerëzit të shkojnë me gjithë qejf të punojnë në çdo vend, dhe të kërkojnë vetë me insistim të shkojnë të punojnë në rrethe. Fakt është se që tani, me këto ndryshime të mëdha që janë bërë, shumë kërkojnë transferim në bazë, në rreth, në kooperativë. Rrethet, lokalitetet, kooperativat tani i sulmojnë, dhe në vitet e ardhshme, do të shkojnë një numër më i madh kuadrosh stabël, si mësues, agronomë,



mjekë etj. Jeta kërkon ndryshime dhe kultura po përhapet me shpejtësi. Tani për të mos folur për të tjerat, më se 10 000 vajza të reja kanë mbaruar shkollat 7-vjeçare dhe punojnë në kooperativa; punëtorë të rinj në fabrika rrallë gjen pa shkollë 7-vjeçare. Prandaj prej ndërtuesve, arkitektëve tanë që ndërtojnë e zbukurojnë qytetet me godina, me shkolla, me muze, me skulptura etj., kërkohet një punë plot gusto e shije artistike, që të përfaqësojë socializmin dhe zhvillimin e artit tonë kombëtar, çdo gjë që del prej duarve dhe frymëzimit të tyre, të kënaqë masat, të shprehë bukurinë, dëshirat e popullit, çdo gjë të ketë karakterin definitiv, dhe ajo që ndërtojmë sot t'i pëlqejë jo vetëm brezit tonë, por të mos na kritikojnë shumë edhe brezat e ardhshëm, që do të kenë gusto dhe kulturë më të madhe se tonën.

Të tilla janë, në vija shumë të përgjithshme, sukseset tona dhe perspektivat e shkëlqyera që i hapen vendit tonë. Të ardhshmen tonë ne e shohim në planet madhështore të Partisë dhe të shtetit tonë. Këto plane nuk janë aspak ëndërrime e fantazira, siç kanë shpifur e shpifin armiqtë tanë. Planet dhe perspektivat tona janë të bazuara në studime të thella, ato mbështeten në mundësitë tona reale, në forcën e ekonomisë sonë, në burimet e pasuritë e vendit tonë, në punën krijuese të popullit tonë, në aftësitë drejtuese të kadrove tanë dhe në ndihmën internacionaliste e vëllazërore të miqve tanë. Planet tona nuk janë premtime boshe, siç bëjnë kandidatët për deputetë në vendet kapitaliste, për të mashtruar zgjedhësit e për të marrë votat e tyre. Planet tona mbështeten në ligjet e zhvi-

llimit ekonomik të shoqërisë sonë dhe janë të garantuara materialisht. Ato shprehin dëshirat e aspiratat e popullit tonë dhe realizohen në jetë. Partia dhe Qeveria jonë nuk i kanë ndarë dhe nuk i ndajnë kurrë fjalët nga veprat. Te ne zbatohet plotësisht parulla: «Ç'thotë Partia bën populli dhe ç'do populli bën Partia».

Të dashur shokë dhe shoqe,

Populli ynë, ndonëse është një popull i vogël, e ka mendimin dhe pikëpamjet e veta në problemet ndërkombëtare që preokupojnë njerëzimin. Populli shqiptar ka të drejtë të rrojë i lirë, independent, sovran me të gjitha të drejtat që gëzon çdo popull dhe çdo shtet, i madh ose i vogël qoftë ky. Në qoftë se ndokush dyshon për këtë, ne i themi: le të shfletojë historinë shekullore të popullit tonë, dhe do të bindet se si i kemi fituar këto të drejta. Në qoftë se ndokush mendon si i marrë të na i shkelë këto, ose të tentojë të na i rrëmbejë, ne i themi përsëri: Në qoftë se nuk dëshiron të mbytesh në gjak, lexo historinë e lavdishme të popullit tonë dhe do të të shërbejë si një dush i ftohtë që të të shkaktojë mornica në trup. Në çdo kohë, edhe në ato më të errëtat, stërgjyshërit dhe gjyshërit tanë, me këtë gjuhë kanë folur me shtypësit e tyre të egër, plumba ballit u kanë dhënë për të fituar dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre, për të mbrojtur këtë popull dhe këtë dhë; ne, bijtë e nipërit e tyre, ndjekim me besnikëri gjurmët e tyre të lavdishme, mbrojmë atdheun, mbrojmë popullin, mbrojmë të drejtat e tij, që populli ynë të rrojë me dinjitet

nën këtë diell e në këtë botë, që s'është monopoli i kurrkujt, duke qenë monopoli i të gjithëve.

Tani ne jemi më të fortë se ç'kanë qenë gjyshërit tanë, jemi më të organizuar nga çdo pikëpamje, kemi një shtet të fuqishëm ku populli është në fuqi, na udhëheq një Parti e lavdishme marksiste-leniniste, Partia heroike e Punës. Shqipëria është sot një vend socialist i përparuar dhe i lulëzuar nga çdo pikëpamje. Populli shqiptar i ka njëqindfishuar aftësitë e tij fizike, mendore, kulturore, shpirtërore, ushtarake. Traditat e lashta të popullit tonë, të burrërisë, të ndershmërisë, të guximit, të shpirtit luftarak për liri, u shprehën me një forcë të pashembullt dhe u ngritën në një shkallë më të lartë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë, që është lufta më e lavdishme e më e madhe që ka bërë populli ynë gjatë gjithë historisë së tij. Viganët partizanë i zhvilluan më tej këto tradita dhe ngritën më lart frymën e Gjergj Kastriotit, të Naim Frashërit etj., që frymëzojnë edhe sot popullin tonë, ashtu si do të frymëzojnë në shekuj brezat e ardhshëm të tokës shqiptare.

Përse rroku armët Partia dhe populli ynë, përse u derdh gjithë ai gjak? Për të fituar lirinë, independencën, për të sjellë për popullin ditën e sotme të bukur dhe ditë akoma më të bukura në të ardhshmen. Luftuam, se ndryshe s'vinte kjo ditë, rrugët e tjera na ishin mbyllur nga shtypësit. Luftuam me konsekuencë të frymëzuar nga nevojat jetike, nga aspiratat e zjarrra të popullit, luftuam me flamurin e papërkulur të Partisë, të marksizëm-leninizmit, prandaj fituam. Pse ne themi një të vërtetë të tillë të madhe, të pamohuesh-

me, reale, kanë dalë njerëz, revizionistë, me në krye Hrushovin dhe Titon, që duan të rishkruajnë së prapthi historinë, që duan të errësojnë të kaluarën heroike, që duan të futin botën socialiste në qorrsokak. Ata na quajnë «dogmatikë», «sektarë», «nacionalistë», mbi të gjitha ata na quajnë stalinistë, duke menduar se po na poshtërojnë. Ata udhëheqës mendjeshkurtër ose që kanë tradhtuar, si Hrushovi me shokë, mund të mendojnë se «udhëheqja e tyre është diçka tejpamëse», por që në fakt nuk sheh, ose bën sikur nuk sheh që po i digjet shtëpia dhe tymi ka shkuar në qiell.

*Pastaj, pasi foli për disa probleme të zhvillimit botëror, siç janë ato të luftës e të paqes, të çarmatimit, të prirjes për luftë që ka imperializmi me atë amerikan në krye, e për shërbimet që i sjellin imperializmit revizionistët modernë, me pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre antimarksiste etj., shoku Enver Hoxha tha:*

Të dashur shokë dhe shoqe,

Shqipëria socialiste është një shtet paqedashës, liridashës, dhe që me përpjekjet e me qëndrimet e drejta politike të saj merr pjesë në zhvillimin e ngjarjeve në botë, dhe kontribuon në forcimin e lëvizjes komuniste në botë, në ruajtjen e paqes dhe të progresit shoqëror. Shqipëria është një shtet i vogël, që e respektojnë shtetet socialiste e ato demokratike përparimtare, të gjithë njerëzit e thjeshtë dhe të ndershëm të botës, dhe kjo gjë ndodh jo pa arsye. Imperialistët dhe revizionistët modernë e kanë halë në sy Shqipërinë. Por kjo armiqësi e tyre, kundër popullit dhe Repu-

blikës sonë, e ngre akoma më lart respektin dhe shton dashurinë e botës ndaj vendit tonë, që lufton me guxim e trimëri kundër planeve të imperializmit e të revizionizmit modern.

Ç'c shtyn Partinë tonë të flasë me një guxim, me një besim kaq të madh, me një qartësi shembullore? E shtyn bindja e saj e plotë, e palëkundshme në drejtësinë e vijës së saj, mbrojtja e një çështjeje të madhe kombëtare dhe ndërkombëtare, mbrojtja e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, që i dha kaq fitore popullit tonë, që i siguroi atij në shekuj lirinë, pavarësinë, socializmin dhe të ardhshmen e ndritur të komunizmit. Rrugë tjetër s'ka, rrugë tjetër do të thotë të humbasësh për popullin këto fitore. Partia kurrë nuk mund të tradhtojë popullin dhe as populli partinë e tij, që e shpëtoi. Këtu qëndron besimi dhe trimëria e Partisë dhe e popullit tonë, dhe kjo shprehet në unitetin e çeliktë në mes popullit shqiptar dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Këtë na e kanë zili armiqtë, këtu përpiqen të na godasin, por këtu kanë thyer dhe do të thyejnë kokën. Ata njerëz që mendojnë se ne kështu do të rrojmë të vetmuar, gabohen, sepse kjo është ide e huaj për Partinë tonë. Antimarksistët, revizionistët modernë, janë ata që thonë se «mund të rrojmë dhe vetëm», «ne jemi shtete të mëdha dhe s'kemi nevojë as për ty, as për atë». Sigurisht, kur ata shfaqin të tilla mendime, udhëhiqen nga idetë e shovinizmit të shtetit të madh, ata vënë në dukje idetë e tyre përçarëse dhe antiinternacionaliste. Kjo është shprehje e avancuar e polarizimit të revizionizmit modern, jo vetëm si rrymë, por si forca shtetërore për të luftuar marksizëm-lenin-

nizmin si ideologji krijuese revolucionare dhe si realizime të shkëlqyeshme në jetë.

Jo, Shqipëria socialiste, as ka rrojtur, as do të rrojë kurrë e izoluar, përkundrazi ajo është e lidhur me miqtë e saj të vërtetë, si kurrë ndonjëherë tjetër. Shqipëria ka miq me kokë e besnikë në të gjithë botën.

Në radhë të parë, populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë ka te populli vëlla kinez, te Partia e lavdishme Komuniste e Kinës dhe te shoku Mao Ce Dun, miq shumë të dashur e besnikë, të ditëve të mira dhe të këqija. Kjo miqësi, e bazuar në marksizëm-leninizmin, po lulëzon dhe po kalitet në interes të të dy popujve tanë dhe të të dyja partive tona, në interes të socializmit dhe të komunizmit ndërkombëtar, në interes të paqes botërore. Distanca në shekullin e leninizmit nuk luan rol të madh, ajo u mund përgjithmonë qëkur fitoi marksizëm-leninizmi në një sërë shtetesh të mëdha e të vogla në të gjithë botën, qëkur u krijua në botë dhe u konsolidua e po konsolidohet çdo ditë lëvizja komuniste botërore. Prandaj, çështja se gjoja Shqipëria e vogël ose Kina e madhe u izoluan, është si ato përrallat e gjyshes për të vënë në gjumë kalamajtë.

Dikur Bismarku, i ashtuquajtur i kancelari i hekurt, mund t'i shqelmonte lehtë rivendikimet e drejta «të barinjve injorantë të maleve të egra të Shqipërisë», që rronin në shpella ose në kasolle prej kashte, siç thoshte ai, mund me një të rënë të shpatës t'i shkëpuste aldheut tonë pjesë të trupit të tij, Kosovën, dhe t'ua jepte të tjerëve, por tani në shekullin e leninizmit kancelarëve dhe mareshalëve u është thyer dhe do t'u

thyhet shpata po ta ngrenë. Aventurierëve imperialistë, këtyre luftënxitësve të tërbuar, forcat e paqes dhe të socializmit duhet t'u presin seriozisht oreksin e aventurave të përgjakshme, t'u ndalin dorën kriminale sa s'është vonë, sepse kushdo që mendon se na frikëson me shantazhin atomik, për të na skllavëruar, ka humbur logjikën, s'ka mësuar asgjë nga Lufta e Dytë Botërore.

Të dashur shokë,

Për komunistët e gjithë botës është bërë e qartë se revizionizmi modern aktual është bërë sot një armë e helmatisur në duart e imperializmit dhe kapitalizmit botëror, për të dëmtuar socializmin triumfues, për të krijuar përçarje, për t'u futur në çdo vend të kampit socialist dhe në lëvizjen komuniste botërore, në mënyrë paqësore, për ta minuar dhe dobësuar atë dhe për t'i lehtësuar imperializmit rrugën e luftës, kundër socializmit dhe komunizmit, kundër popujve që luftojnë për çlirimin e tyre nacional. Klikat revizioniste në botë po koncentrohen, po zbutin kontradiktat në mes tyre, po rregullojnë dhe harmonizojnë planet strategjike dhe taktike të tyre, po mbështesin dhe po lajnë shoqi-shoqin, po rregullojnë maskat e grisura. Me imperializmin amerikan disa mbajnë lidhje të hapura, disa po i afrohen me kujdes, por pa ngurrim, gjoja sikur bëjnë tregti dhe marrin kredi të mëdha prej tij, disa të tjerë e kanë shuar luftën politike dhe ideologjike kundër imperializmit dhe përdorin ato formula stereotipe, që as ndezin as shuajnë, por që mendojnë ata se ju mjaftojnë

për të fshehur fytyrën e vërtetë, kurse disa të tjerë, akoma më të rrezikshëm, po mjaftohen me «*zheremi-ada*» ndaj imperializmit amerikan, kanë rënë në gjunjë, nanurisin Kenedin dhe paqja e tyre është bërë si Jerusalemi i profetit Jeremi.

Marksistë-leninistët nuk mund të mos kenë parasysh veprimtarinë shumëvjeçare të revizionistëve jugosllavë, lidhjet e tyre të ngushta me imperializmin amerikan, nuk mund të harrojnë komplotet e diversionet e panumërta të tyre kundër vendeve të demokracisë popullore dhe partive komuniste e punëtore të këtyre vendeve, dhe të të gjithë botës. Revizionistët jugosllavë formuluan planin e tyre të veprimit botëror në programin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, dhe ky program është bërë udhërrëfyesi i revizionizmit modern kundër marksizëm-leninizmit. Revizionizmi modern i ka rrënjët mbi ujë, ai është armik i papajtueshëm i komunizmit dhe i masave të gjera të popujve që përkrahin komunizmin dhe partitë marksiste-leniniste, prandaj ai është një fenomen i përkohshëm, ai është një çiban me qelb, që do ta zhdukë bisturia e operatorit, dhe ky operator e ka dorën të sigurt e të fortë për të tilla operacione që nuk e lejon plagën të gangrenizohet, ky operator me eksperiencë është marksizëm-leninizmi.

Por koha ka ardhur që komunistët në botë të reflektojnë thellë dhe të veprojnë në mënyrë revolucionare ndaj kësaj sëmundjeje të ndytë që është revizionizmi, dhe të mos ta lejojmë këtë plagë në trupin tonë të shëndoshë të majiset. Kemi të gjithë, vend i madh ose i vogël qoftë, përgjegjësi historike përpara popujve, që shpresojnë te ne, kemi detyra të rënda që duhet t'i plo-



tësojmë, pa marrë parasysh asnjë sakrificë; kemi parimet që na ndritin rrugën tonë të drejtë, parimet e marksizëm-leninizmit.

Këto parime duhet jo vetëm t'i lexojmë, por t'i lexojmë drejt dhe jo së prapthi, njëkohësisht t'i zbatojmë me rigorozitet dhe jo t'u bëjmë bisht. Për t'u bërë bisht ligjeve kriminelit dhe avokati i tij mbrojtës shpik një mijë arsye, sajon një mijë rrena e shpifje për të vënë në gjumë gjykatësit, ata përdorin demagogjinë, lajkat, ryshfetet, kërcënimet e çfarëdolloj poshtërsie. Por kur gjykatësi është i drejtë, i guximshëm, i pakorruptueshëm, kur ai është vigjilent dhe revolucionar i vendosur, i kupton të gjitha këto dredhi, i demaskon, i shqelmon dhe u jep dënimin e merituar. Pra revizionistët modernë duhen vënë në bankën e të akuzuarve përpara gjykatësve të tillë të guximshëm marksistë-leninistë të vërtetë. Revizionistët modernë kanë frikë nga gjyqet revolucionare, kjo është frikë e vjetër që u ka hyrë në palcë borgjezisë dhe shërbëtorëve të saj. Ajo i ka quajtur me kohë këto «terror», por për vete të saj, ajo mund t'i lejojë vetes «termidore», «genocide», «Luftë të Parë e të Dytë Botërore», «Algjeri» dhe «Lumumba», «Angolë» dhe «kanal të Suezit», mund t'i lejojë vetes «Hiroshima» dhe të përgatitë në heshtje, në pseudopaqe, Hiroshima të tjera.

Sa gjak është derdhur në botë nga të njëjtat bisha të egra imperialiste, që përgatitin kasaphana të reja. Kur njerëzit e guximshëm dhe të drejtë në botë ngriheshin me armë në dorë për t'u mbrojtur, për të fituar lirinë dhe të drejtat e tyre, s'mungonin renegatë që të tradhtonin kauzën e shenjtë të popujve, s'mungonin

Kautskët të ngriheshin kundër marksizëm-leninizmit, s'mungonin Trockët e Buharinët të ngriheshin kundër Stalinit dhe Partisë Komuniste Bolshevike dhe t'u përgatitnin kalanë nga brenda imperialistëve, që përgatitnin sulmin kundër Bashkimit Sovjetik. Kishte boll pacifistë borgjezë që llomotitnin, që bënin llogje, që nanurisinin për të vënë masat në gjumë dhe, kur pëlciste katastrofa, ata i gjeje në radhët e shovinistëve të tërbuar për të mbrojtur të drejtat e borgjezisë së tyre.

Borgjezia ka ligjet e egra të saj, ajo ka historinë e saj, dhe këndeje ajo nxjerr mësim, për të vepruar. Në ç'moment ajo nxori mësim nga disfatat e saj, në ç'moment ajo vuri mend nga pësimet dhe dha shenjat se ajo ndryshoi natyrë? Në asnjë moment. Ëndrra e saj të sundojë botën, oreksi i saj për gjak dhe pasuri me gjithë humbjet kolosale, në fushat e betejave të historisë, nuk janë shuar, ajo ëndërron për revanshe. Prandaj s'mund të gënjehen komunistët e botës, patriotët e njerëzit përparimtarë, përpara manovrave, demagogjisë, dhe përgatitjes për luftë të imperialistëve amerikanë dhe të satelitëve të tyre. Njerëzit e ndershëm në botë duhet ta kenë të qartë se revizionistët modernë kanë si qëllim të tyre të shuajnë vigjilencën revolucionare të njerëzimit përpara rrezikut kërcënues atomik imperialist, ata synojnë në përçarjen ideologjike dhe politike të lëvizjes komuniste botërore, ata gjoja, duke folur për paqen, kërkojnë të frikësojnë hovin ngadhënjimtar të revolucionit, ata flasin gjoja për lirinë e popujve që luftojnë për independencë, por me veprimet e tyre nën rrogoz ata dobësojnë këtë popuj, i pengojnë dhe përpiqen të degjenerojnë regji-

met demokratike që porsa kanë fituar mbi kolonializmin. Të tillë punë bëjnë dhe do të bëjnë kurdoherë revizionistët jugosllavë dhe grupi revizionist i Hrushovit.

Revizionistët jugosllavë nuk i kanë mirë punët as brenda vendit të tyre. Për t'u shfaqësuar për katastrofën ekonomike dhe politike të «socializmit specifik», Titoja nuk mungoi të kërcënojë, të qortojë, të tregohet sikur gjoja do të marrë masa ndaj shkaktarëve të këtyre katastrofave të brendshme. Por të gjithë e dinë se kush është fajtori dhe përgjegjësi. S'do të jetë aspak e çuditshme që një mëngjez kjo demagogji e grupit titist të marrë akoma më shumë ngjyra, bile edhe më «dramatike», duke mënjanuar një ose dy eksponentë që gjoja janë fajtorë, dhe këta «fajtorë» t'i çojë përkohësisht në «internim» të artë. Po pse këta revizionistë duan të bindin të tjerët, se gjoja grupi i Titos po ndërron rrugë, kurse grupi i Beogradit s'lajthit kurrë të thotë se ka hequr një presje nga plani dhe programi i tij. Është më mirë të thuhet se janë ata që venë te Titoja, dhe jo Titoja te ata. Në këto kohëra të vështira për imperializmin dhe revizionizmin modern grupi i Titos është më adapti për tratativë revizioniste. Por partitë komuniste e punëtore të botës, komunistët në botë, duke u mbështetur fuqimisht në deklaratat e Moskës, do të vazhdojnë më me fuqi ta demaskojnë revizionizmin modern që është rreziku kryesor për lëvizjen komuniste botërore, do t'ia çjerrin maskat revizionizmit jugosllav dhe padronit të tij imperializmit amerikan, do t'ia djejin në dorë të gjitha kartat.

Të dashur shokë,

Zgjedhjet e reja të deputetëve për në Kuvendin Popullor po zhvillohen në kushtet, kur prej afro dy vjetësh grupi revizionist i N. Hrushovit zhvillon një fushatë të tërbuar kundër Partisë dhe vendit tonë. Kjo fushatë sulmesh, shpifjesh e veprimesh armiqësore të padëgjuaara kundër Partisë sonë të Punës dhe Republikës sonë Popullore është pasojë logjike e tërë vijës revizioniste e antimarksiste të N. Hrushovit, është një nga shfaqjet më konkrete e më të hapura të qëllimeve dhe të metodave të tij për t'i imponuar kampit socialist dhe gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare vijën e tij oportuniste. N. Hrushovi mendonte se Partia jonë e Punës, si Parti e një vendi të vogël socialist, do t'i nënshtrohej dhe, duke goditur e nënshtroar atë, do të mund të vazhdonte më lehtë punën e tij për të nënshtroar të gjitha partitë e tjera komuniste e punëtore, për t'u diktuar atyre vullnetin e pikëpamjet e tij revizioniste.

Por N. Hrushovi gaboi rëndë. Ai nuk mundi të njihte Partinë dhe popullin tonë heroik. Partia dhe populli ynë, të bashkuar si një trup i vetëm, u bënë një mur i pakapërcyeshëm për N. Hrushovin dhe grupin e tij. Ai gjeti në Shqipëri një Parti të fortë, që qëndron e palëkundur në pozitë revolucionare të marksizëm-leninizmit, që nuk i trembet syri, që nuk bën lëshime në parimet, që nuk di t'i kthejë armikut shpinën dhe të gjunjëzohet para tij, sado i fortë e i madh qoftë. Në Shqipëri, N. Hrushovi gjeti një popull trim e të papërkulur, të lidhur si mishi me koskën me Partinë e

tij, që për çështjen e socializmit është gati të bëjë çdo sakrificë, të përballojë çdo pengesë e vështirësi. Me një fjalë i ngeci sharra në gozhdë, jo vetëm nuk ua arriti qëllimeve të tij djallëzore, por u demaskua keq në sytë e komunistëve të të gjitha vendeve, të popujve të ndryshëm dhe të njerëzve përparimtarë në botë.

E çfarë nuk bëri N. Hrushovi kundër Partisë sonë! Përdori të gjitha mjetet, por të gjitha u kthyen kundër tij. Në fillim u përpoq ta bashkëradhiste Partinë e Punës të Shqipërisë me vijën e tij oportuniste e antimarksiste; pastaj bëri çmos për t'ia mbyllur gojën, që të mos ngrinte zërin e të kritikonte atë për pikëpamjet revizioniste dhe veprimet e tij të palejueshme ndaj Partisë e vendit tonë, më vonë, kur pa se këto përpjekje nuk patën sukses, u orvat ta gjunjëzonte e ta nënshtrointe me anë presionesh e bllokadash ekonomike, politike e ushtarake të pashembullta deri sot në marrëdhëniet midis vendeve socialiste; më në fund, duke e sulmuar publikisht nga tribuna e Kongresit të 22-të të PK të BS, duke prerë marrëdhëniet diplomatike me RP të Shqipërisë dhe duke bërë thirrje të hapura për kundërrivolucion, për përmbysjen e udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit tonë, deshi ta likuidonte atë ose në pamundësi për t'ia arritur kësaj, ta izolonte Partinë dhe vendin tonë në arenën ndërkombëtare.

Por të gjitha këto plane dështuan. Tani këtë e sheh e gjithë bota. Ai nuk mundi ta largojë Partinë e Punës të Shqipërisë nga rruga e saj e drejtë marksiste-leniniste, nuk mundi ta nënshtrojë, as ta likuidojë, as ta izolojë; Kongresi i 4-t i Partisë sonë i dha N. Hrushovit një grusht të fortë. Duke ruajtur të paprekur dhe

duke aprovuar plotësisht vijën marksiste-leniniste të Partisë, Kongresi i 4-t shprehu me forcë unitetin e pashmë dhe vendosmërinë e papërkulur të Partisë sonë të Punës për të ecur përpara në rrugën e saj të drejtë. Koha ka vërtetuar plotësisht drejtësinë e vijës së Partisë sonë si për çështjet e ndërtimit socialist në Shqipëri ashtu edhe për çështjet e zhvillimit të sotëm botëror, të qëndrimit e të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Jeta ka treguar në mënyrë më të qartë se në vlerësimin e gjendjes ndërkombëtare dhe në konkluzionet që duhen nxjerrë prej saj kanë të drejtë Partia e Punës e Shqipërisë, Partia Komuniste e Kinës dhe partitë e tjera që qëndrojnë në pozitë e marksizëm-leninizmit dhe jo revizionistët modernë, grupi i N. Hrushovit me pasuesit e tij.

Grupi i N. Hrushovit bëri orvatje të shumta për të penguar e për të sabotuar ndërtimin e socializmit në Shqipëri, për të dobësuar edhe fuqinë mbrojtëse të atdheut tonë. Por vështirësitë që na krijoi N. Hrushovi u kaluan dhe do të kalohen me sukses. Punonjësit tanë janë mobilizuar tani si kurrë ndonjëherë tjetër për realizimin e planeve në industri, në bujqësi dhe në gjithë sektorët e tjerë të jetës së vendit. Presioneve e bllokadave ata iu përgjigjën me një vrull të ri në punë. Sido që të bëjë N. Hrushovi, ai nuk mund ta ndalë dot ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Planet tona të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës kombëtare do të realizohen me sukses. Për këtë ne kemi edhe ndihmën e miqve tanë, sidomos të popullit të madh kinez dhe të Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës, që, të frymëzuar nga ndjenjat e larta të internacionalizmit prole-

tar, i kanë dhënë dhe po i japin popullit tonë një ndihmë të madhe, të pakursyer e vëllazërore.

Dështuan, gjithashtu, orvatjet e grupit të N. Hrushovit për të dobësuar fuqinë tonë mbrojtëse. Liria e pavarësia e atdheut tonë janë të sigurta. Në roje të tyre qëndron populli ynë trim e liridashës, qëndron ushtria jonë heroike e pajisur me të gjitha mjetet moderne të teknikës ushtarake. Me ne janë popujt e të gjitha vendeve socialiste. Ne kemi solidaritetin ndërkombëtar të punonjësve të të gjitha vendeve, të njerëzve përparimtarë në botë. Pozita jonë ndërkombëtare është sot më e fortë dhe më e qëndrueshme se kurrë.

Lufta e drejtë parimore e Partisë sonë kundër grupit revizionist të N. Hrushovit, qëndrimi i saj burrëror dhe i vendosur përpara presioneve e provokacioneve më të egra, gjakftohtësia dhe urtësia e Partisë dhe e popullit tonë kanë bërë që Partisë sonë t'i rritet autoriteti dhe prestigji në sytë e komunistëve të mbarë botës, përpara lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Për këtë dëshmojnë qartë qindra e qindra letra që Komiteti ynë Qendror ka marrë nga komunistë e kuadro udhëheqës të partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme të botës, në të cilat ata aprovojnë plotësisht qëndrimin tonë, dënojnë pikëpamjet revizioniste e veprimet antimarksiste të N. Hrushovit, shprehin solidaritetin e tyre me luftën e Partisë sonë. Komunistët po e kuptojnë gjithnjë e më mirë rrezikshmërinë që përfaqëson për kampin socialist e për lëvizjen komuniste ndërkombëtare grupi revizionist i N. Hrushovit, dëmin e madh që po i sjellin pikëpamjet dhe metodat e tij çështjes sonë të madhe — luftës kun-

dër imperializmit për triumfin e socializmit e të komunizmit. Pozitat e drejta marksiste-leniniste i mbrojnë tani me vendosmëri jo vetëm Partia jonë e Punës dhe Partia Komuniste e Kinës, por edhe shumë parti të tjera. Disa parti akoma lëkunden por zhvillimi i ngjarjeve do t'u hapë sytë. Bile edhe në ato parti, ku udhëheqësit janë partizanë të vijës së N. Hrushovit, komunistët nuk i aprovojnë veprimet e N. Hrushovit dhe të udhëheqësve të tyre kundër vendit tonë.

Lufta e drejtë parimore e Partisë sonë kundër grupit të N. Hrushovit, qëndrimi i drejtë e i vendosur i Partisë Komuniste të Kinës dhe i partive të tjera që mbrojnë pozitat parimore të marksizëm-leninizmit dhe vetë zhvillimi i ngjarjeve në botë kanë forcuar edhe më tej pozitat e marksizëm-leninizmit revolucionar në radhët e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe kanë demaskuar vijën dhe veprimet e grupit revizionist të N. Hrushovit. Faktet flasin qartë se grupi i N. Hrushovit ka marrë të tatëpjetën dhe ngjarjet në këtë drejtim po rrokullisen me një shpejtësi të madhe. N. Hrushovi dhe pasuesit e tij janë vënë tani në pozita të vështira. Por është e qartë se ai, si revizionist i ndër-gjegjshëm, nuk heq dorë nga rruga e tij e tradhtisë dhe nga veprimet e metodat e tij përçarëse, në dëm të unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Prandaj përpiqet të manovrojë. Ndërsa nga një anë vazhdon me këmbëngulje politikën e tij oportuniste dhe puqet hapur me klikën e Titos, siç e patë këtë nga fjalimi që mbajti në Varna të Bullgarisë, ku u tha se marrëdhëniet e Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë tani janë të mira, foli për rolin e Jugosllavisë në



Ballkan dhe për nevojën e marrëdhënieve të gjithanshme me revizionistët jugosllavë, nga ana tjetër, i detyruar nga gjendja e vështirë dhe presioni gjithnjë më i fortë i partive komuniste e punëtore që kërkojnë rivendosjen e unitetit, bën përpjekje për të dalë me flamurin gjoja të unitetit, me qëllim që të fitojë kohë, të arrijë një farë pushimi për të mashtruar partitë komuniste e punëtore dhe të përgatitë goditje të reja kundër unitetit.

Në këto kushte Partia jonë si dhe gjithë partitë e tjera marksiste-leniniste do të luftojnë për të mbajtur lart flamurin e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, duke demaskuar manovrat taktike të N. Hrushovit, për t'i çjerrë këtij maskën e pseudounitetit, që kërkon ta përdorë për goditje të reja përçarëse kundër lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Duke marrë parasysh dëshirat e shprehura nga disa parti që qëndrojnë në pozita të drejta marksiste-leniniste, Partia jonë ka pranuar që në një periudhë të parë të ndërpriten kritikrat e sulmet publike në shtyp e radio ndaj N. Hrushovit. Edhe pa e zënë në gojë përkohësisht emrin e këtij revizionisti, pozitat e Partisë sonë janë sot aq të forta, sa që kjo nuk na shkakton ndonjë dëm. Kjo do të jetë edhe një provë nëse N. Hrushovi do të njohë gabimet e tij të rënda ndaj lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe ndaj Partisë e vendit tonë. Por ne, shokë, jemi të bindur se N. Hrushovi nuk do t'i pranojë gabimet, nuk do të bëjë autokritikë, ai nuk do të kthehet në rrugë të drejtë dhe nuk do të largohet nga vija e tij revizioniste. Sidoqoftë aq më keq do të jetë për të, sepse do të demaskohet akoma më shumë në sytë e komunistëve të mbarë botës si

armik i unitetit, si përçarës i kampit socialist dhe i lëvizjes komuniste ndërkombëtare, kurse Partia jonë do të forcojë edhe më shumë pozitën e saj në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, e cila do të shohë qartë se kush është për unitetin e vërtetë marksist-leninist dhe kush e minon këtë unitet<sup>1</sup>.

Shokë,

Populli shqiptar ka shumë miq në botë, që e simpatizojnë, e duan, e mbrojnë, e ndihmojnë dhe kjo është një forcë e madhe dhe e çmueshme për një popull të vogël, që s'i ka bërë kurrë keq njeriu, që respekton të tjerët, ashtu siç dëshiron që ta respektojnë dhe atë. Politika e Partisë dhe e Qeverisë sonë ka qenë dhe mbetet e pandryshueshme: miqësi me të gjithë popujt e botës, marrëdhënie të mira, korrekte me cilindo shtet që dëshiron të ketë po këto marrëdhënie me shtetin tonë. Ne as duam të ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme, por as nuk lejojmë që të tjerët të ndërhyjnë në punët tona të brendshme. Ne duam të rrojmë në paqe me ta, në qoftë se ata e dëshirojnë atë. Ne duam të rrojmë në fqinjësi të mirë, të kemi marrëdhënie të rregullta diplomatike dhe tregtare me fqinjët

---

<sup>1</sup> Edhe në bisedën e zhvilluar më 6 prill 1962 me ambasadorin e një vendi mik, shoku Enver Hoxha, midis të tjerash tha: «Partia e Punës e Shqipërisë lufton jo për të mballosur unitetin, por për të kalltur këtë unitet në rrugën e drejtë marksist-leniniste. Mendimi ynë është se grupi i N. Hrushovit është i pandreqshëm dhe Hrushovi vetë është usta intrigash. Këtë të vërtetë ne shpresojmë se duhet ta kuptojnë edhe partitë e tjera që qëndrojnë në pozita parimore marksist-leniniste».

tanë të Ballkanit dhe me Italinë, të rrojmë me ta në kushtet e bashkekzistencës paqësore. Ne kemi bindje se kjo është në interes të të gjithëve dhe jo vetëm në interesin tonë. Ne u themi fqinjëve tanë të pushojnë veprimtarinë armiqësore kundër vendit tonë, pse s'kanë pasur dhe nuk do të kenë kurrë sukses. Në qoftë se ndokush mendon se Shqipërisë së vogël mund t'i imponohet me madhësinë e shtetit të tij, me fuqinë e tij ushtarake, ose me shantazhe e kërcënime, ai gabohet rëndë dhe do të pësojë deziluzione të mëdha.

Populli shqiptar ushqen një dashuri të madhe për të gjithë popujt liridashës e paqedashës. Ai ka respekt të veçantë për popujt arabë, për popujt e Amerikës Latine, për popujt e Azisë e Afrikës, që luftojnë me vetëmohim për lirinë, pavarësinë dhe konsolidimin e fitoreve të tyre, kundër kolonializmit dhe neokolonializmit, kundër çdo intrige të imperialistëve amerikanë dhe partnerëve e veglave të tyre. Populli ynë simpatizon me gjithë zemër të gjithë popujt e Evropës që luftojnë kundër fashizmit, kundër luftës, luftojnë për paqe, liri e të drejta demokratike. Ai zhvillon me ta marrëdhënie miqësore dhe do të përpiqet me të gjitha forcat për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve.

Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, për të gjitha çështjet ndërkombëtare s'kanë munguar asnjëherë të mbajnë qëndrim të drejtë dhe do të vazhdojnë pa përkulje ta mbrojnë qëndrimin e tyre të drejtë në interes të socializmit dhe të paqes botërore.

Të dashur shokë,

Zhvillimi i ngjarjeve të brendshme dhe të jashtme ka konfirmuar në mënyrë të padiskutueshme drejtësinë e vijës së përgjithshme të Partisë sonë, e cila, e bazuar si kurdoherë në marksizëm-leninizmin, ka qenë, është dhe do të jetë në përputhje të plotë me interesat jetike të popullit tonë, të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe të popujve paqedashës, me interesat e paqes, lirisë, demokracisë e socializmit. Është për këtë arsye që Partia dhe populli ynë kanë marshuar gjithnjë përpara dhe vetëm përpara, duke korrur fitore pas fitoresh, duke triumfuar mbi pengesat dhe armiqtë dhe duke fituar respektin e admirimin e të gjithë popujve.

Le të vazhdojmë, pra, shokë, akoma më me guxim dhe me vendosmëri rrugën tonë të drejtë të përcaktuar nga Kongresi i 4-t i Partisë. Të hidhemi akoma më me vrull në punë për të realizuar dhe për të tejkaluar detyrat e pesëvjeçarit të tretë në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të kulturës për të rritur begatinë e atdheut tonë në marshimin e pandalshëm drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Të rritim akoma më shumë vigjilencën revolucionare dhe fuqinë mbrojtëse të atdheut, në mënyrë që ai të qëndrojë vazhdimisht një kështjellë e pamposhtur e punës dhe e jetës sonë paqësore në brigjet e Adriatikut, e zonja për të përballuar çdo furtunë e stuhi. Të çelikosim më tej unitetin moralopolitik të popullit me Partinë tonë heroike të Punës, që është garancia e patundur e të gjitha fitoreve dhe e lumturisë sonë. Shprehje e re e shkëlqyer e këtij uniteti le të bëhen zgjedhjet e 3 qershorit, ku të vemi të

gjithë si një bllok i vetëm dhe të votojmë pa përjash-tim dhe njëzëri për kandidatët e Frontit Demokratik, për bijtë dhe bijat më të mira të popullit tonë, për vi-jën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë!

Rroftë populli ynë i lavdishëm, punëtor dhe paqe-dashës që ndërton me vetëmohim socializmin!

Rroftë Partia heroike e Punës, udhëheqëse e spro-vuar e popullit tonë, besnike e patundur e marksizëm-leninizmit!

Rroftë uniteti i lëvizjes komuniste e punëtore dhe i të gjithë popujve në luftën për paqe, liri, demokraci e socializëm!

*Botuar për herë të parë, me  
shkurtime, në gazetën "Zëri  
i popullit", Nr. 129 (4287)  
31 maj 1962*

*Botohet me ndonjë shkurtim  
sipas origjinalit që gjendet  
në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## POPULLI ËSHTË MËSUESI MË I MIRË I PARTISË

*Fjala në mitingun e organizuar në Memaliaj  
të Tepelenës*

27 qershor 1962

Shokë dhe shoqe, vëllezër dhe motra të Tepelenës,  
Të dashur shokë punëtorë dhe veteranë të Luftës  
Nacionalçlirimtare,

Jam shumë i gëzuar për këtë dashuri të madhe  
dhe të ngrohtë që ju shprehni sot për Partinë tonë he-  
roike të Punës, për Qeverinë e Republikës sonë Popu-  
llore dhe jam i ngarkuar që t'ju sjell juve, motra dhe  
vëllezër, përshëndetjet më të nxehta të Komitetit Qe-  
ndror të Partisë dhe të Qeverisë!

Rrethi i Tepelenës zë një vend të rëndësishëm në  
historinë dhe në jetën e popullit shqiptar, si në kohët  
e kaluara, ashtu edhe në të tashmen, në ndërtimin e  
socializmit.

Tepelena, me gjithë fshatrat e saj, mbahet në gojë  
për të mirë nga Partia dhe populli ynë, për baballarët,  
gjyshërit e stërgjyshërit tuaj, të cilët, të frymëzuar

nga një patriotizëm i madh gjatë shekujve, kanë luftuar, kanë derdhur gjak për lirinë e Shqipërisë, për lirinë e popullit.

Populli i Tepelenës, megjithëse i djegur dhe i vrarë barbarisht nga pushtuesit, kurrë dhe kurrësi nuk u përul, por me forca të shumëfishuara, duke kapërcyer vështirësi të shumta, u ngrit kundër pushtuesve dhe luftoi me trimëri. Ashtu si gjithë populli shqiptar edhe populli i Tepelenës e dinte mirë se armiqtë nuk hiqnin dorë nga synimet pushtuese. Kështu, si kudo në Shqipëri, edhe në këto vende e male, burra dhe gra, lanë parmendën dhe shatin, morën dyflekun për të mbrojtur lirinë e atdheut. Pikërisht më 1939, kur armiqtë barbarë fashistë italianë, të cilët ishin të përgatitur për të ndezur Luftën e Dytë Botërore, sulmuan atdheun tonë, filloi lufta e çlirimit në të katër anët e vendit dhe populli i Tepelenës, me kushtimin që dha Partia, u ngrit si vullkan kundër hordhive fashiste. Të gjitha këto male e gërxhe, fole shqiponjash, u bënë të pakapërcyeshme për armiqtë, sepse atyre u pritej koka. Si kudo në Shqipëri, edhe në Tepelenë filloi përleshja, bijtë e Labërisë, të Selam Musait, stërnipërit e Skënderbeut, burra dhe gra, rrokën armët.

Selam Musain nuk e përmend vetëm populli shqiptar, por dhe të huajtë. Një gjeneral i huaj në atë kohë e paralajmëroi qeverinë italiane që të mos dilte ushtria nga Vlora se do të gjente vdekjen nga burrat shqiptarë.

Mbarë Tepelena është e shquar për trimërinë dhe patriotizmin e saj. Tepelena dhe nëpërmjet saj e gjithë Shqipëria është njohur edhe në botën e jashtme me

Ali pashë Tepelenën, i cili ka anë pozitive dhe negative. Ana pozitive që pasqyrohet në historinë e tij është se ai ishte kundër imperatorisë otomane, kundër sulltanit dhe donte që Shqipëria të ishte më vete, e shkëputur nga turqit. Ali pashë Tepelena ishte diplomat, njeri i zgjuar. Napoleon Bonaparti i shkruante gjeneralit të tij që të kishte mendjen dhe të përpiqej të ishte mik me të, se ai ishte i zgjuar dhe se shqiptarët janë trima.

Tepelena është e njohur gjithashtu edhe për faktin se 150 vjet më parë poeti i njohur anglez Bajron ka kaluar nëpër këto fshatra dhe ka shkruar për jetën e këtij populli, i frymëzuar nga këto male, dhe nga traditat e tij të mikpritjes e të bujarisë. Në një letër që ky poet i dërgonte nënës së vet, i shkruan: Kur udhëtoja në Shqipërinë e Jugut më zuri nata në një fshat, vajta në një shtëpi ku më dhanë të haja dhe të pija, më dhanë krevat për të fjetur, më shërbyen për t'u larë sipas zakonit, kur ika nxora paratë, por i zoti i shtëpisë më tha me krenari «dua të më duash, jo të më paguash».

Ne sot përkujtojmë 19-vjetorin e një ngjarjeje të shënuar, të përleshjes së përgjakshme të forcave partizane me fashistët italianë, ku heronjtë e popullit Abaz Shehu, Asim Zeneli e shumë të tjerë luftuan me trimëri. Në këtë betejë lanë koskat mbi njëqind italianë, por ranë heroikisht dhe nga njerëzit tanë, për të mos vdekur kurrë. Ata rrojnë dhe do të jenë të gjallë në shekuj në zemrat e popullit, ata janë sot këtu me ne, dhe gëzohen për Shqipërinë e re, për të cilën nuk kursyen as jetën.

Vëllezër dhe motra, të luftosh për popullin, të luf-



tosh për atdheun, s'ka gjë më të shenjtë! Ata që luftuan dhe ranë për atdheun jo vetëm kanë fituar të drejtën që për ta të flitet me respektin më të madh, por masat e popullit të vet, me mirënjohjen më të thellë përulen përpara varreve të tyre. Në saje të tyre, të sakrificave që ata bënë, duke dhënë jetën në lulen e rinisë, në saje të Luftës Nacionalçlirimtare, të udhëhequr kurdoherë nga Partia jonë heroike, ne sot gëzojmë këto ditë të lumtura, gëzojmë socializmin.

Partia jonë u themelua në një kohë kur ajo mësues të mëdhenj kishte mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit dhe popullin shqiptar. Partia jonë e dinte mirë se marksizmi dhe mësimet e marksizëm-leninizmit nuk duhej të shkëputeshin nga populli; ata që do të vepronin ndryshe, nuk mund të ishin marksistë-leninistë dhe një parti e tillë nuk do të ishte marksiste-leniniste. Marksizëm-leninizmi u krijua me ndjenjat revolucionare të klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse.

Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini, kur krijuan këtë teori, kishin parasysh gjithë luftërat shekullore të popujve, luftërat e fshatarësisë dhe të klasës punëtore. Karl Marksi ka shkruar për historinë e Skënderbeut. Engelsi ka shkruar për historinë e luftërave fshatare ku pasqyrohen tiparet themelore të këtyre luftërave gjatë gjithë historisë.

Partia jonë, që e udhëhoqi popullin në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin e socializmit, është frymëzuar dhe është edukuar nga mësimet e marksizëm-leninizmit.

Vëllezër dhe motra, populli ynë me luftën e tij kun-

dër pushtesve jo vetëm që kreu detyrën historike të çlirimit të atdheut, por, nga ana tjetër, u dha një mësim të madh të gjithë armiqve të Shqipërisë kudo që janë. Armiqtë e vendit tonë, të jashtëm dhe të brendshëm, duke shikuar historinë e popullit tonë, që nga luftërat e popullit shqiptar nën drejtimin e Skënderbeut, e më pas Luftën e Vlorës, si dhe epopenë e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, është e pamundur që të mos i bëjnë mirë llogaritë për Shqipërinë. Ata kanë arritur në konkluzionin, se që të sulmohet, të godasësh Shqipërinë, duhet të mendohesh mirë. Armiqtë e popullit tonë kurdoherë njëri pas tjetrit janë mundur dhe populli ka fituar. Nga ana tjetër, nuk është më ajo kohë kur Shqipëria ka qenë e vetmuar. Shqipëria sot është më e fortë se kurrë, ka një popull heroik, një Parti të çeliktë që ndërton me sukses socializmin dhe ka shumë miq në botë.

18 vjet kanë kaluar që nga Çlirimi, gjatë kësaj kohe dhe armiqtë kanë përgatitur shumë herë komplete kundër nesh, por të gjitha përpjekjet e tyre kanë dështuar dhe do të dështojnë me turp, sepse populli shqiptar është trim dhe luftëtar dhe se barutin e mban kurdoherë të thatë.

Shokë dhe shoqe, gjatë këtyre kohëve të pasçlirimit, çdo njeri e shikon me sy se sa ndryshime janë bërë në vendin tonë. Njerëzit kanë ndryshuar dhe janë edukuar me një patriotizëm akoma më të madh, sepse Partia i mësoi, hapi shkolla në të katër anët e vendit, u zhvilloi diturinë, nga i madhi deri te më i vogli. Në programin e saj Partia ka pasur si qëllim që atdheu të ecë përpara, që klasa punëtore dhe fshatarësia të merr-

nin në duart e tyre pushtetin për ndërtimin e socializmit. Tani, të gjitha këto fitore u arritën dhe baza ekonomike e socializmit të ne u ndërtua. Partia e zhvilloi këtë program me sukses të madh, për arsye se populli i kuptoi fare mirë mësimet e saj. Jo vetëm ndihmat e miqve kanë bërë që në vendin tonë të ndërtohet socializmi, se ndihma është ndihmë, por kryesore është forca e popullit, dituria e tij. Pasuria e popullit nuk qëndron vetëm në pronën, por edhe në zemrën e tij, në vullnetin e hekurt dhe në besimin e patundur ndaj vijës së drejtë të Partisë.

Gjatë këtyre viteve të pushtetit popullor, në të katër anët e vendit, u ndërtuan shumë fabrika dhe uzina, të cilat drejtohen më së miri nga bijtë e popullit. U zhvilluan minierat, të cilat janë një pasuri e madhe për vendin tonë. Pa këto miniera nuk do të ndërtohej socializmi, sepse industria minerare zë vendin e parë për ndërtimin e socializmit. Edhe miniera juaj është një nga ato që zë vend të nderuar në ekonominë e vendit tonë. Me punën tuaj ju kurdoherë keni dalë faqebardhë, mbasi jeni udhëhequr nga Partia jonë e Punës, e cila mbështetet fuqimisht te ju, te populli.

Në dy vjetët e fundit megjithëse në kushte shumë të vështira, të cilat na u krijuan nga N. Hrushovi, populli shqiptar ka bërë mrekullira, duke pasur rezultate akoma më të shkëlqyera sesa në vitet e mëparshme. Kjo tregon se Partia jonë është në rrugë të drejtë, se vijën e Partisë e pëlqen dhe e aprovon i tërë populli ynë.

Shokë dhe vëllezër, në fushën e bujqësisë, gjithashtu ne kemi shkuar përpara. Çështja kryesore ishte kolektivizimi, bashkimi vullnetar i fshatarëve në koo-

perativa bujqësore. Kjo detyrë u realizua me sukses dhe nuk hasëm në vështirësi dhe mosmarrëveshje, sepse fshatarësia jonë, ashtu si gjithë populli shqiptar, duke përqafuar vijën e Partisë, është treguar përparimtare dhe revolucionare, e vendosur për të ndërtuar socializmin. Kolektivizimi ishte eksperiencë e fituar nga Bashkimi Sovjetik, të cilën ne e morëm, e studjuam dhe e zbatuam sipas kushteve konkrete të vendit tonë. Fshatarësia hyri në kooperativa dhe jeta u përmirësua. U hapën toka të reja, u thanë kënetat, u hapën kanale, u bënë bonifikime, u shtua sipërfaqja e tokave të ujitshme etj.

Partia punoi me mend në lidhje me mekanizimin e bujqësisë dhe me shtimin e ujitjes së tokave. Ne do të arrijmë që gjatë këtij pesëvjeçari të ujitim 45 për qind të tokave bujqësore. Partia do të sigurojë në vend plehurat kimike dhe kjo do të bëhet, sepse nga RP e Kinës na është siguruar një uzinë e madhe, e cila do të ngrihet në Fier. Në vitet 1966, 1967, prodhimet bujqësore do të dyfishohen, rendimenti do të shtohet, kështu që do ta bëjmë bujqësinë tonë një bujqësi intensive dhe populli shqiptar atëherë me të vërtetë do të ketë me bollëk ushqime dhe veshmbathje, sepse bujqësia jo vetëm siguron ushqimin e popullit, por siguron edhe lëndën e parë për industrinë. Gjatë këtyre tre vjetëve të këtij pesëvjeçari do të fillojnë punime të mëdha për ngritjen e mjaft objekteve industriale.

Në shumë vende të botës ka filluar të ketë krizë, bile edhe në vendet socialiste të Evropës. Në Bashkimin Sovjetik, pas 45 vjet socializëm, hasen vështirësi ekonomike. Dhe pse ngjet kjo? Kjo ngjet sepse Nikita

Hrushovi tradhtoi marksizëm-leninizmin, ai krijoi teoritë e tij revizioniste në lëmin e bujqësisë, duke i rrëzuar të gjitha pikëpamjet e drejta të Stalinit mbi zhvillimin e bujqësisë, dhe duke ngritur akuza false se në këtë fushë janë bërë gabime. Por Stalini nuk kishte bërë gabime. Fakti është se pas Luftës së Dytë Botërore, në saxe të politikës së brendshme staliniane, Bashkimi Sovjetik në vitin 1952 arriti në drithëra rendimente më të larta se më 1939.

Nikita Hrushovi bëri shumë bujë se gjoja do të arrinte rezultate të larta në bujqësi, bëri fjalë shumë dhe premtoi se Bashkimi Sovjetik do t'ua kalonte Shteteve të Bashkuara të Amerikës në prodhimin për frymë në gjalpë, mish etj. Por në fakt kjo nuk ngjau, dhe s'kishte si të ngjiste, sepse, masat që mori Hrushovi, ishin të gabuara, ato e shkatërruan bujqësinë socialiste, e dëmtuan prodhimin në atë masë sa që në Bashkimin Sovjetik ka krizë të madhe në qumësht, në mish e në prodhime të tjera. Politika revizioniste hrushoviane e shpuri Bashkimin Sovjetik, pas 45 vjetëve të socializmit, në një situatë të tillë sa që të ngrihen çmimet për mishin, qumshtin etj. Te ne megjithëqë kemi pësuar dëme nga thatësira, prapëseprapë furnizimi në këtë drejtim jo vetëm ka mbajtur normën e caktuar, por ka qenë më i mirë nga vitet e tjera. Kjo vjen sepse Partia jonë ndjek vijën e drejtë, ndjek vijën që na mësojnë Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini në çështjet e zhvillimit të industrisë dhe të bujqësisë.

Armiaqtë bëjnë kundër nesh propagandë të keqe, shpifin dhe ngrenë akuza false, por këto nuk po u zënë vend, sepse sado që na kanë bërë edhe bllokadë, pra-

pëseprapë njerëz nga vende të ndryshme të Evropës vijnë dhe shohin se si qëndron realiteti ynë.

Rëndësi e veçantë do t'u kushtohet bujqësisë e blegtorisë. Në rrethin tuaj rendimenti i drithërave ka qenë në një nivel shumë të ulët, kurse tani ai ka marrë një hov të madh, ka shkuar drejt rritjes. Shokët e komitetit të Partisë më raportuan se gjendja e sivjetme e bujqësisë dhe e ekonomisë suaj, në përgjithësi, do të jetë e kënaqshme, ju do të merrni më shumë drithëra nga viti i kaluar. Duhani që ka një rëndësi të madhe për rrethin tuaj, sivjet paraqitet i mirë. Këtë kulturë e kemi mirë në tërë Republikën dhe do të kemi prodhime shumë të mira. Përsa u përket pambukut dhe panxharit të sheqerit paraqiten shumë mirë. Gjithashtu në blegtori jeni mirë dhe do ta realizoni planin, megjithëse keni pasur vështirësi, të cilat me siguri do të kalohen nga puna juaj këmbëngulëse. Prandaj në të gjithë zërat do të kemi një prodhim bujqësor-blegtoral të kënaqshëm dhe kjo ç'do të thotë? Kjo do të thotë që në Shqipëri të kemi me bollëk çdo gjë. Ne konstatojmë me kënaqësi se industria e minierave po e realizon me sukses planin kudo. Ne kemi perspektiva që ta zgjerojmë akoma më shumë zbulimin e hekur-nikelit. Ne jemi në gjendje të sigurojmë dhe të shesim minerale, për të cilat kanë nevojë miqtë tanë. Kemi perspektiva në zbulimin e bakrit, për të plotësuar nevojat tona dhe të furnizojmë edhe miqtë. Gjithashtu, po zbulohen minerale të pasura të boksitit, të cilat janë të nevojshme për vendin tonë. Përveç këtyre, do të zbulohen minerale të tjera. E tërë Shqipëria, pëllëmbë për pëllëmbë, do të jetë e studjuar, dhe pasuritë tona të nëntokës do të

pasqyrohen në hartat gjeologjike dhe mbi këtë bazë në të ardhshmen do të zhvillohet industria jonë e fuqishme.

Prandaj, siç e shikoni, perspektiva të mëdha i janë hapur zhvillimit të ekonomisë sonë. Populli ynë me energji të mëdha po bën që çdo ditë t'i ndryshohet faqja Shqipërisë. Situata e brendshme e vendit karakterizohet nga uniteti i çeliktë i popullit me Partinë, unitet i arritur në saje të veprës dhe të vijës së drejtë të Partisë sonë.

Partia pa popullin nuk mund të rrojë dhe nuk mund të ecë përpara. Prandaj ne luftojmë, përpigemi që çdo gjë ta bëjmë në shërbim të popullit, për të evituar mungesat, të cilat në fakt po zhduken gradualisht dhe po plotësohen më mirë nevojat e popullit. Unitetin Parti-popull e treguan votimet për në Kuvendin Popullor, që u zhvilluan disa ditë më parë, ku në të gjithë vendin vetëm 37 vota ishin kundër. Këto votime vërtetuan vijën e drejtë të Partisë, dashurinë e popullit ndaj atdheut dhe lirisë, respektin e dinjitetin për gjakun e dëshmorëve, treguan forcën e madhe të Partisë dhe të popullit, treguan politikën e drejtë që ka ndjekur Partia. Me politikën e drejtë të Partisë në ekonomi, në industri ashtu dhe në bujqësi, vendi ynë ka arritur të ketë këto suksese, që duhet të na shërbejnë për të ecur më përpara, për sulme të reja e gjithnjë më përpara në ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe shteti ynë ndjekin një politikë të drejtë, të bazuar në mësimet e marksizëm-leninizmit. Këtë politikë e di dhe e njeh i tërë populli ynë, sepse ne nuk ia kemi mbajtur fshehur. Politika jonë është politikë paqësore, populli shqiptar do të

rrojë në paqe dhe nuk e do luftën. Luftën për paqe e duan të gjithë popujt paqedashës të botës dhe për këtë të gjithë duan të luftojnë kundër imperializmit amerikan, kundër shërbëtorëve të tij, gjithë reaksionarëve dhe revizionistëve modernë, të cilët hiqen si komunistë për të fshehur punën e tyre në shërbim të imperializmit amerikan.

Ç'kërkon imperializmi amerikan? Imperializmi amerikan kërkon skllavërimin e botës, sundimin mbi klasën punëtore dhe fshatarësinë, me një fjalë kërkon të sjellë në fuqi në vendet socialiste bejlerët dhe agallarët. Kjo është politika e imperializmit amerikan.

Kurse politika jonë është që të shkatërrohet imperializmi, borgjezia, dhe popujt kudo në botë të fitojnë lirinë që klasa punëtore dhe fshatarësia të marrin pushtetin në dorë dhe të ndërtojnë shoqërinë e re socialiste, të zhdukin çdo shtypje e shfrytëzim.

Pra këto dy politika janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Imperialistët amerikanë duan luftën, sepse pa luftë nuk mund të nxjerrin fitime. Me luftë ata kërkojnë gjithashtu të na shkatërrojnë ne. Kurse ne duhet të inkurajojmë popujt për greva, demonstrata dhe për kryengritje të armatosur që të përmbysin pushtetin e borgjezisë e të vendosin pushtetin e klasës punëtore. Ja pse politika jonë është në kundërshtim me atë të imperialistëve.

Revizionistët modernë, Hrushovi dhe Titoja, po i shërbejnë imperializmit amerikan. Hrushovi propagandon «paqe me çdo kusht», «të çarmatosemi», se «vetëm me paqen, vetëm kur të çarmatosemi, atëherë do ta fitojmë luftën». Kurse ne pyesim: A çarmatohet impe-



rializmi amerikan? Jo, kurrë! Prandaj të veprojmë ashtu siç na mëson marksizëm-leninizmi, që lufta kundër imperializmit të zhvillohet e pandërprerë. Vetëm kështu mbrohet paqja, dhe jo sipas vijës së Hrushovit. Politika e Partisë sonë dhe e shumë partive të tjera marksiste-leniniste po fiton. Popujt e aprovojnë vijën e drejtë të partive tona.

Nikita Hrushovi, kur e pa se ne kishim pikëpamje të kundërta me ato të tijat, llogariti që Shqipërinë duhej ta shkatërronte, por këtë hesap e bëri keq. Ai nuk e kishte kuptuar mirë se ç'ishte Partia jonë, populli ynë; nuk e kishte kuptuar udhëheqjen tonë, të cilën nuk e ka sjellë në fuqi Nikita Hrushovi, por ka dalë nga populli, nga lufta. Hrushovi mendonte se brenda disa ditëve do ta rrëzonte Komitetin Qendror të Partisë dhe do të sillte në fuqi disa renegatë, mirëpo i hasi sharra në gozhdë, Partia dhe populli qëndruan si shkëmb graniti. Hrushovi vajti edhe më tej: na preu kreditë, tërhoqi specialistët, preu marrëdhëniet diplomatike që ishte kulmi i tradhtisë së tij dhe që e diskreditoi atë në të katër anët e botës. Këtë veprim as miqtë e tij nuk e pranuan dhe nuk e pasuan.

Në situatat që po kalojmë, ne duhet të ecim me besim të plotë në forcat e popullit tonë e të Partisë, me besim të madh në drejtësinë e vijës së Partisë sonë, duhet të jemi vigjilentë kundër çdo armiku, sepse imperialistët amerikanë përgatiten për luftë, por ne do t'i mposhtim edhe sikur ata të shpërthejnë luftën. Ne duhet të vëmë të gjitha forcat tona që luftë të mos bëhet, por dhe armikun të mos e harrojmë. Atje ku punojmë, duhet dhe të vigjilojmë, në kufi, në ara, në fabrika e në

shkolla. Të punojmë për realizimin e planeve tona, me ndërgjegje dhe heroizëm, sepse sa më mirë t'i realizojmë detyrat tona, aq më të fortë do të jemi, aq më tepër armiqtë nuk do të guxojnë të na prekin. Hrushovi, shokët e tij dhe përkrahësit e tij revizionistë do të demaskohen.

Në momente të tilla duhet të jemi vigjilentë në kulm. Vendin tonë e kemi të armatosur ekonomikisht dhe ushtarakisht. Ne i thyem italianët me ato «maliherat» e vjetër, po tani ç'mund të bëjmë? I shikoni këta ushtarakë që gjatë luftës ishin partizanë të thjeshtë? Tani këta janë të pajisur me shkencën ushtarake më moderne, janë të fortë si çeliku e të pajisur me dashurinë ndaj popullit dhe atdheut, kanë në duart e tyre armët më moderne. Dhe armë kemi boll, jo vetëm për ushtrinë e për burrat, por dhe për gratë që të mbrojmë fitoret e arritura me kaq gjak e sakrifica.

Në të kaluarën ndoshta ishte më kollaj që të vinin aeroplanë, vaporë dhe armiku të pushtonte qytetet tona. Tani ata e dinë se Shqipërinë s'e gëlltit dot, dhe si të mos e dinë se çfarë populli kemi, çfarë ushtrie kemi, çfarë Partie kemi? Preke Shqipërinë, ke prekur të gjithë popullin shqiptar. Ne jemi të rrethuar nga vende kapitaliste e revizioniste, por kemi miq në të gjithë botën dhe në mbrojtje të popullit tonë do të ngrihen popujt paqedashës e përparimtarë.

Anëtarët e Partisë dhe udhëheqësit e saj, duhet të jenë të thjeshtë si populli, sepse ai që ngre kokën dhe mban hundën përpjetë, është si kalliri pa kokrra. Në qoftë se punon mirë dhe drejt, populli të vlerëson. Ai është mësuesi më i mirë i Partisë dhe nëse populli ta

thotë se nuk po punon mirë, atëherë frenohu, pse vetëm populli është në gjendje të të gjykojë më mirë se kushdo tjetër. Partia grumbullon eksperiencën e popullit, e studjon dhe e përgjithëson atë, e bën ligj për ta zbatuar të gjithë. Prandaj Partia na mëson të forcojmë e të ruajmë unitetin tonë, unitetin Parti-popull, që të jemi kurdoherë të bashkuar. Në këto kushte populli i rrethit tuaj të luftojë që të dalë faqebardhë në realizimin e planit. Çdo ndihmë të mundshme për nevojat që do të keni, do t'ju japim në kohën e duhur, si ndërtimin e ujësjellësit, shtëpinë e kulturës, SMT-në etj. Të gjitha këto dhe të tjera Partia dhe shteti jua sigurojnë që të plotësoni nevojat tuaja, që të punoni më mirë, të ecni më shpejt, të ngrini më tej nivelin e jetesës; Partia punon për ju, punon për popullin.

Edhe një herë ju uroj nga zemra shëndet të plotë, t'ju dëgjoj të mirën dhe të jeni në ballë të ndërtimit të socializmit, ashtu siç e kërkon Partia!

Të rrojë Partia jonë heroike dhe e lavdishme!

Të rrojë populli shqiptar!

Të rrojë populli i Tepelenës, trim, luftëtar e i zgjuar, mbështetje e fuqishme e Partisë së Punës të Shqipërisë!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## POPULLI YNË USHTRON PLOTËSISHT PUSHTETIN E TIJ SOVRAN

*Fjala në sesionin e parë të legjislaturës së pestë  
të Kuvendit Popullor*

14 korrik 1962

Të dashur shokë e shoqe deputetë,

Më lejoni që në emër të Partisë sonë heroike të Punës dhe të Komitetit të saj Qendror t'ju sjell juve, deputetëve të Kuvendit Popullor të legjislaturës së pestë, të zgjedhur unanimisht nga populli ynë i lavdishëm, përshëndetjet më të zjarra dhe urimet më të mira për të kryer si kurdoherë me nder detyrat fisnike ndaj atdheut e socializmit!

Kuvendi Popullor është organi më i lartë i pushtetit të punëtorëve dhe të fshatarëve të lirë të vendit tonë, ai është dëshmi e çartë e demokracisë sonë socialiste, e demokracisë së vërtetë për popullin. Dita e 3 qershorit, kur mbi 99.99 për qind të zgjedhësve morën pjesë në votime e po atë votuan për kandidatët e Frontit, ose kur në të gjithë vendin votuan kundër vetëm 37 vetë, do të mbetet e paharruar. Ne dhe e gjithë bota,

miqtë e armiqtë, atë ditë dëgjuam me një forcë të re e të paparë buçimën e zërit aprovues të mbarë popullit për vijën e drejtë marksiste-leniniste, që ka ndjekur dhe ndjek me besnikëri të patundur Partia jonë e pamposhtur. Atë ditë të gjithë panë edhe një herë qartë se populli shqiptar është i bashkuar grusht me Partinë e tij dhe është i vendosur deri në fund për të marshuar përpara, pa u ndalur nga asgjë, drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, drejt fitores së kauzës së paqes, lirisë, demokracisë e socializmit në botë.

Dhe kjo nuk është e rastit. Uniteti i çeliktë i mbarë popullit rreth Partisë, i ka rrënjët te gjaku i bijve tanë më të mirë që u derdh si lumë në luftën për çlirimin e atdheut nga pushtuesit fashistë e tradhtarët, te djersa e kulluar e masave tona punonjëse, që vërshoi pa pushim dhe hovi në punë i njerëzve tanë të mrekullueshëm që po ia ndërrojnë pamjen atdheut, te aleanca e pathyeshme e klasës sonë punëtore heroike me fshatarësinë punonjëse, te patriotizmi i flaktë socialist dhe internacionalizmi i thellë proletar që karakterizojnë popullin tonë, te besnikëria e pafund e Partisë dhe e Qeverisë ndaj interesave të popullit e të socializmit, për të mbrojtur atdheun dhe fitoret tona socialiste në luftë të papajtueshme me armiqtë e brendshëm e të jashtëm, me imperialistët dhe revizionistët modernë; ky unitet e ka burimin te vija gjithmonë e drejtë, kurdoherë fitimtare, e bazuar në themelet prej graniti të marksizëm-leninizmit, që ka ndjekur, ndjek e do të ndjekë kurdoherë Partia jonë.

Gjatë periudhës së legjislaturës së katërt, të mbushur me ngjarje të një rëndësie të madhe historike në

jetën e popullit e të shtetit tonë, u kalit më tej ky unitet. Ashtu sikundër konkludoi Kongresi i 4-t i Partisë, në vendin tonë u bënë ndryshime socialo-ekonomike të tilla që shpunë në ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, si në qytet ashtu dhe në fshat, dhe tani kemi hyrë në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. U zhdukën përgjithmonë ekonomia kapitaliste, klasat shfrytëzuese dhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut. Tani në vendin tonë ekzistojnë dy klasa mike, klasa punëtore e fshatarësia kooperativiste, të lidhura në aleancë të ngushtë midis tyre nën udhëheqjen e klasës punëtore.

Gjatë këtyre katër vjetëve Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria kanë udhëhequr me urtësi dhe me guxim masat punonjëse në realizimin me sukses të planit të dytë pesëvjeçar, që e ngriti në një shkallë më të lartë fuqinë ekonomike, nivelin e kulturës dhe fuqinë mbrojtëse të vendit; tani populli ynë ka vënë të gjitha forcat e tij për realizimin e pesëvjeçarit të tretë, që do të shënojë një hap të madh përpara në rrugën e shndërrimit të atdheut tonë nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar. Janë të njohura nga të gjithë sukseset e mëdha, që kemi arritur në zhvillimin dhe në zgjerimin e industrisë e të prodhimit industrial, në shtimin e prodhimit bujqësor, si rezultat i përfundimit të kolektivizimit, i mekanizimit, i rritjes së rendimenteve e i shtimit të sipërfaqeve të mbjella, si dhe në zhvillimin e arsimit e të kulturës. Populli ynë tani rron shumë më mirë dhe e nesërmja do të jetë edhe më e bukur. Perspektiva të shkëlqyera ka hapur plani i tretë pesëvjeçar, i cili parashikon një zhvillim më të madh të të gjitha degëve të industrisë e sidomos të asaj minerare,

i jep një hov të ri bujqësisë në rrugën e kalimit të saj nga një bujqësi ekstensive në një bujqësi intensive, bën një zgjerim të pashembullt të ndërtimeve, ngre në një nivel të lartë arsimin, kulturën, shkencën, artet etj. Entuziazmi krijues, hovi patriotik dhe shpirti i vetëmohimit që i karakterizon masat tona punonjëse në këtë etapë të rëndësishme të zhvillimit të vendit tonë dhe udhëheqja largpamëse e Partisë dhe e Qeverisë janë garanci se plani pesëvjeçar do të realizohet me sukses dhe jeta e popullit tonë do të bëhet më e pasur dhe më e bukur. Më kot ëndërrojnë e përrallisnin armiqtë se do të ndodhë ndryshe.

Si rezultat i ndryshimeve socialo-ekonomike dhe i fitoreve të shkëlqyera në ndërtimin socialist është forcuar më tej pushteti popullor, është zgjeruar pjesëmarrja aktive e masave në pushtet, është çelikosur e është zgjeruar më tej demokracia jonë dhe ligjshmëria socialiste. Në vendin tonë populli ushtron kudo dhe plotësisht pushtetin e tij sovran, të konsakruar në Kushtetutën e Republikës sonë Popullore. A ka dëshmi më bindëse për këtë se zgjedhjet e 3 qershorit? E ç'mund të vlejné para kësaj shpifjet e imperialistëve e të revizionistëve kundër popullit, pushtetit dhe Partisë sonë lidhur me «mungesën e demokracisë» e të tjera?

Komiteti Qendror dhe Qeveria, duke zbatuar plotësisht detyrat e caktuara nga Partia dhe Kuvendi Popullor, kanë bërë gjithçka që të forcohet më tej pozita ndërkombëtare dhe autoriteti i Republikës sonë Popullore. Besnikë dhe të vendosur ndaj marksizëm-leninizmit e internacionalizmit proletar ne s'jemi ndalur para asgjëje, para asnjë pengese ose vështirësie, por

kemi bërë dhe bëjmë çmos për zhvillimin e marrëdhënieve vëllazërore me vendet socialiste në të gjitha fushat. Në themel të politikës sonë të jashtme ka qenë, është dhe do të jetë kurdoherë ruajtja dhe zhvillimi i pandërprerë i miqësisë vëllazërore me popujt që ndërtojnë socializmin. Nuk ka intrigë, qoftë nga ana e imperialistëve, qoftë edhe nga ana e revizionistëve modernë, nuk ka forcë në botë që ta prishë këtë miqësi. Partia, Qeveria dhe populli ynë kanë zbatuar dhe do të zbatojnë me konsekuencë parimet e marksizëm-leninizmit për triumfin e çështjes së paqes, lirisë, demokracisë e socializmit në botë. Ne kemi përkrahur luftën e popujve të shtypur për liri e pavarësi dhe luftën e proletariatit ndërkombëtar kundër shfrytëzimit kapitalist, për liri demokratike e për socializëm, gjithashtu kemi ndjekur me besnikëri politikën e bashkekzistencës paqësore me vendet me sisteme të ndryshme shoqërore. Populli ynë edhe në të ardhshmen nuk do të pushojë për asnjë çast luftën e tij kundër planeve, qëllimeve e veprimeve agresive të luftënxitësve imperialistë, me imperializmin amerikan në krye dhe nuk do të pushojë luftën për demaskimin e revizionistëve modernë të të gjitha ngjyrave, që shpien ujë në mullirin e imperializmit.

Partia, Qeveria dhe populli ynë në të ardhshmen do të rritin akoma më shumë vigjilencën revolucionare, duke mbajtur në njërën dorë kazmën e në tjetrën pushkën dhe do të çelikosin më tej fuqinë mbrojtëse të atdheut për të bërë shkrumb e hi çdo tentativë të armiqve që do të guxonin të preknin lirinë, sovranitetin dhe fitoret tona socialiste. Shqipëria do të qëndrojë në



shekuj kështjellë e pathyeshme e socializmit dhe e paqes në brigjet e Adriatikut tonë të kaltër. Nuk ka forcë në botë që mund të largojë Partinë, Qeverinë dhe popullin tonë nga rruga e lavdishme e marksizëm-leninizmit dhe e internacionalizmit proletar.

Të dashur shokë,

S'ka asnjë dyshim se nën udhëheqjen e Partisë populli ynë trim, i talentuar dhe i palodhur, punëtorët, fshatarët, inteligjenca popullore, do të marshojnë edhe në të ardhshmen nga fitorja në fitore si një trup i vetëm. Ky besim i patundur është futur thellë në gjakun e në shpirtin e tij, kjo vendosmëri përshkon tërë qenien e tij dhe përcakton frymëmarrjen e të rrahurat e zemrës së tij fisnike. Të jemi si kurdoherë të denjë për besimin e madh që na ka dhënë populli, duke na zgjedhur në këtë forum të lartë udhëheqjeje dhe t'ia kushtojme të gjitha energjitë tona, të gjitha dituritë, djersën dhe gjakun tonë po ta lypë nevoja, për t'i shërbyer sa më mirë popullit — kështu na mëson Partia. Të mbajmë kurdoherë lidhjet më të ngushta me popullin, të dëgjojmë zërin e tij, të mësojmë sa më shumë nga gjenia e tij e pavdekshme dhe të vëmë me besnikëri në jetë aspiratat e tij, të mishëruara në vijën e përgjithshme marksiste-leniniste të Partisë — këtë kërkon nga secili prej nesh Partia jonë. Të çelikosim më tej unitetin monolit, të pathyeshëm të popullit me Partinë që është burimi i të gjitha fitoreve tona — kjo qe porosia që na dha populli kur na zgjodhi, kjo është edhe porosia e Partisë sonë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës, në mbledhjen e saj të fundit, më ngarkoi t'i propozoj Kuvendit Popullor të legjislaturës së pestë që, për formimin e Qeverisë së re të Republikës Popullore të Shqipërisë, të ngarkojë birin e shquar dhe të talentuar të popullit tonë, një nga udhëheqësit më besnikë të Partisë e të shtetit që gjithë jetën ia ka kushtuar çështjes së popullit e të socializmit, anëtarin e Byrosë Politike, ish-Kryetarin e Këshillit të Ministrave, shokun tonë të dashur, Mehmet Shehu. Komiteti Qendror ka besim se ashtu si deri tani edhe gjatë legjislaturës së pestë Qeveria që do të dalë nga Kuvendi Popullor, nën udhëheqjen e Partisë, do të vërë të gjitha forcat e saj për të zbatuar sa më mirë vijën e Partisë, për të vënë në jetë planet tona madhështore, për të mbrojtur interesat jetike të popullit, për të çelikosur më tej fuqinë e atdheut, për lavdinë e Republikës sonë Popullore, për ndërtimin e socializmit, për triumfin e marksizëm-leninizmit dhe të paqes në botë.

Rroftë populli ynë i lavdishëm!  
 Rroftë pushteti ynë popullor!  
 Rroftë Partia jonë heroike e Punës!  
 Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 168 (4326), 15 korrik 1962*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR URIMI ME RASTIN E 80-VJETORIT  
TË DITËLINDJES SË PROFESOR DOKTOR  
MAKSIMILIAM LAMBERC<sup>1</sup>**

18 korrik 1962

Zoti Profesor Doktor,

Me rastin e 80-vjetorit të ditëlindjes suaj, më le-  
joni t'ju dërgoj urimet më të mira dhe përshëndetjet  
më të përzemërta në emrin tim personal, të Partisë së  
Punës të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar! Në per-  
sonin tuaj vendi ynë ka pasur gjithmonë një mik të  
vyer, që ia ka kushtuar një pjesë të mirë të jetës së  
tij miqësisë midis dy popujve tanë vëllezër. Për këtë  
ne ju jemi dhe do t'ju jemi kurdoherë shumë mirë-  
njohës. Urojmë që të gëzoni gjithmonë shëndet të mirë  
dhe të keni jetë sa më të gjatë për lumturinë tuaj fa-  
miljare, për vazhdimin e mëtejshëm të punës suaj fis-  
nike shkencore, për forcimin e miqësisë midis popujve  
tanë! Urojmë gjithashtu që së shpejti, me rastin e fes-

---

<sup>1</sup> Prof. Dr. Maksimilliam Lambere (1882-1963) — një ndër  
albanologët e shquar që ka dhënë një kontribut të çmuar për  
gjuhën shqipe.

tës sonë kombëtare, 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, t'ju kemi midis nesh!

I transmetoni, i dashur mik, përshëndetjet tona të përzemërta dhe zonjës suaj të nderuar, Josefa.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**KUADROT TË LIDHEN MË NGUSHTË  
ME PRODHIMIN, ME POPËLLIN,  
ME LIBRIN**

*Fjala në Plenumin e 7-të të Komitetit Qendror  
të PPSH<sup>1</sup>*

**19 korrik 1962**

Të dashur shokë dhe shoqe,

Çdo mbledhje e Plenumit të Komitetit Qendror ka shënuar një datë me rëndësi në zhvillimin e mëtejshëm të punëve të Partisë dhe të shtetit tonë socialist, u ka dhënë problemeve që janë trajtuar një impuls të ri dhe janë korrur rezultate të mira në jetën e popullit tonë. Kjo është e natyrshme, pse udhëheqja e Partisë në shtruarjen e problemeve, duke ndjekur vijën e përgjithshme të Partisë, gjen rrugë e forma të reja pune, të përshtatshme me periudhat dhe me etapat e ndërtimit të mëtejshëm të socializmit. Prandaj edhe kjo mbledhje e Plenumit të Komitetit Qendror shënon një

---

1 Ky Plenum u zhvillua më 18-19 korrik 1962 dhe diskutoi rreth raportit të Byrosë Politike «Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrit», mbajtur nga shoku Manush Myftiu.

datë me rëndësi, pse u shqyrtua një problem jetik, nga më të rëndësishmit që ka preokupuar dhe preokupon vazhdimisht Partinë tonë: çështja e ngritjes, perfeksionimit, edukimit të mëtejshëm të kuadrit të shtetit dhe të Partisë sonë.

Për të marrë në analizë këtë problem të rëndësishëm u mbledh ky Plenum i Komitetit Qendror, ku veç anëtarëve të tij marrin pjesë si të ftuar një numër i konsiderueshëm i kuadrove tanë kryesorë. Programi që parashtroi Byroja Politike, nëpërmjet raportit që mbajti shoku Manush, ishte fryt i eksperiencës suaj, i eksperiencës së të gjithë Partisë, në punën për zbatimin me sukses të kësaj detyre të madhe. Kjo eksperiencë e grumbulluar hapi perspektiva të mëdha dhe u plotësua me diskutimet tuaja që dhanë gjithashtu një kontribut jashtëzakonisht të çmueshëm për këtë problem kaq të rëndësishëm, delikat dhe të komplikuar. Ky është mendimi i të gjithë shokëve të Byrosë Politike se diskutimet tuaja jo vetëm që kanë qenë në një nivel të lartë, por, çka është akoma më mirë, na kanë hapur horizont të gjithëve. Pas këtij Plenumi, Byroja Politike, Sekretariati, Këshilli i Ministrave dhe Kryesia e tij, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, në bazë të raportit dhe të eksperiencës që sollët ju në Plenum, duhet të bëjnë një studim të shumanshëm, për të gjitha problemet që u ngritën këtu, sepse çështja e kuadrit nuk është vetëm çështje shifrash. Çështja e kuadrit është një çështje delikate, sepse ka të bëjë me njerëzit. Studimet që duhet të ndërmarrim, t'i bëjmë me imtësi dhe brenda mundësive tona financiare, mundësive të kuadrit

pedagogjik të kontingjentit të nxënësve etj., për të përcaktuar rrugët e mëtejshme për zhvillimin e kuadrove.

Në punën me kuadrin ne do të ndeshim në vështirësi objektive dhe subjektive, sepse dhe organizimi i punës nga ana jonë çalon, megjithatë një gjë është e rëndësishme, që ky problem i ka preokupuar dhe i preokupon vazhdimisht shokët. Kjo është garancia për të ecur përpara dhe jo predikimi i revizionistit Hrushov, që trumbeton se kuadrot tanë gjoja i paska prepatitur ai.

Rëndësia e Plenumit qëndron edhe në faktin se i bëri një analizë të mirë punës sonë që nga viti 1957, kur zhvilluam Plenumin e Komitetit Qendror po për këtë çështje. Por çështjen e kuadrit, si pjesë të pandarë të çdo problemi, Partia e ka marrë në shqyrtim dhe në Kongresin e 4-t e në çdo mbledhje të Komitetit Qendror e të Byrosë Politike. Këtu nuk është fjala për emërimin ose shkarkimin e këtij apo e atij kuadri, por për faktin dhe kuptimin e thellë se çdo problem i madh që preokupon Partinë është i lidhur ngushtë me kuadrin. Pra një analizë e tillë e thellë e problemit të kuadrit duhej bërë. Por tani, pas kësaj analize, rëndësi ka se çdo të bëhet më tej. Detyrat të gjithë i kemi të qarta, ato janë të rëndësishme, janë edhe të rënda, por të realizueshme. Me gjithë pengesat e mëdha që kemi hasur në të kaluarën, ne asgjë nuk na ka ndalur në rrugën tonë. Por tani, shokë, nuk kemi më ato pengesat e para. Dhjetë vjet më parë s'kishim kuadro, por që atëherë ne kemi kaluar disa etapa në edukimin e tyre, në rritjen e kuadrove jo vetëm në numër, por edhe në

cilësi. Këtë rritje mund ta konsiderojmë të rëndësishme.

Ku mund të mbështetemi ne për të hedhur hapa të tjera përpara?

Së pari, kemi krijuar një kontingjent të konsiderueshëm kuadrosh të kategorive të ndryshme dhe të sektorëve të ndryshëm, me një bagazh të madh njohurish, që drejtojnë me kompetencë, që kanë dhënë për këtë prova në jetë, në punë, në prodhim, dhe ku ne mbështetemi e do të mbështetemi fuqimisht për të hedhur hapa të tjera përpara. Ky është një thesar i madh, të cilin Partia me vijën e saj të drejtë e krijoi me këmbëngulje, me djersë.

Së dyti, kemi krijuar një numër organizmash drejtues për pregatitjen e kuadrit, për perfeksionimin, rritjen dhe zhvillimin e tij në të gjitha hallkat, që nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, deri në rrjetin e saj të gjerë shkollor të çfarëdo kategorie që i duhet një shteti modern. Ne kemi krijuar, pra, të tillë organizma që nga institutet e larta e deri te kurset e perfeksionimit në fabrikë e në kooperativë, që kanë punuar e kanë fituar një eksperiencë të madhe. Ju këtu bëtë shumë propozime, që, sipas mendimit tim, në vija të përgjithshme, sado që ne kemi disa caqe, duhet të jenë objekt i një studimi të imtë, sepse ato kanë si qëllim përmirësimin e punës me kuadrin. Ndihma që i dha Plenumi udhëheqjes, Byrosë Politike, do të bëjë që detyrat e mëdha që ne kemi ngritur dhe që ngremë sot të realizohen dhe të tejkalohen.

Së treti, arsimit dhe kultura nuk kuptohen më nga kuadrot tanë vetëm sepse u është ngarkuar si detyrë. Jo, ato kuptohen tani edhe si një nevojë. Ata e ndiejnë



nevojën për kulturë, për arsim. Edhe pleqtë, shpesh thonë: «Ah, pse s'u ndodhëm më të rinj!».

Çështja që arsimit dhe kultura të kuptohen si nevojë nga të gjithë, ka një rëndësi të madhe dhe këtë pikëpamje ne duhet ta forcojmë kudo; t'i pajisim me kulturën e duhur djemtë e vajzat dhe këtë ta ndiejnë të gjithë, i pamësuar, gjysmë i mësuar, i mësuar dhe i dituri. I dituri duhet të bëjë përpjekje çdo ditë, sepse edhe për atë është nevojë e domosdoshme që të pajiset me kulturë të mëtejshme, sepse kultura s'ka fund. Pra, kur ne, shokë, të kemi krijuar një botëkuptim të drejtë, lidhur me pajisjen e njerëzve me arsim dhe me kulturë, atëherë do të kemi ku të mbështetemi për të plotësuar detyrat e mëdha që na janë shtruar përpara.

Shokë, për çështjet që radhita më sipër, për kushtet e favorshme që krijuan me luftë dhe me punë Partia dhe pushteti, është derdhur kaq gjak, janë bërë e po bëhen kaq sakrifica. Por këto duhet të kuptohen mirë dhe jo të veçuara, si çështje në vetvete, pa lidhje të ngushtë midis njëra-tjetrës, në të tashmen dhe në të ardhshmen. Këto duhet të kuptohen si një kombinim i harmonishëm për ta çuar arsimin dhe kulturën përpara.

Ç'dua të them me këtë? Me këtë dua të them:

Së pari, djali ose vajza që ndjek shkollën duhet ta kuptojë mirë (por që ta kuptojë mirë duhet t'ia përsëritim vazhdimisht) vlerën që ka shkolla si një institucion për të mësuar, po aq i rëndësishëm për të sa edhe shtëpia, ku ushqehet çdo ditë. Pra, djali ose vajza, të mos e kuptojnë shkollën si një detyrë vetëm për moshën e tyre të re, por si një nevojë të domosdoshme për jetën e tyre. Po ta kuptojnë kështu, te ata do të

ngjallet dashuria e madhe për shkollën, për mësuesit, për diturinë.

**Së dyti**, kur djali ose vajza mbaron shkollën, zakonisht thotë: «Uf, shyqyr, i mbarova mësime, shkollën, provimet!». Nga kjo situatë kemi kaluar edhe ne dhe, pas nesh kështu do të bëjnë dhe të tjerë. Është një satisfaksion legjitim i rinisë që mbaron një fazë të jetës së saj, fazë e rëndësishme, kur ka filluar pjekuria e saj. Kjo është ashtu si me një punëtor që mbaron një punë dhe për këtë ndien kënaqësi. Pra, i riu dhe e reja, me mbarimin e shkollës, kanë fituar një betejë dhe për këtë, me të drejtë, gëzohen si ata, ashtu dhe ne. Por, këtu ka një gjë: i riu mund të mendojë se, mbasi mbaroi mësime dhe provimet, për të mori fund çdo gjë. Ndërsa ne të vjetrit e dimë që njeriu në jetë ka për të kaluar edhe shumë provime të tjera. Prandaj detyra jonë është që t'i marrim ata nga dora dhe t'i kalitim në betejat e jetës, që të mos thyhen nga vështirësitë.

**Së treti**, në luftën për jetën, i riu dhe e reja do të shohin se dituria e fituar në shkollë i ndihmon ata në jetën e përditshme, por në të njëjtën kohë do të shohin, dhe ne duhet t'i mësojmë që të shohin si duhet, se u duhet të perfeksionohen më tej, të zgjerojnë dituritë e tyre, që të punojnë më mirë, që të prodhojnë më shumë, që të rrojnë më mirë, ata dhe i gjithë populli. Ata do të shohin, dhe ne duhet t'i ndihmojmë që të shohin, se janë të detyruar, në luftën për jetë, jo vetëm të mësojnë vetë për veten e tyre, por të mësojnë edhe të tjerët. Pra, të gjitha ato që thamë, kthehen në një satisfaksion dhe detyrë në krahasim me atë që kanë pasur kur ishin të rinj. Prandaj ata do të shi-

kojnë më mirë se sa rëndësi kanë shkollat, kurset, mjetet, format që ka krijuar Partia e Qeveria, për t'i ndihmuar ata, jo vetëm që të perfeksionohen vetë, por të perfeksionojnë edhe të tjerët, se, duke punuar dhe duke luftuar për jetën, ata janë jo vetëm nxënës të përherëshëm, por edhe mësues, pedagogë.

Prandaj çështja që thashë më përpara, krijimi i institucioneve arsimore dhe kulturore, duhet t'u bëhet e qartë të gjithë kuadrove dhe inteligjencës sonë, në tërë kompleksitetin dhe vazhdimësinë e saj, dhe ata të kuptojnë se lufta e tyre për arsim dhe kulturë është një çështje jetike. Vetëm kështu ne do të mundemi të kryejmë me sukses ato që ka shtruar dhe shtron Partia, në lidhje me çështjen e kualifikimit të vazhdueshëm të specialistëve tanë.

Prandaj, shokë, ka rëndësi të madhe që këtë Plenum e bëjmë në këtë etapë. Siç dihet, ne tani kemi hyrë në etapën e ndërtimit të plotë të socializmit. Për realizimin e planit tonë pesëvjeçar ne kemi futur, edhe në të ardhshmen do të futim akoma më gjerë në prodhim teknikën dhe shkencën, domethënë do të zhvillohen më tej industria dhe minierat, do të vijnë makina më të komplikuar, të cilat duan njerëz të mësuar. Pra Plenumin e bëjmë lidhur ngushtë me problemet kyç që na kanë dalë ose që do të na dalin përpara.

Kudo zhvillohet luftë për rritjen e rendimenteve në punë. Për këtë bëhen përpjekje nga tërë kuadrot e Partisë e të pushtetit, nga tërë populli ynë. Populli tani e kupton, se ç'është thotë rritje e rendimentit. Na del përpara problemi i intensifikimit të bujqësisë. Sigurisht, në këtë drejtim do të bëhen studime të mëtej-

shme nga Partia dhe Qeveria dhe do të jepen udhëzime akoma më të qarta, por çështja e bujqësisë, perspektiva e saj, qëndron në rendin e ditës.

Rëndësi kanë rezervat tona të mëdha për kuadro. Sa rezerva kemi ne për përgatitjen e kuadrit? Pa fund. Kjo doli qartë këtu dhe mendoj se nuk është nevoja që t'i numëroj, sepse tani ne s'jemi as si dy vjet më parë, por fenomeni është bërë masiv. Edhe këto shënime që kam përpara, të cilat i kisha nxjerrë para se të vija këtu, m'i rrëzuan shokët që diskutuan. M'i rrëzuan, sepse, siç thashë, të gjithë diskutuan në një nivel të lartë. Po mos vallë nga kjo unë u turpërova? Përkundrazi, unë ndiej një kënaqësi të jashtëzakonshme, pse kjo tregon se Partia ka ditur që të krijojë me mijëra kuadro, që përbëjnë një forcë të madhe për të. Rëndësi për ne ka që këta kuadro janë kuadro të Partisë e patriotë dhe se kjo ndjenjë është futur në popull. Kështu e kuptojmë ne marksistët këtë gjë.

E kisha fjalën, shokë, te çështja e shfrytëzimit të rezervave, sa rezerva kemi ne për kuadro. Ne duhet të kemi parasysh se ka edhe nxënës që mbeten në klasë. Duhet të përpiqemi që këtë vështirësi ta kapërcejmë. Metoda më e mirë është që ta organizojmë si duhet punën, sesa t'i futim në konkurs. Unë nuk jam dakord me mendimin që propozohet për konkurs.

Çdo klasë krijon inteligjencën e vet, pra edhe klasa punëtore kudo, qoftë në fuqi, qoftë jo në fuqi, bën përpjekje kolosale që të krijojë kuadrin e saj, inteligjencën e saj. Inteligjenca e klasës punëtore duhet të kuptojë dhe të zbatojë vijën e klasës së saj, të asaj klase që, nëpërmjet luftërave të mëdha, të përgjakshme,

përpiqet të marrë fuqinë nga dora e uzurpatorëve (ashtu siç ia ka marrë atë borgjezisë te ne) dhe që përvetëson diturinë, shkencën e madhe botërore, të krijuar dhe të zhvilluar nga mendimtarët e mëdhenj të njerëzimit. Për këtë inteligjenca e klasës punëtore ka avantazhe të mëdha, ajo ka një armë të madhe: marksizëm-leninizmin, që e bën atë shumë më të aftë, shumë më të zonjën për të përvetësuar shkencën dhe për ta zhvilluar me sukses më tej.

Në këtë drejtim edhe Partia jonë marksiste-leniniste nuk ka bërë përjashtim. Ajo është treguar në lartësinë e detyrave të saj historike. Për këtë, ne komunistët dhe patriotët pa parti, mburremi që populli ynë dhe klasa jonë punëtore arritën një situatë të tillë. Ndryshime të mëdha janë bërë në vendin tonë në drejtim të ngritjes dhe të edukimit të kuadrove të rinj.

Mua nuk më pëlqen të them kuadro të vjetër dhe kuadro të rinj, sepse, para së gjithash, në të kaluarën ne kemi pasur fare pak kuadro dhe se shumica e tyre janë patriotë të ndershëm. Me këtë dua të them se inteligjenca e vjetër, e paktë në numër, është e bashkuar dhe përbën një trup të vetëm me inteligjencën e re, e cila është e madhe në numër. Kjo inteligjencë ka një motor të shëndoshë, që s'ka vdekje kurrë — Partinë, që çon përpara komunistët, kuadrot e rinj, duke i ndihmuar të përvetësojnë mirë diturinë dhe shkencën dhe që njëkohësisht ka ditur t'i rrethojë me një dashuri të ngrohtë, me një simpati të madhe dhe kujdes të vazhdueshëm të gjithë njerëzit përparimtarë të vendit tonë. Prandaj ne mburremi që kemi krijuar këtë inteligjencë, e cila ka dhënë prova të mëdha në

luftë dhe në ndërtimin e socializmit. Disa nga ju e dinë historinë e lavdishme të Ciolkovskit. Ai ishte mësues autodidakt; në një kohë kur s'kishte as libra dhe as manuale, kur ishte në një fshat të humbur të Kalugës, zbuloi vetë shumë gjëra të shkencës, bile edhe nga ato që ishin zbuluar më parë që nga Euklidi e deri te Paskali dhe, kur njoftoi për këto më lart, i kthyen përgjigjen: Ohu, ku je ti, këto janë zbuluar me kohë! Por ai vazhdoi punën e tij, gjersa arriti dhe zbuloi raketën. Pra i tillë ishte Ciolkovski dhe raketën e zbuloi ai dhe jo Nikita Hrushovi, që e trumbeton veten e tij si babai i raketës. Kanë qenë Lenini, dhe veçanërisht Stalini, që i dhanë gjithë përkrahjen shkencëtarëve sovjetikë për të arritur fitoret kolosale që dihen, kurse tani Nikita Hrushovi fryhet si kaposh dhe mburret me punën e tyre.

Pra ne krenohemi jo se kemi shpikur gjëra të mëdha, por sepse kuađrot tanë bëjnë përpjekje kaq madhështore, në kushte jashtëzakonisht të vështira, dhe i japin popullit atë që ka nevojë, pavarësisht se këto dhe mjaft gjëra të tjera janë shpikur me kohë përpara tyre.

Partia na ka mësuar që ta shohim e ta çmojmë këtë krijimtari kaq të madhe të mijëra kuadrove tanë, të cilët nuk i zë gjumi ditë e natë dhe t'i bashkojmë ata në një bllok të vetëm për të forcuar ekonominë, kulturën, lirinë e atdheut.

Është fakt që shteti ynë investon shuma të mëdha që fëmijët tanë të mbarojnë shkolla të kategorive të ndryshme, deri në universitet. Përparimi në mësimet e fëmijëve, sigurisht nuk është i njëjlojtë, për pasojë do

të ketë edhe nga ata që do të mbeten në klasë, megjithatë ata nxënës nuk duhet t'i konsiderojmë të humbur. Kjo ndodh edhe për faktin se kujdesi i familjes dhe kushtet ekonomike nuk janë të njëjlojta. Kryesorja është që shkollën ta ndjekin me kujdes fëmijët tanë e sidomos fëmijët e punëtorëve që janë një rezervë e madhe për sigurimin e kuadrove tanë.

Krahas këtyre çështjeve duhet të nxitim zhvillimin e iniciativave krijuese, të cilat kanë marrë vull dhe detyra jonë është ta shtojnë akoma më tepër këtë vull, e këtë do ta bëjnë nëpërmjet aktivizimit të kuadrove tanë, që t'i japim impuls në përgjithësi gjithë ekonomisë sonë. Kjo që një ndër arsyet që Byroja Politike vendosi të bëjë këtë Plenum për problemet e kuadrit.

Arsyeja tjetër është e lidhur me situatën ndërkombëtare, e cila na imponon detyrën që të forcojmë ekonominë dhe ushtrinë tonë. Kjo do të thotë se ne po ndërtojmë me sukses socializmin në një situatë të vështirë ndërkombëtare, prandaj duhet të jemi kurdoherë të gatshëm për të mbrojtur atdheun dhe fitoret e popullit, të mbrojmë socializmin në vendin tonë. Për këtë problem nuk do të zgjatim shumë, sepse në lidhje me këtë çështje, ju, shokë, jeni në korent.

*Pasi foli për disa probleme të situatës ndërkombëtare, për luftën e drejtë dhe parimore të PPSH kundër revizionizmit modern, shoku Enver Hoxha tha:*

Në një situatë të tillë, shokë, ne duhet të jemi sa më të fortë ekonomikisht dhe ushtarakisht. Ekonomikisht mund të themi se nuk jemi keq, ne jemi një popull i vuajtur, megjithëse nevojat tona gjithnjë në

rritje i kemi plotësuar. Ekonomia jonë po ecën përpara, planet realizohen, bile këta dy vjetët e fundit, në këtë tufan, në krahasim me të gjitha vitet e tjera, planet u realizuan shumë më mirë. Ky entuziazëm i madh që ka shpërthyer kudo për mbrojtjen e atdheut dhe për realizimin e planit, s'është parë asnjëherë.

Por në këtë situatë, shokë, neve na vihet detyrë që të forcojmë akoma më shumë ekonominë. Një nga faktorët vendimtarë për forcimin e ekonomisë janë kuadrot. Kuadrot kanë bërë mrekullira, por këta duhet të hedhin hapa të tjera të mëdha përpara, për ta forcuar akoma më shumë bujqësinë dhe industrinë tonë që të jemi sa më të fortë ushtarakisht. Ushtarakët dhe i gjithë populli janë të ngritur politikisht, moralisht, ideologjikisht dhe e dinë fare mirë pse luftojnë dhe pse i kanë armët në duar. Populli e ka kuptuar që ne jemi aktualisht të rrethuar dhe kjo është një gjë me rëndësi të madhe. Ne kemi shumë rreziqe, por populli nuk trembet. Kjo vjen nga puna e Partisë, nga ndershmëria e njerëzve tanë, nga patriotizmi dhe nga zgjuarsia e kuadrove tanë, qofshin këta me parti ose pa parti, qofshin civilë ose ushtarakë.

Kujt nuk iu bë zemra mal, kur dëgjoi se në ç'nivel teknik, arsimor dhe kulturor ka arritur ushtria jonë, pa folur këtu për zotësinë, ndershmërinë e cilësi të tjera të ushtarakëve tanë? Në qoftë se nuk gabohem, rreth 96 për qind e kuadrove të ushtrisë janë me shkollë dhe akademi ushtarake dhe përsa u përket njohurive të përgjithshme, vetëm 3 për qind janë me shkollë 7-vjeçare. Mendoni tani shokë, se në ç'gjendje ka qenë ushtria e Zogut. Shumica e tyre në problemet ushta-



rake, ishin injorantë, xhahilë, aq sa nënoficeri i thoshte ushtarit: «nga qepa, kthehu! nga hudhra, kthehu!».

Partia, Komiteti Qendror i saj, çështjes së forcimit të ushtrisë i kushtoi rëndësi të madhe që në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare. Atëherë ne nuk kishim ndonjë përgatitje ushtarake dhe bënim si bënim, ndërsa tani kemi krijuar, me të vërtetë, një kolektiv të mrekullueshëm; ushtria jonë është bërë një shkollë e madhe përsa i përket edukimit të ushtarëve dhe të oficerëve për të qenë të gatshëm në çdo situatë. Kujdesi i Partisë bëri që ne të arrijmë në një gjendje të tillë.

Kështu po bëjmë tani në të gjithë sektorët: në industri, në bujqësi, në shkolla, në edukimin e nxënësve dhe të mësuesve. Këtë ne po e arrijmë, sepse kemi mbajtur parasysh një gjë: njerëzit e brezit që u rrit në regjimin e demokracisë popullore dhe që në kohën e luftës ishin 5-6-7 vjeç, tani janë nga 25-30 vjeç dhe vijnë në punë me shkollë 7-vjeçare dhe me shkollë të mesme. Sa vite kalojnë aq më tepër i edukuar vjen brezi i ri. Në të ardhshmen, nuk do të kemi më aq vështirësi, sa kemi pasur gjer tani, qoftë në ushtri ose gjetkë.

A ju kujtohen, shokë, ditët e para pas Çlirimit të atdheut tonë? Atëherë detyra jonë ishte: luftë për të mbajtur në dorë pushkën, për të mbrojtur atdheun, por edhe luftë kundër analfabetizmit. Tani lufta kundër analfabetizmit ka marrë fund dhe njerëzit vijnë në ushtri jo analfabetë, por me shkollë 7-vjeçare. Tani pra është më e lehtë edhe për shokët e ushtrisë që t'i bëjnë këta njerëz me kulturë të lartë, njerëz të përsosur për çfarëdo armë. Ne jemi të bindur se ky Plenum do

ta çojë punën përpara, por që të arrihet kjo duhet të kemi parasysh, së pari, se kuadrot tanë që ne kemi ngritur dhe që do të ngremë, duhet t'i pajisim me ideologjinë tonë marksiste-leniniste dhe me kulturë të gjërë; së dyti, t'i pajisim me njohuri të thella teknike, profesionale; dhe së treti, t'u krijojmë mundësi kuadrove tanë të lidhen më ngushtë me prodhimin, me popullin, me librin. Këto tri gjëra duhet të na udhëheqin vazhdimisht në punën tonë me kuadrin.

Përpara nesh shtrohen gjithashtu dy detyra, domethënë dalin dy preokupacione:

Së pari, ne duhet të luftojmë akoma më shumë si për sasinë, por njëkohësisht edhe për cilësinë. Këtë e kërkon edhe situata në të cilën jemi. Shifrat që përmendi këtu një shok kur bëri krahasimin e vendit tonë me Gjermaninë Perëndimore, mund të jenë të drejta, por duhet pasur parasysh një gjë, se atje kultura është shumë e vjetër — shekullore dhe se në çdo fabrikë gjermane mund të ketë me dhjetëra inxhinierë, kurse të tjerët janë teknikë të mesëm. Që të arrijmë e të themi se ne me këtë ritëm kemi kapërcyer Gjermaninë Perëndimore, nuk është e drejtë. Ju e patë vetë se si e ngritën shokët këtu, qoftë për bujqësinë, industrinë, komunikacionin etj. Ashtu siç thashë, ne jemi në një situatë të tillë që duhet të luftojmë edhe për sasi, edhe për cilësi.

Së dyti, përfeksionimin e kuadrove duhet ta bëjmë me shpejtësi. Kjo është një detyrë e rëndësishme. Në këtë drejtim duhet pasur parasysh një gjë se vajzat dhe djemtë tanë, që mbarojnë shkollat me rezultate të mira, mesatare ose të dobëta, marrin gjithashtu një kulturë, jo vetëm kulturë të gjerë, por edhe speciale, me-

gjithëse ata, akoma nuk janë specialistë. Janë shumë me vend propozimet që bënë disa shokë mbi përcaktimin e disa kriterëve të drejta për ata që mbarojnë universitetin për të bërë një farë stazhi në prodhim. Ky duhet caktuar pas një studimi të mirë në përputhje me nevojat që paraqiten në sektorët e ndryshëm. Këtu duhet pasur parasysh edhe një çështje tjetër që këta kuadro, të cilët dalin nga shkollat, nuk gjejnë në terren ose në fushë një sasi kuadrosh të vjetër që t'i marrin këta në patronazh dhe t'i edukojnë.

Duke e parë çështjen në këtë prizëm, ne duhet të tregojmë një kujdes të madh veçanërisht për pedagogët. Udhëheqja e Partisë i përgëzon ata për zotësitë dhe veçoritë e tyre të shquara, si edukues dhe organizatorë të shëndoshë me frymë partie. Ne e dimë që ata janë të ngarkuar, se mbajnë mbi supet e tyre detyra të rënda dhe bëjnë sakrifica, këtej rrjedh ajo që nuk kanë pasur dhe aq mundësi të perfeksionohen më shumë. Por do ta gjejnë edhe këtë ilaç. Kjo gjendje influencën edhe në daljen e nxënësve me nota të dobëta. Kjo nuk është një ofezë për këta shokë, sepse ata janë të rinj. Ata me të vërtetë janë të mësuar, por kur mendojmë se gjer ku ka arritur sot shkenca dhe ç'forcë të madhe ka ajo, atëherë ata do të kuptojnë se duhet të bëjnë edhe më tepër përpjekje për të shkuar përpara.

Kuadrot, sidomos ata të rinjtë, ne duhet t'i ndihmojmë gjatë punës, t'u transmetojmë eksperiencën. Ata që mbarojnë shkollat, ne duhet t'i nxitim të mos harrojnë rëndësinë që ka regjimi i studimit. Në shkollë regjimi i studimit është i organizuar, mësuesi dhe profesori i mësojnë nxënësit e studentët se ç'duhet të

lexojnë. Por kur studenti del në jetë dhe futet në punë praktike, çështja e studimit për të bëhet edhe më e nevojshme. Prandaj ne duhet t'u bëjmë atyre thirrje që regjimin e studimit ta vazhdojnë me një vullnet të hekurt, duke marrë parasysh nevojat tona dhe nevojën e perfeksionimit të tyre, si dhe ndihmën që duhet t'u japin shoqëve për të ecur përpara puna në fabrikë ose në uzinë.

Shumë probleme që u ngritën nga diskutantët në lidhje me punën e studimit dhe të literaturës, mendoj se duhet t'i analizojmë në Byronë Politike dhe në Qeveri, sepse në këtë drejtim ka shumë probleme që duhen rishikuar. Kuadrot tanë në fabrika, uzina, kooperativa bujqësore e kudo, ashtu siç vlerësojnë mjetet e punës, duhet të vlerësojnë edhe një nga mjetet më të fuqishme — librin.

Problemi i studimit të librit duhet të bëhet me të vërtetë një çështje e madhe, shumë serioze, dhe se shteti ynë duhet medoemos t'i japë një zgjidhje. Ndoshta tani për tani nuk do t'i jepet zgjidhje definitive, por brenda mundësive tona ta shikojmë këtë çështje serioze për literaturën teknike-shkencore, e cila u duhet kuadrove tanë. Për sigurimin e literaturës së nevojshme është e domosdoshme të përcaktohen drejt dhe mirë disa kriterë.

Librat kushtojnë, prandaj duhet të shikohet çështja e tyre dhe të caktohen disa kriterë të drejta. Kriteri më i drejtë hëpërhë është që të sillen libra dhe revista për bibliotekat qendrore, qoftë edhe në dy-tri kopje. Ne kemi caktuar edhe fondet, por ato nuk janë shfrytëzuar si duhet. Mirë thanë shokët që diskutuan këtu, që për ndonjë specialist që ka shumë nevojë, mund të

bëhen edhe disa favore, për t'i sjellë ndonjë libër individualisht, por për edukimin e masës dhe të njerëzve tanë duhet të sillen libra në biblioteka.

Duhet bërë gjithashtu inventari i librave që kanë sidomos bibliotekat e dikastereve, sepse nga një relacion që lexova në lidhje me bibliotekat e tyre mësova se librat teknikë pothuaj nuk lexohen fare e për këtë më erdhi shumë keq. Që të qëndrosh indiferent përpara kësaj pasurie të madhe, të cilën e sigurojmë me sakrifica të mëdha për të përhapur diturinë, nuk është e drejtë. Prandaj, krahas inventarizimit, njerëzit, duhet të nxiten që të lexojnë e të mësojnë.

Por, që njerëzit të nxiten të mësojnë, është e nevojshme që të shikohet edhe çështja e lokaleve të bibliotekave. Nuk është e domosdoshme që të ngremë klube, por duhet që bibliotekës t'i japim karakterin e saj. Salla e leximit dhe biblioteka të jenë salla leximi dhe biblioteka në kuptimin e tyre të vërtetë. Bibliotekat, mundësisht, të jenë të ndara edhe në degë me salla për grupe të ndryshme specialistësh etj. Nga ana tjetër, duhet të arrihet që atje jo vetëm të studjohet, por të bëhet një studim i organizuar, ku herë pas here të qëndrojnë me turne njerëz të zotë, profesorë, të cilët të venë njerëzit për konsultim, lidhur me burimet bibliografike e me studimin e ndonjë problemi, siç bëhet edhe në bibliotekat e tjera të botës. Çështja është, pra, që të organizohet mirë regjimi i studimit. Kjo ka rëndësi të madhe, sepse shumë libra nuk i disponojmë në sasi të mëdha e për pasojë studimi do të bëhet i detyruar në bibliotekë, megjithëse nuk përjashtohet edhe studimi individual në shtëpi etj.

Shokë, ka njerëz, bile dhe kuadro, që nuk studjojnë seriozisht. Nuk duhet të lejohen kuadrot tanë që të mos kenë vullnet dhe të mos studjojnë. Nuk e kam fjalën këtu që të venë e të japin provime, por, duke marrë parasysh se kuadrot kanë një horizont të gjerë, ata kanë mundësi gjithashtu që të studjojnë libra të profesionit të tyre, ose të kulturës së përgjithshme. Çështja është që një kuadër ose një drejtues partie duhet të vejë në bazë për të ndihmuar, pse të tjerët presin dhe kërkojnë ndihmën e tij. Por, që të bëhet kjo, duhet të përgatitesh me seriozitetin e duhur.

Duhet shënuar edhe një gjë, se ka edhe njerëz që lexojnë, por që nuk dinë të lexojnë. Kjo është një e metë e madhe. Koha është e vlefshme, shokë. Kuadrot duhet të lexojnë.

Së pari, të thellojnë njohuritë e tyre tekniko-profesionale, krahas kulturës së përgjithshme. Duhet vënë në dukje se ka njerëz që gjejnë kohë dhe lexojnë çdo gjë, për të kaluar kohën. Mund të lexojnë çdo gjë për të kaluar kohën. Mund të lexojnë, po pse ta humbasin kohën kot? Çdo gjë është interesante. Por s'ka gjë më interesante sesa nga një anë të zhvillosh profesionin: tënd, nga ana tjetër të merresh edhe me çështjet teknike dhe shoqërore. Unë nuk e kam fjalën këtu se nuk duhet lexuar literaturë artistike. Jo, ajo ka rëndësi të madhe. Por një drejtues që merret dhe lexon vetëm literaturë artistike dhe neglizhon pajisjen me kulturë speciale dhe të përgjithshme, nuk e ka drejt. Prandaj ne duhet t'i mësojmë njerëzit se çfarë duhet të lexojnë dhe si duhet të lexojnë.

Së dyti, ka gjëra që njeriu mund t'i lexojë lehtë,

por ka edhe gjëra që kërkojnë të ulësh e të studjosh dhe që duhen nënvizuar. Një studim serioz të vë edhe përpara detyrash të reja. Studimi bëhet edhe në punë dhe në të gjitha format. Unë nuk do të numëroj format, sepse besoj që ju jeni të qartë lidhur me orientimin dhe format që ka krijuar Partia. Propozimet që u bënë këtu në lidhje me përmirësimin e punës dhe format që janë rekomanduar nga Partia, duhet të vihen në jetë. Por unë theksova rëndësinë e madhe që ne duhet t'u kushtojmë librave, bibliotekave dhe revistave shkencore.

Tani, shokë, dua të them pak fjalë edhe lidhur me organizimin e një pune më të madhe që ne duhet të bëjmë për përhapjen e njohurive shkencore në masa. Çështja është që, përveç formave që përmendëm, të përdorim dhe disa forma më të gjera e të organizuara sipas specialiteteve. Kështu, për shembull, të tilla të ketë me agronomë, zooteknikë etj. Si të thuash, Instituti i Lartë i Bujqësisë të ndihmojë kuadrot dhe specialistët e bujqësisë në rrethe me seminare, konferenca në shkallë kombëtare etj. Që të mund ta bëjë më mirë këtë, a do të ketë mundësi që në ato rrethe ku ka shumë specialistë të bujqësisë, agronomë, veterinerë etj. të krijojmë një këshill, i cili të mbajë lidhje me Institutin e Lartë të Bujqësisë dhe që në tre ose në gjashtë muaj një herë t'i mbledhë në mënyrë të organizuar këta kuadro dhe t'i mbajë në korent për çështjet më të rëndësishme?

Edhe përsa u përket mjekëve, Fakulteti i Mjekësisë në qendër të shikojë mundësinë që të mblidhen mjekët në ato rrethe ku ka shumë. Në rrethe, pranë

spitaleve ose drejtorive të shëndetësisë të krijohen këshilla shkencore, të cilat të organizojnë seminare për shkëmbimin e eksperiencës mjekësore dhe, sipas nevojave, të aktivizojnë mjekët për propagandë sanitare me masat e popullit etj. Ndërsa shoqata e juristëve që ekziston, nga një anë, duhet të mbajë lidhje të vazhdueshme me Fakultetin Juridik, nga ana tjetër, të ketë si detyrë që të mbahet në korent dhe të organizojë në 1-2 rrethe seminare e konferenca me juristët e të tjerë, që këta të organizojnë biseda e konferenca me masat për shpjegimin e ligjeve. Kështu që këto gjëra të mos i lihen spontancitetit, por të bëhen në mënyrë të organizuar e në forma tërheqëse.

Mundet që këto forma të mos jenë shumë të përshtatshme, unë nuk insistoј për to, por rëndësi ka që të përdorim të gjitha mjetet dhe metodat e përshtatshme për kualifikimin e kuadrove e për përhapjen e njohurive shkencore dhe të kulturës së përgjithshme.

Të gjithë kuadrot, përveç funksioneve dhe detyrave që kanë, duhet të merren edhe me punë shoqërore. Të merresh me punë shoqërore do të thotë që të interesohesh për fatin e popullit dhe të vendit tënd. Fati i vendit tonë nuk është në duart e disave, por në duart e të gjithë popullit, prandaj e kemi për detyrë që të bëjmë punë shoqërore, të flasim me popullin për politikën, të bëjmë referate, të jetojmë me popullin dhe të ndihmojmë për edukimin e rinisë me shije të shëndosha kudo që të jetë. Kështu ne do t'i vijmë në ndihmë popullit. Unë këtu nuk dua të them që të vejë, për shembull, një mjek dhe t'i flasë popullit për problemin e armëve atomike. Jo. Mjeku të vejë e të flasë



për shëndetin ose për dobinë e perimeve. Prandaj puna shoqërore duhet të kuptohet e gjithanshme dhe si një nga detyrat më me rëndësi, si një nga detyrat që ka të bëjë me fatin e popullit dhe të atdheut. Me punë shoqërore të merremi aq sa të kemi kohë. Kështu, pra, përveç të tjerave, kuadrot mund të flasin në konferenca etj. Mirëpo është e nevojshme që ata që organizojnë këto konferenca, të kenë parasysh edhe një gjë, mundësitë e kuadrove dhe t'u krijojnë atyre lehtësitë e duhura për një punë të tillë. Këto punë duhet të bëhen në bashkëpunim të ngushtë dhe me pëlqimin e të dyja palëve, duke e kuptuar parimin drejt.

Desha të theksoj edhe një gjë tjetër se për çfarë duhet të bisedojmë në kohë të lirë në mes nesh, në klub, në shtëpi etj. Natyrisht, jeta ka shumë gjëra. Edhe me gruan e me fëmijët do të bisedosh. Por e kam fjalën këtu, që në takime, jo në mbledhje zyrtare e konferenca, por gjatë takimeve të lira duhet të mësohemi që të rrahim probleme. Të mësohemi që, veç gjërave që janë dëfryese, të krijojmë një traditë që të mos flasim sa për të kaluar kohën, por të krijojmë një ambient edhe për bisedime serioze. Dhe këtë duhet ta bëjmë jo për të shitur mend, për të thënë që unë di dhe ti s'di, por, kur jeta dhe koha ngrenë një problem, atëherë ta diskutojmë këtë problem seriozisht. Në qoftë se njëri di më shumë se një tjetër, atëherë duhet mësuar që të dijë më tepër edhe ky i fundit, ose në qoftë se njëri di diçka, të rrahë mendime me një tjetër në kohë të lirë. Kjo influencon tepër, shokë, në shumë drejtime dhe të nxit për të shkuar përpara. Kuadrot tanë janë në gjendje ta bëjnë këtë se kanë kulturë.

Duhet t'i lëvizim ata në këtë drejtim, sepse do të shohim se do ta ndiejnë kështu veten të kënaqur.

Unë nuk do të hyj thellë në dobësitë që janë vërtetuar, por mendoj se e tërë puna duhet të rishikohet që nga dikasteret e komitetet ekzekutive, që nga aparati i Komitetit Qendror e komitetet e Partisë në rrethe dhe kjo punë të organizohet më mirë, të ndihmojmë më shumë dhe të ecim përpara.

Tani dua të them edhe nja dy gjëra të tjera. Ne duhet të kemi parasysh që të sillemi mirë me kuadrin dhe të jemi të durueshëm me të. Kjo është një punë partie me rëndësi të madhe. Kush sillet mirë me kuadrin, ai do ta ndihmojë atë që të ecë përpara. Ndodhin momente të vështira, ndodhin edhe momente nervozizmi, kur, për shembull, ndonjë kuadër gabon, mirëpo ne duhet të përpiqemi të ruajmë ose të fitojmë prapë gjakftohtësinë, ta marrim atë pas vetes dhe të përpiqemi që ta edukojmë.

Këtu e kam fjalën që kuadrot në përgjithësi duhet t'i ruajmë mirë, kurse kuadrot e rinj duhet t'i ngremë me guxim e në kohën e duhur, t'i ndihmojmë, të kemi te ata më shumë besim, të arrijmë që të kuptojnë mirë vijën e Partisë e ta bëjnë atë të tyren, ta zbatojnë, të përgjigjen për të dhe ta mbrojnë. Po të punojmë në këtë mënyrë, atëherë do të krijojmë me të vërtetë kuadro marksistë revolucionarë. Por krahas kësaj ne duhet të mësojmë dhe kuadrot e vjetër, që të ndihmojnë dhe të mos pengojnë kuadrot e rinj. Edhe në këtë rast unë nuk po them ndonjë gjë të re, pse që kuadrot e vjetër kanë tendencë që të ecin më ngadalë, kjo dihet. Ata kanë parë halle më shumë, kanë vjetërsi, kanë ekspe-

riencë më shumë. Ndërsa të rinjtë kanë hov, duan të ecin më shpejt. Kuadrot e vjetër janë palca e kurrizit, por edhe të rinjtë janë revolucionarë. Megjithatë mund të themi se për ne nuk ka qenë ndonjëherë problem çështja «i vjetri dhe i riu». Bile neve do të na vinte ca si çudi po të na thonin se një teknik i vjetër ka penguar një të ri, sepse Partia ka pasur shumë kujdes në këtë drejtim.

Dëshiroj të theksoj këtu edhe çështjen e edukimit marksist-leninist të kuadrit, të cilën e kemi ngritur kurdoherë. Ne duhet të bëjmë që kuadrot të jenë të qartë politikisht dhe të zhvillojnë në maksimum botë-kuptimin marksist-leninist. Çështja e specializimit është një gjë e veçantë, kurse shkenca e marksizëm-leninizmit është për të gjithë. Prandaj kuadrot tanë, të çfarëdo specialiteti, qofshin këta mjekë, inxhinierë etj., duhet të njohin shkencën marksiste-leniniste, ligjet e zhvillimit të shoqërisë, ligjet e zhvillimit ekonomik, ligjet e zhvillimit të socializmit dhe të komunizmit. Të gjitha këto i duhen kuadrit pse pa këto nuk mund të ecë përpara. Çështja e profesionit, pra, nuk mund të përjashtojë njeri që të mos pajiset me marksizëm-leninizmin. Kjo është e vetmja hallkë që i hap kuadrit një horizont të gjerë edhe në specializimin e tij të veçantë. Prandaj studimi i marksizëm-leninizmit, studimi i ligjeve të zhvillimit të shoqërisë dhe të ekonomisë i duhet çdo njeriu dhe çdo kuadri. Partia jonë nuk ka pushuar dhe nuk do të pushojë kurrë së edukuari kuadrin ideologjikisht dhe politikisht. Edhe ne, udhëheqësit, nuk mund të pretendojmë dhe të mendojmë se e zotërojmë marksizëm-leninizmin «në ma-

jë të gishtërinjve». Po, një gjë është e qartë, shokë, se të tërë, qoftë teorikisht, qoftë praktikisht po ccim, në mënyrë të vendosur në rrugën e marksizëm-leninizmit. Kështu, pra, shokë, Partia u ka vënë rëndësi shumë të madhe edukimit të kuadrit dhe në mënyrë të veçantë pajisjes së tij me njohuritë marksiste-leniniste. Por në këtë drejtim ne duhet të bëjmë akoma më shumë. E shikoni se ç'detyra të mëdha kemi, ç'rreziqe të mëdha kemi! Prandaj duhet të mësojmë edhe më shumë, duke luftuar dhe duke punuar nën flamurin e marksizëm-leninizmit.

A kemi mundësi që të arrijmë në një shkallë akoma më të lartë në këtë drejtim? Po, kemi mundësi, dhe për këtë po përdoren të gjitha format. Por për zbatimin e kësaj detyre duhet t'i japim rëndësi të veçantë edhe studimit në mënyrë individuale. Për këtë duhet të përpiqemi që të sigurojmë materialet që nevojiten. Por, në qoftë se këto nuk gjenden, atëherë duhet shkuar te ata që janë në gjendje t'i shpjegojnë. Nuk duhet pasur turp për këtë edhe sikur të jesh më i madh, mund të shkosh te ai më i vogli ose më i vogli të shkojë te më i madhi, për të mirën e punës, në interes të Partisë dhe të popullit.

Përsa i përket ngritjes politike, Partia ka bërë një punë të madhe. Populli ynë është i mprehtë politikisht, për të mos folur më për kuadrot. Kjo është një fitore e madhe. Por ne duhet ta mbajmë popullin vazhdimisht në korent që të jetë i qartë për çdo gjë, t'i shpjegojmë të gjitha rreziqet dhe të mirat, t'i tregojmë rrugën që duhet të ndjekë, të kuptojë mirë taktikën. Populli, kur është i ngritur mirë, e kupton si duhet edhe

taktikën. E kupton populli, për shembull, sepse që prej dy-tre muajsh ne nuk flasim në shtyp e në radio me emër për Nikita Hrushovin. Po të jetë nevoja, ne përsëri do të flasim për të. Pra populli e di si është puna.

Duke përfunduar fjalën time, shokë, dëshiroj të theksoj se çështja që ngriti Plenumi për përgatitjen dhe për kualifikimin e kuadrit, na vë detyra të mëdha që patjetër do t'i kryejmë, siç kemi kryer të gjitha detyrat tona. Rruga që na cakton Partia është e drejtë dhe ne asnjëherë s'ia kemi bërë dy fjalën Partisë, sepse nga kjo rrugë ka interes dhe varet fati i popullit dhe mbrojtja e atdheut.

Në punën tuaj ju, dhe të gjithë shokët e tjerë, do të keni kurdoherë ndihmën e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë. Ta kërkonit këtë ndihmë në çdo rast dhe në çdo moment. Edhe ne kërkojmë e do të kërkojmë kurdoherë ndihmën tuaj. Kjo ndihmë duhet të jetë e dyanshme, reciproke, kështu zgjidhet mirë puna. Kështu puna jonë do të ecë drejt dhe përpara.

Shokët e ftuar i falënderojmë nga zemra për këtë kontribut që i dhanë Komitetit Qendror në zgjidhjen dhe në përcaktimin e detyrave të këtij Plenumi!

Ju uroj të gjithëve punë të mbarë!  
Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **«ZËRI I POPULLIT» LUFTËTAR I VENDOSUR PËR ÇESHTJEN E PARTISË**

*Letër përshëndetjeje me rastin e 20-vjetorit  
të themelimit të gazetës «Zëri i popullit»*

**25 gusht 1962**

Të dashur shokë,

Ju përshëndesim nxehtësisht me rastin e 20-vjetorit të botimit të numrit të parë të «Zërit të popullit», gazetës luftarake të Partisë sonë të lavdishme dhe ju urojmë suksese të mëtejshme në detyrën e rëndë, por shumë fisnike që ju ka ngarkuar Partia!

Njëzet vjet më parë, vetëm një vit pas themelimit të Partisë, doli «Zëri i popullit». Kjo është një ngjarje e shënuar në historinë e Partisë sonë. «Zëri i popullit», duke shprehur kurdoherë aspiratat më të thella të popullit, u bë ndihmësi më i afërt i Partisë për mobilizimin e masave në Luftën Nacionalçlirimtare dhe arma më e mprehtë për demaskimin e pushtuesve fashistë e tradhtarëve të vendit. «Zëri i popullit», duke vënë

në dukje vetitë luftarake dhe traditat revolucionare të popullit tonë, forcoi edhe më shumë ndjenjat e patriotizmit në masat, çoi në çdo skaj të vendit fjalën e zjarrtë të Partisë, përhapì të vërtetën marksiste-leniniste dhe mbushi zemrat e shqiptarëve me dashurinë për lirinë, atdheun dhe socializmin.

Në kohët më të vështira dhe në betejat më të ashpra pas Çlirimit, «Zëri i popullit» e ndihmoi Partinë në luftën për forcimin e pushtetit popullor, për mbrojtjen e pavarësisë së atdheut dhe për ndërtimin e socializmit. «Zëri i popullit» ka qenë kurdoherë një luftëtar i vendosur për çështjen e popullit dhe të Partisë, për triumfin e ideve të mëdha të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Në themelet e Shqipërisë së re, që doli nga revolucionin ynë popullor, dhe të socializmit të ne, bashkë me gjakun e mijëra dëshmorëve dhe djersën e punëtorëve, fshatarëve e intelektualëve patriotë, gjejmë edhe fjalën e urtë, gjithmonë të drejtë, të «Zërit të popullit». Prandaj gjithë populli ynë e do «Zërin e popullit», këtë luftëtar të paepur e besnik të dëshirave të tij.

Sot «Zëri i popullit» qëndron në radhët e para të luftës që bën Partia për mbrojtjen e atdheut tonë socialist dhe për ndërtimin e plotë të socializmit në Shqipëri. Ai është tribuna e përpjekjeve titanike që po bëjnë populli dhe Partia për ta çuar vendin tonë përpara me hapa të shpejta. «Zëri i popullit» është sot një militant i flaktë në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, për sigurimin e paqes në botë dhe

për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit. «Zëri i popullit» ruan dhe zhvillon të gjitha ato cilësi që kërkonte Lenini i madh nga shtypi bolshevik: principialitetin dhe besnikërinë e pafund ndaj çështjes së popullit e të Partisë. Artikujt e «Zërit të popullit» janë me të vërtetë rreze drite që u ndriçojnë rrugën njerëzve tanë. Jehona e tyre sot dëgjohet edhe jashtë kufijve të atdheut tonë.

Komiteti Qendror është i bindur se edhe në të ardhshmen «Zëri i popullit» do të luftojë si një propagandist, agjikator dhe organizator kolektiv për triumfin e vijës së Partisë. Momentet historike që kalojmë dhe detyrat e mëdha që kemi përpara, kërkojnë që të forcohet gjithmonë e më shumë karakteri militant i «Zërit të popullit» dhe, në shembullin e tij, i të gjithë shtypit tonë popullor. «Zëri i popullit» të bëhet një edukator i vërtetë i popullit, duke përhapur eksperiencën më të mirë të masave e të Partisë dhe të luftojë me të gjitha forcat për vënien në jetë të vendimeve historike të Kongresit të 4-t të Partisë, për realizimin e detyrave të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, për edukimin e njeriut të ri. Propagandimi i ideve të marksizëm-leninizmit, forcimi i unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, demaskimi deri në fund i imperializmit dhe i revizionizmit mbeten një nga detyrat kryesore të «Zërit të popullit».

Është detyra juaj, të dashur shokë, ta bëni «Zërin e popullit» një gazetë me përmbajtje sa më të lartë politike dhe ideologjike, sa më tërheqëse, sa më të dashur për popullin. Për këtë pasuroni përherë e më



shumë dijet tuaja politike e teorike, ngrini paresh-tur aftësitë tuaja profesionale dhe mjeshtërinë e gazetarit!

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë  
së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
Nr. 203 (4361), 25 gusht 1962*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## PEZA HEROIKE — NJË NGA BAZAT E SHËNDOSHIA TË LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE

*Fjala në drekën e shtruar me rastin e 20-vjetorit  
të Konferencës historike të Pezës*

16 shtator 1962

Të dashur shoqe dhe shokë,

Kanë kaluar 20 vjet që nga dita kur u mbledh këtu Konferenca e Pezës, por zemrën e kemi edhe më të re se atëherë. Tani jemi më të pjekur e më të kalitur, dhe shohim se ato që na mësoi Partia dhe lufta e udhëhequr prej saj, i sollën rezultate të mëdha popullit shqiptar. Për këto zemrat tona sot janë shumë të gëzuara; gëzimi kurdoherë e forcon njeriun, jo vetëm fizikisht, po edhe shpirtërisht, forcon zemrën dhe nervat e tij, gjë që ka rëndësi të madhe, sepse gjendja shpirtërore mban gjallë edhe trupin.

Qëllimet e Konferencës së Pezës kanë qenë të shejta: të bashkonin gjithë popullin shqiptar në luftën kundër armikut të egër fashist, i cili kishte në plan të na shtypte e të na skllavëronte. Prandaj Partia, me

programin e saj, mendoi drejt për të siguruar bashkimin politik të popullit, kjo ishte një nga çështjet vendimtare të Partisë sonë.

Një parti që nuk ka me vete popullin, që nuk përfaqëson dëshirat e tij dhe nuk lufton për t'i realizuar ato në jetë, që nuk kupton se liria duhet të arrihet me luftë, që nuk kupton problemin e madh të aleancës në mes shtresave të ndryshme të popullit, brenda vendit, si edhe çështjen e aleancës jashtë vendit në rrugë të drejtë, ajo nuk mund të jetë parti marksiste-leniniste. Këto mësimë Partia jonë i ka pasur kurdoherë parasysht dhe duke i zbatuar ato me sukses në kushtet e vendit tonë, i siguroi popullit shqiptar gjithë këto fitore të mëdha. Prandaj qysh në fillim, por sidomos gjatë këtyre 21 vjetëve pas themelimit të Partisë, është kalitur dhe është shtuar shumë dashuria e madhe që ka populli ynë për Partinë. Kur populli sheh gjithë këto realizime madhështore që janë arritur në vendin tonë thotë: e urtë, e guximshme dhe e papërkulur ka qenë Partia jonë. Dashuria e zjarrtë dhe simpatia e madhe që manifestohet për Partinë i kanë bazat në realizimet konkrete që janë arritur gjer më sot në vendin tonë, nën udhëheqjen e Partisë. Prandaj në masat tona punonjëse ekziston një besim i patundur te Partia.

Shokë dhe vëllezër, të gjitha të mirat që gëzojmë sot u realizuan në saje të unitetit të fortë midis Partisë dhe popullit tonë. Përpara se të themelohej Partia, shumë njerëz kishin influencë në popull, në saje të lidhjeve të vjetra, miqësive, krushqive, akraballëqeve, lidhjeve tregtare dhe të tjera. Nuk do të ishte mirë, po

të mos i kishim parasysh të gjitha këto. Partisë Komuniste të Shqipërisë megjithëse e re (edhe gjithë anëtarët e saj ishin të rinj), i duhej t'i studjonte, t'i kishte parasysh këto rrethana dhe të ecte përpara e matur e me guxim.

Po ku e gjeti këtë forcë të madhe Partia Komuniste e Shqipërisë, e cila bëri të arriheshin gjithë këto fitore për popullin shqiptar, megjithëse në fillim kishte fare pak anëtarë? Këtë forcë Partia e gjeti te populli ynë, te virtytet e tij të larta, te njerëzit e popullit tonë, me të cilët u lidhën komunistët, sepse anëtarët e Partisë ishin dhe janë bijat dhe bijtë e këtij populli. Virtytet dhe qëllimet e larta të popullit tonë, taktikat e tij të drejta, pastërtinë morale dhe thjeshtësinë e popullit tonë, Partia diti t'i gërshetojë bukur me marksizëm-leninizmin.

Marksizëm-leninizmi është shkenca jonë e lavdishme. Ne, komunistët shqiptarë, as që na vjen rëndë të themi se në fillim nuk e njihnim mirë marksizëm-leninizmin; atëherë ne ishim në hapat e para të kësaj pune. Por populli, që na besoi neve ta udhëheqim në luftë, na ndihmoi dhe na mësoi me urtësinë e tij. Mësuesit tanë të pavdekshëm, Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini e kanë nxjerrë teorinë e tyre të madhe të socializmit shkencor, e cila do të triumfojë në të gjitha vendet, nga eksperiencia e madhe shekullore e popujve, nga eksperiencia e klasës punëtore, e fshatarësisë dhe e inteligjencës të të gjitha vendeve.

Mungesën e njohurive marksiste-leniniste në kohët e para, ne e plotësuam me diturinë, zotësinë, urtësinë dhe eksperiencën e popullit, dhe nuk u gabuam.

Prandaj uniteti i Partisë me popullin u bë i pathyeshëm. Në këtë drejtim një rol vendimtar ka luajtur Konferenca e Pezës, e cila u mbajt këtu në Pezë në shtator të vitit 1942.

Partisë sonë nuk mund t'i bëhet as akuza më e vogël, nuk mund të gjendet asnjë fakt apo argument kundër saj, që të vërtetojë se komunistët e orës së parë në Shqipëri nuk kanë punuar dhe nuk kanë luftuar për unitetin e popullit shqiptar. Me cilët nuk kemi biseduar dhe nuk jemi takuar ne, qysh në fillim? Me të gjithë, që nga Lumo Skëndoja, Ali Këlcyra dhe gjer te krerët e tjerë të reaksionit. Ne kemi biseduar shtruar me ta, me dashamirësi, për të mirën dhe interesin e popullit, kemi mbyllur një sy, kemi bërë edhe ndonjë lëshim ndaj tyre. Të gjitha këto i kemi bërë për hir të unitetit, me qëllim që armikut të mos i jepnim asnjë njeri.

Partia jonë, pra, nuk mund të akuzohet se s'ka dashur dhe s'ka luftuar për unitetin, e ca më pak nuk mund të akuzohet ajo për vëllavrasje. Reaksionarët u hodhën në vëllavrasje, ata u inkuadruan në forcat gjakatare të fashistëve italianë dhe gjermanë, kurse ne bëmë detyrën tonë, në unitet me popullin rrëmbyem armët dhe i dërrmuam. Unë dëshiroj të flas pak veçanërisht për çështjet e Pezës, sepse shoku Spiro Koleka foli në miting për Luftën tonë Nacionalçlirimtare dhe për sukseset në ndërtimin e socializmit pas Çlirimit, si për zhvillimin e industrisë, kolektivizimin e bujqësisë, për shkollat e shumta që janë hapur e ndërtuar, për kuadrot e lartë dhe të mesëm, që janë përgatitur me shumicë dhe për sa e sa gjëra të tjera, që ia kanë ndry-

shuar pamjen atdheut tonë, për ecjen gjithnjë nën udhëheqjen e Partisë drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Unë dëshiroj të flas pak për krahinën e Pezës, për popullin e saj luftëtar dhe për shokun dhe mikun e shtrenjtë Myslym Pezën. E di se shokut Myslym nuk i pëlqen të flasim për të, po nuk kam si të mos flas sot me rastin e këtij përvjetori.

Më parë dua të them përse Partia e zgjodhi Pezën për mbledhjen e Konferencës historike të shtatorit 1942. Partia mund ta mblidhte këtë Konferencë edhe në ndonjë vend tjetër me tradita luftarake, që ka nxjerrë gjithashtu revolucionarë të shquar si Myslym Peza, me kushte më të mira sigurie nga goditjet e armikut. Por për Partinë ka pasur një rëndësi shumë të madhe mbledhja e Konferencës në Pezë. Partia ka pasur arsytet e veta, të forta, që kjo Konferencë të bëhej këtu, sepse një gjë e tillë ishte një sfidë ndaj pushtuesve italianë. Ajo ishte një sfidë me kuptim të madh, ajo nuk ishte sfida e një grushti komunistësh dhe patriotësh, po një sfidë që përfaqësonte kryengritjen e armatosur të popullit shqiptar kundër një agresori, që kishte pushtuar vendin tonë. Me këtë Konferencë Partia u thoshte pushtuesve italianë: ja, nën hundën tuaj ne vumë një nga gurët themeltarë të pushtetit popullor. Për këtë arsye, pra, u zgjodh Peza si vendi më i përshtatshëm për Konferencën dhe për këtë morëm parasysh edhe sakrificat që do të bënte populli i krahinës së Pezës.

Peza ishte një vend shumë i përshtatshëm edhe për zhvillimin e Luftës Nacionalçlirimtare brenda vetë kryeqytetit. Partia qysh në fillim, kur po organizohe-

shin dhe hidheshin në sulm njësitet e para guerile, mendoi se Peza duhej të bëhej një bazë e shëndoshë e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit tonë. Partia kishte parasysh se lufta do të bëhej e rreptë, e tmerrshme, prandaj Peza, këtu afër Tiranës, duhet të ishte mbështetja kryesore e veprimeve ilegale të Partisë.

Zgjedhja e Pezës bëhej edhe me një qëllim tjetër perspektiv. Duke pasur qendrën e saj kryesore në afërsitë e kryeqytetit, qysh në fillim të luftës, Partia mendoi ta bënte Pezën edhe një bazë të rëndësishme për stërvitjen e partizanëve që do të dilnin në mal më vonë. Partia gjithashtu mendonte që edhe më vonë, kur lufta do të bëhej më e ashpër dhe do të arrihej në pragun e Çlirimit të Shqipërisë, Tirana të përshkohej nga një rreth i zjarrtë, me qëllim që forcat e reaksionit të mos inkuadroheshin dot me ndihmën e okupatorëve, ose të agjentëve të imperializmit anglo-amerikan, për të penguar çlirimin e kryeqytetit nga forcat partizane nacionalçlirimtare dhe të krijonin kështu trubullira për të penguar vendosjen e pushtetit popullor. Këto që po them, janë të dokumentuara.

Në Konferencën e Pezës mori pjesë edhe shoku Myslym Peza, njeri i thjeshtë, po që ka luajtur një rol me rëndësi në Luftën Nacionalçlirimtare. Edhe pa pasur taserën e Partisë, ai qysh në fillim e kuptonte si komunist vijën e Partisë.

Qëkur Partia ra në kontakt me këtë patriot të madh, asnjë re, sado e hollë, nuk ka kaluar në shoqërinë, miqësinë dhe në besnikërinë e shtrenjtë të Myslym Pezës ndaj Partisë dhe të Partisë ndaj Myslym Pezës. Siç dihet në Konferencën e Pezës morën pjesë

njerëz me parti dhe pa parti dhe ne, megjithëse e dinim cilët ishin njerëzit si Abaz Kupi, Kamber Qafmolla etj., vepruam me durim të madh me ta. Më kujtohet se si, kur dolëm me Myslymin në një arë gjatë pushimeve të Konferencës, ai më tha: «E di unë ç'njerëz janë këta, po duhet të kemi durim». «Ashtu është, iu përgjigja unë, ne duhet të kemi durim».

Platforma e Konferencës së Pezës ishte bashkimi dhe mobilizimi i të gjithë popullit në Frontin Nacionalçlirimtar. Por lufta bëri diferencimin e njerëzve, ata që nuk ishin me popullin, e treguan veten e tyre ç'ishin, po edhe Partia jonë me vijën dhe luftën e saj të drejtë tregoi ç'ishte, prandaj populli e përqafoi vijën e saj të drejtë dhe e ndoqi atë gjer në fund në vështirësi dhe në ditë të mira.

Për shërbimet e mëdha që solli, Konferenca e Pezës ka një rëndësi të madhe, prandaj çdo përvjetor i saj duhet të festohet brez pas brezi, ajo duhet të studjohet me vëmendje, që nga më i madhi e gjer te më i vogli, e jo vetëm në vija të përgjithshme, po edhe në çështje të veçanta edhe në hollësira.

Partia në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare gjeti te Myslym Peza dhe te gjithë populli i kësaj krahine një mbështetje vendimtare. Kam 23 vjet që e njoh Myslym Pezën dhe që kam bashkëpunuar me të. Pra, unë e njihja Myslymin më parë se Konferenca e Pezës, në kohën kur Partia më caktoi detyrën të takohe-sha me të. Myslym Peza e donte shumë popullin e varfër, që ishte hedhur me kohë në luftë dhe në armiqësi me regjimin kusar dhe shtypës të Ahmet Zogut. Lidhjet e Myslymit, miqësitë e tij me njerëzit e asaj



kohe kishin një rëndësi relative për të, ai i shikonte ato nën prizmin e qëndrimit ndaj popullit. Myslymi mendonte dhe vepronte kështu jo se ishte i pregatitur teorikisht, teori ai nuk dinte shumë, po se në këtë rrugë atë e udhëhiqte shpirti i tij i pastër, drejtësia që e karakterizon dhe ndjenjat e tij patriotike.

Të tillë e njihja unë Myslym Pezën, kur u themelua Partia dhe kështu ia rekomandova Partisë. Pra Partia më ngarkoi mua dhe në këto rrepa u takova me të dhe me shokët e tij. Ata më gostitën me një copë bukë dhe me disa ullinj. Të gjithë, që nga Myslymi, Kajo Karafili e gjer te xha Kasëmi<sup>1</sup>, ramë dakord e vendosëm: luftë kundër okupatorëve dhe tradhtarëve të atdheut. Myslym Peza qëndroi kurdoherë i palëkundur me Partinë.

Myslym Peza gëzon një dashuri dhe influencë të madhe këtu në Pezë, po ai kurrë nuk e përdori këtë për të rritur influencën e tij personale, atë ai e kanalizoi në rrugën e drejtë të Partisë. Disa tradhtarë që morën pjesë në Konferencën e Pezës, po që nuk i përkrahën asnjëherë vendimet e Konferencës, e njihnin mirë influencën që kishte te populli i kësaj krahine Myslym Peza dhe mendonin se ai, duke mos qenë komunist, nesër ose pasnesër do të lëkundej. Po sa u gabuan këta tradhtarë! Ata vetëm një gjë dinin me saktësi, që influenca e Myslym Pezës ishte e madhe, jo vetëm në rrethin e Tiranës, por edhe më tej. Po Myslymi nuk u bashkua me ta, ai u bashkua përjetë vetëm me Partinë, me forcën e madhe të saj që po rritej.

---

1 Kasëm Sinani — bashkëluftëtar me shokun Myslym Peza.

Shumë reaksionarë kanë luftuar dhe kanë intriguar që populli i krahinës së Pezës dhe Myslymi të ndaheshin nga Partia. Disa nga këto janë shkruar, disa të tjera akoma nuk janë shkruar. Të mos harrojmë tradhtarët, Mustafa Krujën, Irfan Ohrin, Qazim Mulletin, Mehdi Frashërin e shumë të tjerë, të cilët punonin me intensivitet që Peza të mos bëhej qendra e Partisë dhe Myslym Peza e partizanët e kësaj krahine të mos lidheshin me ne. Por Myslymi dhe fshatarët e Pezës ishin lidhur me Partinë si mishi me koskën. Intriga u bënë edhe para Konferencës me qëllim që ajo të mos mbledhej këtu. Më vonë këta reaksionarë u përpoqën të gënjenin vëllanë e Myslymit, Shyqyriun, i cili nuk kishte ato pikëpamje përparimtare që kishte dhe ka Myslymi, megjithëse qëndroi gjer në fund me Myslymin dhe me partizanët. Po intrigat, veç, ishin të mëdha dhe në ato intriga, nga të cilat Shyqyriu u lëkund, ka marrë pjesë edhe Mustafa Gjinishi. Unë, Myslymi dhe Qemali [Stafa] e thirrëm atë për të biseduar. Mustafai insistonte që Shyqyriu dhe Myslymi të bisedonin me tradhtarët, po ne kundërshtuam. Atëherë Myslymi u ngrit e njoftoi Shyqyrinë se ai nuk ndahej nga Partia, prandaj po të donte të bisedonte me reaksionarët, le të shkonte në Tiranë, po me Myslymin do të ndahej me pushkë. Shyqyri Peza ndenji në vend, nuk u largua pas qëndrimit që mbajti Myslymi, e kuptoi që kishte gabuar dhe gjer në fund qëndroi me Myslymin. Kjo tregon se Myslym Peza nuk ishte vetëm njeri i pushkës, luftëtar i zoti, po dhe njeri politik, gjersa ai vendosi të vihej në konflikt edhe me të vëllanë për çështje të mëdha politike, të cilat i shihte drejt, në rrugën e

Partisë. Ky qëndrim bëri që Myslymin ta donin shumë komunistët.

Myslymi qysh në ditët e para kuptoi shumë mirë edhe çështjen e aleancave. Ai ka pasur besim të plotë te Bashkimi Sovjetik, ai i donte shumë Leninin dhe Stalinin. Myslym Peza politikisht dhe ideologjikisht mendonte drejt. Ai e kuptonte si duhet edhe aleancën me Anglinë, Amerikën dhe me të gjitha shtetet e tjera antifashiste dhe nuk kishte nevojë t'i thojë të ishte i kujdesshëm ndaj intrigave të oficerëve të misionit anglez.

Më kujtohet se si një herë, kur ishim duke biseduar në një fshat, bashkë me Myslymin dhe me disa shokë të tjerë, na vjen me nxitim një partizan me një qese në dorë me rreth 300-400 lira angleze dhe na thotë se i «kishte harruar» oficeri anglez, pasi ishte larguar me gjithë çadër. Mustafa Gjinishit i ndritën sytë, kur pa qesen, kurse Myslymi u ngrit në këmbë dhe e porosi partizanin ta ndiqte, ta gjente oficerin anglez dhe t'i thoshte që «të mos mbillte paratë rrugëve se ne nuk e hamë atë që bën ai». Unë brofa menjëherë në këmbë dhe e pushtova me dashuri Myslym Pezën për këtë qëndrim të zgjuar.

Do të them edhe diçka tjetër. Kishte në radhët tona disa elementë të këqij, që ishin gjoja miq të Myslymit dhe të mitë, por që, duke u maskuar nën influencën e Myslymit, përpiqeshin si e si ta minonin këtë influencë dhe njëkohësisht të minonin e të sabotonin vijën e Partisë, të çonin ujë në mullirin e imperializmit; nga ana tjetër ata e hiqnin veten si patriotë. Po Partia nuk flinte, ajo vigjilonte. E donte interesi i

lartë i popullit që ajo të vigjilonte. Por ashtu si Partia, edhe Myslym Peza nuk flinte. Partia vazhdimisht e ndihmonte Myslymin me armë e me të holla për ushqimin, veshmbathjen e armatosjen e partizanëve, po armët e të hollat që i dërgoheshin atij zhdukeshin. E niban mend Myslym sa kemi luftuar në Labinot për këtë çështje?

Po le të mos ë zgjasim këtë, rëndësi ka fakti që në Kongresin e Përmetit, që ka një rëndësi të madhe historike për popullin tonë, ka pasur njerëz që kishin në xhep taserën e Partisë, por që, duke mbajtur lidhje me imperialistët, u përpoqën ta sabotonin Kongresin. Elementëve të tillë Partia u lidhi duart. Kur shkova në mesnatë te Myslymi, i paraqita situatën dhe i thashë se «miku yt» dhe «imi» është i tillë dhe i këtillë, intrigant etj., në atë çast Myslymi më tha: «Shoku Enver, në gjyq njerëz të tillë! Kryetar gjyqi bëhem unë dhe do ta dënoj». Me gjithë këto veprime, që ky njeri i lig bënte prapa shpine, përsëri Partia u tregua zemërgjerë. Pra, shokë, mik i mirë me Myslymin mund të ishe vetëm po të ishe në rregull me vijën e Partisë dhe me interesat e popullit.

Pas disa ditësh po ai njeri erdhi në Shtabin e Përgjithshëm, shfaqti dëshirën dhe kërkoi ndihmë për të shkuar në zonën e Durrësit e të Peqinit që të krijonte brigada dhe batalione. Ne i thamë atij që nuk kishte përse të shkonte në një zonë, ku ne kishim komandant Myslym Pezën, i cili me ndihmën e Partisë kishte krijuar reparte të shumta partizanësh dhe me fjalën e Partisë, po të ishte nevoja, mund të ngrihej i gjithë populli i Durrësit dhe i Peqinit. Partia e kuptonte për-

se bësheshin këto gjëra dhe ku e kishin burimin, e kuptonte çfarë kombinacionesh bësheshin nga pushtuesit në kohën e Çlirimit të Shqipërisë dhe të Tiranës për të përçarë forcat tona. Po Tirana dhe rrethet e saj, nën drejtimin e Partisë, qëndronin të patundura. Nga të katër anët rrethi i Tiranës u bë një kala e pamposhtur, armiku dogji fshatra e shtëpi, vrau njerëz, po populli nuk u dorëzua, ai i theu të gjitha sulmet e pushtuesve dhe kështu triumfoi vija e Partisë, drejtësia e saj. Divizionet tona, që komandoi këtu në Tiranë gjenerali i lavdishëm, Mehmet Shehu, gjetën një mbështetje të madhe dhe as ballistët, as zogistët, as Mustafa Kruja dhe as Ali Këlcyra nuk e dëmtuan dot bllokun nacionalçlirimtar. Prandaj historia e Pezës dhe e popullit të të gjithë kësaj krahine është një histori e lavdishme, që duhet të shkruhet gjer në detajet më të vogla dhe që do të lexohet brez pas brezi. Trimat që ranë këtu, djemtë e Partisë, luftëtarët e miqtë e Myslym Pezës, do të kujtohen në shekuj dhe emrat e vepra e tyre do të jenë një frymëzim i madh për brezat e rinj.

Anglezët nuk vunë mend me çështjen e Sarandës<sup>1</sup>, prandaj në pragun e Çlirimit të Shqipërisë oficerët e misionit anglez kërkuan që në Pezë të hidheshin parashutistë të tyre dhe 10-15 radiostacione për të siguruar «çlirimin» e Tiranës. Partia i kuptonte këto ma-

---

1 Komandot (grupe speciale zbulimi) angleze hynë në Sarandë më 9 tetor 1944 pas asgjësimit të garnizonit hitlerian nga brigadat e UNÇSH. Komanda e Përgjithshme e UNÇSH e detyroi Shtabin Britanik të largonte forcat e veta nga bregdeti shqiptar.

novra, prandaj njoftoi që asnjë parashutist dhe radio-stacion anglez të mos hidhej në Pezë. Myslym Peza mori urdhër të hapte zjarr kundër kujtdo që do të bënte një gjë të tillë.

Një ditë më lajmëruan në shtëpi që të veja sa më shpejt në klinikë, se Myslymi ishte shumë i sëmurë. Ky lajm më tronditi tepër. U ngrita menjëherë e shkova për ta parë. Po, para se të hyja në dhomën e tij, u takova me mjekun, që kujdesej për të. Ai dhe kolegët e tij ishin shumë pesimistë për gjendjen shëndetësore të Myslymit dhe më shpjeguan si qëndronte gjendja e tij. Njëri prej tyre më tha: «Shoku Enver, Myslym Peza po lufton me shumë sëmundje». Iu përgjigja menjëherë, se në qoftë se Myslym Peza ka hyrë në luftë me sëmundjet, ai me siguri do të fitojë. Kur shkova dhe e vizitova në dhomën e tij, pasi e pyeta si ishte, më tha se nuk kishte asgjë, se çdo gjë do të kalonte. Dhe me të vërtetë ashtu ndodhi, Myslymi u shërua, ai tani ndodhet këtu midis nesh shëndoshë e mirë.

Sidoqoftë ne e këshillojmë Babë Myslymin t'i ndjekë porositë e mjekëve, se duam që të rrojë edhe 100 vjet, që ta shohë Shqipërinë të lulëzojë dhe armiqtë e Partisë e të popullit tonë, armiqtë e komunizmit, imperialistët dhe tradhtarët e marksizëm-leninizmit, renegatët Hrushov dhe shokët e tyre t'i shohë të përmbysur. Ne jemi në rrugë të drejtë, ndërsa ata janë në rrugën e tradhtisë. Prandaj ne jemi të bindur se do të fitojmë, kurse imperialistët e revizionistët do të shkatërrohen, dhe në botë do të triumfojë paqja e vërtetë, demokracia, socializmi e komunizmi.

Të dashur shokë, në këtë përvjetor historik, le ta

ngremë gotën për Partinë tonë të madhe, të urtë dhe të lavdishme, që është e vetmja udhëheqëse e popullit shqiptar, faktori dhe garancia e fitoreve të punonjësve të vendit tonë, ta pimë për lavdinë e komunistëve dhe të partizanëve, që ranë në fushën e nderit për lirinë dhe lumturinë e popullit, ta pimë për bashkimin dhe unitetin e çeliktë midis popullit dhe Partisë, ta pimë për shëndetin e shokut dhe të mikut tonë të dashur, Myslym Peza!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## ZEMRËN E KAM PLOT KUJTIME PËR SHKOLLËN TIME TË PARË, PËR MËSUESIT E MI TË DASHUR

*Letër dërguar nxënësve dhe mësuesve të gjimnazit  
«Asim Zeneli» Gjirokastrë*

17 shtator 1962

Të dashur xha Thoma Papapano, nxënës e mësues të gjimnazit «Asim Zeneli»,

Ju falënderoj nga zemra që më kujtoni, por edhe unë kurrë s'ju harroj. Kërkesën që më keni bërë dhe që ma ripërsëritni, ju siguroj se nuk e kam harruar. Zemrën e kam plot kujtime për shkollën time të parë, për mësuesit e mi të dashur. Por dëshirën tuaj nuk ua plotësova më parë, jo se përtoja të shkruaja, se shkolla ku unë mësova abc-në nuk na mësoi përtacë, por letrën time dëshiroja ta shoqëroja me diçka që më kërkoni, si të them me diçka që të plotësonte dëshirën tuaj dhe timen, me diçka që të më kujtonte vegjëlinë time.

Ju e dini, xha Thoma, se 47 vjet kanë kaluar nga dita që kur unë u paraqita për herë të parë në bankën e shkollës përpara jush. Një jetë e tërë ka kaluar, por



dita e parë e shkollës nuk harrohet. Në zemër ndieja gëzim të përzier me frikën e parë, por fjalët e ëmbla të mësuesit tim dhe copa e kulaçit të misërt me pak djathë e një qepë që mëma më kishte futur në qesen e librave, kur më përcolli për në shkollë, sikur ma ngrohnin zemrën, ma hiqnin ndrydhjen.

Furtuna kaluan mbi atdheun që nga ajo kohë kur ju, basho Thoma, hapët shkollën e parë shqipe në Gjirokastrë, dhe unë hapa për herë të parë sytë në jetë. Jeta e familjes sime dhe imja, si jeta e gjithë bashkëqytetarëve të mi, kaloi herë me brenga, herë me gëzime, por kurdoherë me shpresa për të ardhshmen. Ju e mbani mend, xha Thoma, kur neve na u dogj shtëpia në kohën e okupacionit të parë të grekëve. Unë atëherë isha i vogël, por mbaj mend se mëma, e llahtarisur, më shkundi nga gjumi dhe më shtyu përpara në mes të flakëve dhe të tymit për të më shpëtuar. Në shkallët që po digjeshin, nuk e harroj as tash, ktheva kryet dhe shikova mëmën në mes të tymit që në një sqetull mbante motrën time, foshnjë të vogël, dhe në sqetullën tjetër një sahat të vjetër që e ruante varur në odën e gjumit dhe që zilja e tij e zgjoi atë nga gjumi në atë natë të frikshme. Çdo gjë na e dogji zjarri, motra më e vogël na vdiq, por unë dhe sahati jetuam. Këtë sahat, të vetmen gjë të shtrenjtë që kam të familjes, po ia dërgoj shkollës sime të dashur, mësuesit tim të vjetër, nxënësve dhe mësuesve të rinj.

Të dashur shoqe dhe shokë të rinj, poet dhe shkrimtar unë s'jam, por, kur isha dhe unë i ri si ju, ëndërroja për poezi, për dashuri, këtë ua them se unë i besoj poetët kur ata thonë se edhe sendet kanë jetën

e tyre dhe «ligjërojnë» historinë e tyre. Sahati që po ju dërgoj s'është veç një mekanizëm i thjeshtë dhe i vjetër, i lyer me pak bojë për t'i fshehur pleqërinë, ashtu siç bënin dikur nënat tona plaka që vinin këna në flokë për të fshehur thinjat e bardha. Sipas mëmës, ky sahat ka afro një shekull që i shërben familjes sime. Një shekull s'është pak, por dëgjojeni me kujdes, ai këndon vazhdimisht si... bilbil. Mos t'ju vijë keq, i nderuari xha Thoma, edhe ju nuk jeni i ri, por zëri juaj vazhdon të këndojë si ngahera nga klasa në klasë, nga viti në vit për më shumë se 50 vjet me radhë vjershat dhe këngët e bukura të Naimit që i këndonte Shqipërisë dhe të ardhshmes, këngët e fuqishme të punonjësve të rinj që ndërtojnë socializmin me vrullin rinor. Sahati që po ju dërgoj dhuratë, është i thjeshtë, por për mua është i dhëmshur. Kur i mora leje mëmës që t'ua dërgoja juve, ajo më tha: «Hallall e pastë shkolla jote, dërgojau! Zilja e këtij sahati të zgjonte çdo mëngjes kur të nisja për shkollë, dhe shkolla ku ti mësove të hapi sytë. S'kemi tjetër gjë nga e kaluara t'u dërgojmë të rinjve dhe të rejave, biro». Nëna ime më porositi t'ju them juve se ajo ju çon të fala dhe ju puth sytë. Ju këshillon të doni atdheun, popullin dhe Partinë si shpirtin, dhe të mësoni mirë e bukur. Ajo m'u lut gjithashtu t'ju tregoj juve edhe «jetën», historinë e sahatit.

«Ju thuaj djemve dhe bilave<sup>1</sup> të Gjirokastrës se të gjitha gëzimet dhe hidhërimet e zemrës na i ka parë dhe dëgjuar, na i di ki sahat i shkretë. Ki sahat

---

1 Kështu quhen në Gjirokastrë vajzat.

ka parë mullanë<sup>1</sup> të bisedonte fshehurazi me Çerçizë, me Duro Gurre dhe Idriz Gurre. Tiktaket e sahatit rrihnin si zemrat tona dhe të gjithë gjirokastritëve, kur mullai iu përgjigj ultimatumit të gjeneralit grek që donte të digjte Gjirokastrën. Të gjithë prisnim vdekjen nga ora në çast, prisnim të na digjeshin shtëpitë dhe ne brenda, por Venizellosit dhe Zografos nuk i dorëzoheshim. Përpara trimërisë së popullit, gjenerali grek u zbraps. Qyteti shpëtoi nga djegia. Më vonë na pllakosi varfëria, ki sahat na i di hadhet, por nuk u turpëruam. Një pjesë të fëmijëve i përcolla në varr, ki sahat m'i njeh hidhërimet. Ki ma di llahtarën time kur na zaptuan italianët dhe gjermanët. Sahati e di mirë frikën dhe dhimbjen që ndieja në zemër, kur ti, biro, biri im, dhe djemtë e mëmave të tjera shqiptare dolën ilegalë me Partinë, kur luftonin në demonstrata, kur shkuan në luftë e s'i pashë më, derisa u çlirua Shqipëria. Orët më dukeshin ditë dhe ditët vite. Kërcitnin çdo natë pushkët e bombat në Tiranë dhe sikur më godisnin në zemër. Binte zilja e këtij të flamosurit sahat. Mendoja djalin tim, mendoja djemtë e bilat e nënave që kishin dalë në mal partizanë dhe luftonin për popullin me flamur të kuq në dorë... Por ja u kthyen nga mali fitimtarë, qeshi nga gëzimi gjithë Tirana, gjithë Shqipëria. Tani zile e sahatit më dukesh si këngë e bukur. Një ditë, duke shikuar sahatin, i thaçë atij: ditëshkurtër, sa shumë kemi vojtur ti dhe unë,

---

1 Hysen Hoxha — patriot, iniciator për çeljen e shkollës së parë shqipe në Gjirokastër dhe kryetar i shoqërisë «Bashkimi» dhe «Pleqënisë» së klubit «Drita». Në vitin 1913-1914 kundërshtoi lëvizjen për autonomi të «Vorio Epirit».

por ç'e zë dhe nuk e kalon njeriu. Njeriu është më i fortë se ti, më i fortë se hekuri. Tani i thaçë sahatit: këndo se s'do ketë më ditë të zeza as për popullin, as për ne, as për ti».

Këtë sahat, pra, po i dërgoj si dhuratë të thjeshtë shkollës sime të parë e të dashur. Unë e mbaja këtë në odën e punës, por mendoj se te ju do të jetë më mirë, pse pleqtë gëzojnë dhe kanë nevojë të rrinë me të rinjtë, pse u kujtohet rinia e tyre, pse duan kurdoherë të jenë të rinj, pse duan të gëzojnë, të punojnë si të rinjtë pse, kur rrinë me të rinjtë, të vjetrit marrin forca të reja për t'u shërbyer deri në mbrëmjen e jetës së tyre të resë, atdheut socialist, Partisë sonë të lavdishme.

Edhe unë ju siguroj, të dashur shokë, shoqe e miq të gjimnazit «Asim Zeneli» të Gjirokastrës, se me të gjitha forcat e mia, sa të kem fuqi do të punoj, do të luftoj deri në fund, si ushtar i Partisë dhe i popullit, për lumturinë e njerëzve të Shqipërisë, për lumturinë e brezit të ri.

Të rrojë në shekuj, në lavdi e në lumturi populli ynë i mrekullueshëm, Partia jonë e lavdishme, rinia jonë heroike!

Ju përqafoj dhe mirë u pafshim  
shokë dhe miq të mi të vjetër dhe të rinj

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në almanakun: Gjimnazi «Asim Zeneli» — Gjirokastrë, 1963*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## PUNA DHE SJELLJET E KUADROVE NDIKOJNË SHUMË TE TË TJERËT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

18 shtator 1962

Jam dakord me diskutimet që bënë shokët e Sekretariatit. Studimi i këtij problemi dhe ndihma që u është dhënë disa organizatave-bazë të këtyre rretheve kanë rëndësi të madhe për forcimin e unitetit të Partisë, për çelikosjen e mëtejshme të saj. Por unë desha të ndalem pak në disa qëndrime të gabuara të sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Sarandës e të disa shokëve të tjerë të byrosë së Partisë të këtij rrethi.

Letra që ju, shokë të Sarandës, i keni drejtuar Komitetit Qendror dhe Qeverisë për realizimin e planit

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga ekipi i KQ të PPSH «Mbi disa çështje të jetës së brendshme të organizatave-bazë dhe pranimet në Parti në rrethet: Shkodër, Përmet dhe Sarandë».

nuk është e drejtë, për arsye se keni dhënë shifra të parealizuara. Një gabim të tillë ti, shoku Sh..., nuk e bën për herë të parë. Besoj se e mban mend mirë që, kur ishe në Kukës, ke rënë në një gabim si ky. Kjo do të thotë se nuk vure mend nga vërejtja që të bëme atëherë. Përse njoftoni Komitetin Qendror dhe Qeverinë kur planin nuk e keni realizuar? Kur e pe se plani nuk ishte realizuar, s'duhet ta kishe dërguar letrën, sidomos për faktin se është hera e dytë që kritikohe për të njëjtën çështje. Radhën e parë ia hodhe fajin një tjetri, kurse tani Miho Xhanit, të cilin, megjithëse është zëvendëskryetar i komitetit ekzekutiv të rrethit dhe një kuadër i vjetër i luftës, njeri që ka kaluar në shumë prova, nuk e pyetët fare për letrën që na dërguat.

Shoku Miho në komitetin ekzekutiv merret me çështjet ekonomike, prandaj ai ka të drejtë të bisedojë me drejtorët e të gjitha ndërmarrjeve për problemet e sektorëve që ka në vartësi dhe s'ka përse të vijë të bisedojë kurdoherë me ty. Ti je sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit, po edhe atij Partia i ka besuar sektorë me përgjegjësi, prandaj, kur e sheh të nevojshme, ai mund dhe duhet t'i thërrasë vartësit e vet e jo vetëm t'i pyesë, po edhe t'i kontrollojë, t'u kërkojë llogari, të marrë edhe masat që parashikon ligji. Atëherë, përse e akuzoni ju atë se bisedon me vartësit e vet? Ai nuk bisedoi me armikun, por me kuadro. Mihoja mund të ketë të meta të tjera, por në këtë rast, s'keni arsye ta ngarkoni me përgjegjësi. Mihonju nuk e keni pyetur as në mbledhjen e byrosë, as në atë të komitetit të Partisë, as kur përgatitët letrën për Komitetin Qendror. Në qoftë se ai nuk ishte aty, ta

gjenit kudo që ndodhej, sepse ai është një kuadër me përgjegjësi në rreth. Ta kritikosh tjetrin për atë që s'e ka bërë mirë, kjo është e drejtë, por të mos i japësh hak për atë që e ka në rregull, ky është gabim.

Ne jemi shokë partie, kritikohemi dhe kritikojmë, bëjmë edhe vërejtje për njëri-tjetrin, bile edhe për planin. Planin komunisti ka për detyrë ta realizojë, por edhe vërejtje ka të drejtë të bëjë. Kur unë kam ardhur në Kukës, mbaj mend mirë se ti ke bërë një kritikë për planin e leshit të rrethit. Kritika ishte e drejtë dhe ne, pasi e pamë planin e leshit, e korrigjuam. Përse ti ia lejon vetes t'i bësh kritika planit, ndërsa kur e bën një tjetër një gjë të tillë nuk ia lejon, por vjen në Komitetin Qendror dhe thua se ai është në kundërshtim me planin dhe vijën e Partisë? Një qëndrim i tillë nuk është aspak i drejtë.

Nëse ferma e Vrinës, siç thua ti, ka dalë me 2 000 kv realizim më pak, atëherë përse ti raportove për 2 000 kv më shumë, përse nuk dërgove njerëz ta kontrollonin këtë çështje? Apo ty, shoku Sh..., ta ka qejfi të dukesh dhe të marrësh flamurë? Çështja që të paraqitesh me plan të realizuar, kur kjo nuk është e vërtetë, është me përgjegjësi për një sekretar të parë të komitetit të Partisë të rrethit. Duke vepruar kështu, ti futesh në rrugë të shtrembër. Nuk e di ti që Partia porositi «beso dhe kontrollo»? Këtu nuk kemi të bëjmë me një, po me 2 000 kv. Nga ana tjetër kemi të bëjmë edhe me një qëndrim të padrejtë që mban ti ndaj një kuadri të vjetër, i cili ngre një çështje, bën një kritikë. Nuk mund të lejojmë që të luftohen e të trajtohen në një mënyrë të tillë kuadro besnikë të Partisë. Me këtë

tari duhet të jenë të drejtë, të thjeshtë, joarrogantë, jomendjemëdhenj e fodullë. Në parim mund të themi sa të duash, «shokë, të diskutojmë, të kritikojmë gabimet dhe të metat», por në qoftë se sekretari i parë i komitetit të Partisë në rreth dhe kryetari i komitetit ekzekutiv mbajnë qëndrime të tjera dhe nuk japin vetë shembullin e mirë, atëherë fjalët e tyre do të jenë boshe.

Nuk duhet menduar se sekretari i parë i komitetit të Partisë dhe kryetari i komitetit ekzekutiv janë të pagabueshëm, janë njerëz që gjykojnë kurdoherë drejt. Në rast se shkohet me këtë mendim, atëherë bëjmë një gabim të madh. Ato që di Partia, komiteti i Partisë dhe byroja janë shumë më të drejta, më të rëndësishme e më të zgjeruara nga sa di sekretari i parë i komitetit të Partisë dhe kryetari i komitetit ekzekutiv. Por sekretari i parë është zgjedhur nga Partia në atë detyrë për hir të disa meritave dhe cilësive të tij. Këto cilësi ai duhet t'i vërë në shërbim të Partisë dhe jo t'i konsiderojë sekretarët dhe shokët e tjerë të komitetit të Partisë sikur janë të varur te goja e tij. Ka dhe të tjerë që janë po aq të zotë sa edhe ai. Partinë nuk e përbëjnë as një, as dy, apo tre vetë, por të gjithë anëtarët e saj. Prandaj u bie detyrë sekretarit të Partisë dhe kryetarit të komitetit ekzekutiv në radhë të parë, që të bëjnë së bashku një punë të shëndoshë dhe t'u japin të gjithë shokëve të tjerë kompetencat që u takojnë për zbatimin e detyrave dhe të vendimeve të marra në mënyrë kolegjiale, të pyesin dhe të zhvillojnë konsultime me të gjithë shokët që janë për t'u pyetur, pa u justifikuar se «nuk u konsultova, sepse s'pata kohë».



Cilido që është ngarkuar nga Partia, Qeveria e populli dhe varet prej jush, duhet të përgjigjet për detyrat, prandaj nuk është e drejtë që sekretari i parë i komitetit të Partisë ose kryetari i komitetit ekzekutiv të veprojnë nën mjekrën e tyre, me kokën e tyre. Nëse çështja është urgjente dhe duhet vepruar shpejt, ve-pro, po menjëherë duhet t'i thuash edhe të zotit të punës që «unë e bëra këtë në mungesën tënde, sepse duhej bërë» në mënyrë që ai të mos thotë: «po përse nuk pyetem unë, çfarë jam unë këtu?».

Sekretari i parë i komitetit të Partisë dhe kryetari i komitetit ekzekutiv e kanë për detyrë të krijojnë në popull përshtypjen e vërtetë se ç'është udhëheqja jonë. Ata të kenë kujdes dhe t'i mbështetin shokët e tjerë të udhëheqjes që drejtojnë sektorë të ndryshëm, t'i ndihmojnë ata në kryerjen e detyrës. Populli duhet të shohë edhe drejtuesit e tjerë të Partisë e të pushtetit, jo vetëm dy kryesorët, sekretarin e parë dhe kryetarin e komitetit ekzekutiv. Dhe populli e sheh këtë kur të gjithë drejtuesit marrin përgjegjësi në punë dhe i japin llogari për këtë komitetit të Partisë dhe sekretarit të parë. Ky nga ana e vet nuk duhet të shesë mend, por në qoftë se ka ndonjë vërejtje, le ta bëjë, ndërsa kur s'ka vërejtje, atëherë t'i thotë tjetrit: «E ke bërë punën shumë mirë». Pra, edhe sekretari i parë duhet ta kryejë mirë detyrën që i është ngarkuar, t'i ndihmojë dhe t'i mësojë shokët e tjerë. Kështu masa e Partisë dhe e popullit nuk do të shohë vetëm një ose dy njerëz, por të gjithë shokët në funksionet e tyre. Për këtë duhet të ndihmojnë në radhë të parë sekretari i parë i

komitetit të Partisë, po edhe kryetari i komitetit ekzekutiv, për ata që ka nën vartësinë e vet.

Këto çështje kanë të bëjnë me rritjen, përtëritjen dhe forcimin e kuadrit. Nuk duhet mjaftuar vetëm me atë që komunistët ose punonjësit e një rrethi të thonë që filan sekretar i parë është i mirë. Është një e mirë e madhe për Partinë kur populli thotë se sekretari i parë i komitetit të Partisë është xhevahir djalë, po Partia duhet të luftojë që populli të thotë për të tërë se janë të mirë dhe kjo ka të bëjë me përgatitjen dhe me edukimin e kuadrit. Tani ne kemi në udhëheqje shokë që po plaken ose janë të sëmurë, mirëpo në çështjen e kuadrit duhet të ketë vazhdimësi, sidomos në udhëheqje, prandaj duhet punuar kurdoherë për përgatitjen e filizave të rinj. Është lehtë të thuash për një kuadër që nuk bën, po duhet parë mirë se edhe mund të bëjë. Të gjitha këto duhet ta bëjnë çdo drejtues të mendojë për përgjegjësitë e mëdha që ka përpara Partisë, jo vetëm përsa u përket detyrave të veçanta, por sidomos për çështjen e udhëheqjes kolegjiale, për t'u dhënë ndihmë shokëve, për t'u vënë atyre në dukje meritat dhe gabimet, por në radhë të parë secili të shohë gabimet e veta.

Kështu, pra, shoku Sh... dhe ju shokët e tjerë të Sarandës, t'i vini mirë në dukje këto çështje në mbledhjen e byrosë suaj, sepse kanë rëndësi të madhe për punën e Partisë, ta rregulloni gjendjen jo të mirë që keni krijuar në atë rreth. Ta themi edhe një herë hap-tazi se të përpiqesh t'ia paraqitësh ndryshe udhëheqjes gjendjen, të raportosh edhe për ato që akoma nuk janë realizuar, kjo është shumë e dëmshme, është si të

thuash të ngopesh me lugë të zbrazët. Nga ky veprim jo vetëm s'kemi fitim, por përkundrazi kemi humbje. Çështjet e emulacionit dhe të flamurëve duhen kuptuar drejt.

*Botohet për herë të parë, me  
disa shkurtime, sipas tekstit të  
nxjerrë nga procesverbali i  
mbledhjes së Sekretariatit të  
KQ të PPSH që gjendet  
në AQP*

## FSHATI KA NEVOJË PËR MË SHUMË MJEKË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

18 shtator 1962

Është e vërtetë se spitalet mund ta bëjnë mirë depistimin e sëmundjeve, por do të ishte më mirë, sikur të kishim një mjek për disa fshatra, i cili mund të vizitojë të sëmurin në vend, t'i bëjë diagnozën, t'i japë recetën dhe këshillat se çfarë duhet të bëjë, gjersa të përmirësohet etj. Sigurisht, mjekimet në shtëpi nuk kryhen dot si në spitale, po një farë pune bëhet. Mirëpo sot ne nuk kemi sa duhet mjekë në fshatra, prandaj shumë të sëmurë vijnë në spitale. Shumë fshatra të vendit tonë janë të lidhura tashmë me rrugë automobilistike, megjithatë jo të gjithë të sëmurët i drejtohen spitalit. Prandaj çështja e shpërndarjes së mjekëve duhet parë më mirë, sepse në rast se do të va-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën me masat për përmirësimin e gjendjes në shëndetësi.

zhdojmë t'i grumbullojmë ata nëpër qytete, duke shkuar nga parimi që në spitale bëhet një punë më e kualifikuar, nuk i dalim punës përpara. Fshati ka nevojë për më shumë mjekë. Prandaj del nevoja që të merren masa për të lehtësuar spitalet nga numri i shumtë i mjekëve (nuk e kam fjalën për specialistët), sepse kështu do të arrijmë të kemi një mjek për disa fshatra.

Po të dërgojmë një mjek në 4-5 fshatra, duhet t'i sigurojmë edhe një shtëpi, jo vetëm për të jetuar, por edhe për ngritjen e klinikës, të cilën shteti dalngadalë do ta plotësojë. Atje të ketë edhe një farmaci të vogël. Pra në vend që t'i themi fshatarit të vijë për t'u kuruar në spital dhe shteti të bëjë shpenzime të mëdha, të dërgojmë mjekun në fshat, dhe kështu të sëmurët do të kurohen në vend. Me kohë mund t'u jepet këtyre klinikave edhe ndonjë aparat i vogël depistimi për disa sëmundje, natyrisht, mjete ose vegla jo të kushtueshme. Përsa u përket nevojave për kontrolle me aparate «Rontgen» etj., të sëmurët mund të vijnë në qytete, po disa nga analizat më të thjeshta të bëhen në vend, në qendrat e fshatit. Për ato të komplikuarat të organizojmë një farë shërbimi që të dërgohen në spitale, të bëhen atje, dhe t'i kthehen qendrës rurale që i ka dërguar.

Më vonë, pranë mjekut në fshat, mund të caktohet edhe një ndihmësmjek. Në klinikë mund të ketë edhe një ose dy krevate. Mjeku, herë pas here, të shkojë në çdo shtëpi për t'u dhënë fshatarëve këshilla profilaktike mbi pastërtinë, mbi ushqimin etj. Sot këto bëhen po jo aq sa duhet dhe si duhet.

Në kohën e tanishme që nuk kemi shumë mjekë, sipas kushteve që ekzistojnë, të dërgojmë mjekë në ato krahina ku ka më shumë nevojë. Hëpërhë mund të fillojmë të dërgojmë edhe në dhjetë fshatra një mjek, më vonë nevojat do t'i plotësojmë edhe më mirë. Prandaj të ekonomizohen mjekët dhe Qeveria të marrë masa për ngritjen e një klinike për mjekun, për disa mjete të nevojshme etj.

Në ato vende ku sot kemi nga një ndihmësmjek, këta t'i zëvendësojmë gradualisht me mjekë, të cilëve t'u vëmë në dispozicion një infermier, ndërsa ndihmësmjekun ta dërgojmë në atë fshat ose në grup fshat-rash, ku të japë ndihmën e parë mjekësore, të depistojë një sëmundje, të japë një ilaç dhe, kur sheh se i sëmuri është rëndë, ta drejtojë te mjeku, në qendrën më të afërt. Të caktohet një rregull që mjeku ose ndihmësmjeku i fshatit dy herë në javë t'ia hipë kalit dhe të shkojë në fshatra ku të vizitojë të sëmurët që janë të shtruar në shtëpitë e tyre. Në qoftë se i mbajmë spitalet rurale, t'u japim disa mjete edhe krevate më shumë dhe të pengojmë kështu ardhjen e të sëmurëve në spitalet kryesore. Në këto spitale të sillen të sëmurët më të rëndë, të tjerët të mjekohen nëpër shtëpi dhe në spitalet rurale. Por spitalet rurale t'i kemi të kompletuara me mjekë dhe jo me ndihmësmjekë. Këta t'i dërgojmë nëpër ambulancat që kujdesen për një grup fshatrash.

Lidhur me studimin që është bërë e shikoni më ndryshe proporcionin e mjekëve dhe pa pritur vitin 1966 të arrijmë në përfundim se çfarë mund të bëhet qysh tani dhe pastaj të vendosim.

Mendoj që mjekët e rinj, pasi mbarojnë fakultetin, të vihen në punë afër spitaleve nën drejtimin e mjekëve me eksperiencë, sepse do të përfitojnë nga përvoja e tyre. Mjekët e rinj ta dinë që në qytet do të rrinë 2-3 vjet, sa të praktikohen e pastaj do të dërgohen në fshatra. Natyrisht për të dërguar mjekë nga qytetet për në fshatra, do të haset edhe në rezistencën e drejtorëve të spitaleve, por ata duhet ta kuptojnë këtë nevojë që ka sot fshati ynë.

Një mjek që e kam pasur mik, më ka thënë se sa vështirësi të mëdha ka pasur në 3-4 vjetët e parë pas mbarimit të shkollës. Atëherë ai nuk jepte menjëherë recetë, por, pasi vizitonte pacientin, i thoshte të shkonte pas 3-4 orësh në farmaci e të merrte ilaçet. Kjo kohë i duhej atij për të shkuar në shtëpi, të hapte librat dhe, në bazë të simptomave që konstatonte te i sëmuri, pregatiste recetën, të cilën e jepte me shumë frikë. Pastaj, kur fitoi eksperiencë, u mësua dhe diagnozën e bënte mirë. Nga ky shembull i thjeshtë del se mjekët tanë të rinj, duhet të mos shkëputen nga libri edhe pasi mbarojnë studimet e larta.

Por mjeku duhet të bëjë përpjekje jo vetëm për ngritjen tekniko-profesionale. Ai ka nevojë të ushqehet vazhdimisht me politikën e Partisë, me ideologjinë e saj marksiste-leniniste. Të mos harrojmë, se te disa mjekë ekzistojnë edhe pikëpamje të gabuara, kundër të cilave duhet luftuar. Te këta, nganjëherë më shumë se te njerëzit e profesioneve të tjera, ekziston koncepti se «unë jam i domosdoshëm, prandaj kërkoj edhe

më shumë favorizime». Diçka në këtë drejtim për mjekët mund të bëhet, natyrisht me masë dhe brenda mundësive.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



# SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA E MAKINERISË — PROBLEM I RËNDËSISHËM EKONOMIK DHE POLITIK

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**18 shtator 1962**

Jam dakord me vërejtjet e drejta të shokut Hysni. Është e domosdoshme që çështja e mirëmbajtjes së makinerisë të ngrihet si një problem shumë i rëndësishëm ekonomik dhe politik për të gjithë punonjësit e dikastereve që kanë makineri në përdorimin e tyre. Prandaj, që të bëhet kjo, kërkohet një mobilizim i madh dhe konkret në rrugë partie dhe në rrugë shtetërore.

Në rrugë partie duhet të kuptohet mirë momenti politik dhe ekonomik që po kalon vendi ynë. Shfrytëzimi në maksimum i makinerisë është një detyrë e

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi shfrytëzimin më racional të mjeteve dhe të makinerive.

përhershme, aq më tepër sot në kushtet e bllokadës ekonomike kundër vendit tonë. Bllokadës së imperia- listëve iu shtuan edhe sabotimet që na bëjnë vendet e demokracisë popullore, me të cilat më parë ishim në marrëdhënie të mira ekonomike, ndërsa tani këto marrëdhënie janë prishur jo për fajin tonë, por për shkak të tradhtisë së revizionistëve modernë.

Kjo situatë kërkon që njerëzve të mos u flitet në përgjithësi për problemet që na preokupojnë, po konkretisht e veçanërisht për makineritë. Punonjësit duhet të bëhen të ndërgjegjshëm e të mendojnë sa të vlefshme janë makineritë dhe ç'vështirësi të mëdha ka shteti ynë. Edhe sikur të ishim një shtet i pasur socialist, do të bënim kudo sa më shumë ekonomi, planin do ta realizonim sa më mirë në të gjitha drejtimet dhe do të krijonim rezerva për ngritjen e mirëqenies së popullit.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se ekonomia jonë pa makineri nuk mund të ecë përpara. Probleme si ky janë shqyrtuar shumë herë dhe përsëri do të shqyrtohen, sepse kanë rëndësi shumë të madhe. Edhe tani do të merren masa nga Qeveria e Byroja Politike e Komitetit Qendror. Fakti është se përparime kemi, po është e domosdoshme që këto përparime t'i përforcojmë e të arrijmë suksese edhe më të mëdha. Natyrisht kjo do të vijë si rezultat i një pune më të madhe politike, organizative dhe teknike.

Sot ne kemi një mori makinash. Mendimi im është se Ministria e Komunikacioneve, me gjithë të metat që ka, bën një punë më të organizuar në këtë drejtim,

i shfrytëzon dhe i mirëmban më mirë mjetet që ka në dispozicion. Në parqet që ajo drejton, ka më shumë disiplinë dhe rregull në punë. Kjo nuk përjashton që edhe prej saj të merren masa të mëtejshme për forcimin e disiplinës, e cila ka një rëndësi të madhe për mirëmbajtjen e për shfrytëzimin e makinerisë, sidomos nga shoferët. Për shembull, ka shoferë që nuk e çojnë makinën për remont sipas grafikut dhe kjo është thyerje e disiplinës.

Por disiplina nuk mund të vendoset vetëm me dekrete. Ka sektorë të shpërndarë që disponojnë makineri dhe e kanë vështirë të bëjnë mbledhje të rregullta me shoferët e traktoristët, ku të zhvillojnë leksione, punë politike e ideologjike, të nxjerrin konkluzione politike dhe detyra nga të metat dhe vështirësitë që hasin. Megjithatë, puna politike nga ana e Partisë duhet të zërë një vend kryesor edhe në këta sektorë, pavarësisht nga kushtet që kanë. Por edhe nga organet shtetërore është e nevojshme të merren disa masa organizative, siç e kërkojnë koha dhe rregullat dhe bashkë me këto të lidhet e të kombinohet më mirë interesi personal i shoferëve ose i traktoristëve me interesin e përgjithshëm, duke synuar që këtij të fundit t'i nënshtrohet interesi vetjak.

Ne kemi vështirësi si në sigurimin e lëndës së parë për prodhimin në vend të pjesëve të këmbimit, ashtu edhe për importimin e veglave të gatshme. Vështirësia qëndron në mungesën e devizës së mjaftueshme për të plotësuar nevojat me kohë dhe në bazë të normave. Por edhe sikur të kishim devizë të mjaftueshme, duke marrë parasysh marrëdhëniet jo të mira që kemi tani

me vendet socialiste të Evropës, ku i kemi blerë makinat që kemi, dërgimi i këtyre materialeve do të na pengohet, do të na vonohet etj. Kërkesat që u bënë këtu për importimin e pjesëve të këmbimit dhe të lëndës së parë për prodhimin e disave prej tyre në vend, brenda mundësive dhe kufijve të devizës, Ministria e Tregtisë të bëjë përpjekje më të mëdha dhe të sigurohen.

Shokët e Ministrisë së Ndërtimit, të Komunikacioneve, të Bujqësisë etj., duhet të bëjnë përpjekje në mënyrë të ndërgjegjshme për këto probleme. Puna politike dhe organizative së bashku edhe me rregulloret për makineritë dhe me emulacionin të gërshetohen dhe të arrihet që të ecet më mirë në këtë drejtim. Të shfrytëzohen si duhet makineritë, në mënyrë që ato të përdoren gjer në fund dhe të mos ndodhë si në disa sektorë, ku ato i hedhin sa andej-këtej me lehtësi. Këto ne kemi mundësi t'i bëjmë, vetëm se duhet të jemi të gatshëm, objektivë dhe të luftojmë kundër dobësive që ekzistojnë.

Vura re se shokët Milo Qirko<sup>1</sup> dhe Sali Angoni<sup>2</sup>, bënë autokritikë të ndërgjegjshme, kurse shokët e sektorit të bujqësisë nuk e bënë si duhet një gjë të tillë. Propozimet e komisionit të ngarkuar për hartimin e këtij raporti që kryesohet nga Miloja, i cili ka një eksperiencë shumë të madhe në këtë çështje, duhet të vlerësohen jo vetëm nga udhëheqja e Ministrisë së Komunikacioneve dhe Qeveria, por edhe nga shokët e Partisë në rrethe, me qëllim që të vihet në zbatim

1 Në atë kohë zëvendësministër i Komunikacioneve.

2 Në atë kohë zëvendësministër i Ndërtimit.

eksperienca. Propozimet që bëhen për disa forma organizative duhet t'i rekomandohen Qeverisë që t'i studjojë në hollësi dhe të marrë vendimin përkatës. Shokët ishin dakord që automjetet të mos shkëputen nga ndërtimi, por të organizohen në hozrashot dhe të ndihmojnë ndërtimin.

Duke marrë parasysh vështirësitë e mëdha të Ministrisë së Ndërtimit për shkak të natyrës së punës, të materialeve të rënda që transportohen dhe të futjes së makinave vend e pa vend në rrugë të këqija, t'i rekomandohet Qeverisë që nga kontingjentet që vijnë, brenda mundësive, ta ndihmojë këtë ministri me disa makina të reja. Kjo nuk do të thotë që shokët e ndërtimeve të shkojnë tani me pikëpamjen që t'i braktisin makinat e vjetra. Përkundrazi, makineritë të shfrytëzohen gjer në fund, të përdoren me vend, të ngarkohen si duhet, të mos bëjnë udhë bosh ose me ngarkesa jo të plota apo të pastudjuara. Në ndërgjegjen e drejtorëve të ndërmarrjeve dhe të vetë shoferëve të rrënjoset pikëpamja që komandimi i makinave të mos jetë diçka e rastit, sipas dëshirës ose e një vendimi të shpejtë. Ata nuk duhet të kenë për makinën një koncept jomarksist, një qëndrim prej padroni, të mos nisët shoferi për rrugë sa për të marrë vetëm pak trarë. Në një rast të tillë shoferi vetë të luftojë që makina të shfrytëzohet me leverdi.

Kështu është edhe çështja e përdorimit të automjeteve të enteve të tjera, për të cilat nuk bëhet fjalë në raport. Kam biseduar edhe me shokët e Qeverisë që ta shikojmë këtë çështje dhe të marrim masa. Nuk e kam fjalën për automjetet që transportojnë zarzavate,

fruta ose peshk, po për ato që transportojnë mallra të tjera, të cilat mund të lëvizin me anën e hekurudhës, materiale që vijnë nga porti ose nga qytete të ndryshme dhe nuk prishen. Të tilla mallra dhe materiale, kur nuk ka mundësi të transportohen, s'prish punë po të vijnë edhe me dy ditë vonesë, prandaj të dërgohen me tren dhe automjetet të kursehen e jo të lëvizin varavingo. Ka raste që nuk kalon dot në rrugën e Durrësit, sepse lëvizin shumë makina, të cilat nuk janë ngarkuar të tëra me zarzavate, po me materiale që mund të transportohen me tren, ose syri të shoh edhe makina që lëvizin bosh apo vetëm me disa pasagjerë.

Traktorët janë mjete të rëndësishme në duart e Partisë, prandaj, të sillesh ndaj tyre në mënyrë të pakujdesshme, është një humbje e madhe për shtetin, një veprimtari e tillë është e dëmshme. Traktorët duhen shfrytëzuar në maksimum, t'i ruajmë, t'i mbajmë mirë.

Po përse ka ndodhur ndryshe në Sukth? Kjo çështje duhet analizuar. Të meta objektive mund të ketë si kudo dhe në këtë ndërmarrje, por duhet bërë analiza e të metave subjektive. Në Sukth nuk ruhen si duhet jo vetëm traktorët, por ka edhe skartime të lojëve duke shkelur vendimet që janë marrë.

Në përgjithësi duhet të kemi kujdes për mekanikën dhe traktorët. Partia i ka vënë bujqësisë rëndësi dhe forcë të madhe. Traktorë kemi sjellë dhe do të sjellim. Por kjo nuk do të thotë që disa punonjës të bujqësisë e veçanërisht të fermave të mendojnë se «ne nuk mbetemi kurrë pa traktorë, Partia dhe shteti do të sjellin traktorë të tjerë». Ka të ngjarë që te disa punonjës të bujqësisë, e veçanërisht të fermave, të jetë

krijuar një mendim i tillë. Është e vërtetë që ne nuk do të mbetemi kurrë pa traktorë, por nuk është e drejtë që të mos u zgjatim atyre jetën.

Në ferma duhet më shumë kujdes për ta pasur kurdoherë në evidencë fuqinë motorike, për të mbjellë në kohën më të shkurtër. Fermat veçanërisht e kanë këtë mundësi. Nëse ferma e Sukthit ka fuqi të tepërt motorike, atëherë jo ta keqpërdorjë mekanikën, por ato që i ka tepër t'ia japë SMT-së së Shijakut, të Përmetit apo të ndonjë rrethi tjetër që ka më pak. Pikëpamja që të kemi me bollëk, duhet të luftohet. Partia kërkon që udhëheqja e ndërmarrjeve bujqësore të mos abuzojë me prioritetin që u jepet fermave dhe të mos harrohet detyra e madhe e kursimeve, e mirëmbajtjes dhe e shfrytëzimit të plotë të makinerive.

Këto çështje që po themi kanë rëndësi të madhe dhe ju i dini, po del nevoja që edhe t'i përsëritim. Nuk mund të thuhet se kështu si në Sukth ndodh kudo. Traktoristët dhe shoferët tanë janë heronj. Unë mendoj se puna e shoferëve është edhe më e rëndë, sidomos nga pikëpamja që këta janë gjithë ditën në rrugë, larg familjeve, midis tyre ka heronj, patriotë të vërtetë dhe organizatorë të zotë në punë. Në radhët e traktoristëve kemi njerëz që janë shembull i shkëlqyer. Tani nuk jemi më si në fillim, por kemi plot kuadro që drejtojnë gjithë këta mekanizma. Në rast se duhen kuadro, ngrini në të gjitha hallkat elementë patriotë dhe kontrollorë të aftë, sepse kështu punët do t'ju shkojnë më mirë.

Përparime kemi kudo, të mos jemi pesimistë. Pavarësisht se nuk është realizuar plani, po është një gjë

e mirë që koeficienti i shfrytëzimit të makinerisë është realizuar me sukses nga ndërmarrjet e ndërtimit dhe të komunikacioneve. Tani ne kemi një lëvizje të madhe në traktoristët, të cilët ndjekin iniciativat e Budo Isufit, Rako Pinës etj. Këto janë gjëra të mëdha, prandaj të përmirësojmë më tej punën që të korrin suksese më të mëdha në të ardhshmen.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## **NUK DUHEN LËNË PAS DORE BAGËTITË E IMTA DHE KULLOTAT E TYRE DIMËRORE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**19 shtator 1962**

Dëshiroj të flas pak për një problem të rëndësishëm, i cili na preokupon shumë, por që në këtë mbledhje nuk u shtrua si duhet. Këtu u fol për çështjen e qumshtit dhe mishit të bagëtive të fermave dhe të tufove të kooperativave bujqësore, po u la mënjanë problemi që shumica e bagëtive të vendit tonë ndodhet në oborret kooperativiste dhe në ekonomitë bujqësore të pakolektivizuara. Ky është një sektor shumë i rëndësishëm, për të cilin ne nuk interesohemi sa duhet. Kjo çështje është lënë vetëm në dorën e kooperativistëve dhe të fshatarëve individualë. Nuk e kam fjalën vetëm

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi zbatimin e vendimeve të Plenumit të KQ të PPSH të nëntorit 1958 për prodhimin e mishit e të qumshtit dhe mbi masat organizative për blegtorinë e oborreve kooperativiste dhe të ekonomive bujqësore në fshatrat e pakolektivizuara.

për organizimin e kullotave në përgjithësi, edhe këtë duhet ta shikojmë më me kujdes, por të interesohemi veçanërisht e në radhë të parë për kullotat dimërore. Sepse për kullotat verore problemi është më i lehtë, megjithëse edhe në këtë drejtim duhet një farë organizimi.

Është e domosdoshme që çështjen e kullotave dimërore ta zgjidhim më mirë për bagëtinë e imtë të oborreve kooperativiste dhe të fshatarëve që akoma s'janë anëtarë të kooperativave bujqësore, të cilët kanë shumicën e bagëtive të imta. Më duket se nga ana shtetërore duhen caktuar disa detyra, siç është, për shembull, mbjellja e hasëlleve. Këtë çështje ne duhet ta studjojmë jo vetëm në planin e blegtorisë së fushës, po edhe për të gjitha bagëtitë e malësisë.

Natyrisht ky problem duhet studjuar në shkallë republikane se ku ka mundësi të krijojmë kullota dimërore në mënyrë të organizuar e në periudha të caktuara. Dhe atje ku ka mundësi, të lejohet mbjellja e tokës për hasëlle ose për bimë të tjera, po në asnjë mënyrë të mos pengohen punimet bujqësore të kohës për kulturat e tjera. Pra të kemi një plan për hasëlle dhe për të organizuar edhe shpejtimin e punimeve të tjera dhe për këtë të investojmë. Në qoftë se nuk kemi, të importojmë edhe farë tërshëre ose farëra barërash të tjera të përshatshme që të plotësojmë këtë plan, ashtu siç importojmë edhe grurë.

Rrethet të mbajnë parasysh se në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojnë, që në tokën e bukës të mbjellin bimë për ushqime të njoma ose të koncentruara për kafshët. Kryesorja është buka. Ne jemi deficit me drithërat e bukës, por mundësitë që kemi t'i studjojmë

më e t'i planifikojmë edhe për ushqimin e bagëtive. Duke i pasur të planifikuar këto gjëra, ne do të dimë t'i kanalizojmë ku duhet.

Në këtë mënyrë do të luftojmë edhe kundër spekulimit, sepse do të ushtrohet një kontroll më i mirë mbi tufat që venë në kullota në mënyrë të organizuar dhe sipas krahinës. Lidhja e kontratës është një gjë e mirë, në kushtet e sotme kjo të mos bëhet nga blegtorët e malësisë, por të bëhet midis kooperativave bujqësore. Një punë e tillë, në mënyrë të organizuar, mund të jetë një bazë për kolektivizimin e mëtejshëm.

Ne themi se nuk ka interesim për bagëtitë e oborrit kooperativist, sepse për të s'po bëhet gjë dhe kooperativistët e fshatarët individualë janë në vështirësi për sigurimin e ushqimit. Ky është një shkak që ka rënie në krerët e bagëtisë. Prandaj, nga ana shtetërore, ne duhet të interesohemi për këtë sektor e të bëjmë edhe disa investime. Ne mund të mos marrim përsipër të gjitha bagëtitë e malësive menjëherë, por në këtë drejtim të ecim gradualisht, me etapa. Këto probleme t'i studjojmë, zgjidhja e tyre do të jetë një ndihmë e madhe për blegtorinë e oborrit kooperativist si dhe të fshatarësisë që akoma s'ka hyrë në kooperativë. Në këtë mënyrë ne do të sigurojmë më shumë mish, qumësht dhe lesh.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# DISA VËREJTJE E SUGJERIME PËR METODËN E PUNËS NË BASHKIMET PROFESIONALE DHE NË BASHKIMIN E RINISË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

19 shtator 1962

Do të bëj edhe unë disa vërejtje e sugjerime. Orientimi i punës për bashkimet profesionale është i qartë, veçse shokët që i drejtojnë këto organizata duhet ta zbatojnë më mirë në praktikë këtë orientim.

Nuk duhet harruar se bashkimet profesionale luajnë një rol edukues dhe këshillues ndaj punëtorëve dhe një rol kontrollues ndaj aparateve shtetërore, të cilat në punën e tyre është e domosdoshme të zbatojnë ligjet dhe normat e vendosura. Të mos lejohen këto aparate që korraba e tyre të tërheqë nga vetja në dëm të shëndetit dhe të interesit të punëtorëve, në kundërshtim me ligjet e shtetit.

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi zbatimin e detyrave të Kongresit të 4-t të PPSH për përmirësimin e mëtejshëm të metodës së punës në organizatat e masave».

Mua më duket se nuk është e drejtë që bashkimet profesionale ta ndjekin prodhimin sikur të ishin organe shtetërore. Aparatet shtetërore kanë për detyrë të ndjekin realizimin e planit, normat, rendimentet etj., kurse organizatat profesionale duhet ta ndjekin prodhimin duke nxjerrë mësim për të ndërtuar punën edukative, politike e ideologjike me njerëzit, me qëllim që të luftohen të metat e gabimet, të kapërcehen vështirësitë nga punëtorët dhe nga drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore. Pra, ju, shokët e bashkimeve profesionale, nuk duhet ta ndiqni prodhimin në atë formë dhe në atë mënyrë siç bëjnë ndërmarrjet shtetërore; prodhimin ju ta ndiqni për të nxjerrë konkluzione për mobilizimin e punëtorëve e të punonjësve, për t'u këshilluar me drejtuesit e ndërmarrjes në lidhje me mungesat e organizimit të punës, për t'u këshilluar me dikasteret e drejtorët e enteve etj.

Në raport bëhet fjalë për normat. Këto norma kanë afate të caktuara dhe për ndryshimin e tyre duhet të pyeten punëtorët. Prandaj, kur mendohet që normat të ndryshojnë, organizata profesionale duhet të tërheqë mendimin e punëtorëve, t'u krijojë mundësi që ata të bëjnë vërejtje dhe kritika në rrugë të drejtë. Si drejtues, ju t'i shikoni këto mendime dhe të jepni ndihmën tuaj gjatë kohës që zhvillohen diskutime. Në qoftë se ndërmarrja insiston në disa norma të ekzagjeruara dhe punëtorët nuk i pranojnë ato, ju duhet të ndërhyni gjer në Komitetin Qendror. Prandaj ndërmarrjet dhe Qeveria duhet të mendojnë e të veprojnë drejt për vendosjen e normave, ndërsa shokët e bashkimeve profesionale duhet ta organizojnë punën në

mënyrë të tillë që punëtorët t'i zbatojnë ato dhe të bëjnë vërejtjet e tyre.

Është e domosdoshme që të kuptohet karakteri i normave dhe të ndiqet realizimi i tyre. Kjo punë bëhet nga secila ndërmarrje, por në këtë drejtim veprojnë edhe organizatat profesionale, të cilat punojnë politikisht dhe ideologjikisht, për të formuar bindjen te punëtorët, që ata të realizojnë normat e caktuara. Ja si shfaqet roli edukues i bashkimeve profesionale, të cilat ndihmojnë që normat të realizohen nga të gjithë punëtorët. Kështu, kur një kategori punëtorësh nuk i realizojnë normat, organizata profesionale punon që edhe ata të ecin përpara si shokët e tyre të përparuar.

Mos e harroni për asnjë moment, shokë, rolin edukues të bashkimeve profesionale! Të punohet që punëtorët të jenë të ndërgjegjshëm, të vendosin norma të mira dhe të mobilizohen t'i realizojnë e t'i tejkalojnë ato. Kështu, pra, ka rëndësi të madhe roli edukues dhe këshillues i bashkimeve profesionale për punëtorët dhe roli kontrollues i tyre për zbatimin e të drejtave që u takojnë punëtorëve.

Ju, shokë të bashkimeve profesionale, keni gjithashtu edhe disa funksione të tjera, që duhet t'i kryeni seriozisht, siç janë çështja e sigurimeve shoqërore. Ashtu sikurse veprojnë ndërmarrjet për të realizuar planin, edhe ju në sektorë të tillë duhet të realizoni detyrat, duke luftuar për zbatimin e përpiktë të ligjeve. Asnjë punonjës nuk duhet të favorizohet jashtë ligjeve, mos lejoni që të lëshohen raporte false. Shokët që drejtojnë këta sektorë edhe kryetarët e sekretarët e këshillave të bashkimeve profesionale duhet të jenë

të rreptë, sidomos në çështjet e pensioneve dhe të sigurimeve shoqërore.

Mendoj se çështjen e kuadrove teknikë që punojnë në bashkimet profesionale ta rishikojmë. Nuk është fjala që këta kuadro t'i shtojmë, por të përmirësojmë përbërjen dhe të ngremë nivelin e tyre teknik, të zgjidhen njerëz më të përgatitur, rigorozë, që u dhimbsët leku i popullit.

Bashkimet profesionale duhet t'i forcojmë më shumë me kuadro politikë, të hiqen njerëzit që nuk meritojnë të qëndrojnë në këtë organizatë, gjithë ata që nuk kanë garancitë dhe aftësitë që kërkohen. Nuk mjafton që kuadri të jetë besnik i Partisë, ai duhet të ketë edhe përgatitjen e duhur, aftësinë. Prandaj të kemi kujdes që kush punon në organizatën profesionale t'i përgjigjet nivelit të klasës punëtore.

Ka shumë rëndësi që në bashkimet profesionale të përmirësohet metoda e punës. Në këtë drejtim të mësohet më tepër nga eksperiencia e Partisë. Për shembull, instruktorët e bashkimeve profesionale kanë ç'të përfitojnë nga puna e instruktorëve të Partisë në ndihmë të bazës. Gjithashtu të shihet me kujdes metoda e punës kolegjiale në qendër e në bazë si dhe ndarja e përgjegjësisë dhe e kompetencave të udhëheqjes.

Për një punë më të gjallë me njerëzit, është e domosdoshme që të shkurtohen kërkesat për raporte e statistika të gjata e të shumta, që jeta ka treguar se nuk shfrytëzohen. Derisa nuk duhen këto materiale, atëherë përse ngarkohen njerëzit me punë të kota? Veç kësaj, bashkimet profesionale nuk kanë aparate si organet shtetërore. Prandaj i rishikoni këto gjëra.

Ju, shokët e Këshillit Qendror, duhet të bashkëpunoni më shumë me drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror. Edhe ju, shokë të drejtorive, sidomos ju të propagandës dhe të organeve të Partisë, të futeni më në thellësi të punës së bashkimeve profesionale, largohuni nga format e përgjithshme, burokratike e statistikore. Të gjeni kohë për të bashkëpunuar me shokët kryesorë të Këshillit Qendror, t'u qepeni problemeve të klasës punëtore në thellësi.

Puna e propagandës dhe e agjitacionit që zhvillohet nga organizata profesionale, të lidhet më mirë me atë të komiteteve të Partisë, të koordinohet me gjithë punën propagandistike dhe agjitative të Partisë. Në veprimtarinë e tyre edukative bashkimet profesionale të kenë parasysh që të bëjnë një punë të veçantë pa përsëritje, joparalele, po të koordinuar. Puna e agjitacionit dhe e propagandës që bën organizata profesionale, nuk mund të kuptohet kurrsesi e palidhur me punën e agjitacionit e propagandën e komiteteve të Partisë.

Kisha edhe disa vërejtje për punën e organizatës së rinisë. Ju, shokë të Komitetit Qendror të BRPSH, kur dërgoni në bazë instruktorët, mos u jepni një mori detyrash, por u jepni më pak, më kryesoret. Për çështjet e dorës së dytë përdorni një metodë tjetër, atë të bisedimeve dhe të informimit. Jepni udhëzime, por të krijohen mundësi që të punojë truri i instruktorit dhe t'i hapet atij horizonti i nevojshëm për probleme të caktuara. Kur instruktori të udhëzohet mirë për dy-tri çështje, ai do të shikojë si duhet edhe të tjerat, me të cilat do të ndeshet.



Aksionet me afat të gjatë duhet të kuptohen të lidhura ngushtë me planet e shtetit. Ju të shikoni në këto aksione çështjen e parimit vullnetar, të disiplinës dhe të frymës revolucionare që duhet të ketë rinia. Prandaj lidhur me këto aksione kanë rëndësi kontaktet që duhet të keni me sekretarët e komiteteve të Partisë, me kryetarët e komiteteve ekzekutive, me shefat e planit dhe të ketë kurdoherë në rini gjak dhe frymë të re.

Edukimit të rinisë t'i kushtoni më tepër kujdes, sepse në këtë fushë ka dobësi dhe formalizëm. Përpjekje bëhen dhe ka suksese, por duhet pranuar se ka mjaft të meta. Tani nuk jemi në situatë aq të vështirë sa të kemi akoma kaq shumë propagandistë me shkollë fillore, në një kohë kur Partia ka pajisur me kulturë masa të gjera të rinisë. Më duket se ju, shokë që drejtoni rininë, jeni mjaft sektarë në këtë drejtim.

Në përgjithësi për edukimin ideopolitik e kulturor të rinisë ekzistojnë një radhë formash, por duhet mbajtur parasysh që ato të mos jenë burokratike. Prandaj, në çështjen e edukimit ideologjik e kulturor të rinisë, ruani frymën masive dhe krijuese, duke luftuar kundër çdo shfaqjeje të huaj që dëmton në edukimin e rinisë. Detyra juaj është vërtet që t'i jepni rinisë një përgatitje fillestare, po efektive. Duke bërë këtë përgatitje me një punë të kujdesshme, atëherë krijohen mundësi që një pjesë e të rinjve të kalojnë më vonë edhe në kurset dhe në shkollat e Partisë.

Rëndësi të madhe ka puna përgatitore e rinisë, qysh në moshën e re, sidomos me vajzat, që janë gratë dhe nënat e ardhshme të Shqipërisë dhe luajnë një

rol të rëndësishëm në ndërtimin socialist të vendit dhe në edukimin e fëmijëve me idetë e marksizmit, me frymën e patriotizmit dhe me virtytet e larta të ndershmërisë, guximit, heroizmit etj. Edukimi i të rejave për rolin që do të kenë nesër si nëna, do të sjellë me të vërtetë përfundime jashtëzakonisht të mira në të ardhshmen në edukimin e brezit të ri, në qëndrueshmërinë dhe në karakterin e gruas shqiptare. Këtë çështje nuk duhet ta kuptojmë në mënyrë burokratike duke caktuar në çdo komitet rinie nga një sekretare për punën me të rejat, por të kuptojmë me të vërtetë hovin revolucionar të rinisë dhe detyrën e madhe që kemi për edukimin e brezit të ri të vajzave, sidomos të atyre fshatare, e në mënyrë të veçantë të krahinave të prapambetura. Kjo ka rëndësi të madhe. Nëse kuptohet dhe punohet kështu, ne mund të bëjmë një sakrificë, duke shtuar në organikë disa sekretare, sidomos për rrethet kryesore. Për këtë punë të gjenden shoqe të zonja, të zgjuara, me kulturë dhe me hov rinor, të gjalla. Dhe të tilla kemi shumë në organizatën e rinisë.

Më duket se nëpër shkolla nuk bëhet një punë e mirë me librin, nuk u rekomandohet nxënësve çfarë të lexojnë. Mësuesi, duke ditur librat që dalin, është mirë t'u rekomandojë nxënësve ata që duhet të lexojnë dhe të pyesë ndonjërin prej tyre se çfarë ka lexuar dhe ç'përmban libri. Kjo do t'i nxitë ata të përqendrohen në lexim dhe do të ndihmojë edhe të tjerët kur do të dëgjojnë përmbajtjen e librit të lexuar. Kur nxënësi e di se do ta pyesë mësuesi, atëherë ai e lexon librin më me kujdes, kështu do të rritet pjekuria e nxënësit, dhe një punë e tillë do ta ndihmojë atë edhe

për përvetësimin më mirë të lëndëve të tjera. Gjithashtu, kur një i ri do të tregojë për librin që ka lexuar, të mos dëgjojnë vetëm 3-4 vetë, po sa më shumë të rinj, sepse edhe ai që do të flasë nxitet ta lexojë librin me kujdes, edhe shokët e organizatës edukohen. Libri ndihmon për zhvillimin mendor dhe për forcimin e vëmendjes së fëmijëve.

Në forumet drejtuese të rinisë sot kemi një shumicë kuadrosh të mirë e të zotë për edukimin e brezit të ri. Kjo është pozitive, por të kemi kujdes që puna me rininë të zhvillohet në përshtatje me veçoritë e moshës së saj, larg frymës së formalizmit dhe të akademizmit. Një frymë e tillë në format e punës edukative të rinisë mpin forcat e saj të reja, pengon shpirtin e saj sulmues në punë.

Edukimi i rinisë, kalitja e saj revolucionare duhet të bëhen në punë e sipër; fryma e patriotizmit të lidhet edhe me dashurinë për vendin e punës, për zana-tin, të lidhet me realizimin e planit, me detyrat e rinisë dhe jo të zhvillohet punë e përgjithshme. Pra gjithë punën për edukimin e rinisë ta drejtojmë në një frymë realiste, dhe jo me ëndrra romantike apo sentimentaliste.

Ne duhet të insistojmë që rinia jonë të jetojë në mënyrë praktike, të interesohet për çdo gjë, t'i zërë dora çdo gjë. Jeta praktike t'i bëhet rinisë një jetë e dytë. Kjo do të thotë që rinia të dojë punën. Ndjenja e punës të futet thellë në ndërgjegjen e saj. Qysh në familje, në qoftë se ndonjë nga prindërit ka për të ngulur një gozhdë në mur, këtë të mos e bëjë vetë, por ta bëjë djali apo vajza e tij. Në qoftë se duhet fshirë

oborri, këtë ta kërkojë ta kryejë gjithashtu djali dhe vajza. Pra, të futen të rinjtë gradualisht në ato punë që janë të përshtatshme për ta, të bëhen praktikë në jetë, në shkollë, në familje e kudo. Duke u zënë dora çdo gjë, të rinjtë tanë do të jenë më të aftë dhe do të përgatiten më mirë për jetën. Kjo kërkon që ata të kuptojnë pse-në e çdo gjëje, dhe që nuk arrihet vetëm me parulla, por duke zbatuar një program të tërë edukimi masiv, për të cilin të merren masa që të zbatohet.

Rinia të rrojë e pastër, për këtë të punohet në një mënyrë të tillë që kjo t'i bëhet rinisë jetë e saj. Ka të rinj e të reja që i kanë të gjitha kushtet të jenë të pastër, por kur kthehen në shtëpi vijnë pis, ecin zbathur, hyjnë nga një dhomë në tjetrën, tërë pluhur dhe, po nuk u folë, harrojnë të lahen. Prandaj duhet të punohet vazhdimisht që fëmija të rrojë në pastërti e në ambient të kulturuar.

Rinia gjithashtu duhet të merret më mirë me fizikulturë, të kalitet fizikisht dhe ushtarakisht. Të bëhet një punë e dendur edukative në shkallë të gjerë që rinia të jetë trime dhe e patrembur nga vështirësitë. Kjo jo vetëm me propagandë, po me aktivitete e lodra të tilla që zhvillojnë te ajo guximin, trimërinë, shkathësinë. Rinia të bëjë jetë shoqërore dhe sa të jetë e mundur veprimet e saj të jenë kolektive.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## TRADHTI E MADHE NDAJ MARKSIZËM-LENINIZMIT

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**13 tetor 1962**

Me ftesën e Titos qëndroi në Jugosllavi për një vizitë zyrtare prej 11 ditësh, Presidenti i Presidiumit të Sovjetit Suprem të Bashkimit Sovjetik, L. Brezhnjev. Vizita e Brezhnjevit u shpall nga shtypi sovjetik dhe jugosllav si kthim i vizitës që Titoja bëri në Bashkimin Sovjetik në vitin 1956.

Në aeroportin e Moskës ai u përcuall nga N. Hrushovi. Me të mbërritur në Beograd, ku u prit me pompozitet të madh nga Titoja dhe klika e tij, Brezhnjevi u nxitua t'i shprehë «të nderuarit, shokut Tito» falënderimet për ftesën miqësore dhe t'i transmetojë në emër të N. S. Hrushovit «përshëndetjen e përzemërt dhe urimet e mira për sukses në jetë dhe në punë, në luftën për paqen e qëndrueshme dhe socializmin».

Gjatë vizitës, të dy presidentët shkëmbyen pa kursim fjalime pas fjalimesh. Titoja, në ligjëratat e tij shprehu gëzimin e madh që gjeti rastin t'i tregojë sho-

kut Brezhnjev «rezultatet e zhvillimit e të ndërtimit socialist në Jugosllavi», të arritura nën udhëheqjen e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Ai tha se «ekzistenca e disa ndryshimeve nuk duhet të jetë pengesë në këtë rrugë, meqenëse ato paraqitin një fenomen normal, që shpesh në botën e sotme rrjedh nga fakti se rrugët konkrete të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, të zhvillimit të vendeve të veçanta, janë të ndryshme, në varësi nga kushtet e ndryshme historike» dhe të tjera. Titoja foli për ndihmën dhe përkrahjen që Jugosllavia u ka dhënë lëvizjeve nacionalçlirimtare dhe përparimtare në botë dhe vendeve të pavarura në Azi e në Afrikë. Ai pohoi përpara Presidentit të Sovjetit Suprem se «qëndrimet e qeverisë jugosllave dhe qeverisë së Bashkimit Sovjetik përkojnë ose janë identike lidhur me një sërë çështjesh rrënjësore ndërkombëtare». Duke përmendur periudhën e një farë errësimi në marrëdhëniet midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, Titoja dha direktivën: «Ne nuk kemi nevojë të shahemi. Ne duhet t'i japim fund kësaj një herë e përgjithmonë dhe të jemi miq të mirë. Unë jam i bindur se vizita e tanishme do të jetë një hap i madh në zhvillimin e marrëdhënieve të vendeve tona». Në fjalimin e mbajtur në Kragujevac Titoja tha: «Miqve tanë ne mund t'u themi hapur se kanë ardhur në një vend në të cilin po ndërtohet socializmi dhe në të cilin nuk mund të ketë asnjë rrugë tjetër zhvillimi. Ne do të vazhdojmë të ecim në këtë rrugë dhe kemi me se ta ndërtojmë rendin tonë shoqëror socialist (natyrisht, këtu nuk foli për «ndihmat» amerikane). Duke përfunduar do të desha të falënderoj shokun tonë

Brezhnjev dhe miqtë e tjerë për vizitën që bënë këtu dhe për fjalët e tyre, të cilat përputhen plotësisht me mendimet tona të socializmit».

Nga ana e tij, Presidenti i Sovjetit Suprem të Bashkimit Sovjetik, anëtari i Presidiumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik Brezhnev, duartrokiti fjalët e Titos dhe bëri deklarata të ndryshme. Në fjalimin e parë të përshëndetjes me 24 shtator dhe disa herë të tjera me radhë ai përsëriti se «bashkëpunimi me Jugosllavinë është në dobi të të gjitha vendeve që ndërtojnë socializmin e komunizmin»(!) pasi vuri në dukje se «fusha e veprimtarisë në marrëdhëniet sovjeto-jugosllave është shumë e gjerë», tha: «Ne vlerësojmë lart përpjekjet e qeverisë dhe personalisht të Presidentit të RFPJ, shokut Josif Broz Tito, të cilët shprehen për politikën e paqes, e bashkëpunimit paqësor midis shteteve» etj. Kurse në fjalimin e mbajtur në një miting në Split, Brezhnjevi u raportoi «shokëve jugosllavë» mbi likuidimin e kultit të personit dhe kapërcimin e pasojave të dëmshme. Ai theksoi se «rëndësi të madhe për ndërtimin me sukses të shoqërisë komuniste ka pasur zbulimi dhe demaskimi me guxim dhe dënimi i kultit të personit të Stalinit». Këtu Brezhnjevi shprehu edhe përshtypjet e tij nga ndërtimi i socializmit në Jugosllavi, duke thënë se «ne kemi parë se si punojnë popujt e Jugosllavisë si një familje vëllazërore e bashkuar, duke ndërtuar jetën e tyre të re». Shpeshherë ai foli për «bisedat interesante dhe të vlefshme me presidentin Tito dhe me personalitetet e tjera të shquara të Jugosllavisë», për «gjërat interesante që pa», për «vizitën shumë interesante».

për «rrugën shumë interesante» që bëri nëpër Jugosllavi.

Gjatë vizitës nëpër Jugosllavi, shoqërues nderi i Presidentit të Sovjetit Suprem të Bashkimit Sovjetik ishte A. Rankoviçi, i njohur për organizimin e torturave dhe vrasjeve të mijëra komunistëve jugosllavë, që patën guximin të kundërshtonin kursin revizionist të klikës së Titos qysh nga viti 1948 e këtej.

Duke u ndarë «përzemërsisht» me Titon, Brezhnjevi vuri në dukje edhe një herë «bisedat e singerta me të për shumë çështje të luftës së përbashkët për paqe dhe të zhvillimit të përgjithshëm, të marrëdhënieve sovjeto-jugosllave në interes të paqes dhe të socializmit», falënderoi përsëri «përzemërsisht mikun e dashur presidentin e republikës, shokun Tito» dhe në emër të N. Hrushovit iu lut të shkojë për vizitë në Bashkimin Sovjetik. Titoja, sipas TASS-it, e priti me kënaqësi ftesën dhe do të shkojë për vizitë të N. Hrushovi në muajin dhjetor të këtij viti.

Në përfundim të vizitës së Brezhnjevit gazeta «Borba», me gëzim të papërmbajtur, shkruante: «Marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimi i frytshëm midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë patjetër do të marrin atributet e marrëdhënieve me afate të gjata e marrëdhënieve më të stabilizuara e më të mira».

Këto janë ato që u thanë publikisht, por tërheqin vëmendjen ato që nuk u thanë dhe që u shmangën me qëllim, qoftë gjatë fjalimeve, qoftë në komunikatën e botuar. Nuk e kemi fjalën këtu për bisedimet sekrete, të cilat vazhdojnë prej shumë kohësh midis grupit të N. Hrushovit dhe Titos, për planet e tyre të bashkë-



punimit dhe të bashkërendimit të veprimtarisë përçarëse. Këto do t'i nxjerrë në shesh koha, siç i ka nxjerrë herë pas here. E kemi fjalën për ato çështje rreth të cilave mbahet heshtje, ose preken në mënyrë të shtrembëruar. Kujtdo, që ndoqi nga afër vizitën e Brezhnjevit në Jugosllavi dhe lexoi me vëmendje komunikatën përfundimtare të bisedimeve Tito-Brezhnjev, i bie në sy se si aty nuk theksohet rreziku që paraqit imperializmi amerikan për paqen, pavarësinë kombëtare të popujve dhe socializmin, se si përhapen iluzione se gjoja ka ardhur koha që imperialistët, si rrjedhim i «çarmatimit», do t'i kalojnë një pjesë të madhe të fondeve për zhvillimin e mirëqenies së popujve, sidomos të vendeve të pazhvilluara, se si, kur flitet për Kubën, nuk vihet gishti mbi imperializmin amerikan, që e kërcënon atë me agresion, por flitet vetëm për disa qarqe agresive të imperializmit, se si, kur flitet për çështjen e pranimit të RP të Kinës në OKB, nuk përmendet dëbimi i çankaishistëve nga OKB-ja dhe nuk dënohet politika imperialiste e «dy-Kinave» etj., etj.

\*  
\* \* \*

Nga sa përmendëm, del qartë se vizita e Brezhnjev, e këtij të dërguari personal të N. Hrushovit te Titoja, me gjithë orvatjet e lehta që bëhen për ta mbajtur formalisht në kuadrin e bashkëkzistencës paqësore, të marrëdhënieve midis shteteve, nuk është një

udhëtim i thjeshtë e i zakonshëm për të parë «vendet e bukura e të mrekullueshme të Jugosllavisë mike». Kjo vizitë bëhet vetëm pak kohë pas fjalimit të mbajtur në Varna të Bullgarisë nga N. Hrushovi, ku ai i bëri clozhe klikës së Titos «që ndërton socializmin», i konsideroi «jo vetëm normale, por të mira» marrëdhëniet e tij me Titon; bëri thirrje për afrimin dhe përmirësimin e gjithanshëm të marrëdhënieve me Jugosllavinë e sotme; duke e çmuar bashkëpunimin dhe ndihmën për Jugosllavinë një faktor që «jo vetëm do të ndihmojë për përmirësimin e marrëdhënieve reciproke midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, por edhe do të jetë në dobi të të gjitha vendeve që ndërtojnë socializmin dhe komunizmin» (!) Udhëtimi i Brezhnjev, po ta shikojmë në sfondin e veprimtarisë përçarëse që zhvillon klika e Titos kundër kampit socialist, kundër lëvizjes nacionalçlirimtare, lëvizjeve revolucionare të klasës punëtore, lëvizjeve përparimtare në përgjithësi, po ta shikojmë në sfondin e pikëpamjeve revizioniste e të veprimeve përçarëse të grupit të N. Hrushovit dhe në sfondin e orvatjeve të dyanshme, si nga N. Hrushovi ashtu edhe nga Titoja, për t'u afruar, për të koordinuar veprimtarinë e tyre anti-marksiste, nuk ka pikë dyshimi se është një udhëtim që del nga kuadri i vizitave të mirësjelljes që kërkon protokollin diplomatik. Udhëtimi i Brezhnjev, ky «mision i tij i miqësisë», kjo «vizitë e rëndësishme», sikurse i quan vetë shtypi sovjetik, ka karakter të theksuar politik e ideologjik dhe është një hallkë në vazhdën e orvatjeve të N. Hrushovit për t'u afruar me revizionistët jugosllavë, për të bashkërenduar me ta

kursin e ri revizionist për përçarjen e kampit socialist, për likuidimin e socializmit.

Dihet se përpjekjet e tij për afrim me renegatët jugosllavë N. Hrushovi i filloi botërisht qysh në vitin 1955, kur shkoi e i ra në gjunjë Titos në Beograd dhe i kërkoi ndjesë për fajet që gjoja ishin bërë nga partitë komuniste e punëtore të vendeve socialiste ndaj «udhëheqësve jugosllavë», duke larë kështu me autoritetin e Bashkimit Sovjetik mëkatet e titistëve. Ky ishte hapi i parë. Pasi u vuri revizionistëve jugosllavë përsëri vellon e marksistë-leninistëve, N. Hrushovi ndërmoi në mënyrë të planifikuar, hap pas hapi, sikurse e ka vërtetuar dhe e vërteton jeta, masa për t'u afruar gjithnjë më shumë me ta.

Ngjarjet që rodhën pas vizitës së Titos në Bashkimin Sovjetik më 1956, sidomos ngjarjet e kundërrevolucionit në Hungari dhe botimi i programit revizionist të LKJ, e vunë në vështirësi N. Hrushovin për të vazhduar në rrugën e tij. Mbledhjet e Moskës të viteve 1957 e 1960, të cilat e demaskuan rreptësisht dhe me të drejtë klikën revizioniste jugosllave, si tradhtarë të marksizëm-leninizmit, si minuese të kampit socialist në shërbim të imperializmit amerikan etj., e shqetësuan fort N. Hrushovin. Prandaj ai, disa herë, nën presionin e luftës së drejtë që bënin partitë komuniste e punëtore kundër revizionizmit, e në radhë të parë atij jugosllav, si rrezik kryesor në lëvizjen komuniste, u detyrua të thotë edhe ndonjë fjalë kundër klikës së Titos. Por gjithmonë, sikurse e vërtetojnë faktet e shumta që tanimë njihen publikisht, përmes vetë fjalimeve të tij të mbajtura kohë e pa kohë, Hrushovi gjithmonë

e ka lënë derën hapur për marrëveshje me klikën e Titos, gjithmonë, në një mënyrë ose në një tjetër, ka nxitur edhe të tjerët për të mos i ashpërsuar marrëdhëniet, për të mos i luftuar revizionistët jugosllavë, nën justifikimin absurd «se mos u rritet vlera».

Por erdhi koha e Kongresit të 22-të, kur Hrushovi doli haptazi si përçarës i kampit socialist e i lëvizjes komuniste. Dhe në këtë kohë të parën punë që duhej të bënte ishte të hiqte tërë pengesat e të rifillonte kontaktet zyrtare shtetërore e partie me klikën e Titos. Kjo ishte e domosdoshme për të vazhduar veprimet e tij përçarëse dhe aleati më i mirë në këtë ndërmarrje ishte pa dyshim Titoja, i cili kishte dhënë prova në rrugën e tradhtisë së marksizëm-leninizmit. Për t'ia arritur këtij qëllimi, atij iu desh të shqelmojë me të dyja këmbët Deklaratën e Mbledhjes së Moskës të vitit 1960. Dhe, i vendosur për të zbatuar planet e tij, ai nuk ngurroi ta bënte një gjë të tillë.

Kështu filloi bashkëpunimi në fushën ekonomike dhe qysh në vitin 1961 shkëmbimi i mallrave u rrit 2,5 herë kundrejt vitit 1955. Në vitin 1962 shkëmbimi i mallrave do ta kalojë 30 për qind nivelin e vitit të kaluar. Në korrik të këtij viti, «në atmosferën e bisedimeve të përzemërta, në frymën e miqësisë e të mirëkuptimit të plotë reciprok», u zgjidhën pa asnjë vështirësi të gjitha çështjet e bashkëpunimit ekonomik reciprok. U nënshkruan njëra pas tjetrës marrëveshjet e ndryshme që parashikojnë shtime të konsiderueshme të burimeve reciproke të mallrave për vitet 1963-1965, në krahasim me volumin e caktuar për këtë periudhë nga marrëveshja në fuqi me afat të gjatë. U

morën të gjitha masat për kooperimin në fushat e industrisë e të bashkëpunimit tekniko-shkencor dhe në shkëmbimin e dyanshëm të specialistëve etj.

Pas zgjidhjes së çështjeve ekonomike, N. Hrushovit i duhej patjetër të zgjidhte plotësisht edhe çështjet me karakter politik e ideologjik me klikën e Titos. Një nga bashkëpunëtorët e afërm të N. Hrushovit, sikurse është, për shembull, J. V. Spiridonov, Kryetar i Sovjetit të Bashkimit të Sovjetit Suprem, ka thënë se «në goftë se synohet në drejtimin që midis shteteve dhe qeverive të ketë më shumë pika të kontaktit mbi çështjet e politikës së jashtme, të ekonomisë dhe të kulturës, atëherë mund të ecet edhe në drejtim të mënjanimin të divergjencave në fushën ideologjike» (nga fjali i Spiridonovit mbajtur më 2 korrik 1962 në pritjen për nder të delegacionit parlamentar jugosllav). Bashkëpunimi filloi të marrë përpjesëtime të gjera në drejtim të shkëmbimit të delegacioneve të shumta të të gjithë sektorëve, duke përfshirë këtu edhe delegacione të sektorëve politikë e ideologjikë. Shkëmbimi i delegacioneve ka përfshirë organizatat e masave si ato të bashkimeve profesionale, gazetarët, shkrimtarët, artistët, shkencëtarët etj. Zërat që dëgjoheshin herë pas here nga N. Hrushovi dhe propagandistët e tij për përputhjen e politikës së tij me atë të grupit të Titos, ishin prologu i vizitës së Brezhnjevit.

Afrimin me klikën e Titos Hrushovi e maskoi me deklaratat se «Jugosllavia është një vend që ndërton socializmin». Një maskë e tillë është shumë e zbetë për të mbuluar tradhtinë e madhe që bëhet duke bashkëvepruar me renegatët e Beogradit.

Mbi ç'baza, në ç'logjikë mbështeten N. Hrushovi dhe pasuesit e tij kur deklarojnë se Jugosllavia ndërton socializmin? Si mundet të ndërtojë socializmin një grup tradhtarësh të marksizëm-leninizmit, kur dihet se ideologjia shkencore e ndërtimit të socializmit është marksizëm-leninizmi? Si mund të ndërtohet socializmi duke i lënë rrugë të lirë zhvillimit kapitalist të fshatit, duke e futur ekonominë çdo ditë e më thellë në binarët e ekonomisë kapitaliste? Si mundet të ndërtohet socializmi me miliardat e dollarëve amerikanë, që e kanë zënë prej gryke gjithë ekonominë jugosllave? Si mund të ndërtojë socializmin një vend udhëheqësit e të cilit minojnë unitetin e kampit socialist? Pra dhe minues të socializmit, dhe ndërtues të socializmit? Si mund të quhet socialist një vend udhëheqja e të cilit, nën pretekstin e politikës «jashtë blloqeve», zhvillon veprimtari që i sjell dëm çështjes së unitetit të të gjitha forcave dhe shteteve paqedashëse? Ç'ka ndryshuar vallë në Jugosllavi që nga Mbledhja e Moskës e vitit 1960 për të arritur në konsiderata të tilla siç bëjnë grupi i N. Hrushovit? Asgjë nuk ka ndryshuar. Revizionistët jugosllavë jo vetëm nuk kanë bërë asnjë ndryshim, por çdo ditë janë futur më thellë në shërbim të imperializmit, në rrugën e rivendosjes së kapitalizmit në Jugosllavi.

Pikërisht për veprimtarinë tradhtarë e përçarëse të klikës së Titos ka nevojë grupi i N. Hrushovit. Eksperienca e Titos në këtë fushë i duhet atij për të vënë në jetë kursin e vet revizionist. Prandaj ai me qëllim mbyll sytë përpara realitetit të sotëm të Jugosllavisë, që po ecën drejt rivendosjes së sistemit kapi-

talist, dhe harron çdo gjë që ka thënë kundër revizionistëve jugosllavë. Me këtë shpjegohen të gjitha koncesionet e ndryshme ideologjike, përpjekjet për përputhjen e pikëpamjeve të tyre që u bënë gjatë vizitës së Brezhnjevrit në Jugosllavi.

Jo pa qëllim Brezhnjevi, gjatë gjithë vizitës së tij, në asnjë fjalim nuk e përmendi asnjëherë shprehjen «kampi socialist». Këtë ai u detyrua ta bëjë, së pari, sepse Titoja nuk do ta pranonte, pasi ai është «kundër kampeve», qëndron «mbi kampet»; dhe e dyta, ajo që ka më tepër rëndësi, sepse, me sa del nga vetë fjalimet e Brezhnjevrit, ai, në vend që të flasë për kampin socialist, flet për «botën e vendeve socialiste», për «forcat socialiste në botë», për «shoqërinë e shteteve socialiste», përpiqet të gjejë forma të përshtatshme për likuidimin e kampit socialist, për futjen e ujkut në vathë, për futjen e «Jugosllavisë mike socialiste» në familjen e vendeve socialiste, për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, të cilat tanimë dihen nga të gjithë.

Për të realizuar qëllimet e tij të afrimit, N. Hrushovi i dha me vete Brezhnjevrit një mbështetje të sigurt, që përbënte suitën e tij në vizitën në Jugosllavi. Kjo mbështetje përbëhej nga njerëzit më të afërt e më të sprovuar të vijës së tij revizioniste, sikurse janë Axhubej, Firjubin dhe Andropov. Axhubej, merita e vetme e të cilit si «personalitet politik» është se ka grua bijën e Hrushovit, njihet si ndërlihdësi i drejtpërdrejtë i N. Hrushovit në pazarllëqet e tij me Kenedin dhe që, duke ecur në gjurmët e vjehrrit, e ka quajtur presidentin miliarder të monopoleve amerikane, Kenedin, «hero me të cilin duhet të krenohet populli ameri-

kan». Firjubini ka qenë ambasador në Beograd, ka shërbyer si ndërlidhës zyrtar i N. Hrushovit me klikën e Titos dhe ka një meritë të veçantë në afrimin Tito-Hrushov. Andropovi, ish-ambasador në Hungari, tani funksionar i rëndësishëm në aparatën e KQ të PK të BS, është i njohur si njeriu i veprimeve të zeza të Hrushovit dhe grupit të tij në ngjarjet e kundërrevolucionit hungarez të vitit 1956 dhe në komplotet e Hrushovit kundër PPSH dhe partive komuniste e punëtore të tjera të botës.

Grupi i N. Hrushovit dhe vetë Titoja e gjejnë se ka ardhur çasti më i volitshëm për afrim të gjithanshëm, se ka ardhur koha e bashkëpunimit të hapur në të gjitha drejtimet, në të gjitha format. Kjo shprehet qartë në fjalët që Titoja i drejtoi Brezhnjev: «Mjaft u shamë. Tani nuk duhet të zihemi më. Duhet të jemi miq të mirë». Me fjalë të tjera, Titoja thotë: Mjaft u hodhëm të tjerëve pluhur syve, sikur jemi kundërshtarë. Le t'i heqim maskat. Ka ardhur çasti t'i japim haptazi dorën njëri-tjetrit dhe të punojmë së bashku për qëllimet tona të njëjta.

Gjatë vizitës së tij në Jugosllavi, Brezhnjevi shpesh herë përsëriti formulën e njohur të N. Hrushovit mbi «përputhjen» e pikëpamjeve dhe të qëndrimeve në çështjet e politikës së jashtme.

Në artikujt tanë të mëparshëm ne kemi analizuar me hollësi dhe kemi vërtetuar me fakte se qëndrimet e revizionistëve jugosllavë nuk kanë asgjë të përbashkët me politikën e jashtme të vendeve socialiste. Prandaj këtu nuk po zgjerohemi, vetëm po vëmë në dukje se pikërisht në ditët kur Brezhnjevi në turneun e tij nëpër



Jugosllavi bëri përpjekje të rrumbullakosë qëndrimet dhe politikën e revizionistëve jugosllavë dhe t'i paraqitë ato identike me politikën e shtetit sovjetik, përfaqësuesi i revizionistëve jugosllavë në sesionin e tanishëm të Asamblesë së OKB-së, Popoviç, në fjalimin e tij, vuri edhe një herë në bankën e të akuzuarit politikën e Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera socialiste, duke e krahasuar me politikën e agresionit e të luftës të imperializmit amerikan.

Orvatjet e N. Hrushovit për ta vënë në një plan politikën e revizionistëve jugosllavë me atë të Bashkimit Sovjetik, për përputhjen dhe identitetin e qëndrimeve sovjetë-jugosllave në çështjet ndërkombëtare, janë vetëm një bluf, një maskë që i duhet N. Hrushovit për ta paraqitur si socialiste klikën renegate të Beogradit. Në të vërtetë këto orvatje janë hedhur poshtë nga faktet e shumta dhe nga vetë Titoja në intervistën e tij të fundit, kur ai deklaroi: «Përfaqësuesit tanë në radhë të parë, nuk votojnë gjithmonë në anën e kundërt të SHBA-së... Ka pasur raste që përfaqësuesit tanë kanë marrë, në pajtim me pikëpamjet tona, qëndrime që pajtoheshin me qëndrimet e përfaqësuesve amerikanë».

Dihet tanimë botërisht se politika jugosllave në çështjet e jashtme është një shtojcë e politikës që ndjekin imperialistët amerikanë dhe nuk mund të bëhet fjalë për përputhjen e saj me politikën e shteteve socialiste. Politika e revizionistëve jugosllavë puqet plotësisht me pikëpamjet dhe qëllimet që ndjek grupi revizionist i N. Hrushovit.

Për N. Hrushovin rëndësi të madhe ka që qëndrimet e klikës së Titos për çështjet e ndryshme ndërko-

mbëtare të jenë në përshtatje me çështjet themelore strategjike që bashkojnë grupin e N. Hrushovit me klikën e Titos. Të tilla çështje janë: pajtimi klasor i socializmit me kapitalizmin, bashkekzistenca politike dhe ideologjike midis tyre, paqja dhe bashkekzistenca me çdo kusht, mohimi i çdo lëvizjeje revolucionare, integrimi ekonomik e politik i botës. Përsa u përket veprimeve dhe qëndrimeve për çështje të caktuara konkrete, në këto vetë N. Hrushovi është në shumë raste kontradiktor. Për këtë ka shembuj të shumtë që tregojnë se N. Hrushovi ç'thotë sot nuk thotë nesër. Sot e lavdëron Ajzenhauerin, nesër e shan; sot deklaron se çështja e Gjermanisë duhet zgjidhur pa vonesë, duke caktuar edhe afatin, nesër deklaron pa turp se çështja e afateve nuk ka rëndësi; sot thotë se revizionizmi jugosllav është «kalë i Trojës», nesër thotë se ai ndërton socializmin. Kjo taktikë përbën një tipar dallues të revizionistëve modernë, sepse ata nuk janë njerëz parimorë. Ata, si antimarksistë që janë, mundohen t'u përshtaten kthesave të shkaktuara nga ngjarje të vogla politike, harrojnë interesat jetësore të proletariatit dhe natyrën e rendit kapitalist.

Më kot u mundua grupi i N. Hrushovit t'i japë vizitës së Brezhnjev-it ndonjëherë edhe karakter anti-imperialist, për të maskuar qëllimin e vërtetë që kishte vizita për të kolauduar pikëpamjet dhe veprimet e tyre revizioniste. Gazeta sovjetike «Izvestija» në një artikull me titull «në emër të qëllimeve të përbashkëta», në të cilin theksohet me ngut «atmosfera e pastër e marrëdhënieve sovjeto-jugosllave», përpiqet të vërë në dukje se gjoja vizita e Brezhnjev-it na qenka pritur «me shqe-

tësim e nervozizëm në qarqet drejtuese të Adenauerit» dhe në përgjithësi në qarqet imperialiste. Por e vërteta qëndron ndryshe. Në të vërtetë as Brezhnjevi nuk u mor shumë me këtë çështje as «Izvestija» nuk ngul këmbë për ta argumentuar këtë. Përkundrazi, duke u shqetësuar se mos imperialistët zemërohen dhe i kthejnë shpinën klikës së Titos, grupi i Hrushovit e thekson në mënyrë të posaçme se «Bashkimi Sovjetik, duke dashur zgjerimin e marrëdhënieve të mira me Jugosllavinë, nuk kërkon keqësimin e marrëdhënieve të saj me vendet e tjera»<sup>1</sup>. Dhe kjo nuk bëhet pa qëllim, N. Hrushovit nuk i intereson në asnjë mënyrë që revizionistët jugosllavë të shkëputen nga imperialistët, sidomos nga imperialistët amerikanë. Klika e Titos është një urë e rëndësishme lidhjeje ndërmjet Hrushovit dhe Kenedit. Nuk është e rastit as zhurma që po bëhet këto ditë në SHBA në lidhje me një vendim që paska marrë senati amerikan për t'i hequr Jugosllavisë të drejtën e kombit të privilegjuar në tregtinë e jashtme me SHBA-në. E vërteta është se shtypi reaksionar nuk e përmbajti dot gëzimin që ndien nga kjo vizitë dhe, me entuziazëm e quajti demonstracionin e miqësisë që bëri grupi i N. Hrushovit ndaj Titos «pranverë në marrëdhëniet sovjetojugosllave».

Nga gjithë sa u përmendën del qartë se grupi i N. Hrushovit dhe i Titos tani puqen politikisht dhe ideologjikisht në të gjitha çështjet themelore, puqen në strategjinë dhe në taktikën e tyre për afrimin me imperialistët, puqen në strategjinë dhe në taktikën e tyre

---

1 «Izvestija» 29 shtator 1962.

për luftën kundër marksizëm-leninizmit, kundër unite-  
tit të kampit socialist, puçen në përpjekjet e përbash-  
këta të tyre për të tërhequr në rrugën e tradhtisë, për  
të degjeneruar edhe disa udhëheqës të partive komu-  
niste e punëtoare të disa vendeve socialiste të Evropës  
dhe të disa vendeve kapitaliste. Ata puçen në strate-  
gjinë dhe në taktikën e tyre për të minuar lëvizjen na-  
cionalçlirimtare, duke ia nënshtruar këtë «çarmatimit  
të përgjithshëm e të plotë», puçen në strategjinë dhe  
në taktikën e tyre për integrimin ekonomik e politik  
të botës.

Të gjitha këto e bëjnë shumë të qartë se ndodhemi  
përpara një tradhtie të madhe ndaj marksizëm-leniniz-  
mit. Këtë tradhti mund të mos e shohin vetëm ata që  
nuk duan, vetëm ata të cilëve nuk u leverdis ta shi-  
kojnë.



Ne duhet t'i shikojmë gjërat drejt e në sy, t'i quaj-  
më me emrin e tyre. Revizionizmi modern është bërë  
një rrezik shumë i madh për fitoret e mëdha historike  
që ka arritur proletariati për revolucionin, për socia-  
lizmin. Ai është bërë agresiv dhe i paturpshëm.

Revizionizmi modern, si rrymë antimarksiste, ako-  
ma nuk është demaskuar plotësisht. Pikërisht këtu që-  
ndron rrezikshmëria e tij. Është e vërtetë se forma e  
revizionizmit jugosllav është diskredituar shumë, por  
sot duhet demaskuar deri në fund fronti i përbashkët që

po krijojnë revizionistët modernë në luftën kundër socializmit, kundër marksizëm-leninizmit revolucionar.

Ku qëndron fuqia e revizionizmit modern? Sot nuk kemi të bëjmë me një oportunizëm si ai i Internacionales II në periudhën 1894-1917, që mbështetej vetëm në lëmoshat që jepte borgjezia sunduese nga fitimet e pafund që nxirrte, duke shfrytëzuar popujt kolonialë e të varur. Tragjedia e madhe që e ka goditur sot lëvizjen komuniste ndërkombëtare është se revizionizmi përfaqësohet nga grupi i N. Hrushovit, i cili qëndron në krye të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Leninit të madh.

Revizionistët, duke ushtruar një demagogji të shfrenuar, shfrytëzojnë për interes të tyre autoritetin e madh ndërkombëtar që ka fituar Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik nën udhëheqjen e Leninit dhe të Stalinit, si dhe të kaluarën e lavdishme revolucionare të disa partive komuniste të vendeve të ndryshme. Revizionizmi modern e përdor marksizëm-leninizmin, dhe sidomos emrin e Leninit, si etiketë në përhapjen e teorisë dhe pikëpamjeve të tij antimarksiste për mashtrimin e masave. Sigurisht nuk mund t'ua ndalosh Hrushovit, Titos dhe pasuesve të tyre të përdorin etiketat që u pëlqejnë për të shitur mallin e tyre bajat. Po ato paraqitin rrezikshmëri kur përdoren nga njerëz që nuk e kanë akoma të çjerrë krejt maskën, e cila mbulon fytyrën e tyre prej antimarksistësh. V. I. Lenini vazhdimisht theksonte se nuk është aq i rrezikshëm dhe i dëmshëm oportunizmi i hapur sa ai që paraqitet i mbuluar me petkun e marksizëm-leninizmit.

Përveç këtyre, revizionizmi modern ka edhe për-

krahjen e imperializmit ndërkombëtar, i cili e ndihmon atë me forma dhe me mënyra të ndryshme, të hapura dhe të fshehta. Mjafton të marrim shembullin e Jugosllavisë, ku monopolistët amerikanë kanë vënë në duart e Titos, njërit nga krerët e revizionizmit modern, shumën prej 5 miliard dollarësh, që duhet të përdoret për të arritur qëllimin kryesor strategjik të imperializmit: likuidimin e sistemit socialist dhe vendosjen e sundimit botëror të imperializmit.

Burimi i revizionizmit të sotëm u zbulua dhe u përcaktua më së miri në mbledhjet e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtoresh që u mbajtën në Moskë më 1957 dhe 1960. «Qenia e influencës borgjeze, thuhet në Deklaratën e vitit 1957, është burimi i brendshëm i revizionizmit, kurse kapitullimi përpara presionit të imperializmit është burimi i tij i jashtëm».

Pra, revizionizmi modern nuk është një gjë e rastit, nuk doli ashtu papritur si Athinaja nga koka e Zeusit. Ai lindi si rezultat i luftës së ashpër klasore që zhvillohet midis socializmit, që ka të ardhshmen përpara, dhe borgjezisë imperialiste, që e pret vdekja, ai është mishërim i kapitullimit në këtë luftë i pjesës së aristokratizuar e të pavendosur ndër përfaqësuesit e klasës punëtoresh, si pasojë e presionit të fortë e të vazhdueshëm që ushtron imperializmi.

Si në të kaluarën ashtu edhe në ditët e sotme kryesorja në përmbajtjen e oportunitizmit është ideja e bashkëpunimit të klasave. Këtë ide revizionizmi modern e ka vënë në themel të të gjithë veprimtarisë së tij.

Grupit revizionist të Hrushovit i vret veshin, prandaj ai nuk e zë kurrë në gojë përkufizimin shkencor të

epokës së sotme, që është dhënë në Deklaratën e Moskës të vitit 1960. Në këtë Deklaratë epoka e sotme përcaktohet si një epokë e luftës midis dy sistemeve të kundërta shoqërore, epokë e revolucioneve socialiste dhe e revolucioneve nacionalçlirimtare, epokë e shembjes së imperializmit, e likuidimit të sistemit kolonial, epokë e kalimit në rrugën e socializmit të vendeve të tjera, e triumfit të socializmit dhe të komunizmit në shkallë botërore. Kurse Hrushovi dhe ata që i venë pas, epokën e sotme e paraqitin në të vërtetë si epokë të bashkekzistencës paqësore, gjatë së cilës, në rrugë paqësore e me bisedime, duhet të gjejnë zgjidhje problemet shoqërore dhe politike që e ndajnë sot botën. Për ta përmbajtja kryesore e epokës sonë është gara ekonomike paqësore midis dy sistemeve shoqërore botërore, socialist dhe kapitalist. Prandaj bashkekzistenca paqësore shpallet me bujë nga grupi i Hrushovit si vijë e përgjithshme e politikës së jashtme të vendeve socialiste, si rrugë e përgjithshme për fitoren e socializmit në shkallë botërore. Në të njëjtën qafë të çojnë edhe vlerësimet që i bëjnë epokës së sotme grupi i Titos, i cili e quan atë si epokën e integritit paqësor të botës në socializëm.

E theksuam ndryshimin esencial të kuptimit që i japin epokës sonë, nga një anë, Deklarata e Moskës e vitit 1960 dhe, nga ana tjetër, revizionistët, sepse që këtu ndahen rrugët krejt të kundërta të marksizëm-leninizmit revolucionar dhe të revizionizmit modern.

Duke u nisur nga përcaktimi shkencor mbi epokën e sotme marksistë-leninistët nxjerrin konkluzione të drejta revolucionare. Rritjen e forcave të komunizmit

në botë, forcimin e influencës së socializmit revolucionarët i kuptojnë si një faktor që ka krijuar kushte shumë të favorshme dhe mundësi të reja për partitë komuniste dhe punëtorë, për klasën punëtorë dhe për të gjitha forcat revolucionare të vendeve kapitaliste, si dhe për popujt e shtypur nga imperializmi për fitoren e sigurt të revolucioneve socialiste dhe të lëvizjeve nacionalçlirimtare, për triumfin e socializmit dhe të komunizmit në të gjithë botën. Por fitorja kurrë nuk vjen vetë, as ta fal njeri, ajo arrihet me luftë dhe përpjekje të masave popullore, të bashkuara fort rreth një udhëheqje revolucionare, të vendosur deri në fund për mbrojtjen e interesave të popullit, të revolucionit. Ky është mësimi i historisë. Sot më tepër se kurrë situata kërkon që partitë komuniste dhe punëtorë të jenë kurdoherë në ballë të përpjekjeve të masave kundër imperializmit, të tregojnë me vepra se janë të zonjat të udhëheqin proletariatin dhe aleatët e tij në luftë për triumfin e revolucionit socialist dhe të revolucionit nacionalçlirimtar.

*«Nuk mjafton ta quash veten «pararojë», repart pararojë — thotë V. I. Lenini — duhet edhe të veprosh në mënyrë që të gjitha repartet e tjera ta shohin, se ne marshojmë në krye dhe të detyrohen ta pranojnë këtë»<sup>1</sup>.*

Zhvillimi historik i ngjarjeve nuk të pyet fare se ç'është mban, parti komuniste apo ndonjë emër tjetër, se çfarë

---

1 V. I. Lenini. Veprat, vëll. 5, f. 504.



programesh dhe parullash shpall. Revolucioni nuk do fjalë, por vepra. Po s'i dole në krye gjendjes me vepra, ajo të flak atje tej, të përplas aq fort, sa të dërrmohesh fare, dhe asnjëri të mos të përfillë. Nuk mungojnë shembujt, bile ka të tillë shembuj fare aktualë, që tregojnë se sa rëndë i ka dënuar zhvillimi i situatave revolucionare ata që kanë qëndruar në bisht të ngjarjeve, si rezultat i degjenerimit të tyre, duke ndjekur kursin revizionist të Hrushovit.

Imperializmi amerikan përbën sot forcën kryesore të agresionit e të luftës, është sot armiku më i egër i mbarë njerëzimit. Bota është dëshmitare e akteve të shumta të agresionit e të luftës, të shpërthyer nga imperialistët në vende të ndryshme, është dëshmitare e përgatitjeve të ethëshme për luftëra të reja agresive nga ana e imperialistëve amerikanë dhe e partnerëve të tyre në blloqet agresive kundër vendeve socialiste, kundër popujve që porsa kanë fituar lirinë e pavarësinë, kundër popujve që janë ngritur e ngrihen ditë-ditë në luftën për përmbysjen e zgjedhës së kolonizatorëve imperialistë, për likuidimin e regjimit të urryer të shtypjes e të shfrytëzimit kapitalist.

Gjendja e sotme më tepër se kurrë kërkon në mënyrë të ngutshme krijimin e një fronti të bashkuar të luftës kundër imperializmit, për paqe, pavarësi kombëtare dhe socializëm, të vendeve socialiste, të lëvizjes revolucionare punëtore në vendet kapitaliste, të lëvizjes revolucionare nacionalçlirimtare dhe demokratike, të të gjitha vendeve dhe popujve paqedashës të botës, sepse imperializmi është sot armiku kryesor e i përbashkët i njerëzimit. Vetëm kështu ka mundësi të si-

gurohet një paqe e qëndrueshme dhe të mënjanohet një luftë e re botërore; njëkohësisht, të likuidohet sundimi imperialist dhe të arrihet triumfi i socializmit në shkallë botërore.

Por krijimin e një fronti të shëndoshë kundër imperializmit e pengojnë në çdo mënyrë revizionistët modernë. Ata nuk lënë gjë pa përdorur, deri në aktet më të ulëta kriminale, për të sabotuar luftën çlirimtare të popujve të shtypur kundër imperialistëve, për të ndaluar bashkimin e gjithë forcave antiimperialiste në luftë për paqe, pavarësi kombëtare dhe socializëm, për të penguar përhapjen dhe rrënjosjen e ideve të marksizëm-leninizmit revolucionar. Në lidhje me këto revizionistët modernë u bëjnë lëshime të mëdha parimore imperialistëve.

Ndërkaq imperialistët, me ata amerikanë në krye, i shfrytëzojnë më mirë dobësitë dhe lëshimet e revizionistëve modernë, veçanërisht të Hrushovit. Politika dhe veprimtaria oportuniste, antirevolucionare, politika e pajtimit me imperialistët që ndjekin revizionistët, përçan dhe dobëson kampin socialist, dobëson lëvizjen revolucionare të popujve kundër imperializmit, u jep dorë imperialistëve të forcojnë pozitën e tyre në pjesë të ndryshme të botës, që janë kthyer në vatra agresioni kundër vendeve socialiste, si dhe kundër lëvizjeve çlirimtare të popujve të shtypur.

Me gjithë masat e egra dhe miliardat e dollarëve që përdor imperializmi, i ndihmuar nga revizionistët për të shuar lëvizjet revolucionare, antiimperialiste, në përgjithësi lëvizja revolucionare dhe lëvizja komuniste ndërkombëtare shkojnë çdo ditë duke u zgjeruar dhe

duke u forcuar. Dhe s'ka si të ndodhë ndryshe. Kontradiktat e të gjitha llojeve në gjirin e imperializmit ashpërsohen gjithnjë e më tepër. Sot më shumë se kurrë bota e plakur kapitaliste është e mbarsur me revolucionet socialiste dhe luftërat nacionalçlirimtare. Në arenën ndërkombëtare zhvillohet një luftë shumë e ashpër klase. Në pjesën më të madhe të vendeve të shtypura në Azi, Afrikë dhe në Amerikën Latine gjithnjë e më shumë po përhapet flaka e luftërave revolucionare. Edhe në vendet kapitaliste më të zhvilluara lufta e klasës nuk është shuar dhe s'mund të shuhet kurrë, sepse ajo nuk varet as nga vullneti i revizionistëve, as nga ai i borgjezisë imperialiste, atë e shkaktojnë kushtet objektive të shtypjes dhe të shfrytëzimit të njeriut prej njeriut, që nuk mund të zhduken, veçse me përmbysjen e rendit kapitalist dhe vendosjen e rendit socialist. Një farë rritjeje jo e zakonshme e prodhimit në disa vende kapitaliste nuk është veçse një fenomen koniunktural i përkohshëm, sepse nuk ka pasur dhe nuk mund të ketë as tani zhvillim paqësor të përhershëm të kapitalizmit. Sistemi kapitalist botëror është zhytur në krizë të thellë të përgjithshme, prandaj edhe situata e «zhvillimit paqësor» të kapitalizmit në disa vende të botës nuk mund të zgjatë në mënyrë të pakufizuar.

Siç e vuri në dukje Deklarata e Moskës e vitit 1960, asnjë lloj orvatjeje e imperializmit nuk mund të ndalojë ecjen përpara të shoqërisë, likuidimin e sistemit imperialist dhe triumfin e plotë të socializmit në shkallë botërore. Por kjo mund të ndodhë në një kohë më të shpejtë ose në një kohë shumë më të gjatë. Në këtë çështje vendos fakti se sa do të jenë të gatshme dhe të

pregatitura nga çdo anë për të vepruar në situatat revolucionare, që janë bërë tani të pashmangshme, proletariati dhe masat e tjera të shtypura e të shfrytëzuara, se sa do të jenë në gjendje partitë komuniste dhe punëtore të pregatitin në mënyrë të gjithanshme masat për revolucion, t'i bëjnë ato plotësisht të ndërgjegjshme dhe t'i udhëheqin në fitoren e plotë mbi armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm. Asnjë parti e klasës punëtore nuk është në gjendje ta kryejë këtë detyrë, po qe se është molepsur nga sëmundja e rrezikshme e revizionizmit, në qoftë se në krye të saj janë shtruar këmbëkryq udhëheqës revizionistë, në qoftë se nuk ruhet dhe forcohet solidariteti i lëvizjes revolucionare botërore, uniteti i lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe uniteti i kampit socialist në luftë kundër revizionizmit. Përhapja dhe konsolidimi i revizionizmit në lëvizjen komuniste ndërkombëtare jo vetëm i shton jetën imperializmit dhe vonon shumë triumfin e socializmit në vendet e tjera, por rrezikon seriozisht edhe fitoret e arritura nga masat punonjëse në vendet ku ka triumfuar socializmi.

Prandaj sot tingëllon më tepër se çdo herë tjetër aktual dhe konkret përcaktimi që iu bë revizionizmit në Mbledhjen e Moskës më 1957 dhe 1960, si rreziku kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, si dhe detyra për ta luftuar dhe për ta shkatërruar revizionizmin ideologjikisht deri në fund. Lufta për shkatërrimin ideologjik të revizionizmit modern është bërë sot një detyrë historikisht e domosdoshme dhe urgjente.

Revizionizmi jo vetëm i mpin dhe i topit energjitë revolucionare të masave, por edhe gjen terren të përshatshëm për t'u zhvilluar mbi këtë mpirje e topitje.

Këtë fenomen ne e shohim sot në ato vende ku në krye të partive komuniste kanë dalë revizionistët. Kurse marksizëm-leninizmi dhe partitë marksiste-leniniste mbështeten dhe forcohen pikërisht në energjinë revolucionare të masave. Pra, duke luftuar revizionizmin, dhe duke demaskuar bartësit e tij, gjallërohet energjia revolucionare e masave, bëhen ato të ndërgjegjshme dhe mësohen të luftojnë për interesat e tyre, për revolucionin, për pavarësinë e plotë kombëtare, për demokracinë, për socializmin dhe për komunizmin.

Pa luftuar dhe pa demaskuar revizionizmin, nuk mund të luftohet me sukses imperializmi dhe të arrihet fitorja mbi të. V. I. Lenini theksonte vazhdimisht se

*«lufta kundër imperializmit, po të mos lidhet ngushtë me luftën kundër oportunizmit, bëhet një frazë e zbrazët dhe e rreme»<sup>1</sup>.*

Për të luftuar me sukses revizionizmin, që është bërë një rrezik kaq i madh për komunistët dhe masat, duhet të bëhet e qartë kush është konkretisht revizionizmi. Për luftën kundër revizionizmit është i detyruar të thotë ndonjë fjalë, ngandonjëherë, edhe grupi i N. Hrushovit. Sigurisht, për grupin e Hrushovit «lufta kundër revizionizmit» është një gjë abstrakte, pa objekt, është vetëm një frazeologji boshe. Më parë, kur në shtypin ose në fjalimet e udhëheqësve të sotëm sovjetikë përmendej «lufta kundër revizionizmit», ndonjëherë edhe mund të interpretohej se ishte fjala për re-

---

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 22, f. 367.

vizionistët jugosllavë. Por tani, që ndodhemi përpara faktit të kryer të bashkërendimit në të gjitha fushat të politikës së Hrushovit me politikën e Titos, nuk mbetet asnjë dyshim se grupi i Hrushovit jo vetëm nuk lufton kundër asnjë forme revizionizmi, por ka marrë vetë në dorë flamurin e revizionizmit modern.

Në kushtet e sotme të luftës së ashpër klasore ndërmjet komunizmit dhe imperializmit, kur reaksioni imperialist bashkon gjithnjë e më shumë forcat kundër komunizmit, në mënyrë të posaçme është e domosdoshme ruajtja dhe forcimi i unitetit të lëvizjes komuniste dhe të lëvizjes punëtore revolucionare ndërkombëtare. Për çdo marksist-leninist të vërtetë është e qartë se këtë unitet e kanë dëmtuar sot rëndë revizionistët modernë. Një nga synimet kryesore të grupit revizionist të Titos ka qenë gjithnjë përçarja e unitetit të kampit socialist dhe të forcave të komunizmit ndërkombëtar. Por kundër këtij uniteti tani vepron edhe grupi revizionist i Hrushovit me sulmet, komplotet dhe veprimet e tjera nga më të ulëtat dhe kriminale kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe partive të tjera revolucionare marksiste-leniniste, kundër kampit socialist, si dhe kundër gjithë lëvizjes revolucionare botërore.

Ruajtja e unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, si dhe forcimi i mëtejshëm i këtij uniteti kërkojnë që të kundërshtohet me vendosmëri revizionizmi modern, që të luftohet dhe të demaskohet ai me të gjitha format dhe në të gjitha fushat që të ndahen një herë e mirë kufijtë me revizionizmin. Revizionizmi është një plagë që tanimë është hapur në gjirin e lëvizjes komuniste. Kjo plagë duhet

shëruar sa më shpejt, me gjithë dhimbjen e fortë që mund të shkaktonte operacioni i saj.

Sot përsëri është vënë në rendin e ditës, si në kohërat heroike të Marksit e të Leninit, parulla revolucionare që për më tepër se 100 vjet i udhëheq në betejat e ashpra klasore dhe në fitore proletarët dhe të gjitha masat e shtypura e të shfrytëzuara: «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!». Ashtu si kurdoherë, edhe sot bashkimi mund të bëhet vetëm e vetëm mbi themelet e marksizëm-leninizmit revolucionar, vetëm rreth ideve të pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, dhe kurrë rreth revizionistëve dhe ideve të tyre të kalbura.

Revizionistët modernë, edhe kur kanë pozita drejtuese në ndonjë parti, përveç ndonjë shtrese të privilegjuarish që kanë krijuar si mbështetje për veprimet e tyre antimarksiste, nuk kanë me vete kryesoren, masën e komunistëve, s'kanë me vete proletarët dhe fshatarësinë revolucionare, megjithëse revizionistët e kanë bërë zakon t'u referohen «masave» sa herë që duan t'i reklamojnë si të mbaruara teoritë dhe veprimtarinë e tyre antikomuniste. Masa e komunistëve dhe e punonjësve po e kupton gjithnjë e më mirë se po luhet një tradhti e madhe në kurriz të tyre dhe të marksizëm-leninizmit dhe se revizionistët janë renegatë të komunizmit dhe të pandreqshëm. Pikërisht këtyre masave në këto çaste historike u bie barra e madhe për të thënë fjalën e tyre, për t'u treguar vendin dhe sa më shpejt revizionizmit dhe revizionistëve, sepse revolucionin dhe kundërrevolucionin, marksizmin dhe antimarksizmin, ideologjinë proletare dhe ideologjinë borgjeze, pjellë e së

cilës është edhe revizionizmi, nuk mund të bashkëjetojnë gjatë as në kuadrin e një partie, as në kuadrin e gjithë lëvizjes.

Përveç kësaj, ata komunistë që notojnë në batakun e N. Hrushovit dhe tani kanë mundësi të shikojnë kush më pak e kush më shumë tradhtinë e ngritur ndaj marksizëm-leninizmit, është koha që të gjejnë forcën dhe guximin t'i thonë ndal vetes dhe të shkëputen nga revizionistët. Ata ndodhen përpara alternativës: ose të hidhen në humnerë ku po i çon grupi i Hrushovit, ose të reagojnë me guxim dhe me vendosmëri, të bashkohen me masën e partisë, të mbështeten fort në masat punonjëse dhe t'u japin grusht për vdekje revizionistëve. Vetëm në këtë mënyrë ndihmohet partia, vendi, socializmi, komunizmi, paqja.

Nuk është hera e parë që lëvizja punëtore dhe komuniste ndodhet përpara një tradhtie të madhe, siç është tradhtia e revizionistëve modernë. Historia e luftës së proletariatit botëror e ka vërtetuar disa herë se në çastet e rënda të krizës së përgjithshme të kapitalizmit, oportunizmi, si pjellë dhe agjenturë e borgjezisë, është vënë në veprim, është gjallëruar dhe është përpjekur t'i zërë për gryke partitë e klasës punëtore, duke ndihmuar në këtë mënyrë borgjezinë ndërkombëtare imperialiste në luftën e përpjekjet për vendosjen e sundimit botëror dhe për shtypjen e lëvizjeve revolucionare të masave. Tanimë njihet mirë nga të gjithë tradhtia e Internacionales II dhe dështimi i saj, tradhtia e Kautskit, Plehanovit, Trockit dhe dështimi i tyre, tradhtia e Zinovievit, Kamenievit, Buharinut dhe disfata e tyre. Marksistë-leninistët e vërtetë, në çastet vendimtare të



rrezikut oportunist, kanë vepruar me vendosmëri, janë ngritur me guxim dhe kanë bërë një luftë të papaj-tueshme dhe parimore shumë të ashpër kundër armiqve të marksizem-leninizmit. Lenini dhe shokët e tij bolshevikë, edhe pse janë ndodhur përmes zjarreve që vinin nga shumë anë, nga ana e autokracisë së egër cariste dhe më pas e diktaturës borgjeze të Kerenskit, nga ana e borgjezisë imperialiste ndërkombëtare dhe nga ana e krerëve tradhtarë të Internacionales II, kurrë nuk janë trembur, por me kurajë kanë mbrojtur pari-met e marksizem-leninizmit, kanë ndarë kufijtë me menshevikët, trockistët e të tjerë, për t'u bashkuar edhe më fort rreth ideve të marksizem-leninizmit. Dihet shumë mirë se si vepruan bolshevikët, me Leninin në krye, kur panë se çdo shpresë për të ndrequr menshevikët ishte e kotë dhe se qëndrimi i mëtejshëm me ta në një parti të vetme ishte i dëmshëm dhe i pamundshëm. Vetëm duke u dhënë dërmën përfundimisht menshevikëve më 1912, u vendos uniteti i vërtetë në Partinë Bolshevike, dhe vetëm në këtë mënyrë ajo mundi të bëhej një parti revolucionare, pararojë për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Më 1917, në përgjigje të atyre që vazhdonin të kërkonin bashkimin e gjithë socialdemokratëve rusë, Lenini shkruante se as që mund të bëhet fjalë për bashkimin e socialdemokratëve në Rusi.

*«Është më mirë të mbetesh dy vetë, si Libk-  
nehti, dhe kjo do të thotë të qëndrosh me pro-  
letariatën revolucionar, sesa të pranosh qoftë:  
edhe për një çast idenë e bashkimit me partinë»*

*e Komitetit të Organizimit [menshevikët], me Çheixen dhe me Ceretelin...»<sup>1</sup>.*

Marksizëm-leninizmi ka dalë gjithnjë ngadhënjimtar në luftën kundër kapitalizmit dhe kundër oportunitizmit në radhë të parë, sepse marksistë-leninistët kurdoherë i kanë ndarë kufijtë me tradhtarët e proletariatit, sepse me komunistët revolucionarë ka qenë klasa punëtore, kanë qenë të gjitha masat e shtypura dhe të shfrytëzuara nga imperializmi ndërkombëtar dhe borjezia vendëse.

Procesi i demaskimit, i izolimit dhe i shkatërrimit ideologjik të revizionizmit modern, si një sëmundje shumë e rrezikshme në gjirin e komunizmit ndërkombëtar, tanimë ka filluar dhe përparon me hapa të shpejta. Ky është një proces dialektik që s'e ndal dot asgjë. Atë nuk mund ta ndalë demagogjia që përdor grupi i N. Hrushovit, nuk mund ta ndalë për një kohë të gjatë pas N. Hrushovi e pasuesit e tij, të cilët abuzojnë me autoritetin e Partisë së madhe të Leninit. Autoriteti i madh i Bashkimit Sovjetik dhe i Partisë Komuniste të Leninit, nuk mund të konsiderohet si pronë e disave, e aq më pak e një grupi renegatësh e revizionistësh, siç është grupi i N. Hrushovit. Autoritetin e Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Leninit e ruajnë dhe e mbrojnë jo me fjalë, por me vepra ata që ndjekin me konsekuencë rrugën e Leninit, mësimet e tij fitimtare, e mbrojnë partitë motra që luftojnë për pastërtinë e marksizëm-leninizmit, e mbron Partia e Punës e Shqi-

---

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 24, f. 73.

përisë, bolshevikët e vetë Partisë së Leninit, besnikë të rrugës së tij revolucionare, e ruajnë komunistët e revolucionarët e të gjithë botës. Duke luftuar revizionizmin modern, në të njëjtën kohë ata shprehin dashurinë dhe respektin e tyre për atdheun e Revolucionit të Tetorit, për Partinë dhe idetë e Leninit të madh, që një grup revizionistësh po i njollos.

Krijimi i frontit të përbashkët të revizionistëve Hrushov-Tito, bashkëpunimi i tyre, mprehja e përbashkët e armëve, e thellon dhe e shpejton procesin e shkatërrimit politik e ideologjik të revizionizmit modern, sepse në veprimtarinë e tyre të hapur, të koordinuar, partitë komuniste, lëvizja komuniste ndërkombëtare, klasa punëtore, shikojnë çdo ditë e më qartë rrezikun e madh që i kërcënohet sot unitetit të kampit socialist, unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, unitetit të forcave përparimtare e paqedashëse në përgjithësi. Prandaj, me bindje të plotë në energjinë e pashtershme revolucionare të marksizem-leninizmit, mund të themi se s'ka forcë në botë që të ndalë marshimin triumfal të ideve të tij gjithmonë ngadhënjimtare!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 245 (4403), 13 tetor 1962*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TE MARRIM ME SHUME RENDIMENT NE PRODHIMIN E DRITHËRAVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

19 tetor 1962

Jam dakord me raportin që na është paraqitur, i cili është mjaft i studjuar dhe do të na shërbejë. Unë i bëra disa sugjerime shokut Hysni [Kapo], të cilat janë pasqyruar në këtë raport. Ku ishte qëllimi im?

Vetë subjekti i Plenumit është zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë, intensifikimi i saj në bazë të direktivave që caktoi Kongresi i 4-t. Detyra jonë është jo vetëm ta realizojmë planin në sektorin e bujqësisë, por edhe ta tejkalojmë. Pikërisht këtej rrjedhin edhe masat që duhet të marrim jo vetëm për realizimin, por të hedhim edhe baza të shëndosha për intensifikimin e bujqësisë.

---

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti që do t'i paraqitej Plenumit të KQ të PPSH «Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë për synimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor».

qësisë, për të shtuar prodhimet në të njëjtën sipërfaqe toke.

Cilat janë disa nga këto masa? Përveç masave për hartimin e planit, në këtë raport ne japim edhe disa orientime më të përcaktuara deri edhe në çështjet e kodit agroteknik. Po të punojmë si duhet për zbatimin e këtyre masave agroteknike, atëherë prodhimi do të shtohet. Prandaj, pa lëvizur planin e caktuar, të japim shifrat që do të jenë orientuese për të gjithë bujqësinë në Shqipëri, veçanërisht për disa rrethe dhe të luftohet për arritjen e tyre.

Shokët që kanë punuar për këtë raport, kanë vënë edhe shifra se ku duhet të arrijmë. Për një gjë të tillë unë nuk kam kundërshtim. Mundet edhe të gaboj, por është mirë të mos e angazhojmë Plenumin që të aprovojë shifra. Më mirë është që rretheve, ku prodhohen më shumë drithëra buke, t'u caktojmë detyra të veçanta, t'u japim edhe ndihma, pastaj të kërkojmë realizimin e detyrave nga ana e tyre. Pra, të investojmë më shumë në ato rrethe ku prodhohen drithërat e bukës si dhe bimët industriale pambuku, duhani etj., të shtojmë ndihmën dhe të ndjekim arritjen e rezultateve.

Kooperativat bujqësore dhe ndërmarrjet bujqësore të marrin masa të tilla që të arrijnë rendimentet e planifikuar. Këto rendimente duhet të jenë të bazuara edhe në eksperiencën e përparuar. Në rrethin e Fierit, për shembull, ka disa kooperativa që marrin rendimente të larta. Mund të marrim si shembull kurdoherë dy kooperativa bujqësore me kushte të njëjlojta, por me rezultate të ndryshme për shkak se në njërin ka organizim më të dobët, kujdes më të paktë, shfrytëzim jo

të mirë të mjeteve të punës etj. Duke parë rezultatet e kooperativave bujqësore të një rrethi, ne caktojmë një shifër natyrisht josentimentale, por orientuese e mobilizuese, që t'i japë mundësi rrethit të luftojë për të arritur objektiva më të lartë se ata të një viti më parë. Të mos harrojmë se shifrat orientuese që jepen, mbase nuk arrihen, por puna është se ato sqarojnë, mobilizojnë. Në qoftë se, për shembull, kooperativa bujqësore e Zharrëzës në rrethin e Fierit merr rendimente të mira, duhet që të njëjtat rendimente të luftojnë për t'i arritur edhe ato kooperativa që kanë kushte të njëjta me të. Kështu do të arrijmë të krijojmë një situatë më të mirë për prodhimin e mëtejshëm të drithit që do të planifikojmë në pesëvjeçarin tjetër, ose në një plan më me perspektivë.

Duke qenë se këtë plan e bëjmë pas dy vjetësh, mendoj që rretheve kryesore ku mbillen më shumë drithëra, bimë industriale etj., t'ua caktojmë detyrat që tani. Natyrisht, këto detyra mund të mos vihen në plan, kjo të bëhet fill pas aprovimit të planit nga Qeveria. Në këtë mënyrë Ministria e Bujqësisë së bashku me rrethet bëjnë një përgatitje më të mirë, më konkrete, shteti mund t'u japë disa ndihma të tjera suplementare për të prodhuar më shumë nga sa është parashikuar drithëra, pambuk, duhan, panxhar etj.

Organet e Partisë e të pushtetit në rrethin e Lushnjës, të Fierit etj., duhet ta kuptojnë se nuk është e drejtë kur e krahasojnë veten me ato rrethe ku nuk janë bërë investime të mëdha. Nuk është e pranueshme që, ta zëmë, Peshkopia, ku nuk janë bërë investime në bujqësi, të marrë rendimente aq të larta, kurse rrethet

ku janë bërë investime të qëndrojnë më poshtë. Prandaj, atje ku janë bërë investime të mëdha, duhen arritur medoemos më shumë rezultate. Kjo frymë të karakterizojë edhe diskutimet që do të bëjnë shokët në Plenumin e Komitetit Qendror.

Çështjet në raport janë shtruar mirë, prandaj nuk e quaj të nevojshme të futemi thellë në të gjitha hollësitë e kodit agroteknik. Ne të japim orientimet kryesore, pastaj specialistët e bujqësisë jo vetëm të japin udhëzime e këshilla, por të nxjerrin edhe rregulla agroteknike për çdo kulturë sipas sezoneve.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## FUTBOLLI TË MOS SHIHET ME SYRIN E REPARTIT, POR NËN PRIZMIN E INTERESIT TË PËRGJITHSIËM

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 tetor 1962

Skuadrat e futbollit të ushtrisë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë të drejtë në bazë të rregullores të mbajnë 11 lojtarë, të cilët i aprovon federata përkatëse. Kur një lojtar i skuadrës ushtarake kryen kohën e shërbimit, ai duhet të largohet. Për asnjë nuk duhet të veprohet në kundërshtim me vendimet tona dhe të Federatës së Futbollit. Prandaj çdo gjë të bëhet brenda rregullave të vendosura. Në qoftë se këto shkelen, atëherë të merren masa. Nëse futbollisti, për të cilin bëhet fjalë, dëshiron të punojë, për shembull, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, le të qëndrojë, natyrisht po të aprovohet një gjë e tillë, po për të luaj-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi zhvillimin e mëtejshëm të fizkulturës dhe të sportit.



tur, duhet të zbatohet rregullorja që ka vënë federata. Ai që kryen shërbimin ushtarak, kthehet në rrethin ku ka qenë. Në qoftë se një futbollist, nuk do të luajë me skuadrën që caktohet, atëherë, në marrëveshje midis dy klubeve dhe me aprovim të Federatës së Futbollit, ai mund të inkuadrohet në tjetër skuadër. Unë jam dakord që gjithçka të bëhet në bazë të vendimeve. Nga të gjithë të punohet që për këto çështje të rrënjoset një frymë e shëndoshë.

Edhe thirrja nën armë e lojtarëve të bëhet sipas rregullave, në afatet e parashikuara me ligj. Ne nuk kemi marrë asnjë vendim që sportistët të mos thirren nën armë, si të gjithë edhe ata nuk përjashtohen nga shërbimi ushtarak. Prandaj, kur vjen koha, të mobilizohen në ushtri dhe të kryejnë detyrën. Por edhe më shumë nga sa parashikon ligji i shërbimit ushtarak të mos mbahen.

Që të krijohet skuadra kombëtare e futbollit, federata duhet t'i shkëputë lojtarët nga skuadrat që luajnë për të bërë stërvitje të paktën 4-5 muaj përpara ndeshjes. Nga kjo të përfitojnë e të kualifikohen edhe lojtarët e skuadrave të ndryshme, sepse lojtarët më të mirë pas ndeshjes ndërkombëtare do të shpërndahen në skuadrat e tyre dhe do të ndihmojnë për ngritjen e cilësisë së futbollit.

Futbolli të mos shikohet me sy reparti, po nën prizmin e interesit të zhvillimit në përgjithësi të sportit në të gjithë vendin. Nuk është mirë që një skuadër të mbajë të gjitha «yjet» e futbollit, ndërsa të tjerave t'u lihen lojtarë të paaftë. Shokët ushtarakë kanë më shu-

më mundësi si për të zgjedhur elementin, ashtu edhe për stërvitjen e tij. Fizkultura në ushtri bëhet në mënyrë më të organizuar.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## TË HEQIM DORË NGA FORMULAT DHE TË JEMI MË KONKRETË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 tetor 1962

Çështja e metodës së punës në organet lokale të pushtetit duhet të na preokupojë. Lidhur me këtë doja të thosha disa vërejtje që u përkasin shokëve të drejtorisë së organeve të Partisë, Rinisë e Bashkimeve Profesionale.

Në seminarin që u organizua në Durrës shkuan edhe shokë përgjegjës dhe diskutuan për shumë probleme. Edhe këtu ne dëgjuam diskutime të mira dhe vërejtje të rëndësishme. Por e them me keqardhje se në raportin dhe në projektvendimin që na është paraqitur, nuk janë shënuar këto probleme kryesore që preokupojnë Partinë dhe pushtetin në bazë, por janë përsëritur formulat e zakonshme.

---

1 Në këtë mbledhje u zhvilluan diskutime rreth raportit të paraqitur nga një ekip i Komitetit Qendror të Partisë «Mbi metodën e punës në organet lokale të pushtetit».

Unë nuk jam dakord me të tilla formula, do të ishte më mirë që në këtë raport të figuronin 3-4 probleme më kyç, që u ngritën në seminar dhe që na preokupojnë më shumë. Edhe organet qendrore kanë shumë çështje, po këtu duhet të flitej për ato më me rëndësi dhe jo të hynim edhe në çështjet e vogla. Pikërisht këtë t'ua shpjegojmë mirë njerëzve. Unë jam kundër formulave stereotipe, prandaj të ndërtohet më drejt metoda e paraqitjes së materialeve dhe të mos thuhet gjërat njësoj, siç janë thënë ose siç mund të thuhet përsëri edhe pas disa vjetësh. Po të mbahej parasysh kjo, atëherë në projektvendimin që na është paraqitur nuk do të thuheshin gjëra të përgjithshme, që mund t'i gjesh në çdo kohë.

Mua më duket se në materialin e paraqitur nuk dalin me mprehtësinë e duhur problemet kryesore dhe të jepen udhëzime të mira për komitetet e Partisë e për komitetet ekzekutive. Sekretariatit të Komitetit Qendror duhet t'i paraqiteshin konkluzionet e gjithë punës së seminarit dhe të propozimeve që u bënë atje.

Në diskutimet që u zhvilluan këtu, u ngritën disa probleme kyç, që na kanë preokupuar shumë, të cilat duhet të trajtoheshin patjetër në projektvendim. Për shembull, çështja e spostimit të organeve të pushtetit duhet të vihet po jo në mënyrë formale. Nga e gjithë ajo eksperiencë që u paraqit në seminar dhe sa u tha në këtë mbledhje, vihet pyetja: përse t'i marrë në studim komiteti i Partisë të gjitha ato çështje që shqyrton edhe komiteti ekzekutiv?

Në këtë drejtim ne kemi eksperiencën e madhe të

Byrosë Politike të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë. Ne kurrë nuk jemi gërshtuar në këto çështje dhe t'i hanim «bukën» njëri-tjetrit, Byroja Politike Qeverisë ose Qeveria Byrosë Politike. Këtej duhet të nxirren mësimë dhe eksperiencë edhe për komitetet ekzekutive dhe për bazën. Në komitetet ekzekutive tani ka plot kuadro të aftë, ata kanë përgjegjësi për zbatimin në praktikë të vijës së Partisë, ata kanë kompetencat e tyre. Byrotë dhe komitetet e Partisë të rretheve duhet të ndjekin një metodë pune si ajo që ndjek Byroja Politike e Komitetit Qendror, e cila merr në shqyrtim çështjet kryesore. Pastaj Byroja Politike jo vetëm që merr vetë në studim probleme të ndryshme, po për shumë probleme ngarkon edhe Qeverinë, edhe Komisionin e Planit. Bile ka probleme që Byroja Politike, pasi i merr në shqyrtim, bën vërejtje dhe ngarkon Qeverinë që ndonjë prej tyre ta shikojë edhe një herë, ta kontrollojë nga të gjitha anët për t'ia sjellë për aprovim definitiv përsëri Byrosë Politike. Natyrisht për çështje parimore të rëndësishme iniciativën duhet ta marrë Byroja Politike. Disa çështje që janë në kompetencën e Qeverisë i merr kjo në shqyrtim, po, kur ndonjë ka rëndësi të madhe, për atë vendos Byroja Politike, pasi Qeveria të ketë bërë studimin. Byroja Politike shqyrton problemet vendimtare, parimore që duhet të zbatojë Partia.

Përsa i përket kontrollit të zbatimit të vendimeve, këtë detyrë e ka edhe Qeveria dhe kjo është një detyrë e vazhdueshme e saj. Qeveria ndjek zbatimin e vendimeve të saj dhe të Byrosë Politike. Partia kontrollon zbatimin e vendimeve, po ajo ka edhe një funksion tje-

tër, funksion edukues dhe mobilizues për zbatimin e vendimeve të saj dhe të Qeverisë.

Çështja e studimit të problemeve ka mjaft rëndësi. Në përgjithësi kjo metodë pune është kuptuar, por në praktikë është lënë pas dore. Nuk është nevoja që të studjohen të tëra çështjet, por fjala është për ato që janë më të rëndësishme. Një nga këto çështje është, për shembull, formalizmi në mbledhjet e organeve të pushtetit. Kjo është një çështje e rëndësishme partie. Diskutimet e bëra në organet lokale të pushtetit kanë rëndësinë e tyre për përmirësimin e punës, po më e rëndësishme është që njerëzit të mobilizohen dhe t'i kryejnë ato, të zbatojnë vendimet që merren. Me këtë masë t'i vlerësojmë ne mbledhjet dhe diskutimet dhe jo të shihet ana formale, u bë mbledhja apo jo, a u bë një herë në muaj apo në dy muaj një herë. Me këtë rast, doja të thosha se më duket që mbledhja e këshillit popullor nuk duhet bërë një herë në muaj, sepse është shumë, prandaj do të ishte më mirë që këto mbledhje të zhvillohen një herë në dy ose në tre muaj, në mënyrë që të mos bëhen formale, por të caktojnë detyra për zbatimin e të cilave të jepet llogari në mbledhjen e ardhshme.

Ne themi vazhdimisht që të rritet përgjegjësia e këshillave popullore të fshatrave, po si do të rritet përgjegjësia e kryetarit të këshillit popullor të fshatit, pikërisht kjo nuk zërthehet. Për këtë u bënë këtu disa propozime të mira, që mendoj të vihen në vendim, ku të theksohet mirë që kryetari i këshillit popullor të fshatit të mos jetë i varur nga kryetari i kooperativës bujqësore. Kur ta thuash kështu këtë çështje, ngrihet

vërtet përgjegjësia e kryetarit të këshillit popullor, ndryshe ai do të mbetet përsëri siç është. Po të mos i konkretizojmë çështjet, jam i sigurt se dikush do të na thotë: «I dimë këto gjëra, sa herë na janë përsëritur». Prandaj të bëhen më shumë përpjekje që vendimet të jenë konkrete e të ndihmojnë për të çuar punën përpara. Drejtorja e organeve dhe drejtoritë e tjera të aparatit duhet të heqin dorë nga formulat dhe të jenë më konkrete në punë e në formulime të dokumenteve.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## DISA MENDIME PËR SHFRYTËZIMIN E LITERATURËS TEKNIKO-SHKENCORE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 tetor 1962

Është e domosdoshme që njerëzit t'i futim si duhet në rrugën e studimit. Kjo ka rëndësi. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë, atëherë bibliotekat që kemi ngritur e pajisur, kujt do t'i shërbejnë? Studimi i literaturës tekniko-shkencore ka një rëndësi të madhe. Njerëzit tanë duhet ta ndiejnë nevojën për të mësuar. Po arritën ta ndiejnë këtë nevojë, ata vetë do të kërkojnë libra, do të shkojnë për t'i gjetur ata në universitet, në biblioteka etj., sepse u është ngjallur dëshirë për lexim. Kjo, pra, duhet të jetë kryesorja e kryesoreve.

Çështja e dytë është ajo e mësimin të gjuhëve të huaja. Ne kemi pak libra tekniko-shkencorë në gjuhën tonë, sepse shteti ynë kaq mundësi ka, prandaj njerëzit

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi gjendjen dhe masat për një shfrytëzim më të mirë të literaturës tekniko-shkencore.



tanë duhet të mësojnë gjuhë të huaja. Në qoftë se djali ose vajza ka kryer shkollën e mesme dhe nuk ka mësuar, atëherë duhet ta vazhdojë punën me këmbëngulje, sepse gjuha e huaj mësohet duke lexuar. Ndryshe fol sa të duash për leximin e librave tekniko-shkencorë në gjuhë të huaja, po nuk dite ndonjë gjuhë, si mund t'i shfrytëzosh ata? Njerëzit tanë, pra, duhet t'i vihen punës dhe të mësojnë gjuhë të huaja.

Çështja e tretë është në lidhje me shërbimin e bibliotekave tona, në të cilat duhen bërë katalogët e përmbajtjes së librave që disponojnë, gjë që kërkon punë, sepse për çdo libër do bërë edhe nga një faqe ose ndonjë paragraf me përmbledhje rreth përmbajtjes së tij. Aq më vështirë është kjo të bëhet kur njerëzit s'dinë gjuhë të huaja. Në këtë kuadër ka shumë rëndësi propagandimi i librit. Një njeri që lexon një libër, kur e mbaron, takohet me 3-4 shokë dhe ua bën të ditur përmbajtjen e tij. Kjo është një mënyrë si ta propagandojmë librin.

Përse lexohen më shumë libra artistikë? Një nga arsyet është se për ta bëhet një propagandë më e gjerë, me radio, me shtyp, me gojë nga ata që lexojnë etj., dhe kështu të tjerët interesohen, gjejnë ose blejnë dhe lexojnë libra artistikë. Edhe për literaturën tekniko-shkencore mund të bëhet më shumë se deri tani, prandaj t'i nxitim djemtë dhe vajzat e reja të mësojnë, të përvetësojnë shkencën dhe teknikën.

Njerëzit tanë janë përpjekur të përhapin diturinë në kohë jashtëzakonisht të vështira, nën pushtimin turk e jo më tani që populli është vetë në fuqi. Prandaj disa aktivistëve që lexojnë, t'u vihet detyrë që të shkru-

ajnë mbi përmbajtjen e librit dhe t'ia japin këtë bibliotekës. Në këtë mënyrë do të bëhet një punë më e gjerë për propagandimin dhe për shfrytëzimin e librit. Natyrisht një gjë të tillë nuk kanë mundësi ta bëjnë të gjithë ata që janë ngarkuar me administrimin e librave, sepse disa s'kanë arsimin e duhur, disa s'kanë praktikë. Këta, edhe sikur t'i viheshin leximit, do të mund të lexonin një libër në muaj, kurse libri kërkon propagandim të shpejtë, pra bibliotekës i kërkohet shërbim.

Një çështje tjetër është ajo e porosisë së librave me karakter tekniko-shkencor në gjuhë të huaja. Natyrisht këtë gjë ne s'mund t'ia lëmë spontaneitetit. Zgjedhja e këtyre librave duhet bërë me kujdes dhe në bazë të kritereve të caktuara. Vetëm njerëzit që kanë praktikën e studimit të librave mund të bëjnë një gjë të pastër në këtë drejtim, ata mund të porositin ata libra që na duhen. Këtu unë përjashtoj ata njerëz që lexojnë libra dhe janë të shkëputur nga jeta e vendit. Njerëz të tillë mund të bëjnë gabime shumë të mëdha. Ata mund të jenë njerëz të zotë, studjozë, po mund të porositin libra shumë të rëndë, që nuk u shërbejnë kuadrove tanë. Librat që rekomandojnë ata, mund të kenë tituj të mëdhenj dhe përmbajtje shumë të thellë, po të tillë libra te ne do të qëndrojnë në biblioteka për të zbukuruar vitrinat dhe nuk do të shfrytëzohen, sepse nuk do t'i tërheqë njeri. Po të sillen, për shembull, libra të rëndë të teorisë së atomit etj., tani për tani këta te ne mund t'i kuptojnë vetëm pak njerëz. Tjetri tani kërkon gjëra më të thjeshta. Ne duam që njerëzit tanë të rritin shkallë-shkallë njohuritë e tyre shkencore e teknike. Kështu, gradualisht, ata do të arrijnë të kup-

tojnë edhe librat me përmbajtje të lartë. Prandaj porosinë për libra t'i bëjmë me kriter, jo me një të parë të titullit të tyre. Në qoftë se porosia do të bëhet qorrazi, vetëm disa prej tyre mund të jenë me vlerë për t'u lexuar.

Tani për tani neve na duhen më shumë libra të shkencave teknike për masa të gjera, sepse për të tillë kanë më shumë nevojë kuadrot tanë. Libra të tillë janë më të kuptueshëm për studentët dhe për nxënësit e shkollave të mesme. Pra kemi nevojë për libra të thjeshtë, por që sigurisht të jenë pak më të komplikuar nga manualët e shkollave. Natyrisht mund të zgjedhim dhe libra të një shkalle më të lartë, të cilët mund t'u shërbejnë njerëzve që kanë një praktikë dhe eksperiencë studimi. Ka gjithashtu edhe libra shumë të thellë. Detyrën për të porositur libra sipas këtyre kritereve nuk mund ta kryejnë njerëz që nuk njohin gjendjen aktuale të vendit tonë, që nuk dinë nevojat e punonjësve tanë të çdo sektori, stadin e kulturës së tyre. Kjo është një detyrë e vështirë, të cilën më mirë se kushdo mund ta bëjnë, për shembull, pedagogët e universitetit. Ndryshe do të bëjmë porosi pa perspektivë, shumë herë të kota, të shpejtuara, dhe, si pasojë, do të studjohen fare pak libra me vlerë për ne. Pra në radhë të parë këtë punë ta bëjë universiteti, po si e qysh kjo duhet menduar në bazë të orientimeve të Partisë. Këtu nuk është çështja e shpenzimeve, kryesorja është të sillen librat që na duhen.

Detyrë tjetër është që të vëmë rregull për shfrytëzimin e librit tekniko-shkencor nëpër ministritë.

Unë them se gjersa dikasteret nuk kërkojnë libra

tekniko-shkencorë, kjo do të thotë se ato nuk kujdesen sa duhet për ta. Prandaj mendoj se duhet parë çështja e bibliotekave të tyre, sepse jo vetëm që ato s'kërkojnë libra të tillë, por nuk shfrytëzojnë edhe ata që kanë. Kuptohet se po të interesohen për libra, dikasteret do të organizonin edhe shfrytëzimin e tyre. Siç duket, shoqët e dikastereve merren me shkresurina ose largohen me shërbim nga një vend në tjetrin dhe nuk merren me studime, pra libri nuk i preokupon. Në parim ministritë duhet të kenë libra, por kjo do parë në praktikë, sepse, me sa duket, askush nuk i lexon ata dhe bibliotekat e tyre janë formale.

Çështjen e botimeve tona shkencore duhet ta shikojmë lidhur me mundësitë që kemi, sa jemi në gjendje ta bëjmë një gjë të tillë. Nuk duhet të botojmë vetëm sa për të kaluar radhën një revistë tekniko-shkencore të rinisë. Nëse ne do të botojmë një revistë shkencore të tillë, këtë ta bëjmë duke u nisur nga fakti i plotësimit të nevojave që kanë kuadrot tanë për materiale të përkthyer që nuk mund të sigurohen me librat që disponojmë në gjuhë të huaja. Sigurisht kjo punë duhet bërë me plan. Pra të përkthehen ato materiale që na duhen ose të bëhen shkrime mbi probleme të kohës që duhet të zgjidhim.

Duhet thënë se shkrimet me karakter shkencor te ne kanë marrë një rrugë të mirë, megjithatë në to ka plot ujë. Prandaj, në qoftë se nxjerrim një revistë shkencore, këtë ta bëjmë me synime të caktuara e me plan dhe jo kur të afrojnë afati që ajo të dalë në qarkullim t'i thuash tjetrit dy ditë përpara për të bërë një artikull. Kjo punë të bëhet e menduar mirë dhe shumë

kohë përpara, duke i rekomanduar artikullshkruesit edhe bibliografinë. Kështu duhet punuar në qoftë se duam të nxjerrim një revistë serioze, e cila të plotësojë boshllëqet që kemi. Kjo realizohet duke punuar e duke luftuar me këmbëngulje.

Ne mund të bëjmë një kritikë që është me vend për kuadrot kryesorë, sepse ata nuk lexojnë sa duhet, nuk i vihen me ngulm çështjes së studimit, nuk e kuptojnë mirë rëndësinë e tij, që do t'i ndihmojë në punën e tyre praktike, do t'i lehtësojë nga një punë shumë e lodhshme, do t'i ndihmojë ata për të bërë leksione të mira e për të dhënë këshilla më të frytshme. Po të studjojnë sistematikisht kuadrot tanë kryesorë, do të bëhen instruktorë të një niveli të lartë për kuadrot e tjerë me të cilët bashkëpunojnë. Duke marrë parasysh kushtet tona aktuale, studimi i literaturës tekniko-shkencore është një problem shumë serioz. Por të mos mendojmë se kjo është një punë kaq e lehtë. Edhe ata që kanë praktikën e studimit dhe vazhdimisht lexojnë, ka periudha që e lënë ose e ngadalësojnë studimin. Kjo varet nga punët që kanë njerëzit tanë, nga predispozicioni i tyre, nga gjendja shëndetësore etj. Por sidoqoftë duhet punuar vazhdimisht që njerëzve t'u ngjallet dëshira për studim, t'u forcohet vullneti, t'u shtohet interesimi, të kenë një farë plani dhe të studjojnë me sistem.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**PUNA IDEOPOLITIKE NË USHTRI DO TË BËJE  
QË AJO TË JETË KURDOHERË NË GATISHMËRI  
EDHE NGA ANA USHTARAKE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**22 tetor 1962**

Ju, shokë të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, të keni mirë parasysh rëndësinë e punës politike dhe ideologjike, sepse kjo do të bëjë që ushtria jonë të jetë kurdoherë në gatishmëri nga ana ushtarake për të zbatuar të gjitha vendimet e Partisë dhe urdhrat e komandës. Është e drejtë, siç tha edhe shoku Ramiz [Alia], që në ushtri duhen bërë përpjekje për të zbatuar programet e punës ideopolitike, duke luftuar kundër shabllonizmit e formalizmit. Kjo do të thotë që puna ideopolitike të ketë karakter aktual, të mos bëhet sa për t'u bërë, të jetë një punë e gjallë dhe me rezultate që ushtaraku të jetojë me situatën etj. Për një punë të tillë ideopolitike kemi nevojë ne në ushtri dhe në terren.

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi gjendjen e punës ideopolitike e kulturore në ushtri.

Repartet e ushtrisë janë pak a shumë të shkëputura nga lufta që zhvillohet në terren për realizimin e detyrave ekonomike dhe kundër armiqve të përditshëm. Në ushtri puna është ndryshe, atje kemi gjithçka që duhet, edhe parullat armiqësore janë më të pakta. Këto veçori dhe avantazhe të punës në ushtri mund të çojnë në një farë shabllonizmi dhe rehatie, duke bërë që puna politike të kufizohet vetëm brenda programit. Prandaj vënia në dijeni e reparteve ushtarake për luftën që zhvillohet në terren, mpreh më shumë vigjilencën e anëtarëve të Partisë dhe të të gjithë efektivit. Kjo kërkon që kuadrot, të cilët merren me punë politike, të jenë të informuar mirë për të gjitha çështjet politike dhe ideologjike që ngre Partia dhe të zhvillojnë një punë të gjallë e konkrete me të gjithë ushtrinë.

Në repart, kur zhvillohet puna politike, mund të drejtohen edhe pyetje, si për shembull: Mos jemi ne, shqiptarët, të izoluar? Kini parasysh që pyetje të tilla e të tjera të mos i merrni sikur bëhen me qëllim armiqësor. Po të jetë një ushtar në pozita armiqësore, nuk e bën fare pyetjen. Prandaj, kur bëhen pyetje, të dilet me konkluzionin që në disa njerëz ka paqartësi, sepse nuk janë të gjithë të ngritur politikisht dhe ideologjikisht. Duke u nisur nga ky mendim, do të jepen përgjigje të drejta dhe askujt nuk do t'i mbyllet goja për të pyetur. Kështu pyetjes «a jemi ne të izoluar?», do t'i përgjigjemi: «Jo, ne nuk jemi të izoluar, të izoluar janë revizionistët, dhe çdo ditë që kalon ata izoloohen më tepër». Dhe këto t'u thuhën me fakte e jo vetëm me fjalë. Kjo do të krijojë te secili bindje të plotë e të thella për të drejtën, e cila është kurdoherë me ne.

Përveç punës politike sqaruese që zhvillohet në repartet dhe në organet ushtarake, është e domosdoshme të ndiqet edhe zbatimi me rreptësi i rregulloreve të ushtrisë, të kufirit, të policisë etj. E them këtë për shkak se në brezin kufitar disa herë nuk janë zbatuar rregullat. Sipas rregullores, edhe gjeneral të jetë tjetri, po erdhi me shërbim në kufi duhet t'i nënshtrohet rregullores së postës përkatëse kufitare, sepse efektiv i postës është përgjegjës për sektorin e vet. Ushtarët që kryejnë shërbimin në kufi ose në çdo vend, kanë të drejtë të kërkojnë nga cilido zbatimin e një rregulli të caktuar. Edhe ata që venë me shërbim në brezin kufitar janë besnikë, po kufirin janë ngarkuar ta ruajnë kufitarët, të cilët duhet të kërkojnë që rregullorja të zbatohet me përpikëri. Prandaj të punohet me efektivin që rregulloret të kuptohen politikisht, ndryshe dëmtohet puna. Kështu, duke ua bërë ushtarëve të qartë politikisht rëndësinë e zbatimit të rregullores, këta nuk do të flenë, por do ta kryejnë mirë detyrën. Në këto çështje nuk duhet të ketë familjaritet.

Sekretet ushtarake duhet të ruhen me rreptësinë më të madhe, sepse armiku përpiqet të marrë çdo gjë nga ne dhe të na dëmtojë. Kini parasysh se vendi ynë është i vogël. Në qoftë se armiqtë mësojnë, për shembull, sekretet tona në sistemin mbrojtës të kufirit, atëherë masat në mbrojtje të kufirit bëhen pronë e armikut, i cili nuk kalon nëpër zona të mbrojtura, por futet në shtigje të tjera. Historia e spiunazhit botëror tregon se kundërshtarët kanë harxhuar miliona e miliona për zbulimin e sistemit mbrojtës të një fortifikate, kanë bërë që të vriten sa e sa njerëz të tjerë për të shtënë



në dorë të dhëna mbi të, me qëllim që të vepronin me sukses në favor të tyre. Rëndësia e kësaj çështjeje nuk mund të kuptohet në rast se nuk ngrihet vazhdimisht vigjilenca e efektivit me një punë të mirë politike.

Çdo gjë duhet të kuptohet politikisht nga njerëzit tanë. Për këtë ne i kemi të gjitha mundësitë. Në radhë të parë ne kemi një ushtri besnike dhe heroike, kemi kuadro të dalë nga lufta, por mbi të gjitha është udhëheqja e drejtë e Partisë. Puna politike e Partisë në ushtri luan një rol të madh në këtë drejtim.

Çështjes së stërvitjes të efektivit t'i vini rëndësi të madhe. Ushtarët dhe oficerët të edukohen mirë edhe teknikisht, sepse edhe kjo ngjall te ata ndjenjën e forcës dhe të besimit, zhduk lëkundjen, frikën ose dyshimin që mund të duket te ndonjëri. Në qoftë se efektiv i përvetëson mirë mësimet e stërvitjes ushtarake, në qoftë se mëson të përdorë mirë armën që i është besuar, ai do ta ndiejë veten më trim. Ai gjithashtu do ta ndiejë veten më të sigurt kur të bëhet me të edhe një punë e veçantë për ngritjen e tij politike. Atëherë ai bëhet i patundur dhe optimist se fitorja është jona.

Do t'ju këshilloj edhe për një gjë. Duke pasur parasysh luftën moderne dhe pozitën gjeografike të vendit tonë, ushtria duhet të jetë në gatishmëri të plotë në çdo kohë, sidomos përse i përket anës së stërvitjes në kushtet e vështira. Ta zhvillojmë stërvitjen ushtarake në male e në fusha, në shi e në dëborë, në vapë e në të ftohtë, ditën e natën, me armë të lehta e të rënda. Ushtarët dhe oficerët tanë duhet t'i zotërojnë mirë të gjitha armët dhe t'i mirëmbajnë si duhet ato. Stërvitjen ushtarake në kushte të vështira klimatike dhe tokësore

mos e lini pas dore. Ushtarët tanë të ruajnë shkathhtësinë tonë karakteristike, dhe të kaliten për të përballuar çdo vështirësi. Kjo ka rëndësi të madhe për ne. Po të kemi ushtarë të kalitur dhe të stërvitur në këto drejtime, mund të themi me siguri se armiqtë do ta kenë shumë të vështirë të na prekin. Megjithëkëtë, ne t'i stërvitim vazhdimisht, t'i mësojmë ushtarët që, në rast rreziku, të koordinojnë zjarrin me armët e ndryshme, me artilerinë, me aviacionin, me tanksat etj.

Oficerët tanë janë bij besnikë të popullit, që kanë dhënë prova të shumta për devocionin ndaj tij. Të pajisur me këto cilësi dhe të kalitur më së miri në çdo drejtim, ata mbajnë mirë në dorë armët moderne që u janë besuar dhe që vazhdimisht janë përmirësuar. Me këto armë ata janë furnizuar gjithnjë më mirë e më shumë. Dhe kryesorja e kryesoreve është se kuadrot dhe i gjithë efektiv i forcave tona të armatosura kanë Partinë që i udhëheq.

Prandaj, ju, kuadro të sektorit politik të ushtrisë, këtë situatë dhe këtë frymë të shëndoshë duhet t'i rrënjosni thellë dhe t'i forconi në zemrat dhe në mendjet e ushtarëve tanë, të forcave të kufirit, të policisë etj., në mënyrë që vendi ynë të jetë kurdoherë në gjendje të përballojë çdo rrezik.

*Botuar për herë të parë në:  
Enver Hoxha «Në ndihmë  
të Ushtrisë Popullore», vëll.  
II, f. 442. Tiranë, 1975*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## INTELIGJENCA JONË RRRITET DHE ZHVILLOHET NË GJIRIN E POPULLIT

*Fjala në takimin me përfaqësuesit e inteligjencës  
së kryeqytetit<sup>1</sup>*

25 tetor 1962

Të dashur shokë dhe shoqe,

Para së gjithash më lejoni t'ju sjell përshëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë juve, intelektualëve të vendit, dhe veçanërisht intelektualëve të kryeqytetit, që jeni një repart i fuqishëm dhe luftarak i inteligjencës sonë të lavdishme popullore, mbështetje e rëndësishme e Partisë sonë të Punës dhe e pushtetit popullor. Unë personalisht e ndiej veten shumë të gëzuar që jam midis jush, midis shokëve të mi të vjetër e të rinj, bashkëluftëtarë për realizimin e idealeve të mëdha të socializmit e të komunizmit.

---

<sup>1</sup> Me ftesën e Rektoratit të Universitetit të Tiranës, më 25 tetor 1962, shoku Enver Hoxha pati një takim me pedagogë, punonjës shkencorë, studentë të universitetit e të instituteve të larta të kryeqytetit dhe përfaqësues të tjerë të inteligjencës,

## **Inteligjenca jonë është bërë një forcë që luan një rol të madh në ndërtimin socialist të vendit**

Dikur intelektualët shqiptarë ishin aq të paktë në numër, saqë, po të grumbulloheshin nga të gjitha anët e atdheut, nuk do të mund ta mbushnin këtë sallë, kurse sot janë aq sa kjo sallë s'merr dot as vetëm ata të qytetit të Tiranës. Tani inteligjenca është bërë një forcë e madhe që luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin socialist. Mirëpo nesër vendi ynë do të ketë akoma më shumë kadro dhe roli i inteligjencës do të rritet nga dita në ditë. Pikërisht për forcimin e këtij roli mori vendime të rëndësishme Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i cili u mbledh në korrik të këtij viti dhe shqyrtoi çështjen e përmirësimit të mëtejshëm të punës për pregatitjen dhe për kualifikimin e kuadrit.

Udhëheqja e Partisë sonë ka krijuar një traditë të mirë, sa herë që do të shqyrtojë e të zgjidhë një problem të rëndësishëm, konsultohet me masat dhe me kuadrot, i tërheq ato në diskutimin konkret të çështjes dhe pastaj vendimet ua shtron po atyre, në mënyrë që t'i përvetësojnë, t'i pasurojnë dhe t'i vënë në jetë. Bile edhe në plenumet e Komitetit Qendror, shpeshherë veç anëtarëve të tij, marrin pjesë edhe mjaft kadro me parti e pa parti nga rrethet, qendrat e prodhimit, institucionet e ndryshme etj. njerëz me eksperiencë të pasur, njerëz me frymë të re, me frymë partie. Kështu veproi Komiteti Qendror i Partisë edhe në rastin e pregatitjes dhe të zhvillimit të Plenumit

për çështjen e kuadrit. Prandaj edhe vendimet e këtij Plenumi qenë fryt i një pune dhe i përgjithësimit të një eksperience të gjerë kolektive, të bazuar në vijën marksiste-leniniste të Partisë dhe që synojnë në forcimin e mëtejshëm të atdheut dhe në lulëzimin e jetës së popullit.

Kjo dëshmon edhe një herë mbi lidhjen e ngushtë Parti-kuadro-popull që ekziston te ne. Në fakt, në vendin tonë ka një unitet të tillë organik dhe të çeliktë mendimi dhe veprimi midis të gjitha forcave të gjalla të shoqërisë dhe udhëheqëses së tyre, Partisë, saqë ne, me të drejtë, mund të krenohemi. Dhe kjo sepse ai bazohet në interesat dhe qëllimet e vetme e të përbashkëta të tyre, që ndriçohen nga doktrina e pavdekshme e marksizëm-leninizmit dhe që synojnë në ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Nëse sot, shokë, Republika jonë Popullore është bërë një shtet i fuqishëm socialist, avanpost i socializmit në brigjet e Adriatikut, kështjellë e pamposhtur para sulmeve, komplotëve, intrigave të imperialistëve dhe të revizionistëve modernë, kjo i detyrohet, në radhë të parë, këtij uniteti të të gjithë popullit me Partinë. Gjithashtu, nëse në vendin tonë janë arritur aq suksese të mëdha në të gjitha fushat e ndërtimit të jetës sonë të re, saqë Shqipërisë i është ndërruar krejt pamja, nëse u përballuan dhe po kapërcehen njëra pas tjetrës pengesa e vështirësi të shumta, duke realizuar e duke tejkaluar çdo vit planet madhështore të ndërtimit, edhe këto i detyrohen unitetit të çeliktë të një milion e gjysmë njerëzve rreth udhëheqëses së tyre të sprovuar, Partisë së Punës. Në këtë unitet qëndron garancia për ta

ngritur lart e më lart emrin e lavdishëm të atdheut tonë, këtu është garancia se çdo vendim që merr Partia, do të bëhet patjetër realitet.

Si mishi me thoin është e lidhur me Partinë e popullin e saj edhe inteligjenca jonë popullore. Këtë ne nuk e themi për t'i bërë qejfin vetes, por sepse i tillë është realiteti. Dhe këtë e dëshmon më së miri vepra e saj, puna e saj e palodhshme gjatë pushtetit popullor. Këtë e dëshmojnë akoma më mirë vullneti e vendosmëria e saj e patundur që në të ardhshmen të bëjë akoma më shumë, njëqind herë më shumë se ç'ka bërë deri tani. Dhe ky nuk është një fenomen i izoluar, por një fenomen masiv, që përfshin të gjithë kuadrot e çdo fushe të jetës sonë. Kjo pa dyshim është një nga fitoret më madhështore të Partisë sonë. Nuk ka gëzim dhe krenari më të ligjshme sesa të shohësh që Partia ka rritur mijëra kuadro besnikë e të zotë që s'kursejnë asgjë, as djersën dhe, po të jetë nevoja, as gjakun e tyre për popullin e atdheut, për socializmin e komunistin.

Një gjendje e tillë e inteligjencës sonë, kuptohet, është rezultat dhe pasqyrim i transformimeve të mëdha revolucionare që kanë ndodhur në vendin tonë. Ajo pasqyron më së miri zhvillimin, efektet, marshimin triumfues të revolucionit tonë kulturor.

Po, shokë, te ne u krye një revolucion i pashebullt në historinë e popullit tonë, një revolucion madhështor, që u dha fund regjimeve feudalo-borgjeze e fashiste dhe përmbysi rendin e tyre ekonomiko-shoqëror. Krijimi i shtetit të demokracisë popullore, shtetëzimi i industrisë, i bankave etj., industrializimi socia-

list, kolektivizimi i bujqësisë, janë hallka e zinxhirit të revolucionit socialist, që konsoliduan pushtetin shtetëror dhe rendin e ri socialo-ekonomik të masave punonjëse, shoqërinë socialiste. Mirëpo ky revolucion ishte i gjithanshëm, ai për të qenë i plotë, nuk mund të mos futej në të gjitha poret e jetës sonë, të prekte të gjitha fushat e saj, të ishte një gërshetim unik i sektorëve të ndryshëm të aktivitetit njerëzor. Pikërisht për këtë arsye Partia jonë, duke u udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit, që në fillim dha sinjalin e kryerjes edhe të revolucionit kulturor, si pjesë përbërëse të revolucionit socialist. Juve ju kujtohet shumë mirë se si e filluam ne këtë, duke luftuar analfabetizmin që në radhët partizane dhe duke e zgjeruar këtë pas Çlirimit edhe në skajet më të largëta të atdheut. Ju kujtohet heroji i një veprë të Maksim Gorkit, fshatari Danko, bir i popullit, që shkuli nga gjoksi zemrën e tij dhe e ngriti lart si një fakell për t'u ndritur udhën njerëzve në mes të errësirës dhe i nxori në dritë? Ja po ashtu si ai, Mësuesi i Popullit Ndrec Ndue Gjoka nga Mirdita kaloi kasolle më kasolle dhe bëri edhe gjakun e tij dritë për t'u hapur sytë bijve të popullit të vet. Pa transformimet social-ekonomike ne s'do të mund ta bënim e ta vazhdonim revolucionin kulturor, por edhe pa këtë s'do të mund t'i shpinim deri në fund këto transformime dhe të shkonim më tej në ndërtimin socialist. Një anë e zhvillimit të revolucionit kulturor është vetë krijimi e zhvillimi i inteligjencës sonë popullore.

Ju të gjithë e dini parullën e Stalinit: «Kuadrot

vendosin gjithçka»<sup>1</sup>. Kjo nuk mohon aspak rolin primar dhe ekskluzivisht vendimtar të masave në zhvillimin e shoqërisë. Sepse në fund të fundit roli i kuadrove merr kuptimin e mësipërm kur ata shprehin aspiratat e masave dhe kur në punën e tyre ata mbështeten në veprimtarinë praktike të masave.

1 Këtë parullë J. V. Stalini e ka hedhur në kushte të caktuara për zgjidhjen e detyrave të mëdha në industri, në bujqësi, në transport dhe në ushtri, për realizimin me sukses të planit të dytë pesëvjeçar në vitet 30-të.

Pra parulla «kuadrot vendosin gjithçka» nuk është një parim, as një parullë strategjike, por një parullë taktike.

Ja ç'thotë Stalini lidhur me këtë çështje:

... «Më parë thoshim se «teknika vendos gjithçka». Kjo parullë na ndihmoi që të zhdukim zënë në teknikë dhe të krijojmë një bazë teknike shumë të gjerë në të gjitha degët e veprimtarisë për t'i pajisur njerëzit tanë me një teknikë të dorës së parë. Kjo është një gjë shumë e mirë. Po kjo nuk është aspak e mjaftueshme. Për ta vënë teknikën në lëvizje dhe për ta shfrytëzuar atë deri në fund, duhen njerëz që ta zotërojnë teknikën, duhen kuadro të aftë që ta përvetësojnë dhe ta shfrytëzojnë këtë teknikë sipas të gjitha rregullave të artit... Sikur në uzinat dhe në fabrikat tona të mrekullueshme, në sovkozet dhe në kolkozet tona, në transportin tonë, në Ushtrinë tonë të Kuqe të kishte një numër të mjaftueshëm kuadrosh të aftë që ta zotërojnë këtë teknikë, vendi ynë do të arrinte një efekt tri dhe katër herë më të madh se sot. Ja pse sot theksin duhet ta vëmë mbi njerëzit, mbi kuadrot, mbi punonjësit që zotërojnë teknikën. Ja pse parulla e vjetër «teknika vendos gjithçka», që pasqyron një periudhë tashmë të kapërcyer, kur kishim zi në teknikë, sot duhet të zëvendësohet me një parullë të re, me parullën «kuadrot vendosin gjithçka». Kjo është kryesorja sot». J. V. Stalini. Veprat, vëll. 14, f. 7-8.



Prandaj çdo klasë krijon inteligjencën e vet. Këtë bën edhe klasa punëtore. Dhe ajo e bën këtë jo për traditë, por sepse kjo është një nga detyrat e kushtet themelore për të realizuar revolucionin politik, ekonomik e kulturor. Këtë Partia jonë e kishte të qartë qysh në fillim, prandaj në këtë çështje veproi drejt. Sigurisht, ne hodhëm poshtë teoritë trockiste oportuniste «për të përgatitur më parë kuadrot e pastaj për të vepruar» dhe i përgatitëm kuadrot, inteligjencën tonë, në zjarrin e revolucionit, në punë e sipër, paralelisht me zgjidhjen e problemeve më të ngutshme. Inteligjenca jonë, dikur e paktë në numër, erdhi duke u rritur dallngadalë, si ndonjë ortek dëbore, që me vrullin e saj e shpuri gjithnjë e më përpara revolucionin tonë kulturor. Dhe përpjekjet e sakrificat e klasës sonë punëtore për të krijuar inteligjencën e saj, inteligjencën tonë të mrekullueshme, nuk vajtën kot.

Ne kemi një inteligjencë të re, krejtësisht të re në përbërje, në botëkuptim dhe në moshë. Në këtë të fundit dua të ndalem pak. Kjo shpreh vetëm anën sasiore, atë që intelektualët në moshë të kaluar janë shumë të paktë në krahasim me ata të moshës së re, që përbëjnë shumicën dërrmuese. Kështu që shprehja «kuadro të vjetër» dhe «kuadro të rinj» që përdoret ndonjëherë të ne e ka humbur kuptimin e saj klasor lidhur me përmbajtjen, por tregon vetëm moshën apo pamjen e jashtme të tyre.

Rruga e krijimit të inteligjencës sonë ka specifikën e saj. Dhe është pikërisht kjo specifikë që ka vënë vullën e saj në atë që s'e dallon dot intelektualin e vje-

tër nga i riu përse u përket botëkuptimit, ndërgjegjes socialiste.

Para Çlirimit në vendin tonë numëroheshin rreth 380 kuadro me arsim të lartë, rreth 1 600 mësues dhe një numër shumë i kufizuar teknikësh të mesëm etj. Ja, kjo ishte e gjithë inteligjenca jonë në atë kohë. Kuptohet se shumica e tyre ishin të shtresave të mesme e të varfëra, bij të popullit, që në përgjithësi përshkoheshin nga ndjenja përparimtare e thellësisht demokratike. Por edhe midis inteligjencës që vinte nga shtresat e larta kishte mjaft të tillë që përshkoheshin nga tendenca progresive demokratike. Kuadrot, duke mbaruar studimet në shkollën e mesme apo të lartë, ashtu siç ngjet me çdo njeri që mbaron një etapë të tillë të rëndësishme të jetës së tij, fillonin punën me ëndrrat e tyre më të bukura, për të krijuar në sektorët më të ndryshëm që kishin zgjedhur e për të lulëzuar atdheun e tyre. Atyre që kishin qenë jashtë shtetit këto ëndrra ua kishin ushqyer edhe ato që kishin parë në vendet e zhvilluara kapitaliste, si ngjarjet politike të atjeshme, përleshjet klasore midis proletariatit dhe borgjezisë, lufta e partive komuniste dhe e elementëve të ndryshëm përparimtarë etj. Kështu që, me të hyrë në jetë të pavarur, duke marrë kontakt me realitetin e vendit që lëngonte nën një regjim obskuranist dhe tiranik, ata filluan të deziluzionoheshin. Regjimi i Zogut jo vetëm që nuk i përkrahte ëndrrat dhe aspiratat, qoftë këto edhe thjesht profesionale të intelektualëve, por edhe i kundërshtonte e i prishte ato me çdo mjet. Kështu që, dashur padashur, këta njerëz filluan të vihen në kundërshtim me regjimin ekzistues,

në fillim, nëse mund të shprehemi kështu, profesionalisht, më vonë, kur s'kishin rrugëdalje tjetër, edhe politikisht. E ç'mund të ngjiste tjetër veç kësaj në shpirtërat e mësuesve që, ashtu si Migjeni në Pukë, shihnin në çdo skaj të Shqipërisë mijëra «Lula të vocërr»? Ose ja dy shembuj tipikë: kur Ahmet Zogu takoi për herë të parë skulptorin Odise Paskali, pasi ky kishte krijuar një nga veprat e tij më të bukura, «I urituri», i tha: «Unë kam nevojë për skulptor, mbasi në banjone time do të baj do punime e zbukurime...». Piktori i njohur në atë kohë, Kolë Idromeno, u detyrua të ushtronte punën e fotografit e të projektuesit të shtëpive që të mund të siguronte bukën e gojës. Kështu, këta e shumë të tjerë, në një formë ose në një tjetër, u ndeshën me regjimin.

Më vonë erdhi fashizmi. Sigurisht, ky u përpoq të flirtonte me ëndrrat e intelektualëve, pasi në këtë punë kishte edhe eksperiencë. Mirëpo këtu te ne nuk i eci aq mbarë, për dy arsye: së pari, sepse ai ishte pushtues, gjë që s'e fshihte dot dhe kjo bënte që intelektualët tanë në përgjithësi (me përjashtime të rralla) të mos tradhtonin ndjenjat e tyre të pastra patriotike, por të ruanin distancën e duhur nga ai; së dyti, sepse shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore ia çorri maskën «qytetëruese» fashizmit italo-gjerman dhe zbuloi fytyrën e tij të vërtetë barbare. Ndërkohë, lindi Partia, që u vu në krye të luftës së armatosur të popullit kundër pushtuesve fashistë, luftë që tronditi të madh e të vogël në vendin tonë. Thirrja e Partisë jehoi si kushtrim edhe thellë në zemrat e intelektualëve. Ja pse arsimitarët merrnin pjesë së bashku me nxënësit në

demonstrata, ja pse mjaft mjekë të atëhershëm, pa marrë parasysh rreziqet, kuronin ilegalët e partizanët e plagosur. Ja pse piktori komunist Jordan Misja me shokë kryen epopenë e lavdishme të Shkodrës.

Pas Çlirimit kuadrot tanë të lartë shpërthyen në lulëzim të vërtetë. Ata filluan të mishërojnë ëndrrat e tyre më të bukura në urat madhështore që ndërtuan mbi gërmadhat e lëna nga pushtuesit, në godinat e reja, në fabrikat e kombinatet, në hekurudhat e hidrocentralet, në shkollat e reja, në ansamblet e para artistike, në kompozimet muzikore, në ekspozitat e arteve etj. Këtu, pa dyshim, është fjala për rrugën e shumicës dërrmuese të kuadrove dhe jo për ata të paktë që u vunë kundër popullit. Pra vendin e deziluzionimeve dhe të pesimizmit të dikurshëm të intelektualëve e zunë shpresa dhe optimizmi. Realiteti, jeta, lufta, puna ndërtimtare, nga njëra anë, puna edukative dhe përkrahja e zjarhtë e Partisë, nga ana tjetër, qenë faktorët kryesorë që bënë të mundur riedukimin dhe kalimin e tyre në pozitë e popullit punonjës, në pranimin vullnetar nga ana e tyre të marksizëm-leninizmit e të rolit udhëheqës të Partisë. Vetëm kështu mund të shpjegohet edhe një fakt tjetër kuptimplotë: Siç dihet, Koçi Xoxe me shokë, duke vepruar si trockistë e revizionistë, në bazë të urdhrave të padronëve të tyre titistë, krahas goditjes së përgjithshme që u dhanë Partisë e popullit, goditën rëndë edhe inteligjencën, duke u përpjekur ta komprometonin e ta shkëputnin atë nga Partia. Mirëpo e vërteta është se këto goditje s'e çoroditën inteligjencën, aq i fortë ishte besimi i saj te Partia dhe vija e saj e drejtë. Dhe Partia e mbrojti

atë. Partia dërrmoi komplotistët revizionistë, shpëtoi atdheun, popullin, inteligjencën. Prandaj më vonë kuadrot tanë intelektualë u lidhën edhe më ngushtë me Partinë, u hodhën në punë me entuziazëm edhe më të madh dhe bënë vepra gjithnjë e më të mrekullueshme.

Ju, shokë, e dini se rruga e këtyre 18 vjetëve pas Çlirimit nuk ka qenë e shtruar me lule për Partinë e popullin tonë. Përkundrazi, ajo ka qenë e mbushur plot pengesa e vështirësi, që duheshin kapërcyer. E kaluara na la si trashëgim varfërinë e prapambetjen në të gjitha fushat e jetës, lufta na la shkatërrime e dëme kolosale, armiqtë e jashtëm e të brendshëm na kurdisën lloj-lloj komplotesh e sabotimesh, vetë ecja jonë përpara ishte e shoqëruar me vështirësitë e rritjes.

Të gjitha këto kërkuan nga Partia dhe populli luftë parimore dhe këmbëngulëse, gjak e djersë, kërkuan sakrifica të mëdha. Popullit iu desh që të shtrëngonte rripin për bukë në vitet e para, të hapte me gjoks tunele ngaqë s'kishte mjete, të shtronte e të rishtonte shinat e hekurudhave ngaqë sabotonin teknikët jugosllavë e ngaqë s'kishte teknikë të tij, atij iu desh të shpartallonte provokacionet greke të 2 gushtit 1949 dhe qindra provokacione e komplete të tjera të armiqtëve të jashtëm, të përleshej dhe të zhdukte bandat diversante që futeshin nga të katër anët, iu desh të ngrinte kombine, të thante moçale, të hapte toka të reja, të sillte teknikë të re, të kultivonte bimë të reja, iu desh të ngrinte industrinë e të kolektivizonte bujqësinë, të ndërtonte bazën ekonomike të socializmit. Dhe ai i bëri të gjitha, mundimi nuk i shkoi kot. Por,

ndërsa na mungonte buka dhe popullit i duhej të përleshej me vështirësitë, me diversantët etj., Partia s'harroi, përkundrazi, luftoi për të ngritur më shumë shkolla, kinema e teatro, biblioteka e muzcume, ajo dërgoi bijtë e popullit për studime të larta në Bashkimin Sovjetik e në vende të tjera. Klasa jonë punëtoare dhe fshatarësia hoqën shumë nga goja për të gjitha këto, dhe i krijuan inteligjencës kushte sa më të favorshme pune, krijimtarië dhe jetese.

Ç'doli nga kjo? Si rezultat i vijës marksiste-leniniste dhe i punës me perspektivë të Partisë doli që revolucioni ynë kulturor u zhvillua me sukses, duke ndihmuar tërë zhvillimin e vendit; u krijua një armatë e tërë kuadrosh — jo 380, por 6 000 kuadro të lartë kemi ne sot, jo afro 2 000, por 21 600 kuadro të mesëm, veç 95 mijë punëtorëve të kualifikuar, ka sot Shqipëria e re. Dikur në çdo 18 vetë vetëm një qytetar mezi arrinte të mësonte, kurse sot në çdo 5 vetë një mëson. Nuk po përmend universitetin, institutet e larta, Teatrin e Operës dhe të Baletit etj., që i dini. Tani ne u themi miqve dhe armiqve: prisni vetëm 8 vjet dhe do të shihni se deri më 1970 ne pothuaj do ta trefishojmë numrin e kuadrove të lartë, duke arritur shifrën 16 500, se do të arrijmë afro dyfishin e kuadrove të mesëm, me shifrën 40 600 vetë dhe afro dyfishin e punëtorëve të kualifikuar me shifrën 175 000 vetë. Këto konkluzione dhe vendime të Plenumit të fundit të Komitetit Qendror të Partisë, shokë, s'janë fjalë në erë, por fakte dhe llogari ekzakte, që i vërteton dhe do t'i vërtetojë edhe në të ardhshmen jeta.

Ne, komunistët dhe patriotët shqiptarë, pra, dimë

të krijojmë dhe të ëndërrojmë. Por ëndrrat tona janë fisnike dhe reale. Dikur ëndërruan edhe Naimi e Samiu, Çajupi e Migjeni ta shihnin Shqipërinë «kryezonjë» e me «gjithëmësonjëtores»; u shkruanë ata si qiriri për këtë. Por satrapët s'i lanë të realizonin e t'i shihnin të mishëruar në jetë ëndrrat e tyre. Mirëpo partizanët tanë trima dhe të gjithë patriotët e Shqipërisë së re me Partinë e tyre të Punës në krye, të armatosur me shkencën e pavdekshme të marksizëm-leninizmit jo vetëm huajtën ëndrrat e të parëve, por thurën edhe ëndrra më të guximshme dhe, me gjak e me djersë, i bënë ato realitet. Kështu do të bëjmë ne edhe në të ardhshmen.

**Ne duhet dhe i kemi të gjitha mundësitë  
të bëjmë shumë për zhvillimin e shkencës  
dhe të teknikës**

Megjithëkëtë e vërteta, shokë, është se ne duhet të bëjmë akoma shumë në drejtim të zhvillimit të kuadrove, të përvetësimit të shkencave, të ngritjes shkencore të vendit tonë. Bota në këtë fushë ka ecur shumë përpara. Mirëpo ne jetojmë në këtë botë, për më tepër ne po ndërtojmë socializmin e nesër do të ndërtojmë komunizmin. Për këtë na duhen, midis të tjerave, quadro, na duhen teknika e shkenca. Siç dihet, shkencat kanë marrë një hov të paparë ndonjëherë në historinë e njerëzimit dhe janë arritur rezultate të mahnitshme. Dijetarët e mëdhenj të epokave të ndryshme, të kombësive të ndryshme, të shkollave dhe të

pikëpamjeve të ndryshme, i kanë sjellë njerëzimit të mira të pallogaritshme, i kanë hapur kush më shumë e kush më pak shtigje të atilla diturisë saqë sot elektriku është bërë motori i botës sonë të re. E gjithë shkenca e sotme e aplikuar bazohet te elektriciteti dhe mund të themi se veprimtaria më e madhe e jetës së përditshme të njerëzimit zhvillohet, punon nën shenjë e forcës së Voltës, Amperit etj., të cilët e rriten atë, si të thuash, «me biberon» dhe tani ajo është bërë një forcë kolosale, një forcë e tillë që lindi një forcë tjetër kolosale, energjinë atomike, këtë zbulim nga më të mëdhenjtë e kohërave. Zhvillimi i shkencës është vepër jo vetëm e disa dijetarëve gjenialë, që gjatë historisë njerëzore kanë ndritur si yje të shkëlqyer dhe që studimet e shpikjet e tyre janë në themel të shkencës kurdoherë në ngjitje, por edhe e mijëra e dhjetëra mijëra punonjësve të ndryshëm nga të katër anët e botës, që kanë ëndërruar, që kanë studjuar, që kanë vënë në praktikë, që kanë bërë kombinime të ndryshme dhe kanë arritur të krijojnë zinxhirin e pandërprerë të shkencës moderne.

Gjatë historisë së njerëzimit katastrofa ose rryma të forta obskurantiste kanë penguar për një kohë zhvillimin e shkencës në përgjithësi dhe të disa shkencave në veçanti. Ju e dini se ç'katastrofë i solli shkencës imperatoria romake, dhe veçanërisht periudhës greko-aleksandrine, ku zhvillimi shkencor shkëlqeu me emrat e Arkimedit, Euklidit etj. Mesjeta obskurantiste mbyti për një periudhë të gjatë shkencën dhe i qëndroi asaj si një gur i rëndë varri, ku ishte shkruajtur diktatura e Aristotit dhe emri i Shën Thoma Akunit, për



të cilët shkencë ishte bibla, Aristoti dhe magjitë. Në Luftën e Parë Botërore, dhe veçanërisht në Luftën e Dytë Botërore, agresorët fashistë hitlerianë goditën me grusht të rëndë shkencën dhe ngjallën misticizmin, ashtu siç ngjet në kohë krize, kur librat bëhen kapica në sheshe dhe u vihet zjarri.

Këto mësimë të historisë duhet t'i përmendim, sepse edhe në kohërat tona imperializmi amerikan, revanshistët e Bonit dhe aleatët e tyre po vijnë rrotull me pishë në dorë, ose më mirë të themi me bomba atomike në duar, për t'i vënë zjarrin botës dhe për ta përdorur këtë zhvillim kolosal të diturisë dhe të shkencës në dëm të njerëzve dhe të pasurive morale e materiale që ata kanë krijuar. Ne duhet t'ua ndalim dorën që këta kriminelë kanë ngritur kundër njerëzimit e qytetërimit. Njerëzit e shkencës, kudo që janë, kudo që rrojnë dhe punojnë, duhet të jenë zgjuar dhe të bashkuar, të luftojnë që frytet e mendimit krijues, të punës dhe të eksperiencës së tyre të përditshme të mos lejojnë që të përdoren në dëm të së mirës njerëzore. Shkencat kanë pasur dhe duhet të kenë një karakter universal dhe zhvillimi i tyre jo vetëm nuk mund të jetë monopoli i disa njerëzve të veçuar, i disa shteteve të fuqishme, ose i disa koncerneve të mëdha, por ato duhet të vilen tërësisht në shërbimin e njerëzimit, në shërbimin e paqes dhe jo të luftës e të shfrytëzimit të njerëzve.

Ne i detyrojmë shkencës vlera të pallogaritshme për njerëzimin, ne i detyrojmë shkencës çlirimin e shpirtit dhe të mendjes nga bestytinitë. Çdo çap përpara i bërë nga shkencë, në luftë e në përpjekje, ko-

lektive e individuale, bën që të zbrapset një hap prapa mistika e errët dhe irracionale që gjatë historisë, por akoma edhe sot në epokën e elektrikut, të marksizëm-leninizmit dhe të atomit, del përpara dhe kundërshton arsyen. Të mendosh se shkencë është një epifenomen i izoluar, siç bëjnë disa të ashtuquajtur «dijetarë» perëndimorë ose lakej të Vatikanit, s'ka absurditet më të madh dhe s'është tjetër veçse mendim anti-shkencor.

Epoka që jetojmë, është epoka e triumfit të socializmit, është epoka e ideologjisë së lavdishme të shoqërisë së re, marksizëm-leninizmit, i cili vuri në vend vlerat e krijuara nga njerëzit brez pas brezi dhe i armatosi njerëzit e epokës së vet me një armë të fuqishme dhe të pagabuar, që i bën shkencat të përparojnë me kaq hov.

Ne jemi një vend i vogël, me një prapambetje të theksuar në lëmin shkencor, ne nuk kemi ato mundësi materiale siç kanë shumë vende të tjera të botës, nuk kemi trashëguar nga e kaluara jonë e zezë një plejadë shkencëtarësh me traditë, që të linin gjurmët dhe traditat e një zhvillimi të tillë në universitete e në fakultete, ose në zhvillimin praktik të eksperiencave të tyre në lëmin e industrisë, të bujqësisë, të mjekësisë, të fizikës, të kimisë etj. Si çdo gjë te ne, edhe zhvillimi i shkencës është i ri. Tani çdo gjë në këtë drejtim ndodhet në fillim të rrugës së saj, por në rrugë të mbarë, në rrugë të drejtë dhe ne po i shohim frytet. Vendi ynë tani është mbushur me shkolla, ne kemi universitetin e institutet tona të larta, laboratorë, fabrika, miniera, ferma e kooperativa bujqësore dhe, tok

me të gjitha këto, kemi krijuar kuadro akoma më të rinj, akoma jo me një dituri të madhe e me një eksperiencë të gjerë, por kuadro plot vullnet, plot energji, bazë e sigurt për të ardhshmen e ndritur të shkencës në vendin tonë. Në disa degë të shkencës, si në atë të gjuhësisë e të letërsisë, ne kemi njerëz të shquar e shkencëtarë të nivelit ndërkombëtar, si Sami e Naim Frashërin etj., vepra e të cilëve dihet; kemi njerëz me merita të mëdha si profesor Refat Frashërin, i njohur gjer në vitet 30-të në të gjithë botën për studimet e veprat e tij mjekësore, sidomos në bakteriologji; kemi edhe specialistë të kohës sonë, që kanë punuar ose punojnë e luftojnë edhe sot me metoda shkencore dhe me rezultate të shkëlqyera, siç kanë qenë profesorët Aleksandër Xhuvani e Kostaq Cipo, siç janë Eqrem Çabej, Dhimitër Shuteriqi, Mahir Domi e Androkli Kostallari, Aleks Buda e Stefanaq Pollo etj. Studime me vlerë të madhe për vendin e shoqërinë tonë të re po bëjnë ekonomistët, filozofët, juristët e specialistë të fushave të tjera.

Është kënaqësi e veçantë, gjithashtu, kur shohim se ne kemi mjekë të shquar të vjetër e të rinj si Fejzi Hoxha, Selaudin Bektashi, Kristo Kristidhi, Petro Cani, Petrit Gaçe e shumë të tjerë që jo vetëm kanë vënë të gjitha energjitë e tyre për ruajtjen e përmirësimin e shëndetit të popullit dhe për përgatitjen e qindra kuadrove të rinj, por me diagnozat ekzakte e operacionet e tyre të komplikuar po provojnë se nuk janë pas kolegëve të tyre të shquar të vendeve të tjera.

Ne kemi matematicienë, fizikanë, kimistë etj. që kanë hyrë në rrugën e studimeve serioze të një niveli

të lartë, siç janë shokët Kristaq Fundo, Sotir Kuneshka, Kolë Popa, Minella Karajani, Islam Zeko, Kolë Papanisto, Petraq Pilika e mjaft të tjerë. Të tillë kuadro dhe shokët e tyre më të rinj përbëjnë një bërthamë të shëndoshë, që do ta çojnë përpara shkencën në vendin tonë.

Këta kuadro janë në gjendje, dhe këtë e kanë treguar, të mbrojnë çështje të rëndësishme shkencore në mbledhje dhe forume shkencore ndërkombëtare, të tërheqin seriozisht vëmendjen e shkencëtarëve të huaj për zhvillimin e pasur shkencor të tezave që ata kanë mbrojtur. Të shquar janë dhe doktor veterineri Dhimitër Vavako, autor i vaksinës së plasjes në vendin tonë dhe drejtues i prodhimit të shumë biopreparateve veterinare, që nuk qëndrojnë më poshtë nga ato të vendeve të tjera, Mentor Përmeti, që arriti të zbatojë konvejerin e gjelbër në bregdetin e vendit tonë e shumë shokë të tyre. Studime dhe vepra me rëndësi shumë të madhe për vendin kanë ndërmarrë inxhinierë të tillë të zotë, si shokët Hajredin Kumbaro, Petrit Radovicka e të tjerë. Këtu dua të përmend veçanërisht edhe laureatët e çmimeve të Republikës inxhinierët Mirush Puto, Safa Kumbaro, Ilia Plasa e shumë kolegë të tyre, që kanë zgjidhur detyra shumë të vështira shkencore-praktike në dobi direkt të ndërtimit tonë socialist. Specialistët tanë kanë arritur rezultate të shkëlqyera në fushën e kërkimeve e të studimeve gjeologjike, duke zbuluar vendburime të reja shumë të rëndësishme. Ata kanë projektuar dhe po ndërtojnë uzina, fabrika e reparte të reja, vepra të rëndësishme të ekonomisë dhe të kulturës. Këtë vit po projektohet në vend rreth 82

për qind e planit të ndërtimeve, nga 64 për qind që ishte më 1960, kurse zbatimi i veprave bëhet qind për qind nën drejtimin e kuadrove tanë të zotë, siç janë arkitektët Skënder Luarasi, Anton Lufi, Eqrem Dobi, Sokrat Mosko etj. Për herë të parë janë prodhuar në vend artikuj dhe mallra të ndryshme, si soda kaustike, karbiti etj., dhe pjesë këmbimi e makineri që më parë importoheshin nga jashtë.

Më falni që po zgjatem në këtë drejtim, por me këtë nuk kam për qëllim t'u rrit mendjen disa intelektualëve, specialistëve tanë, rrezik ky që nuk ekziston, pasi ata janë njerëz sa të zotë, aq edhe të thjeshtë, ashtu siç janë edhe shumë e shumë të tjerë, emrat e të cilëve s'i përmenda dot për mungesë kohe, as të tregoj se shkencat në Shqipëri kanë arritur një përparim të madh dhe këtej të dalim të kënaqur, me pikëpamje se çdo gjë te ne është arritur. Jo, përkundrazi, këto i them për të vënë mirë në dukje se ne jemi prapa, shumë prapa, por edhe për të theksuar se kuadrot tanë kanë ecur përpara dhe se para tyre janë hapur perspektiva të mëdha, janë krijuar dhe do të krijohen paskëtaj mundësi edhe më të mëdha për një zhvillim akoma më të vrullshëm të shkencave në vendin tonë.

Mendjemadhësia dhe vetëkënaqësia janë dy vese të këqija, që duhet t'i luftojmë, se na pengojnë të ecim përpara në këtë fushë që po flasim, por edhe thjeshtësia e tepruar, që të kuptohemi më mirë, e kam fjalën se mund të ketë njerëz që të thonë afërsisht kështu: «Ne jemi të vegjël, ne jemi në bisht, shkenca ka shkuar përpara, në vendet e tjera të botës ka koka të mëdha, çdo gjë e kanë shpikur të tjerët» etj., etj. — edhe

pikëpamje të tilla s'janë të drejta, se ato të ngjallin pesimizëm, të pengojnë në zgjerimin e diturisë dhe në zhvillimin e intelektit, të heqin pas dhe s'të lënë të bësh përpjekjet e duhura për të shkuar më tej.

Ne tani mund të flasim me krenari për karakteristikat më fisnike që dallojnë sot kuadrot tanë, gjithë inteligjencën tonë, karakteristika këto që duhen zhvilluar e duhen forcuar edhe në të ardhshmen. Së pari, ne kemi një inteligjencë të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, një inteligjencë patriote dhe revolucionare, e zonja për të përballuar çdo situatë dhe për të qenë kurdoherë në lartësinë e detyrave kombëtare dhe ndërkombëtare që qëndrojnë para Partisë dhe popullit tonë. Së dyti, ne kemi një inteligjencë të talentuar dhe të aftë për të zgjidhur detyrat më të vështira të ndërtimit socialist, problemet më të ndërlikuara në të gjitha fushat ekonomike, shoqërore, arsimore, kulturore. Së treti, ne kemi një inteligjencë të lidhur ngushtë me popullin, që rritet dhe zhvillohet në gjirin e popullit, që ushqehet nga gjenia e popullit dhe që lufton për të mirën e popullit të saj. Të gjitha këto i vërteton plotësisht vetë jeta, ky është realiteti ynë objektiv, në të cilin mbështetet Partia në gjykimet e në veprimet e saj.

Natyrisht Nikita Hrushovi dhe grupi i tij nuk mund të jenë dakord me këtë vlerësim, sepse dihet që ai kurdoherë ka nënvleftësuar aftësitë dhe mundësitë krijuese të popullit tonë, që midis të tjerave shprehen në shpikjet e racionalizimet e punonjësve tanë, për të cilat ne mburremi. Dihet gjithashtu se ai dhe pasuesit e tij janë shprehur më se një herë se gjoja janë ata që e kanë krijuar inteligjencën tonë. Por neve kjo aq

na bën. Përsa u përket shpikjeve, racionalizimeve, propozimeve, këtij hovi të paparë në këtë drejtim që shpërtheu me forcë të veçantë pas sulmeve kundër Partisë sonë e zbulimit të tradhtisë së N. Hrushovit ndaj marksizëm-leninizmit, ne mburremi e do të mburremi me plot të drejtë, sigurisht pa na u rritur mendja e pa fjetur mbi dafina. Ne mburremi jo se kemi bërë e po bëjmë shpikje të papara e të një rëndësie botërore, por sepse kuadrot tanë, duke luftuar në kushtet e vështira të rrethimit armiqësor kapitalist e të bllokadave revizioniste, po bëjnë përpjekje kolosale, duke i dhënë popullit ato që i nevojiten. Këto kanë rëndësi të madhe, sepse forcojnë Republikën Popullore të Shqipërisë, që është ngritur me heroizëm kundër këtij armiku të betuar të kampit socialist e të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, siç është revizionizmi modern i grupit Hrushov — Tito e kompani. Pastaj nuk jemi vetëm ne që po bëjmë shpikje që i kanë bërë më parë të tjerët ose nuk përjashtohet që edhe ne të japim ndihmën tonë në zhvillimin e shkencës botërore.

Nuk duhet harruar se në kohën e tyre eksperimentet e Ërstedit dhe të Amperit dukeshin dhe i cilësuan si lodra zbavitëse, por ato përmbanin elektronikën moderne. Kini parasysh përbuzjen e njerëzve gjoja realistë ndaj eksperimenteve laboratorike të Radhërfordit, ku u zbulua energjia atomike; kujtoni deduksionet mbi astronautikën të një mësuesi të humbur fshati, Ciolkovskit, që i quajtën ëndërrime zhulverniane, në saje të cilave sot po sulmohet dhe zbulohet kozmosi. Faktet tregojnë se shumë shpikje të mëdha që kanë

revolucionuar shkencën, janë bërë edhe nga punonjës të thjeshtë. Po të ndjekësh, qoftë edhe në mënyrë diletante, historikun e disa çështjeve që tani janë aq të kohës, që nga shpikja e Lumierit dhe deri te shpikja e punëtorit Zenob Grami, fotografia, kinemaja, televizioni etj., do të shohësh se nëpërmjet punës në industri e në fabrika nga inxhinierë të ndryshëm janë shpikur në punë e sipër gjëra që të habitin. Kështu mund të ndodhë edhe te ne.

Përsa i përket pretendimit tjetër se gjoja kuadrot tanë i përgatitën ata, Hrushovi me shokë, nuk është aspak i vërtetë. Kuadrot tanë që studjuan në Bashkimin Sovjetik, nuk vajtën në çiflikun e Hrushovit, por në atdheun e madh të Revolucionit të Tetorit, ku ditën të marrin, dhe për këtë ne gjithashtu mburremi, kulturën e madhe të popujve të lavdishëm sovjetikë, mësimet e pavdekshme të Leninit dhe të Stalinit, të cilat po i vënë me zotësi të madhe në shërbim të atdheut e të çështjes së përgjithshme të socializmit, ata shqelmuar me neveri dhe luftuan si burrat kundër pikëpamjeve armiqësore të këtij revizionisti dhe të pasuesve të tij. Përkundrazi, kur erdhi puna në dorë të Hrushovit, dihet se ai jo vetëm nuk ndihmoi, por u mbylli dyert e shkollave të larta e të institucioneve shkencore studentëve e kuadrove tanë, ashtu siç bëri edhe për çdo gjë tjetër.

Kështu qëndron, shkurtimisht, puna lidhur me zhvillimin e shkencës botërore, me rrugën e saj të vështirë, me peripecitë e saj të sotme dhe me mundësitë tona. Vepra e inteligjencës sonë në zhvillimin e shkencës, kulturës dhe ekonomisë së vendit është e lavdish-



me. Kështu e çmojnë atë Partia dhe populli. Mirëpo, megjithatë, sikundër e thashë pak më lart, kjo gjendje ne nuk na bën të flemë mbi dafina. Kuadrot tanë duhet t'i shohin rezultatet e tyre të lidhura ngushtë me nevojën e domosdoshme për ta forcuar gjithnjë e më shumë atdheun tonë nga çdo pikëpamje. Prandaj ata duhet ta ndiejnë veten gjithmonë të angazhuar në luftë për të arritur rezultate të reja, akoma edhe më të mëdha, në përputhje me nevojat e ndërtimit të mëtejshëm socialist.

### **Pregatitja dhe kualifikimi i kuadrove — detyrë me rëndësi**

Duke u nisur nga këto nevoja, vëmendja kryesore e institucioneve të ndryshme dhe e kuadrove tanë, pa dyshim, duhet të përqendrohet në dy aspekte kryesore të një problemi të madh, të problemit të kuadrit: si në përgatitjen ashtu edhe në kualifikimin e mëtejshëm të kuadrove, si në rritjen e sasisë e të cilësisë ashtu edhe në perfeksionimin e tyre. Kështu, nëse më parë ne e kishim parë këtë çështje kryesisht nga ana e përgatitjes së kuadrit si sasi, pa injoruar cilësinë, për të siguruar sa më parë një farë minimumi të domosdoshëm që na mungonte, në etapën e tanishme duhet t'i shohim të dyja anët e problemit, duke shtuar më shumë kujdes për cilësinë gjatë përgatitjes së kuadrit, e duke theksuar me forcë të veçantë kualifikimin, perfeksionimin e mëtejshëm të tij.

Ç'kërkon Partia nga kuadrot e kryeqytetit dhe in-

teligjenca jonë në përgjithësi? Që ato të merren sot më seriozisht se kurrë me të dyja këto çështje themelore.

**Së pari**, lidhur me çështjen e përgatitjes së kuadrit, duhet pasur parasysh se nga puna e tyre varet përgatitja e specialistëve me arsim të lartë, pa folur për rolin e madh që ata luajnë edhe në përgatitjen e kuadrove të ulët e të mesëm, kur punojnë si pedagogë, ose si specialistë në prodhim. Objektivat që ka caktuar Partia, nuk janë të lehtë për t'u arritur, por ata mund dhe do të arrihen. Për përgatitjen e mirë të specialistëve me arsim të lartë personeli mësimor i universitetit dhe i instituteve të larta duhet të bëjë përpjekje të gjithanshme për të përmirësuar më tej punën mësimore-pedagogjike. Këtu është kyçi i të gjithë suksesit të punës sonë. Një gjë e tillë do të shpjerë drejt pakësimit dhe, në fund të fundit, drejt eliminimit të deficiteve që na krijohen gjatë përgatitjes së kuadrit. Sepse është fakt që jo të gjithë punonjësit tanë pedagogjiko-shkencorë kanë një përgatitje të mirë teorike e praktike, niveli shkencor i leksioneve nuk është akoma në lartësinë e duhur etj. Kjo ka të bëjë, pa dyshim, edhe me arsye objektive, siç janë mosha e re e shkollave tona të larta, stazhi i ri i shumicës së pedagogëve, baza materialo-laboratorike e pamjaftueshme. Mirëpo me përpjekjet dhe me punën e tyre të palodhur, këto vështirësi duhen kapërcyer. Po kështu, është e nevojshme t'u kushtohet kujdes i veçantë katedrave, për të ngritur në një nivel më të lartë rolin e tyre udhëheqës në problemet organizative, metodike, në ndihmën e kuadrit të ri, në nxitjen e punës së pavarur të stu-

dentëve. Rëndësi të veçantë për një përgatitje sa më të mirë të specialistëve ka që studentët, nëpërmjet diplomave, të përpunojnë tema konkrete, si edhe të organizohen sa më mirë praktikat në prodhim. Meqë përmenda praktikën, desha të theksoj që ajo të mos nënvleftësohet, por nga ana tjetër, të mos kalohet edhe në ekstrem, që të bëhet në kurriz të teorisë; specialistit të ardhshëm i duhen që të dyja, edhe teoria, edhe praktika. Prandaj duhet parë shtrirja e drejtë e lëndëve atje ku një gjë e tillë s'është bërë, ose ku ndihet nevoja të rishikohet.

Çështja e përmirësimit të punës mësimore-pedagogjike që theksova pak më sipër, shtrohet jo vetëm për përgatitjen e kuadrove të lartë, por edhe për përgatitjen e kuadrove të mesëm e të ulët. Si kjo ashtu edhe çështje të tjera duhen shikuar e duhen zgjidhur me iniciativë e përpjekje në terrenin konkret të veprimtarisë së çdo kuadri ose institucioni.

Por kuptohet se në përgatitjen e kuadrit një rol të dorës së parë do të luajnë vetë studentët, vetë rinia. Prandaj i drejtohem veçanërisht rinisë sonë studjoze e të mrekullueshme, që të përqafojë me zell shkencën — shkencën në përgjithësi, matematikën në veçanti — jo vetëm për arsyet që thashë, por edhe sepse shkenca, matematika, të dashur të rinj e të reja, ka edhe romanizmin e vet, poezinë e vet, hovin kurdoherë rinor, aq të lidhur me brezin e ri.

Tani që po flas me kaq zjarr për shkencën e sidomos për matematikën, ndoshta të rinjtë mund të qeshin, ashtu siç kam qeshur dhe unë vetë kur kam qenë i ri, pasi duhet të pohoj, shokë, se nuk e kisha shumë

qejf matematikën dhe besoj se orët e mësimit të matematikës në shkollën e mesme ma kanë shpejtuar ca daljen e mjekrës. Por e vërteta është se matematika ka poezinë e saj të madhe, ajo është pasionante, ajo s'është aq e «egër» sa kujtohet. Pyesni pedagogët e matematikës, pyesni fizikanët dhe kimistët, pedagogët dhe bashkënxënësit tuaj në këto degë. Ata do t'ju bindin më mirë se unë, ata do t'ju tërheqin në këtë degë, ata do t'ju entuziazmojnë dhe duhet t'ju entuziazmojnë.

Por dikush mund të më thotë: Ju vetë, shoku Enver, thatë se s'e kishit qejf matematikën, kurse tani sa s'po i thurni edhe poezi. Unë do t'u them shoqeve dhe shokëve të mi të rinj se Partia më mësoi, lufta, puna që më ka ngarkuar Partia më vë në dukje çdo ditë rolin e madh të matematikës. Zhvillimi i tanishëm i shkencave natyrore mbështetet kurdoherë e më shumë në një matematizëm të madh. Tani jo vetëm fizika, kimia, astronomia, atomi etj. janë të lidhur ngushtë me matematikën, por duhet thënë se një shkencë ekzakte është më e përsosur kur ajo shprehet plotësisht në format matematike. Të gjithë kemi dëgjuar për makinat elektronike të llogaritjeve të çuditshme. Truri i mrekullueshëm i Inodisë<sup>1</sup> nuk e imagjiononte një gjë të tillë, të tjerë erdhën pas tij dhe krijuan «trurin» makinë matematike. E kam, pra, të drejtë të them, të dashur shokë të rinj, që matematika është një shkencë e mrekullueshme dhe po të kisha mundësi të kthehesha në moshën tuaj, po të kisha në bankën e shkollës këto mend dhe zotësi që keni ju sot, do t'i vihesha matematikës.

<sup>1</sup> Kalkulator i njohur italian i fundit të shek. XIX.

Prandaj të rinjtë dhe të rejat e vendit tonë, në masë dhe në mënyrë të organizuar, në mënyrë shkencërisht të organizuar, duhet të studjojnë shkencat, dhe t'i studjojnë ato jo përciptazi, por me rrënjë. Universiteti i Tiranës duhet të bëhet qendra për këtë qëllim, mirëpo duhet të shfrytëzohet edhe çdo mundësi tjetër që ekziston në vendin tonë. Veç kësaj, duhet të jeni në dijeni të shpikjeve dhe të studimeve të dijetarëve të huaj, të forconi lidhjet me akademitë dhe universitetet e vendeve të tjera.

Nikita Hrushovi, që është një revizionist dhe me pikëpamje antishkencore, përpiqet ta paraqitë zhvillimin e shkencës në Bashkimin Sovjetik si një dafinë të periudhës që ai erdhi atje në fuqi. Ai dhe pasuesit e tij përpiqen të errësojnë përpjekjet e vazhdueshme dyzetepesëvjeçare të shkencës dhe shkencëtarëve sovjetikë, që punuan, hodhën bazat, krijuan në kushtet e socializmit shkencor, që punuan dhe krijuan duke u udhëhequr nga marksizëm-leninizmi, të ndriçuar nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, nga Lenini, nga Stalini, që ndritën me gjenialitetin e tyre rrugën që ata përshkuan.

Hrushovi i pengon miqtë e vërtetë të Bashkimit Sovjetik të përfitojnë nga të mirat e mëdha të shkencës sovjetike, por ai është dorëlëshuar me miqtë e tij revizionistë dhe me shkencëtarët e vendeve kapitaliste.

A mund të merret me mend që në kohën e sotme të përparimit të vrullshëm të shkencës, të atomit, të triumfit mbi kozmosin, të triumfit të socializmit, të gjendet një grup njerëzish në krye të shtetit të parë socialist që t'u mbyllë dyert e shkollave, të universi-

teteve dhe të shkencës djemve dhe bijave të Shqipërisë socialiste, djemve dhe bijave të një populli të vogël, heroik dhe arsimdashës? Një veprim të tillë skandaloz e bën grupi renegat antimarksist i Nikita Hrushovit dhe ata që e pasojnë atë. As në vendet ku sundon borgjezia s'ka ndodhur një gjë e tillë!

Vetëm shovinistët, obskurantistët, megalomanët, ata që përbuzin popujt dhe masat, ata që janë të huaj me çështjen e madhe të proletariatit, mund të veprojnë kështu dhe të mendojnë se popujt e vegjël, se njerëzit e vegjël s'kanë vend në diellin e ndritur të shkencës, se këta janë të destinuar të rrojnë nën hijen e «të mëdhenjve», në bisht të «të mëdhenjve», se dituria dhe aftësia gjen vend të zhvillohet «në kokën dhe në natyrën e elitës së zgjedhur» të vetëm disa popujve dhe shteteve të mëdha e të fuqishme.

Por shkencës dhe diturisë nuk mundi t'u vinte dot fre as reaksioni më i egër klerikal i Vatikanit, bile edhe në apogjeun e tij. Pirgjet me dru të ndezur nuk e penguan Xhiordano Brunon të ngrinte zërin për të vërtetën, nuk e penguan Keplerin të shpikte teorinë e tij gjeniale dhe as Galileo Galileun të thotë «megjithatë, lëviz». Atëherë si mund t'u vihet fre sot shkencës e diturisë që të mos i përvetësojnë ose zhvillojnë dhe të tjerët, midis të cilëve dhe ne?

Dikur, ju kujtohet feudali Fejzi Alizoti se çfarë llomotiste për diturinë, për arsimin, si privilegj vetëm të klasave të pasura. Por Fejzitë i përlau pa lënë nishan revolucionin në vendin tonë, i cili vërtetoi shkëlqimisht të kundërtën e asaj që predikonin ata. Mirëpo Fejzi Alizotët s'janë zhdukur kudo, ata ringjallen edhe

atje ku mbin fara e revizionizmit dhe këta Fejzi Alizotë, kokëboshë si ai, shfaqen po me atë forcë, po me atë egërsi, por të veshur me rroba të tjera dhe me plot fjalë të thurura me demagogji të rrallë.

Kështu, asgjë nuk do ta pengojë rininë tonë studjose të thëthijë me etje të madhe diturinë, shkencën, të bëhet e zonja e vetvetes, t'i dalë zot atdheut të vet e të japë edhe kontributin e saj modest në shkencën botërore.

Së dyti, dhe kjo ka të bëjë me ngritjen e inteligjencës ekzistuese dhe rritjen e rolit të saj në ndërtimin socialist, kualifikimi i mëtejshëm duhet të jetë preokupacioni i vazhdueshëm i të gjithë kuadrove tanë. Nga kjo varet shumë edhe zgjidhja e detyrës së pregtitjes së kuadrove për të cilën folëm.

Problemin duhet ta shohim realisht, ashtu siç është, dhe ta zgjidhim në rrugë marksiste-leniniste. Zhvillimi i mëtejshëm i vendit tonë, ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit në Shqipëri, si kudo, është i lidhur me zhvillimin e shkencës. Prandaj na vihet si detyrë të mësojmë shkencat, të përfitojmë sa më shumë nga eksperiencia e përparuar botërore.

Kuadrot tanë duhet ta thithin shkencën botërore të gjithë zjarrin e shpirtit të tyre. Sigurisht në këtë shkencë botërore ka edhe plehra, por është edhe për këtë arsye që Partia u ka vënë në dorë dijetarëve tanë të vjetër e të rinj armën e marksizëm-leninizmit për të spastruar plehrat. Kur them se me të gjitha forcat duhet t'i përvishemi studimit, veçanërisht studimit të shkencave, unë u drejtohem mësuesve e pedagogëve, nxënësve e studentëve, mjekëve dhe inxhinierëve,

agronomëve e muzikantëve, me një fjalë të gjithëve.

Mësuesit, pedagogët, mjekët etj., duhet të kuptojnë rolin vendimtar të studimit, të perfeksionimit të tyre. Që nga pedagogu i universitetit dhe deri te agronomi në ara, inxhinierët e të gjitha kategorive, jo vetëm duhet të studjojnë, jo vetëm duhet të zbatojnë, por duhet edhe të shpikin edhe të racionalizojnë.

Çdo njeri, shokë, kur mbaron shkollën e lartë dhe del specialist për një degë të caktuar, me të drejtë ndien një kënaqësi të madhe për faktin që kalon një fazë të rëndësishme të jetës së tij. Kështu ka ndodhur me ne, kështu ndodh edhe tani e do të ndodhë në të ardhshmen me të tjerët. Dje ishe nxënës apo student, tani bëhesh kuadër, pedagog, drejtues. Mirëpo, kur futesh në jetën e pavarur, kur nis të merresh me sektorin tënd dhe ndeshesh me problemet më të ndryshme, mjaft nga ato të reja e të panjohura, që nga ti kërkojnë zgjidhje, kur bie në kontakt me probleme të përgjithshme, që preokupojnë mbarë popullin, ose me çështje joprofesionale, por të nevojshme për ty, kur shoqërohesh me kuadro të sektorëve të tjerë, në të gjitha këto raste, krahas me atë që je kuadër, mësues i të tjerëve, ndien se ti nuk i di të gjitha, se ke nevojë të vazhdueshme për të mësuar diçka më tepër, diçka të re. Këtë e ndien kushdo e kurdoherë. Pra, njeriu, duke qenë kuadër, është njëkohësisht nxënës, një nxënës i përjetshëm. Lind detyrimi i dyfishtë: për vete dhe për të tjerët, për shoqërinë. Që të mund të japësh, duhet vazhdimisht të marrësh diçka më tepër nga ajo që ke, të marrësh kulturë të përgjithshme e profesionale,



të cilat janë të pafund, ashtu siç është e pafund jeta me problemet e aspektet e saj.

Cila është rrugëdalja? Kryesorja në këtë, po e përsëris, është, pa dyshim, studimi i vazhdueshëm. Mirëpo shpeshherë dëgjon nga kuadrot të ankohen ose të justifikohen: na mbytën punët e përditshme dhe nuk kemi kohë për studim. Është e vërtetë, shokë, se kuadrot tanë në përgjithësi janë mjaft të ngarkuar, se mbi shpatullat e tyre qëndrojnë barrë të punëve të përditshme më të rënda se ato që qëndrojnë mbi shpatullat e kuadrove të vendeve të zhvilluara, ose të atyre që do të ketë më vonë vendi ynë. Destinacioni ynë është të heqim ca më shumë, të luftojmë në një periudhë më të vështirë, por më të lavdishme — kur po çahet traseja për marshimin e popullit tonë drejt majave më të larta të shkencës dhe drejt komunizmit. Kjo luftë i kalit njerëzit, kuadrot. Prandaj duhet e mund të përballohet edhe kjo barrë, studimi i vazhdueshëm, i cili, në fund të fundit, do të lehtësojë edhe barrën e përgjithshme në punë.

Kjo çështje ka të bëjë me një farë praktikizmi që gozhdon energjitë e kuadrove tanë. Por kjo nuk vjen vetëm nga punët e shumta, kjo vjen edhe nga mungesa e organizimit të mirë të punës, si dhe nga një koncept jo i drejtë që është krijuar te disa, për të mos shikuar përpara, më larg, perspektivën. Shpeshherë në prodhim shohim specialistë që merren jo me atë që duhet të merren, por padashur bëjnë punën e shefave të zonave, ose të reparteve dhe të brigadierëve. Kështu që ka rëndësi të përcaktohet drejt se cili është roli dhe

vendi i specialistit të lartë në këtë apo në atë sektor. Për ta përcaktuar dhe për ta organizuar këtë kushto, natyrisht, do të veprojë sipas kushteve ku punon. Por e përbashkët për specialistët e lartë të çdo lloji, për mendimin tim, është të kombinojnë praktikën, të përditshmen, punën e tyre të sotme me perspektivën, të nesërmen, të ardhshmen, në përputhje me kërkesat e planit korent dhe perspektiv. Prandaj është e nevojshme që kuadrot të merren më shumë se gjer tani edhe me përgjithësimin e eksperiencës, me studime, me punë shkencore. Një përgjegjësi të madhe për organizimin e studimeve shkencore kanë dikasteret e institucionet e ndryshme, të cilat, për fat të keq, këtë detyrë akoma s'po e kryejnë të gjithë mirë. Jeta, prodhimi, sektorët ku punohet ngrenë mjaft probleme që, në mos tani, në të ardhshmen do të kërkojnë zgjidhje. Atëherë t'u dilet atyre përpara, t'u hyhet me guxim e në mënyrë sa më të organizuar dhe do të shikohet se do t'u dilet mbanë, ashtu siç ua kanë dalë e po ua dalin mjaft specialistë. Por që të mund të bëhet kjo, duhet punuar dhe njëkohësisht duhet studjuar në mënyrë sistematike nga specialistët. Sigurisht në këtë influencën edhe kujdesi që duhet të tregojnë drejtuesit e ndërmarrjeve apo të institucioneve për t'u krijuar specialistëve kushte sa më të favorshme për një gjë të tillë. Ata duhet, së pari, ta kuptojnë drejt rëndësinë e kësaj gjëje dhe pastaj t'i ndihmojnë, t'i çlirojnë nga detyrat administrative, burokratike dhe nga punë të tjera që s'u përkasin atyre, t'i nxitin dhe t'u kërkojnë llogari lidhur me studimet e tyre.

## Ku duhet t'i drejtojmë studimet tona?

Pas gjithë sa thamë, del një pyetje e tillë: Ku duhet t'i drejtojmë studimet tona? Më duket se çështja nuk është e thjeshtë që mund t'i përgjigjemi me dy fjalë: atje ku ka më shumë nevojë. Meqenëse ne jemi një vend që po zhvillohemi më vonë se shumë vende të tjera dhe nevojat tona janë të shumta, pritet që studjuesit, kërkuesit dhe shkencëtarët tanë të thonë fjalën e tyre në të gjitha fushat. Por kjo është e pamundur, në radhë të parë, sepse forcat tona, qoftë në njerëz, qoftë në mjete, janë të pakta.

Përsa u përket shkencave konkrete, atyre teknike dhe të natyrës, kjo është më e qartë dhe më e lehtë për t'u përcaktuar. Vendi ynë ka hyrë në rrugën e zhvillimit të shpejtë për krijimin e bazës materialo-teknike të socializmit, të industrializimit të vendit, të intensifikimit të bujqësisë. Zhvillimi i minierave, elektrifikimi i vendit, zgjerimi i ndërtimeve, degët e ndryshme të industrisë, si ajo mekanike, kimike, e lehtë, ushqimore etj., zhvillimi i bujqësisë, si tërë kulturat e drithit, kulturat teknike, blegtoria etj., kërkojnë jo vetëm më shumë inxhinierë, agronomë, teknikë e punëtorë të kualifikuar, por ngrenë para nesh një sërë problemesh të rëndësishme, të cilat duhen zgjidhur, në qoftë se nuk duam të pengojmë zhvillimin tonë. Pra, më duket se edhe tematika e studimeve, e punës kërkuese e shkencore është e përcaktuar; ajo duhet të përqendrohet në zgjidhjen e problemeve që ngre ndërtimi ynë socialist. Nuk besoj se ndokush mund të mendojë se ne do të

merremi qysh tani me problemet e kozmosit, me teorinë e kuantëve apo me kibernetikën, as me automatizimin etj. Është krejt e drejtë të themi se do të përqendrohemi kryesisht në problemet nga zgjidhja e të cilave i hapen rrugë zhvillimit të mëtejshëm të industrisë, bujqësisë, ndërtimeve, shfrytëzimit të minierave dhe burimeve energjitike të vendit etj. Nuk besoj, gjithashtu, që ndokush mund të mendojë se ne, në këtë fazë të parë, do të merremi me çështje vetëm të një karakteri historik, lidhur, për shembull, me zhvillimin e artizanatit të ne në të kaluarën, si ndërtoheshin rrugët ose urat dikur etj. Jo sepse këto studime nuk vlejné dhe nuk na duhen, por sepse sot na preokupojnë shumë probleme të tjera, për shembull, si mund të përdoret kjo ose ajo lëndë e parë për prodhime të industrisë, si mund të ndërtojmë më mirë, më shpejt dhe më lirë rrugët e urat etj. Por a mos do të thotë kjo se duhet të merremi vetëm me probleme të një rëndësie praktike imediate? Edhe një kuptim i tillë i ngushtë nuk është i drejtë. Në qoftë se themi se do të merremi kryesisht me zgjidhjen e atyre problemeve që ngre ndërtimi ynë socialist, kemi parasysh jo vetëm problemet që na preokupojnë sot, por edhe ato që na duhen në perspektivë, lidhur me zhvillimin e ardhshëm të vendit tonë. Pra duhet të punojmë si sot për sot, ashtu edhe sot për nesër e pasnesër.

Sikundër dihet, Komiteti Qendror dhe Kongresi i 4-t i Partisë kanë aprovuar një plan të gjerë të punës kërkimore shkencore të Universitetit të Tiranës dhe të Institutit Bujqësor, i cili parashikon studime dhe punime me vlerë të madhe për vendin tonë. Në realizi-

min e tyre janë tërhequr dhe do të tërhiqen një numër i madh specialistësh të sektorëve më të ndryshëm. Pra, do të zhvillohet më tej mendimi krijues i inteligjencës sonë, ajo do të rritet më tej nga pikëpamja profesionale dhe populli do të shohë frytet e punës së saj krijuese. Detyra themelore e këtij plani perspektiv është që, pa ngadalësuar ritmin e zhvillimit të shkencave shoqërore, të zhvillohen me ritme më të shpejta shkencat natyrore e teknike, që të studjohen dhe të shfrytëzohen sa më shumë burimet e pasura natyrore të vendit tonë. Ky plan përfaqëson një fushë të gjerë studimesh, kërkimesh e punë sa të lodhshme, aq edhe të lavdishme. I tillë është, për shembull, studimi kimik dhe fizik i mineraleve të dobishme të vendit, përcaktimi, zbulimi dhe shfrytëzimi praktik i vendburimeve të reja të naftës, gazit natyror, fosforiteve, argjileve, silikateve, mineraleve metalurgjike etj., inventarizimi i bimëve të dobishme dhe i florës së Shqipërisë, studimi gjeofizik i vendit tonë, tipizimi i ndërtimeve dhe i konstruksioneve prej betonarmeje, studimi i burimeve hidroenergjitike të lumenjve, dermatomikoza e bruceleza dhe përcaktimi i masave për pakësimin ose zhdukjen e tyre etj.

Jam i bindur se për të gjithë është e qartë se këto probleme janë tani aq të shumta, sa askush nuk mund të mendojë që për zgjidhjen e tyre mund të merret një grup i vogël nga kuadrot shkencorë të universitetit ose nga teknikët tanë më të mirë. Unë dua të theksoj se në këtë punë duhet të angazhohen të gjithë kuadrot tanë, që nga ata më të kualifikuarit shkencorë, deri te specialistët që ka sot në dikasteret, te inxhinierët e tek-

nikët që kanë ndërmarrjet vetë, te agronomët e bujqësisë, bile deri te teknikët e mesëm dhe punëtorët e kualifikuar të prodhimit. Rëndësi kolosale në këto studime ka koordinimi i tyre, bashkëpunimi i shkencëtarëve të ndryshëm për probleme të tilla që kanë lidhje me më shumë se një shkencë.

Veç kësaj, në këtë duhet pasur parasysh edhe një gjë, se ne s'kemi vetëm universitetin e institutet e larta si qendra shkencore të mëdha e të rëndësishme, por kemi edhe industri, miniera, transport, bujqësi ku inxhinierë dhe punëtorë të kualifikuar punojnë në fabrika, në ara dhe në laboratorë, krijojnë gjëra të mrekullueshme që pasurojnë shkencën. Sidomos sot ekziston një entuziazëm i tillë në punë, kur njerëzit e thjeshtë s'i zë gjumi natën dhe përpiqen të futen në të fshehtat e teknikës e të shkencës për të çuar përpara prodhimin. Për këtë dëshmojnë më së miri rezultatet e konsultave popullore, ku u bënë 10 500 propozime, nga të cilat u aprovuan në mënyrë paraprake 7 000, me një vleftë prej 500 milion lekësh. Prej këtyre propozimeve 150 janë për ngritje fabrikash, repartesh e punishtesh të reja, kurse mijëra të tjera janë për prodhimin në vend të shumë makinerive, pajisjeve, pjesëve të këmbimit etj., që sillëshin nga jashtë. Këtu kuadrot mund e duhet të gjejnë një mbështetje të madhe e një burim të pashtershëm frymëzimi për punën e krijimet e tyre.

Le të marrim konkretisht një nga fushat më të rëndësishme të ekonomisë, ku është përqendruar një pjesë e mirë e specialistëve tanë dhe që tani tërheq shumë vëmendjen e Partisë dhe të Qeverisë. E kam fjalën për bujqësinë. Dihet se Kongresi i 4-t i Partisë

caktoi detyrën për kalimin e bujqësisë sonë nga një bujqësi ekstensive në një bujqësi intensive. Ky përcaktim nuk është bërë në mënyrë arbitrare, por pas një studimi të thellë e shkencor të kushteve e nevojave tona në rrugën e ndërtimit socialist.

Ju e dini që në krahasim me paraluftën, ne e kemi rritur sipërfaqen e tokës nën kulturë 64 për qind, kurse prodhimin e përgjithshëm bujqësor, në më se dyfish, mirëpo edhe popullsia është shtuar më se gjysmë milioni banorë. Nesër, të themi, më 1980, me ritmin që rritet popullsia te ne, ajo do të shtohet me rreth 1 milion banorë, plus kësaj kërkesat do të jenë më të larta, kurse kufiri maksimal i tokave nën kulturë në vendin tonë është deri në 700 mijë hektarë tokë, nga 484 000 që kemi tani. Ne këtë shtrirje do ta bëjmë, por a është ajo e mjaftueshme të kënaqë nevojat e popullsisë me rendimentet e sotme? Sigurisht që jo. Atëherë rruga e daljes për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit është kalimi në bujqësinë intensive, rritja e rendimenteve të kulturave për të njëjtën sipërfaqe. Mirëpo ju e kuptoni se ta bësh një gjë të tillë, nuk është një fjalë goje, nuk është lehtë. Këtu del në plan të parë shkenca, agroteknika e lartë, sepse, për të rritur rendimentet, duhen zgjidhur shkencërisht një varg problemesh dhe duhen zbatuar në mënyrë praktike një tok masash. Të tilla janë, për shembull, shtrirja e renditja e drejtë e kulturave bujqësore sipas zonave, tokës dhe parabi-mëve, studimi dhe aplikimi i punimeve të thella sipas llojeve të tokave e bimëve, shtimi e përdorimi i drejtë i plehrave, lufta kundër lagështirës, erozionit, thatësisë, ujitja, riprodhimi i farërave më të mira në bazë të

një rajonizimi të drejtë, mbjellja në kohë optimale e sigurimi i bimëve për hektarë, shërbimet kulturore, lufta kundër dëmtuesve, sëmundjeve e barërave të këqija dhe organizimi i korrjeve, shirjeve e grumbullimit pa firo. Mirëpo këto s'janë gjëra të thjeshta, këto janë shkencë. Nuk po flas për rezervat e brendshme në bujqësi, që duhen shfrytëzuar, për luftën që duhet bërë për t'i marrë tokës 2 dhe 3 prodhime në vit etj. Vëmendjen ne do ta përqendrojmë në radhë të parë te drithërat e bimët industriale, pa lënë pas dore të tjerat. Drithërat janë buka e popullit, bimët industriale janë buka e industrisë. Ne i hodhëm poshtë pallavrat e Titos për të mbjellë vetëm lule dielli, se gjoja grurin do të na i sillte ai nga Vojvodina; gjithashtu «këshillat» e Hrushovit që të mbillnim vetëm pemë e vreshta, se grurin do të na e jepte ai nga prodhimet e tokave të reja që, siç pat thënë aq sa na duhej neve, ia «hanin minjtë», por që s'ia dha popullit tonë kur ai pat nevojë. Për të kryer këto detyra ne do ta përqendrojmë vëmendjen, sidomos në rrethin e Fierit, të Lushnjës, të Durrësit, të Korçës pastaj edhe të Shkodrës, të Elbasanit e të Beratit, që janë hambari i Shqipërisë, pa lënë pas dore rrethet e tjera.

A mundet që këto detyra të kryhen pa pjesëmarrjen e të gjithë specialistëve tanë të bujqësisë, duke filluar nga ata që merren që tani me zgjidhjen e një sërë problemesh të rëndësishme shkencore, deri te agronomi e tekniku bujqësor në fshat? Nuk ka dyshim se këtu kërkohet pjesëmarrja e të gjithëve për të zgjidhur edhe problemet e sotme edhe ato të perspektivës, si në bujqësi ashtu edhe në blegtori.



Edhe në fushën e shkencave shoqërore duhet të bëhen mjaft studime. Temat me karakter historik kanë, sigurisht, një rëndësi të veçantë, sepse në të vërtetë shumë çështje kanë mbetur akoma të pastudjuara, ose ka pasur edhe shtrembërime në të kaluarën. Temat në lidhje me revolucionin popullor dhe transformimet socialiste në vendin tonë, ku mund të bëhen edhe përgjithësime teorike, të cilat kanë vlerë jo vetëm për ne, por edhe për të tjerët, duhet të tërheqin vëmendjen tonë. Ne duhet të trajtojmë edhe shumë çështje në lidhje me rrugën nëpër të cilën ka ecur vendi ynë gjatë kësaj periudhe. Por nuk do të ishte e drejtë që të priremi vetëm nga temat historike dhe t'u shmanlemi temave aktuale, problemeve të ndërtimit socialist sot dhe atyre të perspektivës, të cilat presin zgjidhje. Të shpjegojmë drejt atë që është bërë, si Partia ka zgjidhur një sërë problemesh, për shembull, si u krye kolektivizimi i bujqësisë te ne, është një gjë e dobishme, por të tregosh si do të zgjidhen problemet që na dalin sot për forcimin ekonomik e organizativ të kooperativave, për shembull, si do të bëhet perfeksionimi i marrëdhënieve socialiste në fshatin tonë, është një gjë tjetër shumë e dobishme, praktike dhe që jep rezultate konkrete për të çuar përpara sistemin tonë kooperativist. Shembuj të tillë mund të sillen shumë edhe për rrugët e industrializimit të mëtejshëm të vendit, të progresit teknik te ne, për rolin e Partisë, të shkollës sonë dhe të organizatave shoqërore në edukimin e njeriut të ri etj. Siç e shikoni, në këto drejtime hapet një punë e madhe përpara ekonomistëve, filozofëve, pedagogëve tanë etj.

Por duhet thënë se studimet mbi çështjet aktuale dhe të perspektivës paraqitin vështirësi më të mëdha, sepse të shpjegosh fenomenet që ndodhin përditë përpara syve tanë, të kuptosh tendencat e zhvillimit të tyre dhe të nxjerrësh konkluzione të drejta për të nesërmen, në një kohë kur nuk disponon të dhëna e dokumente të plota, siç mund t'i kesh ato për ngjarjet që kanë ndodhur 5-20 ose 50 vjet më parë, është shumë më e vështirë. Mirëpo a mund të jetë kjo një arsye për t'iu shmangur trajtimit të këtyre temave? Etapa e re në të cilën ka hyrë tani vendi ynë, etapa e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, ngre para nesh probleme me rëndësi, të cilat duhen studjuar, siç mund të jenë: rrugët e krijimit të bazës materialo-teknike të socializmit, rrugët e industrializimit të vendit tonë dhe të kthimit të bujqësisë nga ekstensive në intensive, ligjet e përgjithshme dhe veçoritë e ndërtimit socialist në këtë etapë të re, shteti dhe zhvillimi i demokracisë socialiste etj., etj. Në këtë mënyrë do të bëjmë që studimet e ndryshme në fushën e shkencave shoqërore do t'i shërbejnë më mirë ndërtimit tonë socialist.

Lidhur me shkencat shoqërore do të doja të thosha dy fjalë edhe për një fushë shumë të rëndësishme dhe aktuale, për albanologjinë. Në kuadrin e festimit të 50-vjetorit të Pavarësisë dhe 18-vjetorit të Çlirimit, në Tiranë do të mbahet konferenca e albanologëve, ku janë ftuar të marrin pjesë edhe një numër i madh albanologësh nga vendet socialiste dhe kapitaliste. Shkencëtarët tanë, që janë edhe organizatorët e kësaj mbledhjeje, do të mbajnë aty referatet kryesore dhe një numër kumtesash. Ata, pra, do t'u japin miqve të huaj

rezultatet e punës së tyre dhe kjo do t'i ndihmojë këta në punën e tyre të mëtejshme, por, natyrisht, edhe albanologët e huaj do t'u japin tanëve rezultatet e punës së tyre. Rëndësi të madhe ka fakti që shkencëtarët tanë tani nuk janë në bisht, por në krye të shkencës së albanologjisë, se këtë tani e kanë në dorë kryesisht vetë njerëzit tanë, ashtu siç kanë në dorë edhe të gjitha shkencat e tjera në vendin tonë. Dhe kjo është arritur në saje të studimeve e të punës së tyre të palodhur.

Por, megjithatë, shokë, në këtë fushë mbetet akoma për të bërë shumë. Kështu, një sërë problemesh të mëdha e të rëndësishme kanë për të zgjidhur shkencat historike filologjike. Etnogjeneza e popullit shqiptar është një problem sa i rëndësishëm, aq edhe kompleks, për studimin e të cilit do të nevojitet aktivizimi dhe bashkëpunimi i mjaft punonjësve shkencorë. Studime më të thelluara kërkojnë problemet e kombësisë dhe të kombit shqiptar, si dhe të lëvizjeve të mëdha të shekullit tonë. Në fushën e kulturës materiale të popullit tonë duhet të zgjerohet e të thellohet puna kërkimore shkencore për kulturën e hershme shqiptare, për artin mesjetar, të hershëm dhe të vonë, për arkitekturën popullore, stilet, shkollat dhe veçoritë e tyre. Një problem i rëndësishëm është edhe ai i sintetizimit shkencor të të gjithë materialit etnografik lidhur me përpilimin e atlasit etnografik. Që gjuhësia shqiptare të ndihmojë me studimet e saj në problemin e madh të normalizimit të gjuhës letrare shqipe, duhet vazhduar më tej puna e filluar për të përpiluar gramatikën shkencore shqipe, fjalorin e mesëm të gjuhës sonë me orientim normativ, duhen bërë studime më të thellua-

ra në fushën e dialektologjisë dhe të hartohet atlas i dialektologjik.

Unë, shokë, këtu përmenda vetëm disa probleme kryesore, kurse ka edhe shumë të tjera. Në studimin dhe në zgjidhjen e tyre, pra, duhet të përqendrohet vëmendja dhe puna krijuese e kuadrove tanë.

**Kuadrot e çdo specialiteti duhet të njohin  
shkencën marksiste-leniniste dhe ta studjojnë  
atë vazhdimisht**

Por që kjo punë të mund të bëhet sa më e frytshme, është e domosdoshme që kuadrot e çdo specialiteti, qofshin ekonomistë apo historianë, inxhinierë apo agronomë, gjeologë, mjekë apo shkrimtarë dhe artistë, të njohin shkencën bazë, shkencën marksiste-leniniste, ta studjojnë atë vazhdimisht. Kjo është e nevojshme, sepse filozofia marksiste-leniniste u jep atyre njohuri të vërteta shkencore mbi ligjet e përgjithshme të zhvillimit të natyrës, të shoqërisë dhe të mendimit. Të gjitha shkencat kanë të bëjnë me natyrën, me shoqërinë dhe me mendimin, prandaj zotërimi i ligjeve të përgjithshme të zhvillimit të tyre ndihmon studimet në çdo fushë të shkencës, u jep shkencëtarit, shkrimtarit ose çdo specialisti tjetër kyçet për të studjuar dhe për të shpjeguar drejt fenomenet e ndryshme në natyrë ose në shoqëri. Si mundet specialistët tanë të shoqërisë socialiste, ose, më konkretisht, për shembull, historianët tanë t'i interpretojnë drejt faktet e dokumentet, të nxjerrin prej tyre konkluzione të drejta, pa njohur

thellë ligjet e përgjithshme të zhvillimit të shoqërisë, formacionet shoqërore, zhvillimin ekonomik të vendit në një kohë të caktuar, kryqëzimin e interesave të klasave të ndryshme etj., që i kanë mësuar në një farë mase qysh në shkollë? E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ekonomistin. Fizika, kimia dhe shkencat e tjera konkrete, siç dihet, kanë ligjet e tyre të veçanta, me studimin e të cilave merren këto shkencë që përbëjnë objektin e tyre. Por bota në tërësi, universi ynë, materia si nocion filozofik, ka ligjet e saj të përgjithshme të zhvillimit, ajo nuk ka as fillim, as fund, është e përjetshme dhe të gjitha proceset fizike, kimike etj. nuk janë tjetër veçse procese të zhvillimit të materies. Nga kjo kuptohet se për të studjuar, pra, proceset fizike e kimike të trupave dhe të lëndëve të ndryshme, është e domosdoshme që shkencëtari ynë, inxhinieri, agronomi etj. të kenë një kuptim të drejtë e të thellë mbi botën në tërësi. Mund të vazhdoj të përmend se sa e nevojshme është për shkrimtarin e artistin të njohë ligjet e zhvillimit të mendimit, proceset psikike të njeriut, rolin e kushteve materiale të jetesës në formimin e ideve të personazheve që ata krijojnë në veprat e tyre. Ja, sepse Partia ngul këmbë me shumë të drejtë që të punohet pa u lodhur për përvetësimin e marksizëm-leninizmit, të studjohet në mënyrë individuale ose në format e organizuara nga Partia dhe nga të gjithë pa përjashtim.

Ka në botë injorantë dhe reaksionarë që thonë se ne komunistët duam t'i atribuojmë marksizëm-leninizmit edhe veprat e atyre shkencëtarëve të lashtë e të rinj që s'dinin dhe s'dinë ç'është marksizëm-leninizmi,

që s'janë marksistë, dhe disa bile janë edhe kundërshtarë të tij. Kjo s'është aspak kështu, këtu nuk është puna, te përvetësimi i këtij ose atij shkencëtari, të lindur në këtë ose në atë vend, bir i këtij ose atij populli. Por është fakt se as Dekarti dhe as Pavllovi, as xhansenisti Paskal dhe as shkencëtari Bogomolec e mijëra të tjerë shkencëtarë të dëgjuar të çdo kohe nuk njihen nga njerëzimi pse venin në kishë, ose i bënin nga ndonjë lutje zotit, por njihen për veprat e tyre racionale, përparimtare, materialiste, antiklerikale, antimistike. Metoda e tyre në përgjithësi, në disa drejtime, ka qenë dialektike, ndonëse jo e përkryer, siç ta jep marksizëm-leninizmi. Doktrina marksiste-leniniste është sumumi i shkencës materialiste dhe i zhvillimit të shoqërisë njerëzore, është sinteza e zhvillimit të mëparshëm të filozofisë, e përgjithësisht të mendimit krijues të njerëzimit, sinteza e çdo gjëje racionale dhe përparimtare që ka luftuar në të gjitha epokat dhe në forma të ndryshme kundër bestytive, magjive, mistifizimit, injorancës, shtypjes morale dhe materiale të njerëzve; kjo doktrinë tani është bërë pishtari që ndrit rrugën e popujve drejt socializmit dhe komunizmit. Prandaj sot, kur ekziston një shkencë e tillë e plotë, siç është marksizëm-leninizmi, që na jep kuptimin e drejtë materialist mbi botën dhe metodën më të mirë shkencore, metodën dialektike marksiste, është e pafalshme për shkencëtarët dhe specialistët tanë të mos e përdorin atë në interes të studimeve në të gjitha fushat. Dhe nuk duhet t'i vijë zor asnjërit të fillojë qoftë edhe nga studimi i nocioneve të para të marksizëm-leninizmit, ose, kur nuk di këtë apo atë çështje, të konsultohet

me ndonjë specialist për këtë punë, qoftë ky edhe më i ri në moshë. Për çështjen e Partisë dhe të popullit, cilido prej nesh është gati që një «turp» të tillë «ta hajë me bukë».

Thamë se marksizëm-leninizmi na jep njëkohësisht edhe metodën më shkencore për studimin dhe njohjen e botës që na rrethon, metodën dialektike marksiste. Dihet se ndjekja e kriterëve të drejta shkencore në studimin dhe në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, përpunimi i një metodologjie të drejtë, ka një rëndësi të madhe për të pasur suksese në çdo fushë të krijimtarisë së kuadrove tanë të specialiteteve të ndryshme. Kjo çështje ka preokupuar kurdoherë ata që janë marrë me punë shkencore dhe eksperiencia ka vërtetuar, bile shumë kohë përpara Marksit dhe Engelsit, epërsinë e metodës dialektike. Por merita e madhe e Marksit, e Engelsit dhe më vonë e Leninit dhe e Stalinit qëndron në çështjen se ata na dhanë metodën më të plotë dialektike, të vetmen metodë shkencore, dialektikën materialiste, dhe shembullin më të mirë të përdorimit të saj në studimin e fenomeneve të natyrës dhe të shoqërisë.

Unë nuk kam ndër mend të flas këtu hollësisht mbi metodën dialektike marksiste. Por ajo që dua të theksoj është se përvetësimi i kësaj metode është i domosdoshëm për të çuar përpara me hapa të shpejta shkencën tonë të re. Dua të theksoj, gjithashtu se, që ta përvetësosh atë, nuk është një gjë e lehtë, nuk mjafton të dish përmendësh ligjet e saj të përgjithshme, por duhet që ajo të udhëheqë dhe të bëhet metodë pune në studim, në gjithë veprimtarinë praktike, në punën

shkencore, me një fjalë kudo dhe kurdoherë. Receta në këtë çështje nuk mund të ketë. Bile duhet thënë se recetat, skemat dhe «normat» e vendosura që më parë dëmtojnë shumë, ashtu si në fakt edhe kanë dëmtuar. Kohët e fundit na ka rënë rasti të diskutojmë për disa çështje të historisë së Partisë sonë, ose përgjithësisht të studimeve historike, me disa shokë që janë marrë dhe merren me këto punë. Skematizmi në çështjet e historisë së Partisë sonë shprehet sidomos kur për strategjinë, taktikën dhe etapat e zhvillimit të revolucionit tonë etj. u përmbahemi disa skemave e kallëpeve. Por revolucionet, shokë, nuk bëhen, pra edhe historia e revolucionit tonë popullor nuk mund të shkruhet në bazë të normave të dhëna, skemave e kallëpeve. Ky është një trajtim i përceptë dhe joshkencor i sendeve, një largim nga realiteti objektiv. Studjoni me kujdes faktet e ngjarjet, dokumentet dhe fenomenet e ndryshme, i analizoni ato në bazë të metodës dialektike marksiste dhe do të shikoni se Partia jonë i ka zbatuar në një mënyrë krijuese mësimet e Leninit dhe të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit në kushtet konkrete të vendit tonë.

Ose le të marrim çështjet e historisë së vendit tonë përgjithësisht. Dihet se botëkuptimi dhe metoda luajnë një rol të rëndësishëm në analizën dhe në interpretimin e fakteve historike, po, kur kemi parasysh se te të huajtë, që janë marrë deri para Çlirimit me historinë e Shqipërisë, kanë influencuar edhe interesat e vendeve të tyre imperialiste e shoviniste, del qartë se historiografia jonë nuk mund të qëndrojë skllave e disa «normave» të vendosura nga historianët borgjezë të



huaj ose të vendit. Për fat të keq, ndodh në disa raste që në studimet e ndryshme disa nga njerëzit tanë nuk shkëputen lehtë nga «normat» e gjetura dhe influencohen ose tërhiqen nga «autoritetet» e huaja.

Përsa u përket shkencave shoqërore, duhet që, në dritën e marksizëm-leninizmit, të bëhet analiza dhe interpretimi i drejtë i faktëve dhe, në qoftë se në këtë dritë do të rrëzohen disa «norma», s'ka pse të ngurrohet, pavarësisht se ndokush do të habitet dhe do të rrudhë buzët. Ne i përmbahemi fort parimit se historia nuk shkruhet sipas qejfit të njërit dhe të tjetrit, por në bazë të dokumenteve, fakteve, ngjarjeve etj. Por këto të dhëna duhen interpretuar drejt dhe i vetmi interpretim i drejtë është ai që bazohet në materializmin historik. Historianët borgjezë na akuzojnë se ky është interpretim tendencioz dhe thonë se gjoja ata janë «të paanshëm». Kjo është «kënga e Mukës» e tyre, por le të vazhdojnë t'i bien këtij avazi, ne le të bëjmë punën tonë. Ne nisemi nga ajo se, për të arritur në konkluzione të drejta, është e domosdoshme që çdo gjë të shihet me syrin kritik, në kuptimin shkencor të kësaj fjale, të luftohen dogmat e skemat, t'i jepet prioritet kryesorës, pa nënvleftësuar gjërat e dorës së dytë, të mos grumbullohen faktet si qëllim në vetvete, por të shoqërohen me analiza, të interpretohen drejt influencat e faktorëve të ndryshëm (për shembull, të jashtëm dhe të brendshëm), të përcaktohet drejt shkaku i aksionit dhe objektivi i tij etj.

Kurse përsa u përket shkencave konkrete, duhet që, duke ndjekur nga afër zhvillimin e madh të shkencave në botë, të studjojmë problemet që ngre përpara

nesh zhvillimi i ekonomisë dhe i teknikës sonë. Përparimi i shpejtë i vendit tonë në rrugën e socializmit, siç e pamë më lart, shtron përpara specialistëve tanë shumë probleme, të cilat nuk i gjejmë gjithmonë të zgjidhura nga të tjerët. Duhet të jetë e qartë se ne vetë dhe jo të huajtë do të merremi me këto çështje dhe do t'i zgjidhim këto probleme. Sigurisht nuk është nevoja që ne të ecim nëpër një rrugë të gjatë, siç kanë ecur të tjerët, por as të mos mendojmë se çdo gjë mund ta gjejmë gati, mjaft të hapim librat. Pra, rruga e shkencës nuk është e lehtë, ajo është e vështirë dhe kërkon punë e këmbëngulje.

Prandaj lidhur me problemin e studimeve desha të theksoj edhe një gjë: atë të rëndësisë së regjimit të studimit. Çështja e regjimit të studimit është jetike për kuadrot. Sa kohë ata ishin nxënës, këtë e organizonte shkolla, pedagogu, mirëpo kur dalin në jetë të pavarur, këtë duhet ta bëjnë vetë. Specialisti, nëse do të ecë bashkë me kohën, dhe bile të ecë më shpejt se koha, duhet të studjojë me regjim, të jetë në kontakt të vazhdueshëm me librat dhe me revistat.

Lind pyetja: Çfarë të lexojmë dhe si të lexojmë? Njeriu mund të lexojë çdo gjë, literaturë artistike, speciale etj., nga të gjitha mund të përfitojë. Bile kuadrot kanë nevojë ta zgjerojnë sa më shumë horizontin e kulturës së tyre të përgjithshme duke lexuar libra nga më të ndryshmit, gjë që do të ndihmojë edhe në punën speciale. Por askush nga ne nuk mund ta kuptojë, për shembull, se si një specialist do të lexonte vetëm letërsi artistike dhe nuk do të lexonte literaturë tekniko-shkencore të specialitetit të tij. Veç kësaj, duhet

lexuar, por edhe duhen studjuar librat, ata nuk duhen lexuar vetëm sa për të kaluar kohën, por duke u thelluar në ta, duke mbajtur shënime, duke bërë konspekte etj.

Një çështje me rëndësi është sigurimi dhe shfrytëzimi i librave tekniko-shkencorë. Për këtë ne po marrim masa që të sigurojmë sa më shumë literaturë të tillë. Por libra ka edhe tani. Të tillë kanë vetë kuadrot, ka Biblioteka Kombëtare, ajo e universitetit dhe bibliotekat e dikastereve e të rretheve. Por, me sa jam informuar unë, ata nuk shfrytëzohen si duhet, ose shfrytëzohen shumë pak. Është e nevojshme, pra, që ata të merren dhe të lexohen. Këtu, pa dyshim, pengon edhe gjuha, sepse mundësitë tona për ta përkthyer e botuar literaturën tekniko-shkencore akoma janë të pakta. Prandaj çdo specialist duhet të luftojë të zotërojë të paktën një-dy gjuhë kryesore, që të mund t'i shfrytëzojë si duhet librat e revistat në gjuhë të huaja. Por, nga ana tjetër, duhen bërë përpjekje që edhe literatura jonë shqipe shkencore të zgjerohet me anë të botimit të veprave të autorëve tanë, si dhe me anë të zgjerimit e sidomos të përmirësimit të buletineve shkencore, të cilat duhet të kenë një problematikë më të studjuar dhe të pasur.

Rëndësi të veçantë për kualifikimin e kuadrove ka organizimi sa më i mirë i aspiranturës dhe i formave të tjera, si seminaret, sesionet shkencore etj. Kjo do t'u hapë atyre rrugën për t'u bërë shkencëtarë të vërtetë. Siç dihet, deri tani në këtë drejtim është bërë një farë pune, por e paktë. Ne kemi 37 vetë që e kanë mbaruar dhe 91 të tjerë që e vazhdojnë aspiranturën. Ndërsa

kuadro me tituj e grada shkencore kemi mbi 100. Pra, në krahasim me nevojat tona, nuk jemi mirë. Çështja është, shokë, që në këtë punë të tërhiqen sa më shumë kadro, të zhvillohen te ata dëshira e vullneti për të mos mbetur në vend, po për të vazhduar punën me durim e këmbëngulje, që të ngjiten shkallë-shkallë në majat e shkencës. Edhe në këtë gjë ne duhet të mbështetemi kryesisht në forcat tona, pasi mundësia për të vazhduar specializimin më tej në Bashkimin Sovjetik ose në vendet e tjera socialiste të Evropës, siç e dini, na është hequr, ose kufizuar shumë. Për ta zhvilluar më tej këtë punë, duhet vlerësuar më mirë aspirantura. Rëndësi në këtë duhet t'u jepet zgjedhjes dhe caktimit të temave të tyre në përputhje me planin tematik të punës shkencore, si dhe me problemet e prodhimit, në mënyrë që t'i jepet fund një farë spontaneiteti që vihet re në këtë çështje.

Veç kësaj, pranë katedrave e gjetkë duhet të zhvillohet një veprimtari e dendur shkencore, duhet të organizohen më mirë e më shpesh, në bashkëpunim të ngushtë me dikasteret përkatëse, seminarët, informacionet dhe sesionet shkencore, ku nëpërmjet referateve e diskutimeve serioze dhe të lira, pa interpretime arbitrare dhe, pa i hedhur jashtë *a priori* tezat e reja me anë epitetesh politike, të nxirren në shesh gjërat e shëndosha, të përgjithësohet eksperiencia dhe kadrot të vihen në korent mbi të rejat e shkencës e të teknikës dhe mbi rezultatet e kongreseve apo konferencave ndërkombëtare.

Këtu desha, shokë, të theksoj dhe dy gjëra. Nga një anë, krahas diskutimeve të organizuara, duhet luf-

tuar që edhe në jetën e përditshme, në kohën e lirë, të krijohet një atmosferë shkëmbimi e rrahje mendimesh e problemesh midis kuadrove, në mënyrë që të përfitohet kudo dhe sa më shumë. Nga ana tjetër, këto nuk duhet të ngatërrohen me grindjet personale apo profesionale, që vihen re ndonjëherë aty-këtu midis specialistëve dhe që, kurdoherë, por veçanërisht sot, jo vetëm nuk sjellin dobi, por janë edhe të dëmshme.

Po kështu duhet të organizojmë e duhet të zgjerojmë caktimin e asistentëve pranë shkencëtarëve më të vjetër e më të shquar, në mënyrë që edhe t'i ndihmojmë këta të fundit në punimet e në studimet e tyre, edhe vetë të specializohen e të përfitojnë sa më shumë. Një gjë e tillë, për shembull, do të ishte mjaft e dobishme për mjekët e rinj që sapo mbarojnë universitetin; ata kanë nevojë të praktikohen për një farë kohe pranë specialistëve dhe qendrave kryesore dhe pastaj të venë kudo ku ka nevojë, për të punuar në mënyrë të pavarur. Por kuptohet se një gjë e tillë duhet organizuar edhe me kuadrot e rinj të specialiteteve të tjera. Në të njëjtën kohë është e nevojshme të mendohet edhe për krijimin e instituteve shkencore të specializuara, si dhe për organizimin e formave të tjera që mund të ndihmojnë në kualifikimin e kuadrit, siç mund të jenë byrotë teknike e shkencore pranë ndërmarrjeve, këshillat tekniko-shkencore në bazë rrethesh për grupe specialistësh të ndryshëm etj. Në këtë mënyrë, gradualisht, do të krijohet në vendin tonë një bazë e gjerë kuadrosh shkencorë, që është e nevojshme edhe për perspektivën e mëtejshme, sepse kështu ne do

të kemi mundësi të krijojmë kushtet e duhura që në një të ardhshme jo shumë të largët të kemi edhe akademinë tonë të shkencave.

**Lidhja me popullin është burimi kryesor  
i frymëzimit, mbështetja kryesore  
për vepra të mëdha**

Të gjitha këto që thashë, shokë, mund të ndihmojnë që intelektualët të qëndrojnë, si kurdoherë, në lartësinë e detyrave të tyre para popullit e atdheut. Dhe, siç e dini, objektivi është populli, mirëqenia e tij e lartë. Mirëpo një gjë e tillë nuk mund të arrihet kurrsesi duke u mbyllur ata në guaskën e tyre, duke vlerësuar vetëm mendjen e tyre, duke u dhënë vetëm pas profesionit e çdo gjëje që ka të bëjë me të, duke mos çarë kokën se çka ngjet rreth tyre, duke u shkëputur nga populli. Lidhja me popullin që na ka lindur e për të cilin luftojmë, që është krijuesi i të gjitha vlerave morale e materiale, është burimi kryesor i frymëzimit, mbështetja kryesore për vepra të mëdha, për gëzim e lumturi. Këtë ne duhet ta mbajmë mend kurdoherë. Popullit tonë nuk i duhen mizantropë e egoistë, sado njerëz të zotë që ata të jenë. Ai ka nevojë për njerëz që e vlerësojnë gjeninë e tij, për njerëz të gjallë, optimistë, që i ndodhen pranë në çdo moment, që ndajnë me të gëzimin e hidhërimit, që e ndihmojnë të kapërcejë vështirësitë, që djersiten bashkë me të. Spektatorët dhe kapadainjtë populli nuk i duron dot.

Prandaj është e nevojshme që specialistët të mbaj-

në kurdoherë lidhje sa më të ngushta me popullin, me klasën heroike punëtorë, me fshatarësinë tonë kooperative. Kjo ka rëndësi të dyfishtë: nga njëra anë, të njihen me prodhimin e me njerëzit e prodhimit, të mësojnë prej tyre nga eksperiencia e tyre, të lidhin teorinë me praktikën; nga ana tjetër, t'i mësojnë ata në punë, t'u japin teorinë, diturinë e tyre profesionale. Sa në pozitë të vështirë e vënë veten ata që nënvleftësojnë praktikën, eksperiencën e masave dhe që preferojnë rehatinë e tyre, mundohen të zënë një vend «të ngrohtë», diku në qytet a kryeqytet dhe i shmangen minierës, apo fshatit, ku punojnë dhe luftojnë njerëz me një eksperiencë kolosale shumëvjeçare! A është e drejtë kjo? Sigurisht që jo. Dhe jo vetëm sepse nuk përmbushen si duhet nevojat e popullit, por edhe sepse nga rehati personal rrezikohe të biesh në apati, në amullinë e mendimit e të veprimit shkencor; kurse për zhvillimin e këtij të fundit fshati, miniera etj. paraqitin një terren mjaft të pasur e të gjallë.

Nga ana tjetër, është e nevojshme që kuadrot të merren edhe me punë shoqërore edhe t'u mësojnë masave atë kulturë të përgjithshme që u ka dhënë Partia dhe populli. Sepse dituritë tona janë në radhë të parë pasuria e të gjithë popullit. Të mos u shmangemi, pra, punëve shoqërore, siç bëjnë disa, nën pretekstin e punëve të mëdha që gjoja i kanë mbuluar gjer në grykë. Nuk ka e nuk mund të ketë punë më të madhe e të rëndësishme sesa të punosh me popullin.

Kusht tjetër i domosdoshëm për të kryer me sukses detyrat dhe për të merituar me të vërtetë titullin e lartë të intelektualit popullor, është lufta për t'u ngri-

tur sa më shumë nga pikëpamja politike dhe ideologjike.

Në fakt, ne kemi një inteligjencë që në përgjithësi është mjaft e ngritur nga pikëpamja politike dhe ideologjike. Kjo ka gjetur shprehjen e vet jo vetëm në pjesëmarrjen aktive në ndërtimin e socializmit, por edhe në qëndrimin parimor e konsekuent e në pjesëmarrjen aktive të saj edhe në luftën e Partisë në fushën politike e ideologjike. Le t'i referohemi, për shembull, qëndrimin të intelektualëve në çështjen e luftës parimore të Partisë sonë kundër revizionizmit modern të grupit Hrushov-Tito, vendosmërisë së tyre të paturtur për krahu Partisë në momentet politike më të vështira. Nuk ka intelektual që të mos e ketë ndier veten krenar për ndershmërinë dhe guximin e pashembullt me të cilin Partia jonë ka mbrojtur dhe mbron marksizëm-leninizmin dhe interesat e popullit të saj nga intrigat dhe komplotet e grupit të Titos, Hrushovit dhe pasuesve të tyre, pavarësisht se ne jemi një popull i vogël që jetojmë, luftojmë dhe triumfojmë të rrethuar nga armiq; nuk ka te ne intelektual të tillë që të mos ketë luftuar së bashku me Partinë për të përballuar dhe për të thyer shigjetat e helmatisura të imperialistëve dhe të veglave të tyre, revizionistëve modernë.

Megjithatë ne prapëseprapë nuk duhet të kënaqemi me kaq, sepse problemet politike e ideologjike sot qëndrojnë në plan të parë, si rrjedhim, çështjen e ngritjes së vazhdueshme ideopolitike ne e konsiderojmë detyrë numër një për çdo njeri të vendit tonë.

Imperialistët dhe revizionistët kohët e fundit kanë



filluar një sulm të ri kundër marksizëm-leninizmit dhe përpiqen ta hedhin poshtë ose ta shtrembërojnë atë. Kjo sigurisht, nuk është një gjë e re. Sa herë ideologët borgjezë kanë shpallur «disfatën» e tij? Sa herë revizionistët kanë dashur ta «korrigojnë» atë? Mirëpo kanë kaluar më se 100 vjet nga koha kur u botua Manifesti Komunist, gjatë kësaj kohe janë zhvilluar beteja të ashpra me antikomunistët e të gjitha ngjyrave, nga gjiri i revolucionarëve janë shkëputur tradhtarë e renegatë të ndryshëm, megjithatë idetë e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit rrojnë dhe do të rrojnë në shekuj. Periudha që kalojmë është një nga më heroiket; reaksionarët më të tërbuar kolonialistë e imperia- listë, socialdemokracia tradhtare dhe renegatët revizionistë zhvillojnë një veprimtari të ethëshme minuese kundër marksizëm-leninizmit, por fitorja do të jetë e marksizëm-leninizmit revolucionar. S'ka forcë në botë që të ndalë ecjen e shoqërisë përpara.

### **Të jemi sa më të përgatitur për të luftuar kundër imperializmit dhe revizionizmit në të gjitha fushat**

Një rol të veçantë luajnë sot revizionistët, prandaj lufta për demaskimin dhe për shpartallimin e plotë ideologjik e politik të tyre, është për ne një detyrë me rëndësi të dorës së parë. Revizionistët sulmojnë sot marksizëm-leninizmin nga të gjitha anët, si në lidhje me strategjinë e taktikën revolucionare, ashtu edhe në fushën e filozofisë, në atë të ekonomisë politike etj., duke prekur në një mënyrë ose në një tjetër bazat teo-

rike dhe metodologjike të shkencave të tjera, sidomos të atyre shoqërore. Prandaj studjuesit, kërkuesit dhe shkencëtarët tanë, duke përfshirë këtu edhe shkrimtarët e artistët, duhet të jenë në gjendje dhe shumë të vëmendshëm për të ndarë kurdoherë shapin nga sheqeri, revizionizmin nga marksizëm-leninizmi, të jenë sa më të përgatitur për të luftuar kundër revizionizmit në të gjitha fushat.

Karakteristike për revizionistët është se ata, me pretekstin e «kushteve të reja», hidhen kundër tezave të marksizëm-leninizmit dhe përpiqen «të argumentojnë» tezat e tyre revizioniste. Ata goditjet e tyre i drejtojnë kryesisht në ato çështje ku demagogjia do të mund të mbulonte më lehtë tradhtinë e tyre, siç është përpjekja që, duke u nisur nga ndryshimi i raportit të forcave në arenën ndërkombëtare, të hedhin poshtë gjithë teorinë mbi revolucionin etj., pa ngurruar të prekin edhe fusha të tjera të teorisë dhe të praktikës revolucionare.

Tani revizionizmi është bërë kaq i papërmbajtur në vrapin që ka zënë drejt greminës dhe kaq i paturpshëm, sa nuk ngurron të sulmojë edhe materializmin dialektik e historik, edhe teorinë ekonomike, edhe shkencat historike, edhe estetikën marksiste etj. Tendenca është e qartë: çdo gjë bëhet për të kaluar nga materializmi në idealizëm dhe nga dialektika në metafizikë, për të zëvendësuar revolucionin me evolucionin dhe luftën e klasave me garën paqësore ekonomike, për të hedhur poshtë realizmin socialist në letërsi e në arte dhe për t'u hapur rrugën rrymave dekadente. Vitin e kaluar në Francë disa filozofë, anëtarë të Partisë Komuniste të Francës, fi-

liuan të vënë në dyshim një sërë çështjesh themelore të materializmit dialektik dhe historik. Duke diskutuar mbi objektin e filozofisë marksiste-leniniste, një palë, këta ishin revizionistë më të avancuar, nxirrnin konkluzionin se, pasi njohja ka arritur në një fazë ku dija reale është zhvilluar nga shkencat e veçanta, filozofia marksiste duhet të kufizohet në studimin e teorisë së mendimit dhe të ligjeve të saj. Ju e kuptoni ku të çon kjo, ajo synon në ngushtimin e filozofisë marksiste nga një shkencë që studjon ligjet e përgjithshme të zhvillimit të natyrës, të shoqërisë dhe të mendimit njerëzor, në një shkencë që studjon vetëm këtë të fundit. Prej këtij nuk është vështirë të kalohet në atë që ka qenë gjithnjë qëllimi i ideologëve borgjezë dhe revizionistë: në mohimin se marksizëm-leninizmi është në gjendje të studiojë dhe të shpjegojë shkencërisht zhvillimin e natyrës dhe të shoqërisë, në mohimin e vetë marksizëm-leninizmit.

Diskutime të këtij tipi bëhen edhe në Partinë Komuniste të Italisë. Sidomos tezat e botuara lidhur me Kongresin e 10-të të kësaj partie që do të mbahet në dhjetor të këtij viti, janë një kod tjetër i revizionizmit modern, ku flitet pothuaj hapur se shumë çështje të marksizëm-leninizmit duhen riparë, sepse nuk janë të drejta. Jo vetëm kaq, por duhet theksuar se është Hrushovi me «teoricienët» e tij të falimentuar që përcakton drejtimet dhe u jep tonin sulmeve kundër marksizëm-leninizmit. Në fund të fundit, çfarë që edhe mbledhja e të ashtuquajturve teoricienë marksistë për çështjet ekonomike, që u mbledh disa kohë më parë në Moskë, për të diskutuar mbi kapitalizmin e sotëm?

Në çfarë konkluzionesh arritën këta «teoricienë»? Ata na shpallën si një zbulim të madh të kohëve tona se kapitalizmi i sotëm nuk është më si ai i djeshmi, se nuk është e vërtetë kjo ose ajo tezë e thënë më parë nga Marksi dhe Lenini, se jeta vërtetohet të kundërtën ose diçka tjetër etj., etj. Thanë e ç'nuk thanë, gjithë puna ishte që «të argumentojnë» teorikisht tezat revizioniste të N. Hrushovit.

Kështu është puna, pra. Ata duke i kthyer faktet kokëposhtë, përpiqen me të gjitha forcat të revizionojnë marksizëm-leninizmin. Prandaj, është e nevojshme që ju, nën udhëheqjen e urtë të Partisë sonë, të angazhoheni akoma më fuqimisht në luftë me këto «teorira» revizioniste, me këto shëmtira të kohës sonë, ta njihni armikun, të dini ç'bën ai dhe të luftoni pa mëshirë kundër tij.

Shokë,

Problemi i kuadrit që shqyrtoi Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë është jo vetëm një problem organizativ dhe ekonomik, por edhe një problem i madh politik. Një shqyrtim i tillë nuk u bë në mënyrë të rastit në momentin e tanishëm. Por ai na diktohet nga kushtet e tanishme të brendshme e të jashtme, nga zhvillimi i situatës në përgjithësi. Në përputhje me këtë situatë duhet të zhvillohet gjithë aktiviteti ynë.

Siç dihet, Kongresi i 4-t i Partisë shpalli përfundimin e etapës së ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit dhe kalimin në etapën e re të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Për plotësimin e detyrave

të pesëvjeçarit të tretë dhe të planeve të ardhshme, do të jetë nevoja të futet sa më gjerë teknika e shkenca në prodhim. Do të zgjerohet e do të përmirësohet shumë arsimi, kultura, do të ngrihet niveli material e kulturor i masave punonjëse në kufijtë e caktuar nga Kongresi i 4-t, pavarësisht nga vështirësitë e reja që na kanë lindur. Të gjitha këto, shokë, kërkojnë të punohet më mirë, më me kulturë, duke përdorur gjerësisht realizimet e shkencës dhe të teknikës. Mirëpo një gjë të tillë mund ta bëjnë vetëm njerëz të kulturuar, që do të dinë të përdorin teknikën e të zbatojnë shkencën. Duhet eliminuar ose zvogëluar në minimum diniveli që ekziston midis teknikës së lartë e shkencës në prodhim dhe njerëzve që merren ose do të merren me këtë. Ja pse çështja e përgatitjes dhe e kualifikimit të kuadrit në përgjithësi dhe e kuadrit të lartë në veçanti merr një rëndësi vendimtare. Ja pse inteligjenca jonë ka një rol nderi në etapën e re të zhvillimit të shoqërisë sonë. Partia ka besim se kuadrot tanë, për hir të së ardhshmes së lumtur të atdheut, për hir të triumfit të çështjes së socializmit, do t'i kryejnë me nder të gjitha detyrat e tyre.

Natyrisht, shokë, ne kemi vështirësi, kemi vështirësi objektive e subjektive. Këto mund të na pengojnë në punë. Mirëpo është fakt që ne sot nuk jemi si 10 ose 15 vjet më parë, nuk kemi vështirësitë e atëhershme. Ne jemi mësuar duke luftuar, duke u përleshur e duke triumfuar mbi këto vështirësi. Dhe shembujt në këtë drejtim nuk janë të paktë. Sa punë e lodhshme u bë, për shembull, për projektimin e impiantit të sodës kaustike, për të përcaktuar procesin teknologjik të pro-

dhimit të pllakave majolike dhe gres në poçerinë e Kavajës, për të përmirësuar procesin teknologjik të ish-punishtes së nishestesë, për të përvetësuar prodhimin e karabojës me anë të studimit të mbeturinave të ofiçinave të qytetit të Tiranës etj., etj.! Sa mungesa, pengesa e vështirësi u hasën në punë, por megjithatë u kapërcyen. Ose merrni tërë ekipin e gjeologëve tanë, në të cilin bënin pjesë dhe shoqe që kaluan shkrep më shkrep në Alpet e Shqipërisë, në kushte mjaft të vështira, duke arritur të zbulojnë shfaqje boksitesh, thesare të vërteta për popullin. Më lejoni, shokë, të hap një parantezë lidhur me pjesëmarrjen e shoqeve në punët e rëndësishme e studimet shkencore. Faktet tregojnë se ato nuk janë më pak të zonjat se shokët, se ato mund të bëjnë studime, kërkime e vepra jo më pak të lavdishme se shokët. Tani numri i shoqeve që vazhdojnë ose kanë mbaruar studimet e larta është rritur dhe do të rritet vazhdimisht. Është detyra jonë, pra, që t'i tërheqim sa më shumë në punët krijuese e shkencore, të thyejmë mentalitetin e ndryshkur që kanë disa se ato gjoja s'mund të bëjnë gjë, të luftojmë kundër nënvleftësimit të tyre dhe t'u krijojmë kushte, e theksoj, t'u krijojmë kushte e lehtësira sa më të mëdha për një gjë të tillë, sepse, nga vetë fakti se ato janë gra e nëna kanë më shumë vështirësi se burrat.

Por në luftën kundër vështirësive tona në përgjithësi ne kemi tani edhe avantazhe të tjera. Tani kemi një bazë materiale të fuqishme, kemi një eksperiencë të madhe, që janë garanci se vështirësitë subjektive do t'i kapërcejmë, se të metat në punë do t'i pakësojmë dhe do t'i likuidojmë. Edhe vështirësitë objektive, në

saje të përpjekjeve tona dhe të ndihmës së miqve, në radhë të parë të shokëve kinezë, do t'i kapërcejmë. Mjafton të punojmë të gjithë me ndërgjegje, mjafton të zbatojmë me besnikëri vijën e drejtë të Partisë. Situata jonë e brendshme është më e shëndoshë se kurrë. Uniteti dhe entuziazmi në punë janë shembullorë. Ne e shohim të ardhshmen me optimizëm dhe jemi të sigurt se inteligjenca jonë është e aftë t'i qëndrojë çdo furtune e të pushtojë çdo kala.

Mirëpo problemi i kuadrit, siç e thashë, kërkon të merret me seriozitetin më të madh edhe për shkak të situatës ndërkombëtare në të cilën ndodhet vendi ynë dhe bota mbarë. Nëse dikur ne mund të mbështeteshim për zgjidhjen e këtij problemi në ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste, tani efektivisht në këtë çështje ne na ndihmon vetëm Republika Popullore e Kinës, duke dërguar atje studentë, ose duke na dhënë ndihmë tekniko-shkencore. Për këtë dhe për ndihmat e tjera të pakursyera ne u jemi thëllësisht mirënjohës shokëve kinezë. Mirëpo ndihma, në fund të fundit, është ndihmë, ajo nuk mund të luajë rolin vendimtar. Rolin vendimtar në atdheun tonë për zgjidhjen e problemit të kuadrit e të mjaft problemeve të tjera mund ta luajmë dhe do ta luajmë ne vetë. Kjo është njëra anë.

Ana tjetër është fakti se ne e ndërtojmë socializmin në kushtet e rrethimit armiqësor kapitalist e revizionist e të shtimit të përpjekjeve të imperialistëve e të veglave të tyre për të shpërthyer luftën. Siç e morët, vesh, me bllokadën totale rreth Kubës dhe me masat e tjera, presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

Kenedi, i bëri Bashkimit Sovjetik e gjithë popujve paqedashës sfidën më të rëndë duke e sjellë njerëzimin në pragun e luftës botërore atomike. Kjo rrethanë na detyron të forcojmë me të gjitha energjitë ekonominë dhe mbrojtjen tonë, për të qenë në gjendje të përballojmë çdo situatë. Të gjitha këto llogari, shokë, Partia i ka bërë; në përputhje me këtë situatë dhe këto eventualitete, ne kemi ndërtuar të gjitha planet tona. Të gjitha masat ne i kemi marrë me kohë dhe kurrë s'do të gjendemi në befasi. Nga e tërë kjo kuptohet, pra, edhe një herë më mirë roli i madh i kuadrove në rritjen e potencialit ekonomik e të fuqisë mbrojtëse të vendit tonë.

Siç jeni në dijeni, te ne punët shkojnë mirë. Industria, bujqësia, kultura, arti, shkencat po përparojnë me shpejtësi. Planet po realizohen dhe po tejkalohen.

Në arritjen e të gjitha fitoreve tona merita kryesore i takon popullit tonë heroik dhe Partisë sonë të lavdishme, emri i të cilëve do të shkruhet në faqet e historisë me shkronja të arta. Por një meritë të madhe këtu kanë edhe kuadrot tanë, keni edhe ju, shokë, që tok me Partinë e popullin, qëndruat grusht dhe të patundur, kurdoherë në krye të detyrave tuaja.

Ne edhe në të ardhshmen do të arrijmë fitore. Garanci për këto fitore, që ne do ta ndërtojmë me çdo kusht socializmin e më vonë komunizmin, që ne do t'i realizojmë të gjitha planet tona, janë Partia dhe populli ynë, klasa jonë punëtore heroike dhe fshatarësia kooperativiste, kuadrot tanë të mrekullueshëm, inteligjenca jonë popullore, është marksizëm-leninizmi kurdoherë fitimtar, të cilit ne do t'i qëndrojmë besnikë



përjetë dhe sa kohë do të rrahin zemrat tona, është solidariteti ndërkombëtar i marksistë-leninistëve, proletarëve e popujve të mbarë botës, që do të jenë gjithmonë në anën tonë.

U bëj edhe një herë thirrje rinisë, pedagogëve të talentuar të vjetër e të rinj, mjekëve, inxhinierëve, agronomëve, punëtorëve të përparuar, njerëzve të artit e të kulturës, të gjithëve, kudo që ata punojnë dhe mësojnë, që jo vetëm ta vënë në shërbim të popullit tonë të mrekullueshëm diturinë e tyre, ashtu siç bëjnë ditë e natë, por që tok me punën e përditshme, dhe që kjo të bëhet më efektive, të nxjerrin konkluzione shkencore të mëtejshme nga një punë e tillë, të pasurojnë diturinë e tyre. Ta ngremë vendin tonë socialist në një vend të një kulture të lartë, ta ngremë kulturën tonë në nivelin e kulturës së vendeve të tjera të përparuara, pasi kështu do të kemi punuar për lulëzimin dhe begatinë e atdheut, për socializmin, për komunizmin, dhe do të meritojmë plotësisht simpatinë dhe respektin e botës përparimtare që e shikon Shqipërinë e re socialiste me sy dashamirës, duke çarë furtunat pa u trembur e pa u lëkundur dhe me besim të plotë në të ardhshmen e lulëzuar të saj, duke ecur përpara dhe duke ngjitur një nga një shkallët e diturisë e të shkencës, të mirëqenies ekonomike e kulturore.

Le të punojmë, pra, shokë, akoma më me optimizëm dhe me vrull t'i vëmë në jetë si duhet edhe vendimet e Plenumit të fundit të Komitetit Qendror të Partisë, t'i japim atdheut qindra e mijëra të tjerë kuadro të rinj, besnikë deri në fund për çështjen e popullit

e të Partisë, të ngremë kualifikimin me të gjitha mjetet e format, të rritim nivelin politik dhe ideologjik!

Ditë më të bukura na presin. Le t'i krijojmë ato së bashku me punën, me krahët e mendjen tonë dhe t'i gëzojë populli sot dhe brezat që do të vijnë pas nesh!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 264 (4422), 4 nëntor 1962*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# NE NUK DO TË MBETEMI KURRË PA BUKE DHE PA ARMË

*Nga fjala e mbylljes në Plenumin e 8-të  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

28 tetor 1962

Të dashur shokë,

Raporti i Byrosë Politike të Komitetit Qendror, që u mbajt përpara këtij Plenumi nga shoku Hysni, orientimet që dha shoku Mehmet dhe diskutimet që u bënë mbi problemet e bujqësisë, tregojnë qartë rëndësinë e madhe që ka kjo mbledhje e Komitetit Qendror, perspektivat e mira që i hapen ekonomisë sonë në përgjithësi dhe bujqësisë në veçanti. Ky është rezultat i politikës së drejtë të Partisë sonë në këtë fushë të rëndësishme. Në të ardhshmen, duke u mbështetur në sukseset e arritura, ta vazhdojmë punën tonë në këtë rrugë të drejtë, të përfitojmë në maksimum nga eksperiencia e gjertanishme, nga të metat dhe gabimet që janë vërtetuar në punën tonë praktike në bujqësi, për të arritur suksese më të mëdha në drejtim të plotësimit të nevojave të popullit, qofshin këto drejtpërsëdrejti

---

<sup>1</sup> Plenumi i 8-të i KQ të PPSH i mbajtur më 26-28 tetor 1962 diskutoi raportin «Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për sigurimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor».

me ushqime, qofshin me lëndë të parë për industrinë që kemi ngritur dhe për atë që po ndërtojmë, me qëllim që të shkojmë vazhdimisht përpara në rrugën e rritjes së mirëqenies së popullit. Kjo kërkon mobilizimin e plotë të të gjithë sektorëve, si të ekonomisë, ashtu edhe të ushtrisë e të Sigurimit të Shtetit për realizimin e plotë të planeve dhe të detyrave të ngarkuara, veçanërisht në këto situata ndërkombëtare, të cilat duhen konsideruar ashtu siç janë, serioze.

Pikërisht për çështjet e situatës politike desha të flisja pak. Komiteti Qendror ka qenë dhe është kurdoherë i qartë për vijën që ka përpunuar dhe e zbaton së bashku me popullin. Ai është gjithashtu mirë në dijeni edhe për situatat që krijohen vazhdimisht në botë, muaj për muaj, javë për javë dhe ditë për ditë. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme dhe këtu ne duhet të kuptojmë në radhë të parë se suksesi ynë më i madh qëndron te vija e drejtë që ka Partia jonë dhe zbatimi i saj me gjithë shpirt dhe me ndërgjegje të plotë nga punonjësit e vendit tonë. Kjo vijë e drejtë ka ngritur në shkallë të lartë një patriotizëm të papërshekruar në të gjitha masat e popullit tonë.

Situatat që po kalojmë nuk janë të lehta. Këtë e kemi theksuar dhe e theksojmë vazhdimisht. Megjithatë të Partia dhe populli ynë nuk shihet asnjë lëkundje dhe panik. Kjo ndodh për arsye të besimit të madh dhe të plotë që ka populli te Partia dhe te politika e drejtë e saj. Kjo është vendimtare, sepse vija e Partisë nuk mund të kuptohet e të zbatohet drejt pa mbështetjen e komunistëve dhe të popullit.

Ju jeni në dijeni të shumë ngjarjeve që kanë ndo-

dhur kohët e fundit në botë dhe në kampin socialist. Ne mund të themi pa u mburrur se këto ngjarje vërtetuan drejtësinë e vijës së Partisë sonë. Pikëpamjet e drejta, parimore dhe të palëkundshme të Komitetit tonë Qendror, çdo ditë që kalon po u heqin maskën grupit të N. Hrushovit, gjithë udhëheqësve revizionistë të partive komuniste e punëtore të vendeve të demokracisë popullore të Evropës, si edhe të mjaft partive komuniste e punëtore të vendeve kapitaliste. Dhe nuk ka si të jetë ndryshe, sepse ata gjithnjë e më shumë po futen në qorrsokak dhe se rruga që ndjekin po i demaskon vazhdimisht para gjithë botës, në radhë të parë përpara komunistëve të partive të tyre dhe njerëzve përparimtarë.

Tani duket qartë se vija e drejtë e Partisë sonë ka çarë kurdoherë përpara, njihet mirë e mbështetet jo vetëm nga një shumicë e madhe komunistësh në botë, po edhe nga njerëzit liridashës e përparimtarë të botës. Për Partinë tonë është krijuar një konsideratë jashtëzakonisht e mirë në opinionin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe në opinionin publik botëror. Çdo ditë që kalon forcohet më shumë besimi ndaj Partisë sonë, sepse ajo ecën në rrugën e marksizëm-leninizmit. Në vendet e Evropës, ku sundojnë klikat revizioniste, si dhe në partitë komuniste të Francës, Italisë etj., etj., ku gjithashtu në udhëheqje janë në fuqi elementë revizionistë, shumë komunistë jo vetëm flasin haptazi për vijën e drejtë të Partisë sonë, por e mbështetin këtë vijë dhe veprimtarinë e Partisë sonë, bile janë duke krijuar edhe grupe me elementë marksistë-leninistë, të cilët me punën e tyre po bëhen një pengesë për veprimtarinë antimarksiste të revizionistëve në vendet e tyre.

Në takimet e shumta që kanë pasur njerëzit tanë, që punojnë jashtë shtetit, në mbledhje e konferenca të ndryshme me komunistë dhe udhëheqës të qeverive ose të partive të mësipërme (dhe që duhet të jenë njerëz besnikë të klikave që sundojnë në vendet e tyre), këta elementë, pra, me të cilët kanë pasur rastin të bisedojnë njerëzit tanë, janë shprehur me admirim të madh për vijën e drejtë të Partisë sonë dhe për tradhtinë e udhëheqësve të tyre. Kështu në BRSS, në Leningrad, ka atë rezistencë kundër klikës së N. Hrushovit, sa jo vetëm anëtarë partie të izoluar, por organizata të tëra kanë votuar kundër udhëheqjes revizioniste të N. Hrushovit, kanë aprovuar edhe rezoluta dhe janë shprehur se nuk janë dakord me luftën që i bëhet J. V. Stalinit. Kjo vërtetohet si nga këto rezoluta ashtu edhe nga vizitat që kanë bërë në Leningrad N. Hrushovi dhe F. Kozllovi me qëllim që të zbutin situatën. Rruga që ndjekin këta revizionistë me shokë, po shton rezistencën e komunistëve.

Ju jeni në dijeni të rezistencës së shumë komunistëve francezë. Kjo rezistencë tani po konkretizohet. Kohët e fundit është botuar dhe është shpërndarë në Francë një broshurë, e cila është model i luftës së drejtë që bëjnë marksistët francezë kundër vijës tradhtarë të N. Hrushovit, Moris Torezit, Palmiro Toliatit, J. B. Titos etj. Ata mbrojnë çështjen e Partisë sonë, mbrojnë haptazi gjithashtu J. V. Stalinin, duke theksuar se të gjitha sa janë thënë kundër tij janë shpifje të kurdisura nga N. Hrushovi. Ata e sulmojnë N. Hrushovin si revizionist dhe Moris Torezin si lake të tij, i bëjnë thirrje PK të Francës të reagojë kundër udhëheqjes së saj revizioniste.

E njëjta gjë ndodh edhe në radhët e PK të Italisë si dhe në disa parti të tjera. Këto tregojnë se situata po ecën në favor të marksizëm-leninizmit dhe në disfavor të revizionizmit. Prandaj tani revizionizmi po kërkohet që të organizohet. Sikurse e keni parë në «Zërin e popullit», po trajtohet çështja që revizionistët po punojnë të krijojnë një front unik, të detyruar nga rrethanat dhe situatat e krijuara, sepse po demaskohen. Prandaj në këto kushte atyre u duhet t'i forcojnë lidhjet e tyre kundër partive marksiste-leniniste si në shkallën ndërkombëtare, ashtu edhe brenda partive të tyre. Tradhtari N. Hrushov krijoi lidhje të hapur me revizionistët titistë, e çori edhe atë çikë maskë të hollë që kishte, për të mbuluar tradhtinë e tij ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj Bashkimit Sovjetik dhe kampit socialist. Ai u bashkua në të gjithë vijën me tradhtarët revizionistë jugosllavë. Kjo lidhje midis Titos dhe Hrushovit tanimë ka mbaruar; atë në përgjithësi po e përqafojnë dhe udhëheqësit bullgarë, rumunë, çekë, polakë, gjermanë e hungarezë etj. Tani lufta e tyre drejtohet kundër marksizëm-leninizmit, por e mbështjellë me petkun e luftës kundër «dogmatizmit» dhe «sektarizmit»; ata përpiqen për afrimin e të gjitha klikave revizioniste me njëra-tjetrën, për të fuqizuar luftën kundër marksizëm-leninizmit, veçanërisht kundër Partisë sonë si edhe për të shtypur çdo rezistencë që bëhet në partitë e tyre nga marksistët e vërtetë.

Lidhjet e N. Hrushovit me Titon dhe futja e tij thellë e më thellë në llumin e revizionizmit janë konkretizuar në veprimtarinë që ai ka zhvilluar kundër Stalinit, për

uljen e prestigjit të BS, të PK të BS, të vijës së drejtë të Leninit dhe të Stalinit. Ai ka arritur sa të rehabilitojë politikisht dhe ideologjikisht të gjithë trockistët e tradhtarët e socializmit gjer te Buharini dhe grupi i tij. E gjithë veprimtaria e N. Hrushovit në degjenerimin e shtetit sovjetik, në bujqësi, në industri etj., mbështetet në teoritë e Buharinit, të cilat Titoja i ka vënë në zbatim më parë në Jugosllavi dhe për të cilat ai u godit më 1948 nga Byroja Informativë. Tani, pra, po ato teori po i vë gjithashtu në jetë me të gjitha forcat e tij në BS edhe Hrushovi. Prandaj ai e ka kot se nuk gënjen dot njeri kur thotë se Buharinin e ka rehabilituar vetëm politikisht, se Stalini e paska pushkatuar gabimisht këtë «farë burri», kurse dihet që teoritë e Buharinit i ka demaskuar rreptë, jo vetëm Stalini, por edhe vetë Lenini që kur ishte gjallë. Lexoni një letër të Leninit të kësaj kohe dhe atje do të shihni çfarë tradhtari ka qenë Buharini, çfarë armiku i marksizmit, i socializmit dhe i BRSS, atje do të shihni se në çështjet e bujqësisë ai ka qenë përkrahës i flaktë i kulakëve. Përveç këtyre është vërtetuar me fakte se Buharini edhe politikisht ka qenë tradhtar, agjent dhe spiun i imperialistëve. Prandaj, të gjitha këto që bën N. Hrushovi, janë blufe.

Edhe në Bullgari kanë rehabilituar Trajço Kostovin dhe, për të humbur çdo gjurmë të fajësisë së tij dhe të shokëve të tij, u kanë dhënë urdhër gjykatave dhe organeve të brendshme që të digjen të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me të.

Nuk ka asnjë dyshim se rruga e revizionistëve tani shkon drejt afrimit me imperialistët. Kjo nuk vihet në diskutim. Si dhe sa do të bëhet ky afrim, do ta shohim,



po duket se ata po ecin me shpejtësi në këtë drejtim. Kjo do të thotë se grupi i N. Hrushovit dhe pasuesit e tij në partitë e tjera do të vihen në pozitë të Titos, sepse së bashku ata kanë marrë përsipër shkatërrimin e kampit socialist. N. Hrushovi, që kurse i hyri rrugës së tradhtisë, i vuri vetes detyrën të shkatërronte kampin socialist, të degjeneronte marksizëm-leninizmin. Po vallë do t'ia arrijë këtij qëllimi? Në asnjë mënyrë! Këtu flas vetëm se si mendojmë ne, komunistët shqiptarë, po është e qartë se ashtu si ne mendojnë me miliona komunistë të tjerë në botë.

Partia jonë e njeh mirë veprimtarinë antimarksiste e antishqiptare të tradhtarit Tito, i cili ka qenë për likuidimin e pushtetit të demokracisë popullore në vendin tonë. Kjo ka mbetur edhe më vonë vija e tij. Ai kudo, në Shqipëri, në Bullgari, në Hungari e gjetkë, ka organizuar komplete, nga të cilat ka dalë qartë synimi i tij. Ai ka dashur të krijonte në Evropën Qendrore dhe Juglindore një situatë të përshtatshme për imperializmin amerikan dhe anglez. Me një fjalë, Titoja po zbatonte pas Luftës së Dytë Botërore politikën që nuk arriti të zbatonte dot Çërcilli gjatë luftës, sepse e penguan politika e drejtë e PK të BS dhe Josif Stalini, si dhe fitorja e Ushtrisë së Kuqe. Kështu Titoja pas Çlirimit ndërmoi atë punë, që u dështoi imperialistëve. Por veprimtaria e tij dështoi. Kështu do të dështojë edhe veprimtaria armiqësore e Hrushovit ndaj vendit tonë.

Revizionistët trumbetojnë me bujë sikur gjoja brenda radhëve të tyre ata kanë unitet politik, ideologjik ose ekonomik. Unitet ata kanë, por vetëm në luftën kundër marksizëm-leninizmit, kundër partive tona, që

qëndrojnë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste dhe kundër kampit socialist. Ata kanë gjithashtu unitet për afrim dhe pajtim me imperializmin agresor. Për t'ia arritur këtij qëllimi të përbashkët, kush më shumë e kush më pak, punojnë dhe u bëjnë lëshime imperialistëve në problemet vendimtare të kohës, dhe përpiqen të degjenerojnë marksizëm-leninizmin, të dobësojnë kampin socialist, sidomos Shqipërinë, Kinën etj.

Uniteti midis tyre është në baza jo të forta, ai nuk mund të ekzistojë, ashtu siç mund të ekzistojë uniteti midis partive, që i qëndrojnë besnike marksizëm-leninizmit dhe midis shteteve që udhëhiqen e frymëzohen nga ideologjia proletare. Ata të gjithë janë revizionistë, pjellë e borgjezisë kapitaliste, por që midis tyre kanë kontradikta, të cilat shtohen akoma më shumë për shkak të presionit të madh të jashtëm imperialist, si edhe të presionit e të luftës së brendshme të komunistëve dhe të popujve të tyre, që po i kundërvihen dhe po reagojnë ndaj politikës tradhtarë revizioniste. Por ne të mos mendojmë se reagimi dhe lufta nga ana e komunistëve dhe e popujve mund të konkretizohen menjëherë dhe me një forcë të madhe brenda disa ditësh a muajsh. Revizionistët përdorin një demagogji të madhe për të trullësuar mendjen e njerëzve, kështu që konkretizimi i kësaj lufte nuk është një punë e lehtë që mund të bëhet shpejt, sepse ka shumë njerëz që tani janë të lëkundshëm, prandaj dhe lufta e puna jonë, e marksistë-leninistëve, kërkon shumë sakrifica.

Kontradiktat midis revizionistëve vërehen edhe në çështjet ekonomike. Kështu koordinimi i planeve të tyre ekonomike në kuadrin e KNER-it është vetëm në dukje.

Për këtë koordinim flitet në vija të përgjithshme, po në detaje, në thelb nuk ka koordinim, pra nuk është ashtu siç duan ta paraqitin gjendjen ata dhe nuk mund të jetë ashtu. Grupi i N. Hrushovit, që ka një potencial të madh ekonomik dhe ushtarak, shfrytëzon prestigjin e BS dhe të PK të BS dhe me këtë përpiket t'u imponojë vendeve të demokracisë popullore politikën e vet në fushën ekonomike, për t'u diktuar pastaj ato që ai do në drejtim të politikës së përgjithshme, në politikën ushtarake etj. Në këtë bazë midis tyre ka kontradikta të mëdha.

N. Hrushovi dhe grupi i tij tradhtar përpiket të zërë kyçet në ekonominë e vendeve të demokracisë popullore. Kështu, vendit që i mungon hekuri, për ta pasur më vonë të varur, i premtun se do t'ia sigurojë; në rast se ky nuk bën pastaj ashtu si do t'i thotë ai, ia pret furnizimin e hekurit dhe këtij i mbeten fabrikat dhe punëtorët pa punë. BS ka naftë, nga kjo N. Hrushovi u jep dhe miqve të tij, këtë ai e propagandon me të madhe, po në rast se ndonjë nuk ecën në rrugën e tij, ia pret dhe e lë në diell.

Në fushën ekonomike të gjitha përpjekjet e revizionistëve midis tyre bëhen që si e si të shthurin lidhjet e vërteta, të shëndosha, marksiste-leniniste, që kanë ekzistuar dhe duhet të ekzistonin midis vendeve socialiste. Midis revizionistëve tani ka disa lidhje, të cilat grupi i N. Hrushovit përpiket t'i ruajë. Mirëpo në këto vende ka shthurje dhe tendenca për të marrë kredi nga SHBA dhe nga vendet e tjera kapitaliste. Bile Hrushovi propagandon edhe në «Pravda» që, kur ju ofron kredi SHBA-ja, mund ta marrin. Kështu Gomulka ka marrë gjer tani nga SHBA-ja 500-600 milion dollarë kredi. Por puna është që sa të fillosh, pastaj rruga të çon të

marrësh edhe miliarda dhe të shkosh atje ku ka vajtur Titoja. Revizionistët bëjnë sikur përpiqen për të luftuar Tregun e Përbashkët Evropian. Nga ana tjetër edhe vetë kapitalistët kanë parasysh që të flitet se vendet e Tregut të Përbashkët do të mbajnë qëndrim kundër vendeve socialiste. Po këto janë vetëm parulla, në të vërtetë kushedi ç'lidhje, ç'tregti e çfarë tradhtish kurdisen. Grupi tradhtar i N. Hrushovit ka marrë përsipër të likuidojë ato forma, që në situata të tjera kanë qenë dhe do të ishin një hallkë e shëndoshë për forcimin jo vetëm ekonomik të kampit socialist, po edhe të unitetit politik të tij.

Përsa u përket qëndrimeve të revizionistëve në fushën ideologjike, ata veprojnë haptazi. Ndaj imperializmit ata po bëjnë lëshime në parimet e politikës dhe të vijës marksiste-leniniste në të gjitha drejtimet, kurse Shqipërinë dhe Partinë e Punës të Shqipërisë i konsiderojnë armiq. Këtë konsideratë kanë edhe për Kinën dhe udhëheqësit e saj. Edhe ndaj Kinës po mbajnë të njëjtin qëndrim si ndaj vendit tonë. Mirëpo RP e Kinës është një forcë kolosale dhe nuk është e lehtë t'i kundërvihesh. Revizionistët po përpiqen me të gjitha mjetet që Kinën ta dobësojnë, ta diskreditojnë, duke organizuar dhe veprimtari armiqësore, por po ashtu si neve edhe Kinës s'kanë çfarë t'i bëjnë.

Duke luftuar me vendosmëri kundër revizionizmit hrushovian, ne jemi në rrugë të drejtë, sepse mbrojmë marksizëm-leninizmin. Këtë renegat e kemi mbërthyer mirë e nuk do ta lëshojmë gjersa të vdesë.

Le të marrim një çështje me rëndësi shumë të madhe, atë të afrimit të Hrushovit me imperialistët. E gjithë politika e tij synon drejt këtij objekti, për të evi-

tuar gjoja konfliktin ushtarak me ta. Popujt nuk e duan luftën, por që të mos ketë luftë, duhet të shkatërrohen mjetet e luftës dhe të asgjësohen ata që janë shkaktarë të luftërave, domethënë imperialistët.

Problemi i Berlinit është bërë një psikozë për njerëzimin: «Sot-nesër do të ketë luftë, sot-nesër do të ketë luftë». Këtë e bën imperializmi amerikan, për të cilin duhet thënë se vijën e tij e ka konkrete: *status quo* në Berlin, Berlini nuk duhet prekur, se ndryshe bëhet luftë. Një psikozë të tillë e shtojnë akoma më shumë qëndrimet ekuivoqe, tradhtare të N. Hrushovit, i cili së bashku me të tjerët, në mos tre, po të paktën dy vjet ka që flet për Berlinin ditë e natë dhe nuk bën asgjë. Përkundrazi, me qëndrimet që mban, ai i bën dëm zgjidhjes së kësaj çështjeje, sepse sa më shumë që shtyhet kjo çështje, aq më e rrezikshme dhe e pazgjidhshme bëhet.

Qëndrimet e N. Hrushovit imperializmi i shikon dhe i ushqen, se po kupton me ç'njeri ka të bëjë, prandaj kërkon nga ai që të ecë edhe më përpara, nxit kalin e këtij tradhtari të vrapojë dhe të thyejë çdo rekord. Dhe në qoftë se N. Hrushovi nuk e thyen rekordin, imperializmi krijon situatat e nevojshme për ta vënë atë në ato pozita që i intereson.

Ju e mbani mend deklaratën e parë të N. Hrushovit kur theksoi se «kundër atij që prek Kubën do të shkel sustën e raketave dhe do ta bëj hi». Ne e kishim të qartë, çfarë deklarate ishte kjo, këto ishin fjalë boshe. Mirëpo kjo deklaratë pati pasojat e veta negative në Kubë, ku u krijua një situatë e vështirë.

Vija e Partisë sonë është e drejtë, kurse veprimtaria dhe vija e grupit të N. Hrushovit dhe e pasuesve

të tij, që zbukurojnë imperializmin, duke thënë se «në kohën e tanishme ai ka ndryshuar dhe nuk është më agresor, prandaj duhet të bëhemi miq me të, se tani bota mund të jetë pa luftëra dhe pa armë», është anti-marksiste. Këto pikëpamje tradhtarët revizionistë vazhdojnë t'i thonë edhe tani, po sa e shtrembër është kjo, këtë e vërtetuan edhe një herë kohët e fundit vetë SHBA me bllokadën dhe masat e tjera kundër Kubës. SHBA vepron kështu edhe për të parë pulsën e Hrushovit, e këtij farë burri, që ka raketat në dorë, se gjerku do të kundërshtonte ai. Dhe ne e pamë ç'bëri e si kundërshtoi N. Hrushovi. Të gjithë e lexuam mesazhin që ai i bëri Kenedit<sup>1</sup>, i cili ishte tamam si letra që shërbëtori i drejtonte padronit 120 vjet më parë. Dhe ai e bëri këtë, kur e gjithë bota, jo vetëm njerëzit përparimtarë, por edhe reaksionarët e dënojnë hapin luftënxitës të Kenedit, kështu, për shembull, edhe Raselli<sup>2</sup> e këshillon atë të merret vesh e të mos bëjë luftë, sepse megjithëqë vetë është nga ata që lexojnë romanet policëske dhe simpatizojnë kriminelët, nuk e aprovon veprimin e Kenedit, se fundi kriminelët një njeri vrasin, po Xhon Kenedi, thotë ai, kërkon të vrasë gjithë botën. Pra, në një kohë kur e gjithë bota shikon ç'është imperializmi dhe ç'përfaqëson Kenedi, N. Hrushovi në të kundërtën i shkruan atij letër, duke i bërë lajka, ku i thotë se është forcuar bindja që «Kenedi është njeri i paqes», prandaj i lutet të heqë bllokadën kundër Kubës.

1 Është fjala për mesazhin e N. Hrushovit drejtuar Kenedit, lidhur me problemin e Turqisë dhe të Kubës, botuar në gazetën «Zëri i popullit», 28 tetor 1962.

2 Bertran Rasell — sociolog dhe filozof idealist anglez.

Situatat, pra, duhet t'i shikojmë ashtu siç janë, ato janë të rrezikshme, prandaj duhet të jemi të përgatitur që t'u bëjmë ballë, sepse armiqtë tanë janë duke ndër-marrë kundër nesh një luftë të ashpër politike dhe ideologjike, prandaj të përgatitemi për ta përballuar atë. Të jemi të qartë për çdo gjë, sepse kështu do të jemi edhe më të fortë. Panik në vendin tonë nuk ka, për arsyt që thashë, po ne duhet të përpiqemi që panik të mos ketë as në të ardhshmen. Për këtë qëllim të organizohet një punë e dendur politike, duke u orientuar nga artikujt e «Zërit të popullit», që e mbajnë opinionin tonë në dijeni mbi zhvillimin e situatës, kështu që Partia dhe populli të mund të kuptojnë ngjarjet jo në mënyrë shabllone, po drejt. Për shembull, sot shihet që ne nuk flasim në shtyp kundër N. Hrushovit, atëherë komunisti duhet të kuptojë se ky qëndrim lidhet edhe me momentin e luftës kundër imperializmit; ai duhet të sqarojë atë tjetrin që nuk është i qartë dhe që mund të thotë: përse nuk po e demaskojmë më N. Hrushovin? Këtij i duhet thënë: ngadalë një çikë, sot e nesër nuk do të flasim kundër N. Hrushovit se Kenedi po bën gjoja sikur lufton kundër këtij, ndonëse kjo nuk është e vërtetë. Po pasnesër do të flasim përsëri.

N. Hrushovi në letrën e tij e cilëson Kenedin si njeri që e do paqen, dhe këtë shprehje tipike të tij ne e botuam. Mirëpo mund të ketë ndonjë që të thotë: përse i botuam fjalët e këtij revizionisti? Durim, duhet pritur se nesër, ose pasnesër, do të vijë bomba, që do të sqarojë ç'mendon populli shqiptar, për shembull, për Kubën. Atëherë ai tjetri do të gjykojë dhe do kuptojë më mirë se N. Hrushovi është një tradhtar.

Ne duhet t'i mësojmë njerëzit të gjykojnë, t'i bëjmë të mprehtë, të zgjuar, që ngjarjet t'i shpjegojnë në rrugën marksiste-leniniste dhe të mos hutohen nga asgjë. Këto situata dhe puna sqaruese e Partisë e kalitin popullin. Në këto çështje dhe situata, kërkohet gjithashtu edhe një vigjilencë e madhe. Të mos flemë, duke u nisur nga ajo që jemi të fortë. Armiqtë punojnë intensivisht kundër nesh. Vetëm me radio jepen qindra emisione në ditë që flasin mbi këto çështje dhe që trembin njerëzit me nerva të dobët. Me gjithë veprimtarinë tradhtarë të N. Hrushovit ne jemi të fortë, po vigjilencën ta forcojmë.

Si pasojë e politikës së N. Hrushovit situata në BS është jashtëzakonisht e vështirë, te ai dhe pasuesit e tij duket një frikë aq e madhe, sa detyrohen të botojnë në gazetën «Pravda» vjershat e një farë Jevtushenko, që e ka zënë tmerri dhe thotë se duhen shtuar rojet rreth Mauzoleumit të Leninit, se Stalini ndodhet akoma në mauzoleum dhe jashtë ka plot njerëz të tjerë që janë me Stalinin. Mua, thotë Jevtushenko, partia më ka urdhëruar të mos jem i qetë. Trupi i Stalinit u hoq nga mauzoleumi, por Stalini rron akoma dhe vazhdon të japë urdhra<sup>1</sup>. Kjo tregon se N. Hrushovi dhe njerëzit e

---

1 Kjo vjershë ultrareaksionare, që u botua në gazetën «Pravda» të datës 21 tetor 1962, shpreh qartë tmerrin dhe degjenerimin që kishte mbërthyer revizionistët hrushovianë. Midis të tjerash, kasneci revizionist Jevtushenko, beniamin i Hrushovit, shkruante se Stalini «Pasues shumë ka lënë / kudo në planotë / dhe mua më duket / sikur telefon kanë lidhur në varr: / Enver Hoxhës ia jep porositë e tij / Stalini vetë / ... Qetësi për mua s'do të ketë / gjersa ka pasues Stalini mbi dhe / do më duket / sikur Stalini ndodhet në mauzole-».



tij nuk janë të qetë, nuk e ndiejnë veten të fortë, se forca është me marksizëm-leninizmin, me ne, dhe fitorja do të jetë jona. Po çdo gjë do të kalojë procesin e vet. N. Hrushovi nuk mund t'i ndryshojë ligjet objektive të zhvillimit, për këtë ne jemi të sigurt. Kështu demonstratat që janë bërë përpara ambasadës amerikane në Moskë, tregojnë urrejtjen e madhe të popullit sovjetik kundër imperializmit amerikan dhe renegatit Hrushov, që bërtet se Kenedi dëshiron paqen.

Populli dhe Partia jonë do të qëndrojnë në lartësinë e kohës. Të kalitim kurdoherë te populli ynë një optimizëm të drejtë revolucionar, të forcojmë unitetin Partipopull, besimin në forcat tona, sepse vetëm kështu armiqtë nuk do të guxojnë të na prekin, bile edhe provokacione po të guxojnë të bëjnë kundër Shqipërisë, do t'i nxirrnin vetes telashe të mëdha (e kam fjalën jo vetëm për fqinjët tanë, po edhe për grupin revizionist-tradhtar të N. Hrushovit), sepse asnjë njeri në botë nuk mund të besojë se në këto provokacione nuk është gisht i N. Hrushovit. Çështja është që sa më të fortë të jemi, aq më mirë është për ne, se vetëm kështu s'kanë ç'të na bëjnë armiqtë. Veç asaj, ne nuk jemi vetëm, sepse Shqipëria ka miq të shumtë në të gjithë botën, e në radhë të parë RP të Kinës.

Në këto situata, pra, popullin duhet ta mbajmë të qartë, të ngremë kurdoherë lart moralin dhe entuziazmin e tij për mbrojtjen e të drejtave tona, të lirisë dhe të fitoreve të arritura, ta mobilizojmë popullin për realizimin e detyrave të planit, veçanërisht të bujqësisë, se kjo ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Kini parasysh atë që tha shoku Mehmet, se situatat mund të

vështirësohen akoma më tepër, prandaj të jemi pregatitur për të përballuar gjer në fund çdo situatë. Ne i kemi marrë të gjitha masat që populli të mos mbetet as pa bukë, as pa armë. Tani ne jemi në çdo pikëpamje shumë herë më të fortë se më përpara, veç duhet të punojmë që gjendjen tonë të brendshme ta forcojmë gjithnjë e më shumë. Ndihamat e miqve kanë rëndësi për ne dhe ato vazhdojnë e do të vazhdojnë të na vijnë, sa kohë që situatat nuk janë vështirësuar më tej. Por, sido që ato të vështirësohen, ne do t'i kapërcejmë dhe ky do të jetë një sukses i madh, sepse kështu demaskohet imperializmi dhe revizionizmi, forcohet gjithnjë e më tepër edhe besimi në popull. Po, për të ecur përpara, vetëm ndihamat nuk janë të mjaftueshme. Ne duhet të punojmë vetë sa më shumë që të krijojmë një potencial edhe më të madh ekonomik e mbrojtës, të arrijmë që jo vetëm ta mbajmë nivelin aktual të jetesës së popullit tonë, po ta përmirësojmë atë edhe më tej. Dhe këtë ne do ta bëjmë me doemos, mundësitë i kemi, sepse në radhë të parë kemi një Parti të çeliktë dhe një popull të lavdishëm.

Të rrojnë Partia jonë heroike dhe populli ynë i mrekullueshëm!

*Botohet për herë të parë, me shkurtime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLEMIN E 23-të ..... V—VIII

1962

- SHKENCA DHE TEKNIKA TE NE JANË PRONË E MASAVE — Nga fjala në mbledhjen solemne me rastin e 15-vjetorit të themelimit të politeknikut «7 Nëntori» (6 janar 1962) ..... 1—26.
- TË JEMI VIGJILENTË, TË QARTË POLITIKISHT DHE TË ARMATOSUR KUNDËR ARMIQVE TË JASHTËM DHE TË BRENDSHËM — Diskutim në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë të rrethit të Shkodrës (15 janar 1962) ..... 27—44.
- GJYKATËSI PËRFAQËSON DHE MBRON INTERESAT E KLASËS NË FUQI — Diskutim në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë të rrethit të Shkodrës (15 janar 1962) ..... 45—51.
- KOMUNISTËT JANË KURDOHERË SË BASHKU ME POPULLIN SI NË KOHË TË MIRA DHE NË KOHË TË VËSHTIRA — Nga fjala me punonjësit e Fabrikës së Cigareve dhe të Uzinës së Fermentimit të Duhanit në Shkodër (15 janar 1962) ..... 52—66.
- PA ÇIMENTO NDËRTIMET TONA S'KANË «BUKË» — Nga fjala me punëtorët e Fabrikës së Çimentos në Shkodër (16 janar 1962) ..... 67—78.
- KOOPERATIVAT BUJQËSORE T'I NDIHMOJMË ME KREDI NË BAZË TË KRITEREVE TË ÇAKTUARA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 janar 1962) ..... 79—81.
- PUNA ORGANIZATIVE E PARTISË NUK DUHET SHKËPUTUR NGA DETYRAT E TJERA — Diskutim

në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 janar 1962) .....	82—86
PAK FJALË PËR MASAT NDËSHKIMORE DHE SHLYERJEN E TYRE — Diskutim në mbledhjen e Se- kretariatit të KQ të PPSH (20 janar 1962) .....	87—89
PAK FJALË MBI PRANIMET NË PARTI NGA RA- DHËT E USHTRISË — Diskutim në mbledhjen e Se- kretariatit të KQ të PPSH (20 janar 1962) .....	90—92
ARSIMI ËSHTË NJË NGA SEKTORËT MË TË RËN- DËSISHËM TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 janar 1962) .....	93—95
VITI 1962 TË JETË NJË TJETËR VIT LUFTE PËR REALIZIMIN E PLANIT — Nga fjala e mbajtur në Plenumin e 6-të të KQ të PPSH (25 janar 1962) .....	96—127
DISA PIKËPAMJEMBI KRYENGRITJEN E FSHATA- RËSISË SË SHQIPËRISË SË MESME (1914-1915), TË UDHËHEQUR NGA HAXHI QAMILI (31 janar 1962)	128—175
FIERI — NJË NGA HAMBARËT E MËDHENJ PËR DRITHËRAT E BUKËS — Nga fjala në konferencën e 12-të të Partisë të rrethit të Fierit (18 shkurt 1962)	176—216
TË KUJDESEMI VAZHDIMISHT PËR GRATË DHE TË REJAT — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekre- tariatit të KQ të PPSH (1 mars 1962) .....	217—219
FIZKULTURA DHE SPORTET NDIHMOJNË SHUMË PËR SHËNDETIN E MASAVE — Diskutim në mble- dhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (1 mars 1962)	220—224
MENDJEMADHËSIA SHFAQET NË FORMA TË NDRYSHME — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (31 mars 1962) .....	225—234
KUNDËR FESË DHE ZAKONEVE PRAPANIKE KËR- KOHET NJË PUNË MË E ORGANIZUAR — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (3 prill 1962) .....	235—241

MONUMENTET E KULTURËS — THESAR I MADH I POPULLIT TONË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (3 prill 1962) .....	242—253
RADIOJA — NJË NGA MJETET MË TË RËNDE-SISHME TË PROPAGANDËS SË PARTISË — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (3 prill 1962) .....	254—258
TË MIREMBAJMË DHE TË SHFRYTËZOJMË SI DUEHET VEPRAT E BONIFIKIMIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (3 maj 1962) .....	259—263
ZGJEDHJA DHE TRAJTIMI I FARËRAVE BUJQË-SORE ËSHTË NJË PUNË SHKENCORE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (3 maj 1962) .....	264—269
MARRJA E ARSIMIT KËRKON VËLLNET, KËMBË-NGULJE, KONTROLL — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (4 maj 1962) .....	270—272
TË BËJMË NJË PUNË MË TË STUDJUAR PËR FORCIMIN E PËRBËRJES DHE TË SHTRIRJES SË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (4 maj 1962) .....	273—277
TË FORCOHET PUNA MËSIMORE, EDUKATIVE DHE PEDAGOGJIKE NË SHKOLLAT USHTARAKE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (4 maj 1962) .....	278—281
VIJA E PARTISË SONË ËSHTË NJË VIJË E DREJTË, REVOLUCIONARE DHE NË PËRPUTHJE ME MËSIMET E MARKSIZËM-LENINIZMIT — Letër dërguar të gjitha organizatave-bazë të Partisë (9 maj 1962) .....	282—296
ZGJEDHJET TË NE KANË QENË KURDOHERË SHPREHJE E LARTË E UNITETIT TË POPULLIT RRETH PARTISË — Fjala para zgjedhësve të zonës elektorale Nr. 179 (30 maj 1962) .....	297—347

POPULLI ËSHTË MËSUESI MË I MIRË I PARTISË — Fjala në mitingun e organizuar në Memallaj të Tepelenës (27 qershor 1962) .....	348—361
POPULLI YNË USHTRON PLOTËSISHT PUSHTETIN E TIJ SOVRAN — Fjala në sesionin e parë të legjislaturës së pestë të Kuvendit Popullor (14 korrik 1962) .....	362—368
LETËR URIMI ME RASTIN E 80-VJETORIT TË DITËLINDJES SË PROFESOR DOKTOR MAKSIMILIAM LAMBERC — (18 korrik 1962) .....	369—370
KUADROT TË LIDHEN MË NGUSHTË ME PRODHIMIN, ME POPULLIN, ME LIBRIN — Fjala në Plenumin e 7-të të Komitetit Qendror të PPSH (19 korrik 1962) .....	371—395
«ZËRI I POPULLIT» LUFTËTAR I VENDOSUR PËR ÇËSHTJEN E PARTISË — Letër përshëndetjeje me rastin e 20-vjetorit të themelimit të gazetës «Zëri i popullit» (25 gusht 1962) .....	396—399
PEZA HEROIKE — NJË NGA BAZAT E SHËNDOSHATË LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARË — Fjala në drekën e shtruar me rastin e 20-vjetorit të Konferencës historike të Pezës (16 shtator 1962) .....	400—413
ZEMRËN E KAM PLOT KUJTIME PËR SHKOLLËN TIME TË PARË, PËR MËSUESIT E MI TË DASHUR — Letër dërguar nxënësve dhe mësuesve të gjimnazit «Asim Zeneli» Gjirokastrë (17 shtator 1962) .....	414—418
PUNA DHE SJELLJET E KUADROVE NDIKOJNË SHUMË TE TË TJERËT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 shtator 1962) .....	419—427
FSHATI KA NEVOJË PËR MË SHUMË MJEKË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 shtator 1962) .....	428—432
SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA E MAKINERISË — PROBLEM I RËNDËSISHËM EKONOMIK DHE POLITIK — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 shtator 1962) .....	433—440

NUK DUHEN LËNË PAS DORE BAGËTITË E IMTA DHE KULLOTAT E TYRE DIMËRORE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 shtator 1962) .....	441—443
DISA VËREJTJE E SUGJERIME PËR METODËN E PUNËS NË BASHKIMET PROFESIONALE DHE NË BASHKIMIN E RINISË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 shtator 1962) .....	444—452
TRADHTI E MADHE NDAJ MARKSIZËM-LENINIZMIT — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (13 tetor 1962) .....	453—483
TË MARRIM MË SHUMË RENDIMENT NË PRODHIMIN E DRITHËRAVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 tetor 1962) .....	484—487
FUTBOLLI TË MOS SHIHET ME SYRIN E REPARTIT, POR NËN PRIZMIN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 tetor 1962) .....	488—490
TË HEQIM DORË NGA FORMULAT DHE TË JEMI MË KONKRETË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 tetor 1962) .....	491—495
DISA MENDIME PËR SHFRYTËZIMIN E LITERATURËS TEKNIKO-SHKENCORE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 tetor 1962) .....	496—501
PUNA IDEOPOLITIKE NË USHTRI DO TË BËJË QË AJO TË JETË KURDOHERË NË GATISHMËRI EDHE NGA ANA USHTARAKE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 tetor 1962) .....	502—506
INTELIGJENCA JONË RRRITET DHE ZHVILLOHET NË GJIRIN E POPULLIT — Fjala në takimin me përfaqësuesit e inteligjencës së kryeqytetit (25 tetor 1962) .....	507—570
NE NUK DO TË MBETËMI KURRË PA BUKË DHE PA ARMË — Nga fjala e mbylljes në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH (28 tetor 1962) .....	571—586